

Përkushtim ekstrem

Tregime ditore përkushtimi

*të besimtarëve të hershëm dhe atyre të kohëve të sotme,
të cilët sakrifkuan gjithçka për Krishtin.*

Zëri i Martirëve

Përkushtim ekstrem

Tregime ditore përkushtimi

*të besimtarëve të hershëm dhe atyre të kohëve të sotme,
të cilët sakrifkuan gjithçka për Krishtin.*

Zëri i Martirëve



The Voice
of the Martyrs



Përktheu: Etleva Zela
Redaktuan: Aurora Manaj, Valbona Avdullaj

Titulli i origjinalit:
Extreme Devotion

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, të mblidhet, të transmetohet në ndonjë mënyrë, apo me ndonjë mjet – elektronik, mekanik, fotokopje, regjistrim, apo ndonjë mjet tjetër përveç ndonjë citimi të shkurtër në përmbledhjet e botuara, pa lejen e botuesit.

Originally published in English as
Extreme Devotion
© 2001 by The Voice of the Martyrs.
English edition published by
W Publishing Group, Nashville, Tennessee, USA.

© 2008 by The Voice of the Martyrs for the Albanian edition.
Translated by permission. All rights reserved.
Published in cooperation by The Voice of the Martyrs and OM EAST.

PËRKUSHTIM EKSTREM
Copyright 2001, Zëri i Martirëve

Ky libër u kushtohet...

Atyre që zgjodhën vdekjen e jo mohimin e besimit...

Që zgjodhën besimin e jo frikën...

**Dhe vendosën më mirë të ishin dëshmitarë
sesa të largoheshin.**

Për të gjithë ata për të cilët bota nuk ishte e denjë.

Hebrenjve 11:38

Mirënjohje

Realizimi i këtij projekti ishte një përpjekje e vërtetë skuadre dhe janë shumë persona për t'u falënderuar.

Së pari do të doja të falënderoja Perëndinë për dashurinë e tij të madhe dhe për drejtimin e tij. Atij i shërbejmë dhe për lavdinë e tij shkruajmë.

U jam mirënjohës të gjithë martirëve, të së shkuarës dhe të së tashmes, jetët e të cilëve na kanë prekur me anë të besimit dhe përkushtimit të tyre. Pa shembullin e tyre, kisha sot nuk do të ishte e plotë.

Falënderoj veçanërisht Ë. Publishing për përkushtimin dhe vizionin e tyre. Pa ata, ky libër do të kishte pasur një publik më të vogël. Është frymëzuese të shohësh dëshirën e tyre për të bërë të mundur që këto lloj burimesh të jenë në dispozicion për ata që dëshirojnë të shkojnë përtej zonës së rehatisë së krishterë.

Gjithashtu do të doja të falënderoja dhe i jam mirënjohës skuadrës së kërkimit dhe të shkrimit, që ka punuar me këmbëngulje për të plotësuar këto histori. Xhini Kleri, Rik Killiën, Tod Netllton, Sheril Oden dhe Henri «Buddy» Von, të gjithë kanë punuar pa u lodhur bashkë me drejtuesin e skuadrës, Stiv Kleri.

Falënderimet e fundit janë gjithashtu, për Meri An Lekland, Deiv Virmen, Eshli Teilër, Peixh Draiges dhe Greg Longbons të kompanisë Livingston, që shtuan mendimin e tyre të çmuar në këtë libër dhe kanë punuar ngushtë me skuadrën Ë për të dhënë produktin përfundimtar.

Tom Uait

Drejtori i SHBA i Zërit të Martirëve

Hyrje

Besimtarët, për të cilët flitet në këtë libër, nuk janë viktimë; ata janë fitimtarë. Historitë e tyre shtrihen përmes historisë, që nga dishepujt e vetë Jezusit e deri te martirët e kohëve të sotme. Persekutuesit janë të të gjitha llojeve, që nga romakët te rumunët, që nga kriminelët e rëndomtë deri te myslimanët, që nga konfu-të (lloj kult) deri te komunistët. Secili prej këtyre besimtarëve është një shembull për ne, shembull i një përkushtimi ekstrem ndaj Krishtit. Këta besimtarë, historitë e të cilëve do t'i gjeni në këto faqe, zbuluan një dëshirë më të thellë se thjesht instinktin njerëzor për vetëmbrojtje: dëshirën për t'i shërbyer Krishtit dhe për të qenë dëshmitarët e Tij.

* * * *

Ndërsa filluam të hartonim këtë libër, hymë në një epokë të re në Amerikë. Ngjarjet e 11 Shtatorit të vitit 2001 ndryshuan fasadën e një bote të lirë dhe kjo na çoi të gjithëve në një kohë pyetjesh – një kohë kur shumë njerëz do t'i drejtoheshin kishës për përgjigje – një kohë kur kisha do t'i drejtohej Perëndisë në gjithëpushtetshmërinë e Tij për forcë.

Është qëllimi ynë përfundimtar që ky libër të përdoret për të zgjeruar të menduarit dhe për të ndikuar në veprimet tona, kur ne vetë të përballemi me vështirësi të tmerrshme. Për shembull, si reagojmë ne ndaj atyre që na bëjnë keq? Si reagoi Krishti? Si reagues të krishterët në të shkuarën? Cili duhet të jetë qëndrimi ynë ndaj njerëzve të besimeve të tjera, nëse na kundërshtojnë me dhunë? A është e drejtë të rrezikosh çdo gjë për t'u treguar atyre që mund të na vrasin për dashurinë e Zotit?

Ky libër nuk do t'u përgjigjet të gjitha këtyre pyetjeve, por është e sigurt që do të na sfidojë besimin. Ndërsa lexoni këto histori të të krishterëve, që kanë kaluar vështirësi të mëdha për kauzën e Krishtit, shikoni përtej tragjedisë dhe vështirësive për të zbuluar gurët e çmuar që ndodhen nën sipërfaqe.

Fokusohuni te besimi që ndodhet në dëshmitë e këtyre motrave dhe vëllezërve të guximshëm. Mësoni se i njëjti Shpirt që banon, apo banonte në ta, banon gjithashtu edhe tek ju dhe besoni se keni të njëjtën masë besimi në vetvete në çdo rrethanë ekstreme.

Ndërsa lexoni këto rrëfime do të arrini një vlerësim të vërtetë të anës radikale të besimit, duke fituar dhe kuptuar teologjinë e vuajtjes.

Pjesa e parë në kuptimin e kësaj teologjie është në të kuptuarit se këto tregime nuk janë rrëfime të pashpresa mundimesh dhe as që këta janë «super» të krishterë.

Sigurisht që ata janë të pazakontë për guximin e tyre, këmbëngulës përtej arsyes njerëzore dhe të përkushtuar ndaj Krishtit në një mënyrë që ndonjëherë është e vështirë për t'u kuptuar. Në të vërtetë ata janë të krishterë të zakonshëm (si ne), që përballen me situata të pazakonta.

Por çfarë elementi misterioz në dukje i çon ata në të tillë «përkushtim ekstrem»? E thënë fare thjesht, besimi i tyre në Jezusin si Zot, i cili kishte si pasojë vuajtjen.

Vetëm besimi është i mjaftueshëm. Të vuash nga duart njerëzore mund të jetë e padurueshme. Kur vuajtja është për mbretërinë e Krishtit, me besim, ajo forcon zemrën e të

krishterit që është i hapur dhe me dëshirë për ta lënë veten e tij me qëllim që të marrë më shumë prej Krishtit.

Të gjithë martirët në këtë libër ndajnë një zjarr të përbashkët për Perëndinë dhe ky zjarr mposhti frikën e tyre për pasojat e ashpra të kapjes, duke u treguar të tjerëve për dashurinë e Perëndisë.

Ndoshta një pjesë e zjarrit të tyre vinte nga njohja e çmimit të lartë të asaj që zotëronin. Kur besimi na kushton diçka, ai pa dyshim që bëhet më me vlerë. Është pikërisht ky aspekt i natyrës njerëzore që forcon të krishterët që jetojnë nën qeveri shtypëse, të cilat nuk lejojnë liri fetare.

Shën Augustini ka thënë një herë: «Martir të vërtetë të bën motivi dhe jo vuajtja». Sipas origjinalit në greqisht, fjala «martir» do të thotë «dëshmitar».

Martirët në këtë libër ishin në gjendje të dëshmonin personalisht të vërtetën dhe fuqinë e Jezu Krishtit dhe të besonin se do ta çonin këtë dëshmi tek të tjerët, pavarësisht nga çmimi.

Në dramën e tij *Vrasje në Katedrale*, T. S. Eliot e përshkruan një martir si dikë «që është bërë *instrument* i Perëndisë, i cili ka lënë vullnetin e tij në vullnetin e Perëndisë dhe nuk e humbet, por e gjen atë, sepse ka gjetur liri duke iu nënshtruar Perëndisë. Martiri nuk dëshiron asgjë për vete, madje as lavdinë e martirizimit».

Të qenit dëshmitar të vendos në frontin e zjarrit. Pastor E. V. Hill tregoi një herë një histori për një grua, që kishte shkuar tek ai dhe i kishte thënë: «Pastor Hill, lutuni për mua. Djalli po më ndjek». Dhe pastor Hilli i ishte përgjigjur: «Djalli nuk po të ndjek. Nuk ke bërë mjaft që djalli të të ndjekë». Qëllimi për të gjithë të krishterët duhet të jetë që të «bëjnë mjaft» për mbretërinë e Krishtit, që të tërheqin vëmendjen e djallit.

Kur disa forma vuajtjesh vijnë tek ju për shkak të dëshmisë së krishterë, shpresa jonë është që ju, si personat në këtë libër, të përjetoni lavdinë dhe bukurinë e *Përkushtimit Ekstrem*.

*Ekipi që shkroi Përkushtim Ekstrem
Zëri i Martirëve*

EKSTREM

Pyetje ekstreme

TURQI: ERKAN SENGUL



Kur Erkan Senguli ia përkushtoi jetën Krishtit në shtetin mysliman të Turqisë, disa e panë këtë si mohim të trashëgimisë së kombit të tij. Kur ai tha se do të bënte gjithçka për Perëndinë, e kishte me gjithë mend. Por, po tani?

Erkani ishte ulur në errësirë, në një qeli të ftohtë burgu i rrethuar nga shokët me të cilët ndante qelinë. Ishte arrestuar nga qeveria lokale, e cila kishte thënë se ai kishte «fyer» islamin duke shpërndarë libra të një botuesi të krishterë. Erkani i thirri Perëndisë duke i lutur që të lirohej. Ai e dinte që s'kishte bërë asgjë të keqe dhe që nuk e meritonte të ishte atje. «Ti më ke thënë se do të bëje gjithçka për mua», – i pëshpëriti në zemër Perëndia Erkanit. «E kishte me gjithë mend?» I thyer para Perëndisë, Erkani qau dhe e adhurroi. I tha Perëndisë në zemër të tij: «E kisha me gjithë mend». Erkani filloi të predikonte tri orë çdo ditë në burg. Mësoi se Perëndia e lejoi të ishte në burg për t'i dhënë një fushë të re misioni! Erkani qëndroi aty për tridhjetë ditë derisa dëshmitarët pranuan që policia i kishte detyruar të firmosnin deklaratën dhe gjykatësi nuk gjeti të dhëna për ndonjë krim. Arrestimi kishte përhapur dëshminë e Erkanit. Që nga lirimi i tij, shumë persona me të cilët ai kishte ndarë qelinë vizituan kishën e tij, duke pyetur për Perëndinë, i cili i dha paqe ndërsa ishte i mbyllur në burg. Erkani akoma shpërndan me gëzim libra të krishterë, duke e ditur që mund të arrestohet.

Pjesa më e madhe e të krishterëve do ta pranonin që vuajtja nuk është pikërisht ajo që ne kemi ndërmend kur themi se duam që Perëndia të na përdorë. Sigurisht, ne duam ta jetojmë besimin tonë, por jo deri në pikën e persekutimit. Neve nuk na vjen mirë kur na shpërfillin në punë, kur bëhet fjalë për ngritje në detyrë, apo për përjashtim nga ngjarjet shoqërore. Ndihe mi të fyer, të mashtruar, të shpërfillur. Megjithatë, duhet të kemi vullnetin e mirë të kërkojmë Perëndinë me anë të lutjeve, në kohë dëshpërimi. Në momentin që e bëjmë këtë, zbulojmë që lutja ndryshon perspektivën tonë, fillojmë të shohim mundësi për rritje, marrim shpresë, zbulojmë premtimin nëpërmjet vuajtjes. Në fakt ne fillojmë të zbulojmë situatën tonë aktuale, megjithëse e padrejtë dhe e pamërituar, në fund të fundit, mund të jetë pjesë e planit të Perëndisë. Kur lutemi për këndvështrimin e Perëndisë ndaj persekutimit, gjejmë kurajë dhe bindje me çdo kusht.

Lutu edhe për mua, që kur të hap gojën, të flas lirshëm për ta bërë të njohur misterin e Ungjillit, për të cilin jam i dërguari në pranga.

Efesianëve 6:19-20

Unitet ekstrem

MAURITANIA: TIMOTEU

«Trego, Timote, të lutem!» – thirri Maura duke iu përgjëruar të shoqit. «Tregoji guvernatorit ku janë Shkrimet e fshehura dhe do të jesh i lirë! S'mund ta duroj të të shoh më në këtë gjendje.» Timoteu dhe Maura, banorë të provincës romake të Mauritanisë, ishin martuar vetëm disa javë para arrestimit.

Maura kishte parë e tmerruar ndërsa ushtarët ia nxorën sytë të shoqit me hekur të nxehtë, duke u përpjekur ta mposhtnin vullnetin e tij. Tani i varur kokëposhtë, me një peshë rreth qafës sipas urdhrimit të guvernatorit romak, Arrianit, Timoteu priste që të varej. Frika që ai ndjeu në fillim kur e arrestuan ishte zëvendësuar me një ndjenjë qetësie hyjnore.

Në vend që të mohonte besimin dhe të zbulonte vendndodhjen e kopjeve të Shkrimeve të kishës së tij, siç prisnin edhe ushtarët, Timoteu qortoi të shoqen: «Mos lejo që dashuria për mua të kalojë para dashurisë për Krishtin», – e nxiti ai Maurën, duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë e tij për të vdekur për Shpëtimtarin e tij. Duke parë kurajën e të shoqit, vendosmëria e Maurës u forca.

Arriani, tashmë i inatosur nga refuzimi i Timoteut, vendosi të thyente kurajën e sapogjetur të Maurës. Ai e dënoi atë me torturat më të ashpra të botës romake, por përsëri ajo nuk u mposht dhe refuzoi ta mohonte Krishtin.

Pasi secili kishte kaluar vuajtje të përkrahueshme, Timoteu dhe Maura u kryqëzuan pranë e pranë.

Jezusi nuk ua besoi shërbesën e Tij besimtarëve në veçanti – ai themeloi një familje shpirtërore. Përdori fjalë si «vëlla» dhe «motër» për të shprehur idenë, që ai nuk priste që dishepujt e tij të ishin vetëm në gjithë këtë. Pali vazhdoi misionin e Krishtit duke udhëzuar besimtarët e rinj për t'u mbledhur së bashku në kishë për miqësi dhe adhurim të përbashkët. Të krishterët kanë nevojë për njëri-tjetrin, veçanërisht në kohë sprovash. Kur një besimtar pengohet, bashkëbesimtarët mblidhen për mbështetje dhe inkurajime. Ja pse Dhiata e Re e konsideron detyrën e të jetuarit duke qenë një shembull, si domosdoshmëri në besimin e krishterë. Shembulli i besimit dhe kurajës së një besimtari mund të frymëzojë dhe të bashkojë të tjerët për t'u bërë ndjekës. Në të kundërt, kur një besimtar dorëzohet nën presionin e persekutimit, është më e lehtë që edhe të tjerët të dorëzohen. Historia e ngrë lart unitetin e komunitetit të krishterë, veçanërisht gjatë persekutimit.

Që zemrat e tyre të ngushëllohen, duke u bashkuar në dashuri.

Kolosianëve 2:2

FKSTREM

Gatishmëri ekstreme

KINË: PASTOR LI DEKSIAN

Në çastin kur pastori Li Deksian filloi predikimin e tij, dyert e shtëpisë – kishë u hapën me vull. Oficerë të armatosur të Byrosë së Sigurimit Publik kinez mbushën dhomën, duke kërcënuar të gjithë të pranishmit dhe duke rrëmbyer Linë për ta arrestuar.

«Prisni, ju lutem, sa të marr çantën.» Si gjithmonë, toni i pastorit me oficerët ishte i sjellshëm, por i vendosur.

Oficerët u habitën me kërkesën. «Çfarë ka në të?» – e pyetën duke ia rrëmbyer çantën me zinxhir të zi dhe e hapën. «Ka një batanije dhe një palë ndërresa rezervë.» – u tha Li atyre, sepse ai priste të arrestohej atë ditë.

Pastor Li ishte arrestuar shumë herë. Dy herë policia e kishte rrahur derisa kishte vjellë gjak dhe një herë e kishin goditur në fytyrë me Biblën e tij. Lija ishte paralajmëruar që policia po ruante fshatin ku ai kishte takimet e të martave. Ai e dinte se po të vinte e të predikonte, do të arrestohej. Sot qytetarët kinezë mund të dërgohen në kampe pune për tre vjet pa një gjyq zyrtar.

Rreziqet ishin të mëdha, por çanta e Lisë ishte e paketuar. Më shumë se sa çanta e paketuar, ai kishte mendjen dhe zemrën të përgatitur. Ishte gati të paguante çfarëdo çmimi për të predikuar ungjillin. Ai ishte i bindur se Perëndia do të kujdesej për të edhe në burg.

Gatishmëria është një shenjë përkushtimi. Përkushtimi që nuk është i përgatitur të sakrifikojë është thjesht një kompromis i fshehur. Për shembull, po ta konsideroni martesën një përkushtim, Do të të kushtonte egocentrizmin tënd duke i dhënë një grusht të fortë ndjenjës së pavarësisë. Megjithatë, rezultati është një martesë më e fortë. Marrëdhëniet që nuk janë gati të sakrifikojnë për hir të përkushtimit, nuk zgjasin.

Kompromisi kërkon një çmim të vazhdueshëm dhe dobëson dëshirën dhe aftësinë tonë për të qenë të përkushtuar. Në të njëjtën mënyrë, përkushtimi i besimtarit ndaj Krishtit duhet të ketë një çmim me qëllim që të ruajë vlerën e tij. Ne duhet të përgatitemi për testin e përkushtimit tonë duke konfirmuar çdo ditë që krishterimi ia vlen. Ia vlen të kalosh kohë në lutje të përditshme, ia vlen të mblidhesh dhe të adhurosh në kishë, ia vlen të durosh vështirësi dhe sprova, abuzime dhe madje, edhe arrestim për nder të ruajtjes së përkushtimit tonë pa kompromis.

Shumë të dashur, mos t'ju duket çudi për provën e zjarrit që u bë ndër ju për t'ju provuar, sesi ju ndodhi diçka e jashtëzakonshme.

1 Pjetrit 4:12

FKSTREM

Dritë ekstreme

KOLORADO: RAKELA SKOT

«Humba të gjithë miqtë e mi në shkollë. Tani që kam filluar të jetoj sipas asaj që flas, ata tallen me mua.» Fillimet e ditarit të Rakelës treguan zhgënjimin e saj, pikërisht çdo person të cilit donte t'i tregonte dashurinë e Krishtit, u largua prej saj. Por ajo nuk do të dorëzohej.

«Unë nuk do të kërkoj të falur se po flas për emrin e Jezusit. Do ta pranoj këtë. Nëse miqtë e mi bëhen armiqtë e mi sepse unë dua të jem me mikun tim më të mirë, Jezusin, atëherë le të jetë kështu. Gjithnjë e kam ditur që të jesh një i krishterë do të thotë të kesh armiq, por s'e kisha menduar kurrë që «miqtë» e mi do të ishin këta armiq.»

Rakela studionte në Shkollën e Mesme të Kolumbinit në kohën kur dy studentë hapën zjarr në shkollë. Një nga personat që mbante armë e pyeti nëse ajo akoma besonte te Zoti. Ajo e pa në sy dhe tha: »Po.« Ai e pyeti pse, por e qëllloi para se ajo të hapte gojën të përgjigjej.

Rakela Skot e kaloi provën e saj dhe për këtë shkak, drita e saj ndriçoi përtej shkollës, në mbarë botën. Kohë përpara se prova të vinte, Rakela kishte shprehur dëshirën e saj që të jepte gjithçka për Krishtin. Fjalët nga ditari i saj të shkruara pikërisht një vit para vdekjes, tregojnë për përkushtimin e saj: «Unë nuk do ta fsheh dritën që Zoti ka vendosur në mua. Nëse do të më duhet të sakrifikoj gjithçka, do ta bëj.»

Besimi është shprehje e padukshme e marrëdhënies sonë personale me Krishtin. Bibla e krahason besimin e njerëzve me një dritë – një shpërhapje e shpresës që ndikon çdo person përreth. Jezusi zgjodhi këtë ilustrim për shkak të pamundësisë së dritës për t'u penguar. Për shembull, të lexosh me dritë elektrike nën shtresa, gjë jo e ditur kjo nga pjesa më e madhe e fëmijëve, zor se është efikase përsa i përket fshehjes së aktivitetit të vonë gjatë natës! Drita nga vetë natyra ndriçon, pavarësisht nga përpjekjet tona për ta penguar. Në të njëjtën mënyrë, tensioni rritet në jetën e besimtarëve kur ata duhet të vendosin të shprehin plotësisht besimin e tyre, apo ta fshehin disi. Me besimin se ashtu si lind dielli, ata që kanë konfirmuar vendimin e tyre një herë e mirë, shkëlqimin e dritës e kanë si natyrë të dytë.

Ashtu le të shndrisë drita juaj para njerëzve që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiell.

Mateu 5:16

Lutje ekstreme

EKSTREM

KINË: MOTËR UONG

Kur oficeri i zyrës së Sigurisë Publike hyri në qelinë e burgut kinez, motër Uong u largua. Ky njeri pa zemër kishte arrestuar dhe persekutuar shumë të krishterë dhe vetëm disa ditë më parë e kishte rrahur ndërsa e kishte marrë në pyetje.

«Ju lutem, motër Uong, motra ime është shumë e sëmurë. Ka humbur ndjeshmërinë e këmbëve. Mund të vini të luteni për të?» A ishte ky i njëjti person që kishte konfiskuar qindra Bibla dhe libra të krishterë prej saj, i cili po kërkonte lutje? Në të vërtetë Perëndia do të ketë tërhequr vëmendjen e tij.

Ditë më parë, ndërsa oficeri e kishte marrë në pyetje dhe kishte keqtrajtuar motër Uongun, ai pati një telefonatë ku iu tha se e ëma ishte përplasur nga një makinë. Kur i tregoi mamasë së tij se çfarë ishte duke bërë, ajo i tha se sulmi i tij ndaj të krishterëve kishte shkaktuar aksidentin e saj. Oficeri e mori paralajmërimin thjesht si besëtytni.

Të nesërmen, ai e mori përsëri në pyetje motër Uongun, por mori një mesazh tjetër që i vëllai ishte plagosur në një aksident. I vëllai gjithashtu ua vuri fajin sulmeve të oficerit ndaj të krishterëve për fatkeqësinë e familjes. Por kur iu sëmur e motra, ai i kërkoi motër Uongut të lutej për të.

Motër Uongu pa mundësinë për të cilën ajo ishte lutur, mundësinë për t'u dëshmuar persekutuesve të saj. Perëndia ia shëroi motrën dhe nëpërmjet veprimeve të motër Uongut, Ai ndryshoi zemrën e oficerit. Oficeri ktheu të gjitha Biblat e konfiskuara dhe sot e kësaj dite është mbështetës i kishës.

Pjesa më e madhe e njerëzve tërhiqen në mënyrë të çuditshme nga lutja, veçanërisht në kohë lëndimi apo dhimbjeje. Barrierat ndaj çdo gjëje paksa fetare bien një nga një kur dikush kërkon apo merr lutje. Të rrallë janë personat që refuzojnë një ofertë lutjeje pa imponim. «Po lutem për ty» mund të jenë fjalët më të fuqishme që një besimtar i thotë një jobesimtar. Pse? Lutja është agjenti i Perëndisë për ndryshim. Ajo jep rezultate, ndonjëherë ajo ndryshon rrethana. Ndonjëherë kthen vendime. Më shpesh ndryshon ata që janë prekur nga lutja. Në Bibël na thuhet se veprimi i parë i shënuar pas kthimit në besim, të persekutuesit të mëparshëm të të krishterëve, Saulit nga Tarsi, ishte lutja. Kush e di rolin që do të luajë lutja në kthimin e «Saulëve» në besim në mbarë botën, të cilët aktualisht i janë përkushtuar shkatërrimit të të krishterëve!

Dhe Zoti i tha: «Çohu dhe shko në rrugën e quajtur E drejtë dhe kërko në shtëpinë e Judës një njeri nga Tarsi me emër Saul, i cili po lutet».

Veprat 9:11

«Faj» ekstrem

MADAGASKAR: RANAVALONA

Ranavalona I, mbretëresha e Madagaskarit, i urrente të krishterët në mbretërinë e saj. Ankesat e saj ndaj tyre ishin të shumta: ata përbuznin idhujt e saj, do ishin gjithnjë duke u lutur, shkonin në kishë dhe gratë e tyre ishin të thjeshta, të papërlyera. Ajo dërgoi oficerë për të mbledhur të gjithë ata që dyshoheshin se ishin të krishterë dhe i dënoi.

Kur u lexuan akuzat, gjashtëqind besimtarë u shpallën «fajtorë». Ata nuk mohonin akuzat, sepse duke vepruar kështu do të mohonin Krishtin. Mbretëresha u ofroi një mundësi të dytë për të mohuar Krishtin dhe për t'iu përlurur idhujve të saj, por secili prej tyre refuzoi. Ata u hodhën në biruca të errëta e të ftohta dhe shumë prej tyre u ekzekutuan. Mbretëresha u inatos edhe më shumë, se për çdo të krishterë që kishte vvarë, njëzet të tjerë ngriheshin.

Më vonë mbretëresha urdhëroi që pesëmbëdhjetë të krishterë të ekzekutoheshin. Ata u hodhën nga një shkëmb në një greminë shkëmbore 45 metra të thellë. Idhujt e mbretëreshës u çuan në majë të një shkëmbi, ku çdo i krishterë zbritej me ngadalë në buzë të tij i lidhur me litarë.

«A do të adhuron Krishtin tuaj, apo idhujt e mbretëreshës?» – pyesnin ushtarët çdo të krishterë që varej në greminë.

Çdo i krishterë përgjigjej thjesht «Krishtin». Litarët u prenë dhe ata u hodhën në greminë. Disa këndonin ndërsa shkonin drejt vdekjes. Një vajzë e re nuk u ekzekutua dhe u deklarua e çmendur. Më vonë ajo themeloi një kishë të madhe.

Në pjesën më të madhe të vendeve, të akuzuarit mendohen të pafajshëm derisa të provohet që janë fajtorë. Parimi që shtrohet është se duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për të dënuar një person për një krim. Të shprehësh besimin në Krishtin është shpesh një fytyrë ndaj qeverisë në shumë vende ku roli i sistemit të drejtësisë bie në kundërshtim. Besimtarët janë fajtorë derisa të provohet e kundërta. Dikujt i duhet të mohojë Krishtin me qëllim që të jetë i pafajshëm në një gjykatë njerëzore, tokësore. Megjithatë, në qiell vendimi fajtor është në fakt një fitore. «Faj ekstrem» do të thotë të sigurosh kaq shumë të dhëna për besimin në Krishtin, sa nuk do të të lironin nga akuzat. Paradoksi i njohur ia vlen të përsëritet:»Nëse sot je në gjyq sepse je i krishterë, a do të kishte mjaft të dhëna për të të dënuar?»

Dhe jini gati për t'iu përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju.

1 Pjetrit 3:15

**Ne kemi mësuar se vuajtja nuk është
gjëja më e keqe në botë – mosbindja ndaj
Perëndisë është më e keqja.**

NJË PASTOR I KRISHTERË VIETNAMEZ I BURGOSUR PËR SHKAK TË
BESIMIT TË TIJ NË KRISHTIN



Shenja ekstreme

JERUZALEM: THOMAI

Ai kishte dëgjuar zëra. Në fakt Thomai e kishte dëgjuar këtë direkt nga dishepujt e tjerë, të cilët e kishin parë Zotin të gjallë. Të paktën kështu i kishin thënë. «Pa e parë në duart e tij vrazhën e gozhdave e pa e vënë gishtin tim në vend të gozhdave; pa e shtirë dorën time në kraharorin e tij, nuk do ta besoj kurrë se është ringjallur», – kishte thënë Thomai.

Thomai nuk kërkonte mrekulli. As ndonjë shenjë të jashtëzakonshme. Ai thjesht donte të shihte shenjat në trupin e Jezusit, simbolet e vuajtjes së tij. Megjithëse Jezusi e kishte mundur vdekjen dhe jetonte në një trup të lavdishëm, ai akoma kishte shenja, në kujtim të çmimit që pagoi.

Tetë ditë më vonë Jezusi u shfaq përsëri. Sa budalla duhet të jetë ndjerë Thomai kur është ndodhur ballë për ballë me Zotin! Sa budallallëk duhet të jetë dukur thënia e tij e madhe kur dishepujt ia kanë kujtuar! Megjithatë, Jezusi nuk e qortoi ashpër Thomain. Ndërsa e shihte në sy, Jezusi ofroi duart e tij, duke e inkurajuar të prekte shenjat dhe të besonte.

Shenjat e Krishtit mbetën pas ringjalljes si kujtim të trupit të tij që është akoma duke vuajtur. Sepse, megjithëse Ai e mposhti vdekjen, trupi i tij në tokë vuan akoma. Ai mund të identifikohet me ata persona në mbarë botën që kanë shenja për shkak të besimit të tyre në Krishtin.

Shenjat janë mësuesit tanë, si kujtues të gjallë të mësimëve të dhimbshme. Ato shpesh janë të shëmtuara për t'u parë dhe jo shpesh të drejtuara nga të tjerët për t'i parë. Në të njëjtën mënyrë, shenja e persekutimit në kishë nuk është shpesh çështje bashkëbisedimi në mbledhjet e krishtera. Kjo për ne është trishtuese. Një mister. Megjithatë qëllimi i tij është që të na mësojë. Persekutimi luan një rol të rëndësishëm në planin e mrekullueshëm të Perëndisë, që e gjithë bota të dëgjojë dhe t'i përgjigjet ungjillit. Jezusi mori shenjat e tij në mënyrë publike. Në fakt Ai inkurajoi Thomain t'i prekte ato me qëllim që të mësonte. Shenjat janë mësuesit tanë – duke na kujtuar çmimin që u pagua për shpëtimin tonë. Ne duhet të vazhdojmë të mësojmë prej tyre, nuk duhet ta shpërfillim çmimin që kisha e persekutuar ka paguar.

Dhe ti e ndoqe nga afër mësimin tim, sjelljen, këshillat, besimin, dashurinë, ngulmin, përndjekjet, vuajtjet që më ndodhën...ti e di çfarë përndjekjesh hoqa.

2 Tim 3:10-11

FKSTREM

Zgjedhje ekstreme

ANGLI: XHON LAMBERT

«Do të vendosësh të jetosh, apo të vdesësh? Si thua?»

Ai që pyeste ishte Henri VIII, mbreti i Anglisë, i cili kishte fuqi të pakufizuar në vend. «Krimineli», i cili qëndronte para tij i akuzuar për herezi, ishte Xhon Lambert, një tutor i greqishtes dhe latinishtes.

Lamberti sfidoi me guxim pastorin e tij që po predikonte diçka të pabazuar në Bibël. Për këtë Lamberti u soll para kryepeshkopit të Kanterbërit dhe më vonë para mbretit Henri. Duke cituar nga Shkrimet dhe duke shpjeguar origjinalin greqisht, Lamberti ia parashtroi kauzën e tij një grupi peshkopësh, avokatësh, gjykatësish dhe kolegësh. Të dyja palët argumentonin ashpër derisa Henri, i mërzitur prej tyre, i paraqiti Lambertit zgjedhjen përfundimtare: «Pas gjithë arsyetimeve dhe udhëzimeve të këtyre njerëzve të ditur, nuk je i kënaqur? Do të vendosësh të jetosh, apo të vdesësh? Si thua?»

Lamberti mori frymë thellë dhe u përgjigj me vendosmëri: «Unë e lë shpirtin tim në duart e Perëndisë dhe trupin tim në mëshirën tuaj».

«Ti duhet të vdesësh,» – u përgjigj Henri me përçmim, «sepse unë nuk do të bëhem mbrojtës i heretikëve». I dënuar për herezi, Lamberti u dogj në turrën e druve.

Lamberti ishte i papërulur në vdekjen e tij të ngadaltë torturuese. Ai ngriti duart lart në adhurim duke shpallur: «Asnjë veç Krishtit! Asnjë veç Krishtit!»

Në epokën tonë moderne të mundësive, e drejta jonë për të zgjedhur është rritur pa masë. Dyqind kanale televizive janë një e drejtë «themelore», me një fjalë, vetë liria. Ne duam mundësi. Shumëllojshmëri. Madje edhe vendimet materiale na lihen në prag të derës – çfarë të veshim, të hamë, të ngasim, apo çfarë të bëjmë. Megjithatë zgjedhjet tona nuk janë më – ato janë të panumërta. Në kontrast me këtë, kur na drejtohet pyetja më e rëndësishme e jetës, ne kemi vetëm një përgjigje për të dhënë: «Asnjë veç Krishtit». A ka ndonjë rrugë tjetër për në qiell? Asnjë veç Krishtit – Ai është Rruga. A ka ndonjë prioritet në jetë që meriton përkushtimin e plotë të dikujt? Asnjë veç Krishtit, ai është suprem. A mund ta kënaqë dikush tjetër dëshirën e zemrës njerëzore? Asnjë veç Krishtit nuk mund ta kënaqë. E vërteta nuk ka alternativë, ti e di. Kur pyetjet më të mëdha të jetës të të vijnë dhe do të të vijnë, të jesh i përgatitur të shpallesh që nga të gjitha mundësitë, a do të të kënaqë «asnjë veç Krishtit?»

Zgjidhni sot kujt doni t'i shërbeni...sa për mua dhe shtëpinë time do t'i shërbejmë Zotit.

Jozueu 24:15

TRADHTIA EKSTREME

Tradhti ekstreme

RUMANI: VËLLA VASILI

Në Rumaninë komuniste, kishat u mbyllën dhe pastorët u arrestuan si pjesë e një fushate 7 vjeçare për «të eliminuar kombet e çfarëdo besëtytnie».

Kur vëlla Vasili dhe gruaja e tij filluan të zhvillonin më shumë takime kishë në shtëpinë e tyre të vogël, ata e dinin që s'mund t'i shpëtonin përgjithmonë vëmendjes së qeverisë. Çdo mbrëmje Vasili lutej: «Zot, nëse ti e di se disa të burgosur kanë nevojë për ndihmën time, më dërgo përsëri në burg». Gruaja e tij u drodh ndërsa me zë të mekur dhe me ngurrim tha: «Amen».

Pastaj ata mësuuan se shtëpia e një prej anëtarëve të kishës ishte bastisur dhe kopjet e predikimeve të Vasilit ishin konfiskuar. Mësuuan gjithashtu se ndihmës pastori, miq dhe bashkëpunëtori i tyre, ishte bërë informator dhe kishte paditur Vasilin.

Ishte ora 01:00 e mëngjesit kur policia bastisi apartamentin e vogël dhe arrestoi Vasilin. Ndërsa i vunë prangat, Vasili tha: «Nuk do të largohem këtej paqësisht, nëse nuk më lejoni disa minuta të përqafoj gruan time».

Policia pranoi me ngurrim. Do të vepronin shumë shpejt. Çifti u përqafoi, u lut dhe këndoi me aq emocion sa dhe kapiteni u prek. Më në fund e shoqëruan në një furgon policie ndërkohë që gruaja e Vasilit vraponte pas tyre me lot ndër sy. Vasili u kthye dhe tha fjalët e tij të fundit para se të zhdukej për shumë vjet: «Përsëritet djalin tonë dhe pastorin që më denoncoi».

Tradhtia ekstreme kërkon falje ekstreme. Nëse armiqitë tanë na kundëroihej me kaq egërsi, a nuk duhet të jemi po aq bujarë me veprën tonë të faljes? Kur armiku ynë shkon aq poshtë sa të na denoncojë, a nuk duhet të shkojmë ne aq lart sa të gjejmë vullnet për ta falur? Jezusi na mësoi që të falim të keqen se kjo është në të mirën tonë. Tradhtia e thellë mund të na shkaktojë ngurtësim të zemrave ndaj përjetimit të faljes nga ana jonë. Nëse je i kursyer në falje, të tillë çlirim do të përjetosh nga fajet e tua. Të tradhtohesh është mjaft keq. Të hidhërohesh është një mposhtje që s'mund ta përballosh. Kujt duhet t'i ofrosh falje ekstravagante sot?

Na i fal neve fajet tona ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë.

Mateu 6:12

«Ç'është?» – iu hakërrye Marko, kapiteni sovjetik, djalit të vogël. «Çfarë do?»

Djali, vetëm 12 vjeç, largoi frikën ndërsa qëndronte para oficerit komunist. «Kapiten, ju jeni personi që futi prindërit e mi në burg. Sot është ditëlindja e mamasë sime dhe unë i blej gjithnjë lule për ditëlindje.

Meqenëse mamaja më ka mësuar t'i dua armiqtë dhe t'ua kthej të keqen me të mirë, kam sjellë lule për mamanë e fëmijëve të tu. Ju lutem, çojini në shtëpi te gruaja juaj sonte mbrëma dhe tregojini asaj për dashurinë time dhe dashurinë e Krishtit.»

Kapiten Marko, i cili kishte parë pa u prekur se si të krishterët ishin rrahur dhe torturuar pa mëshirë, u habit nga veprimi i dashurisë së këtij djali. Lotët i ranë ndërsa me ngadalë eci përreth tavolinës dhe e pushtoi djalin me një përqaflim atëror. Zemra e Markos u ndryshua nga dhurata e dashurisë së Krishtit. Ai s'mund të arrestonte dhe të torturonte më të krishterë dhe shumë shpejt u arrestua edhe vetë.

Vetëm disa muaj pas vizitës së djalit në zyrën e tij, Markon e rrasën në një qeli të ndyrë burgu të rrethuar nga të njëjtët të krishterë, të cilët ai vetë kishte arrestuar dhe torturuar më parë. Me lotë ndër sy ai u tregoi shokëve të qelisë për djalin e vogël dhe për dhuratën e thjeshtë të luleve. E konsideronte një nder të ndante qelinë me ata që kishte gjurmuar dhe sulmuar më parë.

Bujaria është natyrë e dytë e besimtarit. Jezusi mësoi që të tjerët do ta njihnin besimtarin e vërtetë nga shfaqja e dashurisë dhe jo vetëm ndaj atyre që na duan. Shpesh herë bujaria ndaj të panjohurve, madje edhe ndaj armiqve, është aplikimi më i mirë i mësimëve të Jezusit. Dëshmitarët e veprimit tonë, nëse jo vetë marrësit, habiten nga ajo që shohin. Imagjinoni një punëtor të krishterë të lënduar që lutet për pronarin që e ka pushuar nga puna padrejtësisht. Imagjinoni ndikimin e prindërve që vuajnë, të cilët i japin dhuratën e faljes një shoferi të dehur. Bota nuk e kupton bujarinë, megjithatë ajo ndikohet prej saj. Zbulojmë se nuk bëhemi kurrë më të ngjashëm me vetë Perëndinë, derisa t'u japim me bujari të tjerëve. Perëndia dha Birin e tij të vetëm për të treguar dashurinë e tij për botën dhe bleu shpëtimin tonë. Çfarë mund të jepje sot që do të mund të hapte zemrën e dikujt për mbretërinë e Perëndisë?

Duajini armiqtë tuaj, bëjuni mirë atyre.

Luka 6:35

FKSTREM

Misionar ekstrem

PAKISTAN: SALEMA DHE RAHELA

«Nëse premtan të marrësh kryqin tënd, do të jetë një jetë plot me gjemba, male dhe vështirësi», – tha vajza palestineze me zë të vendosur. Salema, një e krishterë që jeton në pjesën e Pakistanit të dominuar nga myslimanët, i tregoi për besimin e saj një shoqeje të shkollës, Rahelës, e cila më vonë pranoi Krishtin.

Familja e zemëruar e Rahelës akuzoi Salemën «se kishte kthyer në besimin e krishterë një myslimane», një akuzë që mund të çonte në dënim me vdekje në Pakistan. Salema dhe pastori i saj u arrestuan dhe prindërit e saj u morën në pyetje dhe u rrahën nga policia. Salema u trajtue keq ndërsa ishte nën arrest nga policia, por nuk e mohoi besimin e saj. Në fakt, ajo këndonte këngë të krishtera në burg me shpresë që të tërhiqte të tjerë të Krishti.

Rahela u largua nga shtëpia, por familja e ndoqi. Kur i ofruan mundësinë e fundit për të braktisur besimin e saj dhe të kthehej te Muhamedi, ajo refuzoi. Për «krimin» e saj, vetë familja e ekzekutoi të bijën, Rahelën.

Salema kaloi nëpër seanca të gjata gjyqesh. Familja e Rahelës akuzonte atë për vdekjen e vajzës së tyre. Në fakt akuzat ranë, por jeta e Salemës nuk do të ishte kurrë si më parë. Ajo u detyrua të transferohej në një pjesë tjetër të Pakistanit nga frika e vrasjes prej myslimanëve radikalë. Megjithatë, gjembat, malet dhe vështirësitë nuk e kanë zbehur besimin e saj. Në fakt, ajo është duke u përgatitur për të shërbyer si misionare duke na thënë: «Nuk ka rëndësi sa i lartë është mali, Jezusi do të më ndihmojë për ta kaluar!»

Misionarët janë përshkruar gabimisht si një lloj forcash speciale – trup unik në ushtrinë e besimit të Perëndisë, që vepron në emrin tonë. E vërteta është se çdo besimtar është thirrur për të qenë misionar. Disa nga veprat më të vlefshme të Perëndisë mund të ndodhin rreth tavolinës së kuzhinës, duke pirë një kafe, apo në shtëpinë e komshiut aty afër. Ne duhet të ndajmë dashurinë e Krishtit. Për disa, ndarja e besimit të tyre me miqtë më të ngushtë do të ishte një bëmë me përmasa heroike. Për të tjerë, një shumëllojshmëri e konteksteve kulturore, do të formonte fushën e tyre të misionit. Nuk është përmasa e misionit tonë ajo që është e rëndësishme. Është motivi ynë që ka rëndësi, në çfarë ekstremi ke dëshirë të shkosh për të treguar për lajmin e mirë të Krishtit?

Lutem që bashkësia e besimit tënd të bëhet e frytshme nëpërmjet njohjes së çdo të mire që është në ju për shkak të Jezu Krishtit.

Filemonit 6

«Më duket sikur më është prerë njëri prej krahëve», – tha dr. P. P. Job. Ishte predikimi më i vështirë i jetës së tij – funerali i djalit të tij. Zëri i tij ishte plot emocion. «Por me çfarëdo që të mbetem, do të vazhdoj t'i shërbej mbretërisë së Krishtit».

Dr. Job drejton punën e Zërit të Martirëve në Indi dhe shpesh rrezikon jetën e tij duke udhëtuar për të inkurajuar të krishterët në vendet e ndaluara. Ai gjithashtu predikon në fushata të mëdha në Indi dhe ka parë me mijëra të kthehen te Krishti.

Puna e tij ka zemëruar hinduistët radikalë në vendin e vet. Në qershor të vitit 1999 dritarja e makinës së tij u godit nga një gur që i shkaktoi dr. Jobit plagë në ballë.


Një javë më vonë, djali më i vogël i dr. Jobit, Mikaeli, ndërsa po ecte pranë shkollës së mjekësisë ku studionte, u godit nga një makinë e tipit Fiat që më pas u largua me të njëjtën shpejtësi maksimale. Fajtori nuk u gjend ndonjëherë. Mikaeli, i dëmtuar rëndë, ra në koma dhe vdiq ditë më vonë.

Ashtu siç premtoi, humbja e të birit nuk e ka ndaluar shërbesën e dr. Jobit. Që nga vdekja e Mikaelit, dr. Jobi ka predikuar në më shumë fushata duke fituar mijëra për Krishtin. Çmimi i shërbesës së dr. Jobit ishte i lartë: biri i tij. Por ai nuk ishte vetëm. Perëndia e di ç'është të thotë të humbasësh një bir që të tjerët të mund të shohin shpëtimin.

Rruga që ndodhet përpara kishës së per-sekutuar është e thepisur dhe mund të jetë e gjatë. Për më shumë se dy mijë vjet, shumë janë motivuar nga i ligu në kundërshtimin e tyre ndaj ungjillit të Krishtit. Si të krishterë, ne duhet të jemi gati të paguajmë një çmim, madje edhe kur nuk na kërkohet të veprojmë kështu. Ky është një mësim nga jeta e Abrahamit. Ai ishte gati të sakrifikoje Isakun – me anë të të cilit do të vinte bekimi. Gatishmëria për të sakrifikuar për përkushtimin tonë ndaj Krishtit na bën më të fortë. Ideja e sakrificës qartëson synimet tona. Sakrifika përforcon karakterin tonë. Përkushtimet që na kushtojnë diçka ndryshojnë familjen tonë, lagjen tonë dhe botën për Krishtin. Ne mësojmë se sa të fortë mund të jemi në të vërtetë. Megjithatë nuk duam të humbasim çfarë kemi të dashur – ne përpiqemi të mbetemi të palëkundur në përkushtimin tonë, pavarësisht nga rrethanat.

*Tani e di mirë që ti i trembesh
Perëndisë, se nuk më ke refuzuar
birin tënd, të vetmin bir që ke.*

Zanafilla 22:12



**Zot, më bëj mjet të paqes sate
Ku ka urrejtje, më lejo të mbjell dashuri
Ku ka lëndim, falje
Ku ka dyshim, besim
Ku ka dëshpërim, shpresë
Ku ka errësirë, dritë
Ku ka trishtim, gëzim**

**O Zot hyjnor, më ndihmo,
Që të mos kërkoj më tepër të ngushëllohem,
sesa të ngushëlloj
Që të mos kuptohem sesa të kuptoj
Që të mos të duhem sesa të dua
Sepse kur japim, atëherë marrim
Kur falim, falemi
Kur vdesim, ne lindemi në jetë të përjetshme**

Shën Fransis i Asizit

FKSTREM

Buzëqeshje ekstreme

SIBERI: PAULI

Po bëhej vonë dhe oficeri sovjetik e kishte rrahur dhe torturuar Paulin për shumë orë. «Nuk do të të torturojmë më», – tha ai duke buzëqeshur brutalisht kur i krishteri ngriti sytë. «Do të të dërgojmë në Siberi, ku bora nuk shkrin asnjëherë. Është vendi i vuajtjeve të mëdha. Ti dhe familja jote do të përshtateni mirë».

Pauli, në vend që të dëshpërohej, buzëqeshi. «E gjithë toka i përket Atit tim, kapiten. Kudo që të më dërgosh, do jem në tokën e Atit».

Kapiteni e vështroi ashpër. «Do të të marrim gjithçka që ke». «Do t'ju duhet një shkallë e gjatë, kapiten, sepse thesari im ndodhet lart në qiell». Pauli kishte akoma një buzëqeshje të bukur.

«Do të të qëllojmë me plumb në ballë», – bërtiti kapiteni tani i zemëruar.

«Nëse më merr jetën në këtë botë, atëherë jeta ime e vërtetë e gëzimit do të fillojë», – iu përgjigj Pauli. «Nuk kam frikë të më vrasin».

Kapiteni e kapi Paulin nga këmisha e rreckosur e burgut dhe i ulëriti në fytyrë: «Nuk do të të vrasim! Do të të mbajmë të mbyllur vetëm në një qeli dhe nuk do të lejojmë asnjë të vijë të të takojë!»

«S'mund ta bëni këtë, kapiten», – tha Pauli, akoma duke buzëqeshur. «Kam një mik që mund të kalojë përmes dyerve të mbyllura dhe shufrave prej hekuri. Asnjë nuk mund të më ndajë nga dashuria e Krishtit.»

Pavarësisht nga një e ardhme e pasigurt, ne mund të jemi të sigurtë për një gjë: Krishti do ta përballojë atë bashkë me ne. Nëse po kalojmë një sprovë personale, apo një pikëllim publik, ne s'jemi asnjëherë vetëm. Në kontrast, çdo mik njerëzor do të na zhgënjë në një kohë të caktuar. Do të ketë vende në udhëtimin e jetës ku ata s'do të mund të ecin me ne – uji do të jetë shumë i thellë dhe qartësia më e madhe do të jetë e turbullt. Vetëm Jezusi ka aftësinë të kalojë përmes «shufrave të hekurit» në zemrat tona që vuajnë dhe të ndajë këto kohë të vështira. Megjithatë, në urtësinë e tij, ai mund të mos vendosë të na çlirojë nga rrethanat tona, prania e tij e sigurt do të na shoqërojë përmes tyre. Buzëqesh, duke ditur se ke një mik nga i cili nuk mund të ndahesh kurrë.

Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit? Pikëllimi, a ngushtica, a përmdekja, a uria, a të zhveshurit, a reziku, a shpata?

Romakëve 8:35

FKSTREM

Sakrificë ekstreme

INDONEZI: PASTOR HENDRIK PATIUAEAL

Ata u turrën për në dhomë ndërsa dëgjonin ulërimat e të krishterëve të tjerë që po masakroheshin jashtë. Pastor Hendrik Patiuael dhe gruaja e tij po ndihmonin në drejtimin e kampit të të rinjve indonezianë duke ndier përgjegjësi për të rinjtë nën kujdesin e tyre.

Kampi kishte qenë një kohë e gëzueshme rritjeje shpirtërore dhe adhurimi. Pastaj ata u sulmuan.

Kur turma e myslimanëve radikalë rrethoi ndërtesën ku ata ishin fshehur, pastor Patiuael doli jashtë. Duke tërhequr vëmendjen e turmës së etur për gjak larg prej gruas së tij dhe të rinjve, pastori u sulmua, ndërsa të tjerët shpëtuan.

«Jezus, më ndihmo!» Këto ishin fjalët e tij të fundit.

Gruaja e pa më pas të shtrirë në një arkivol. Plagë të shëmtuara mbulonin kryq e tërthor trupin dhe krahët e tij. E tronditur dhe në zemërim, zonja Patiuael i thirri Zotit.

«Si mund ta lejoje të ndodhte kjo? Pse nuk e mbrojte bashkëshortin tim?»

Por Fryma e Shenjtë i kujtoi fjalët e të shoqit disa ditë para sulmit. «Nëse më do mua, apo familjen tënde më shumë se Jezusin, atëherë nuk je e denjë për mbretërinë e Krishtit». Ai i kishte thënë se ishte i gatshëm të vdiste për mbretërinë e Krishtit.

Duke kujtuar këto fjalë, ajo refuzoi të hidhërohej. Sot punon akoma me kishën e saj në Indonezi. Këshilla që do t'u jepte ajo të krishterëve në vendet e lira është kjo: «Kërkoni Perëndinë më me zell, që të jini të qëndrueshëm përballë çdo problemi».

Neve nuk na duhet të kërkojmë telashe. Ato e kanë tashmë adresën tonë. Jezusi ua kujtonte shpesh dishepujve të tij, që sprovat janë pjesë e jetës së përditshme. Kërkimi i Perëndisë më me zell nuk do të thotë kërkimi i më shumë telasheve për jetën tonë. Jo, përfitimi i kërkimit të një marrëdhënieje më të thellë me Perëndinë është për të na përgatitur më mirë për të pashmangshmen. Ne nuk mund të zgjedhim problemet që mund të vijin në jetën tonë. Megjithatë, mund të vendosim të kemi një marrëdhënie me Perëndinë që na përgatit për problemet. Në disa sprova do të na duhet të humbasim jetën tonë për hir të Krishtit. Por përsëri, kjo nuk është sakrificë e vërtetë. Sakrificë e vërtetë duhet të vijë kohë më parë. Ne duhet të sakrifikojmë egoizmin tonë në çdo nivel me qëllim që të zhvillojmë më parë intimitetin me Perëndinë. Kur ne kemi sakrifikuar gjithçka për të ndjekur një marrëdhënie të veçantë me Krishtin, do të kemi bërë tashmë pjesën më të vështirë.

O vëllezër, ju bëj thirrje përmes dhemshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia që është shërbesa juaj e mençur.

Romakëve 12:1

FKSTREM

Dhimbje ekstreme

SUDAN: DJEMTË SUDANEZË

«Thuaje me ne!» – ulërinin ushtarët duke shkelmuar dhe grushtuar fytyrën dhe barkun e djemve.
«Allahu është Perëndia dhe Muhamedi është profeti i tij. Thuaje!»

Katër djemtë e rinj sudanezë qanin dhe ulërinin për nënat e tyre, por refuzonin të përsërisnin fjalët që do t'u shpëtonin jetën atyre duke mohuar krishterimin. Gjaku filloi t'u rridhte nga lëkura e tyre e zezë, por nuk hoqën dorë nga besimi në Krishtin.

Djemtë adoleshentë më të mëdhenj shikonin me tmerr. Ata kishin parë familjet e Sudanit Perëndimor të vrarë nga shpata e luftëtarëve islamikë, tani po shihnin katër shokët e tyre të vegjël dhe të afërm – më i vogli vetëm pesë vjeç – të rriheshin për vdekje.

Tashmë ushtarët kishin urdhëruar secilin prej djemve të mëdhenj të shtrihej mbi qymyr të nxehtë, të përsëriste kredon myslimane dhe t'i bashkohej besimit islamik. Asnjë prej djemve hapi gojë, pavarësisht nga dhimbjet torturuese.

Ishin katërbëdhjetë djem dhe trembëdhjetë vajza të rrëmbyera pas një sulmi atë ditë. Vajzat nuk u gjetën asnjëherë dhe ka të ngjarë të jenë shitur si skllave, apo konkubina në Sudanin e Veriut. Të gjithë djemtë u torturuan, por asnjë nuk u dorëzua.

Natën tjetër djemtë më të rritur u larguan duke mbartur shenjat e netëve të mëparshme. Askush nuk e mohoi besimin e tij.

Dhimbja luan shpesh një qëllim të rëndësishëm në planin e Perëndisë. Fatkeqësisht, nuk ka përvojë tjetër që barazon aftësinë e tij për të tërhequr dhe fokusuar vëmendjen tonë. Dhimbja fizike, prej një sëmundjeje të gjatë apo një dëmtimi të papritur merr të gjithë vëmendjen e trupit njerëzor. Truri dërgon sinjale në të gjithë sistemin nervor për të fokusuar rezervat në burimin e problemit. Në të njëjtën mënyrë, dhimbja emocionale është gjithashtu e vështirë për t'u shpërfillur. Ankthi i humbjes së dikujt që duam në rrethana të vështira si kanceri, apo sëmundje të tjera, persekutimi, apo të tjera padrejtësi mund të jetë dërrmuese. Në çfarëdo situate që na çon në dhimbje, kemi dy mundësi për t'u marrë me të. Ne mund të dorëzohemi ose mund të rritemi. Ata që përjetojnë dhimbje mund të bëhen shërbyesit unikë të hirit të Perëndisë. Si një atlet në stërvitje, muskujt e të cilit mund të tendosen nga mundimi dhe të ushtruarit për t'u bërë më i fortë, dhimbja është rruga jonë drejt një rritjeje të re.

Nëse dikush vuan si i krishterë, le të mos ketë turp, por le të përlëvdojë Perëndinë për këtë.

1 Pjetër 4:16

FKSTREM

Kundërshtim ekstrem

RUMANI: RIÇARD VURMBRAND

«I admiroj komunistët.» Fjalët dukeshin të çuditshme, të thëna nga një pastor që kaloi katërbëdhjetë vjet në burgjet komuniste, por Riçard Vurmbrand ishte i sigurtë kur u tha këtë.

"Shumë komunistë ishin gati të vdisnin për të mbrojtur «utopinë» e tyre. Ata ishin më të përkushtuar ndaj çështjes së tyre sesa disa të tjerë që takoj në kishë."

Tek çdo armik, pastor Vurmbrandi shihte një potencial miku, ose një potencial të krishterë. Duke dashur kundërshtarët e tij, ai jo vetëm që pa shumë të njihnin Krishtin, por gjithashtu, rriti mundësitë e tij për të dëshmuar.

"Kur më thërrisnin «çifut i ndyrë» dhe u thoshin të gjithëve të mos lexonin librat e mi, njerëzit menjëherë dilnin për të parë se çfarë kishte për të thënë ky «çifut i ndyrë». Unë i mirëpres të gjithë që kanë një akuzë kundër meje. Të tjerët nuk janë shumë të interesuar në atë që keni për të thënë. Ju duhet t'i sidoni ata me të vërtetën para se të ndani besimin tuaj. Për ta bërë këtë, duhet të kuptoni se nga vijnë dhe të jeni në gjendje të flisni me zgjuarsi, por duhet të kujtojmë gjithashtu se duhet të flasim gjithnjë me dashuri."

Fjalët e pastor Vurmbrandit nuk ishin disa ideale të paarrishme, të papërfjetuara prej tij. Ai dhe gruaja e tij, Sabina, mirëpritën në shtëpinë e tyre një oficer nazist, i cili kishte punuar në të njëjtin kamp përqendrimi, ku ishte ekzekutuar e gjithë familja e Sabinës. Kur oficeri pa faljen dhe dashurinë e tyre për të, ai u fitua në mbretëri.

Shënim: Këto deklaratat u bënë gjatë një prej intervistave të fundit të pastor Vurmbrandit para vdekjes së tij, në shkurt të vitit 2001.

Jezusi na mësoi që të tjerët do ta njihnin besimin tonë nëpërmjet dashurisë sonë – veçanërisht kur na duhet të merremi me kundërshtimet. Se si i trajtojmë armiqtë tanë është po aq e rëndësishme sa mënyra se si i trajtojmë ata të familjes sonë të krishterë. Në fakt përgjigjja jonë ndaj kritikave shpesh e shpall krishterimin më tepër se çdo shembull tjetër. Kur besimtarët e vënë në jetë këtë parim të fuqishëm të krishterimit, e veçojnë veten nga bota. Reagimi i natyrshëm ndaj kundërshtimit është ta refuzojmë atë, ose të reagojmë në të njëjtën mënyrë. Besimtarët nga ana tjetër, përpiqen t'i kuptojnë armiqtë e tyre e jo t'i shkatërrojnë ata. Kur kundërshtimi vendoset në këtë perspektivë, mirëpritet si një mundësi për të ushtruar besimin dhe për të zbatuar urdhërimet e Krishtit.

Ju keni dëgjuar se ishte thënë: «Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd». Por unë po ju them: «Duajini armiqtë tuaj, bekonj ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni për ata që ju keqtratojnë dhe ju përndjekin».

Mateu 5:43-44

FKSTREM

Udhëtim ekstrem

TITANIKU: DR. ROBERT BEITMEN

Dr. Robert Beitmëni e ndihmoi me kujdes kumatën e tij të hipte në varkën e shpëtimit. «Mos u shqetëso, Eni! Kjo do të provojë besimin tonë. Unë duhet të qëndroj e të ndihmoj të tjerët. Nëse nuk takohemi më në këtë tokë, do të takohemi përsëri në parajsë.» Beitmëni i hodhi shaminë gruas, ndërsa varka u lëshua në drejtim të errësirës në ujën e akullt aty poshtë. «Vëre rreth fytit, Eni, që të mos ftohesh!»

Dr. Beitmëni mblodhi pastaj rreth vetes pesëdhjetë burra në bashin e anijes dhe u tha të përgatiteshin për vdekjen. Më herët atë ditë, ai kishte drejtuar shërbesën fetare në anijen e madhe, një shërbesë që përfundoi me himnin e tij të preferuar «Më pranë Teje, o Zot».

Robert Beitmëni kishte themeluar Misionin Central City në Xheksonvil, Florida, një dritë shpirtërore në një qytet të mbushur zakonisht me marinarë të dehur. Ai ishte quajtur «njeriu që rrezaton më shumë njerëzishmëri se çdokush tjetër në Xhaksonvil». Beitmëni shkoi në Angli për të studiuar punë sociale të krishterë dhe po kthehej në Shtetet e Bashkuara për të zbatuar atë që kishte mësuar.

Megjithatë, natën e vonë të 14 prillit të vitit 1912, anija e Beitmënit goditi një ajsberg. Ai i udhëhoqi burrat në bashin e anijes në lutjen e Zotit. Ndërsa orkestra luante «Më pranë Teje, o Zot», anija gjigante e Titanikut u zhyt nën dallgë.

Thuhet se një mënyrë e sigurt për ta bërë Zotin të qeshë, është t'i tregojmë planet tona! Kur ne pranojmë Krishtin, nisemi në aventurën më të madhe të jetës sonë. Me qëllim që udhëtimi t'ia vlejë, ne duhet ta dorëzojmë veten nën urdhrat e tij – kapitenit të anijes. Ai organizon udhëtimin e jetës sonë si e sheh më të përshtatshme, duke na drejtuar përmes dëshirave (dhe tekave) tona drejt një qëllimi më të madh. Herë pas here, madje në kohët më të këqija, harta e tij duket si e vjetëruar (jo aktuale) dhe pyesim veten nëse ai ka humbur rrugën. Shkëmbinjtë të thepisur dalin nga thellësitë e errëta. Nata pa hënë na shfaqet në errësirën e saj. Sa të tunduar jemi në atë moment për të marrë në kontroll planet e jetës sonë. Megjithatë, udhëtimi është një aventurë me besim. Planet e Zotit e çojnë jetën tonë në drejtime që kurrë nuk do t'i zgjidhnim për vete. Por ai njeht më të mirën.

Ka shumë plane në zemrën e njeriut, por vetëm plani i Zotit do të mbetet i pandryshuar.

Fjalët e urta 19:21

FKSTREM

Hap ekstrem besimi

EGJIPT: NJË DREJTUES I KRISHTERË I TË RINJVE

«Ky është plani» – i tha drejtuesi i ri i krishterë grupit të të rinjve. «Në orën 8:30 ju duhet të filloni të ndani ftesat e takimit në universitet. Duhet t'i shpërndani shpejt, para se policia sekrete të vijë e t'ju pyesë se çfarë po bëni. Nëse s'mund t'ia jepni dikujt, thjesht i lini diku. Zoti do t'i çojë në duart e duhura.»

Ju doni që të ndajmë ftesa para se të kemi marrë leje? Imazhet e të qenit të arrestuar nga policia egjiptiane kaluan nëpër mendjet e burrave dhe grave të shqetësuar të mbledhur rreth drejtuesit të tyre.

«Pikërisht! Shikoni, ne duhet të ushtrojmë pak besim. Do të hedhim hapin e parë dhe pjesa tjetër është në duart e Perëndisë.»

Në Egjipt, mbledhjet e krishtera mbikëqyren nga afër dhe nuk mund të organizohen pa miratimin e qeverisë. Pak pas 08:30-ës drejtuesi i të rinjve i telefoni policisë për t'i kërkuar leje për të pasur një takim të krishterë.

«Ju duhet të plotësoni formularët e duhur dhe do t'ju lajmëojmë për një muaj.»

«Më vjen keq, zotëri, por ne tashmë kemi filluar të ndajmë ftesa për takimin», – iu përgjigj i krishteri në ankth.

«Pse i ndatë ftesat para se të merrnit miratimin? Ju e dini se ne duhet të merrni më parë miratimin tonë për takime ë tilla. Mirë pra, meqenëse ftesat janë shpërndarë tashmë, këtë herë po e miratoj..»

Zbatimi i besimit tonë ka të bëjë me hedhjen e hapit të parë në një udhëtim të pasigurt. Siç do të na tregojnë edhe të tjerë që e kanë bërë këtë udhëtim, nuk është më e vështirë ajo që po kalojmë, sesa e frikshme është «të ecësh pa ditur». Nuk ka harta në udhëtimin e besimit. Ne udhëtojmë me dritën e asaj që Zoti siguron. Është një aventurë pa drejtim të qartë që na çon në vende, të cilat s'mund t'i shohim nga rruga kryesore e jetës sonë. U desh besim i madh nga besimtarët të shpërndanin ftesa për një takim që s'ishin të sigurtë nëse do të lejohej. Zoti nderoi hapin e tyre të besimit, duke i bekuar me treqind të kthyer në besim atë natë. A jeni gati të hidhni hapa me besim?

Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, tregim i gjërave që nuk shihen.

Hebrenjve 11:1

**Gjatë luftës së fundit na mësuan se,
që të arrinim objektivin tonë duhej të ishim
gati të sakrifkoheshim...**

**Ne e dimë që ka vetëm një përgjigje
kur vendi ynë kërkon që të ndajmë çmimin
e lirisë, por kur Zoti Jezus na kërkon të
paguajmë çmimin për ungjillizimin botëror,
shpesh nuk kemi fjalë të përgjigjemi.**

S'mund të shkojmë.

Themi se kushton shumë...

**Misionarët vazhdimisht përballen
me sakrifica.**

**NATE SAINT, NJË MISIONAR I MARTIRIZUAR NË
XHUNGLËN E EKUADORIT
NE VITIN 1956**

DEKRET EKSTREM

LAOS: TE KRISHTERËT

Vula e kuqe kërcënuese në fund të faqes mbante shenjën e zyrës komuniste të distriktit për zonën e Laos. Për të krishterët e zonës, fjalët ishin edhe më kërcënuese.

«Nëse ndonjë person, fis, apo familje mashtrohet për të besuar në fe si krishterimi, apo të tjera, duhet të kthehet në fenë në të cilën besonte më parë» – deklaronte dokumenti. «Është e ndaluar të propagandosh atë fe. Në të kundërtën, ata besimtarë do të duhet të transferohen dhe të jetojnë në zona të tjera. Nëse ka ndonjë fshat, apo familje që beson në një fe tjetër...anëtarët e komitetit të partisë duhet të mbledhin statistika dhe të bëjnë një listë të këtij grupi njerëzish...dhe ta dërgojnë në zyrën për Frontin e Ndërtimit. Ne duam të dimë veçanërisht se sa besojnë te Jezusi në këtë zonë». Dokumenti kishte datën 18 korrik 1996 dhe ishte firmosur nga Komiteti i ngritur i Frontit për Ndërtim.

Kohët e fundit të krishterët në Laos janë detyruar shpesh me anë të drejtimit të armëve të firmosnin një dokument, ku hiqnin dorë nga kthimi i tyre në krishterim. Për qeverinë ateiste, duket se çdo fe tjetër është më e pranueshme se adhurimi i Jezu Krishtit.

Pavarësisht nga përpjekjet e qeverisë, kisha në Laos po rritet ndërsa të krishterët ndajnë me guxim besimin e tyre.

Kur autoriteti njerëzor kundërshton urdhërimet e Perëndisë, hiqet një vijë; duhet bërë një zgjedhje. Ose t'i dorëzohemi autoritetit njerëzor, ose t'u bashkohemi urdhërimeve të Perëndisë dhe të rrezikojmë pasojat. Ndërsa paqja është qëllimi ynë përfundimtar, ne s'mund t'i vendosim prioritetet tona sipas kërkesave njerëzore. Për shembull, qeveria e Shteteve të Bashkuara e ka shpallur lutjen si një aktivitet jo të ligjshëm në ambientet e shkollave. Megjithatë, ata s'mund ta largojnë lutjen nga studentët, apo nga trupi mësimor që duan të ushtrojnë bashkësim me Perëndinë e tyre. Të tjerët mund të nxjerrin një kufizim të ngjashëm, apo më të keq. Megjithatë, Perëndia ia kalon autoritetit të tyre, sepse vetëm ai është mbret në zemrën njerëzore. Ne mund të vendosim me siguri t'i bindemi Perëndisë sesa autoriteteve njerëzore si një akt i vullnetit tonë.

Por Pjetri dhe apostujt, duke u përgjigjur thanë: «Duhet t'i bindemi Perëndisë më shumë sesa njerëzve».

Veprat 5:29

FKSTREM

Kontrabandist ekstrem

KINË: UATCHMAN NEE

Uatchman Nee, drejtuesi i kishës kineze kishte vetëm gjashtë orë kohë. Ai duhet të drejtonte te Krishti rojën para qelisë së tij të burgut me qëllim që letrat e tij të inkurajimit për të krishterët jashtë burgut të mund të shpërndareshin.

Drejtuesi i qeverisë së Maos u tërmbua nga përhapja e krishterimit në Kinë. Me qëllim që të ndalonte shpërndarjen e këtij «kulti të huaj», ata kishin dëbuar, apo vvarë të gjithë misionarët e huaj dhe kishin futur në burg mijëra drejtues të krishterë kinezë, apo çuar për riedukim në kampet e punës. Por kisha rritej akoma.

Kur policia zbuloi që letrat e bukura dhe të fuqishme inkurajuese të Nee po dilnin nga burgu për në duart e të krishterëve, dyfishoi numrin e rojave dhe nuk lejohej që të qëndronte më shumë se një herë i njëjti rojë jashtë qelisë së Nee. Ata i shkurtuan turnet deri në gjashtë orë, duke shpresuar që Nee nuk do të kishte kohë ta kthente në besim rojën.

Nee i tregoi rojës për dashurinë e Atit dhe gatishmërinë e tij për të dhënë gjakun dhe mishin e tij në mënyrë që roja të mund të jetonte përjetë në parajsë.


«Komunizmi nuk mund të të çojë në parajsë», – tha ai. «Vetëm gjaku i Jezu Krishtit mund ta bëjë këtë».

Pesë orë në predikim, me lot që i rridhnin nga sytë, roja pranoi Krishtin. Përsëri një njeri tjetër u fitua për mbretërinë dhe përsëri një tjetër letër e Uatchman Nee do të shpërndahej lirshëm.

Mësimi i madh i martirëve të krishterë është që duhet të përdorim energji krijuese me qëllim që të ndihmojmë në ndarjen e ungjillit. Mendjemprehtësia e tyre, kuraja dhe madje, edhe dinakëria e tyre duhet ta zgjojnë shpirtin tonë për të shpërndarë Lajmin e Mirë. Megjithëse jo të gjithë kanë mundësi të përcjellin Shkrime në zona të ndaluara, ne duhet të vazhdojmë të jemi shërbëtorë të gatshëm për mbretërinë. Kjo mund të thotë për shembull, të gatuajmë për komshinjtë tanë, të regjistrohemi në kurse, apo në gjëra të tjera me qëllim që të takojmë persona jo të kishës. Një metodë e re dëshmie ka gjithnjë rrezikun e pasojave. Pse duhet të kemi dëshirë për të rrezikuar në vend që të zgjedhim mediokritetin? Cila e përshkruan jetën tënde të ungjillizimit sot? Jeta mondane dhe mediokre, apo jeta krijueshmërisht energjike për Krishtin?

Për këtë mundohem duke u përpjekur me fuqinë e tij, e cila vepron tek unë me pushtet.

Kolosianëve 1:29



«Në Peru, të krishterët nuk presin të marrin diçka sepse i shërbejnë Jezusit», – tha pastor Zapata. «Ata presin të japin diçka.» Jashtë fshatit të qetë malor, pastor Zapata u tregoi të ftuarve një radhë kryqesh të bardhë të punuara me dorë, secili përfaqësonte një të krishterë të vranë nga rebelët komunistë.

I shtrirë përpara pastor Zapatës brenda shtëpisë së fshatit të vogël, ishte trupi i një pastori tjetër që ishte vranë një natë më parë nga guerilasisit. Trupi i tij, i mbuluar me një batanije të thjeshtë ishte rrethuar nga qirinjtë dhe nga pjesëtarët e brengosur të familjes.

Jashtë në shi, bashkësia e pastorit të vranë këndoi këngë lavdërimi. Këpucët e tyre ishin të mbuluara me baltë. Guerilasisit kishin shkatërruar kishën e tyre dhe kishin djegur shumë prej shtëpive të tyre. Por përsëri, ata thurnin lavde.

Të krishterët e kishin rrezikun në prag, sepse guerilasisit mund të ktheheshin në çdo kohë. Pastorët shpesh eliminoheshin, meqenëse ata forconin të gjithë fshatin për t'u bërë ballë sulmeve marksiste.

Pastori u kujtoi dëgjuesve se Bibla na thërret që të kërkojmë Perëndinë e jo bekime materiale që vijnë nga dora e tij. «Pse blini këmishë?» – i pyeti ai njerëzit. «Për t'i përdorur. Pse ju shpengoi Jezusi dhe ju bleu me gjakun e tij? Për t'ju përdorur për mbretërinë e tij.»

Këta besimtarë të varfër ishin gati që Perëndia t'i përdorte.

Kur ne persekutohemi për shkak të besimit tonë, është e lehtë të fokusohemi më shumë se sa duhet në humbjet tona. Mund të mbajmë zi për miqtë e mëparshëm që na kanë braktisur për shkak të besimit tonë. Mund të na vijë keq për mundësitë e biznesit që kemi pasur. Të na vijë keq për veten kur mbetemi jashtë rretheve shoqërore. Megjithatë ka shumë të tjerë që kanë humbur më shumë se gjëra materiale, apo marrëdhënie sipërfaqësore. Këta besimtarë të patundur fokusohen mbi atë që mbetet për t'u dhënë në shërbim të Krishtit dhe jo në atë se çfarë ka humbur tashmë. Shumë prej tyre kanë humbur kishat, shtëpitë, punën dhe familjet në persekutimet fetare. Përsëri ata duan të japin më tepër, si sakrificë për kauzën e Krishtit. E dinë mirë se humbja e tyre tokësore është mundësia e një personi tjetër për të fituar shpëtimin.

Jeta e njeriut nuk qëndron në mbushullinë e gjërave që zotëron.

Luka 12:15

«Frikë ekstreme»

EKSTREM

LAOS: LU



Kodi i pashkuar i policisë ishte i qartë: Nëse kapni Khmu apo persona të fiseve të tjera që kthehen në besimin e krishterë, arrestojini! Nëse kapni dikë duke ungjillizuar një person nga fisi, vriteni!

Pasi e kishin lidhur Lu këmbë e duar me zinxhirë dhe e kishin kaluar në mënyrë të turpshme përmes fshatit, polici komunist e hodhi në një gropë. «Do të të lejojmë të largohesh,» – i thanë ata, «kur njëqind të krishterë në fshatin tënd të heqin dorë nga kthimi i tyre në krishterim». Por ata s'ishin në gjendje të gjenin besimtarë që donin t'i kthenin shpinën Krishtit.

Pastaj tragjedia goditi policinë. Një djalë i oficerit theu të dyja këmbët në një aksident. Djali tjetër i tij u sëmur rëndë. Oficeri që kishte rrahur dhe kishte sulmuar të krishterët e rinj vdiq papritur nga një krizë zemre.

Oficerët e tjerë me frikë e nxorën Lu nga gropa dhe e lejuan të kthehej në shtëpi. Autoritetet e qeverisë ishin shumë të frikësuar për të vepruar kundër të krishterëve në fshat, pasi panë se çfarë i ndodhi drejtuesit të tyre.

Duke parë shfaqjen e fuqisë së Zotit, më tepër Khmu u bënë besimtarë. Atje ku kishte pasur njëqind të krishterë, tani kishte shtatëqind. Ata, madje dërguan të krishterë për t'u treguar fshatrave të tjerë për Jezusin. Ndërsa autoritetet në Laos kontrolloheshin nga frika e tyre, të krishterët në Azinë juglindore e kapërcyen atë.

Frika është një nga motivet bazë njerëzore. Ajo nxit tregjet e aksioneve dhe nder luftërat. Energjitë e saj të pakufizuara mund të përdoren për dëme të mëdha, ose mund të kanalizohen për të mira të mëdha. Boksierët profesionistë thonë shpesh se frika është miku i tyre më i mirë. Frika mund t'i bëjë ata boksierë (luftëtarë) më të mirë. I mban në gatishmëri. Ajo nxit vendosmërinë e tyre. Në të njëjtën mënyrë Zoti mund të përdorë frikën tonë dhe të na bëjë luftëtarë më të mirë për kauzën e tij. Sa herë që jemi të frikësuar, ne kemi potencialin për të bërë të pamundurën. Pse? Ajo që është e pamundur me fuqinë tonë është bërë e mundur me ndihmën e Zotit. Frika na bën më të hapur për t'i lënë burimet tona dhe të mbështetemi te Zoti. Në këtë mënyrë, frika ekstreme mund të na çojë në besim ekstrem.

*Zoti është drita ime dhe shpëtimi
im - nga kush do të kem frikë?*

Psalmi 27:1

Xhevahir ekstrem

SUDAN: PITERI

Një unazë bronzi në arabisht quhet *bacle*. Pjetri e mbante atë si të ishte një objekt i shenjtë. Ishte një kujtesë e së kaluarës dhe të bekimit të madh të Pjetrit.

Gjyshi i tij e kishte bërë *bacle*-n, por ajo nuk ishte thjesht një projekt punë dore. Në fakt, ai ishte i detyruar ta mbante nga padronët islamikë. Gjyshi i Pjetrit ishte kapur në Sudanin jugor dhe çuar në Sudanin verior ku u shit dhe u ble si skllav.

Megjithëse i sfliturur dhe i torturuar nga padronët islamikë, ai nuk iu bashkua besimit të tyre. Ai qëndroi i fortë në besimin e tij në Krishtin dhe trupi i tij mbartte shenjat e refuzimit të tij. Për shkak se nuk ishte mysliman, ai shihej si një kafshë.

Pak para se të vdiste, gjyshi i Pjetrit e hoqi unazën dhe ia dha babait të Pjetrit. «Familja jonë nuk do të jetë gjithnjë familje skllevërish,» – tha ai, «por ne nuk duhet të harrojmë».

Më vonë babai i Pjetrit ia la unazën atij dhe ai e kishte me vete kur u largua nga padroni i tij mysliman dhe u arratis drejt lirisë. Sot ajo nuk është më një shenjë zotërimi, por një shenjë e fuqisë së pamasë të Perëndisë. Është një simbol i dorës së Zotit mbi familjen duke punuar përmes tre brezave për t'i sjellë në liri.

«Mos i harro asnjëherë njerëzit e mi, » – nixiti ai. Mos resht së luturi për të krishterët e persekutuar në Sudan.»

Harresa është armiku numër një i lutjes. Ne jemi të shpejtë për të ofruar lutjet tona të mbështetjes. Fatkeqësisht, qëllimet tona të mira rrallë janë mjaft të mira për të na ndihmuar në përkushtimin tonë për t'u lutur për personat në nevojë.

Çfarë mund të të kujtojë të lutesh për ata që janë të persekutuar nëpër botë? Ndoshta një ngjitëse e vogël në orën tënde do të të ndihmonte. Sa herë të shihni orën gjatë gjithë ditës, mund të jetë një mundësi për të kujtuar një grup njerëzish që jetojnë nën persekutim fetar. Çfarëdo metode të zgjidhësh që të kujtohesh për mundësitë e humbura për lutje, ndiqe. Duke lexuar tregime për besimtarë ekstremë nuk do të ndryshojë asgjë. Duke u lutur për besimtarët mund të ndryshojë gjithçka, madje edhe sot.

Lutuni vazhdimisht.

1. Selanikasve 5:17

FKSTREM

Kurajë ekstreme

RUMANI: NJË GRUA E RE

Ishte pothuajse mesnatë kur gratë e burgosura dëgjuan rojat komunistë të vinin. Ato me të shpejtë u mblodhën rreth së dënuarës, një grua e re rreth të njëzetave, e cila ishte dënuar me vdekje për besimin e saj në Krishtin. Pëshpëritën një lamtumirë me nxitim. Nuk kishte lotë në sytë e gruas së re rumune, as të thirrura për mëshirë.

Më herët atë mbrëmje, të burgosurat kishin dëgjuar gruan e re me fytyrën që i rrezatonte dashuri. «Për mua, ky varr është dera drejt një qyteti qiellor», – u kishte thënë ajo. «Kush mund të tregojë bukuritë e atij qyteti? Atje nuk njihet trishtimi. Ka vetëm gëzim dhe këngë. Të gjithë janë veshur me të bardhën e pastërtisë. Ne mund ta shohim Zotin ballë për ballë. Ka një gëzim të atillë, sa gjuha njerëzore nuk mund ta shprehë. Pse duhet të qaj? Pse duhet të jem e trishtuar?»

Ajo ishte e fejuar dhe do të martohej, por këtë natë ajo u tha se, në vend që të ishte me të fejuarin e saj tokësor, ajo do të takonte dhëndrin e saj qiellor.

Rojat e pamëshirshëm u futën në qeli dhe gruaja u drejtua drejt tyre gati për të shkuar. Tek largohej nga qelia, e rrethuar nga rojat e saj, ajo filloi të thoshte kredon e apostujve. Minuta më vonë, me lotë që u rridhnin nga sytë, të burgosurat e tjera dëgjuan të shtëna. Ekzekutuesit mendonin se i kishin dhënë fund jetës së gruas së re, por ata vetëm e kishin çuar atë për të jetuar përjetë në një vend shumë më të mirë.

Guximi është ura që na çon nga një ekzistencë formale mbi tokë në një mall të pashpjegueshëm për një të ardhme qiellore. Ata që e kuptojnë plotësisht sigurinë e ekzistencës së parajsës e kanë më të lehtë ta shkëmbejnë jetën e tyre të përkohshme për qytetarinë e përjetshme në qiell. Guximi na ndihmon të lëmë gjithçka me të cilën jemi të lidhur në tokë – të gjitha gjërat që na bëjnë të duam të qëndrojmë këtu. Duhet guxim për të besuar në një jetë pas vdekjes. Mbi të gjitha, jeta në tokë është gjithçka që njohim deri në momentin që vdesim. Ne jemi të guximshëm kur hidhemi me besim duke besuar se Krishti e ka bërë të mundur për ne që të shkojmë në përjetësi me të. Kur e kemi marrë këtë vendim të patundur, ne mund ta përballojmë jetën me qëllim dhe vdekjen me guxim.

*Për mua të jetuarit është Krishti dhe
të vdekurit fitim!*

Filipianëve 1:21

**NE NUK PO LUTEMI QË KUFIJTË
TANË TË HAPEN. NE PO LUTEMI QË
QIELLI TË HAPET.**


LUTJA E NJË KISHE NËN PERSEKUTIM NË VIETNAM



FKSTREM

Misione ekstreme

BHUTAN: PASTOR NORBU PROMILA



Pastor Norbu Promila u kënaq me shërbesën, ndërsa u predikoi njerëzve të fiseve në malet e Bhutanit. Ata që erdhën, u dukën veçanërisht të vëmendshëm dhe të hapur ndaj Lajmit të Mirë. Kur në fund të predikimit, policia shpërtheu nga çdo derë, duke zënë podiumin dhe rrëmbyer me forcë Norbunë.

Pastor Promila u fut në burg dhe u torturua dhe autoritetet e udhëruan të braktiste thirrjen e tij për të predikuar ungjillin. Ai mori goditje të rënda në kokë dhe kur autoritetet e lanë më në fund të shkonte, kishte dëmtime të pashërueshme në trup. U kthye në shtëpi dhe gruaja dhe fëmijët u tronditën nga fytyra e tij e mavijosur dhe e gjakosur. Dhjetë ditë më vonë ai vdiq si rezultat i plagëve.

Bashkësia e pastor Promilës në këtë mbretëri militante hinduiste refuzoi të hiqte dorë nga misioni i tij. Shumë pak pas vdekjes së tij, ata u takuan së bashku dhe kërkuan vullnetarë për të vazhduar punën e Norbusë midis njerëzve të fiseve. Pesë duar u ngritën, një prej të cilave i përkiste gruas së tij. Ajo iu përgjigj thirrjes së Perëndisë për misionin ndërsa kujdesej për pesë fëmijët e saj.

Shërbeu me besnikëri dhe bashkë me punëtorë të tjerë panë shumë njerëz të fiseve të fituar për Krishtin. Perëndia siguroi për nevojat e saj dhe të fëmijëve të saj. Zonja Promila qëndroi fort në njohurinë se një ditë ajo do ta shihte burrin e saj përsëri dhe do të shpërblehej për besnikërinë e saj ndaj Krishtit.

Ajo që bëjmë për Zotin nuk është një punë – është një mision. Një mision nuk është asnjëherë në përgjegjësinë e një personi të vetëm. Ai fokusohet vetëm mbi Krishtin dhe mbretërinë e Tij. Ndaj, nëse dikush në drejtimin e punës së Perëndisë në një zonë të caktuar largohet, vetë misioni nuk vdes kurrë. Puna e Perëndisë nuk lihet kurrë e pambaruar. Ajo vazhdon përgjithmonë deri në përfundim. Ata që kalojnë persekutime për besimin e tyre na mësojnë për kuptimin e misionit. Ata e dinë që ka vetëm dy gjëra që zgjasin përjetësisht – puna e Perëndisë dhe shpirtrat e njerëzve. Kur ne duam ta investojmë jetën tonë në këto gjëra, jemi të përfshirë në një mision me rëndësi të përfundimtare.

Dhe duke qenë i bindur për këtë, se ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezu Krishtit.

Filipianëve 1:6

FKSTREM

Vrasje ekstreme – pjesa e parë

BANGLADESH: ANDREU

Ungjilltari Andreu vështroi armën duke pyetur veten pse personi nuk e shkrepi. Vrasësi u irritua, pastaj u frikësua dhe më në fund iku nga dhoma.

Ra zilja e telefonit dhe Andreu u gjend duke biseduar me personin që kishte ardhur për ta vrarë disa minuta më parë.

«Udhëheqësit myslimanë më ofruan një shpërblim të madh për të të vrarë», – shpjegoi i ashtuquajtimi vrasës. «Kam udhëtuar përmes Bangladeshit për të ardhur në zyrën tënde. Shpërblimi ishte i imi. Isha gati për të qëlluar, por s'munda të lëvizja krahun. S'munda të tërhiqja këmbëzën.» Ungjilltari falënderoi Zotin për mbrojtjen.

Andreu iu duk disi komike. «Ç'mund të bëj për ju tani?» – e pyeti ai.

«Zotëri, unë akoma s'mund ta lëviz krahun dhe është për shkakun tuaj! A mund të më ndihmoni?»

Pikërisht në telefon Andreu u lut dhe menjëherë personi rifitoi përdorimin e plotë të krahut të tij. I shtangur nga mrekullia, ai u kthye te zyra e ungjilltarit dhe filloi t'i bënte pyetje për këtë «Jezus» nga i cili dukeshin se kishin frikë udhëheqësit myslimanë.

Ungjilltari me durim shpjegoi lajmin e mirë të dashurisë së Jezusit, madje duke i ofruar çaj personit që kishte ardhur ta vriste. Pas dyzet e pesë minutash personi u lut për të pranuar Jezusin në zemrën e tij. Shërbesa e vrasësit të mëparshëm tani është të shkatërrojë veprat e djallit. Deri më sot ai është misionar në Bangladesh.

Përpjekja e të ashtuquajturit vrasës ishte një komedi me gabime. Nëse do të kishte qenë një film, publiku do të kishte brohoritur me të madhe kur protagonistin Andreu të dilte në skenë. Si çdo hero tjetër filmi, Andreu jo vetëm që mposhti planet e armikut, por madje, i hutoi ata deri në atë pikë sa të pinte çaj me ish-vrasësin të kthyer në besim. Kjo nuk po shkonte sipas planeve. Djalli duhet të kthehet vazhdimisht në prapaskenë për të menduar planet e tij për shkatërrimin tonë. Andreu nuk ishte një viktimë e rrethanave dhe as ju nuk jeni. Nëse ai do të ishte qëlluar, vdekja e tij do të kishte qenë gjithashtu dëshmi dhe kështu do të jeni edhe ju. Pavarësisht nga komplotet e djallit, planet e Perëndisë për jetën tënde nuk mund të shkatërrohen.

*E pranoj që mund të bësh gjithçka,
dhe që asnjë nga planet e tua nuk
mund të pengohet.*

Jobi 42:2

FKSTREM

Shpallje ekstreme

RUMANI: SABINA VRUMBRAND

Sabina Vrumbrand iu afrua të shoqit dhe i kapi krahun. «Riçard,» – tha ajo me vendosmëri, »ngrihu dhe largo këtë turp nga Krishti. Ata po i pështyjnë në fytyrë!»

«Nëse do të veproj kështu, – iu përgjigj Riçard Vrumbrandi duke e parë me vëmendje të shoqen, ti do të humbasësh bashkëshortin tënd».

Sytë e saj ndeshën me të tija. «Nuk dua për bashkëshort një frikakak!»

Ata po merrnin pjesë në një kongres kombëtar rumun mbi fenë shumë pak kohë pasi ushtarët komunistë kishin pushtuar vendin. Të krishterët e mbledhur, pastorë, priftërinj dhe drejtues të çdo lloj denominacioni qëndronin një nga një dhe i jepnin lavdi Josef Stalinut dhe udhëheqjes së re komuniste që kishte burgosur mijëra të krishterë.

Ndërsa Riçardi u ngrit për të folur, shumë u entuziazmuan që po shihnin që ky pastor i mirënjohur do t'i bashkohej çështjes së tyre. Por në vend që të lavdëronte komunistët, ai lavdëroi Jezu Krishtin si rruga e vetme për shpëtim. «Besnikëria jonë e parë,» – u tha ai pjesëmarrësve në mbledhje, «duhet të jetë ndaj Perëndisë e jo udhëheqësve komunistë». Mbledhja u transmetua direkt në të gjithë Rumaninë dhe mijëra veta në të gjithë vendin e dëgjuan sfidën e Riçardit.

Duke e kuptuar dëmin që po bënte Riçardi, oficerët komunistë nxituan për në skenë. Riçardi u largua nga dera e pasme, por që atëherë jetoi si i përndjekur. Ai do të kalonte më vonë katërmbëdhjetë vjet në burg.

Ndoshta pjesës më të madhe prej nesh nuk do t'i duhet kurrë të marrë qëndrim për Krishtin para një kombi të tërë. Por ne të gjithë jemi thirrur për të mbajtur një qëndrim për të çdo ditë, kudo që jemi. Nuk është përmasa e publikut, por sinqeriteti i qëndrimit tonë që ka rëndësi. Jetët tona mund të mos varen në atë që themi, por puna jonë mund të varet mbi vendimin tonë për të vënë në dukje bindjet tona. Kjo mund të thotë të humbasësh një marrëdhënie, ose mospranim nga familjet tona. Në çdo rast, është më mirë të durojmë pasojat e bindjeve tona sesa të na vijë keq për mungesën e dukshme të tyre. Kur dhe ku do të gjeni mundësinë për të mbajtur një qëndrim për Krishtin sot?


*Unë e kam kryer shërbimin e
ungjillit të Krishtit.*

Romakëve 15:19

FKSTREM

Pjekuri ekstreme

JAPONI: IBARAGI KUN



Pasi u gjykuan të gjithë, u shpallën fajtorë dhe u dënuan me vdekje, njëzet e gjashtë të krishterët marshuan për në vendin ku mizorisht qëndronin kryqet. Pothuajse tre muaj më parë, ata ishin arrestuar në Kyoto, Japoni dhe u akuzuan se ndiqnin Krishtin. Një nga të dënuarit quhej Ibaragi Kun.

Duke parë sesa i ri ishte Kuni, një oficer e mori mënjane dhe e nxiti të hiqte dorë nga besimi i tij dhe të shpëtonte jetën. Kuni e pa në sy oficerin dhe i tha me siguri: «Zotëri, do të ishte më mirë sikur ju vetë të bëheshit i krishterë. Atëherë do të vinit në parajsë me mua».

Oficeri e vështroi, i tronditur nga besimi i djalit të vogël. Në fund, Ibaragi e pyeti: «Zotëri, cili kryq është i imi?»

Oficeri i habitur i tregoi më të voglin e njëzet e gjashtë kryqeve. I riu Kun vrapoi për te kryqi, u përkul para tij dhe e përqafoi. Kur ushtarët filluan të gozhdonin këmbët dhe duart e tij në kryq, ai nuk bërtiti nga dhimbja, por pranoi me guxim rrugën që Zoti i kishte shtruar.

Kryqëzimi i njëzet e gjashtë të krishterëve në 23 nëntor të vitit 1596 ishte fillimi i një periudhe intensive persekutimi të të krishterëve në Japoni. Gjatë njëzet e shtatë viteve të ardhshme më shumë se një milion të krishterë japonezë do të vriteshin për shkak të besimit të tyre. Shumë prej tyre do të përqaфонin kryqet për të ndjekur shembullin e Ibaragi Kunit, një djalë shumë i matur dy-mbëdhjetë vjeçar.

Pjekuria shpirtërore nuk matet nga certifikata e lindjes. Moshë kronologjike nuk ka të bëjë shumë me bindjen. Për më tepër, pjekuria shpirtërore matet ditë pas dite. Ne masim pjekurinë tonë shpirtërore nga ajo se sa mirë e zbatojmë çdo ditë besimin tonë. Ndryshe nga çfarë besohet zakonisht, pjekuri shpirtërore nuk do të thotë sa njohuri ke rreth Biblës. Shumë njerëz e njohin mirë Biblën, por përsëri ata mbeten të huaj ndaj pjekurisë shpirtërore. Bindja ndaj urdhërimeve të Biblës është shenjë e pjekurisë. Një pyetje do të na ndihmojë të dimë se si po rritemi shpirtërisht. Ne duhet të pyesim veten çdo ditë: «Sa më shumë dukemi si Jezusi sot në krahasim me dje?» Përgjigjja është një pasqyrim i vërtetë i rritjes sonë.

Askush të mos e përbuzë moshën tënde të re, por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në besim e në pastërti!

1 Timoteut 4:12

Gatishmëri ekstreme

FILIPINE: NJË VAJZË E VOGËL

«Fustanin tim,» – mërmëriste vajza e vogël me fjalët që i dilnin mbyturazi përmes buzëve të ënjtura. «Ju lutem, më jepni fustanin. Dua ta mbaj.»

Të krishterët që rrethonin krevatin e vajzës ishin të trishtuar. Për shkak të dëmtimeve të saj të mëdha të brendshme, mjekët nuk mund të bënin asgjë për të. Javë më parë, besimtarët i kishin blerë një fustan të bardhë për të festuar jetën e saj të re dhe zemrën e pastër në Krishtin Jezus.

Ati i saj nuk kishte qenë i kënaqur me vendimin e së bijës për të ndjekur Krishtin. Një natë, në një zemërim prej të dehuri, ai e sulmoi të bijën duke e rrahur dhe shkëlmuar. E la të shtrirë në rrugën me baltë që të vdiste.

Kur ajo nuk u duk në kishë, miqtë e saj të krishterë shkuan ta kërkonin. E gjetën të pavetëdijshme, të shtrirë mënjanë dhe fustani i saj i bardhë ishte mbuluar me gjak dhe baltë. U dërgua tek një mjek, por dëmtimet ishin të rënda.

Tani ajo po kërkonte fustanin e saj.

«Fustani është prishur», i thanë shokët asaj. U përpoqën ta bindnin duke menduar se po të shihte fustanin e prishur, zemra e saj do të thyhej.


Me besimin e thjeshtë të një dhjetë vjeçareje, ajo pëshpëriti: «Ju lutem, unë dua t'i tregoj fustanin Jezusit. Ai ishte gati të derdhte gjakun e tij për mua. Unë dua që Jezusi ta dijë që unë isha gati të derdha gjakun tim për të».

Më pas, vajza e vogël vdiq.

Zoti nuk është i interesuar për aftësitë e tua. Ti mund të jesh i talentuar, i gjith-anshëm, i pasur, profesionistë, i njohur dhe i përpiktë. Ofrimi i aftësive tona të ndryshme në shërbim të Perëndisë, nuk mund të krahasohet me disponueshmërinë tonë. Aftësitë tona janë për ne – ne mund ta shohim veten duke bërë këtë apo atë gjë për Zotin. Në kontrast me këtë, disponueshmëria jonë ka të bëjë vetëm me Zotin. Ne mund të imagjinojmë vetëm se si Zoti do të na përdorë në shërbim të tij. Të qenit në dispozicion të Zotit do të thotë të kesh dëshirë të bindesh pavarësisht nga çmimi. Zoti dëshiron gatishmërinë tonë për t'i shërbyer atij, pavarësisht nga aftësitë tona specifike. Si mund të jemi të gatshëm? Kjo është gjithashtu dhuratë e Zotit. Ai na jep ne «dashjen» – vullnetin, apo dëshirën për të qenë të disponueshëm për të.

Sepse Perëndia është ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij.

Filipianëve 2:13



«Mblidh ca dru,» – iu hakërryen ushtarët. I riu, Jakobi Xheda kujtoi se ushtarët do të gatuanin darkën. Më herët atë ditë, ai kishte parë i tmerruar, ndërsa ushtarët radikalë myslimanë vranë prindërit e tij dhe katër motra e vëllezër në Sudanin jugor. Ata e kursyen Jakobin për ta përdorur si punëtor.

Kur zjarri u ndez mirë, Jakobi u habit dhe u tmerrua kur ata papritur e kapën. U përpoq të largohej, por ushtarët ishin shumë të fortë dhe shumë shpejt ia lidhën këmbët dhe duart.

«Lajme të mira për ty, djalosh,» – tha njëri prej ushtarëve. «Do të të lejojmë të jetosh, por duhet të bashkohesh me ne duke u bërë mysliman.»

«S'mund të bëhem mysliman,» – tha shumë thjesht Jakobi. «Unë jam i krishterë.»

Të zemëruar nga besimi i djalit, ushtarët e morën dhe e flakën në zjarr. Ata mblodhën plaçkat dhe u larguan nga zona duke menduar se Jakobi do të vdiste.


Djaloshi Jakob nuk vdiq. Ai ia doli mbanë të dilte nga zjarri dhe të gjente ndihmë.

Mjekët mundën t'i shpëtonin jetën Jakobit, por ai mbart akoma kujtuesit e asaj dite. Trupi i tij mbart të djegurat e lëkurës dhe shenjat dhe njëri nga krahët është pjesërisht i deformuar nga djegiet. Në qiell ato shenja do të jenë shenja nderi, një kujtim i ditës kur Jakob Xheda refuzoi t'i kthente shpinën Krishtit.

Pjesa më e madhe e njerëzve janë të dhënë pas suvenireve. Zor se dikush mund të kalojë në një seri dyqanesh dhuratash në aeroporte apo stacione treni pa rënë në tundim për të blerë një kujtim nga eksperiencia e udhëtimit. Por çfarë na kujton neve eksperiencia më e rëndësishme e jetës sonë – përkushtimi ynë ndaj Krishtit? Disa do të shohin rrogën e tyre dhe do të kujtojnë ngritjen në detyrë se refuzuan të pranonin për shkak se nuk donin të komprometonin moralin e tyre. Të tjerë do të kujtojnë klasën e tyre në një shkollë publike, ku për herë të parë mësuan se ç'do të thoshte të persekutoheshe. Të tjerë akoma do të shohin gurin e varrit të një besimtari dhe do të kujtohen për kuptimin e përkushtimit. Këto «suvenire» janë kujtues jashtëzakonisht të rëndësishëm të çmimit të besimit në Jezu Krisht.

E falënderoj Perëndinë tim sa herë që ju kujtoj.

Filipianëve 1:3



**Kisha ndjenjën fizike se po luteshin
për mua. Edhe kur nuk dija asgjë dhe nuk
merrja letra, ndieja ngrohtësi sikur
ulesha afër një zjarri. Ndonjëherë
kjo ndodhte në qelitë e dënimit,
të cilat janë shumë të ftohta. Ishte sikur të
dëgjoje dikë që lutej dhe mendonte
për mua. Kjo më mbështeti shumë.
Është e vështirë për t'u shpjeguar...
E ndieja dhe e dija që nuk isha e harruar.
Kjo ishte e mjaftueshme që të
përballoja momentet më të vështira.**

IRINA RATUSHINSKAIA –
POETE E KRISHTERE E BURGOSUR NË ISH-BASHKIMIN SOVJETIK DERI
NË VITIN 1987

FKSTREM

Padrejtësi ekstreme

RUMANI: PASTOR FLORESKU

Pastor Floresku s'mund të duronte ta shihte të birin të rrihej nga oficerët komunistë. Atë vetë e kishin rrahur tashmë dhe nuk kishte fjetur për dy javë nga frika se mos sulmohej nga minjtë e uritur, që oficerët komunistë i kishin futur në qelinë e burgut. Policia rumune donte që Floresku të dorëzonte anëtarë të tjerë të kishës së tij të fshehtë në mënyrë që edhe ata të kapeshin.

Duke parë që të rrahurat dhe torturat nuk kishin sukses, komunistët sollën të birin e Floreskut, Aleksandrin, vetëm katërmbëdhjetë vjeç, dhe filluan ta rrihnin. Para syve të Floreskut ata e masakruan pa mëshirë trupin e djalit të tij, duke i thënë pastorit që do ta rrihnin për vdekje nëse nuk u tregonte vendndodhjen e besimtarëve të tjerë.

Më në fund, duke mos qenë në vete, Floresku u bërtiti që të ndalonin.

«Aleksandër, duhet t'u tregoj atë që duan,» – i tha të birit, «nuk mund ta duroj më të të rrahin».

Me trupin e mavijosur dhe me gjakun që i rridhte nga hundët dhe goja, Aleksandri pa të atin në sy dhe i tha: "Baba, mos më bëj padrejtësinë e të pasurit për prind një tradhtar. Qëndro i fortë! Nëse më vrasin, do të vdes me emrin «Jezus» në buzë."

Kuraja e djalit i zemëroi rojat komunistë dhe e rrahën për vdekje ndërsa i ati i shihte. Ai jo vetëm që qëndroi në besim, por ndihmoi të atin të bënte të njëjtën gjë.

A nuk ka padrejtësi në botë? Kur lexojmë për mizoritë e tmerrshme të kryera ndaj të pafajshmëve, ne s'mund të rrimë pa pyetur veten. Mund të lëkundemi në besim kur dëgjojmë për vuajtjet mizore në duart e keqbërësve, mund të dekurajohemi kur kërkojmë me ngulm balsamin e mëshirës që duket se vonon. A nuk ka padrejtësi në botë? Në përgjigje të thirrjes sonë, Bibla na mëson parimin «po dhe jo akoma». Po, disa keqbërës përballen me drejtësi të menjëherëshme herë pas here. Megjithatë, dora e fuqishme e Zotit, e drejtësisë së përherëshme, duhet akoma të bjerë në këtë tokë. Kjo është ruajtur për fundin e kohëve. Ne mund të lodhemi duke pritur, por ai është i pandryshueshëm.

Ai nuk do të ligështohet e nuk do të dekurajohet; derisa të vendosë drejtësinë mbi tokë.

Isaia 42:4

FKSTREM

Përgjigje ekstreme

KUBA: TOM UAIT



Kur kapuçi i zi iu vu në kokë, Tom Uait nuk e dinte në do ta shihte më dritën. «Ku po më çoni?» – pyeti ai rojat kubanë. Rojat nuk thanë asgjë.

Tom kishte shpërndarë në mënyrë të fshehtë literaturë të krishterë në Kubë për shtatë vjet. Ai dhe të tjerët kishin hedhur trakte ungjilli nga avionët në oqean përreth ishullit komunist. Por nuk kishte dëgjuar sikur nga një i krishterë i vetëm në Kubë, që materialet kishin shkuar.

«Të lutem, o Zot,» – u lut Tomi, – «na jep konfirmim që puna jonë po ndihmon.»

Gjashtë javë më vonë, ai u çua për të takuar një oficer të shërbimit sekret kuban, kapitenin Santos. Avioni i tyre ishte përplasur në Kubë dhe Tomi dhe piloti Mel Bejli, u kapën dhe u akuzuan për kompromentim të stabilitetit të kombit.

«Njerëzit tanë kanë gjetur mijëra prej këtyre në plazhe dhe në fusha!» – bërtiti kapiteni Santos, duke mbajtur një prej pakove detare që ishte lëshuar vite më parë.

Tomi u përpoq të mos buzëqeshte. «Faleminderit, Zot që iu përgjigje lutjes sime», u lut ai. «Faleminderit që puna jonë nuk ka qenë e kotë.»

Përgjigjja e lutjes së Tomit ishte e kushtueshme. Ai kaloi njëzet e një muaj në burgjet kubane. Por në burgjet e Kastros takoi shumë anëtarë të kishës dhe mësoi se madje edhe nën Kastron, trupi i Krishtit po rritej. Zoti e plotësoi lutjen e tij.

Kështu, duke pasur një dashuri të madhe ndaj jush, ishim të kënaqur duke ju komunikuar jo vetëm ungjillin e Perëndisë, por edhe vetë jetën tonë.

1 Selanikasve 2:8

A e dinë besimtarët ç' do të thotë një përgjigje e kushtueshme lutjeje? Nëse ne duam që Zoti t'u përgjigjet lutjeve tona, duhet të jemi të gatshëm të marrim përgjigje nën çdo rrethanë. Një përgjigje e kushtueshme lutjeje është ajo që na përfshin në një proces. Ne ia ofrojmë lutjet tona Zotit, por, a ia ofrojmë jetët tona nëse është e nevojshme? Ne mund të lutemi shpesh për ata që janë nën shtypje. Po sikur të thirresh për të ndihmuar në shpërndarjen e ushqimit dhe ndihmës nëpërmjet një mundësie misioni në kishën tënde? Nëse ne i kërkojmë Zotit të na ndihmojë në kohë nevojë, duhet gjithashtu të përgjigjemi kur na kërkon të jemi pjesë e zgjidhjes. A ka ndonjë problem për të cilin je lutur dhe nuk ke marrë një përgjigje të qartë? A mund të ndodhë që Zoti po pret gatishmërinë tënde për të qenë pjesë e zgjidhjes?

FKSTREM

Dëshmitarë ekstremë

AMORIA: SHTATË TË BURGOSUR

Për shtatë vjet, klerikët radikalë myslimanë ishin përpjekur të bindnin «jobesimtarët» për të ndjekur islammin. Por të krishterët, të mbyllur në errësirën brutale të burgjeve, nuk ndryshonin besim.

«Muhamedi është profeti më i madh» – përiqeshin t'u shpjegonin të krishterëve. «Ai jetoi më vonë se Krishti dhe ishte profeti i fundit i Allahut.»

Të krishterët dëgjuan me kujdes dhe u përgjigjën: «Në sistemin tuaj ligjor, legjitimiteti i një çështjeje përcaktohet nga numri i dëshmitarëve. Jezu Krishti ka dëshmi për ardhjen e tij që nga Moisiu deri te Gjon Pafëzori. Vetëm Muhamedi ka dëshmuar për veten.»

Të hutuar, imamët provuan një sulm tjetër.

«Sigurisht që islami është feja e dhënë nga Zoti sepse perandoria jonë është shumë më e madhe se tokat e kontrolluara nga të krishterët», – thanë ata me buzëqeshje vetëkënaqësie.

«Nëse kjo do të ishte e vërtetë, – iu përgjigjën të krishterët, – atëherë adhurimi i idhujve të Egjiptit, Greqisë dhe Romës do të kenë qenë fe të vërteta, sepse njëherë e një kohë qeveritë e tyre kishin perandoritë më të mëdha. Është e qartë që fitorja juaj, fuqia dhe pasuria nuk provojnë vërtetësinë e besimit tuaj. Ne e dimë që Zoti ndonjëherë u jep fitore të krishterëve dhe ndonjëherë i lë ata në tortura dhe vuajtje.»

Ishte viti 1845 kur myslimanët afër qytetit Amoria të Lindjes së Mesme, më në fund hoqën dorë që t'i shihnin të krishterët të ndiqnin Muhamedin. Të shtatëve iu pre koka dhe trupat e tyre u hodhën në lumin Eufrat.

Jezusi na urdhëroi të jemi dëshmitarët e tij dhe jo të kemi të gjitha përgjigjet. Tri fjalët më të fuqishme që mund t'i thoni një jobesimtari janë: «Nuk e di». Sigurisht që ju mund të keni një përgjigje, madje përgjigjen e duhur të shumë pyetjeve dhe dyshimeve të një jobesimtari. Megjithatë, përvoja do ta tregojë se do të ketë gjithnjë kundërprova ndaj informacionit tënd. Nëse arrin ndonjëherë në një pikë për dëshmi, ku ti nuk e di «përgjigjen», thuaje këtë. Pastaj fokusohu mbi një gjë që ti e di dhe e cila s'mund të debatohet: dëshmia jote. Përvoja jote me Jezu Krishtin dhe se çfarë ka bërë ai në jetën tënde është e pafuzueshme. Ti je ekspert i temës. Dëshmia efektive është ndarja e historisë sate me të tjerët.

Dhe ju do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut.

Veprat 1:8

Bindje ekstreme

EKSTREM

INDONEZI: PETRUS

Në një intervistë të kohëve të fundit, një i krishterë indonezian, Petrus, bëri këtë deklaratë habitëse: «Për shkak se kemi Jezusin, nuk është e vështirë të jesh i krishterë, megjithëse ka shumë shtypje». Ndërsa deklarata e tij duket e qartë për shumë prej nesh, të ndjekurit e Krishtit i ka kërkuar shumë sakrificat të mëdha Petrusit.

Një turmë radikalësh të zemëruar myslimanë rrethuan ndërtesën e kishës duke thyer dritaret dhe duke shprehur urrejtjen e tyre ndaj të krishterëve. Ati i Petrusit, pastori i kishës, ishte brenda me nënën e Petrusit, motrën, kushërirën dhe me një punëtor të kishës. I ati i tij ishte përpjekur të qetësonte turmën, por ata nuk largoheshin. Ai u kthye në kishë për t'u lutur duke kërkuar mbrojtjen dhe ndihmën e Zotit.

Turma e etur për gjak dhe duke ulëritur, i vuri flakën ndërtesës ndërsa priste të sulmonte cilindo që dilte jashtë. Policia indoneziane ishte tepër e frikësuar për të vepruar. Ushtria nuk ishte e pranishme. Kjo ishte kisha e rradhës që digjej në një shtet ku më shumë se pesëqind kisha ishin djegur brenda dhjetë vjetësh.

Kur Petrusi arriti në vendngjarje disa orë më vonë, kisha dhe shtëpia e pastorit ishin bërë hi. Trupat e të dashurve ishin djegur aq sa s'njiheshin.

Më vonë, një zyrtar i qeverisë i kërkoi ndjesë Petrusit, por i kërkoi edhe të mos merrte hak. Dëshira e Petrusit nuk ishte për hakmarrje, por për dashuri. Ai dëshiron t'i shohë myslimanët në vendin e tij të fituar në mbretërinë e Krishtit.

Persekutimi është ndoshta fusha përfundimtare e betejës në luftën midis instinktit natyror dhe bindjes shpirtërore. Instinkti është i përqendruar në vetëmbrojtje. Bindja është përtej interesave tona. Instinkti thotë të marrësh hak ndaj keqbërësve. Shumë prej nesh, kur shohim të dashurit tanë të vranë për besimin e tyre, do ta kishim instinktivisht të vështirë për të ndarë bindjen e Petrusit. Megjithatë, alternativa e ndjekjes së Krishtit ishte më e vështirë për Petrusin. Si të mos e ndiqte Krishtin? Historia e tij provon se është e mundur që bindjet tona të mbizotërojnë mbi instinktet tona. Por kjo ndodh vetëm kur prirjet tona të natyrshme kthehen nga dashuria bindëse e Krishtit – një fitore në mes të fushës së betejës së persekutimit.

Sepse ungjilli ynë nuk erdhi deri tek ju vetëm me fjalë, por edhe me fuqi dhe me Frymë të Shenjtë, dhe me shumë bindje.

1 Selanikasve 1:5

FKSTREM

Vrasje ekstreme – pjesa e dytë

BANGLADESH: ANDREU

Udhëheqësi mysliman u trondit kur gjeti Andreun, ungjilltarin e krishterë, të ulur në dhomën e ndenjies me familjen e tij duke ngrënë së bashku!

Ai u trondit sepse kohët e fundit kishte ofruar një shpërblim të madh për vrasjen e këtij të krishteri. Tani Andreu ishte në shtëpinë e tij duke u treguar pjesëtarëve të familjes së tij për Jezusin. «Çfarë po ndodh këtu?» – ulëriti ai. «Ç'është duke bërë ky njeri, ky i pafe, ky armik i Allahut në shtëpinë time?»

Nusja e djalit e nisi: «I kërkova unë të vinte këtu sepse ai, Jezusi i tij, ka shëruar djalin tënd, bashkëshortin tim». Historia e saj vazhdoi me një furi fjalësh. «Ai ka tetëmbëdhjetë vjet që është i sëmurë, por sot ky i krishterë, Andreu, erdhi dhe u lut për të. Vuri duart mbi të dhe tani është mirë! Jezusi e shëroi!»

Burri pa ngazëllimin e të birit ndërsa ky i thoshte se tani e ndiente që sëmundja ishte larguar nga trupi i tij. Kjo ishte hera e parë prej muajsh që i biri ishte ngritur nga shtrati. Për herë të parë në tetëmbëdhjetë vjet, nuk ndiente asnjë dhimbje.

Zemërimi i burrit u zëvendësua nga një ndjenjë lehtësimi dhe lumturie. Ai nuk zgjodhi të pranonte Krishin atë ditë, por është bërë aleat i të krishterëve në atë zonë dhe ka ndihmuar shumë prej tyre të shmangin burgun dhe persekutimin.

Njeriu që dikur shkroi një kontratë për kokën e Andreut, tani e mirëpret atë krahëhapur.

Krishterimi është një lloj eksperience që duhet provuar vetë. Kur babai mysliman hyri në shtëpinë e tij, Andreu nuk po predikonte një predikim prej tri çështjesh mbi Trininë.

Ai nuk po qortonte gruan dhe fëmijët se besonin më parë tek Allahu, por po hante një vakt pasi u lut me familjen myslimane. Ata kishin një shtrat të sëmuri bosh për të provuar se Zoti ishte i vërtetë. Në të njëjtën mënyrë ne duhet të kujtojmë që të vërtetat e Zotit janë të dukshme. Ne si lajmëtarë, nuk kemi presionin e të thënit apo të bërit drejt të gjërave. Ne bëjmë gjënë e duhur sa herë që u shpallim ungjillin të tjerëve; duhet t'i lëmë provat e realitetit të Krishtit të flasin vetë.

Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t'i tërheq të gjithë tek unë.

Gjoni 12:32

E vërtetë ekstreme

RUMANI: PASTOR KOÇANGA

«Ke frikë se çfarë do të të bëjmë?» – pyeti koloneli komunist, me ton si tallës ashtu edhe sfidues.

Pastori i ri Koçanga, që kishte predikuar vetëm një herë në karrierën e tij, qëndroi para kolonelit duke e ditur që ai kishte pushtetin e jetës dhe vdekjes mbi të. Ai u përgjigj me një ton të respektueshëm, por të zjarrtë.

«Zotëri, e vërteta nuk ka asnjëherë frikë. Imagjinoni sikur qeveria të vendosë të varë të gjithë matematicienët. Sa do të bënin dy plus dy atëherë? Dy plus dy do të bënin përsëri katër. Ne kemi të vërtetën, po aq të vërtetë sa ekuacioni i matematicienit. Ne kemi të vërtetën që ka një Zot dhe ai është Ati ynë i dashur. Kemi të vërtetën që Jezusi është shpëtimtari i botës dhe dëshiron të shpëtojë gjithsecilin, madje edhe ju. Ne kemi të vërtetën që ekziston Fryma e Shenjtë që fuqizon njerëzit dhe u jep atyre dritë dhe kemi të vërtetën që ekziston një paradisi e bukur. Çfarëdo kamxhiku dhe çfarëdo mjeti torture që të keni, do të jetë gjithmonë kështu. Dy plus dy bëjnë katër».

Koçanka u rrah deri në shpërfytyrim dhe nuk u pa kurrë më. Megjithëse fytyra e gjakosur dhe e dërrmuar zor se njihej nga të burgosurit e tjerë, në qiell ai u njoh menjëherë dhe u mirëprit.

«Trego të vërtetën.» Fëmijët e mësojnë këtë urdhërim në moshë të vogël dhe përsëri urtësia e tij është e pafund. Nëse kthehemi thjesht te njohja se ajo që dimë është e vërtetë, do t'i kemi gjithmonë fjalët për të thënë kur thirremi për të dëshmuar për Krishtin. Shumë njerëz ndihen shpesh të pakualifikuar për të dëshmuar për Krishtin, duke thënë se nuk kanë mjaft «stëroitje». Ne kemi frikë se mos na bëjnë pyetje teologjike dhe nuk dimë si të përgjigjemi. Megjithatë, të rrëfesh Krishtin nuk kërkon një kurs mbi apologjikën (mbrojtjen e fesë). Thjesht rrëfe të vërtetën për atë që di – pikërisht ashtu si ata që kanë përjetuar shtypje fetare. Të rrëfesh për Krishtin është më e lehtë sesa duket. Ne duhet të kthehemi te parimi që kemi mësuar që fëmijë. Na urdhërohet të njohim Jezu Krishtin – të tregojmë të vërtetën.

Por kushdo që do të më rrëfejë
përpara njerëzve, dhe unë do ta
rrëfej përpara Atit tim që është në
qiell.

Mateu 10:32

Vetëm kur një njeriu i kundërshtohet dhe i sulmohet besimi i tij, ai fillon me të vërtetë të mendojë për komplikimet e atij besimi. Vetëm kur kisha përballohet me disa herezi të rrezikshme, kupton pasuritë dhe mrekullinë e ortodoksisë (besimit të vërtetë). Është karakteristike e krishterimit që ka pasuri të pashtershme dhe që mund të prodhojë gjithmonë pasuri të reja për t'u përballur me çdo situatë.

UILLIAM BARKLEI – BIBLA PËR STUDIM DITOR

FKSTREM

Misionarë më ekstremë

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

Ndërsa treni filloi të dilte nga stacioni, të krishterët që ishin në platformë shkopsitën palltot e tyre dhe nxorën qindra trakte ungjilli. Me të shpejtë vërtitën traktet, çdo herë nga një grusht drejt dritareve të hapura të trenit ku ndodheshin trupat ruse.

Ushtarët rusë, disa prej tyre jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë vjeç, qeshnin dhe u fërshëllenin veçanërisht vajzave të reja tërheqëse që hidhnin «gjëra» drejt dritareve. Ata kapën traktet duke pyetur veten se çfarë po hidhej në një tren ushtarak. Kur oficeri politik hipi në tren, ushtarët me të shpejtë futën traktet nëpër xhepa. Shumë shpejt ata do të lexonin broshurën e çuditshme për të zbuluar më shumë për këtë «Mbret».

Prapa, në platformën e trenit, të krishterët e mbledhur qeshnin me nervozizëm. Kur oficeri i policisë mori njërin mënjane, ai e hapi me dëshirë pallton sepse nuk kishte asgjë brenda. Të gjitha traktet që ishin sjellë në stacionin e trenit rumun ishin tani në tren, duke u drejtuar për në zemër të Rusisë komuniste.

Ungjillizimi tren-makinë ishte vetëm një nga metodat që Riçard Vurmbandi u mësoi të rinjve në kishën e tij për të arritur rusët për Krishtin. Këta «aleatë» po vidhnin pasurinë e vendit të tij dhe po vrisnin shumë prej njerëzve të tij, por përsëri Riçardi i mirëpriste ushtarët. Te secili ushtar ai shihte një fushë misioni dhe kërkonte mundësinë për të fituar një individ për Krishtin.

Një mision nuk është më shumë një vend, sesa është një qëndrim – qëndrimi i dikujt ndaj jetës. Një misionar është thjesht dikush që mishëron këtë vendosmëri dhe fokusim të vetëm dhe e shpreh këtë në jetën e përditshme. Riçard Vurmband ishte një njeri në mision dhe ngazëllimi i tij u shpërnda përmes radhëve të të rinjve që njohën qëllimin e tij. Në këtë aspekt, ne jemi të gjithë misionarë – ambasadorë për Krishtin – kudo që jemi duke shërbyer. Të qenit në mision do të thotë të jesh gjithnjë gati për mundësi të reja për të zgjeruar mbretërinë e Perëndisë. Në punë, në dyqan, në një tren apo autobus, në shkollë... Bota e përditshme është fusha jotej e misionit kur je i vendosur për të zgjeruar mbretërinë e Perëndisë.

*Prediko fjalën; ngul këmbë me kohë
e pa kohë.*

2 Timoteut 4:2

FKSTREM

Trashëgimi ekstreme

INDONEZI: STANLI

Kur Stanli zbriti nga varka në ishullin e largët indonezian, ndjeu errësirën shpirtërore. Njerëzit praktikonin një kombinim të magjisë dhe islamit. Stanli ishte i sapodalë nga një shkollë biblike dhe gati për punën për të cilën Zoti e kishte thirrur, të fituarit e këtyre njerëzve për Krishtin.

Stanli predikoi me guxim, duke u bërë thirrje njerëzve të ktheheshin te Krishti dhe të digjnin idhujt dhe reliket e jetës së tyre të mëparshme. Një mysliman dogji idhullin e tij, por brenda ishte një rrotull nga Kurani. Kur myslimanët radikalë dëgjuan për djegien e Kuranit, e raportuan Stanlin te zyrrarët e zonës dhe ai u arrestua menjëherë.

Megjithëse Stanli u rrah mizorisht dhe kaloi në gjendje kome, mbikëqyrësi i tij nga shkolla biblike, pastor Siu, erdhi për ta parë dhe dalloj t'i rridhnin lot nga sytë. Shumë shpejt pas kësaj, Stanli vdiq nga dëmtimet.

Por as vdekja s'mund t'i jepte fund shërbesës së Stanlit. Kur historia e tij u tregua në fshatin e tij, njëmbëdhjetë myslimanë pranuan Krishtin si Shpëtimtar. Pesëdhjetë e tre fshatarë morën vendimin për të ndjekur një shkollë biblike, shtatë prej të cilëve kërkuan të dërgoheshin misionarë pikërisht në fshatin ku Stanli kishte vdekur.

Duke shpresuar të shuanin zjarrin e ungjillit, zyrtarët e fshatit shuan jetën e Stanlit. Por edhe në mes të dhunës, dora e Zotit ishte në punë. Sot flakët e ungjillit digjen ndritshëm në atë fshat.

«Lëreni dritën nderur.» Këtë duhet të kenë si qëllim të gjithë ata që ndjekin Krishtin pasi të lënë pas këtë botë. Një i krishter i përkushtuar lë dritën nderur për një botë që është e humbur në errësirë. Ndryshe kjo quhet të lësh një trashëgimi. Duket sikur shpesh dëgjojmë për njerëz të famshëm që lënë pas një trashëgimi në film, sport, apo në fusha të tjera publike. Megjithatë, ndërsa jetët e shumë shenjtorëve të krishterë po shuhen në anonimitet, dritat e tyre besnike digjen akoma ndritshëm në mbarë botën. Trashëgimia e tyre e besimit, e integritetit, e shpresës dhe e dashurisë s'mund të shuhet nga vdekja e tyre. Në fakt vdekja mund ta shtojë flakën, sepse një trashëgimi e tillë shpesh imitohet me dëshirë nga ata që mbeten.

Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet.

Mateu 5:14

FKSTREM

Familje ekstreme

INDONEZI: NËNA E STANLIT

Gruaja donte vetëm një muaj të diplomahej nga shkolla biblike së bashku me të bijën. Ishte e njëjta shkollë biblike në të cilën djali i saj, Stanli, kishte shkuar para se të shkonte në një ishull tjetër indonezian si misionar. Stanli u vra sepse çoi ungjillin, por dëshmia e tij nxiti shumë të tjerë për të shkuar në shkollë biblike dhe për të pranuar thirrjen e Zotit që të tregonin për dashurinë e Tij.

Pasi mbaruan praktikën e tyre, gruaja dhe e bija planifikuan të shkonin pikërisht në fshatin ku Stanli kishte vdekur. Ajo shpresonte për një mundësi për të treguar dashurinë e Krishtit, madje edhe njeriut që i kishte rrahur të birin për vdekje. Një vizitor në shkollën biblike duke dëgjuar për planet e saj, u habit.

«Nuk ke frikë se vdes?» – e pyeti ai.

Gruaja dukej e hutuar nga pyetja, sikur të mos ishte diçka që e kishte menduar më parë. «Pse duhet të kem frikë?» – u përgjigj thjesht ajo.

Besimi i saj në mirësinë e Zotit ishte i plotë. Nëse ai vendoste ta përdorte atë në fshatin ku i biri i vdiq, le të ishte kështu. Dhe nëse ai e lejonte që ajo të vdiste atje, ajo do ta pranonte atë thirrje gjithsesi. Vdekja do ta çonte atë në praninë e Krishtit që ajo donte. Vdekja nuk ishte një pengesë, apo një dënim, ishte thjesht një derë për në praninë e përjetshme të Zotit.

Përballimi me vdekjen mund të na sjellë ndërmend fëmijët që qëndrojnë në buzë të një grope me ujë. Ne shtrëngojmë supet fort pas trupit duke u dridhur, në pritje të së panjohurës. A do të lëndohem? A do t'ia dal mbanë? Ne nuk duam të jemi të parët që hidhemi – jo me gjithë këto pasiguri. Fatmirësisht, nuk na duhet të veprojmë kështu. Historia është plot me pjesëtarë të familjes që kanë kaluar përmes kufijve midis jetës dhe vdekjes. Ata janë shenjtorë që vdiqën me sigurinë e plotë të destinacionit të tyre. Jezu Krishti, në fakt, ka shkuar atje ku asnjë nuk ka qenë më parë – në vdekje dhe përsëri në jetë. Krishti, kreu i familjes sonë të krishterë, ia ka hequr tmerrin vdekjes dhe e ka zëvendësuar atë me siguri. Vërinë veshin thirrjes për të hyrë në të, uji është i mirë.

O vdekje, ku është gjemba jote? O ferr, ku është fitorja jote?

1 Korintasve 15:55

ANËT EKSTREME

RUSI: HIPOKRITËT

Ata ishin duke kënduar në kor kur dy ushtarë hynë me armë. Shërbesa ndaloi ndërsa ushtarët rusë vështronin besimtarët me sy të egër.

«Çfarë po bëni këtu?» – thirrën ata. «Po adhuroni Zotin tuaj imagjinar?» Anëtarët e kishës u ulën në stola duke pyetur veten nëse kishte ushtarë të tjerë dhe më shumë armë jashtë.

«Të gjithë ata që i janë besnikë Zotit, të lëvizin në anë të djathtë të kishës», – tha njëri prej ushtarëve me një maskë urrejtjeje në fytyrë. "Ju do të qëlloheni për besimin tuaj. Ju që dëshironi të shkoni në shtëpi dhe të jetoni, qëndroni në të majtë. Ju duhet të vendosni të jetoni, apo të vdisni. Ata që janë besnikë ndaj «Zotit» do të vdesin, ata që do ta mohojnë atë, mund të jetojnë të lirë."

Dhjetë minuta më parë të gjithë kishin kënduar lavde njësoj, tani ishte çështje jetë a vdekje. Disa qëndruan në të majtë, duke parë me trishtim apo duke vështruar sikur po kërkonin ndjesë, ata në të djathtë qëndruan me sy të mbyllur në lutjet e minutës së fundit.

«Ju në të majtë jeni të lirë të shkoni», – tha njëri prej ushtarëve disa çaste më vonë. Këta njerëz dolën jashtë duke u hedhur një vështrim të fundit atyre që shumë shpejt do të ishin të vdekur.

Kur mbetën vetëm ata në të djathtë, ushtarët ulën armët e tyre. «Edhe ne jemi të krishterë, – thanë ata, – por donim të adhuronim pa hipokritë.»

Momente vendimtare na vijnë kur nuk i presim dhe ne s'mund të përgatitemi për to, duhet t'i përjetojmë «siç janë» dhe të mësojmë nga pasojat. Një moment vendimtar është çdo situatë që përfshin një pyetje karakteri. Ajo mund të jetë po aq komplekse, sa një shërbesë kishë e ndërprerë nga keqbërës që kërkojnë që ne t'i nënshtrohemi një besimi, apo një tjetri. Ose mund të jetë aq e thjeshtë, sa të dalësh jashtë nga një film fjes. Përgjigjja jonë ndaj një momenti vendimtar do të na anojë në atë që është sipas Krishtit, apo në atë që është e dyshimtë. Të gatshëm apo jo, duhet të përballemi me karakterin tonë të vërtetë ballë për ballë në momentin që vendosim të mbajmë një anë.

Ai që nuk është me mua, është kundër meje dhe ai që nuk mbledh me mua, shkapërderdh.

Mateu 12:30

Lutje më ekstreme

BOHEMI: JAN HUS

«O Krisht i mëshirshëm,» – shkroi Jan Hus, ndërsa priste ekzekutimin e tij, «na jep një shpirt të guximshëm që të mund të jemi gati. Dhe nëse mishi është i dobët, hiri yt shkoftë përpara, sepse pa ty s'mund të bëjmë asgjë dhe mbi të gjitha, pa ty s'mund të përballojmë një vdekje mizore. Na jep guxim dhe besim të fortë, një shpresë të patundur dhe mirësi të përsosur që të mund të japim jetët tona për ty me durim dhe gëzim. Amen.»

Hus kishte kërkuar reformim në kishën e shekullit të pesëmbëdhjetë, duke sfiduar priftërinjtë, të cilët shisnin indulgjenca (zëvendësues për të gjitha pendesat e tjera) dhe kërkonte standarde biblike drejtësie. Husit iu premtua mbrojtje mbretërore për të paraqitur mbrojtjen e tij. Por tani ishte i ulur në një birucë duke pritur vdekjen dhe duke i thirrur Zotit.

Më 6 qershor të vitit 1415, Husi u lidh dhe u prangos në një shtyllë stive drush. Ndërsa zjarri u ndez rreth tij, Husi u lut: «Zot Jezus, është për hir të ungjillit dhe të predikimit të fjalës që po i nënshtrohem me durim dhe përlulesi kësaj vdekjeje të tmerrshme, të turpshme dhe mizore».

Ndërsa flakët u ngritën rreth tij, Husi, me frymën e tij të fundit thirri: «O Krisht, Bir i Perëndisë së gjallë, ki mëshirë për mua!».

Dëshmia e Husit ishte vendimtare për heqjen e praktikave të shitjes së indulgjencave dhe për ndikimin e të krishterëve për t'u kthyer te mësimet biblike.

Lutja, ajo që funksionon më shumë dhe që ne e përdorim më pak! Lutja është mbrojtja jonë e parë kundër luftës shpirtërore dhe përsëri, mundësia jonë e vetme. Ata që janë persekutuar për besimin e tyre na mësojnë prioritetin e lutjes. Shënimet e tyre të fundit nuk janë fjalë luftuese, veprimet e tyre të fundit në tokë nuk janë rezistencë. Por është lutja, fryma e tyre e fundit e vdekjes, duke i hutuar akuzuesit dhe duke bindur të tjerët për besimin e tyre të patundur. Historia tregon se lutjet gjatë vdekjes së shenjtoreve të persekutuar mund të ndikojnë tek të tjerët për ungjillin, ndoshta më shumë sesa gjatë jetës së tyre. Kur të jesh në vatrën e zjarrit të jetës dhe «flakët» të jenë të nxehta rreth teje, a do të kthehesh te lutja? A do ta shohin të tjerët që mbrojtja jote e parë dhe e fundit është komunikimi me Atin tënd qiellor?

Shumë fuqi ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë shpirt.

Jakobi 5:16

FKSTREM

Inkurajim ekstrem

VIETNAM: PASTOR NGUJEN LAP MA

Kur komunistët morën në kontroll Vietnamin, pastor Ngujen Lap Ma refuzoi të largohej nga Kisha e Aleancës Misionare në Can Tho. Për këtë «krim» ai dhe e gjithë familja e tij u vendosën nën arrest shtëpie në një fshat të vogël të prapambetur pa mundësi udhëtimi dhe komunikimi me botën për dymbëdhjetë vitet e para.

Më në fund, kur autoritetet i lehtësuan kufizimet për postën, Pastori Lap Ma u rënqeth kur pa letrat të vinin në shtëpinë e tij. Zëri i Martirëve botoi historinë e pastorit Lap Ma dhe adresën e tij. Studentë, shtëpiake, pastorë dhe biznesmenë i shkruan letra inkurajimi pastorit dhe familjes së tij. Policia vietnameze u habit kur pastori Lap Ma mori më shumë se tre mijë letra nga mbarë bota.

«E lexoj çdo letër me lutje dhe lot», – tha pastor Lap Ma. «Përpij çdo letër dhe meditoj mbi Shkrimet e komunikuar në to. Pastaj njoftoj familjen time në vietnamsisht për këto fjalë inkurajimi dhe citimet nga Shkrimet. Ne gëzohemi dhe inkurajohemi nga mesazhet në to.»

«Zoti na ka forcuar dhe na ka ndihmuar» – vazhdoi pastori. «Kështu që ne vazhdojmë të shpresojmë në të duke e mbajtur shikimin nga Jezusi. Ne e ndjekim atë për të duruar kryqin, duke përbuzur turpin e tij deri në pikën e vdekjes. Ndërsa jemi duke jetuar, Zoti na përdor për të ngushëlluar të krishterë të tjerë që janë duke vuajtur». Këto letra ishin inkurajim për ta, ndërkohë që ata vetë me gëzim inkurajojnë besimtarë të tjerë.

Inkurajimi është një nxitës i nevojshëm për të krishterët. Pa inkurajim, ashtu si një vrapues pa ujë, askush s'mund ta durojë këtë gjendje shpesh dërrmuese, për një kohë të gjatë. Ndërsa bëjmë udhëtimin tonë, mësojmë se inkurajimi është një rrugë me dy korsi. Ne u japim inkurajim të tjerëve dhe kështu e marrim atë nga besimtarë të tjerë dhe madje, edhe nga vetë Zoti. Një inkurajim i vogël shkon larg në forcimin e të lodhurve dhe në motivimin e atyre, besimi i të cilëve po dobësohet. Ne shpesh zbulojmë se inkurajimi shpirtëror që marrim nga lutjet e atyre rreth nesh, na përtërin për kilometrin e dytë. Në disa raste do të thotë dymbëdhjetë vite të tjera në burg për besimin tonë. Në raste të tjera, ka të bëjë thjesht me aftësinë për të përballuar një ditë tjetër.

Sepse unë dëshiroj fort t'ju shoh për t'ju shërbyer me ndonjë dhunti frymërore që të fortësoheni. Dhe kjo është që unë të ngushëllohem bashkë me ju me anë të besimit që e kemi të përbashkët, tuajin dhe timin.

Romakëve 1:11-12

***Nëse nuk jeni gati të vdisni për atë
që është në Bibël, nuk duhet të jepni para
për Bibla. Sepse nëse jepni,
ne do të shpërndajmë më shumë.
Dhe nëse shpërndajmë më shumë Bibla,
do të ketë më shumë martirë.***

RIÇARD VURMBRAND –
PASTOR DHE THEMELUESI I MISIONIT ZËRI I MARTIRËVE



FKSTREM

Nënë ekstreme

ANGLI: SUZANA UESLI

Dhjetë nga dymbëdhjetë fëmijët e Suzanës vdiqën para se të bëheshin dy vjeç dhe njëra prej vajzave të saj ishte e deformuar. Përsëri ajo shkroi në ditarin e saj se të gjitha vuajtjet e saj shërbyen për të «rritur të mirën time shpirtërore dhe të përjetshme. Lavdi të qoftë Ty, O Zot!».

Ati i saj kishte refuzuar t'i nënshtrohej ligjit të Anglisë të vitit 1662, i cili i detyronte të gjithë klerikët të rishuguroheshin sipas liturgjisë së re të Lutjesores Anglikane. Shumë prej këtyre të krishterëve të quajtur jokonformistë, vdiqën në burgjet angleze për besimin e tyre.

Bashkëshorti i saj qëndroi me kishën anglikane. Për shkak të jopopullaritetit, anëtarët e famullisë së tij ia nxinin jetën. Ai u fut në burg sepse ishte i mbytur në borxhe dhe Suzana duroi varfëri të tmerrshme gjatë kësaj kohe. Një hajdut madje, i preu *gjoksin* e lopës që ajo të mos kishte qumësht për fëmijët e saj.

Një ditë, çatia e shtëpisë mori zjarr. Por e gjithë familja ia doli mbanë, Xhoni gjashtëvjeçar u shpëtua me shkallë pikërisht në kohë nga një dritare e sipërme. Ai i mbijetoi rënies dhe ky djalë, Xhon Uesli, u rrit për të genë themeluesi i denominacionit metodist. Djali tjetër i saj, Çarls Uesli, shkroi këngën klasike të Krishtlindjes «Dëgjoni si këndojnë engjëjt lajmëtarë» midis himneve të tjera të paharrueshme.

Suzana Uesli tha thjesht: «Feja nuk është gjë tjetër, veçse të bësh vullnetin e Zotit para vullnetit tënd. Parajsa apo ferri varen vetëm nga kjo».

«Ai ka mjekrën e t'atit, ajo është imazhi i gjallë i gjyshes.» Sytë, veshët, flokët, duart, apo tipare të tjera gjenetike mund të na lidhin me pjesëtarët e familjes, ndonjëherë përmes brezave. Kështu janë të lidhur gjithashtu edhe pjesëtarët e familjes së Zotit. Si të krishterë, ne jemi të lidhur nëpërmjet karakteristikave të ndryshme si dashuria, shpresa, gëzimi dhe paqja, të cilat vijnë tek ne drejtpërdrejt nga një trashëgimi qiellore. Edhe nëse nuk kemi prindër biologjikë, apo gjyshër si Uesli, që të na pasojnë besimin e tyre, Zoti na jep një familje shpirtërore për të na ushqyer dhe për të na dashur. Kush është nëna apo babi juaj shpirtëror – dikush që të mësoi për Krishtin? Për kë mund të jesh ti vëlla apo motër?


Sepse kujtoj besimin e sinqertë që është në ty, i cili më parë ishte te gjyshja jote Loide dhe te nëna jote Eunike dhe jemi i bindur se është edhe tek ti.

2 Timoteut 1:5

FKSTREM

Ngrohtësi ekstreme

RUSI: NADEZHDA SLOBODA




Nadezhda Sloboda zor se mund ta përmbante entuziazmin e saj. Ajo sapo kishte mësuar për Krishtin nga një program radioje me valë të shkurtra të transmetuar nga Evropa. Si e para e krishterë në fshatin e saj rus, ajo donte me patjetër t'u tregonte shokëve të saj për Zotin, i cili kishte ndryshuar zemrën e saj në mënyrë të mrekullueshme, por e dinte se autoritetet lokale e ndalonin rreptësisht çdo bisedë për Zotin apo krishterimin.

Megjithatë, Nadezhda nuk mund ta përmbante zellin e saj dhe shumë shpejt hapi një kishë. Kur policia nuk ishte në gjendje ta ndalonte rritjen e kishës, madje edhe me bllokada rrugësh, Nadezhdën e arrestuan dhe e dënuan me katër vjet burgim. Pesë fëmijët e saj u çuan me forcë në një shkollë ateiste me konvikt dhe kjo e shqetësoi Nadezhdën, por ajo ndihej më afër Zotit se kurrë më parë dhe këmbënguli në shpalljen e Krishtit edhe me të burgosurat e tjera.

Për shkak të refuzimit të saj për të ndaluar së foluri për Krishtin, zyrtarët e vunë në një qeli të vetmuar, pa ngrohje për dy muaj. Ishte mesi i dimrit dhe Nadezhdës nuk i lejohej as të kishte shtrat. Ajo detyrohej të flinte në dyshtemenë e ftohtë prej betoni. Pasi u kthye në qelinë e përbashkët, të burgosurat e tjera e pyetën se si ishte në gjendje t'i bënte ballë trajtimit të tillë. Ajo u përgjigj: «Unë bija në gjumë në dyshtemenë e ftohtë prej betoni duke i besuar Zotit dhe ajo bëhej e ngrohtë rreth meje. Unë pushoja në krahët e Zotit».

Pjesa më e madhe e të krishterëve kujtojnë një kohë në udhëtimin e tyre shpirtëror kur dukej sikur kurrë s'mund të merrnin mjaft nga Zoti dhe Fjala e Tij. Zelli shpirtëror ishte si natyrë e dytë. Zjarri ishte një mik i vazhdueshëm. Përsëri, në njëfarë mënyre besimi ynë u ftoh gjatë rrugës. Ndoshta ishte persekutimi që mbyti entuziazmin tonë. Ndoshta ishte tragjedi personale. Ose ndoshta s'ishte asgjë në veçanti – thjesht aktivitetet e zakonshme që ftohën shpirtrat tanë dhe zunë prioritetet tona. A janë flakët e zjarrit shpirtëror tani thjesht hi? A është ftohur zelli yt? Është e mundur të rifillosh një marrëdhënie me Zotin dhe të ndezësh zjarrin përbrenda? Kërkoji Atij të të ndihmojë, të të nxisë që sot këtë ide.



Atëherë unë thashë: «Nuk do ta përmend më dhe nuk do të flas më në emër të tij». Po fjala e tij ishte në zemrën time si një zjarr flakërues, i mbyllur në kockat e mia, përpiqesha ta përmbaja, por nuk mundesha.

Jeremia 20:9

«Shikim» ekstrem

BREGU I FILDISHTË: KLOJE

Grushtet dukeshin sikur vinin nga të gjitha anët dhe Kloje u përpoq të vinte duart rreth kokës për t'u mbrojtur. Megjithëse nuk e dinte sa sulmues ishin, ajo ndiente zhurmën e mprehtë të çdo grushti ndërsa humbi ndjenjat. Sulmuesit i bërtisnin, tallnin besimin dhe Jezusin e saj. Kloje u lut në qetësi duke i thirrur Zotit për t'i dhënë fuqi.

Çdo javë, Kloje ecën më shumë se tridhjetë kilometra në Bregun e Fildishtë për të predikuar në një fshat të quajtur Sepikaha. Një grup i vogël të krishterësh e mirëpret Klojen, por pjesa më e madhe e fshatit është mysliman. Radikalët, myslimanët militantë po e rrihnin.

Klojen e çuan në spital ku i kuruan shumë prej plagëve të saj. Kur policia e pyeti se kush e kishte rrahur, ajo tha se nuk e dinte. Kishte qenë e verbër për shumë vite.

Një javë pasi doli nga spitali, Kloje u kthye në Sepikaha, duke rrezikuar jetën e saj për t'u predikuar njerëzve që s'mund t'i shihte. Sytë i kishte të verbër, por zemra e Klojes mund të shihte qartë. Ajo pa një nevojë për Jezusin në fshatin e vogël dhe të krishterë të rinj të uritur për t'u rritur në besimin e tyre. Ajo kthehet javë pas javë në Sepikaha. Fytyrat që s'mund t'i shohë tani, ajo do t'i shohë një ditë në qiell.

Nuk nevojitet një pamje grafie për të parë zemrën e një gruaje apo një burri, shpirtërisht të vdekur. Vitet e vendimeve të këqija janë shpesh të dukshme – të ngulitura në fytyrat e tyre të lodhura. Shikim shpirtëror do të thotë të përdorim «sytë» e mendjes sonë për të vënë re nevojat e të tjerëve. Kjo mjafton. Fuqia për të dalluar është hapi i parë në drejtim të sjelljes së një ndryshimi. Çfarë shihni në fytyrat e njerëzve rreth teje? Apo nuk i shikoni? Në kulturën e sotme është e mundur të jesh e rrethuar nga një turmë në ashensor, aeroport, apo në një mapo dhe asnjëherë nuk përballësh me sytë e një njeriu tjetër. A sheh njerëz që kanë nevojë për Krishtin? A janë sytë e tu shpirtërorë të stërvitur për të vënë re ata në nevojë rreth teje? Kërkoji Zotit të të ndihmojë të zhvillosh të parin shpirtëror, për të vënë re dhe për të vepruar.

Lutem që Ai të ndriçojë sytë e mendjes suaj.

Efesianëve 1.18

Shëmbëlltyrë ekstreme

EVROPA LINDORE: SHËMBËLLTYRA E TRI PEMËVE TË VOGLA

Një ditë në një pyll tri pemë të vogla ranë dakord për t'u lutur që të përdoshin për një qëllim fisnik, sesa të prisheshin nga mosha e vjetër.

Pema e parë donte të bëhej një grazhd ku gjedhi i lodhur do të mund të ushqehet pas një dite të gjatë pune. Zoti e shpërbleu pemën për një modesti të tillë. Ajo u bë një grazhd shumë i veçantë, ai në të cilin u shtri Biri i Perëndisë.

Pema e dytë u lut që do të mund të bëhej një varkë. Lutja iu plotësua dhe shumë shpejt druri i saj i mirë do të mbante një pasagjer shumë të veçantë – Birin e Perëndisë. Ajo dëgjoi Jezusin të qetësonte një stuhi të ashpër duke thënë: «Qetësohu, hesht!».

Pema e konsideronte jetën e vet si të vlefshme me qëllim që të dëshmonte një skenë të tillë.

Pema e tretë u bë një kryq i madh për të shërbyer si mjet vuajtjeje. Fillimisht ajo u zhgënjye për fatin e saj. Megjithatë, një ditë Jezusi i Nazaretit u gozhdua në gjymtyrët e saj. E çuditshme, por kryqi nuk dëgjoi rënkime dhe mallkime si të tjerët.

Në vend të saj dëgjoi Birin e Perëndisë të ofronte fjalë dashurie dhe falje hyjnore – fjalë që i hapën parajsën një hajduti të penduar.

Pema atëherë e kuptoi se pjesa e saj në kryqëzimin e Jezusit siguroi shpëtimin për njerëzimin.

Në kishat e fshehta në gjithë Evropën Lindore, shëmbëlltyra e tri pemëve është thënë shpesh si inkurajim për ata që vuanin për besimin e tyre. Këta besimtarë kishin nevojë të shihnin qëllimin e asaj që po vuanin. Ata mund të kenë pasur shpresa të larta kur kanë thënë në fillim që donin që Zoti t'i përdorte për laudinë e tij. Përsëri, shtypja dukej sikur i kishte ndërprerë nga planet e Perëndisë. Si mundet vuajtja e padrejtë të luajë rol në një plan të tillë? Si pema që krijoi kryqin, ata e kuptuan se po formoheshin në qëllimin përfundimtar të Zotit për jetën e tyre. Nga kjo perspektivë, vuajtja nuk shihet si një ndërprerje e planeve të Perëndisë për jetën tënde, por është një pjesë integrale e procesit.


Dhe jo vetëm kaq, por mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon këmbënguljen, këmbëngulja përvojën dhe përvoja shpresën. Por shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona me anë të Frymës së Shenjtë që na është dhënë.

Romakëve 5:3-5

FKSTREM

Dobësi ekstreme

RUSI: PRIFTI MIKAIL



«Nëse mohon besimin dhe shkel kryqin, do të të lejojmë të shkosh», – tha banda bolshevike.
«Nëse jo, do të të vrasim.»

Prifti Mikail kishte parë tetëdhjetë mijë bashkëpriftërinj ortodoksë rusë që i lanë njerëzit të vriteshin nga komunistët. Në mes të gjithë kësaj dhimbjeje dhe vuajtjeje, ai vendosi se, nëse Zoti do të ekzistonte nuk do të kishte lejuar një mjerim të tillë.

«Unë nuk besoj», – mendoi ai ndërsa iu drejtua bandës. «Ç'kuptim ka kryqi për mua? Le të shpëtoj jetën.»

Por kur hapi gojën për t'iu bindur urdhrin të bandës, fjalët që i dolën nga goja e tronditën. «Unë besoj vetëm në një Zot, s'do ta shkel kryqin!»

Ata i vunë një thes rreth supeve si një rrobë mbretërore dhe përdorën kapelen e tij gëzofi si kurora e gjembave të Jezusit. Njëri prej tyre, një anëtar i mëparshëm i kishës së Mikailit, u gjunjësua para tij duke thënë «Lavdi Mbretit të Çifutëve». Ata e rrahën me radhë duke fyer Zotin e tij.

Në qetësi, prifti u lut. «Nëse ekziston, të lutem ma shpëto jetën». Ndërsa rrihej, thërriste përsëri: «Unë besoj në një Zot».

Shfaqja e tij e besimit bëri përshtypje të atillë te banda e dehur, sa e lanë të lirë. Kur arriti në shtëpi, ra me fytyrë përmbys në dysheme, duke qarë dhe duke përsëritur «Unë besoj».

Besimi i krishterë është plot me paradokse. Të vdesësh që të jetosh. Të humbasësh që të fitosh. Të jesh i dobët me qëllim që të forcohesh. Kur ne kalojmë vështirësi dhe probleme apo jemi dëshmitarë nga larg të vuajtjeve të padrejta, mund të fillojmë të dyshojmë në mirësinë e Zotit. Kjo është njerëzore, reagim njerëzor. Megjithatë, Zoti nuk e refuzon dobësinë tonë njerëzore. Ai ripërtërin dobësinë tonë me fuqinë e tij. Kështu që ne mund të gëzohemi në dështimet tona, sepse ato na kujtojnë që fuqia njerëzore nuk mund të zëvendësojë fuqinë hyjnore. Ne mund të dështojmë, por Zoti ynë mbetet i fortë. Çfarë po të mëson kjo rreth fuqisë së Perëndisë?

Por ai më tha: «Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi».

2 Korintasve 12:9

Urtësi ekstreme

IZRAEL: SHTJEFNI

Dëshmitarë të rremë dëshmuan kundër tij. «Ne e dëgjuam të thoshte fjalë fyese kundër Moisiut dhe Zotit. Ky njeri flet pa pushim kundër ligjit të Zotit. Ne, madje e dëgjuam të thoshte se Jezusi nga Nazareti do ta shembte këtë vend dhe do të largonte të gjitha traditat që na ka dhënë Moisiu».

Kryepriifti i keshillit të lartë u kthye tek i akuzuari. «Çfarë ke për të thënë për veten?»

Me qetësi ai u ngrit dhe toni i tij i butë ndryshoi. «Parardhësit tuaj vranë të gjithë ata që guxuan të flisnin për ardhjen e Jezusit. Dhe ju keni ruajtur traditat tuaja fetare – ju tradhtarë dhe vrasës, të gjithë ju. Ju kishit ligjin e Perëndisë të dërguar nga engjëjt – dhuratë – dhe e shpërdoruat!»

Ulërima dhe mallkime shpërthyen si përgjigje, por Shtjefni ishte i palëkundur. Ai vështroi lart në qiell dhe tha: «Oh! Unë shoh qiellin e hapur dhe Birin e Njeriut duke qëndruar në anë të Perëndisë!» Ata mbyllën veshët me duar, e kapën dhe e tërhoqën zvarrë jashtë qytetit. Njëri prej farisenjve i quajtur Saul, mblodhi me qetësi rrobat e të tjerëve që të mos njolloseshin nga gjaku i Shtjefnit.

Ndërsa gurët filluan të hidheshin drejt trupit të Shtjefnit, ai thirri: «O Zot Jezus, merre jetën time». Pastaj u gjunjëzua duke u lutur me zë mjaft të lartë që të mund ta dëgjonin të gjithë. «Zot, mos i fajëso ata për këtë mëkat», ishin fjalët e tij të fundit. Pastaj vdiq.

Parafrazim *The Message* nga Veprat 6:11-7.60

Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar dhe atij do t'i jepet.

Jakobi 1:5

Të ruash qetësinë përballë situatave të vështira është lëvizja më e zgjuar. Gjëra të parëndësishme si bllokimi, qarkullimi, marrja e një note të ulët në shkollë, apo një kritikë e rëndë në punë, janë ato që na bëjnë të humbasim durimin në ditët e sotme. Megjithatë, të manovrosh në situatë jo të zakonshme stresuese kërkon më shumë se gjykim të shëndoshë. Duhet urtësi hyjnore. Kur u përball me akuza të rreme, madje edhe me kërcënim me vdekje, Shtjefni ushtroi urtësi të vërtetë. Ai nuk mori hak. Nuk i mallkoi akuzuesit e tij, thjesht u kap tek ajo që dinte të ishte e vërtetë dhe tek ajo që farisenjtë refuzonin të besonin – Jezusi është Biri i Perëndisë. I njëjti Jezus, i cili përqafoi Shtjefnin ndërsa vdiq, do të bëjë të njëjtën gjë edhe me ty kur të kesh nevojë për urtësinë që vjen vetëm nga Zoti.

Unë do të predikoj derisa të vdes

PASTOR LI DEKSIAN – PASTOR KISHE I CILI U ARRESTUA SE PREDIKOI PA
AUTORIZIM MË TEPËR SE NJËZET HERË.



LETRA EKSTREME – pjesa e parë

RUSI: MARIA

Të dashur mami dhe babi,

Ju përshëndes me dashurinë e Krishtit. Po ia kaloj mirë dhe ndihem shumë e bekuar. Një nga shoqet e mia të shkollës, Varia, është anëtare e Organizatës së Rinisë. I kam dëshmuar asaj dhe mendoj se po filloj t'i afrohem. Kohët e fundit më tha: «Nuk të kuptoj fare. Shumë prej studentëve të fyejnë dhe të lëndojnë, por ti gjithsesi i do».

I tregova se Zoti na ka mësuar të gjithëve të duam, jo vetëm ata që sillen mirë me ne, por veçanërisht ata që nuk sillen mirë – që të mund të shohin Zotin brenda nesh. Varia ka qenë një nga ata që u bashkua me talljet dhe fyerjet, por kjo më ka bërë të lutem edhe më shumë për të.

Sot, ajo më pyeti nëse me të vërtetë mund ta doja edhe atë! U përqaftuam dhe të dyja filluam të qanim. Besoj se ajo është shumë afër pranimit të Krishtit. Ju lutem, lutuni për të!

Kur i dëgjon ata që me zë të lartë mohojnë Zotin, duket sikur e kanë me gjithë mend. Por jeta e tregon se shumë prej tyre në të vërtetë kanë një mall të madh në zemrat e tyre. Dhe ti mund të dëgjosh rënkimet e zemrës; ata kërkojnë diçka dhe përpiqen të mbulojnë boshllëkun e brendshëm me padrejtësinë e tyre.

Do t'ju shkruaj së shpejti. Ju lutem, u bëni të fala të gjithëve në shtëpi.

Maria

Zoti i krijoi njerëzit me një boshllëk shpirtëror brenda tyre që mund të plotësohet vetëm prej tij. Kur ndeshim dikë që është armiqësor ndaj krishterimit, mund të kujtojmë nevojat e jashtëzakonshme në jetën e personit. Imagjino një hapësirë boshe në kafazin e krahavorit të armikut tënd – një trup pa një zemër. Kjo hapësirë e brendshme është ajo që çon shumë njerëz në kërkim shpirtëror. Ata, ose përgjigjen me besim, duke dashur të pranojnë ofertën e Krishtit për të mbushur boshllëkun, ose përgjigjen me hidhërim, duke refuzuar Krishtin. Shpesh, prania e një të krishteri thjesht na kujton se çfarë u mungon në jetë atyre që refuzojnë Krishtin. Ata nuk të kundërshtojnë ty personalisht, por refuzojnë atë që përfaqëson.

Sepse shumë nga ata, për të cilët ju kam folur shpesh, edhe tani po jua them duke qarë, sillen si armiq të kryqit të Krishtit.

Filipianëve 3:18

LETRA EKSTREME – pjesa e dytë

RUSI: MARIA

Të dashur mami dhe babi!

Në letrën time të fundit ju tregova për vazhën ateiste, Varinë. Tani jam shumë e gëzuar t'ju tregoj lajmin emocionues: Varia ka pranuar Krishtin! Ajo është ndryshe dhe tashmë po u dëshmon të gjithëve.

Kur Varia besoi në fillim, u ndje fajtoze përbrenda. Mendoj se ishte e mërzhitur, sepse për një kohë të gjatë ajo nuk besonte dhe kishte si synim t'u tregonte të tjerëve që nuk kishte Zot. E ndiente që duhej të vuante dhe të paguante për këtë.

Ne shkuam së bashku në mbledhjen e të pafeve (Mbledhja e Organizatës së Rinisë Komuniste). Megjithëse e paralajmërova që të ishte e rezervuar, ishte e kotë. Pasi refuzoi të këndonte himnin komunist, Varia u ngrit për t'iu drejtuar të gjithë të pranishmëve. U tha me guxim të gjithëve se kishte pranuar Krishtin si Shpëtimtarin e saj!

Ajo u lutej të gjithëve të hiqnin dorë nga rruga e mëkatit dhe të vinin te Krishti dhe i gjithë vendi ra në heshtje. Kur mbaroi së foluri, këndoi me zërin e saj të mrekullueshëm himnin e vjetër «Unë nuk kam turp të shpall Krishtin që vdiq për të mbrojtur urdhërimet e tij dhe fuqinë e kryqit të tij». Unë thjesht mund të shikoja pa mundur ta ndihmoja, ndërsa e morën. Sot është 9 Maj dhe nuk kam dëgjuar gjë për të.

Ju lutem, lutuni!

Maria

Armiqtë më të mëdhenj të krishterimit janë pikësynimi kryesor për lutje. Si Sauli i Tarsit ëshë e mundur që një armik i mëparshëm të bëhet një nga zëdhënësit më të mëdhenj për Krishtin. Megjithatë, pa lutje, do të mbetet vetëm një mundësi. Në vend që të frikësohemi prej tyre, apo të zemërohemi, duhet të lutemi për ata në komunitetin tonë, vendin tonë dhe mbarë botën, të cilët janë të zjarrtë kundër Krishtit. Sa herë që lutemi për jobesimtarë – madje edhe ateistë – mund të parashikojmë ndryshimet që mund të ndodhnin nëse energjitë e tyre do të drejtoheshin drejt Krishtit dhe jo kundër tij. Ata mund të bëhen ungjilltarët e ardhshëm për të dhënë një dëshmi të fuqishme të hirit të Perëndisë. Asnjë prej armiqve tanë nuk është i paarrtshëm për Zotin dhe lutja i mban ata në dorën e tij.

Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja.

2 Korintasve 5:17

LETRA EKSTREME – pjesa e tretë

RUSI: MARIA

Të dashur mami dhe babi!

Dje më 2 gusht isha në gjendje të bisedoja me Varinë në burg. Ajo ishte e dobët dhe e zbehtë, por sytë i shkëlqenin me paqen e Zotit dhe me një gëzim jo tokësor.

Më dhemb zemra kur mendoj për të, është vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç. Si besimtare ajo është akoma një foshnjë shpirtërore, por e do Zotin me gjithë zemër dhe vendosi të merrte menjëherë rrugën më të vështirë.

Ju lutem, lutuni për të! Ata ia kanë marrë të gjitha gjërat, përveç rrobave që ka veshur. Ne kemi mbledhur gjëra dhe kemi dërguar pako, por s'mendoj se i merr të gjitha ato që i dërgojmë.

Kur e pyeta Varinë nëse i vinte keq për atë që kishte bërë, ajo tha: «Jo, dhe sikur të më lironin, do bëja të njëjtën gjë. Nuk mendoj se po vuaj. Jam e gëzuar që Zoti më do kaq shumë dhe më jep gëzim për të duruar në emrin e tij».

E falënderoj Zotin që kemi paqen për ta kuptuar këtë. Nëse jemi në Krishtin, asnjë vuajtje, apo shqetësim nuk duhet të na ndalojë. Unë vetëm mund të lutem që besimi im të jetë po aq i fortë, nëse do të isha në vend të saj.

Ne besojmë që Varia do të dërgohet në një kamp pune në Siberi. Besoj se Zoti do t'i japë fuqinë që ka nevojë për të duruar.

E juaja Maria

*Kurse ata që shpresojnë në Zotin, përtëriten
në fuqi, marrin krahë porsì shqiponja,
vrapojnë e nuk lodhen kurrë, ecin edhe
kurrë nuk meken.*

Isaia 40: 31

Krishterimi nuk është një garë vrapimi njëqind metërshe. Ajo është një maratonë qëndrueshmërie. Shkrimet na mësojnë që ka kohë që ne ngrihemi si shqiponja dhe vrapojmë pa u lodhur. Megjithatë, ka gjithashtu kohë në jetën tonë kur rrugë të gjata e të vetmuara na shtrohen para. Në këto kohë, ne themi që po ia kalojmë mirë vetëm nëse ecim pa u rrëzuar derisa të marrim më shumë forcë. Ky është imazhi i atyre nën persekutim. Gjatë persekutimit, në thjeshtë jemi duke mësuar të hedhim hapin tjetër pa u dorëzuar. Thjeshtë qëndrueshmëria është një fitore e madhe që i jep lavdi Zotit. Nëse je duke kaluar një vështirësi që nuk e kupton, kapu fort dhe qëndro atje. Ju po forcohesh çdo ditë e më shumë – ndonjëherë pa e kuptuar. Shumë shpejt, do të ngrihesh përsëri.

LETRA EKSTREME – pjesa e katërt

RUSI: VARIA

E dashur Maria!

Më në fund jam në gjendje të të shkruaj. Ne arritëm shëndoshë e mirë në kampin e ri, i cili është rreth pesëdhjetë kilometra larg qytetit. S'mund ta përshkruaj jetën këtu, por falënderoj Zotin që jam disi e shëndetshme dhe kam fuqi për të punuar.

Më vendosën të punoja në një dyqan makinerish bashkë me një motër tjetër, e cila nuk ishte mirë me shëndet. Më duhet të bëj punën për të dyja, përndryshe do të dënohemi të dyja. Punojmë dymbëdhjetë deri në trembëdhjetë orë çdo ditë dhe ushqimi është i pakët, por nuk dua të ankohe.

Dua të them se e falënderoj Zotin që të përdori ty për të më çuar mua te Krishti. Për herë të parë, e ndiej që jeta ime ka një qëllim dhe e di se për kë po vuaj. Kam një dëshirë përvëluese për t'u treguar të gjithëve për gëzimin e madh të shpëtimit.

Në punë ata më mallkojnë dhe më dënojnë, sepse s'mund të rri në heshtje. E si të mundem? Për sa kohë që jam në gjendje të flas, do t'u dëshmoj të gjithëve për dashurinë e tij të madhe.

Ka shumë besimtarë këtu. Mbrëmë arritëm të dilnim fshehurazi për në lumë, ku shtatë vëllezër dhe unë u pagëzuam. Kurrë nuk do ta harroj këtë ditë të mrekullueshme! Të lutem, mos qaj për mua! Qëllimi im këtu është i qartë dhe besimi im qëndron i fortë.

Me dashuri
E jotja Varia!

Disa e quajnë fat, disa rrezik. Pavarësisht nga kjo, shumica e njerëzve kanë dëshirë të japin veten e tyre për një çështje të caktuar. Të krishterët e njohin atë si «thirrje» – qëllimi i Zotit për jetën e tyre. Kur ne plotësojmë qëllimin e Zotit për jetën tonë individuale, bëhemi pjesë e një pamjeje më të madhe. Jemi të kënaqur që çfarëdo që bëjmë dhe çfarëdo që të na ndodhë, na çon përpara ungjillin e Krishtit. Jemi të lidhur. Të dobishëm. Për herë të parë në jetën tonë, pavarësisht rrethanave, ndiejmë që po kontribuojmë për diçka që është përtej vetes sonë. Asgjë s'mund ta mposhtë dikë që tashmë e ka marrë këtë qëllim. Cili mendo se është qëllimi më i madh i jetës sate?

Tani, vëllezër, dua ta dini se gjërat që më kanë ndodhur ndihmuan më shumë për përhapjen e ungjillit.

Filipianëve 1:12

LETRA EKSTREME – pjesa e pestë

RUSI: VARIA

Shumë e dashur Maria!

Më në fund gjeta mundësinë për të të shkruar përsëri. Jam e lumtur që po të lajmëroj që ajo motra që ishte e sëmurë po ndihet më mirë. Tani na kanë çuar në një kamp tjetër.

Në letrën e fundit të thashë për pagëzimin tim, por s'kam pasur asnjëherë mundësi të kërkoj të falur për të gjitha herët që të kam keqtrajtuar para se të pranoja Krishtin. Është vetëm për shkak të qëndrimit tënd të hirshëm të faljes që unë jam e krishterë sot. Të lutem, pranoje ndjesën time.

Dua të të falënderoj gjithashtu për pakot që më dërgon. Faleminderit mbi të gjitha për Biblën! Që kur Zoti më zbuloi misterin e dashurisë së tij të shenjtë, e konsideroj veten njeriun më të gëzuar në botë. I konsideroj të gjitha vuajtjet që më janë dashur të kaloj si një hir i veçantë. Jam e gëzuar që Zoti më dha këtë mundësi të jashtëzakonshme për të vuajtur për të.

Të lutem, lutu që të mund të qëndroj besnike deri në fund. Zoti ju ruajtë dhe ju forcoftë për betejë. Mos u shqetësoni për ne! Jemi të kënaqur dhe plot gëzim, sepse shpërblimi ynë në qiell është i madh!

E jotja Varia

Për Varinë nuk u dëgjua më, por dashuria e saj dhe dëshmia për Krishtin nuk u harruan kurrë. Jeta e saj e re u shua nga autoritetet që e burgosën për besimin e saj. Megjithatë, kujtimi i saj ndriçon në zemrat e atyre që ia njohin historinë. Jeta e saj sjell të dhëna të pakundërshtueshme që kanë të bëjnë me nivelin e çuditshëm të miqësisë që vuajtja mund të përballojë. Vuajtja për Krishtin në fakt, mund të na afrojë pranë tij në mënyra që asnjë përvojë tjetër s'mundet. Bibla e quan atë bashkësia e vuajtjeve të Krishtit – një nivel ekskluziv i përvojës njerëzore. Të rritesh më afër Krishtit nëpërmjet vuajtjeve është diçka që kuptohet më mirë nga përvoja personale. Si e ke parë që vuajtja jote personale të të ketë sjellë më afër ecjes me Jezu Krishtin? Si ndodhi kjo?

Që të njoh atë dhe fuqinë e ringjalljes së tij dhe pjesëmarrjen në mundimet e tij.

Filipianëve 3:10

FKSTREM

Hapa ekstremë

SUDAN: PASTOR JEREMIA LOGARA

Jeremia Logara nuk e njohu kurrë dorëzimin, por vetëm vendosmërinë. Ushtarët myslimanë kishin arrestuar gjashtë djem nga kisha e tij duke i akuzuar pa të drejtë si spiunë. Kur Jeremia, pastori i tyre, u përpoq të shpjegonte se djemtë ishin të krishterë dhe jo spiunë, ushtarët vendosën ta arrestonin edhe atë.

Ushtarët islamikë i lidhën krahët dhe këmbët bashkë pastor Logarës dhe e varën 1, 2m në ajër me një litar. E goditën me kamxhik dhe i hodhën dyll të shkrirë të nxehtë mbi kraharor. Ai kujtoi lutjen e Jezusit në kopsht: «O Perëndi, nëse është vullneti yt për mua që të vdes sot, kështu u bëftë». Ai s'mund ta duronte që t'u dorëzohej torturave të arabëve të Sudanit verior ndërsa qëndronte para të rinjve të prekur.

Por vullneti i Zotit ishte që ai të jetonte si dëshmi për djemtë. U lirua, por djemtë u mbajtën. Pastor Logara mendon që ndoshta djemtë u detyruan të stërviteshin si ushtarë.

Kur pastori reflektoi mbi incidentin, kujtonte: «Unë mendoja për vdekjen e Jezusit, që vdiq që të shpëtonte tërë botën. Mendova se vdekja ime do të ishte pjesë e shpëtimit të këtyre djemve, ndërsa ecja në hapat e Zotit tim. Lutem që shembulli im i vuajtjes për ta t'i inkurajojë të mbeten besnikë ndaj Zotit».

Fëmijëve u pëlqen të ecin në hapat e prindërve të tyre. Në plazhet me rërë, ata përpiqen dhe zgjaten për të vendosur këmbët e tyre të vogla brenda gjurmës së mamit apo babit. Përherë besues, ata ndjekin rrugën kudo që t'i drejtojnë ajo. Në të njëjtën mënyrë, gjurmët e Jezusit mund të na çojnë përmes disa terreneve të vështira. Ne mund ta ndjekim atë përmes sprovave dhe shqetësimeve që kurrë nuk do t'i kishim zgjedhur për veten tonë. Megjithatë, nëse jemi të përkushtuar për të ndjekur Jezusin, jemi çliruar nga e drejta jonë për të zgjedhur fatin tonë. Ndjekja e Jezusit na siguron një shembull të qartë për fëmijët tanë dhe vëzhgues të tjerë për të na imituar. Rruga që ne ndjekim, ka rëndësi. Çfarë përshtypjeje po lë në mendjen e atyre rreth teje?

Ai që thotë se qëndron në të, duhet të ecë edhe vetë sikurse ka ecur ai.

1 Gjonit 2:6

**Zot, nuk të kërkoj të ma bësh jetën e lehtë;
të kërkoj të më bësh të fortë.**

NGA NJË FËMIJË ÇIFUT –
E GJETUR NË RRËNOJAT E NJË GETO-JE ÇIFUTE
NË POLONI PAS BOMBARDIMIT NGA NAZISTËT



FKSTREM

Vende ekstreme

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

Riçard Vurmbrand, një pastor rumun, i cili vuajti në burg për katërbëdhjetë vjet, një herë ka thënë një histori që e kishte dëgjuar nga një i burgosur tjetër. Ajo e kishte ndihmuar përmes kohëve më të vështira të torturave. Vëllai i tregoi atij:

«Një herë shkova në një cirk dhe isha dëshmitar i një skene mbresëlënëse. Një shigjetar vendosi një qiri të ndezur mbi kokën e së shoqes, pastaj u largua për në qendër të arenës dhe nga një largësi e madhe, qëlloi qiririn mbi kokën e saj.

Pasi mbaroi shfaqja, iu afrova asaj dhe e pyeta nëse kishte ndonjëherë frikë se shigjeta do mund ta godiste. Ajo u përgjigj: «Pse duhet të kem? Ai kishte si synim qiririn, jo mua».

Kur pastor Vurmbrandi dëgjoji këtë histori mendoi: «Pse duhet të kem frikë nga torturat? Ato nuk më kanë mua si shënjestër. Ata mund të më rrahin trupin, por qenia ime e vërtetë është Krishti brenda meje. Jam ulur me të në vendet qiellore dhe kështu ata s'mund ta prekin personin tim të vërtetë. Nga kjo pikëpamje e pabesueshme unë mund të shoh kotësinë e përpjekjeve të tyre».

Pastor Vurmbrandi jetoi përmes viteve të vuajtjeve dhe iu afrua vdekjes disa herë, por u inkurajua me këtë mësim të thjeshtë dhe madje lulëzoi shpirtërisht sepse e dinte që vendi i tij me Krishtin ishte i sigurt, çfarëdo t'i ndodhte trupit të tij.

Persekutimi, megjithëse jashtëzakonisht i dhimbshëm, ka kujitë e tij. As vuajtja fizike dhe as trauma emocionale s'mund ta shkatërrojë pjesën më të thellë të asaj që ne jemi. Ajo që mbajmë përbrenda është pjesa jonë më e vlefshme – shpirtat tanë. Shpirti i Krishtit jeton brenda nesh dhe mbron shpirtat tanë nga lëndimi fizik dhe emocional. E vërtetë, armiqtë tanë mund të na godasin dhe madje të vrasin trupin tonë. Megjithatë, kur armiqtë tanë na sulmojnë, ata në të vërtetë përgojnë emrin e Krishtit – atij që jeton brenda nesh. Dhe ai s'mund të vdesë përsëri. Megjithëse kundërshtimi është i ashpër dhe personal, ai është pjesë e tablos së plotë. Beteja mund të na përfshijë ne, por ai përfshin një luftë të ndërthurur midis së mirës dhe së keqes.

Lum ju kur do të të shajnë dhe do të të përndjekin dhe, duke gënjyer, do të thonë gjithë të zezat kundër jush, për shkakun tim.

Mateu 5:11

Krahë ekstremë

EKSTREM

RUSI: NJË GUNGË



«Unë kam kaluar shumë vite në gulaget (kampet e punës) sovjetike»– fillonte letra e shkruar me dorë. Teksti ishte i pastër, por shfaqte një dridhje të vogël të dorës – një kujtim i moshës së vjetër dhe viteve në burg.

«Në burg isha i detyruar të punoja nën tokë në një minierë. Puna ishte e vështirë dhe rojat tanë nuk kishin keqardhje apo mirësjellje njerëzore. Një ditë në minierë, ndodhi një aksident. Shpina ime u dëmtua dhe që nga ajo ditë kam mbetur gungaç.

«Një ditë, – thuhej në letër, – pashë një djalë, që nuk m'i hiqte sytë.

– Zotëri, – pyeti ai, – çfarë keni nga shpina?

Isha i sigurt që ndonjë shaka e hidhur do të thuhej për mua, por megjithatë thashë: – Një gungë.

Fëmija buzëqeshi ngrohtësisht. «Jo – tha ai, – Zoti është dashuri. Ai nuk i jep askujt deformime. Ajo që ke ti nuk është një gungë; është një kuti poshtë supeve të tua, fshehur aty brenda kutisë ndodhen krahë engjëjsh. Një ditë, kutia do të hapet dhe ti do të fluturosh në qiell me krahët e tua prej engjëlli.

Fillova të qaja nga gëzimi. Madje edhe tani, – përfundonte letra, – ndërsa po ju shkruaj, jam duke qarë».

Shumë të krishterë të persekutuar mbajnë shenjat e eksperiencës së tyre në trup. Ndonjëherë Zoti mund të na kujtojë, madje edhe nëpërmjet zërit të një fëmije të pafajshëm, për bekimet e fshehura nën këto shenja.

Ka vetëm një kujtues të tokës në qiell, Jezusi! Madje ai, edhe në trupin e tij të lavdishëm të ringjallur, akoma mban shenjat e persekutimit të tij. Jezusi ua tregoi shenjat e tij dishepujve shumë shpejt pas ringjalljes së tij. Thomai preku plagën në anë të tij dhe shenjat te duart. Një ditë, duart e tij me shenjat e gozhdëve do të na përqafojnë kur të hyjmë në parajsë. Ato do të shërbejnë si kujtuese të dashura të bekimeve të sjella nga vuajtjet e tij. Megjithatë, shenjat e jetëve tona të vështira, do të fshihen në trupat tanë të rinj qiellorë. Ata që kanë duruar vuajtje, fyerje dhe padrejtësi për hir të tij do të shkëmbejnë shenjat e tyre një nga një me bekimet e pasura të Zotit.

*Kështu edhe ringjallja e të vdekurve:
mbillet në prishje e ringjallet në
paprishje;*

1 Korintasve 15:42

FKSTREM

Kthim ekstrem

KINË: PASTOR UANG MIN-TAO

«Nuk do ta lejoj këtë», – u tha pastori kinez Uang Min-tao ushtarëve japonezë. «Unë nuk do ta var atë fotografi të perandorit në kishën time.»

Disa vite më vonë komunistët kërkuan që pastori Uang të varte një fotografi të drejtuesit të tyre, udhëheqësit Mao, në kishën e tij.

»Unë nuk kam as një pikturë të vetë Jezusit në kishën time!« – tha pastori. «Unë refuzova të var një pikturë të perandorit japonez dhe refuzoj të var një të Maos.»

Uang u arrestua në vitin 1955 dhe për dy vjet iu nënshtrua torturave të ashpra dhe indoktrinimit. Kur, për shkak të torturave pothuajse u çmend, më në fund firmosi një «rrëfim» duke renditur të gjitha «krimet» e tij kundër Republikës Popullore. Me anë të rrëfimit, pastor Uangu siguroi lirimin e tij nga burgu.

Por jashtë burgut nuk pati paqe. I thoshte vetes: «Jam çifut. Jam si Pjetri kur mohoi Krishtin». Më në fund u kthye në policinë kineze.

«Unë heq dorë nga rrëfimi im», – u tha atyre. »Bëni çfarë të doni me mua».

Rojat nuk u kënaqën thjesht me burgosjen përsëri të Uangut. Ata futën brenda edhe gruan e tij. Në një letër nga burgu shkruante: «Mos u shqetësoni për mua; jam më i vlefshëm se shumë harabela».

Uang Min-tao vdiq në burg, fajtor vetëm se donte Shpëtimtarin e tij.

Kush nuk do të donte të ishte i guximshëm si Pjetri, duke goditur impulsivisht ata që erdhën për të arrestuar Jezun Krishtin? Por, kush nuk është po aq i dobët sa Pjetri, që mohoi Krishtin pothuajse në të njëjtin moment nën kërcënimin e kundërshtimit? Zoti nuk na qorton sepse jemi njerëzorë. Ai pranon dobësitë tona dhe punon me ne derisa të jemi përsëri të fortë. Ashtu si Zoti ripërtëriu Pjetrin dhe besimtarë të tjerë si Uang Min-tao në një pozitë besimi, ai mund të ripërtërijë përsëri edhe kurajën tonë të patundur. A ke vuajtur nga një kujtim i një mundësie të humbur për të përkrahur Krishtin? Kërkoji Zotit të të ripërtërijë sot. Ai do të fillojë të të përgatisë, madje edhe tani për një mundësi tjetër për të qëndruar i fortë.

Grisni zemrën tuaj dhe jo rrobat tuaja dhe kthehuni te Zoti, Perëndia juaj, sepse ai është i mëshirshëm dhe plot dashuri...

Joeli 2:13

Qëndrim ekstrem

RUMANI: FLOREA

«Zoti ynë na urdhëroi të kujtojmë të shtunën dhe ta mbajmë të shenjtë», – u tha Florea rojave në burg. «S'mund të punoj në këtë ditë.»

Të burgosurit rumunë detyroheshin të punonin çdo ditë, por çdo të shtunë Florea refuzonte. Për shkak të refuzimit të tij, rojat vazhdimisht e rrihnin aq keq, sa s'mund t'i përdorte më krahët dhe këmbët. Ai mund të lëvizte vetëm kokën.

Për shkak se nuk mund të punonte më, Florea u detyrua të qëndronte në qelinë e tij gjatë gjithë ditës. Atij i duhej të mbështetej tek të burgosurit e tjerë për t'u ushqyer. Pavarësisht nga situata, nuk i lëshoi zemra.

Kur të burgosurit e tjerë ankoheshin për situatën e tyre, Florea do t'i inkurajonte: «Nëse pamja përpara jush duket e keqe, provoni e ngrini sytë lart. Kur Shtjefni u qëllua me gurë, ai ngriti sytë lart dhe pa Jezusin duke qëndruar në anë të djathtë të Perëndisë. Kjo e ngushëlloi zemrën e Shtjefnit dhe do të ngushëllojë edhe tuajën gjithashtu.» Ai inkurajonte të burgosurit e tjerë të mos «shihnin përpara» te rrethanat e tyre, por të «ngrinin sytë lart» te Jezusi.

Një nga të burgosurit e tjerë ishte edhe Riçard Vurmbrand, i cili, pasi u lirua nga burgu shkoi dhe takoi djalin nëntëvjeçar të Floreas. Ai i tregoi se çfarë bekimi kishte qenë ati i tij në burg.

Djali buzëqeshi dhe u përgjigj: «Unë dua të bëhem një vuajtës dhe inkurajues për Krishtin siç ka qenë babai im».

Një i krishterë nuk është i privilegjuar me një lloj të caktuar rrethanash. Shtëpi të këndshme, familje të përsosur, shëndet të mirë. Jo, një i krishterë është një person me një qëndrim të caktuar ndaj çdo, apo të gjitha rrethanave. Qëndrimi i një personi sjell ndryshim, pavarësisht nga rrethanat. Një qëndrim qiellor përqendrohet mbi praninë e Perëndisë në mes të sprovave. Fokusimi mbi vështirësitë tona na shpërqendron nga pamja qiellore. Ne ndihemi të rënduar, të trishtuar, të pashpresë. Në kundërshtim me këtë, një perspektivë e përshpirtshme mbi problemet tona sjell siguri që Zoti është në punë. Ne gjejmë paqe në praninë e Zotit duke pritur të shohim se si do të veprojë ai me shqetësimet tona. A je duke kaluar një provë tani? Ku je i fokusuar? Kërkoji Zotit të ridrejtojë energjitë e tua, kështu që të mund të shohësh përtej problemeve dhe të ndiesh pranë pranisë së tij.

*Kini po atë qëndrim që ishte në Krishtin
Jezus.*

Filipianëve 2:5

FKSTREM

Vargonj ekstremë

KUBA: NJË I BURGOSUR I KRISHTERË

«Firmos deklaratën!» – thirri oficeri kuban, duke vendosur me forcë një stilolaps në dorën e të burgosurit. «Firmos deklaratën!»

Deklarata e shkruar përpara të burgosurit përmbante akuza për të krishterë të tjerë. Vetëm firma e tij i duhej qeverisë për të burgosur të tjerët.

«S'mund ta firmos këtë letër.» – tha i krishteri qetësisht duke vështruar oficerin në sy.

«Pse jo?» – pyeti kapiteni me qetësi të tepruar para se t'i betohej atij. «Nuk di as të shkruash emrin tënd?»

«Është për shkak të prangave, miku im. Vargoi më pengon që të mos e firmos këtë.»

Duke kapur me forcë duart e të burgosurit, oficeri ia tregoi para syve. «Por ti s'je në pranga, more idiot!», – tha ai.

«Oh, por jam», – tha besimtari i krishterë. «Jam i lidhur me vargonjtë e dëshmitarëve që gjatë gjithë shekujve kanë dhënë jetën e tyre për Krishtin. Unë jam vetëm një hallkë tjetër në këtë vargua dhe nuk do ta këpus atë.»

Megjithëse u kërcënua dhe u keqtrajtua, i burgosuri refuzoi të firmoste.

Martirët e krishterë kanë lënë pas një dëshmi të pasur të një qëndrimi të pabesueshëm në mes të rrethanave të tmerrshme. Fuqia e tyre është heroike, fjalët e tyre janë të urta dhe qetësia e tyre është e patundur. Toma Akuin shkroi: «Fjalët e thëna nga martirët përpara autoriteteve nuk janë fjalë njerëzore, shprehje e thjeshtë e bindjes njerëzore, por fjalë të thëna nga Fryma e Shenjtë nëpërmjet rrëfyesve të Jezusit». Jetë pas jete, hallkë pas hallke, fjalët e folura me fuqinë e Frymës së Shenjtë në mes të shtypjes po formojnë një dëshmi të fuqishme. Ti gjithashtu ke potencialin për t'u shtuar kapitullin tënd faqeve dhe je një hallkë në zinxhirin e besimtarëve. A do ta mbash edhe ti të bashkuar?

Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, duke hedhur tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon vazhdimisht duke na joshur, le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh.

Hebrenjve 12:1

Shkollë ekstreme

EKSTREM

LITUANI: NIJOLE SADUNAITE



Gjendja ishte e rëndë, pothuajse e ashpër. Gjyqi lituanез po mblidhej për të përcaktuar dënimin për Nijole Sadunaiten. «Krimi» i saj, si i shumë të tjerëve, ishte thjesht të qenit i krishterë në një vend komunist.

Pastaj gjykatësi i ofroi asaj një mundësi të fundit për të folur. Ai priste me padurim që gruaja e re t'i kërkonte mëshirë me lot në sy. Ndoshta ajo do të hiqte dorë nga besimi i saj qesharak në Zotin, por atë e priste një surprizë.

Nuk kishte lot nga Nijole. Fytyra i shkëlqente dhe një buzëqeshje e bukur filloi t'i formohej. Sytë e saj kishin ngrohtësi, madje edhe për akuzuesit e saj.

«Kjo është dita më e lumtur e jetës sime», – tha gruaja e dënuar. «Unë jam e akuzuar për kauzën e së vërtetës dhe dashurisë ndaj njerëzve.»

Tani, të gjithë sytë në sallën e gjyqit ishin mbi të. «Unë kam fat të lakmueshëm, fat të lavdishëm. Dënimi im këtu në këtë sallë gjyqi do të jetë triumfi im përfundimtar.»

Zjarri në zërin e saj ishte i pagabueshëm. «Më vjen keq vetëm se kam bërë shumë pak për njerëzit. Le ta duam njëri-tjetrin dhe do të jemi të gjithë të gëzuar. Vetëm ai që nuk ka dashuri do jetë i trishtuar.»

Ajo e largoi vëmendjen e saj nga gjykatësi dhe vështrroi në sytë e besimtarëve të tjerë, të cilët po ndiqnin gjyqin. «Ne duhet të dënojmë të keqen, por duhet të duam njeriun, madje edhe dikë në gabim. Këtë ju mund ta mësoni vetëm në shkollën e Jezu Krishtit.»

Kur është puna për të mësuar për ata që janë persekutuar për hir të Krishtit, mbani shënime. Mësimi është me pjesë. Që nga siguria relative e shtëpive dhe komuniteteve tona, ne mund të lexojmë historitë e martirëve, madje mund të rrëqethemi ndërsa kthejmë faqet. Megjithatë, a jemi gati të regjistrohemi në shkollën e Jezu Krishtit? A jemi gati të studiojmë krahe për krahe me ata që kanë ecur në rrugën e vetmuar të shtypjes? Ne duhet të praktikojmë çfarë mësojmë prej tyre për besimin, dashurinë, shenjtërinë dhe qëndrueshmërinë. Vetëm kur identifikohemi me vuajtjet e Krishtit përmes përvojave të të tjerëve, mund ta quajmë me të vërtetë veten të «krishterë», që do të thotë «krishterë të vegjël». Vetëm atëherë do të jemi gati ta kalojmë testin.

*Merreni mbi vete zgjedhën time
dhe mësoni nga unë*

Mateu 11:29

**Vuajtja mund të parandalojë mëkatin,
por mëkati asnjëherë nuk mund ta pengojë
vuajtjen.**

NJË KOMENT I SHKRUAR, I GJETUR NË BOTIMIN E 1800-të TË LIBRIT
TË MARTIRËVE NGA FOKSI



DEKLARTË EKSTREME

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

«Ju po gënjeni!» – i ulëriti toger Greku pastorit të burgosur, Riçard Vurmbrand. – «Na trego të vërtetën për aktivitetet e krishtera dhe për të tjerët në kishën tënde! Këtu duhet të më shkruash të gjitha rregullat që ke thyer në burg.»

Vurmbrandi u ul dhe me qetësi shkroi të gjitha rregullat e burgut që kishte thyer. Kur përfundoi, ai shtoi një paragraf të fundit: «Nuk kam folur asnjëherë kundër komunistëve. Jam një dishepull i Krishtit, i cili na ka dhënë dashuri për armiqtë tanë. Unë i kuptoj dhe lutem për kthimin e tyre në besim, që të mund të bëhen vëllezërit e mi në besim». Ai firmosi emrin e tij me shkronja të mëdha në fund.

Greku lexoi «deklaratën». Fytyra e tij u zbut ndërsa arriti në fund, i prekur që Vurmbrandi mund të shkruante se e donte qeverinë që e kishte arrestuar dhe e kishte torturuar. «Kjo dashuri,» – tha ai, – «është një nga urdhërimet tuaja të krishtera që asnjë s'mund ta mbajë.»

«Nuk është një çështje e mbajtjes së urdhërimeve», – u përgjigj Riçardi me butësi. – Kur unë u bëra i krishterë ishte si të isha rilindur, me një karakter të ri plot dashuri. Ashtu si vetëm ujë mund të rrjedhë nga një burim, ashtu edhe vetëm dashuri mund të vijë nga një zemër që do.»

Në muajt që pasuan, Vurmbrandi i foli toger Grekut edhe shumë herë të tjera për dashurinë e Krishtit dhe më në fund ai u lut për të pranuar Krishtin!

Të shpallësh besimin tënd në Krishtin do të thotë ta thuash atë me zë aq të lartë, sa të tjerët të mund ta dëgjojnë dhe ta pranojnë. Kjo nuk do të thotë që të jesh i paftytyrë dhe as që duhet të jesh jashtëzakonisht i hapur. Kjo do të thotë thjesht që ti je një libër i hapur që të tjerët të lexojnë rreth Jezu Krishtit dhe je gati ta lexosh me zë të lartë kur është e nevojshme. Ne shpesh hezitojmë në dëshminë tonë për Krishtin, nuk duam të fyejmë dhe as të pritemi keq. Dhe përsëri dëshmia jonë e heshtur e humbet mundësinë për të drejtuar dikë në besim te Krishti. Çfarë do të thoshte për ty të shpallësh besimin tënd në Krishtin sot? Kuft do t'i tregojë për mesazhin e hirit të Zotit?

Dhe tani, o Zot, shqyrto kërcënimet e tyre dhe lejo që shërbëtorët e tu të kumtojnë fjalën tënde me plot çiltërsi.

Veprat 4:29

FKSTREM

Ribashkim ekstrem

SPANJË: ANTONIO HERREZUELO

Megjithëse do të digjej në turrën e druve me urdhrin e autoriteteve spanjolle, Antonio Herrezuelos ndjente dhimbje në shpirtin e tij. Ai e kuptoi që gruaja e tij kishte mohuar besimin në Krishtin për t'i shpëtuar një vdekjeje të tillë.

Antonio mund ta kishte shpëtuar jetën e vet dhe të jetonte në burg si gruaja e tij. Ndoshta ndonjë ditë do të falej dhe do të bashkohej me të shoqen.

Por ai nuk do ta mohonte. Fjalët e fundit që pëshpëriti para se ushtarët t'i mbulonin sytë me kapuç, ishin përgjërime për të shoqen. «Të lutem, kthehu te Krishti dhe ji e falur. Ne do të bashkohemi së bashku në qiell. Të lutem, kthehu!» – i thirri ai së shoqes. Megjithëse nuk kishte një shpresë tokësore për ribashkim, ai donte të ishte me të në përjetësi.

Pas vdekjes së bashkëshortit të saj, zonja Herrezuelo u kthye në burg për të kryer dënimin me burgim të përjetshëm. Për tetë vjet ajo luftoi me Zotin dhe me shpirtin e saj. S'mundi të gjente paqe për vendimin e saj përfundimtar.

Më në fund, publikisht u kthye në besim te Krishti, duke tërhequr mohimin e saj të mëparshëm, madje edhe kur inkuizitorët e shekullit të gjashtëmbëdhjetë e kërcënuan. Një gjykatës e dënoi me vdekje në turrën e druve – tani për herë të dytë dhe të fundit.

Ajo mezi priste të vdiste dhe të ribashkohej me bashkëshortin e saj. Zonja Herrezuelo, megjithëse duke vdekur, ishte përsëri në paqe. Fjalët e saj të para do të ishin për t'i thënë atij për kthimin e saj në besim.

Çfarë ribashkimi i mrekullueshëm do të jetë qielli! Të gjithë ata që kanë vuajtur dhe kanë vdekur për besimin e tyre në Krishtin do të shkëlqejnë si zjarr i hirit dhe mëshirës së tij. Familjet që u ndanë për shkak të regjimeve të këqija do të mblidhen së bashku edhe një herë. Bashkëshorte dhe bashkëshortë, nëna dhe bija, miq dhe të afërm nga të gjitha vendet që u arrestuan dhe u internuan do ta shohin njëri-tjetrin përsëri. Anëtarët e kishave të fshehta dhe bashkësi nga vende të persekutuar do të jenë atje në radhë me rrëfimet e tyre për shpëtimet me anë të engjëjve. Vetëm për tregimet na duhet një përjetësi e tërë për t'i rrëfyer – dëshmi nga brezat e martirëve për besnikërinë e Zotit. A do të jesh atje në qiell për të dëgjuar? Më mirë akoma, a do të kesh historinë tënde për të treguar?

Pas këtyre gjërave, pashë një turmë të madhe, të cilën askush nuk mund ta numëronte, prej të gjitha kombeve, fiseve, popujve dhe gjuhëve; këta qëndronin në këmbë përpara fronit dhe përpara Qengjit.

Zbulesa 7:9

«Para se ta përfundojmë këtë shërbesë funerali» – këmbuan qartë fjalët e saj drejtuar një mijë njerëzve në pritje, – «dua t’ju tregoj çfarë më tha bashkëshorti im para se të vdiste. Ai më kërkoi t’u them të gjithë vrasësve të tij se ai shkon në parajsë duke i dashur të gjithë me gjithë zemër, përfshirë dhe vrasësit e tij. I ka falur të gjithë për çfarë i kanë bërë, sepse Jezusi i do dhe gjithashtu do t’i falë.»

Ajo qëndroi mbi arkivolin e të shoqit. Kishte lot në sy, por zëri ishte i fortë. Të mavijosurat në trupin e saj tregonin që edhe atë e kishin rrahur.

Si të krishterë, ajo dhe bashkëshorti i saj kishin refuzuar të bënin betimin e fisit Kikuju që ishte i papajtuëshëm me besimin e krishterë. Për këtë bashkëshorti i saj ishte rrahur për vdekje, ndërsa ajo ishte rrahur dhe ishte shtruar në spital.

Turma ishte akoma në qetësi nga fuqia e fjalëve të vejushës dhe vullnetit të saj. Shumë persona që jetonin në Kenia në vitin 1969 janë përballur me vështirësi dhe sulme, sepse vlerësonin besimin e tyre mbi besnikëritë e fisit.


«Unë, si vejushë, ju them gjithashtu edhe ju të gjithëve, në praninë e bashkëshortit tim të vdekur, që nuk urrej asnjë prej atyre që e vranë. I dua vrasësit. I fal ata duke ditur që Krishti ka vdekur edhe për ata.»

Asnjë i pranishëm atë ditë s’mund të harrojë kurrë fjalët apo shembullin e saj për falje dhe hir ekstrem.

Falja është një shembull ekstrem se çfarë do të thotë të jesh si Krishti, t’ua shpalosësh hirin e tij të tjerëve. Askujt nuk i është dashur të falë më shumë se Jezu Krishtit. Asgjë s’mund ta krahasojë peshën e mëkateve të të gjithë botës në supet e tij në Golgotë. Kështu që kur ne falim ata që na urrejnë nuk do të jemi kurrë më shumë si Jezusi sesa në atë moment. Falja nuk e kthen të keqen që të është bërë ty në të mirë. Falja të bën ty të jesh mirë. Falja nuk do të thotë t’i lësh keqbërësit jashtë grepit. Falja do të thotë të lësh veten jashtë grepit dhe të çlirohesh nga tirania e mendimeve hakmarrëse. Të falësh të tjerët për gabimet e tyre të jep një mundësi për të ndriçuar për Krishtin si kurrë më parë. Ku do ta ndriçosh dritën e faljes sot?

*Duroni njëri-tjetrin dhe faleni në
qoftë se ndokush ka ndonjë ankim
kundër tjetrit. Sikurse Zoti ju fali ju,
po ashtu bëni edhe ju!*

Kolosianëve 3:13



Barto ishte në prag të vdekjes nga uria. Një herë e një kohë zyrtar i Partisë Komuniste dhe prokuror i palës akuzuese, ai tani ishte i konsideruar i pavlerë nga partia e tij. U dënua me punë në një kamp burgu. Stomaku i tij dikur plot, tani po ligështoj. Ai pyeste veten se sa mund të vazhdonte.

Duke parë trupin e tij të dobët, një i burgosur tjetër erdhi tek ai dhe ofroi të ndante racionin e tij të ushqimit. «Faleminderit, miku im, – i tha ai të burgosurit tjetër. »Sa kohë duhet të qëndrosh këtu?» – e pyeti Barto ndërsa kapërdinte ushqimin.

«Njëzet vjet» – iu përgjigj i burgosuri. Sytë e tij dukeshin që po e pyesnin Barton.

«Çfarë krimi ke kryer?»

«Unë u gjykova dhe u dënova sepse i dhashë ushqim një pastori të arratisur, të cilin po e ndiqte policia», – tha burri me qetësi. Barto vuri re se zëri i tij nuk kishte hidhërim siç kishte dëgjuar nga shumë të tjerë.

«Kush të dha një dënim kaq të ashpër, sepse bëre një vepër të mirë?» – pyeti Barto.

I burgosuri u përgjigj me përlulësi: «Zotëri, ju ishit prokurori i shtetit në gjyqin tim. Ju s'më njihni tani, por unë ju mbaj mend».

Burri vazhdoi. «Unë jam i krishterë. Krishti na mësoi ta kthejmë të keqen me të mirë. Unë doja që atëherë ta kuptonit se ishte e drejtë dhe e mirë t'i jepje ushqim një njeriu të uritur – madje edhe armikut tuaj. Tani mund ta tregoj». Barto filloi që atë ditë të kuptonte se nevojat e tij shpirtërore ua kalonin atyre fizike.

Mirësia është rruga për në zemrat e armiqve tanë dhe ajo mund të bëjë diçka për shpirtrat e tyre. Zoti përdor mirësinë si strategjinë e tij të zgjedhjes kur merret me ne. Në vend që të na japë atë që meritojmë për fyerjet tona ndaj tij, ai merret me ne me mirësi. Mirësia e tij është një shembull se si duhet të veprojmë me ata që na fyjnë. Mirësia tërheq vëmendjen e tyre. Siç është e papritur, ashtu është dhe e pamerituar. Si Barto, mirësia jonë ndaj një armiku, mund të na zgjojë një etje shpirtërore për burimin e zjarrit tonë. Megjithatë, pavarësisht nga përgjigjja e tyre, ne duhet të ndjekim shembullin e Zotit tonë kur merremi me armiq të tanë. Kush ka nevojë për mirësinë tënde sot?

Apo i përçmon pasuritë e mirësisë së tij, të durimit dhe të zemërgjerësisë së tij, duke mos njohur që zemërgjerësia e Perëndisë të prin në pendim?

Romakëve 2:4

FKSTREM

Fëmijë ekstrem

RUSI: PRINDËR TË BURGOSUR

Në vendet e izoluar, fëmijët e krishterë shpesh vuajnë bashkë me prindërit e tyre. Kur baballarët dhe nënat arrestohen për shkak të aktiviteteve të kishës, fëmijët lihen shpesh jetimë. Nëse janë me fat, pjesëtarë të familjes apo miq mund të kujdesen për ta. Megjithatë, më e keqja, ata çohen në jetimore, apo në institucione të drejtuara nga shteti. Nuk ka më histori nga Bibla para se të flenë dhe nuk ka më lutje në familje para vakteve.

Megjithatë, letrat nga fëmijët drejtuar prindërve të tyre të burgosur shfaqin kurajë të jashtëzakonshme dhe qëndrueshmëri gjatë kohëve të vështira të ndarjes. Fjalët e tyre shfaqin shpresën e ribashkimit.

«Zoti të bekoftë, e dashur mami! Mos u shqetëso për ndarjen tonë të përkohshme – nuk do të zgjasë përgjithmonë. Gëzimi do të na kthehet së shpejti – le të jetë ky mendim që të të inkurajojë. Mami, s'mund ta imagjinoj festën që do të bëjmë kur të kthehesh. Unë kam vazhduar me detyrat e shkollës. Tani është natë – nesër do të jetë një ditë tjetër. Ditët ia lënë vendin njëra-tjetrës, por unë e di që do të jemi bashkë shumë shpejt. Të përqafoj. Vajza jote e dashur.»

«E dashur mami, kur të vish në shtëpi, nuk do të mendoj më për dhimbjen dhe vetminë. Të lutem të mos qash, mami. Të dua shumë. Kam shkruar një poemë të vogël për ty:

Ti e ke zemrën flori
Njësoj po aq të bukur
Zoti të sheh prej së larti,
dhe bashkë do na bëjë,
për të mos u ndarë më kurrë!

Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të.

Marku 10:15

Fëmijët janë shpesh të fundit që konsiderohen, përsa u përket pasojave të persekutimit. Për çdo prind të burgosur, është një fëmijë që është lënë pas. Megjithatë, ashtu si Jezusi e ka theksuar në shumë raste, besimi i fëmijës ka rëndësi. Nëse një fëmijë mund të tregojë kurajë të pabesueshme në mes të rrethanave të vështira, atëherë çfarë justifikimi kemi ne? Në vend që të zemërohen për shkak të rrethanave që janë përtej kontrollit të tyre, fëmijët e të krishterëve të persekutuar po rriten në hir. A mund të themi të njëjtën gjë për jetën tonë? Si të rritur ne rrezikojmë të fokusohemi shumë te goditjet dhe të rrahurat që sjell jeta. Ne mund të përfitonim nga formimi i besimit të qëndrueshëm të fëmijëve. Në çfarë mënyrash keni nevojë të rriteni në besimin si e të një fëmije? Filloni që sot duke kujtuar fëmijët.

Protestë ekstreme

RUSI: TË KRISHTERËT BAPTISTE

Ishte një protestë që bota s'e kishte parë kurrë më parë. Shumica e protestave rreth e qark botës janë të dhunshme, me parulla që thirren me zë të lartë, me shenja dhe flamuj që valëviten, madje edhe gurë që hidhen. Por më 16 maj të vitit 1966, pesëqind baptistë sovjetikë u mbledhën në oborrin e Komitetit Qendror Komunist. Megjithatë, ndryshe nga pjesa më e madhe e protestuesve, ata nuk thërrisnin slogane apo kërkesa.

Ata qëndruan së bashku duke u lutur dhe duke kënduar himne. Georgi Vins dhe Genadi Kryçkov i paraqitën një petition qeverisë sovjetike në emër të tyre, duke i kërkuar njohje zyrtare kishës së tyre, një kërkesë për të ndaluar ndërhyrjet e shtetit, lirimin e të burgosurve besimtarë dhe lirinë për qytetarët sovjetikë që të mësonin dhe t'u mësohej besimi fetar.

Mëngjesin tjetër, ushtarët dhe agjentët e KGB-së rrethuan grumbullimin paqësor. Rreth orës 13:00, një numër autobusësh erdhën dhe ushtarët sulmuan duke i rrahur dhe duke i futur me forcë në autobusë. Asnjë nuk luftoi. Përkundrazi, demonstruesit kapën duart dhe filluan të këndonin përsëri në publik me shumë spektatorë të mbledhur për të parë besimin e palëkundur të të krishterëve. Më vonë ata u çuan në burg.

Madje edhe në burg vazhduan të luteshin dhe të këndonin. Komunistët refuzuan kërkesat e këtyre protestuesve paqësorë, por nuk thyen shpirtrat e tyre.

Njerëzit që e kthejnë krishterimin në një polemikë rrezikojnë të ngatërrojnë dhunën për bindje. Megjithatë, asgjë s'mund të ishte më larg nga përshkrimi i vërtetë. Bindje radikale do të thotë që të protestojmë çfarëdo që është në kundërshtim me mësimet e Krishtit. Megjithatë, si baptistët sovjetikë, ne synojmë paqen dhe jo të provokojmë lëndim. Ata që persekutohen për besimin e tyre lënë një shembull demonstrimi dhe vendosmërie paqësore. Ata nuk e kthejnë të keqen me të keqe, por me qetësi pranojnë pasojat e bindjes së tyre ndaj urdhërimeve të Krishtit. Nëse do të jesh një i krishterë radikal, duhet t'u bindesh plotësisht urdhërimeve të Krishtit. Në çfarë sferë të jetës sate po të thërret Zoti në bindje radikale për të? Çfarë do të thotë për ty të jesh i krishterë radikal?

Në çdo gjë jì shembull me vepra të mira:
... që kundërshtari, duke mos pasur çfarë
të flasë keq për ne, të turpërohet.

Titit 2:7-8

**Shkaku i vuajtjes dhe jo vetë vuajtja të bën
një martir të vërtetë.**

SHËN AUGUSTINI



FKSTREM

Vegla ekstreme

NJË BURG KOMUNIST: NJË I KRISHTERË

«Pse ndodh që të krishterët këndojnë vetëm një herë në javë? Pse vetëm një herë? Nëse është e drejtë të këndosh, këndo çdo ditë. Nëse është gabim të këndosh, mos këndo të dielën.»

Pastori kishte kaluar disa vite të tmerrshme në burg në duart e autoriteteve komuniste. Ai u burgos për besimin e tij në Krishtin dhe megjithëse i mbante mend torturat, nuk u fokusua shumë në to. Përkundrazi, foli për kohët e gëzimit në praninë e Zotit të tij. Ai dhe të burgosurit e tjerë të krishterë formuan një komunitet lavdërimi – në qendër të burgut.

«Kur ishim në burg këndonim pothuajse çdo ditë, sepse Krishti ishte i gjallë në ne. Komunistët ishin shumë të mirë me ne. Ata e dinin se na pëlqente të adhuronim Zotin në burg me vegla muzikorë, kështu që i dhanë çdo të krishteri nga një vegël muzikore. Megjithatë, nuk na dhanë violina apo mandolina – këto ishin shumë të shtrenjta. Në vend të tyre, na vunë pranga në duar dhe këmbë, na prangosën për të shtuar vuajtjen tonë. Por ne zbuluam që prangat ishin vegla të shkëlqyera muzikore. Kur i vringëllinim së bashku me ritëm, mund të këndonim. «Kjo është dita (klik, klak), kjo është dita (klik, klak), që Zoti krijoi (klik, klak), që Zoti krijoi (klik, klak).» Ç'zhurmë e gëzueshme për Zotin!

Për ata që s'e kanë përjetuar akoma, persekutimi duket sikur fokusohet plotësisht mbi humbjen. Humbja e lirisë, humbja e shpresës. Madje edhe humbja e jetës. Megjithatë, ata që kanë vuajtur për besimin e tyre në Krishtin nuk shikojnë se çfarë mungon dhe fokusohen mbi zbulime të reja. Ata kënaqen me atë pak liri që kanë në vend që t'u vijë keq për atë që i mungon. Në këtë histori, zaptuesit e besimtarëve u zhoatën atyre pjesën më të madhe të lirisë dhe dinjitetit të jetës. Megjithatë, besimtarët e patundur fokusoheshin tek ajo që mbetej – gëzimi i tyre në Zotin. Nëse është mirë t'i këndosh Zotit kur ke gjithçka – është mirë t'i këndosh atij edhe kur i ke humbur të gjitha. Çfarë do të bësh sot për t'u siguruar që s'do ta humbasësh gëzimin e krishterë?

*Ejani t'i këndojmë Zotit,
t'i brohorisim Perëndisë,
Shpëtimtarit tonë.*

Psalmi 95:1

Shembull ekstrem

KOLUMBI: ÇET BITERMAN

Guerilasit e mbuluar me kapuç dhe të armatosur, anëtarë të një grupi marksistësh revolucionarë të njohur si M – 19, lidhën dymbëdhjetë të rritur dhe pesë fëmijë që ishin të pranishëm në Qendrën e Përgjithshme të Përkthyesve të Biblës, Uiklif, në Bogota të Kolumbisë. «Ku është drejtori juaj? Ku është Al Uiler?» – i bërtiti në fytyrë drejtuesi njëres prej sekretareve. «Ne duam Uilerin!»

«Mos e lëndoni atë!» – Erdhi një përgjigje e shpejtë. «Uileri nuk është këtu».

Marksisti u kthye me të shpejtë për ta goditur, pastaj u mendua: «Në rregull, do të të marrim ty në vend të tij. Le të shkojmë!»

Kërkesat e tyre erdhën disa ditë më vonë. «Nëse organizata juaj nuk largohet nga Kolumbia deri në 19 shkurt, do të ekzekutojmë të burgosurin tonë.» Guerilasit morën në telefon madje edhe presidentin Regan dhe kërkuan që manifestet e tyre të botoheshin në «New York Times» dhe në «Uashington Post», përndryshe zoti Çet Biterman do të vdiste.

Ndërsa data afrohej, u formuan zinxhirë lutjeje. Një kasetë mbërriti në stacionin lokal të radios, i cili vërtetonte që Çeti kishte qenë duke u dëshmuar guerilasve. Gruaja e tij, Brenda, mori një letër në të cilën i kërkohej një Bibël në spanjisht.

Çeti e arriti qëllimin në jetë – për të transmetuar ungjillin kudo që të ishte nevoja. Trupi i Çetit u la në fakt në një autobus të braktisur. Kolumbianët së bashku me të krishterë në të gjithë Amerikën, përkujtuan vdekjen e tij duke bërë një hap përpara për

të mbushur boshllëkun e lënë nga Çeti. Vitin që pasoi, aplikimet për të shërbyer me Përkthyesit e Biblës Uiklif, u dyfishuan.

Të udhëhiqesh nga një shembull është një parim i njohur stërvitjeje. Prioritetet e një kompanie duhet të modelohen nga niveli më i lartë i personelit. Kur vjen puna te krishterimi, udhëheqja nga një shembull është po aq e rëndësishme. Në fakt, Jezusi e urdhëroi këtë. Ai demonstroi se si drejtuesit e krishterë duhet të modelojnë besimin e tyre në mënyrë që besimtarët ta ndjekin. Ai jo vetëm që dha mësim, por i zbatoi ato në jetë. Sa prej nesh janë të gatshëm të jetojnë një standard radikal bindjeje ndaj Krishtit? Nëse jemi të tillë, nuk do ta kontrollojmë destinacionin tonë, por do jemi një shembull për të tjerët, ndërsa ndjekim shembullin e Krishtit. Kush është duke vëzhguar jetën tënde sot? Çfarë po mësojnë ata prej shembullit tënd se sa afër e ndiq Krishtin?

*Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues
i Krishtit*

1 Korintasve 11:1

FKSTREM

Përgatitje ekstreme

SUDAN: FËMIJËT SUDANEZË

Gropat për mbrojtje në një oborr shkollë – ato janë shumë të zakonshme në Sudanin jugor. Në mes të një zone loje të rrethuar nga fëmijët që luajnë dhe qeshin, ngrihet një cilindër i madh metalik me fletë metalike në fund të gropës për propozim të përgjysmë në tokë. Një flamur bie në sy nga bomba e paplasur si kujtesë për fëmijët që të qëndrojnë larg tij.

Një skuadër misionare kohët e fundit ka dhënë ndihmë në këtë shkollë fillore, në krahinën Yei. Si pjesa më e madhe e zonave në Sudan, kjo shkollë rrallë është në gjendje të funksionojë për mungesë materiale dhe mësuesish të kualifikuar. Kjo shkollë, në veçanti ndodhet në një zonë të bombarduar rregullisht nga qeveria islamike e Sudanit.

Këta fëmijë kanë gërmuar me dorë më shumë se njëzet gropat për mbrojtje në tokë rreth oborrit të shkollës. Ata janë të përgatitur vetë me disa mjete mbrojtëse kur vijnë bombarduesit. Kur dëgjojnë motorin e bombarduesve, vrapojnë për të gropat, duke u ruajtur nga cilat fluturues shrapneli.

Disa ia dalin mbanë të arrijnë te gropat të sigurtë, por disa jo. Kur skuadra misionare pyeti se çfarë mund të bëhej për fëmijët, përgjigjja ishte e thjeshtë: «Lutuni për mbrojtjen e tyre».

Bibla na mëson se shumë besimtarë jetuan në një ekzistencë të pasigurt me qëllim që të ruanin besimin e tyre në Krishtin. Për këta fëmijë vuajtja, apo madje edhe vdekja për besimin e tyre, ishte një realitet i përditshëm. Për ne ata janë ushtarë të guximshëm për Krishtin.

Fëmijët në Sudan janë të përgatitur për të hyrë në një betejë tokësore, për më tepër ata janë të përgatitur të hyjnë një ditë në portat e qiellit. Ata kanë siguruar mbrojtje brenda në tokë nga sulmet ajrore të kampeve armike. Përsëri besimi i tyre në Krishtin u ka siguruar mbrojtje të përjetshme në krahët e Perëndisë. Ndoshta, ashtu si fëmijët sudanezë që luajnë afër një bombe të pashpërthyer, ti e ke mësuar tani që jeta vazhdon një hap larg shkatërrimit. Ti mund të kesh ndërmarrë hapa për të ruajtur e mbrojtur jetën tënde në tokë, duke shpresuar për më të mirën në mes të kohëve të pasigurta. Megjithatë, a ke ndjekur edhe ti shembullin e tyre e të qenit të përgatitur për jetën e përtejme? A je i përgatitur për jetë të përjetshme falë një marrëdhënieje personale me Jezu Krishtin?

Ai që ka Birin ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën.

1 Gjoni 5:12

Revolucion ekstrem – pjesa e parë

RUMANI: TË KRISHTERËT E TIMISHOARËS

Kur poeti rumun, Konstantin Ioanid, shkroi poemën e titulluar «Zoti ekziston», ai nuk e dinte rëndësinë që fjalët e tij do të kishin në historinë e rumunëve.

Një natë në vitin 1989, të krishterët po protestonin në qytetin e Timishoarës. Një peshkop, i cili ishte bërë kukull e komunistëve, e kishte pushuar pastorin e reformuar Tëkesh, sepse predikonte Fjalën e Perëndisë.

Në ditën që Pastor Tëkesh i duhej të linte shtëpinë dhe kishën, të krishterët rrethuan shtëpinë e tij për të ndaluar që policia ta dëbonte. Shumë shpejt turma u rrit dhe u thirr ushtria për t'i ndaluar.

Ushtarët filluan të qëllonin dhe shumë u vranë apo u plagosën. Pastaj një gjë mahnitëse ndodhi. E gjithë turma, në vend që të luftonte ushtrinë, u ul në gjunj dhe u lut. Ushtarët e tronditur u prekën dhe refuzuan të qëllonin.

Ndërkohë, i gjithë qyteti ishte mbledhur dhe pastori lokal e drejtoi turmën për në ballkonin e pallatit të Operas. Ai recitoi poemën e vëlla Ioanidit dhe e gjithë turma filloi të thërriste «Zoti ekziston! Zoti ekziston!» Fletushka me tekstin e poemës u kaluan përreth dhe ata që e dinin muzikën e kompozuar për fjalët filluan të këndonin. Shumë shpejt mijëra po e këndonin atë pa reshtur.

Kënga u bë fillimi i revolucionit rumun, i cili çoi në rënien e diktatorit komunist, Nikolai Çaushesku.

Një revolucion është një rilindje e besimit në një ide shumë të vjetër, nëse ka të bëjë me lirinë, dinjitetin personal, ose madje edhe me ekzistencën e Zotit. Këto parime të dukshme mbeten të pandryshuara gjatë ciklit të shtypjes. Megjithëse ato mund të «varrosen» për njëfarë kohe, ekzistenca e tyre është e pasqyueshme. Një revolucion shpirtëror rilind besimin në ekzistencën e Zotit – megjithëse Zoti vetë nuk ka qenë kurrë i vdekur. Revolucioni fillon me zbulimin e së vërtetës rreth Zotit. Ne të gjithë kemi nevojë për kurajë për të ringjallur besimin tonë në një premisë bazë, të fuqishme dhe jetëndryshuese që Zoti ekziston. Ne jemi pjesë e revolucionit kur bashkohemi me të krishterë të tjerë, të cilët fillojnë të jetojnë ashtu si besonin. Si do të dukej revolucioni shpirtëror në jetën tënde?

*Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta
do të të bëjë të lirë.*

Gjoni 8:32

Revolucion ekstrem – pjesa e dytë

RUMANI: TREMBËDHJETË FËMIJË

Pasi qindra kishin vdekur më kot në Timisoara në vitin 1989, demonstrata të tjera shpërthyen spontanisht në qytete të ndryshme në të gjithë Rumaninë. Gjatë një proteste, një grup prej trembëdhjetë fëmijësh krijuan një barrierë njerëzore me trupat e tyre për t'i mbajtur ushtarët larg përparimit mbi turmën. Kur ushtarët filluan të afroreshin gjithsesi, fëmijët u gjunjzuan dhe u thirrën: «Ju lutem, mos qëlloni!».

Ushtarët i shpërfillën fëmijët e pafajshëm dhe filluan t'u qëllonin. Përsëri fëmijët nuk u tërhoqën. Ata thjesht vazhduan t'u luteshin: «Ju lutem, mos na qëlloni!». Një përkujtimore u ngrit atje ku u vranë fëmijët.

Një legjendë ka qarkulluar në të gjithë Rumaninë, që engjëjt në fakt filluan revolucionin duke rrethuar fëmijët dhe duke u dhënë kurajën e shenjtë për të cilën kishin nevojë që t'i bëjnë ballë së keqes.

Në çdo qytet, tanket dhe trupat u thirrën për të ndaluar kryengritjet. Por në fakt, ushtarët iu dorëzuan turmave paqësore. Në qytetin e Sibiusë, ushtarët dhe oficerët u bashkuan me turmën e mijërave, ndërsa dy pastorë mbi tanke u kërkuan të gjithëve të uleshin në gjunjë për lutje. Ata ishin po aq të ngopur me qeverinë, sa ishin edhe njerëzit dhe shumë shpejt u bë e pamundur për të shtypur kryengritjen.

Besohet se martirizimi i një grupi të vogël fëmijësh i dha vendit fitore mbi një brez shtypës komunistësh.

Kur ne bëhemi si fëmijë në besimin tonë, dëshirojmë shumë të kryejmë atë që Krishti ka vendosur para nesh. Si fëmijë, duhet të kapim momentin dhe të bëjmë më të mirën. Fëmijët rumunë u lutën pa sukses për jetët e tyre, por ata ishin të palëkundur në misionin e tyre. A ka ndonjë rrethanë apo pasojë që kërcënon angazhimin tënd ndaj misionit? Për çfarë je gati të sakrifikosh, me qëllim që ta braktisësh veten për kauzën e Krishtit?

Dhe tha: Me të vërtetë po ju them: nëse nuk ktheheni e nuk bëheni si fëmijët, nuk do të hyni në mbretërinë e qiellit.

Mateu 18:3

FKSTREM

Një hap ekstrem

KAMP PËRQËNDRIMI NAZIST: MARIA SKOTSOBAJA

«...shtatë, tetë, nëntë – ti! Bëj një hap para!» – i bërtiti roja naziste gruas. Komandanti nazist i kampit në Aushvitz-Birkenau kishte urdhëruar që çdo dhjetë të burgosura të ekzekutoheshin si dënim për dy gratë e arratisura një natë më parë.

«Ju lutem, kini mëshirë për mua! Kam një fëmijë!» – iu përgjërua gruaja e dhjetë. Maria Skotsobaja, një besimtare ruse, qëndronte pas saj në radhë. Në zemrën e saj ajo dëgjo: «Bëj një hap para dhe thuaj që do të doje të vdisje në vendin e saj». Ajo iu përgjigj zërit të brendshëm: «Pse? Ajo nuk është e krishterë, është një çifute komuniste. Kur nazistët të bien nga fronti dhe komunistët të vijnë në fuqi, ata do të jenë po aq të këqij sa edhe nazistët».

Pastaj Maria u kujtua se ishte e Premtja e Zezë. Zëri tha: «Në këtë ditë unë vdiqa jo vetëm për të mirët, por edhe për të këqijtë, për mëkatarët».

Maria atëherë bëri një hap përpara. «Unë dua të vdes».

Oficeri qeshi. «Nëse je mjaft budallaqe sa të vdesësh në vend të saj, në rregull, eja përpara. Radha e saj do të vijë mjaft shpejt.»

Ndërsa Maria shkoi për t'u ekzekutuar dhe për t'u djegur në furrë, ajo u tha atyre: «Kur Zoti nxori popullin e tij nga skllavëria në Egjipt, është shkruar në Biblën tonë që ai ecte përpara tyre në një kolonë zjarri. Unë lutem që kur trupi im të digjet do të jetë një kolonë zjarri që do t'ju tregojë juve rrugën për te Zoti».

Një hap përpara mund të sjellë të gjithë ndryshimin. Shpesh të krishterët e bëjnë jetën e tyre të balancuar në mënyrë të rrezikshme në prag midis sigurisë dhe së panjohurës. Ata që kanë bërë një hap të vogël përpara në të panjohurën kanë gjetur gjithnjë besnikërinë e Zotit: Noeu, Moisiu, Abrahami, Debora, Ruta, Maria, Pali. Lista e shembujve biblikë vazhdon më tej, pa përmendur një mizëri historik të famshme. Një hap besimi ndryshoi jetën e tyre nga e zakonshme në të pazakontë. A është Zoti duke të thirrur të të bësh një hap përpara me besim sot? A e dëgjo zërin e tij me besim sot? A e dëgjo zërin e tij në zemrën tënde? Dëgjo. Përgatitu të lëvizësh. Hapi yt i vogël i bindjes mund t'u tregojë të tjerëve rrugën drejt Zotit.

*Zoti i drejton
hapat e njeriut;
e si atëherë njeriu mund
ta dijë udhën e vet?*

Fjalët e urta 20:24

**Një martir është ai, i cili është bërë
mjet i Perëndisë dhe e ka humbur vullnetin e
tij në atë të Perëndisë, nuk e ka humbur, por
e ka gjetur, sepse ai ka gjetur liri
në nënshtrimin ndaj Perëndisë. Martiri nuk
dëshiron më asgjë për vete, madje as
lavdinë e martirizimit.**

T. S. ELIOT – VRASJE NË KATEDRALE



SEKRET EKSTREM

KATAKOMBET ROMAKE

Të krishterët e hershëm dalloheshin për dy gjëra: lutjet poshtë nën tokë dhe persekutimi mbi tokë. E gjithë bota ishte kundër të krishterëve në Perandorinë Romake. Mark Aurel Antoni firmosi një dekret në vitin 162 pas Krishtit duke deklaruar: «Kushdo që shpall se është i krishterë, meriton vdekjen më të dhimbshme!» Në një periudhë prej pothuajse katër shekujsh filloi për kishën sekreti ekstrem. Kisha në kuptimin e vërtetë të fjalës shkoi nën tokë, duke krijuar katakombet romake.

Një rrjet i gjerë dhomash dhe korridoresh u ndërtuan nën tokën e Romës për varrosjen e të vdekurve. Por këto u kthyen në katedrale të kishës së hershme. Besimtarët mund të gjenin një vend për adhurim dhe lutje të lirshme dhe pa pengesa.

Katakombet tregojnë përkushtimin e besimtarëve të hershëm për të gjetur një vend për të adhuruar Krishtin. Kockat e thyera dhe të djegura të varreve të tyre tregojnë intensitetin e persekutimit që ata vuanin. Ndoshta më domethënëse janë shënimet sekrete të fitores dhe paqes të skalitura në mure. Pavarësisht nga mizoria e treguar ndaj tyre mbi tokë, nën të ata zbuluronin muret me simbolet e besimit dhe paqes me anë të kryqit.

Nuk është e pazakontë të shohësh nënshkrimet kriptomike mbi varre si të poshtëpërmendurat: «Fitimtarë në paqe dhe në Krishtin» ose «Duke qenë se u thirr, ai u largua në paqe» ose «Këtu ndodhet Maria, prehet në një ëndërr paqeje», «Çelësi drejt triumfit nuk është sekret: paqe të përsosur në Krishtin Jezus.»

Shumë njerëz e mbajnë besimin e tyre sekret gjatë gjithë jetës së tyre. Ata deklarojnë se besimi është një çështje private – diçka midis Zotit dhe vetes së tyre. Megjithatë, nuk ishte kështu në kishën e hershme. Besimtarët ishin aq të hapur në besimin e tyre, sa që identifikoheshin lehtë dhe persekutoheshin. Katakombet romake shërbyen si vende private adhurimi; megjithatë mbi tokë bindja e tyre nuk ishte sekret. Ja, pse kaq shumë u martirizuan për besimin e tyre. Lutja e vazhdueshme dhe e hapur nën tokë u dha atyre paqen që e përjetuan në persekutimin mbi tokë. A ka qenë besimi yt «nën tokë» gjatë jetës sate të krishterë? Është koha që sekreti të dalë. Nuk ka rëndësi se cilat janë pasojat, mos e mban krishterimin të fshehtë.

Sepse nuk ka asgjë të fshehtë që të mos zbulohet, as kurrëgjë sekrete që të mos dalë në dritë.

Marku 4:22

FKSTREM

Siguri ekstreme

QYTETI NJU JORK

«Tani, vëllezër, dua që ta dini, se gjërat që më kanë ndodhur ndihmuan më shumë për përhapjen e ungjillit..., the pjesa më e madhe e vëllezërve në Zotin, të inkurajuar nga vargonjtë e mia, kanë marrë më shumë guxim në shpalljen e Fjalës së Perëndisë pa frikë... Sepse juve ju është dhënë hiri për hir të Krishtit, jo vetëm që të besoni në të, por edhe të vuani për të.» (Filipianëve 1.12. 14. 29).

Nëse të krishterët në Amerikë do të ishin më aktivë në ungjillizim, a do të kishte SHBA një rritje në persekutim brenda kullijve të saj? Shërbesat Metro, një shërbesë ungjillizuese që arrin zonat më të vështira të qytetit të Nju Jorkut e kanë parë këtë efekt në shërbesën e tyre. Ndërsa ungjillizimi hyn më thellë në qytet, ata janë përballur me më shumë rezistencë. Anëtarë të caktuar të personelit janë rrahur, goditur me thika, apo dhunuar ndërsa kryejnë misionin e tyre. Një anëtar i personelit madje është vvarë.

Drejtori i tyre, pastor Bill Uilson, është goditur me thikë dhe është rrahur në një sërë rastesh. Por kërcënimi i së keqes nuk e ka mbajtur larg nga njerëzit, të cilët i do. Ai, gjithashtu, mori tuberkulozin për shkak se u shërbente njerëzve të pastrehë.

Debi, një pesëmbëdhjetë vjeçare në një nga lagjet e varfra të Bruklinit, Nju Jork, flet për shumë të rinj që kanë përjetuar persekutim brenda shteteve. Ajo thotë: «Është shumë e vështirë që ta shpallësh hapur veten si e krishterë në shkollën time. Unë vazhdimisht sulmohem dhe më bëjnë presion për t'u bashkuar me një nga bandat».

Në shumë vende të izoluara, të krishterët nuk persekutohen sepse besojnë në Jezus, por sepse u tregojnë të tjerëve për të. Në këto kombe, ungjillizimi prodhon persekutim, i cili shpesh prodhon dëshmi më të fortë për Krishtin. Çfarë bëhet për t'i shkatërruar, në fakt, i bën ata më të vendosur. Në mënyrë të ngjashme, ungjillizimi në Amerikë dhe në vende të tjera të hapura nuk është gjithmonë i sigurt. Por, a duhet që ky realitet të shuajë entuziazmin tonë për detyrën? Një komb si SHBA, i themeluar në liri fetare, është tërësisht i pamësuar me vuajtjen dhe persekutimin. Në vend që ta përdorim këtë parim si mjet të pafuqishëm për të na mbajtur të sigurt, ne duhet të mbështetemi në të për të na bërë më të guximshëm. Si një person që jeton në një demokraci të lirë, ti ke më shumë arsye për të përhapur besimin tënd me guxim dhe siguri. A do të flasësh sot?

*Dhe këtë besim ne e kemi në
Perëndinë me anë të Krishtit.*

2 Korintasve 3:4

FKSTREM

Përkushtim ekstrem

INDI: GLADIS STEJNS

Gladis Stejns kishte çdo arsye për të qenë e hidhëruar dhe e zemëruar. Askush nuk do ta kishte qortuar nëse largohej nga India. Por kur fanatikët hindu në qytetin indian të Manoharpur i vranë të shoqin dhe dy djemtë, Gladis dhe vajza e saj trembëdhjetë vjeçare, Estera, vendosën të qëndronin. Ajo do të vazhdonte me punën e saj me lebrozët në këtë krahinë.

Bashkëshorti i saj, Grahami, dhe dy djemtë e tyre, Filipi dhe Timoteu, u vranë ndërsa ishin duke fjetur në xhipin e tyre jashtë kishës. Ata ishin atje për t'i shërbyer bashkësisë. Megjithatë, para se dielli të lindte atë mëngjes të tmerrshëm, një bandë prej afërsisht njëqind hinduistëve derdhën gazolinë në automjetin e tyre dhe i vunë zjarrin. Ndërkaq hinduistët e armatosur me harqe dhe shigjeta rrethuan automjetin që të mos i linin të largoheshin.

Gladisi tha se Grahami nuk kishte dalë kurrë për të ungjillizuar midis hinduistëve. Ai thjesht po tregonte dashurinë e Krishtit. Si rezultat, çifti australian kishte parë shumë të ktheheshin te Krishti dhe të digjnin idhujt e tyre. Rreziku i dëshmisë së tyre nuk e lëkundti asnjëherë përkushtimin e tyre për të treguar dashurinë e Jezu Krishtit.

Në shërbesën e përkujtimeve për Grahamin, Filipin dhe Timoteun, Gladisi dhe Estera kënduan:

Sepse ai jeton, kam fuqi për nesër

Sepse ai jeton, s'kam frikë më

Sepse e di që ai mban të ardhmen

Dhe jeta ime tani ka vlerë, sepse ai jeton.

«Sepse Ai Jeton». Fjalët nga Uilliam J. dhe Gloria Gaither, Muzika nga Uilliam

J. Gaither. Copyright 1971 Uilliam J. Gaither. Të gjitha të drejtat e kontrolluara nga menaxhimi i së drejtës së kopjes Gaither. E përdorur me leje.

Përkushtimi ekstrem nuk shkurajohet kurrë nga rreziku. Ai nuk dobësohet nga shqetësimet. Nuk shqetësohet madje, as për pasojat. Përkushtimi njej vetëm një gjë – mbi të gjitha detyrën. Për shumë njerëz, humbja e familjes nga të huaj armiqësorë do të ishte një justifikim racional për të braktisur misionin e tyre. Por nuk ndodh kështu me ata që shtyhen nga një përkushtim ekstrem. Megjithëse mund të jenë të shkatërruar nga sprova, përkushtimi i tyre për të vazhduar përpara është i palëkundur. Vetëm Zoti mund të na japë fuqi shpirtërore të nevojshme për të vazhduar me misionin, pavarësisht nga mjerimi. A gjendesh duke u përpjekur të vendosësh të shkosh apo jo në punën e Zotit? A ka ndodhur diçka që të ka çuar jashtë rrugë? Kërkoji Zotit përkushtim të përditshëm për të vazhduar me detyrën.

Sepse ata që rojnë sipas mishit e çojnë mendjen në gjërat e mishit, por ata që rojnë sipas Frymës në gjërat e Frymës.

Romakëve 8:5

Adoleshente ekstreme

KUBA: ROZA

"Kam lindur në një shtëpi komunistësh ku askush nuk e përmendte fjalën «Zot». Prindërit e mi janë ateistë. Babi im është në udhëheqësinë e Partisë Komuniste Kubane. Mamaja ime është sekretare e Komitetit për Mbrojtjen e Revolucionit. Ju mund të thoni se shtëpia ime është një çerdhe për komunizmin. Megjithatë, gjyshja ime e do Perëndinë dhe më ka mësuar rreth Zotit. Në disa raste u përpoqa të shkoja në kishë me të, por prindërit e mi nuk më lejuan."

«Një ditë, unë e pranova Zotin Jezu Krisht si Shpëtimtarin tim. Jeta ime filloi të ndryshonte. Madje, ndryshoi edhe mënyra se si vishesha. Mamaja ime nuk e pranonte këtë. Ajo s'më kishte rrahur kurrë më parë, por tani e bën shpesh. Kur babi im mësoi se isha e krishterë, më tha të zgjidhja midis atij dhe Zotit. Unë zgjodha Zotin, sepse e kam kuptuar se ai është e vetmja gjë për të cilin ia vlen të jetosh.

Tani, megjithëse jam vetëm katërmbëdhjetë vjeçe, studioj larg shtëpisë sime. Kur erdha në fillim në këtë vend, isha e vetmja e krishterë, por e kam mbjellë Fjalën e Zotit dhe tani jemi katër. Ne takohemi nën një pemë – të fshehur – për të studiuar së bashku Fjalën e Zotit. Vazhdojmë të mbjellim dhe të presim, duke besuar se shumë shpejt do të jemi shumë.»

Fëmijëria e Rozës do të kishte qenë e destinuar për indoktrinim komunist dhe ateizëm, pa ndikimin e gjyshes, e cila rrezikoi duke i shpallur Krishtin. Tani, Roza rrezikon në të njëjtën mënyrë me të tjerë në shkollën me konvikt, duke komunikuar dhe duke mbjellë Fjalën e Zotit. Ajo është duke punuar me nga një besimtar çdo herë për të sjellë ndryshim. Megjithatë, Roza ka zbuluar, si shumë adoleshentë kubanë që jetojnë nën Fidel Kastron, se besimi ka pasoja. Por ajo beson, pavarësisht nga mundësitë e pakta, se disa prej farave do të bien në tokë pjellore. Në jetën e kujt do të mbollësh farat e Fjalës së Zotit dhe do të presësh një korrje?

Por ai që e merr farën në tokë të mirë, është ai që e dëgjon fjalën, e kupton dhe jep fryt; dhe prodhon njëri njëqindfish, tjetri gjashtëdhjetëfish dhe tjetri tridhjetëfish.

Mateu 13:23

FKSTREM

Fitimtarë ekstremë

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

«Gruaja ime është duke fjetur në dhomën tjetër sepse ka qenë sëmure », – e nisi pastor Riçard VurmbRAND. «Ajo dhe unë jemi çifutë. Familja e saj u shkatërrua në të njëjtin kamp përqendrimi nazist në të cilin ju u mburrët se kishit vrarë çifutët me fëmijë në krahë. Ndoshta, po kështu ju keni vrarë edhe familjen e gruas sime.»

Me të dëgjuar këtë, ushtari, tashmë mysafir në shtëpinë e pastorit u zemërua shumë dhe u ngrit për të ikur. Por Riçardi e ndaloi. «Prit, dua të propozoj një eksperiment. Dua t'i tregoj gruas sime se kush jeni dhe çfarë keni bërë. Por gruaja ime nuk do t'ju mallkojë dhe as t'ju shikojë me zemërim. Ajo do t'ju pranojë.»

Burri u ul me gojë hapur, por i mbetur pa fjalë.

Pastori vazhdoi: «Tani, nëse gruaja ime, e cila është vetëm njerëzore mund t'ju falë – atëherë sa më tepër do t'ju falte dhe t'ju donte Jezusi?»

Burri mbuloi fytyrën me duar. «Çfarë kam bërë? Si mund të vazhdoj të jetoj me fajin e këtij gjaku të shumtë? Jezus, të lutem më fal!»

Pastaj Riçardi shkoi dhe zgjoi gruan e tij, Sabinën. «Ky është vrasësi i motrave, vëllezërve dhe prindërve të tu», – e prezantoi ai burrin. – «Por tani ai është penduar». Ajo i vuri duart rreth qafës dhe e puthi në faqe.

«Dashuria i mposht të gjitha», është një thënie e njohur. Të krishterët, megjithatë, e dinë të vërtetën e kësaj thënieje. Kur jemi në mëshirën e zemërimit, ne pushtohemi nga urrejtja, por kur lejojmë Zotin (i cili është dashuri) të kontrollojë jetën tonë, zbulojmë se emocionet e natyrshme, si zemërimi, i nënshtrohen atij. Ne, madje nuk e ndiejmë se po mërzitemi nga situatat që na zemëronin. Dashuria duhet të fitojë çdo gjë brenda nesh që është në kundërshtim me karakterin e Krishtit. Rezultati përfundimtar është që ne do të jemi aq të dhënë pas dashurisë, sa edhe armiku ynë më i madh përfiton nga transformimi ynë. A po përjeton fitore mbi hidhërimin dhe hakmarrjen? Kërkoji Zotit të dashurisë të mposhtë zemërimin tënd sot.

Tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria: por më e madhja nga këto është dashuria.

1 Korintasve 13:13

FKSTREM

Butësi ekstreme

KAMBOXHA: NJË ADOLESHENTE

Ushtarët e Kmerëve të Kuq shpërthyen në dhomë, duke vringëllyer armët dhe duke fyer dhe kërcënuar. Kur Kmerët e Kuq pushtuan Kamboxhan në vitin 1975, mijëra të krishterë u vranë. Fëmijët, madje u hodhën para krokodilëve në mënyrë që ushtarët të «kursenin plumbat».

Asnjë prej anëtarëve të bashkësisë nuk lëvizi. Një oficer shkoi në drejtim të pastorit, i rrëmbeu Biblën, të cilën ishte duke e lexuar dhe e hodhi në dysheme. «Do t'ju lejojmë të shkoni» – tha ai, – «por në fillim duhet të shkëlmi mbi këtë libër gënjeshtrash. Kushdo që refuzon, do të qëllohet.»

Një ushtar tjetër kapi një burrë prej krahu dhe e detyroi të dilte para. «Atë, të lutem më fal» – u lut ai ndërsa u gjunjzua ku kishte rënë Bibla dhe pështyu lehtë mbi të.

«Mirë, ti mund të shkosh.» Pastaj oficeri i drejtoi gishtin një gruaje. Edhe ajo u gjunjzua pranë Biblës, e lagu mjaft Biblën sa të kënaqte oficerët.

Një vajzë adoleshente u ngrit papritur dhe shkoi në drejtim të Biblës. Me lot ndër sy, ajo u gjunjzua, e mori Biblën dhe e pastroi me cepin e fustanit të saj. «Çfarë i kanë bërë Fjalës sate?» – tha ajo. – «Të lutem, fali ata». Ushtari uli revolverin në pjesën e pasme të kokës dhe tërhoqi këmbëzën.

Edhe të krishterët që u lanë në fillim të largoheshin, u vranë. Veprimi i tyre nuk i shpëtoi.

Një akt veprimi butësie mund të frymëzojë një bashkësi më shumë se ndonjë numër tradhtish. Adoleshentja në histori na sjell një vizion se çfarë do të thotë të jesh e bashkuar në Krishtin. Në vend që t'i qortonte vëllezërit dhe motrat e saj më të dobët, ajo thjesht u drejtua nga shembulli në trajtimin e saj të butë ndaj Biblës. Imagjinoni sikur të gjithë në atë kishë të kishin vepruar në të njëjtën mënyrë. Çfarë dëshmie e fortë për Krishtin! Sa herë që veprojmë së bashku, jemi më të fortë. Butësia dhe dhembshuria, të kombinuara me një shembull të fortë, do t'i çojë ata që janë të dobët për t'u bashkuar së bashku në një përkushtim më të madh. Nëse je i mërziur me të tjerët që luftojnë në përkushtimin e tyre, mban mend se Zoti të thërret që të bashkohesh me të tjerët që janë më të dobët dhe t'i ndihmosh.

Pra, në qoftë se ka ndonjë ngushëllim në Krishtin, ndonjë ngushëllim dashurie... atëherë e bëni të plotë gëzimin tim, duke pasur të njëjtin mendim.

Filipianëve 2:1-2

**Persekutimi i të krishterëve nuk ka të bëjë
me të drejtat njerëzore,
është një ritual i kalimit.**

STIV KLERI



«Kjo dhuratë është për ty.»

«Çfarë është?» – pyeti misionari mikun e tij ndërsa përgatitej të shkonte në Korenë e Veriut.

«Vetëm merre. Do ta marrësh vesh kur ta hapësh.»

I maskuar si biznesmen, misionari me qetësi u largua nga hoteli, ndërsa «udhërrëfyesi» i tij flinte. Ai hyri në një fshat aty afër dhe u takua me një grup të vogël besimtarësh. Sapo e kuptuan se misionari i ri ishte një pastor i vajosur, ata thanë: «Ti duhet të na pagëzosh! Ne kemi pritur dikë të na pagëzonte!»

Në një vend, ku të kishe një Bibël do të thoshte një dënim prej pesëmbëdhjetë vjetësh, një pagëzim zyrtar mund të thoshte një vdekje e sigurt.

Duke mos pasur ndonjë liqen, apo lumë aty afër, misionari thjesht u lut për besimtarët një nga një si simbol i besimit të tyre. Por për çudinë e tij ata nuk ishin të kënaqur. «Ne kemi pritur dyzet vjet për Darkën e Zotit».

Një nga besimtarët solli menjëherë disa kekë orizi. Misionari mendoi. «Ata patën një pagëzim pa ujë, ndoshta mund ta kenë edhe Darkën e Zotit pa pije». Pastaj ai kujtoi «dhuratën» që miku i tij ia dha para se të shkonte në Korenë e Veriut. Kapi me shpejtësi çantën e udhëtimit dhe nxori pakon – një shishe vere. Të mbetur pa fjalë, secili prej fshatarëve qau hapur duke lavdëruar Zotin për dhuratën e tij në kohën e duhur.

Ndërsa shumica e njerëzve në kulturën moderne s'mund ta imagjinojnë jetën pa një kalendar apo një orë, Zoti ka kohën e tij. Ai nuk shtyhet nga tirania e urgjencës. Megjithatë ne duhet të mësojmë durimin me qëllim që të jetojmë të gëzuar brenda kohës së tij. Durimi do të thotë të besosh se Zoti është në punë, madje edhe kur ne nuk shohim prova. Durimi është parimi i kënaqësisë së vonuar. Kur ne presim bekimet e Zotit në jetën tonë, i vlerësojmë shumë ato. Atë që presim, e vlerësojmë më shumë. Nëse është një Darkë e Zotit me kek me oriz, ose një nevojë e veçantë në jetën tonë, koha e Zotit është e sigurt. Çfarë të shqetëson ty që ka të bëjë me kohën e Zotit në jetën tënde? A është koha që t'i besosh atij?

*Ki besim tek ai vazhdimisht,
o popull.*

Psalmi 62:8

Ungjillizim ekstrem

UGANDA: PESHKOP HANINGTONI

«Mënyra e vetme se si mund të shpëtohet një torturues, mund të jetë nëpërmjet një të burgosuri të krishterë. Ata asnjëherë nuk shkojnë në kishë apo të lexojnë Biblën e Shenjtë. Por një i krishterë i burgosur mund t'u tregojë dashuri atyre, madje edhe ndërsa janë duke u rrahur.» I tillë është besimi i një anëtarë të një kisha të fshehtë.

Një grua tjetër, e cila ka kaluar vitet e saj duke i shërbyer Krishtit nën rrezikun e torturës tha: «Në të gjithë historinë e kishës, shumë të burgosur të krishterë kanë sjellë torturat e tyre në qiell. Ndodhet një pllakë në burgun romak që përmban emrat e atyre që janë kthyer në besim, ndërsa Pali ishte në burg atje. Ata do të ishin në ferr, nëse Pali nuk do t'u kishte dhënë mundësinë për t'i rrahur». Ajo pushoi. «Nuk e kam problem të vuaj nëse rezultati është shpëtimi i torturuesve.»

Peshkop Haningtoni e dinte se rreziku ishte i lartë kur vendosi t'ua sillte mesazhin e Krishtit kanibalëve në Uganda. Disa javë pasi peshkopi kishte ardhur, kanibalët e refuzuan mesazhin e tij dhe e ekzekutuan atë.

Para se Haningtoni të vdiste, kanibalët dëgjuan fjalët e mëposhtme me zë të lartë: «Duajini armiqtë tuaj... lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju persekutojnë».

Ky ishte i njëjti mesazh që dy djemtë e peshkopit morën me vete kur u nisën në të njëjtin fshat pas vdekjes së babait të tyre. Ata ishin të vendosur të vazhdonin të ungjillizonin të njëjtët njerëz që kishin vlarë babanë e tyre.

Disa mendojnë se vdekja e Krishtit dhe ringjallja është thjesht një mashtrim i krijuar nga mendimtarë të kotë, të cilët donin që kujtimi i mësuesit të tyre të dashur të jetonte. Megjithatë, si e shpjegon kjo martirizimin e pjesës më të madhe të dishepujve dhe të shumë të tjerëve pas tyre? Duket e arsyeshme se do ta kishin pranuar çmendurinë e tyre në momentin e arrestimit dhe sigurisht, përpara vdekjes së tyre të sigurt. Pse do të ishin të gatshëm të mbanin një të ashtuquajtur mashtrim deri në këtë pikë? Në fakt historia dokumenton përpjekjet e tyre për t'i kthyer në besim torturuesit e tyre deri në minutën e fundit. Ky ungjillizim ekstrem ishte një provë për bindjen e tyre. Ky ishte pikërisht ungjilli i Zotit. Sa të bindur je ti nga mesazhi i ungjillit? A je gati ta ruash atë deri në ekstrem?

Në fakt, unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson.

Romakëve 1:16

FKSTREM

Fushë ekstreme misioni

JAPONI: FRANCIS KSAVIER

Japonia, një vend i rrethuar nga male të bukura, u bekua nga besimi i vëllezërve dhe motrave të guximshëm të krishterë, të cilët vendosën të rrezikonin gjithçka për të qenë të parët për t'ua sjellë mesazhin e dashurisë dhe faljes së Krishtit japonezëve.

Në vitin 549, Francis Ksavier ishte misionari i parë në Japoni. Në shërbesën e tij, shumë u kthyen në besim dhe kisha u rrit me shpejtësi. Por zyrtarët japonezë i shihnin të krishterët si kërcënim dhe kështu filloi persekutimi i ashpër. Kundërshtimet ndaj krishterimit u ngritën si një mal i thepisur në qiejtë e Japonisë, duke i lënë në hije besimtarët poshtë. Në qytete si Unzen, të krishterët u zien në llavën vullkanike. Të tjerë u kryqëzuan në kryqe druri në qytetin e Nagasakit. Në vitin 1637 ushtarët japonezë rrethuan të gjithë të krishterët e njohur, rreth tridhjetë mijë dhe vranë secilin prej tyre. Pas kësaj kisha kaloi në fshehtësi me shpresë mbrojtjen e atyre që mund të shpëtonin. Kisha luftoi për disa vite. Megjithatë, me hirin e Zotit kisha mbijetoi. Misionarë besnikë nuk ndaluan së ardhuri. Ata dëgjuan për persekutimin e madh dhe u përgjigjën thirrjes për t'u shërbyer atyre pak besimtarëve besnikë që kishin mbetur.

Japonia tani ka 1.7 milionë të krishterë aktivë dhe kishës po i shtohen besimtarë çdo ditë. Ksavieri dhe misionarët modernë përfaqësojnë besimin e njëfare sinapi që lëvizi një mal kundërshtimesh, që një komb të mund të ndryshohet.

Jeta është plot pikëpamje kundërshtuese. Shpesh besimtarët përballesh me një mal kundërshtimesh nga anëtarët e familjes së gjakut, të cilët nuk e pranojnë besimin e tyre. Shumë të krishterë kalojnë përmes Alpeve të ateizmit në vendin e punës. Majat e larta të persekutimit nga qeveritë e tyre i mbysin besimtarët në kombet e izoluara. Megjithatë, pas çdo mali kundërshtimi me të cilin përballesh sot kisha, gjendet një pamje e bukur. Skena është ajo e mijëra burrave, grave dhe fëmijëve, të cilët kanë etje për ungjillin. Besimi mund të qartësojë rrugën që të tjerët të shpëtohen. Shumë të krishterë para jush janë persekutuar për të treguar të vërtetën. A do të vazhdoni punën e tyre me një besim që mund të lëvizë malet? Në cilin mal kundërshtimi do të fokusohesh sot?


Unë po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t'i thoni këtij mali: «Zhvendosu nga këtu atje» dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju.

Mateu 17.20

FKSTREM

Vende ekstreme

RUSI: ZOJA KRAHMALNIKOVA



Një i burgosur tjetër, i cili ishte një prift në një burg rus, e kishte tradhtuar Zojën. Ai bëri akuza të rreme për të, që të mund të lirohej nga burgu dhe t'u shpëtonte torturave të veta. Gjatë gjyqit, Zoja refuzoi të thoshte ndonjë fjalë kundër tij. Ajo tha: "Kur Juda e tradhtoi Jezusin, ai ishte një njeri tradhtar. Por Jezusi e quajti atë «mik» në Gjetsemani. A nuk duhet të mësojmë ne nga shembulli i Krishtit dhe të sillemi në të njëjtën mënyrë ndaj atyre që na tradhtojnë?"

Zoja Krahmalnikova kaloi gjashtë vjet në një burg rus, sepse ua shpallte Krishtin të tjerëve. Koha që kaloi atje i dha një kuptim të ri të Fjalës së Zotit dhe si të zbatohet në jetën e përditshme.


«Në burg, çdo derë qelie kishte një vrimë të hapur të quajtur e Judës. Përmes saj rojat mund të të kontrollonin çdo pesë minuta. Ata të ruanin nga afër, duke të vëzhguar dhe udhëzuar. Kjo më ndihmoi të kuptoja se komunistët ishin shumë të zellshëm për të më ruajtur, a nuk do ta bënin këtë gjë edhe Zoti dhe engjëjt e tij, madje me më shumë zell?»

Zoja mund ta kishte lënë shumë lehtë hidhërimin t'i zotëronte zemrën, por ajo mori mësimet në Shkrimet dhe i zbatoi drejtpërdrejt në jetën e saj. Ishin mësimet të vështira, por i shërbyen për t'ia bërë jetën asaj dhe të tjerëve rreth e rrotull pak më të ndritshme.

Nisja në një udhëtim të gjatë pa paketuar gjërat e tua është një propozim qesharak në dukje. Cili do të udhëtonte i papërgatitur? Por të krishterët bëjnë një udhëtim shpirtëror çdo ditë, pa u përgatitur si duhet për udhëtimin e tyre. Ne duhet të përgatitemi me Fjalën e Zotit në zemrat tona me qëllim që ta zbatojmë atë kur është e nevojshme. Shumë prej nesh kemi të vështirë të kalojmë me sukses testet tona shpirtërore, sepse nuk e kemi studiuar që më parë parimet e Zotit. Ne përfundojmë duke u ndjerë si dështakë kur mund të kishim qenë fitimtarë si Zoja, duke zbatuar Fjalën e Zotit në situatën tonë. Besimi yt në Krishtin mund të të çojë në vende ekstreme. A je i përgatitur për udhëtimin? Sigurohu të kesh mjaftueshëm nga Fjala e Zotit – do të kesh nevojë për të.

Mundohu të dalësh para Perëndisë si i sprovuar, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që thotë drejt fjalën e së vërtetës.

2 Timoteut 2:15



Juani u dënua për të shërbyer për pesëmbëdhjetë vjet në burgun Migel Kastro për aktivitetet e tij terroriste. Juani e kuptoi se si mendojnë terroristët. Ai ishte një milic i grupit të komunistëve të njohur si «Rruga e ndritshme». Detyra e tij e madhe ishte t'u mësonte të tjerëve se si të vrisnin e të shkatërronin. Ai ishte një oficer i rangut të lartë dhe një ekspert në dinamit, armë dhe asgjësim. Puna i jepte atij një ndjenjë frymëzimi dhe rëndësie.

Juani e vazhdoi punën e tij madje edhe në burg. Ndërsa punonte për të regjistruar në milici një të ri të quajtur Fernando, ai zbuloi se shumë prej ideve të tij marksiste nuk po funksiononin me të. Në kthim, Fernando i bëri Juanit një pyetje të thellë. «Nëse do të vdisnit sot, miku im, ku do ta kalonit përjetësinë?»

Juani kishte parë apo organizuar vdekje të panumërta të të tjerëve, por ai s'e kishte menduar kurrë vdekjen e vet. Pyetja e Fernandos filloi ta shqetësonte. Fernando vazhdoi të fliste çdo ditë me të për dashurinë e Jezu Krishtit dhe sakrificën e tij. Më në fund Juani u bë besimtar.

Fernando e inkurajoi besimtarin e ri: «Ashtu si ti dhe jetën tënde për revolucionin, sot jepja atë Krishtit, Zotit tënd».

Në fakt, Juani drejtoi një grup në burg. Në të kaluarën ai regjistronte njerëz në shkollën e milicisë; në burg organizoi shkollën e së dielës. Misioni i tij i vdekjes ndryshoi për t'i ndihmuar të tjerët të gjenin jetën e përjetshme.

Zjarri u jep njerëzve një ndjenjë frymëzimi dhe rëndësie. Disa njerëz kanë zjarr për punën e tyre. Të tjerë janë të zjarrtë për familjet e tyre. Por akoma të tjerë janë të zjarrtë për çështje që kundërshtojnë direkt kauzën e Krishtit. Ata që persekutojnë të krishterët nuk mund të akuzohen për apati. Vendosmëria e tyre e palëkundur do të ishte pothuajse e admirueshme, nëse nuk do të ishte e keqdrejtuar. Megjithatë, Zoti është në punë për ndryshimin e jetëve tona të vjetra në të reja. Me të njëjtin zjarr që ai ndiente një herë për marksizmin, Juani filloi të regjistronte të tjerët për Krishtin. Zoti e mori zjarrin e tij pervers dhe e ktheu në një zjarr për Krishtin. Lutuni që Zoti të transformojë çdo gjë që konkurron përkushtimin tënd shpirtëror. Kërkoji atij një dëshirë përvëluese për të rritur mbretërinë e tij.

Por gjërat që më ishin fitim i konsiderova humbje për shkak të Krishtit.

Filipianëve 3:7

FKSTREM

Një zgjedhje tjetër ekstreme

FILIPINET: PJETRI

Pjetri ndjeu se ia vlente të rrezikonte. Atij i pëlqente shumë të udhëtonte me xhaxhanë e tij, Mikael, një ungjilltar në Filipine, në fshatrat e largët ku njerëzit kishin etje për të dëgjuar për Krishtin.

Udhëtimet për në fshatra ishin aventureske dhe ndonjëherë të rrezikshme sepse udhëtoje përmes pyjeve të dendur për orë të tëra. Njerëzit në Filipine kanë qenë të terrorizuar për shumë vjet nga Ushtria e Re e Popullit, krahu i Partisë Komuniste. Pjetri dhe xhaxhai i tij shpesh duhej të fshiheshin për të qëndruar larg rrezikut. Pjetri i donte shumë fëmijët dhe kënaqej duke parë sytë e tyre të ndriçonin kur më në fund kuptonin se sa shumë i donte Zoti.

Të Premten e Zezë, Ushtria e Re e Popullit kërkoi t'i jepte fund shërbesës së xhaxha Mikelit. Kështu ata kapën Pjetrin dhe e kërcënuan ta dënonin me vdekje, nëse xhaxhai i tij nuk do të ndalonte së foluri për Krishtin. Prindërit e Pjetrit u përgjigjën: «Ne s'mund t'i themi Mikaelit të ndërpresë punën e tij. Megjithatë, ju kërkojmë dhe ju lutemi të na ktheni djalin tonë. Ai s'ka bërë asgjë të keqe».

Më në fund, me duart e lidhura pas shpine, Pjetri i dëgjoi prindërit e tij t'u thoshin ushtarëve: «Të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim». Dhe me këto fjalë, Pjetri shkoi në shtëpi të takonte Shpëtimtarin e tij atë të

Premte të Zezë. Xhaxhai i tij, Mikeli, akoma u tregon fshatarëve në male për fuqinë e dashurisë së Krishtit dhe për nipin e tij të ri besnik të quajtur Pjetër.

Rreziqet kanë të bëjnë të gjitha me zgjedhjen. Disa njerëz zgjedhin të rrezikojnë pasuritë e tyre, duke vënë baste në aktivitetet më mundane. Rezultatet e një ndeshjeje futbollit. Fituesi në xhiron rreth pistës së garës. Numri i koshave që bën një lojtar i caktuar në një natë. Të tjerë rrezikojnë vetë jetën e tyre duke zgjedhur aktivitete vetëshërbyese pa një rëndësi të përjetshme si droga dhe aklooli. Jezusi i thërret njerëzit drejt një zgjedhjeje tjetër të gjithë së bashku. Ai thotë se ne duhet të zgjedhim të rrezikojmë sigurinë tonë tokësore me qëllim që të fitojmë një shpërblim qiellor, sepse bëjmë vullnetin e tij. Bërja e vullnetit të tij sjell një shpërblim më të madh sesa një pagesë në gara, apo ngazëllim artificial prej drogës më të fundit. A ke përjetuar shpërblimin e Jezusit për shkak të rrezikimit të besimit tënd? Pse, apo pse jo?

Në qoftë se dikush do të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo që unë flas nga vetja ime.

Gjoni 7:17

**Ne nuk lutemi për të qenë të krishterë më
të mirë, por që të jemi lloji i vetëm i të
krishterëve që Zoti donte të ishim;
të krishterë si Krishti,
që do të thotë, të krishterë që me gatishmëri
mbajnë kryqin për lavdinë e Zotit.**

NGA NJË LETËR E NXJERRË NGA KISHA E FSHEHTË NË RUMANI



FKSTREM

Himn ekstrem

KOREJA E VERIUT: FSHATARËT E GOKSANIT

Vajza e vogël me sytë bojëkafë ngritti sytë drejt së ëmës. Çfarë do të vendoste mami i saj?

Më herët atë mëngjes, e ëma e vajzës së vogël, pastori i tyre dhe njëzet e gjashtë të tjerë në ishatin e saj Goksan në Korenë e Veriut ishin lidhur dhe marrë para një turme komunistësh që ulërinin.

Njëri prej rojave urdhëroi Pastor Kimin dhe të krishterët e tjerë: «Mohoni Krishtin, ose do të vdisni». Fjalët e mpinë atë. Si mund t'i kërkonin të mohonte Krishtin? Ajo e dinte në zemrën e saj që ai ishte i vërtetë. Ata të gjithë refuzuan në qetësi.

Pastaj komunistët u bërtitën drejtpërdrejt të krishterëve të rritur: «Mohoni Krishtin, përndryshe do të varim fëmijët tuaj». Vajza e vogël pa drejt së ëmës. E ëma u përkul drejt saj. Me siguri dhe paqe ajo përsëpëriti: «Sot e dashura ime, do të të shoh në parajsë».

Të gjithë fëmijët u varën.

Besimtarët që mbetën i çuan në dyshe me dhe i detyruan të shtriheshin para një ruli ngjeshës. Komunistët u dhanë atyre një mundësi të fundit. «Mohoni këtë Jezus përndryshe do të shtypeni». Të krishterët kishin dhënë tashmë fëmijët e tyre; nuk kishte më kthim pas.

Ndërsa shoferi ndezi pajisjen e rëndë, këngët nga fshatarët filluan butësisht: «Më shumë dashuri, o Krisht, për ty, më shumë dashuri për ty».

Më shumë. Kjo është ajo që Perëndia dha kur dërgoi Birin e tij. Më shumë. Kjo është ajo që Krishti dha kur u kryqëzua. Më shumë. Kjo është ajo që besimtarët thjesht japin nga dashuria për Krishtin. Ata duan t'i japin më shumë Atij që u dha atyre kaq shumë. Në këtë kohë kur bota vlerëson dhënien vetëm për aq sa duhet për të kaluar radhën, besimtarët vendosin një standard të ri. «Më shumë dashuri për ty» është më shumë se vetëm fjalë në një himn tradicional. Është një stil jetese pa kufij. Çdo ditë është një rrugë e zbulimit se si t'i japësh më shumë Jezu Krishtit. Për disa besimtarë, kjo rrugë ka çuar në vdekjen e tyre. Për të tjerë, «më shumë dashuri për ty» ka dashur të thotë sakrificë financiare. Çfarë do të thotë për ty «më shumë dashuri për ty» në jetën tënde të përditshme?

Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa që dha Birin e Tij të vetëmlindurin, që kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.

Gjoni 3:16

Tani të gjithë donin ta shihnin filmin. Ata pëshpërisnin për të në treg, madje edhe në xhami. «Për çfarë flet ai?» «A është me të vërtetë aq i keq, sa njerëzit duhet të arrestohen nëse e mbajnë?»

Filmi në fjalë ishte filmi i Jezusit – një film me cilësi të lartë që portretizon jetën, shërbesën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezu Krishtit. Ai tregon planin e shpëtimit në një ekran të madh, duke sjellë në jetë historinë e Jezusit. Në Jokobabad, Pakistan, dy burra u arrestuan, sepse shpërndanin filmin dhe materiale të tjera të krishtera. Të dy burrat u rrahën dhe mullai i zonës dhe drejtuesit fetarë myslimanë, nxitën që të plotësoheshin akuza kundër tyre dhe të tjerëve që ishin të përfshirë në shpërndarjen e materialeve. Ata shkuan një hap më tej, duke inkurajuar myslimanët në qytet të vepronin kundër të gjithë të krishterëve. Shumë shpejt gjërat që pastori zotëronte u vodhën dhe armë u shkrepën afër një shkolle të krishterë. Qyteti dukej në prag të dhunës së papritur.

Megjithatë, gjërat shumë shpejt filluan të ndryshonin. Në vend që ta bojkotonin, të gjithë në qytet donin ta shihnin filmin e «mëkatshëm». Ata donin të dinin për gjithë këtë shqetësim drejtpërdrejt. Filluan të shpërndaheshin kopjet në tregun e zi, madje filmi JEZUS u shfaq edhe në televizion lokal. Gjykatësi i qytetit e pa dhe deklaroi se ai nuk ishte antiislam.

Me anë të përpjekjeve të kota të mullait, mesazhi i ungjillit arriti një komunitet të tërë. Ata planifikuan ta hiqnin filmin JEZUS nga vendi i tyre. Në fakt, fushata e tyre nxiti shërbesën. Zoti nuk e kthen të keqen në të mirë me metoda konvencionale. Ai bekon përpjekjet e shërbëtorëve të tij, por jo me mënyra që ne mund t'i parashikojmë. Të krishterët në zonat e ndaluara po e mësojnë këtë në mënyrën më të vështirë, por gëzohen duke parë misterin e Zotit të punojë në kombin e tyre. Zoti krijon një rrugë për secilin prej nesh edhe kur nuk ka kuptim. Ka kohë kur çdo gjë duket sikur po shkon keq. A janë ato kohët kur ti i beson Zotit më shumë? Ai e di çfarë është duke bërë edhe kur ti nuk e di.

*Sepse mendimet tuaja nuk janë
mendimet e mia, as udhët tuaja nuk
janë udhët e mia – thotë Zoti.*

Isaia 55:8

FKSTREM

Falje ekstreme

PERU: RIKARDO

Fleta ishte e papastër dhe e grisur në skaje. Boja e zezë marshonte përmes fletës në një shkarravinë pothuajse të palexueshme. Në fund letra ishte e firmosur – Rikardo.

«Unë shkruaj nga një kamp komunist guerilas në Peru. Kohët e fundit kam kërkuar disa programe në radio që të më gëzonin ndopak. Programet e mbushura me urrejtje të shokëve të mi ishin boshe për mua. Pastaj u ndesha me programin tuaj: «Ungjilli në gjuhën marksiste». Ju thatë se Jezusi, mësuesi i madh, foli për faljen e armiqve.

Ky pasazh më drejtoi në pjesët më të thella të qenies sime. Papritur, përjetova paqe dhe qava si fëmijë. Nuk e kuptoj çfarë ka ndodhur.

Prindërit e mi kanë qenë viktime të një pronari shfrytëzues tokash, ndaj i kam urreyer të pasurit gjithë jetën time. Por për ndonjë arsye, nuk i urrej më. S'mund ta shpjegoj këtë. A është e mundur për mua të mos urrej?

Ishte hera e parë që dëgjoja programin tuaj. Sa u gëzova! Tani nuk do të humbas as edhe një të vetëm. Dua të lexoj librin për të cilin ju folët.»

Më vonë, Rikardo i la guerilasit për t'iu bashkuar një kisha. Dy vjet më vonë, u kthye në kamp, duke shpresuar t'u tregonte shokëve të tij të mëparshëm për Shpëtimtarin e tij. Që atëherë nuk është dëgjuar më për të. Nëse ai vdiq, e bëri këtë me dashuri për ata që e vranë.

Një nga emocionet më helmuese të natyrës njerëzore është zemërimi. Ai është krahasuar me një acid që ha mbajtësen e vet. Ata që urrejnë e gjejnë shumë shpesh veten të shkatërruar nga hidhërimi i tyre. Megjithatë, një besimtar ka një natyrë shpirtërore që mund të jetë fitimtare mbi ndotjen e natyrës së vet. Jezusi u tregon njerëzve si të kenë dashuri për armiqtë e tyre dhe si rezultat i saj, ata ndryshohen. Transformimi mund të ndodhë aq shpejt, sa besimtari i kthyer nuk e di se ku përfunduan vitet e zemërimit! A je duke e helmuar shpirtin tënd me urrejtje? A të mbajnë mendime hakmarrëse zgjuar natën? Kthehu te Jezusi për shërim nga urrejtja. Fali fajtorët e tuj sot dhe gje shpresë për të nesërmen.

Po të thotë dikush «Unë e dua Perëndinë», dhe urren vëllanë e vet, është gënjeshtar, sepse ai që nuk do vëllanë e vet që sheh, si mund të dojë Perëndinë që nuk e sheh?

1 Gjonit 4:20

Nikolai Çausheku kishte një indoktrinim të quajtur «kolektivizimi». Si diktator i papërmbytur dhe i lig i Rumanisë, ai ndoshta mendoi se do të ishte ide e mirë t'i detyronte njerëzit që t'i dorëzonin vullnetarisht të gjitha pronat e tyre shtetit për të mirën e përbashkët.

Fermerët, pronarët e tokave dhe fshatarët kudo humbën gjithçka: fushat, bagëtinë, gjedhin, shtëpinë dhe mobilitet. Sektori i bujqësisë që një herë e një kohë lulëzonte, u shkatërrua. Çdo fermer u bë skllav i shtetit duke punuar për paga të mjerueshme në fushat e shtetit. Familjet qëndronin në radhë vetëm për të blerë bukë.

Për t'i mbajtur njerëzit larg rezistencës ndaj strategjisë së tij, vetë diktatori ndihmoi në nismën fillestare. Në provincën rumune të Dobrogeas, të gjithë fshatarët u mblodhën së bashku në qendër të qytetit dhe iu kërkua të jepnin pasuritë e tyre me vullnet të lirë. Kur asnjë nuk u vullnetarizua, Çausheku qëllon dhjetë persona me armën e tij. Fjala u mor përsëri: «Kush ka dëshirë të dorëzojë të gjitha pasuritë e veta?»

Ata luanin muzikë ushtarake dhe i këndonin lavde komunizmit. Ndërsa njerëzit detyroheshin të kërcenin, u bë një video duke propaganduar adhurimin e tyre entuziast ndaj socializmit. Një fermer që kishte humbur gjithçka tha më vonë: «Ata menduan se na morën gjithçka, por lanë diçka shumë të rëndësishme – himnet tona. Kështu që ne u ulëm dhe i kënduam lavde Zotit».

Shpesh njerëzit luajnë lojëra duke bërë që njerëz të panjohur të flasin dhe të mësojnë për njëri-tjetrin. Një nga pyetjet më të njohura është se cila do të ishte ajo gjë që do ta merrnin me vete nëse do të ishin të braktisur në një ishull të shkretuar. Pjesa më e madhe e njerëzve kalojnë një kohë kaq të vështirë për të vendosur, sa duhet t'u kujtohet se është vetëm një lojë. Megjithatë, njerëzit në Rumani nuk e kishin luksin e luajtjes së një loje, ata po përjetonin jetën reale. Madje qeveria e tyre nuk u lejonte asnjë pronë. Megjithatë, fshatarët e kuptuan se prania e atyre himneve të harruara i solli gëzim fshatit të tyre, i cili tani ngjante me një ishull të shkretuar. Njerëzit ruanin himnet dhe Zoti ruante njerëzit.

Meqënëse ti je një popull që je shenjtëruar te Zoti, Perëndia yt, Zoti, Perëndia yt të ka zgjedhur për të qenë thesari i tij i veçantë midis tërë popujve që ndodhen mbi faqen e dheut.

Ligji i përtërirë 7:6

Meri ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç kur fanatikët myslimanë bastisën fshatin e saj në Liban. Meri dhe prindërit e saj u përballën me një zgjedhje ndëshkuese: «Bëhuni myslimanë, përndryshe do të qëlloheni»,

Meri me guxim i tha personit: «Unë zgjedh Zotin. Vazhdo e qëlllo», Meri dhe familja e saj u qëlluan dhe u lanë të vdisnin. Dy ditë më vonë, Kryqi i Kuq arriti në fshat dhe zbuluan një mrekulli. Meri ishte gjallë – e paralizuar prej plumbit.

E shkatërruar dhe e pikëlluar, Meri u kap fort pas besimit të saj dhe u lut. Më në fund një paqe e çuditshme erdhi mbi të. Ajo i bëri këtë përkushtim Zotit: «Të gjithë kanë një punë për të bërë. Unë s'mund të martohem ndonjëherë, apo të bëj ndonjë punë fizike. Kështu do ta ofroj jetën time për myslimanët, për ata që më vranë babanë dhe nënën dhe që u përpoqën të më vrisnin edhe mua. Jeta ime do të jetë një lutje për ta», Lutjet dhe dëshmia e saj e pamohueshme e Krishtit sollën shumë myslimanë në besimin e Birit të Perëndisë. Viti 1990 në Liban ishte viti më i ashpër i luftës civile pesëmbëdhjetë vjeçare. Mijëra u vranë apo u plagosën dhe qindra mijëra u larguan. Megjithatë, ofrimi i jetës së gjymtuar të Merit inkurajoi shumë të krishterë për të qëndruar dhe për të mbrojtur Krishtin.

Dhuratën më të madhe të shërbimit ndaj Zotit nuk do të mund ta zërë një pjatë ofrimi. Kur ne e shohim tërë jetën tonë si ofrim ndaj Zotit, mundësitë tona për të fituar mbretërinë e tij janë të panumërta. Shumë prej atyre që janë persekutuar si Meri tregojnë të njëjtën histori. Ata vazhdojnë t'i ofrojnë jetët e tyre për t'u shërbyer atyre që i shtypin, si një veprim adhurimi. Tereza e Lisiut një herë tha: «Vuajtjet e duruara me gëzim, kthejnë në besim më shumë njerëz se vetë predikimet». Pjesa më e madhe e të krishterëve e kanë të lehtë të thonë justifikimet e zakonshme për të mos ofruar jetën e tyre: «shumë të zënë» dhe «po ndodhin shumë gjëra». Megjithatë, Zoti mund të zbulojë mënyra unike që ne të mund të dëshmojmë për Të.

Por, edhe sikur të jem derdhur si fljijim dhe shërbesë të besimit tuaj, gëzohem dhe ngazëlloj me ju të gjithë.

Filipianëve 2:17

TRISHTIM EKSTREM

RUMANI: ARKIMANDRITI GIUSH

Burgu komunist i Jilavas pranë Bukureshtit ishte veçanërisht i ashpër. Nga dritaret e thyera hynte i ftohti i hidhur i dimrit, madje disa nga të burgosurit kishin ngrirë. Nuk kishte mëshirë për të krishterët në Jilava. Në fakt, ata shpesh duronin të rrahura «të veçanta» nga rojat mizorë.

Një nga të burgosurit e rinj, Arkimandrit Giush, ishte pastor në qytetin Liberti, në Rumani. Ndërsa Arkimandriti shihte me ankth rreth «shtëpisë» së tij të re, ai vuri re një fytyrë të njohur – një person që kishte shërbyer me të në Liberti. Ishte pastor Riçard Vurmbrand. «Si mund të ishte akoma gjallë?» – pyeti veten Arkimandriti. «Askush s'ka dëgjuar më për të për tetë vjet». Dy pastorët besnikë u përqaftuan. Arkimandriti buzëqeshi me mirënjohje për mikun e vjetër që do të ndihmonte nëpërmjet vuajtjeve të tmerrshme që kishte para.

Por Pastor Vurmbrandi nuk buzëqeshi. Ai u trishtua që pa një pastor kaq të mirë në burg dhe filloi të shqetësohej për të. A do t'i mbijetonte të ftohtit dhe trajtimit mizor? A do të çmendej si kishte ndodhur me të tjerët?

Dy miqtë u ulën në qetësi për pak kohë. Më në fund Riçardi theu tensionin dhe pyeti butësisht: «Je i trishtuar?» Për habinë e tij Arkimandriti u përgjigj thjesht: «Vëlla, njoh vetëm një trishtim: Dhe kjo është të mos i jepesh plotësisht Jezusit».

Është e vështirë të lexosh historitë e vërteta të martirëve të krishterë pa u ndjerë emocionalisht i prekur. Reagimi i natyrshëm është ai i trishtimit dhe i keqardhjes për të pafajshmit që odiqën me vdekje të tmerrshme. Megjithatë, heronjtë dhe heroinat e historive do të dëshironin një reagim krejt tjetër. Ata shpresonin që sakrificat e tyre do të frymëzonin të tjerët në drejtim të një përkushtimi të tillë zemre, e jo keqardhje. Sigurisht, vdekjet e tyre prekin zemrat tona. Por realizimi i besimit tonë të vogël duhet t'i thyejë zemrat tona në dysh. Kjo është në të vërtetë e trishtueshme. A sfidohesh ti përtej keqardhjes tokësore drejt pendimit për vetëkënaqësinë tënde? A ke ti një ndjenjë hyjnore vendosmërie si rezultat i leximit? Kërkoji Perëndisë që të nxisë vendosmërinë tënde për të jetuar për të sot.

Tani po gëzohem, jo sepse u trishtuat, por sepse u trishtuar për pendim, sepse u trishtuar sipas Perëndisë, që të mos ju bëhet juve ndonjë dëm nga ne.

2 Korintasve 7:9

**Besimi nuk vlen as për emrin që ka, derisa
shpërthen në veprim**


KATERINA MARSHALL



FKSTREM

Falje ekstreme

RUMANI: DEMETRI



Demetri vuajti për shumë vite në burgjet komuniste. Ai kishte mbetur i fortë në shpirt, por trupi i tij kishte filluar të shkatërrohej. Ishte një gardian i veçantë burgu që argëtohej duke goditur shpinën e Demetrit me çekiç, e cila e paralizoi atë përgjithmonë. Por qëndrimi i tij, si i Krishtit nuk u lëkund asnjëherë dhe në fund ai u lirua nga burgju.

Njëzet vjet më vonë, ai dëgjoji një të trokitur në derën kryesore të shtëpisë së tij. Ai u trondit kur pa të njëjtin gardian burgju, i cili e kishte rrahur me kaq mizori në shpinë dhe e kishte paralizuar përgjithmonë, të qëndronte para tij. Përsëri, Demetri nuk u lëkund në shprehjen e tij të besimit.

Madje edhe më parë se Demetri të mund të ofronte ndonjë përsëritje, gardiani i mëparshëm tha: «E kuptoj se s'mund të falem asnjëherë për atë që të kam bërë. Ishte jashtëzakonisht mizore, por ju lutem dëgjojini fjalët e ndjesës sime dhe pastaj do të largohem».

Demetri qëndroi për një moment ndërsa vështronte me dhembshuri dhe habi burrin. Ai u përgjigj me butësi: «Për njëzet vjet jam lutur çdo ditë për ty. Të kam pritur. Të kam falur tashmë njëzet vjet më parë».

Nëse dëshiron të shfaqësh dashuri dhe falje ndaj të gjithëve – madje edhe atyre që na lëndojnë – atëherë dashuria e Krishtit mund të fitojë mbi gjithçka.

Shumica e njerëzve kurrë nuk do të vuajnë patjetër vuajtje të tmerrshme fizike. Megjithatë, plagët emocionale që të tjerët shkaktajnë mbi ne mund të jenë po aq shkatërruese. Kujtime të fjalëve të këqija, tradhti nga një mik, një divorc i hidhur mund të qëndrojnë me ne gjatë gjithë jetës. Ne tundohemi të mbajmë mëri, ose ndoshta të hakmerremi kundër personit që na ka lënduar. Falja nuk na vjen natyrshëm, por është e pandashme nga natyra e Zotit. Nëse keni shijuar hirin e Zotit, atëherë varuni në kërkimin e faljes nga personi tjetër në fillim. Është një veprim bindjeje, gjithashtu edhe një veprim besimi. Kërkoji Zotit të hapë zemrën tënde ndaj një mrekullie të një faljeje të vërtetë.

Duroni njëri-tjetrin dhe falni njëri-tjetrin në qoftë se ndokush ka ndonjë ankim kundër tjetrit. Sikurse Zoti ju fali ju, po ashtu bëni edhe ju!

Kolosianëve 3:13

FKSTREM

Vizitë ekstreme

EVROPA LINDORE: JON LUGAJANU

Një i krishterë i ri në Evropën Lindore, Jon Lugojanu, u kthye në burg pasi dëgjoji seancën e gjyqit. Shokët e tij të qelisë e pyetën me ankth: «Çfarë ndodhi?»

Ai u përgjigj: «Ishte si në ditën kur engjëlli vizitoi Marinë, nënën e Jezusit. Ja ku ishte ajo, një grua e re e përshtirshme e ulur vetëm në meditim, kur një engjëll vezullues i Perëndisë i tregoi lajmin e pabesueshëm. Ajo do të mbante Birin e Perëndisë në barkun e saj».

Kuriozë se si kjo histori do të lidhej me përvojën e Jonit në sallën e gjyqit, të burgosurit e tjerë dëgjonin me kujdes.

Joni vazhdoi të ndante ungjillin e paqes përmes historisë së Marisë. «Për gjithë gëzimin që Jezusi i solli, një ditë Marisë do t'i duhej të rrinte në këmbë të një kryqi dhe ta shihte të vuante dhe të vdiste për mëkatet e gjithë botës. Perëndia e ringjalli Jezusin, atje ku ai tani mbretëron në qiell. Maria e dinte se kur të ishte në parajsë, ajo do të ishte përsëri me Jezusin dhe do të përjetonte gëzim të përjetshëm».

Të burgosurit e tjerë u habitën me këtë. «Por ne të pyetëm çfarë ndodhi në gjyq», – i kujtuan ata Jonit.

Joni i pa dhe teksa fytyra i ndriste nga paqja tha: «Më dhanë dënim me vdekje. A nuk është ky lajm i bukur?» Joni e kuptoi që lajmi që engjëlli i kishte dhënë Marisë ishte po aq i hidhur sa dhe i ëmbël – pasi Jezusi kishte vuajtur, do të kishte gëzim në qiell. Ai përshpejtoi gëzimin e tij në praninë e Jezusit.

Në shumë kultura vdekja është një temë tabu. Njerëzit shpesh shkojnë aq larg, sa e izolojnë veten nga pashmangshmëria e vdekjes së tyre. Ata pëlqejnë të përdorin shprehje si «ndërroi jetë» në vend të «vdiq». Ne ngurrojmë të lëmë një testament apo të blejmë siguracionin e jetës duke menduar: «Kjo nuk do të më ndodhë kurrë mua». Kompanitë kanë përfitime të mëdha duke na shitur produkte, që premtojnë rini të përjetshme». Zoti nuk na e jep zgjedhjen e të shpërfillurit të vdekjes, por na jep çelësin për ta përballuar atë. Engjëlli vizitor i Marisë nuk e shmangu thënien që ajo do të vuante një pikëllim të madh në kryq. Megjithatë, asaj iu dha shpresa e ringjalljes për ta bërë pikëllimin e saj më të durueshëm. Si të krishterë, premtimi i Zotit për jetën e përjetshme na ndihmon ta pranojmë vdekjen tonë me realizëm dhe kurajë.

Por shohim Jezusin të kurorëzuar me lavdi dhe me nder për vdekjen që pësoi; ai u bë për pak kohë më i vogël se engjëjt, që me hirin e Perëndisë të provonte vdekjen për të gjithë njerëzit.

Hebrenjve 2:9

FKSTREM

Mbrojtje ekstreme

RUSI: GEORGE JELTONOSHKO

Georg Jeltonoshko e dinte që qeveria e tij nuk donte që njerëzit të propagandonin ungjillin e Krishtit, por ai kishte një bindje më të fortë për t'iu bindur urdhërimeve të Krishtit – madje edhe nëse kjo ishte në konflikt me ligjet e vendit të tij.

Nuk ishte një surprizë e madhe për të kur policia i erdhi në derë. Ai e kuptoi që ishte e pashmangshme që ata do të zbulonin aktivitetin e shërbesës së tij për shkak të literaturës që shpërndante. Kur data e gjyqit u afrua, atij iu caktua një avokat komunist nga shteti. Georgu i tha me guxim gjykatësit: «Nuk dua avokat. E ndiej që kam të drejtë dhe drejtësia nuk ka nevojë për mbrojtje».

Gjykatësi e pyeti: «A shpall fajësinë?»

Ai u përgjigj: «Jo. Të shpërndash lajmin e mirë të dashurisë së Perëndisë është detyrë e të gjithë të krishterëve».

Gjykatësi pastaj i kërkoi të bashkohej me rangjet e «kishave zyrtare», të cilat nuk ishin më shumë se kisha kukulla të drejtuara nga shteti, por Georgu refuzoi. Kisha e shtetit ndiqte urdhërimet e shtetit, jo ato të Zotit.

Gjykatësi po nervozohet. «Ku takoheni për adhurim?» – pyeti ai.

Georgu u përgjigj: «Besimtarët e vërtetë adhurojnë kudo».

Ai u dënua me tre vjet në burg ku vazhdoi të kryente detyrën e tij dhe të adhuronte. Ai kishte të drejtë. Drejtësia nuk kishte nevojë për mbrojtje.

Të bësh «gjënë e duhur» duket si një moto e njohur. Është më e lehtë të thuhet sesa të bëhet sepse çfarë është e drejtë në sytë e Zotit bie shpesh në konflikt me besimin e njohur. Diskutimi midis së drejtës dhe së gabuarës bëhet shpesh i dukshëm në një klasë, në një zyrë pune dhe madje, edhe në një dhomë gjumi apo kishë. Ne s'mund të mbështetemi në mjedisin tonë për të na treguar çfarë është e drejtë. Njerëzit mund të na bindin të ngatërrojmë kompromisin me drejtësinë. Fjala e Perëndisë është mbrojtja e vetme për të përcaktuar çfarë është e drejtë në çdo situatë. Të tjerët mund të mos na kuptojnë apo të bien dakord me zgjedhjet që bëjmë. Megjithatë, Zoti premtan që ta nderojë përkushtimin tonë ndaj bërjes së asaj që është e drejtë. Ata që na vëzhgojnë do të shohin dritën dhe do të ndiejnë ngrohtësinë e veprimeve tona të drejta.

*Lëshoje në dorë të Zotit fatin tënd,
shpreso në të dhe ai do të kryejë gjithçka.
Do të bëjë të shndrisë si drita drejtësia
jote, të drejtën tënde porsì mesdita.*

Psalmi 37:5-6

«Me flakët e zjarrit të dashurisë që Jezusi ndezi në zemrën time, bëra që akulli i Siberisë të shkrinte. Haleluja!»

Fytyra e peshkopit Viktor Belih ndriti ndërsa tha këto fjalë. Ai kishte mësuar sekretin e fuqishëm të të lejuarit Zotin të marrë kontroll të zemrës, madje edhe në situatat më të këqija. Për dyzet vjet ai kishte vuajtur në qelinë e vetmuar të burgut në Rusinë komuniste pa një vizitë, lajme nga familja apo miq.

Çdo mbrëmje, një dyshek i thjeshtë kashte vendosej në një qeli të vogël. Ai lejohej të flinte për shtatë orë para se dysheku t'i hiqej. I kalonte shtatëmbëdhjetë orët e mbetura çdo ditë duke ecur përçark në hapësirën e tij të vogël patetike dhe nëse ndalonte apo binte, rojat do ta rrihnin ose do të hidhin ujë mbi të derisa të vazhdonte. Pas njëzet vjetësh vështirësish të pabesueshme, ai u dërgua në një kamp me punë të detyrueshme për katër vite të tjera në Siberinë veriore, ku akulli nuk shkrin asnjëherë. Mbijetoi vetëm sepse lejoi zjarrin e Zotit të shkrinte të gjithë hidhërimin dhe zemërimin.

Situata e Belihut është e rrallë, por vendosmëria e tij nëpërmjet Jezu Krishtit është e disponueshme për çdo njeri që vuan. Jezusi mbajti ndezur zjarrin e dashurisë në zemrën e Belihut – një furrnaltë e devotshme që ishte në gjendje ta mbante atë të ngrohtë për njëzet vjet.

Zjarri. Thjesht fjala ndez imazhe të fuqishme. Ai nënkupton rrezikun kur thirret në një ndërtesë të populluar, mishëron rehatinë kur je në një natë ngrice. Ai është i lidhur me emocione të forta gjatë «nxehtësisë» së momentit, apo një karakteri të «zjarrtë». Zjarri përdoret edhe për të pastruar dhe për të forcuar metalet nëpërmjet procesit të rafinimit. Zjarri eliminon dhe përpin errësirën. Në të gjitha këto imazhe, një gjë mbetet konstante. Zjarri është i lidhur me ndryshimin. Ashtu si një takim me zjarrin, takimi me Perëndinë është jetëndryshues. A të ka mbajtur, rafinuar, qetësuar dhe përfundimisht të ka çliruar dashuria e zjarrtë e Krishtit, siç bëri me Belihun? Mizoria njerëzore nuk mund të shuajë kurrë flakët e dashurisë së Zotit. A është flaka e dashurisë së Zotit e gjallë në ty?

Vërtet, Perëndia ynë është zjarr që përpin!

Hebrenjve 12:29

Reputacion ekstrem

JERUZALEM: JAKOBI

Jakobi, «I drejti» shërbeu me besnikëri si kreu i kishës së sapolindur pas ringjalljes së Jezusit. Asnjë jobesimtar s'mund të duronte predikimet e tij pa u kthyer në besim ose pa u larguar nga prania e tij.

Për këtë arsye, kryepriifti dhe drejtues të tjerë judenj e vendosën Jakobin në majë të tempullit dhe i thanë të mohonte Jezusin dhe ringjalljen e tij para të gjithë njerëzve të mbledhur, përndryshe do të hidhej në tokë. Kjo i dha Jakobit edhe një mundësi tjetër për t'i predikuar një publiku mosdashës?

«Dëgjoni të gjithë ju njerëz! Jezusi është Mesia i premtuar, Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtari ynë! Ai është i ulur në të djathtë të Perëndisë dhe do të vijë përsëri për të gjykuar të gjallë e të vdekur!»

Poshtë, disa filluan të lavdëronin Zotin dhe të ngrinin lart emrin e Jezusit, të tjerët u mahnitën me guximin dhe bindjen e tij. Ai sigurisht ishte njeri i drejtë! Menjëherë, e shtynë në buzë – duke e rrëzuar me vdekje të sigurt.

Turma pushoi; pastaj dikush thirri: «Shiko! Ai jeton!» Jakobi nuk vdiq, por më tepër ishte ulur në gjuhë në lutje. Shumë kishin marrë gurë për ta goditur, kur njëri prej priiftërinjve nxitoi dhe iu lut: «Çfarë po bëni? »I drejti« po lutet për ne dhe ju doni ta vrisni?» Ndërsa tha këtë, një tjetër erdhi pas tij me një shkop të madh dhe e goditi Jakobin në kokë duke e vrarë menjëherë. Ai u varros në vendin ku kishte rënë.

Pas çdo ngjarjeje që dikush lexon në histori ka një ndodhi. Nuancat dhe ndjenja e situatës mund të kenë humbur, por është mjaft e lehtë t'i imagjinosh ato nga faktet e historisë së shkruar. Ky tregim për Jakobin kap esencën e personalitetit dhe dëshmisë së tij të sinqertë për Jezusin. Ata që e njihnin mirë atë, njihnin përkushtimin e tij ndaj Krishtit. Ata që nuk e kishin njohur, kishin dëgjuar për reputacionin e tij si predikues kurajoz. Vdekja e tij është një dëshmi e një besimi të palëkundur në Krishtin. Historia e krishterë dëshmon besnikërinë e ndjekësve të Krishtit me të dhëna të padiskutueshme. Çfarë ka për të thënë historia për ty? Çfarë historie do të duash që brezat të thonë për besimin tënd?

Prandaj, edhe ata që vuajnë sipas vullnetit të Perëndisë, le t'i besojnë shpirtat e vet atij, si te Krijuesi besnik, duke bërë të mirën.

1 Pjetrit 4:19

FKSTREM

Pagëzim ekstrem

SLLOVAKI: ANAMARIA

Anamaria, një e krishterë e re sllovae, ishte në burg për muaj të tërë për shkak të ndërlimit me një kishë klandestine. Atë e sollën rregullisht në një dhomë, ku roja e kishte zakon ta rrihte për të marrë informata për besimtarë të tjerë që ishin anëtarë të kishës.

Me hirin e Perëndisë, ajo mund t'i rezistonte presionit, madje edhe i përdorte këto raste për t'i treguar rojës për dashurinë e Jezusit. Roja i tha me tallje: «Në qoftë se nuk m'i thua të fshehtat e kishës klandestine, do të të rrah derisa të më tregosh për të gjithë dashnorët e tu».

Anamaria iu përgjigj: «Kam një të dashur, i cili është më i ëmbli. Dashuria e tij nuk kërkon kënaqësi, por kërkon t'i mbushë të tjerët me gëzim. Qysh nga momenti kur u njoha me të dashurin tim, edhe unë vetëm mund t'i dua të tjerët. Juve ju pëlqen urretja tani, por ju lutem të pëlqeni dashurinë».

Roja u zemërua aq shumë sa që e qëlloi derisa i ra të fikët. Kur ajo erdhi në vete, e pa duke ndenjur të qetë e zhytur në mendime. Në fund ai pyeti: «Kush është ai i dashuri yt? Anamaria i tregoi për Jezusin dhe përse erdhi në tokë».

Kur e pyeti si të bëhej edhe ai mik i Jezusit, ajo i tha se duhej të pendohej dhe të pagëzohej. Atëherë më pagëzoni menjëherë, ndryshe do t'ju pushkatoj, e urdhëroi roja të renë sllovae.

Më vonë Anamaria e pagëzoi atë në emër të Jezusit dhe ai u bë i burgosur bashkë me ata që dikur e kishte zakon t'i rrihte.

Kur njerëzit bien në dashuri, u tregojnë me ëndje të gjithëve. U tregojnë familjeve të tyre, fqinjve dhe kujdo tjetër që është gati ta dëgjojë. Dashuria i kaplon aq sa duhet patjetër të flasim për të dashurin e tyre. Në po këtë mënyrë, pagëzimi i besimtarit është shpallje publike e vetidentifikimit me Jezusin dhe me shoqërinë e tij se besimtari është i dashuruar me Jezusin. Pagëzimi i të rriturit është shenjë drejtuar të gjithë dëshmitarëve të këtij zotimi – madje edhe nga ana e një të burgosuri tjetër në qeli – se besimtari është gati ta ndjekë Jezu Krishtin me çdo kusht. Dashuria jonë për Krishin na motivon ta shpallim zotimin tonë para të gjithëve. A jemi të frikësuar apo të rezervuar, a kemi zemër të tregojmë për dashurinë tonë për Jezusin?

Kuptimi i pagëzimit nuk është pastrimi i trupit nga ndyrësia, por zotimi i dhënë para Perëndisë për të mbajtur një ndërgjegje të pastër.

1 Pjetrit 3:21

Besimi nuk është kurrë pasiv. Ai kërkon një reagim, një mision. Ai tregon praninë dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë që banon te besimtari.

PASTOR RIÇARD VURMBRAND



FKSTREM

Kurajë ekstreme

RUMANI: NJË NËNË E BIJË

Të gjithë të burgosurit u trishtuan kur panë një vajzë të vogël në burg me nënën e saj. Madje edhe drejtori i burgut tha: «Si, nuk të vjen keq për vajzën tënde? Nëse ti heq dorë së qeni e krishterë, mund të shkoni të dyja në shtëpi».

Gruaja, natyrisht që u thye përbrenda. Ajo ishte burgosur me vajzën e saj, pasi protestoi për arrestimin e pastorit të saj, por ra dakord të mohonte besimin për të ruajtur vajzën nga vuajtjet. Dy javë më vonë, komunistët e detyruan të thërriste nga një skenë para dhjetë mijë vetave: «Nuk jam më e krishterë».

Kur po ktheheshin në shtëpi, vajza e vogël u kthye nga e ëma dhe i tha: «Mami, sot Jezusi nuk u kënaq me ty». Mamaja u përpoq të shpjegonte se e bëri këtë nga dashuria. Vajza e vogël pa drejt së ëmës me bindje shumë të fortë për moshën e saj: «Premtoj se, nëse shkojmë përsëri në burg për Jezusin, unë nuk do të qaj».

E ëma qau, e mbushur me krenari dhe dashuri për të bijën dhe me bindje për dobësinë e vet. Ndërsa ajo i thërriste Perëndisë për fuqi në një vendim të vështirë, u kthye te drejtori i burgut dhe tha: «Ju më bindët të mohojta besimin tim për hir të vajzës sime, por ajo ka më tepër kurajë se unë». Të dyja u kthyen në burg dhe vajza e vogël e mbajti premtimin e saj.

Jozueu i izraelitëve u përball me një sfidë të vështirë – Të merrte popullin e zgjedhur të Perëndisë atje ku e la Moisiu dhe të vazhdonte më tej. A ishte e rrezikshme? Pa dyshim. A ishte Jozueu i frikësuar? Ndoshta. Jozueu mori premtimin e Perëndisë që do të ishte gjithnjë me të, duke i dhënë Jozueut të njëjtën siguri si fëmija në histori. Si Jozueu, ashtu edhe fëmija e kuptuan shumë herët në jetën e tyre që do të kishin nevojë për praninë e Perëndisë për t'ia dalë mbanë. Perëndia na urdhëron të pajisemi me kurajë dhe njohurinë që ai kurrë nuk do të na braktisë. Përballë vështirësive, kuraja shpesh zhduket. Në kohët e vështirësive, vendos t'i besosh premtimit të Perëndisë që ai do të jetë me ty. Ji i bindur dhe me kurajë sot.

Pse, a nuk të kam urdhëruar: »Ti vetëm ji burrë i fortë e ki guxim! Mos u tremb, as mos ki frikë, sepse me ty së bashku është Zoti, Perëndia yt, në të gjitha ndërmarrjet e tua.»

Jozueu 1:9

FKSTREM

Këshillë ekstreme

SHQIPËRI: Valeri Nasaruk

Në Shqipëri, shteti i parë i vetëdeklaruar ateist në botë, një i krishterë i ri i quajtur Valeri Nasaruk, u arrestua sepse me guxim kishte bërë një kryq-tatuazh në dorën e tij. Ai donte që të gjithë ta dinin që në momentin e parë të takimit me të, se qëndronte në besimin e tij në Zotin. Megjithatë Valeri ishte i zhgënjyer që nuk lejohej t'u tregonte me fjalë të tjerëve për dashurinë e Zotit.

Në gjyq, gjykatësi iu drejtua nënës së Valerit: «Thuaji djalit tënd të ndërrojë rrugë, që të mund të lirohet».

Ajo mendoi për pak çaste, para se t'i përgjigjej me lot në sy: «Valeri, këshilla ime për ty është të qëndrosh i fortë dhe të mos e mohosh Krishtin, edhe nëse kjo do të thotë vdekje për ty».

Në një letër të mëvonshme kishës së fshehtë, ajo shkroi: «Unë ndoqa gjyqin, gjë që ishte shumë e vështirë për mua. Do të doja të kisha zënë vendin e tij. Gjëja më e vështirë ishte kur më kërkuan në gjyq që të këshilloja Valerin të ndërronte rrugë, por s'mund ta bëja. Bota na akuzon neve, prindërve të tij për dënimin e tij, duke thënë se ishte rezultat i ndikimit tonë. Madje edhe disa të krishterë s'mund ta kuptojnë pse bëra atë që bëra, por pastaj m'u kujtua se edhe Jezusin e keqkuptuan. Kur luftoj me trishtimin e thellë, kujtohem se Pjetri e këshilloi Jezusin që të shpëtonte jetën e tij. Zoti më jep mua fuqi për të përballuar çdo gjë. Ju lutem, lutuni për mua».

Zoti na do dhe ka plane të mrekullueshme për jetën tonë. Problemi është se edhe gjithë të tjerët kanë plane për ne. Bëj këtë, mos bëj atë, provo këtë. Fjalët e këshillave janë të lira dhe të bollshme. Megjithatë vjen koha kur fjalët janë të kushtueshme. Sa herë që një besimtar tjetër na inkurajon të vazhdojmë me thirrjen e Zotit në jetën tonë pavarësisht nga pasojat, ne e dimë që e kemi dëgjuar nga një person i devotshëm. Çdo gjë tjetër, edhe nëse është me synim të mirë, është këshillë e keqe. Kë dëgjon për drejtim shpirtëror? Sill ndërmend këshillën e fundit shpirtërore të një miku të besuar. Sa mirë e ke ndjekur atë këshillë?

Sa për mua, mos ndodhtë kurrë që unë të mburrem me tjetër gjë, veç për kryqin e Zotit tonë Jezu Krisht, për të cilin bota është kryqëzuar tek unë dhe unë te bota.

Galatasve 6:14

«Unë pastrova zemrën time nga frika e njerëzve dhe mësova të shoh Zotin.»

Me Ling ishte e re kur u arrestua për aktivitetet e saj të krishtera në Kinën komuniste. Gjatë kohës së pyetjeve, policia e torturonte që ta detyronte të tradhtonte miqtë e saj në kishën e ishehtë.

Në fillim Ming Ling kishte jashtëzakonisht frikë dhe nuk mund ta shihte qëllimin që Zoti kishte për të në atë vend të tmerrshëm, por kujtoi mësimet e pastorit të saj që kishte thënë: «Vuajtjet e vërteta zgjasin vetëm një çast dhe pastaj ne do të kalojmë përjetësinë me Shpëtimtarin tonë të mahnitshëm».

Kur u pyet se si ishte në gjendje të mos çmendej gjatë atyre kohëve të tmerrshme, ajo u përgjigj: «Kur mbyllja sytë, s'mund t'i shihja fytyrat e zemëruara të njerëzve apo instrumentet e dhimbjes që ata përdornin. I përsërisja vetes premtimin e Krishtit: «Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë» (Mateu 5:8). Gjithashtu zbulova se kur pastrova zemrën time nga frika e njerëzve, mësova ta shihja me të vërtetë Zotin. Mora kurajë nga të gjithë të tjerët që kishin shkuar para meje dhe u fokusova tek Ai derisa çdo gjë tjetër venitej. Kur oficerët morën vesh mbrojtjen time, mundoheshin të më mbanin sytë hapur, por ishte shumë vonë sepse vizioni im ishte i sigurt».

Ne i admirojmë njerëzit, profesionit i të cilëve kërkon shumë përqendrim dhe fokus. Neurokirurgët e aftë, atletët olimpikë, veprimtarët e ndërmarrjeve të mëdha kanë një tipar të përbashkët. Ata janë të fokusuar. Disiplina e fokusit ia kalon inteligjencës, shkathtësisë atletike apo karizmës. Pa fokus, këta njerëz do të ishin thjesht të zgjuar, atletikë ose më e shumta interesante. Aftësia e tyre për të qëndruar të fokusuar kontribuon shumë në suksesin e tyre. Të zhvillosh një fokus tokësor mund të sjellë një sukses tokësor, por po çështja e përjetësisë? Nëse je më tepër i fokusuar në gjërat e përkohshme të kësaj bote do të humbasësh qëllimin. Çfarë mund të bësh sot për t'u siguruar që je i fokusuar te Krishti dhe në shpërndarjen e lajmit të mirë të tij?

Dëshironi gjërat që janë lart e jo këto përmbi tokë!

Kolosianëve 3:2

Gazeta sovjetike «Molodoj Gruzii», raportoi burgosjen e tre të krishterëve. Krimi i tyre ishte një letër zinxhir i organizuar për të ndihmuar njerëzit në të gjithë Bashkimin Sovjetik për të kuptuar mësimet e Jezu Krishtit.

Duke mos qenë në gjendje të botonin bibla apo libra të krishterë, ata kishin filluar të dërgonin kopje të panumërta të këtyre letrave dhe u kërkonin marrësve të bënin kopje dhe t'i kalonin ato tek të tjerët. Nëpërmjet kësaj metode krijuese të shpërndarjes së ungjillit, mijëra letra kishin arritur në shumë zona të Bashkimit Sovjetik.

Veçanërisht ato i pëlqenin fëmijët, sepse ata nuk lejoheshin të ndiqnin një kishë dhe letrat u bënë një pjesë integrale e mësimëve të tyre të krishtera.

Përveç kësaj, këto letra ndihmonin për të mbështetur besimin e krishterë në të gjithë vendin gjatë asaj kohe. Pas viteve të shtypjes nga qeveria dhe ndërhyrjes në kishat e tyre, ata ishin gati për të provuar diçka të re dhe të guximshme. Ata sinjerisht donin që të gjithë të njihnin dashurinë e Zotit dhe pavarësisht nga kufizimet që u ishin vendosur, thjeshtësia e tyre e shkëlqyeshme lejonte mesazhin të shpërndahej në të gjithë qytetin e Tbilisit dhe madje edhe në disa zona të Ukrainës!

Në një artikull tjetër gazete thuhej: «Të krishterët kanë përmblytur qytetin me shkrimet e tyre». Ajo e përshkruante këtë përpjekje të koordinuar si «një fyerje nga ana e besimtarëve».

Kush mund ta parashikonte efektin e arritjes thjesht nga një letër zinxhir!

*Pas pesëdhjetë vjetësh tiranie kundër krishterimit, zyrtarët sovjetikë u ndjenë të kërcënuar nga një letër zinxhir. Përgjigjja e tyre frikacake tregon fuqinë që ka Fjala e Zotit. Shtypja nuk shteron përpjekjet njerëzore, ajo nuk zbutet me ndjenjat e keqardhjes, i reziston vetëm Fjalës së fuqishme të Zotit – e gjallë dhe aktive në jetën e besimtarëve. Satani dridhet nga fuqia që ka Fjala e Zotit. A jemi të vetëdijshëm për fuqinë që ka **sa janë edhe kundërshtarët e saj**? Nëse ka një kohë të gjatë që kur s'ke përjetuar mahnitje kur lexon Shkrimin, kërkoji Perëndisë një mundësi të dytë. Kërkoji atij të të tregojë fuqinë dhe të përjetosh efektin e Fjalës në jetën tënde sot.*

Gjithnjë, o Zot, fjala jote është e qëndrueshme në qiell.

Psalmi 119:89

FKSTREM

Vullnetar ekstrem

KINË: MOTËR KUANG

Pasi kërkonin shumë orë punë të vështirë dhe duke ofruar një dietë gati vdekjeprurëse, rojat e burgut kinez kërkuan dikë që të vullnetarizohej të pastronte çdo ditë banjat. Asnjë prej grave të burgosura nuk foli.

Më në fund, motër Kuang doli një hap përpara dhe u vullnetarizua të bënte punën e rëndomtë. Ajo e pa këtë si një mundësi të rëndësishme për t'u treguar grave në burg për besimin e saj, të cilat nuk mund t'i takonte ndryshe. Gjatë kohës që qëndroi në atë burg, ajo drejtoi qindra gra te Krishti.

Përkushtimi i Kuangut ishte i dukshëm për të gjithë ata që e njihnin, por kjo erdhi përmes shumë vuajtjeve. Para burgimit të saj, ajo dhe bashkëshorti i saj ishin vullnetarizuar të organizonin një grup ungjillizimi, i cili do të udhëtonte përreth Kinës duke formuar kisha të vogla shtëpi.

Kur zyrtarët komunistë zbuluan aktivitetet e Kuangut, ata e rrahën për vdekje djalin e saj dymbëdhjetëvjeçar. Dhe sërisht ajo refuzonte të mohonte Krishtin duke vazhduar të ndërtonte lëvizjen kishë-shtëpi pas lirit të saj.

Më në fund në vitin 1974, komunistët vendosën ta bënin një shembull «Nënë Kuangun», siç e njihnin atë anëtarët e kishës. Ajo u dënua me burgim të përjetshëm, u vu në një qeli të nëndheshme me një kovë për nevojat sanitare dhe ushqehet vetëm me oriz të ndotur.

U lirua në mënyrë të mrekullueshme pas dhjetë vjetësh dhe gjithmonë e shihte kohën

e saj në burg si dhuratë – një mundësi e veçantë për të ndarë dashurinë e Krishtit me njerëz që, përndryshe nuk do të kishin dëgjuar kurrë.

Vullnetarizmi është pothuajse një punësim profesional për disa persona. Ata vullnetarizojnë në shkollën e fëmijëve të tyre, ndihmojnë në mbrëmjet mësues-prindër dhe në stërvitjen e skuadrës së futbollit të fëmijëve të tyre. Vullnetarizmi për mundësi jo shumë të njohura mund të jetë një sfidë. Shpesh shpirti i vullnetarit nuk gjendet asgjëkund. Azilet, jetimoret dhe strehë të ndryshme janë vendet e fundit ku njerëzit duan të kalojnë kohën e tyre; era, mjedisi trishtues apo çrregullime të tjera i mbajnë larg. Por, ku mendon se do ta kalonte Jezusi pjesën më të madhe të kohës së tij? Pothuajse çdo pozicion vullnetari përfshin punë të nevojshme dhe të admirueshme, por dëgjo me kujdes për mundësi më pak të kërkuara dhe me ata më të paafatët. Përpiku të jesh i pari që të vullnetarizoheni herën tjetër në ndihmë të dikujt që gjendet në rrugën tënde.

Dhe çdo gjë që të bëni, me fjalë a me vepër, t'i bëni në emër të Zotit Jezus, duke e falënderuar Perëndinë Atë nëpërmjet tij.

Kolosianëve 3:17

Edhe kur pastori rumun, Riçard Vurmbrand, u vendos në një qeli të vetmuar burgu pa dritë dhe tingull, vazhdoi të predikonte për një auditor që nuk e shihte.

Pas liritimit të tij të mrekullueshëm nga burgu dhe emigrimit të tij në Shtetet e Bashkuara, pastor Vurmbrandi shkroi disa libra që përshkruanin përvojën e tij të burgut dhe predikimet që shkruante dhe mësonte ndërsa ishte në izolim. Pas disa vitesh ai mori këtë letër:

«I dashur pastor Vurmbrand!

Unë jam rritur në një shtëpi të devotshme, por devijova nga rruga dhe në fakt përfundova në burg në Kanada. Doja të kthehesha te Zoti, por nuk dija se si, kështu u luta: «Zot, nëse dikush në botë është një i burgosur i vetmuar që të njeh ty, të lutem, më sill mendimet e tij». Dëgjova një zë të brendshëm që më thoshte të qëndroja në qetësi dhe me besim se Zoti do të më arrinte.

Në mënyrë të mrekullueshme, natë pas nate fillova të dëgjoja një lloj predikimi që dukej se vinte prej së largu. Unë u pendova dhe pas liritimit tim nga burgu ndesha në një librari të krishterë me librin tënd *Predikime në një izolim të vetmuar*. I njoha menjëherë se ishin të njëjtat që dëgjoja në burg. Faleminderit që i ke dhënë!»

Pastor Vurmbrandi mori dy letra të tjera nga vende të ndryshme që përmbanin pothuajse të njëjtën histori. Në të vërtetë engjëjt ua kishin çuar predikimin të tjerëve që i thërrisnin Zotit.


Thuhet se të krishterët i lënë shpesh engjëjt pa punë për shkak të mungesës së tyre të besimit. Shumë shpesh të krishterëve nuk u mjafton të jetojnë jetë të mira me bekime të vazhdueshme. Por Zoti dëshiron të na japë më tepër sesa është e mirë për ne. Ai dëshiron të na japë gjëra më të mira, madje më të mirën; megjithatë, ai ka rezervuar bekimet më të mira për ata që kërkojnë me besim. Pse duhet t'i kërkojmë Zotit kur ai tashmë i di nevojat tona? Ne duhet të kërkojmë me besim për të treguar varësinë tonë tek ai. A ke qenë i kënaqur me gjërat e mira që Zoti të ka dhënë? Pastaj kërko me besim për më të mirën. Mos kërko gjë tjetër veçse më të mirën për jetën tënde.

...por ju nuk keni, sepse nuk kërkon.

Jakobi 4:2

Nëse i gjithë njerëzimi do të kishte qenë i drejtë dhe vetëm një njeri mëkatar, Krishti do të kishte ardhur për të duruar të njëjtin kryq vetëm për këtë njeri. Ai do çdo individ.

SHËN AUGUSTINI



«Frikacak ekstrem»

TARSI: GJON MARKU

«Ai s'mund të vijë me ne!» – këmbënguli Pali. – «Ai është frikacak dhe nuk është i dobishëm për shërbesë».

Barnaba u përgjigj: «Ti mund të kesh hequr dorë prej tij, por Zoti jo».

Pali ishte akoma i vendosur. «Ti s'mund të detyrosh dorën time, Barnaba. Unë mund të marr vetëm njerëz tek të cilët mund të mbështetem. Ai nuk është i mirëpritur në këtë udhëtim për të ndarë besimin».

«Atëherë as unë nuk jam. Është vendimi yt, Pal. Zoti ta ka dhënë ty drejtimin e udhëtimit. Le të nisemi në paqe. Kur kisha kishte frikë nga ti, me hirin e Zotit erdha unë dhe u tregova që ti do të bësh një punë të mrekullueshme për mbretërinë e Zotit. Zoti ka të njëjtën thirrje për Gjon Markun».

Pali hezitoi. «Le të jetë kështu atëherë. Shpresoj të kesh të drejtë, miku im i vjetër, megjithëse s'mund ta besoj». Kështu Pali dhe Barnaba u ndanë.

Në fakt, Pali dhe Gjon Marku përfunduan në të njëjtin burg në Romë dhe Palit iu duk miku i ri me vlerë të vërtetë në Krishtin si një shërbëtor besnik. Gjon Marku ka shkruar ungjillin sipas Markut dhe e vërtetoi që s'ishte një frikacak ndërsa ai dhe Pali përballeshin me rreptësinë e përditshme të burgut. Përmes kohëve të vështira, Marku qëndroi i palëkundur dhe këtë Pali e bëri të njohur në letrën drejtuar Timoteut shumë pak para vdekjes së tij.

Veprat 15:35-41:2 Timoteut 4:11

Zoti shpesh sjell situata provuese në rrugën tonë për të treguar një nga dy të vërtetat. Ai do të përdorë sprovat për të nga treguar se sa larg kemi shkuar në zhvillimin tonë të krishterë ose do të lejojë probleme në jetën tonë për të treguar saktësisht se ku mund të rriteshim më tepër. Transformimi i Gjon Markut nga një frikacak në pamje të parë, në një ndjekës të përkushtuar na kujton se rritja shpirtërore është një proces. Ne mund të theksojmë dështimet e së shkuarës, aty ku do të donim të kishim qenë më të fortë. Por veprimet e së shkuarës nuk duhet të ndikojnë në të ardhmen tonë. Si Marku, a ke nevojë për një mundësi të dytë për të treguar përkushtimin tënd ndaj Krishtit? Lutu për mundësitë që do të të ndihmojnë të rriteni shpirtërisht.

*Merre Markun dhe sille me vete,
sepse e kam shumë të dobishëm për
shërbesë.*

2 Timoteut 4:11



«Qëllojini dhe do t'ju lejojmë të jetoni!»

Pastori kishte bërë një marrëveshje me komunistët në burgun e krishterë ku ata mbaheshin, por dy vajzat e krishtera qëndronin para tij dhe ishin të bindura të mos mohonin besimin e tyre. Një i burgosur tjetër, i cili po shihte skenën e tmerrshme i përshkroi fytyrat e tyre si të zbehta, por të bukura sa s'thuhet – jashtëzakonisht të trishtuara, por të ëmbla. Ato ishin të vendosura të përballeshin me vdekjen sesa t'i kthenin shpinën Krishtit.

Pastori arsyetoi: «Pse duhet të vdesim që të tre? Nëse ju vras ju dhe ata më lejojnë të jetoj, atëherë mund të vazhdoj të punoj midis kishave».

Vajzat i folën butësisht: «Para se të na qëllosh, ne duam të të falënderojmë për rëndësinë që kishë për ne. Ti na drejtove te Krishti, na pagëzove dhe na dhe Darkën e Zotit. Zoti të shpërbleftë për të gjitha të mirat që ke bërë. Ti na ke mësuar gjithashtu që të krishterët ndonjëherë janë të dobët dhe kryejnë mëkate të tmerrshme, por mund të falen përsëri. Kur t'ju vijë keq për atë që do të na bësh neve, mos u dëshpëro si Juda, por pendohu si Pjetri. Dhe mbaj mend se mendimet e fundit për ty nuk janë mendime urretjtjeje dhe zemërimi, por dashurie dhe faljeje. Ne të gjithë kalojmë nëpër kohë errësire. Ne vdesim me kënaqësi».

Por zemra e pastorit tashmë ishte ngur-tësuar dhe i qëlloi ato. Menjëherë pas kësaj, komunistët i qëlluan atij.

Njerëzit që përballeshin me pamjen e një vdekjeje të papritur, vënë re që mendimet e tyre shkojnë drejt miqve dhe familjarëve ose ëndrrave të papërbushura. Disa kujtojnë që «jeta u shfaqet para syve». Megjithatë, ky kujtim ka të ngjarë të ndërpritet për ata që bien viktima të një tradhtie të paparë – të vriten nga dikush që e konsideronin mik. Zemërimi, hidhërimi dhe urretjtja për të ashtuquajturin mik do të dukej e justifikueshme. A mund të ndërhyjë falja këtu? Si të krishterë, ne duhet të vendosim ta zgjerojmë faljen në çdo rrethanë, madje edhe në ato ku përfshihet jeta apo vdekja. Si vajzat në tregim, reagimi yt ndaj një tradhtie shfaq një predikim efektiv. Si mundet që vendimi yt për të falur t'i tregojë rrugën Jezusit për dikë që njihni?»

Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.

Efesianëve 4:32

FKSTREM

Mburojë ekstreme

PAKISTAN: TAHIR IKBAL DHE RAJMOND LULI

«Unë do të uth litarin, por s' do ta mohoj besimin tim!» – thirri Tahir Ikbali. Ushtarët e ngritën pastorin paralitik nga karroca e tij me rrota dhe i vendosën lakun rreth qafës. Sot ai ecën lirshëm në parajsë me Krishtin.

Në Pakistan, një tjetër pastor i moshuar dëgjoji një të shtënë pikërisht jashtë shtëpisë së tij. Plumbi i fshikulloi një qime larg dhe u ngul në mur pas karriges së tij. Ai falënderoi Zotin për një ditë tjetër që të mund të shpallte Krishtin në një shtet të dominuar nga myslimanët.

Rajmond Luli la një pozicion të rehatshëm si profesor në Oksford dhe kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij duke vuajtur për ungjillin. Ai shkroi: «Një herë kam qenë i pasur dhe shijoja lirshëm kënaqësitë e kësaj jete, por hoqa dorë me gëzim që të mund të shpërndaja njohurinë e së vërtetës. Kam qenë në burgje; më kanë fshikulluar me kamxhik... tani, megjithëse i moshuar dhe i varfër, nuk dëshpërohem; jam gati, nëse është vullneti i Zotit, të këmbëngul deri në vdekje».

Besimtarë të tillë kanë kuptim unik të termit «mburojë besimi». Ata e kuptojnë se kjo nuk do t'i mbrojë patjetër nga vuajtjet, por u ka dhënë kurajë për t'i përballuar ato nëse është e nevojshme. Mburoja e besimit u dha vendosmërinë për të vazhduar betejën shpirtërore për Krishtin, pavarësisht se cili është çmimi i saj këtu në tokë.

Një armaturë e shekullit të parë përfshinte një mburojë në një dorë dhe një shpatë në tjetrën. Me njërën, ushtarët mund të përparonin kundër armiqve të tyre. Me tjetrën, ata shkonin në mbrojtje. Po për armaturën e betejës sonë shpirtërore, a do të gjenim një «mburojë besimi» të pluhurosur, të vendosur atje në një qoshe? Kur dalim nga mbrojtja që Zoti na ofron nëpërmjet mburojës së besimit, bëhemi të prekshëm ndaj sulmeve të armikut tonë. Pa besim, është e pamundur të shmanget frika dhe dekurajimi. Ne ndalojmë së shpërndari ungjillin në shenjë e parë të kundërshtimit. Çfarë të ka mbajtur larg ndarjes së ungjillit në sferën tënde të ndikimit? Ku duhet ta vringëllosh mburojën tënde të besimit në mes të kundërshtimeve të frikshme?

...mbi të gjitha, duke marrë mburojën e besimit, me të cilën mund të shuani të gjitha shigjetat e zjarra të të ligut.

Efesianëve 6:16

Pastori Riçard VurmbRAND kaloi përmes të burgosurve të tjerë drejt një pastori tjetër, i cili qëndronte i palëvizur në dysheme. Ai sapo ishte hedhur në qeli. Ishte rrahur keqas. VurmbRAND nuk e dinte nëse ai do të mund të mbijetonte edhe një natë.

Me dhembshuri pastor VurmbRANDi u ul në gjunjë përkrah pastorit të rrahur dhe e pyeti: «Vëlla... a mund të thuash lutjen 'Atë, fali ata?'»

Burri u vrenjt nga dhimbja, duke prekur fytyrën e tij të ënjtur e të mavijosur. Ishte e vështirë të fliste. Fjalët dolën me ngadalë: «S'mundem».

Në momentin që pastor VurmbRANDi filloi të ndiente keqardhje për burrin, pastori i rrahur filloi të fliste përsëri. Me lot në sy ai tha: «Lutja ime nuk është 'Fali ata', por.. 'At, fali ata dhe më fal mua'. Nëse do të kisha qenë pastor më i mirë, ndoshta do të kishte akoma dhe më tepër torturues të kthyer në besim».

Ky pastor i rraskapitur shprehte shqetësimin e tij për mundësitë e humbura për të kthyer armiqtë e tij te Krishti. Të dy pastorët e dinin që një anëtar të ri të Organizatës Rinore Komuniste të Rumanisë e arrestuan njëherë dhe u rrah pa mëshirë nga një oficer policie i shtirur si i krishterë. Ky incident e ngurtësoi zemrën e tij ndaj Krishtit gjatë gjithë jetës së tij. Nga kjo mundësi e humbur për ungjillin, më në fund ai u bë diktatori i shtetit të mëparshëm komunist të Rumanisë. Nikolai Çaushesku ishte përgjegjës për torturimin e një numri të pamasë të krishterësh, duke

përfshirë pastor VurmbRANDin dhe pastorin tjetër të rrahur.

Asnjë keqardhje nuk është më e madhe se sa një mundësi e humbur. Fatkeqësisht jeta na sjell mundësi të humbura si lindjen e një fëmije, një mëngjes Krishtlindjesh, ose edhe avionin e fundit për t'u kthyer në shtëpi. Megjithatë, asgjë s'krahahet me mundësinë e humbur për të ndryshuar destinacionin përfundimtar të një personi tjetër. Ne asnjëherë s'mund ta dimë se si një person në pamje të parë i parëndësishëm, i ulur afër nesh në tren, një ditë mund të ndikonte botën për Krishtin – vetëm, nëse ne do të thoshim diçka. Po aq e vërtetë është mundësia që thyerja e qetësisë nga ana jonë mund ta shndërrojë një kundështar të vendosur të të krishterëve. Ti mund të numërosh shumë mundësi të humbura për ungjillin në të shkuarën. Megjithatë, mund të ndryshosh të ardhmen, duke kapur mundësitë e dhëna çdo ditë për të ndarë besimin tënd.

Ecni me urti ndaj të jashtëmëve duke shfrytëzuar kohën.

Kolosianëve 4:5

FKSTREM

Përkushtim ekstrem

KINË: LIU XIAOBO

Liu Xiaobo po shqetësohej në qelinë e tij të burgut, duke menduar vetëm për mëkatet e shtypësve të tij komunistë. Si një udhëheqës i protestës në sheshin «Tiananmen» në Kinë, lutja e tij e ethshme kishte qenë për një çlirim paqësor të kishës kineze nga kufizimet mbytëse të qeverisë. Ai kishte parashikuar që komunistët të mposhteshin nga të krishterët paqësorë që shpallnin dashurinë e një Zotit të mëshirshëm, por kjo kishte përfunduar keq.

Një nga një, ai pa miqtë e tij të guximshëm të qëndronin deri në fundin e dhunshëm e të hidhur. Dhe tani ishte kapur dhe arrestuar. Si mundet që Zoti të lejonte një ligësi të tillë t'i pushtonte ata? Përpjekjet e tyre nuk kishin kryer atë që mendonin mendjet njerëzore.

Pastaj inkurajimi i Zotit i erdhi me anë të urtësisë së një të burgosuri tjetër të krishterë. Duke kuptuar mëkatit e tij pas bisedës së tyre, ai shkroi: «Si mundet një person që nuk e ka ndjenjën e mëkatit të dëgjojë ndonjëherë zërin e Zotit? Në vend që të luftoj kundër komunistëve sepse bëjnë gjëra të mëkatshme, unë duhet të përkushtohem për t'u përpjekur t'i fitoj ata për Krishtin edhe nëse kjo do të thotë vdekje për mua. Jezusi u kryqëzua në kryq për shkak të dashurisë së tij për mëkatarët. Unë duhet të përkushtoj veten time për të dashur komunistët. Nëse jo, ne të gjithë do të mbetemi në fund të hendeikut, në vend që të ngjitemi lart në majë».

Njerëzit mendojnë se, nëse i janë përkushtuar Krishtit, jeta e tyre do të jetë e lehtë. Ata mund ta marrin si për të mirëqenë se gjërat do të shkojnë ashtu si duan. Për më tepër «po bëjnë vullnetin e Zotit», apo jo? Pse nuk duhet të kenë sukses përpjekjet e tyre? Megjithatë, shumë shpejt, problemet vijnë. Ata ndoshta mund të ouajnë lëndime fizike për shkak të besimit të tyre. Kur vendosim të numërohem si të krishterë, shpesh zbulojmë se sa shumë armiq ka Krishti. Jezusi premtoi se ne do të urrehemi për shkak të emrit të tij. Se si vendosim ne të reagojmë ndaj armiqve tanë është një test për ngjashmërinë tonë me Krishtin. A je gati t'i duash armiqtë e tu duke u lutur për shpëtimin e tyre? A do ta ndaje ungjillin me ta? Nëse ti nuk arrini shtypësit për Krishtin, kush do të mundet?

Bekoni ata që ju mallkojnë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë.

Luka 6:28

FKSTREM

Kontrast ekstrem

RUSI: KLAUDIA VASILEVNA

Dokumentet e Policisë Sekrete Sovjetike tregojnë se në Butovo, një periferi e Moskës, dyzet e katër mijë njerëz u qëlluan në grupe prej dyqind vetash dhe u varrosën në fshehtësi. Një natë gjatë vrasjes, Klaudia Vasilevna, ia hapi derën një gruaje të plagosur, e cila mendohej të ishte qëlluar për besimin e saj të krishterë, por ia kishte dalë mbanë të shpëtonte. Ajo iu lut Klaudias ta fshihte.

Klaudia refuzoi nga frika. Ajo mbylli derën dhe e la gruan jashtë duke vulosur vendimin me vdekje të saj. Për më shumë se pesëdhjetë vjet, Klaudia ishte përpjekur ta harronte imazhin e gruas.

Në kontrast me përpjekjen e Klaudias, anëtarët e kishës rumune gëzuan paqe në zemrat e tyre që ndihmuan dy ushtarë gjermanë që kishin shpëtuar nga një burg sovjetik. Ata kërkuan strehim në kishën e pastor Riçard Vurmbrandit. Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Rumania u sundua nga nazistët e egër gjermanë. Ndërsa Gjermania po humbiste luftën, ushtria ruse hyri në Rumani dhe filloi t'i merrte gjermanët si të burgosur lufte. T'i fshihje apo t'i ndihmoje gjermanët ishte e dënueshme me vdekje.

Ushtarët akoma vishnin uniformat gjermane dhe ishin kandidatë për vdekje. Familjet e kishës pranuan t'i ndihmonin dhe t'i mbronin ata, sepse nuk ishte vendi për të gjykuar, por për të ndihmuar çdo person në rrezik vdekjeprurës. Ata ndihmuan edhe fëmijët gjermanë gjatë kësaj kohe, duke e ditur që po bënë atë që Krishti do të kishte bërë në vend të tyre.

Të krishterëve shpesh u duhet të zgjedhin midis shqetësimeve për trupat dhe shpirtrat e tyre. Është ndryshimi midis shqetësimeve tokësore dhe keqardhjes së përjetshme. Të krishterët ekstremë jetojnë në kontraste të tilla me pjesën tjetër të botës me të cilën ndonjëherë është shumë e vështirë për t'u marrë. Rrethanat e tyre janë shpesh ekstreme. Madje edhe brenda rrethanave tona krahasimisht të zakonshme, mund të përballemi me vendime që kërkojnë guxim të jashtëzakonshëm. A do të zgjedhim sigurinë tokësore apo atë me rëndësi të përjetshme? A do të ndërmarrim një rrezik tokësor që mund të rezultojë në një fitim shpirtëror? Kur të përballemi me situata që kërkojnë guxim përtej fuqive tona, kërkoji ndihmë Zotit. Ai do të të sigurojë urtësinë që të nevojitet në kohën e duhur për të marrë vendimin e duhur.

*Që të jeni të paqortueshëm dhe të pastër,
bij të Perëndisë pa të meta në mes të një
brezi të padrejtë dhe të çoroditur, në mes
të të cilit ju ndriçoni si pishtarë në botë.*

Filipianëve 2:1

**Sepse juve Perëndia ju dha hirin t'i shërbeni
Krishtit, jo vetëm duke besuar në Të, por
edhe duke pësuar për Të.**

FILIPIANËVE 1:29



Udhëtime ekstreme

KINE: BOB FU

Profesori kinez, Bob Fu, dhe gruaja e tij bënin studime të fshehta Bible në fshatra të largët. Banorët, të uritur për Fjalën e Zotit, kurrë nuk reshtnin së mahnituri.

Udhëtimi i paharrueshëm filloi me një udhëtim dymbëdhjetë orësh me autobus, në të cilin një drejtues kishe qëndroi para dritares së thyer për orë të tëra për të mos lënë shiun të hynte në mënyrë që Fu të mund të flinte. Natën tjetër, ata vazhduan me një furgon të vogël në rrugë të këqija me baltë, derisa furgoni ngeci; pastaj drejtuan një traktor për disa orë në shi të rrëmbyeshëm, derisa edhe traktori ngeci. Pas kësaj ecën gjithë natën nën dritën e hënës, duke rrëshqitur dhe duke rënë në fushat me baltë.

Herët në mëngjesin tjetër mbërritën të përcjellë nga një mirëseardhje e ngrohtë. Fshatarët filluan të vinin në kishën-shtëpi për t'u lutur për dy orë para shërbesës. Disa kishin ecur tetëdhjetë kilometra vetëm për të dëgjuar Fjalën e Zotit. Shtëpia nuk kishte karrige, kështu që anëtarët e saj uleshin në gurë apo në copa druri. Në këtë zonë, ata kishin edhe një bekim tjetër: ishte shumë e vështirë për policinë që t'i ndiqte. Për disa ditë mund të adhuronin lirshëm!

Secili kishte kaluar kushte ekstreme udhëtimi për të adhuruar dhe asnjë nuk e konsideronte si sakrificë. Ata thjesht kishin dëshirë si Davidi, i cili tërhoqej drejt adhurimit nga çdo qelizë e trupit të tij.

Për njerëzit në vendet e ndaluara, kisha nuk është fakultative; ajo është thelbësore. Në ndryshim nga kombet e lira, ku shumë njerëz mundohen të vendosin çdo javë, nëse duhet apo jo të shkojnë në kishë. A kanë kohë? A po bie shi? Do të ishte më mirë të flinin deri vonë? Por gjithsesi, cila është tema e predikimit? Për turp, ne shpesh ndeshemi me një gamë të gjerë pyetjesh duke u përpjekur të vendosim nëse ia vlen ta kalojmë kohën në kishë. Për Davidin dhe të tjerë, të shkuarit për të takuar Zotin nuk ishte diçka për të cilën duhet të vendosnin. Në fakt, ata nuk do të lejonin asgjë që t'i mbante larg. Kur ka qenë hera e fundit që i ke kërkuar Zotit të të japë një dëshirë për të adhuruar në këtë mënyrë? Kërkoji Atij sot dhe bëj plane për të shkuar në kishë këtë javë që të takohesh me Zotin.

*Shpirti im ka etje të madhe për Perëndinë,
për Perëndinë e gjallë. Kur do të
paraqitem para Tij?*

Psalmi 42:2

FKSTREM

Kompozitor ekstrem

RUSI: NIKOLAI MOLDOVAN

Rojat e dehur rusë hynë në qelinë e ftohtë një pasdite të ashpër dimri. Një i burgosur, Nikolai, ishte poet dhe kompozitor, por edhe një besimtar i përkushtuar dhe udhëheqës i një lëvizjeje ungjillizuese në kishën Ortodokse. Mori një dënim prej pesë vjetësh në burgun e tmerrshëm rus për shërbesën e tij.

«Shtrihu barkas!» – i bërtiti një rojë Nikolait. Me këmishën e tij të hollë dhe me pantallona të shkurtra, ai u shtri në dyshemenë e akullt. Rojat i shkelën mbi shpinë me këmbë me çizmet e tyre të rënda për një orë.

Kur ata u larguan, të burgosurit e tjerë u ulën në gjunjë përkrah Nikolait për të parë sa keq ishte vrarë. Për habinë e tyre Nikolai tha: «Kam shkruar një himn të ri ndërsa ata më shkelnin». Ai filloi të këndonte: «Le të mos flas vetëm për qiejtë e së ardhmes, por le të kem qiellin dhe frikën e shenjtë këtu».

Pasi Nikolai u lirua nga burgu, policia komuniste i bastisi shtëpinë dhe i konfiskoi një libër unik dorëshkrimesh për të cilat ai kishte punuar për disa vite. Qindra orë pune të çmuar, shkrime dhe përkushtime iu morën menjëherë. Pas kësaj, Nikolai kompozoi një himn tjetër. «Të adhuroj ty me mirënjohje për çdo gjë që më ke dhënë, por edhe për çdo gjë të çmuar që më është marrë. Ti bën gjithçka mirë dhe unë do të besoj tek ti».

Sot, këngët e Nikolai Moldovanit këndohen në të gjithë vendin e tij.

Thuhet se jeta është 10 për qind çfarë ndodh dhe 90 për qind se si reagojmë ne ndaj asaj që ndodh. Nën dritën e kësaj, rrethanat aktuale të jetës nuk kanë aq rëndësi sesa qëndrimi i personit ndaj tyre.

Rrethanat janë jashtë kontrollit të dikujt, por një qëndrim apo reagim është një zgjedhje. Jeta mund të na sjellë një grumbull jo harmonik notash dhe melodish në një çelës minor. Me ndihmën e Zotit, ne mund të vendosim t'i rendisim notat për të nxjerrë një këngë adhurimi dhe fitoreje. Ne mund të zgjedhim të dëgjojmë melodinë në çmendurinë e jetës sonë. Si do t'i përshkruaje ti rrethanat aktuale në jetën tënde? Për çfarë ke nevojë për të ndryshuar melodinë tënde?

*Dëgjoni, o mbretër! Vini veshin, o princa!
Unë, pikërisht unë, do t'i këndoj Zotit, do
të këndoj lavdinë e Zotit, Perëndisë së
Izraelit.*

Gjyqtarët 5:3

FKSTREM

Dhunë ekstreme

ALEKSANDRI: GJON MARKU

Pasi shkroi Ungjillin sipas Markut, Gjon Marku, udhëtoi duke mbjellë farat e besimit në të gjithë Afrikën Veriore dhe Egjiptin dhe më në fund u vendos në Aleksandri dhe themeloi një kishë atje.

Në 21 prill të vitit 64 pas Krishtit, Marku bëri një predikim që kujtonte vuajtjen dhe vdekjen e Krishtit si pjesë e Pashkës, ose çfarë mund ta konsideronim e diela e Pashkës. Ai nuk i kishte marrëdhëniet e mira me priftërinjë e tjerë të krahinës dhe ata e përdorën këtë ditë për të nxitur popullsinë për t'u ngritur kundër tij.

Rebelët u dyndën në kishë dhe e kapën Gjon Markun. Duke përdorur grepa dhe litarë, ata e tërhoqën zvarrë përmes bashkësisë në rrugët jashtë qytetit. Ai la një çurg gjaku dhe mishi që nulloste gurët mbi të cilët e zvarritën. Gjaku rrodhi nga çdo vend i trupit të tij, ndërsa turma e tallte dhe e fyente. Me fjalët e tij të fundit, ai e dorëzoi shpirtin në duart e Shpëtimtarit dhe vdiq.

Madje edhe me vdekjen e Markut, etja e turmës për dhunë nuk u kënaq dhe priftërinjtë donin që trupi i tij të mos varroset, por të digjej.

Papritur një stuhi shpërtheu, duke e shpërndarë turmën në çdo drejtim dhe trupi i Markut u la atje ku kishte vdekur. Pastaj erdhën një grup të krishterësh,, e morën dhe i bënë një varrim të përshtatshëm.

Jezusi asnjëherë nuk drejtoi një fushatë ushtarake, asnjëherë nuk nxiti një rebelim dhe asnjëherë nuk foli fjalë luftime, por përsëri ndjekësit e tij u kundërshtuan dhe vazhdojnë të kundërshtohen dhunshëm. Mesazhi i Jezusit flet për dashuri, paqe dhe pajtim, por përsëri zyrtarët qeveritarë dhe publikë e kanë penguar ungjillin sikur të ishte një deklaratë luftime. Në të vërtetë, ne jemi të përfshirë në një luftë – Shpëtimtari ynë dhe Satani të mbërthyer në një betejë shpirtërore. I ligu do të bëjë çdo përpjekje për të shkatërruar mbretërinë duke i sjellë një fund të dhunshëm krishterimit. A do të je ti në anën e fitimtarit kur të ketë mbaruar beteja?

Sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore.

Efesianëve 6:12

Pastori rumun dhe gruaja e tij kishin fshehur ushtarët sovjetikë gjatë pushtimit nazist të vendit të tyre. Tani ishin ushtarët nazistë që kishin nevojë për strehim.

Tre oficerë gjermanë u fshehën në ndërtesën e vogël pas shtëpisë së tyre. Gruaja e pastorit u jepte fshehurazi ushqim dhe boshatiste shportat me mbeturina gjatë natës. Si çifute, ajo ndiente urrejtje për veprimet e tyre, pasi i kishin vrarë të gjithë familjen. Por si e krishterë, ajo ndihej e detyruar t'i ndihmonte refugjatët dhe t'u ofronte atyre mbështetje fizike dhe shpirtërore.

Shfaqja e nderit e intrigoi kapitenin: «Pyes veten pse një jude do të rrezikonte jetën për një ushtar gjerman? Unë nuk i pëlqej çifutët dhe nuk kam frikë nga Zoti. Duhet t'ju them se kur ushtria gjermane të ripushtojë Bukureshtin, dhe sigurisht që do ta bëjë, s'do t'juja kthej favorin».

Gruaja e pastorit nuk u lëkund nga zemra e tij e ftohtë. Ajo vazhdoi t'i predikonte atij. «Madje edhe krimet më të këqija janë të falura falë besimit të Jezu Krishti. Unë nuk kam asnjë autoritet t'ju fal, por Jezusi ka, nëse pendoheni».

Oficeri u përgjigj: «Nuk mund të them se të kuptoj. Por ndoshta, nëse më tepër njerëz do të kishin këtë dhunti të të kthyerit të së keqes në të mirë, atëherë do të kishte më pak vrasje».

Shumë shpejt oficerët u kthyen në Gjermani, ende të papenduar, por pastori dhe gruaja e tij e kishin bërë pjesën e tyre, duke u treguar kuptimin e vërtetë të krishterimit.

Jezusi tregoi një shëmbëlltynë për një fermer, i cili mbolli fara në vende të ndryshme toke, të cilat dhanë rezultate të ndryshme. Në historinë e tij, fara është Fjala e Zotit. Si zogjtë që rrëmbejnë farat e shkelura jashtë një kopshti, djalli do të rrëmbejë Fjalën e Zotit nga ata që e dëgjojnë. Në kontrast, ata që përfaqësojnë tokën e mirë e marrin Fjalën e Zotit dhe përgjigjen. Sa herë që ndajmë ungjillin me të tjerë, s'e dimë se çfarë lloj «toke» ndodhet në zemrat e tyre. Ne s'mund të jemi përgjegjës për reagimin e tyre, pozitiv apo negativ. A je i dekurajuar sepse dikush nuk reagoi pozitivisht ndaj ungjillit? Ti ke bërë pjesën tënde. Tani lejoje Zotin të bëjë të tijën.

Duke shërbyer me dashuri si për Krishtin dhe jo si për njerëzit.

Efesianëve 6:7

FKSTREM

Predikim ekstrem

RUMANI: PASTOR RICARD VURMBRAND

Në vitin 1991, qeveria komuniste rumune ndërroi fytyrë. Ata kishin frikë se mos hidheshin poshtë nga qytetarët e tyre, të cilët urrenin aktivitetet që ata bënin. Iu lutën pastorëve rumunë të predikonin, madje edhe në vende publike. Megjithatë, ata i urdhëruan pastorët të predikonin një mesazh të caktuar – dashuri për armiqtë – kështu që njerëzit do t'i falnin ata. Qeveria ndjeu se ata mund të manipulonin mesazhin e krishterë për fitimin e tyre.

Të krishterët e përqafulan me dëshirë thirrjen dhe filluan të predikonin hapur, megjithëse e dinin se motivi i qeverisë ishte për të ruajtur veten. Por disa menduan: «Pse duhet t'u mësojmë të shtypurve të duan shtypësit e tyre?» Ata mendonin se mesazhi i faljes do të forconte dorën e qeverisë.

Në këtë atmosferë pastor Riçard Vurmbrandi u kthye në Rumani pas njëzet e pesë vjetësh mërgimi, u ftua të predikonte në televizionin rumun ku theksoi mesazhin «Duajini armiqtë tuaj».

Kisha u bind nga fjalët e tij: «Dashuria, thjesht sepse është dashuri, e ekspozon veten ndaj çdo rreziku – edhe nga rreziku i të qenit të keqpërdorur nga të ligjtë, **me qëllim që t'i fitojnë të gjitha**. Ne nuk duhet të heqim dorë së predikuari dashurinë për armiqtë, edhe pse për njëfarë kohe, urryesit e Zotit përfitojnë në kurrizin tonë. Ne besojmë që Fjala është Zoti dhe në fund kjo Fjalë do të ndryshojë zemrat, madje edhe të atyre që urrejnë Zotin».

Bibla është plot histori me përfundime të habitshme... deri në kapitullin e fundit. Pikërisht kur duket sikur ligësia po merr kontroll dhe të gjitha rrethanat janë kundër atyre që janë të drejtë, Zoti u sjell fitore të drejtëve. Fatmirësisht, Zoti është autori i jetëve tona. Nuk na takon neve të pyesim se si po evoluon skenari, ne mund të ndihemi që s'jemi përdorur me efikasitet për punën e Zotit. Mund të ndiejmë se përprekjet tona më të mira për të ungjillizuar janë shkatërruar nga të tjerët. Megjithatë, roli ynë është që të predikojmë me besnikëri mesazhin e tij dhe ta lejojmë atë të merret me rrethanat sfiduese. Zoti është akoma duke shkruar historinë. Më e mira do të vijë!

*Ju vërtet ma menduat të keqen, por
Perëndia e ktheu atë në të mirë që të më
lartësojë, si po shihni se ndodhi në të
vërtetë dhe për të shpëtuar një popull të
madh.*

Zanafilla 50:20

FKSTREM

Përkujtim ekstrem

TIBET: UILLIAM SIMPSON

«Djalin tënd e kanë vrrarë».

Zoti Simpson mori mesazhin e tmerrshëm atë ditë. Djali i tij misionar, Uilliam, kishte ndërtuar një shkollë të vogël në kufirin e Tibetit ku u mësonte Fjalën e Zotit fëmijëve. I ati i Uilliamit jetonte afër dhe menjëherë nxitoi për në shkollë pasi mori lajmin. Ndërsa shikonte përreth, kujtimet e shërbesës së të birit e mbytn mendjen e tij.

Uilliami kishte udhëtuar gjashtë mijë kilometra në vit me kalë për të ndarë ungjillin me njerëzit e Tibetit. Myslimanët fanatikë kishin vrrarë pesëdhjetë mijë njerëz në një qyetet të Tibetit, por as kjo nuk e frikësoi djalin e tij.

Uilliami kishte shkruar: «Të gjitha problemet, vetmia, dhimbja, i ftohti dhe lodhja e rrugës së gjatë, dekurajimet dhe të gjitha humbjet, tundimet dhe sprovat nuk ia vlenin në krahasim me lavdinë dhe gëzimin e të dëshmuarit këto 'rryma kënaqësie dhe gëzimi të madh'».

I ati i Uilliamit eci me ngadalë përmes shkollës së shkatërruar dhe gjeti trupin e gjymtuar të djalit të tij të shtrirë në dysheme. Më vonë mësoi se një turmë dezertorësh të ushtrisë myslimane kishin sulmuar shkollën e krishterë, duke mos treguar mëshirë për themeluesin e saj.

Duke qenë se ishte vetë misionar, zoti Simpson ishte krenar për shembullin e Krishtit që Uilliami u kishte dhënë të tjerëve. Nën trupin e djalit të tij ishte një copë letër e njollosur me gjak, e mori dhe me butësi lexoi fjalët: «Në përkujtimin tim».

Përkujtimoret janë shpërndarë gjithandej në çdo vend të botës. Secili prej nesh përkujton një akt heroizmi, guximi dhe sakriçice në mes të vështirësive. Njerëz të çdo epoke në histori kanë ngritur kujtime dhe përkujtime. Është pjesë e natyrës njerëzore. Ne nuk duam t'i harrojmë ata që paguan çmimin përfundimtar, ndërsa ruanin idealet tona të lirisë, drejtësisë, dashurisë dhe nderit. Zemrat tona mbajnë kujtimet e martirëve të krishterë, të cilët vdiqën për hir të Krishtit dhe ungjillit të tij. Asnjë nder ushtarak nuk u është dhënë në funeralet e tyre. Asnjë statujë nuk u ngrit në vendin e tyre. Por përsëri ne lexojmë historitë e tyre dhe betohemi që s'do t'i harrojmë kurrë. Kalo ca kohë për t'i kujtuar sot dhe lavdëro Zotin që i frymëzoi.

*E falënderoj Perëndinë tim, sa herë që
ju kujtoj.*

Filipianëve 1:3

**Nëse ju mund të na e tregoni që jeni kisha
e vërtetë e Krishtit, ne do të kalojmë
menjëherë në anën tuaj, sepse duam të jemi
me Krishtin. Por ju nuk erdhët me
argumente për të vërtetën. Ju na futët në
burg, mund të na merrni jetën,
por jo besimin.**

PESHKOPI XHON BALAN – NË PËRGJIGJE TË UDHËHEQËSVE
ORTODOKSË KOMUNISTË, TË CILËT U PËRPOQËN TA BINDNIN ATË TË
LIDHTE ALEANCË ME KISHËN ORTODOKSE TË RUMANISË.

«Simbol ekstrem»

KUBE: TOM UAJT

Për ata që kanë vuajtur në burg për shkak të besimit të tyre në Krishtin, Darka e Zotit është një ceremoni e çmueshme; megjithatë rrallë ndahet nën sytë vëzhgues të rojave të burgut.

Tom Uajt dhe një pilot i quajtur Mel po fluturonin mbi Kubën komuniste me një avion të vogël, duke hedhur mijëra fletushka që u komunikonin ungjillin e Krishtit njerëzve të shtypur nën diktaturën e Fidel Kastros. Ata u diktuan gjatë një stuhie dhe u detyruan të uleshin pas një përplasjeje. Megjithëse nuk u dëmtuan, ata kishin zbritur në Kubë dhe rojat komunistë po i prisnin me armë të mbushura. Tomi dhe Meli u dënuan me njëzet e katër vjet burgim.

Tomit iu lejuan dy vizita nga gruaja e tij, Ofelia, e cila kishte një mision të vetin. Ajo arriti të fuste brenda një pako të vogël me pije rrushi të mbyllur në një kuti plastike dhe gome. Tomi e çoi pijen në qelinë e burgut kështu që ai dhe të burgosurit e tjerë të krishterë mund të ndanin darkën e Zotit, ndërsa rojat nuk po shikonin.

Tomi dhe Ofelia Uajt kuptuan një gjë. Të festosh Jezu Krishtin dhe gjakun e tij të derdhur në kryq ishte simboli më i fuqishëm që e mbante martesën dhe misionin e tyre të paprekur.

Tomi dhe Meli u liruan pas tetëmbëdhjetë muajsh. Sot Tomi dhe Ofelia vazhdojnë të festojnë sakrificën e Krishtit për ta në Oklahoma, ku Tomi drejton punën e Zërit të Martirëve.

Krishti udhëzoi dishepujt e tij të festonin dy tradita: pagëzimin dhe Darkën e Zotit. Ato janë simbole të përkushtimit ndaj tij – një festim i vdekjes dhe ringjalljes. Ato janë tradita të krishtera, megjithatë asnjëherë nuk duhen bërë thjesht si ngjarje tradicionale. Ne mund të mos i kuptojmë besimtarët që rrezikojnë jetën e tyre për të përkujtuar Darkën e Zotit, sepse tradita asnjëherë nuk është rrezikuar në kulturën tonë. Por ata që janë persekutuar për besimin e tyre zbulojnë se prioritetet e tyre kanë ndryshuar. Simbolet bëhen shprehje të çmuara të përkushtimit. Çfarë do të thonë për të simbolet e pagëzimit dhe të Darkës së Zotit? Si do të festosh më tepër herën tjetër që do të vëzhgosh një pagëzim të krishterë apo të marrësh pjesë në Darkën e Zotit?


Pastaj mori bukën, falënderoi, e theu dhe ua dha atyre duke thënë: «Ky është trupi im, që është dhënë për ju; bëni këtë në përkujtimin tim».

Luka 22:19

FKSTREM

Sakrificë ekstreme

RUMANI




Në burgun e Gherlas, Rumani, megjithëse ishte thyerje e rregullave, emrat e të burgosurve nuk shënoheshin dhe secilit i jepeshin njëzet e pesë të rrahura me kamxhik. Kishte ditë të veçanta, të përcaktuara kur do të jepej dënimi i dhimbshëm. Atë ditë, oficeri do të kalonte nga qelia në qeli, duke mbledhur ata që do të fshikulloheshin.

Meqenëse gardianët ndërronin turnet vazhdimisht dhe të burgosurit ishin të shumtë, ishte e pamundur t'i njihje të gjithë personat e qelisë me emër. Një i burgosur i krishterë dilte përpara dhe thoshte: «Unë jam ai» sa herë që një rojë thërriste në qeli për dikë për t'u rrahur. Ai fshikullohej vazhdimisht brutalisht në vend të dikujt tjetër.

Në fund, kur ky i burgosur i krishterë ishte afër vdekjes në një prej fshikullimeve sakrifikuese, të burgosurit e tjerë u përpoqën ta ngushëllonin duke i thënë: «Vëlla, jii lumtur tani. Së shpejti gjithçka do të përfundojë. Ti do të jesh në parajsë. Nuk do të ketë më dhimbje, vetëm gëzim!»

Ai u kthye, i pa me dashuri dhe u përgjigj: «Zoti bëftë me mua sipas vullnetit të tij... por nëse do të më pyeste, do t'i thosha të mos më merrte në parajsë. Do të preferoja të qëndroja në burg. Sepse e di që atje lart ka kënaqësi të paimagjinueshme, por në qiell mungon një gjë: të sakrifikosh veten për dikë tjetër».

Në një botë që vlerëson më tepër grumbullimin sesa dhënien, parimi biblik i sakrificës duket si një ide e çuditshme. «Merr sa më shumë që të mundesh, sa më shpejt që të mundesh» – është emri i lojës kur vjen puna tek idetë e botës. Bibla na mëson një mënyrë tjetër të suksesit. Ajo quhet sakrificë – të sakrifikosh jetën tënde për një tjetër. Kjo nuk është e natyrshme. Ajo madje nuk i duket tërheqëse as natyrës sonë më të ulët. Megjithatë, kur e provojmë, ajo bëhet një mënyrë bindëse jetese. Shpirti i Zotit brenda nesh na ndihmon të rendisim veten tonë të dytët, pas të tjerëve. Në fakt, Shpirti i tij na ndihmon që të duam ta bëjmë këtë. A je gati të vendosësh nevojat e të tjerëve mbi të tuat?



*Askush s'ka dashuri më të madhe nga kjo:
të japë jetën e vet për miqtë e tij.*

Gjoni 15:13

Legjendë ekstreme

IZRAEL: HISTORIA E GORUNIT

Në një legjendë të vjetër, Jezusi i tha ndjekësit të tij të quajtur Gorun: «Shko dhe vendos një çadër në malin Karmel dhe qëndro atje për një kohë meditimi dhe lutjeje». Goruni bëri si i tha Jezusi.

Një ditë Goruni shkoi në fshatin më të afërt dhe kërkoi: «Ju lutem, më jepni një batanije. Minjtë ma kanë brejtur të vjetrën dhe s'mund të fle». Fshatarët i dhanë me dëshirë një batanije, por Goruni kthehej vazhdimisht sepse ndodhte e njëjta gjë. Më në fund disa sugjeruan: «Do të japim një mace për ta zgjidhur një herë e mirë problemin tënd».

Pas disa ditësh Goruni u kthye. «Ju lutem, a mund të më jepni pak qumësht për macen?» Duke e kuptuar që nevoja do të ishte e përhershme, fshatarët vendosën t'i jepnin një lopë.

Goruni u kthye përsëri: «Kam nevojë për diçka për të ushqyer lopën». Ata i dhanë një copë tokë. Goruni kërkoi punëtorë për tokën, pastaj materiale për të ndërtuar shtëpi për punëtorët dhe kështu me radhë.

Vite më vonë, Jezusi shkoi për të parë dishepujt e tij të dashur. Një burrë i shëndoshë e përshëndeti dhe e pyeti: «Çfarë pune të sjell këtu? Çfarë dëshiron të blesh? Tani Goruni ishte një biznesmen i pasur dhe as që e njuh më Zotin e tij».

Të krishterët flasin për tregime si këto në vendet e persekutuarra, ku zyrtarët qeveritarë shpesh përpiqen t'i nxisin të braktisin besimin dhe shërbesën e tyre në shkëmbim të punëve më të rëndësishme dhe me më tepër para.

Ndonjëherë ne kemi nevojë për një histori për të parë diçka në një dritë tjetër, që të na kujtojë se çfarë është e rëndësishme dhe të na mbajë të fokusuar në detyrën që kemi përpara. Mund të mos na ofrohet një mace apo një lopë, por kundërshtari ynë na tundon shpesh në mënyra të tjera për të na larguar nga rruga. Ai na ofron siguri në vendin tonë kështu që ne do të kundërshtojmë të shkojmë në vende të tjera me ungjillin. Ai do t'i përdorë bekimet e Zotit si shpërqendrimë – një mik, familja apo një punë – për të na bërë kaq të zënë me jetën, sa të lëmë pas dore misionin tonë. Çfarë zbulon kjo histori në jetën tënde, që mund të jetë duke të larguar nga Zoti? A ke qenë aq i zënë me punët tokësore, sa ke neglizhuar misionin shpirtëror?

Kujdes, mos të të mjegullohet mendja nga dehja dhe shqetësimet e kësaj jete, ndryshe kjo ditë do të të zërë si në kurth.

Luka 21:34

EKSTREM

Kohë ekstreme

Një njeri ishte duke ecur natën vonë për në një qytet të largët, kur u pengua te diçka në rrugë. U ul dhe mori një çantë të vogël plot me gurë. Pa rreth e rrotull dhe vështroi në errësirë, duke u përpjekur të kuptonte nëse i kishte rënë dikujt. Duke mos parë askënd, vendosi ta marrë çantën me vete në udhëtimin e tij të gjatë në një natë pa hënë.

Për të kaluar kohën, filloi t'i hidhte gurët e vegjël në një lumë në kufi me rrugën. Plluq... plluq... tingulli ishte një argëtim i padëmshëm për udhëtarin e mërzitur. Kur arriti destinacionin e tij, i kishin mbetur vetëm dy gurë në çantë. Duke hyrë në qytet, iu afrua një llambe në rrugë, larg sheshit. I vuri dy gurët në pëllëmbë të dorës, i vështroi nën dritën e verdhë të llambës dhe pa një vezullim të çuditshëm dhe një shkëlqim të gurëve. I vështroi më nga afër. Për habinë dhe tronditjen e tij, gurët e vegjël ishin në fakt, diamante!

Një pastor burgu ishte në gjendje të udhëhiqte me urtësi shumë prej të burgosurve të tjerë të Krishti dhe e përdori këtë histori në raste të panumërta. Ai mësoi nëpërmjet vuajtjes se çdo minutë mund të përdorej për të rritur mbretërinë e Zotit, duke mos marrë parasysh rrethanat. Shpesh i paralajmëronte të tjerët: «Ju mund t'i rifitoni paratë e humbura, por jo kohën e humbur. Përdoreni kohën tuaj me zgjuarsin në shërbim të Zotit».

Tridhjetë e dy milionë sekonda në një vit dhe çdo sekondë që ne jetojmë është një dhuratë nga Zoti për t'u përdorur për qëllimet e tij. Nëse i shpërdorojmë, sekondat i kthehen Zotit, por jo neve. Ato kanë shkuar përgjithmonë, si diamantet në llumin e lumit. Jezusi, edhe kur po kryqëzohej e shpenzoi frymën e tij të fundit duke i ofruar shpëtim hajdutit dhe duke i thënë fjalë ngushëllimi së ëmës. Ai, madje u shërbeu vrasësve të tij duke u ofruar falje. Imagjino sa e çmuar ishte ajo kohë për hajdutin, i cili shkoi me Jezusin në parajsë atë ditë. A po i mbush momentet e tua të çmuara me qëllim? Kërkoji Zotit se si ta shfrytëzosh kohën tënde dhe jo ta shpërdorosh atë.

Na mëso, pra, t'i numërojmë ditët tona për ta pasur një zemër të urtë.

Psalmi 90:12

FKSTREM

Rreziqe ekstreme

KINË: DY NDËRTUESE KISHASH

Dy gra udhëtonin javë pas jave për të ndjekur takimet e fshehta në kishën-shtëpi. Ato ishin të lodhura dhe të dëshpëruara që në fshatin e tyre nuk kishte asnjë kishë.

Pasi u lutën muaj me radhë për një kishë afër fshatit, një nga gratë më në fund tha: «Ndoshta Zoti po pret që ne të ndërtojmë një kishë. Pse duhet të dëgjojë ankesat tona të vazhdueshme, nëse ne nuk jemi gati të bëjmë diçka vetë?»

Kështu ato vendosën të rrezikonin. Dy gratë dhe bashkëshortët e tyre ndërtuan një kishë në fshatin e tyre të vogël në Anhui, provincë e Kinës. Qeveria menjëherë i kërcënoi se do t'ua shembte ndërtesën, pavarësisht se ata u regjistruan në zyrën e çështjeve fetare. Ata vazhduan dhe fatmirësisht zona e tyre rurale nuk mbikëqyrej aq rrepësisht, sa disa kisha të mëdha të qyteteve. Ata, madje guxuan të ftonin pastorë të tjerë të kishave-shtëpi si folës të ftuar, pa kërkuar në fillim një leje të shkruar.

Gratë ungjillizuan ndërsa vizituan spitalin e zonës dhe u takuan me pacientë që nuk kishin shpresë shërimi. Atëherë ato do të luteshin dhe do t'i kërkonin Zotit t'i shëronte. Brenda një viti, kisha e re u rrit në më shumë se dyqind veta!

Një nga motrat tha: «Ne u lutëm për njëzet ditë rresht për një njeri dhe ai nuk u shërua derisa i erdhi fundi. Familja filloi të na kërcënonte me dhunë, duke thënë se po zemëronim zotat. Ju duhet të jeni gati të rrezikoni për Zotin».

Ungjilli i Krishtit është i kundërshtuar, i thjeshtë, i lehtë. Pse atëherë do ta izolonte djalli krishterimin si fenë numër një në listat kryesore në vendet e ndaluara? Për shembull, budistët nuk e kanë sistemin e kishës së fshehtë të krishterë që është e detyruar të ekzistojë në vendet e mbyllura. Ekspertët e meditimit të New Age nuk kanë frikë për jetën e tyre në vendet e persektuara. Krishterimi është i kundërshtuar sepse ai është i fuqishëm mbi armikun. Satani nuk e shpenzon kohën kot me jetë e rreme. A je ti një rrezik shpirtëror përsa i përket Satanit? Apo nuk luan rrezikshëm? A je ti një kërcënim për planet e tij për shkak të besimit tënd? Nëse është kështu, prit kundërshtime. Por gëzohu, ti je pjesë e së vërtetës!

Të gjithë ata që duan të jetojnë në perëndishmëri në Krishtin Jezus do të përndiqen.

2 Timoteut 3:12

FKSTREM

Dashuri ekstreme

RUMANI: TË KRISHTERË ÇIFUTË

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, ushtarët gjermanë e dinin që rusët do t'i çonin në një kamp pune në Siberi dhe shumë prej tyre do të vdisnin atje. Ushtria sovjetike sapo kishte marrë qytetin nga nazistët, kështu që kur dy ushtarë gjetën mundësinë, u arratisën nga grupi. U endën me frikë përmes rrugëve të errëta të Bukureshtit, Rumanisë.

Kur dalluan kishën e vogël Luteriane, u entuziazmuan sepse Luterianët rumunë kishin prejardhje gjermane. Por kur zbuluan që njerëzit brenda ishin çifutë, iu kthye frika.

Pastori i qetësoi menjëherë: «Ne jemi çifutë, por edhe të krishterë dhe nuk ua dorëzojmë armiqtë ata që kërkojnë strehim»,

Në atë kohë, nëse ndonjë rumun kapej duke fshehur gjermanë, dënohej menjëherë me vdekje. Por për pastorin e mirë, gjermanët akoma me uniformën e tyre naziste – ishin njerëz të humbur që kishin nevojë për një Shpëtimtar. Ai do t'i ndihmonte ashtu si kishte ndihmuar çifutët e persekutuar.

Ai u tha: «Ne kemi vuajtur mjaft nën pushtimin gjerman. Jeni apo jo fajtorë, ne nuk jemi gjykatësit tuaj. Ju ofrojmë shtëpinë tonë dhe rroba civile në mënyrë që të mund të shkoni në Gjermani. Ne e bëjmë këtë për t'ju provuar dashurinë e madhe të Zotit dhe mëshirën e tij për ju. Vetëm ai mund t'ju ofrojë liri nga faji»,

Dashuria i bën njerëzit të bëjnë gjëra të çuditshme. Një çift i dashuruar do të shkojë shumë larg për të treguar përkushtimin e tyre ekskluziv. Në të njëjtën mënyrë, një nënë e do fëmijën si askush tjetër në botë. Përsëri dashuria midis Krishtit dhe besimtarit nuk është vetëm midis të dyve. Ajo është dashuria më e çuditshme nga të gjitha, sepse nuk dëshiron që të jetë ekskluzive. Në fakt, ajo është e vetmja marrëdhënie dashurie që rritet duke përfshirë të tjerët. Ne duhet t'i duam të tjerët me dashuri të krishterë me qëllim që të tregojmë përkushtimin tonë ndaj Krishtit. Ne i tregojmë Krishtit dashuri ekstreme, nëse jemi gati të duam ata që nuk na duan. Kë po ty kërkon Zoti të duash për hir të tij sot?

Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bëni mirë dhe jepni hua, pa pasur shpresë për asgjë.

Luka 6:35

**Zoti nuk do të na gjykojë sipas asaj që kemi
druar, por se sa mund të donim.
Të krishterët që vuajnë për besimin e tyre
në burg mund të duan. Unë jam një
dëshmitar që ata mund të donin si Zotin,
ashtu edhe njerëzit.**

**NJË ISH-PASTOR I KISHËS SË FSHEHTË,
I CILI U BURGOS PËR BESIMIN E TIJ**



Hero ekstrem

RUSI: VANJA MOISEEV

Si ushtar në Ushtrinë e Kuqe Sovjetike, Vanja Moiseevi vazhdimisht kritikojë rëndë për ndarjen e besimit të tij. Shumë persona në regjimentin e tij erdhën te Krishti nëpërmjet dëshmisë së tij. Kur komandanti i tij e urdhëroi të qëndronte në heshtje për besimin e tij, ai u përgjigj: «Çfarë do të bënte një bilbil nëse i urdhërohej të pushonte së kënduari? Ai s'do të mundej, e kështu, as unë».

Të gjithë që e njihnin Vanjan thoshin se besimi i tij ishte ngjitës. Shumë shpejt ai u arrestua dhe iu nënshtroa torturave brutale. I shkroi nënës së tij duke thënë: «E di që ndoshta s'do ta shohim përsëri njëri-tjetrin, por mos qaj për mua. Një engjëll më tregoi Jeruzalemin qiellor dhe është i bukur.

Të lutem, bëj më të mirën, e dashur nënë, për të më takuar atje».

Ai vazhdoi ta siguronte atë që Zoti po e inkurajonte duke i dërguar engjëj përkrah. Ai përshkruante takimet e ndryshme që kishte me engjëjt.

«Engjëjt janë transparentë. Kur ke një të tillë përpara dhe një njeri qëndron mbrapa, prania e engjëllit nuk e pengon pamjen e njeriut. Përkundrazi, e sheh atë më mirë. Kur shikon përmes një engjëlli, ti mund të kuptosh dhe të vlerësosh, madje edhe një torturues».

Në fund, Vanja u vra për besimin e tij në moshën njëzet e një vjeçare. Ai ishte një martir i ri, jeta kurajoze e të cilit e mundësoi të bëhej një hero në të gjithë Evropën lindore.

Engjëjt janë kudo. Shëmbëllimi i tyre gjendet në libra, të gdhendur në mbajtës qirinsh, të varur si zbukurime Krishtlindjeje dhe të gjendur në format e biskotave. Shumë njerëzve u vjen keq që asnjëherë nuk kanë parë një engjëll të vërtetë – lajmëtarët qiellorë të Zotit. Dhe përsëri, shpesh engjëjt përçmohen. Një person, jo i këndshëm në nevojë për ndihmë, mund të jetë një engjëll. Armiku që na lëndon mund të jetë qenia engjëlllore që presim të shohim. Edhe nëse një person del të jetë thjesht një qenie njerëzore e zakonshme, dashuria jonë për atë person, akoma do të na sjellë një hap më afër parajsës. Ashtu si Vanja, a po e shikon jetën tënde nën perspektivën qiellore? A po kërkon engjëj kur më parë shihje vetëm një armik? Kërkoni engjëj potencialë për t'i dashur sot.


Mos e lini pas dore mikpritjen, sepse me anë të saj, disa, pa ditur, pritën engjëjt!

Hebrenjve 13:2

FKSTREM

Vakte ekstreme

EVROPA LINDORE: I BURGOSURI I URITUR



I krishteri i burgosur ishte i uritur dhe i acaruar. Një toger kishte ardhur për ta marrë përsëri në pyetje dhe ai nuk ishte në gjendje për t'u përgjigjur. Mendoi: «Pse duhet të jem unë ai që merret gjithmonë në pyetje?»

Kështu që ishte ai që e mbyti oficerin me pyetje: «A beson në Zot? Çfarë do të ndodhë me ty kur të vdesësh? Si erdhi në ekzistencë kjo botë e bukur?» Në fakt, ai ishte në gjendje të ndante mesazhin e plotë të shpëtimit me oficerin e interesuar. Për habinë e të burgosurit, togeri ia dha menjëherë jetën Krishtit!


Oficeri i dha gjithashtu drekë të burgosurit të uritur. I krishteri ishte mirënjohës që Zoti e ushqeu dhe e përdori, madje edhe në gjendjen e tij të acaruar.

Një herë tjetër, i njëjti person ishte në izolim dhe përsëri, ishte veçanërisht i uritur. Pastaj ai kujtoi fjalët e Jezusit që të gëzohemi në persekutime, sepse janë bekim. Ai menjëherë u ngrit dhe filloi të lavdëronte Zotin dhe të kërcente përreth qelisë së tij të vogël. Gëzimi i tij tërhoqi shumë shpejt vëmendjen e rojës.

Kur roja e kontrolloi, ai ishte i sigurt që i krishteri ishte çmendur. Rojat ishin udhëzuar t'i trajtonin të çmendurit me mirësi, kështu që ai i sollti të krishterit pak djathë dhe një fetë buke.

Përsëri, edhe këtë herë Zoti siguroi. Ky mendim e preku të krishterën: «Është më mirë të jesh një "budalla" në Krishtin sesa një i "zgjuar", që është i zemëruar për gjërat që s'mund t'i ndryshojë».

Shumë njerëz janë «kontrollues të çmendur» – ata kanë nevojë ta mbajnë botën nën kontroll të vazhdueshëm. Fatkeqësisht ka disa gjëra që janë përtej kontrollit të dikujt. Të dimë se për çfarë mund të bëjmë diçka dhe çfarë s'mund të kontrollojmë, është sekret i drejt suksesit. Për shembull, ne s'mund të mbikëqyrim atë që thonë të tjerët, por mund të vendosim të lutemi për ata që na fyejnë. Shqetësimi për atë që është përtej kontrollit tonë është thjesht natyrë njerëzore. Çfarë s'mund të kontrollojmë, ne përpiqemi ta manipulojmë. Por, Zoti thotë të ndalojmë së manipuluarit rrethanat dhe t'i besojmë atij. Si i burgosuri në këtë tregim, Zoti na kujton që thjesht ta vëmë në praktikë Fjalën e Tij duke iu bindur asaj. Ai do të kujdeset për të tjerat.



Lum ju kur njerëzit do t'ju urrejnë, kur do t'ju përjashtojnë nga rrethi i tyre, kur do t'ju poshtërojnë, kur do ta çmojnë emrin tuaj si të pandershëm për shkak të Birit të njeriut!

Luka 6:22

MEKSTREM

Më tepër letra ekstreme – pjesa e parë

ROME: PLINI

Në vijim është një letër nga një guvernator i quajtur Plini drejtuar perandorit romak për rritjen e krishterimit në më pak se njëqind vjet pas kryqëzimit të Krishtit:

«Unë asnjëherë nuk kam qenë i pranishëm në ndonjë gjyq të të krishterëve dhe nuk jam i vetëdijshëm për metodat dhe kufizimet e përdorura në hetimet dhe torturat tona.

A tregojmë ne ndonjë keqardhje ndaj moshës apo gjinisë? Nëse një i krishterë pendohet për fenë e tij, a e dënojmë atë apo e falim?

Aktualisht, unë po procedoj në këtë mënyrë – i pyes ata për fenë e tyre; nëse deklarojnë se janë të krishterë, ua përsëris pyetjen, duke shtuar kërcënimin e dënimit me vdekje. Nëse ata këmbëngulin akoma, urdhëroj të ekzekutohen. Nuk besoj se kokëfortësia e tyre duhet të kalojë pa u dënuar.

Kohët e fundit pyeta një grup të krishterësh, të cilët pas marrjes në pyetje, mohuan besimin e tyre. Nga kjo ngjarje, mund të shoh më shumë se kurrë rëndësinë e nxjerrjes së të vërtetës reale, me ndihmën e torturave, nga dy të burgosura femra. Por nuk isha në gjendje të zbuloja gjë përveç besëtytnisë së shturur e të tepërt.

Kështu mendova se do të ishte më e udhës të konsultohsha me ju para se të vazhdoj me këtë çështje. Çështja ia vlen t'ju referohet, veçanërisht duke konsideruar numrin e rrethuar. Kjo besëtytni ngjithëse nuk është e

kufizuar vetëm në qytete, por është shpërndarë edhe në të gjithë ishtratrat.

Megjithatë, duket e mundur që të kurohet.»

A «kurohen» lehtë të krishterët për krishterimin e tyre? Kur shfaqet presioni, a janë pjesa më e madhe e besimtarëve besnikë të Krishtit, të pakurueshëm apo thjesht janë duke kaluar një temperaturë të lehtë? Persekutimi është mënyrë e sigurt për të zbuluar të vërtetën. Vetëm Zoti e njej zemrën e një personi. Megjithatë, persekutimi na prezanton me veten tonë të vërtetë dhe na ndihmon të përcaktojmë, nëse do ta braktisim Krishtin apo do mbetemi besnikë. Nëse jemi me të vërtetë të përkushtuar ndaj Krishtit, atëherë ai do të na japë forcën që na duhet për të duruar për hir të tij. Nëse jemi më tepër të përkushtuar ndaj një ideologjie sesa personit të Jezu Krishtit, ne do të gjendemi duke u lëkundur nën presion. A ji një rast i pakurueshëm për Krishtin, apo besimi jote do të kthehet në «besëtytni të tepërt?»

Po të kishim harruar emrin e Perëndisë sonë the t'i kishim shtrirë duart drejt një perëndie të huaj, a nuk do ta kishite zbuluar Perëndia këtë gjë? Në fakt ai i njej sekretet e zemrës.

Psalmi 44:20-21

EKSTREM

Më tepër letra ekstreme – pjesa e dytë

ROME: TË KRISHTERËT E HERSHËM

«Gjaku i të krishterëve që derdhni është fara që mbillni; ajo çel nga toka dhe rritet edhe më tepër».

Të krishterët në kishën e hershme lulëzuan përballë një persekutimi intensiv nga autoritetet mizore qeveritare. Vëllezërit dhe motrat e tyre po torturoheshin, gjymtoheshin, digjeshin dhe vriteshin për hir të Krishtit. Çdo besimtar i martirizuar u dha më tepër vendosmëri besimtarëve të tjerë që mbeteshin. Ata e hodhën tej frikën e tyre për jetën dhe panë vetëm fushat e zbardhura për korrje, siç i përshkruante Jezusi ata që janë gati të pranojnë Krishtin. Ata u dhanë vetëm përgjigjen e mëposhtme të guximshme gjykatësve dhe autoriteteve përgjegjës për persekutimin:

«Dhe tani, o gjykatës, vazhdoni me shfaqjen tuaj të drejtësisë dhe do të jeni të drejtë nga opinioni i njerëzve, sa herë që sakrifikoni të krishterë.

Na kryqëzoni, na torturoni, na dënoni dhe na ktheni në pluhur. Padrejtësia juaj është një provë e dukshme e pafajësisë sonë, sepse prova është që Zoti na lejon ne të vuajmë.

Por bëni më të keqen dhe krijoni shpikjet tuaja për tortura mbi të krishterët, ato nuk vlejné për asgjë. Megjithatë, ju po e tërhiqni botën duke e bërë ta dojë më tepër besimin tonë. Sa më shumë që të na rrëzoni, aq më shpejt ngrihemi ne.

Gjaku i krishterë që keni derdhur është fara që ju mbillni; ajo çel nga toka dhe rritet edhe më shumë».

Megjithëse këto fjalë janë shkruar shekuj më parë, ky mesazh vazhdon të përmbushet edhe sot. Mbi dyzet kombe në botë janë aktualisht duke përjetuar persekutim fetar. Megjithatë, në shumë prej këtyre kombeve, kisha është duke lulëzuar me besimtarë të rinj çdo stinë dhe guxim më të madh midis anëtarëve të saj. Persekutimi nuk e ka kryer qëllimin e tij për të pakësuar ndjekësit. Në fakt, shpesh ai ka shërbyer për të rritur numrin e atyre që janë gati të sakrifikojnë. Si ndjekës të Krishtit, ne mund t'i shohim kundërshtimet që patrollojnë fushat e shpirtave, të cilët presin për të pranuar Krishtin, si gjigantë që janë gati të na përpijnë ose thjesht si dordolecë – imazhe të rremë të frikës. A do të hysh në fushat e të korrave për të punuar për Krishtin?

Ja, unë po ju them: Ngrini sytë tuaj dhe shikoni fushat që tashmë zbardhojnë për korrjen.

Gjoni 4:35

FKSTREM

Rritje ekstreme

KINË: KISHAT – SHTËPI

Këngë lavdërimi mbushën ajrin e ftohtë. «Është ora katër e mëngjesit. Nga vijnë këto?» – qeshi një person disi i habitur.

«Të korrat janë të shumta, miku im. Do të jetë një ditë e gjatë, por e mirë për mbretërinë,» – tha pastori ndërsa buzëqeshi. – Le të kthehemi në punë».

Deti i besimtarëve në lumë dukej sikur nuk kishte fund. Pastori foli me zjarr ndërsa i pagëzonte, secili me duart lart drejt një jete të re në Krishtin. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij pagëzuan një mijë e njëqind besimtarë të rinj atë ditë.

Zoti është në lëvizje në mënyrë të fuqishme në Kinë. Besimtarë po i shtohen tufës çdo ditë. Gjashtë vjet më parë në një qytet të Shanxit verior, disa qindra të krishterë ndiqnin kishat-shtëpi. Tani ky numër është rritur në shtatëdhjetë mijë. Në një qytet tjetër prej pesëdhjetë mijë vetash, ka një persekutim të madh, por përsëri tre mijë besimtarë të përkushtuar takohen çdo javë në kishat e fshehta.

Një pastor komentoi me mendjemprehtësi: «Ne besimtarët jemi më të fortë se më parë. Sa më shumë që ata duan të ulin poshtë flamurin e Krishtit, aq më lart fluturon ai».

Për dekada të tëra, kisha në Kinë ka vuajtur persekutim të vazhdueshëm. Qeveria nxori më kot një politikë «Godit fort» për të kufizuar rritjen. Anëtarësimi i sotëm i kishës së fshehtë konsiderohet më i lartë se anëtarësimi në Partinë Komuniste Kineze!

Rritja është shenjë e shëndetit. Kishat e shëndetshme rriten siç rriten bimët e shëndetshme. Ushqim, dritë, ujë dhe tokë të mirë janë gjithçka që kërkohet për një bimë të shëndetshme. Në të njëjtën mënyrë, kishat kanë nevojë për përbërës të veçantë për t'u rritur. Një nga përbërësit më të papritur për një rritje të shëndetshme të kishës mund të jetë një masë e vërtetë persekutimi. Persekutimi pastron besimtarët dhe i bën ata të vlerësojnë vlerën e besimit të tyre. Ashtu si e ilustron edhe pastori në këtë tregim, sa më shumë që persekutohet një kishë, aq më tepër anëtarët e saj ngrihen si një dëshmi për besnikërinë ndaj Krishtit. A je i hidhëruar, apo i përmirësuar për shkak të persekutimit? A po e përdor këtë në avantazhin tund për të rritur mbretërinë?

Ungjilli arriti tek ju, sikurse edhe në të gjithë botën dhe po jep fryt e po rritet.

Kolosianëve 1:6

Angela Kazaku ishte thjesht një grua e zakonshme që jetonte në Rumani gjatë Luftës së Dytë Botërore kur nazistët e pushtuan atë. Shumë shpejt, jeta për çifutët dhe të krishterët u bë një terror i vërtetë. Angela ishte e zënë duke rrëmbyer fëmijë nga getot dhe duke u dhënë ushqim dhe rroba të burgosurave të krishtera në burgjet rreth qytetit të saj.

Më vonë, kur nazistët u nxorën jashtë vendit dhe ushtria sovjetike erdhi, Angela ishte akoma e zënë duke shpërndarë mesazhin e dashurisë së Zotit, Bibla ruse dhe Dhiata të Reja në stacionet e trenave plot me ushtarë sovjetikë.

Kur pastor Riçard Vurmbrandi ishte i burgosur në burgun Tirgul-Okna në dimrin e vitit 1951, ai ishte shumë i sëmurë. Trupi i tij skelet dridhej nga i ftohti i vazhdueshëm i dimrit më të keq. Çdo të burgosuri i lejohej vetëm një batanije dhe ushqimi ishte i pakët, sepse askush nuk ishte në gjendje të shkonte në burgje përmes borës së shumtë.

Gjatë këtij momenti të zymtë, pastor Riçard Vurmbrandi mori një pako që kishte gjëra shumë të nevojshme si; ushqim dhe rroba që pastori me gëzim i ndau me të tjerët. Pakoja që ai mendonte se ishte dërguar nga një engjëll, ndoshta i shpëtoi jetën.

Përsëri edhe një herë, motër Angela (që do të thotë engjëll në rumanisht) ishte shumë e zënë duke u marrë me punët e Atit. E zakonshme? Ndoshta. Por Zoti kënaqet që përdor njerëz të zakonshëm si engjëjt e tij të mëshirës.

Vite më parë, në përgjigje ndaj lajmeve në rritje të veprimeve të rastësishme të dhunës, në një poster sugjerohej praktikimi i «veprimeve të rastësishme të mirësisë». Një veprim mirësie apo mëshire ndaj një të panjohuri mund të jetë po aq e parëndësishme. sa edhe të hequrit dorë nga një vend parkimi në një qendër dyqanesh, apo të dhënit pak kohë nga koha jote shitësit të dyqanit. Megjithatë, Zoti mund të të përdorë për të transformuar, madje edhe veprimin më të zakonshëm të mirësisë në një dhuratë të fuqishme hiri në jetën e dikujt tjetër. Kërkoji Zotit të të ndihmojë të kryesh një veprim të rastësishëm mirësie në emrin e tij sot. Ndoshta s'do ta dish ndonjëherë, por ti mund të jesh «engjëlli» i dikujt tjetër.

Vishuni, pra, si të zgjedur të Perëndisë, shenjtorë dhe të dashur, me dhembshuri të brendshme, mirësinë, përlësinë, zemërbutësinë dhe me durimin

Kolosianëve 3:12

**Ashtu siç nuk mund t'ia largosh vijat tigrin
duke i prerë qimet, po kështu edhe
unë jam akoma një e krishterë.
Kam akoma takime. Në fillim ato ishin
vetëm pesë takime në shtëpinë time;
tani ka më shumë se një dyzinë.**

ZONJA VO THI MANH, NJË GJYSHE VIETNAMEZE E BURGOSUR
PËR BESIMIN E SAJ



FKSTREM

Mjaftueshmëri ekstreme

NIGERI: ROZA

«Nxitoni, hyni në dhomë. Mos bëni asnjë zhurmë derisa të dëgjoni zërin tim. Më kuptuat?» Roza dëgjoji zërin vocërrak të dy fëmijëve të saj parashkollorë të thoshin: «Po, mami» Pastaj mbylli derën dhe u drejtua për nga shkolla e vajzës së saj, duke u lutur që të mos ishte tepër vonë.

Kur u shpall sharia apo ndryshe ligji islamik, nga qeveria nigeriane, shpërthyen akte dhune kundër grupeve të krishtera, sepse ata kishin kundërshtuar ligjet. Vajza më e madhe e Rozës ishte akoma në shkollë gjatë përlëshjeve dhe ajo e dinte se s'do të ishte e sigurt atje. Kur arriti në shkollë, vajza e saj ishte marrë në një bazë ushtarake për siguri. Në fakt, Roza e gjeti atë dhe u kthyen në shtëpi ku fëmijët më të vegjël ishin duke pritur të sigurt.


Ditën tjetër, kur i shoqi u largua për një takim të krishterë, ishte hera e fundit që ajo e pa atë të gjallë. Pothuajse 260 kisha ishin shkatërruar gjatë këtyre konflikteve dhe më shumë se 460 të krishterë ishin vvarë.

Në muajt që pasuan që nga vrasja e të shoqit, Roza gjeti ngushëllim nga libri i Veprave. Ajo tha: «I njëjti Zot që lejoi që Shtjefni të vritej me gurë, lejoi që Pjetri të dilte nga burgu. Zoti ka qenë besnik dhe hiri i tij i mjaftueshëm». Sot Roza vazhdon të punojë në kishën ku ishte pastor i shoqi, ndërkohë që po rrit edhe tre fëmijët e saj.

Është thënë që Zoti asnjëherë nuk do të na çojë atje ku hiri s'mund të na mbajë. Ne duhet ta kuptojmë që ndonjëherë plani i tij nuk përfshin një çlirim të mrekullueshëm nga sëmundja, vdekja apo shtypja. Por përsëri hiri i tij është i mjaftueshëm dhe ai s'na ka braktisur. Ne duhet të besojmë se Zoti nuk do të na çojë në një vend shërbese apo pune pa masën e duhur të hirit të tij për ta kryer atë. Ndonjëherë plani i tij përfshin thjesht shoqërimin nëpërmjet problemit sesa çlirimin prej tij. A ke ardhur në pikën ku je gati të mbështetesh plotësisht tek ai? Ka të ngjarë që asnjëherë nuk do të thuash se hiri i Zotit është gjithçka për të cilën ke nevojë, derisa gjithçka që ke, të jetë vetëm hiri i tij.

Por ai më tha: «Hiri im të mjafton...»

2 Korintasve 12:9



Studenti njëzet e nëntë vjeçar i Biblës ishte në gjumë kur u zgjua nga të thirrurat «Allah-u-Ahbar!» (Allahu është i plotfuqishmi!) Radikalët myslimanë hynë në dhomën e tij dhe e rrahën derisa e lanë pa ndjenja. Ndërsa Domingu u përpoq të shpëtonte, një thikë e goditi pas qafe gati duke ia këputur kokën. Sulmuesit e lanë në një pellg me gjak, duke menduar se ishte në prag të vdekjes.


Më pas Domingu tregoi se shpirti i tij e la trupin dhe u çua nga engjëjt në parasjë dhe ai pa kufomën e tij të shtrirë e palëvizur në tokë. Ai nuk ndiente më dhimbje apo frikë, por paqe ndërsa priste jetën e re me Krishtin. Pastaj dëgjoji: «Nuk ka ardhur koha për ty që të më shërbesh këtu».

Zërat e tjerë që Domingu dëgjoji ishin ata të punonjësve të mjekësisë së urgjencës indoneziane. Meqenëse nuk e dinin nëse ishte i krishterë apo mysliman, po diskutonin ku ta çonin trupin e tij.

Domingu iu lut Zotit për forcë për të folur. Më në fund, fjalët «Jam i krishterë» – dolën nga goja e tij. Vetëm imagjinoni pamjen e fytyrave ndërsa student i «i vdekur» iu përgjigj pyetjes së tyre.

Sot Domingu është shëruar plotësisht. Shenjat e tij fizike mbetën, por shpirti i tij ka një besim të ripërtëritur dhe një mesazh faljeje. Domingu tha se ishte më afër Zotit dhe tani po lutet aktivisht për komshinjtë e tij myslimanë – madje edhe për ata që e sulmuan.

Në një botë të re të pasigurt dhune dhe kërcënimesh, të krishterët urdhërohen ta përballojnë të ardhmen pa frikë. Frika vetëm rëndon një situatë të keqe pa lehtësuar ndonjë presion. Ne mund t'u bëjmë ballë me siguri pasigurive të së ardhmes në tokë sepse e dimë se destinacioni ynë i përjetshëm është i sigurt. Ne e dimë se e ardhmja jonë qiellore është me Krishtin, ashtu si e pa qartë Domingu. Mbi të gjitha jemi më tepër se thjesht trupa tokësorë që armiqtë tanë mund t'i gjytojnë apo t'i vrasin. Jeta juaj do të vazhdojë edhe pasi trupi të jetë shkatërruar. E ardhmja jote e vërtetë është ajo që ndodh në përjetësi, e jo çfarë ndodh këtu në tokë. Çfarë frike ke për të ardhmen? A mund t'ia besosh atë Zotit dhe ta përballosh të ardhmen pa frikë?



Zoti është drita ime dhe shpëtimi im; nga kush do të kem frikë?

Psalmi 27:1

E kënduar ekstreme

KOREJA E VERIUT: SUN OK LI

«Unë asnjëherë s'e mora vesh se çfarë këndonin këta të burgosur, derisa u bëra vetë e krishterë».

Sun Ok Li ishte e burgosur në Korenë e Veriut nga viti 1987 deri në vitin 1992. Megjithatë, ajo nuk u bë e krishterë derisa u arratis për në Korenë e Jugut. Kur pranoi Krishtin në fillim, ishte e mbushur me kujtimet e atyre që kishte parë dhe dëgjuar në burg.

Ishin gjërat e thjeshta, si atëherë kur të krishterët këndonin kur dënoheshin me vdekje. Në atë kohë, ajo nuk kuptonte dhe kishte menduar se ata ishin të çmendur. Ajo nuk lejohet të fliste, kështu që asnjëherë s'kishte pasur mundësinë të bisedonte me një të krishterë, por kujton se kishte dëgjuar fjalën «Amen».

«Ndërsa isha atje, nuk pashë kurrë një të krishterë të mohonte besimin e tij. As edhe një.

Kur këta të krishterë heshtnin, oficerët tërboheshin dhe i godisnin me shkelma. Në atë kohë, s'e kuptoja pse rrezikonin jetën e tyre kur mund të kishin thënë «Unë nuk besoj» dhe të kishin bërë atë që donin oficerët. Unë, madje pashë shumë prej tyre që këndonin himne ndërsa të rrahurat dhe goditjet shtoheshin. Oficerët i quanin të çmendur dhe i çonin në dhomën me trajtim elektrik. Nuk pashë asnjë të dalë i gjallë».

Këngën nuk e ndante nga buzët e saj. Ndoshta ishte të kënduarit e këtyre shenjtorëve të çmuar që mbollën një farë në shpirtin e saj që e drejtoi te Krishti.

Si spiunë, ata që janë kureshtarë për krishterimin përqendrohen te besimtarët, që të mund të vlerësojnë të vërtetën për vete. Ata vëzhgojnë, ruajnë, mbajnë shënime. Sa herë që një i krishterë kalon përmes problemeve, këta vëzhgues të heshtur shpesh shpresojnë t'i shohin besimtarët të bien, që të mund të sigurohen që të krishterët, gjithsesi, janë si të gjithë të tjerët. Megjithatë, kur të krishterët buzëqeshin përmes problemeve, ata hutohen. Kur të krishterët duartrokasin, në vend që të qajnë, ata mahnitën. Kur të krishterët këndojnë në mes të fatkeqësisë, ata tërhiqen nga diçka që s'mund ta shpjegojnë. Nëse po kalon përmes një sprove tani, ke mundësinë e paprecedentë për të dëshmuar për Krishtin. Lutu që shembulli yt plot gëzim do të frymëzojë të tjerët.

... jam plot ngushëllim: sepse, edhe me ngushticën tonë, prapë gëzimi ynë nuk ka masë.

2 Korintasve 7:4

Qëndresë ekstreme

TURKMENISTAN: SHAGELDI ATAKOV

«Thyejeni moralisht ose shkatërrojeni fizikisht!» Burokratët turkmenistanë nuk kishin më durim me këtë predikues rrugësh.

Shageldi Atakovit iu ofrua liria nën presidentin Saparmurat Nijazov në 23 dhjetor të vitit 2000, amnistia do t'i jepej nëse ai do të betohej me betimin e besnikërisë ndaj presidentit dhe të recitonte kredon e myslimanëve. Shageldi e refuzoi përsëri amnistinë.

Shageldi ishte kërcënuar më parë nga zyrtarët e shtetit që të ndalonte së predikuari. Ai u arrestua në dhjetor të vitit 1998 dhe u dënua me dy vjet burgim, por akuza e apeloj vendimin si «shumë të butë». U dënua edhe me dy vjet të tjerë në burg. Shageldi kishte aq shumë dhimbje nga të rrahurat, sa u kërkoi fëmijëve të tij të mos e preknin.

Në shkurt të vitit 2000, gruaja dhe pesë fëmijët e tij u larguan me forcë nga shtëpia e tyre dhe u internuan në Kaahkanin e largët ku qëndronin në «arrest fshati».

Kur familja e tij e vizitoi në fillim të shkurtit të vitit 2001, Shageldi i dha lamtumirën. Gruaja e tij vuri re që «gjatë vizitës ai ishte tërë vurrata dhe i dërrmuar, veshkat dhe mëlçia i ishin dëmtuar dhe po vuante nga verdhëza. Ai ecte me zor dhe humbiste shpesh ndjenjat». Nuk priste të jetonte shumë gjatë.

Pavarësisht nga kjo, sërish Shageldi nuk u thye. Ai nuk do të dorëzohej dhe megjithëse

lirimi ishte në dorën e tij, nuk do ta pranonte, nëse kjo do të thoshte të braktiste besnikërinë e tij ndaj Krishtit.

Njerëzit mund të jetojnë për shumë javë pa ushqim, por ne s'mund të jetojmë shumë ditë pa ujë. Në të njëjtën mënyrë, edhe shpirtrat tanë kanë nevojë për ushqim shpirtëror. Ne mund të kalojmë disa ditë, mua, madje edhe vite pa shoqëri – shpirtrat tanë mund të mbijetojnë pavarësisht nga vetmia. Ne mund t'ia dalim pa paqe, duke duruar sëmundje mbi sëmundje – shpirtrat tanë, megjithëse të dekurajuar, do të mbijetojnë. Nëse përpiqemi të qëndrojmë gjatë pa shpresën e Jezu Krishtit, shpirtrat tanë do të varfërohen. Ne s'mund të jetojmë pa shpresë, dhuratën e çmuar të Perëndisë për fëmijët e tij. Nëse ndihesh sikur s'mund të vazhdosh, kërkoi Perëndisë të të inkurajojë dhe të të motivojë. Ne do t'i durojmë të gjitha gjërat me shpresë të fortë në Jezu Krishtin.


Vëllezër, gjithmonë na duhet ta falënderojmë Perëndinë për ju, sikurse është e drejtë, sepse rritet jashtëzakonisht besimi juaj dhe shtohet dashuria e secilit prej jush kundrejt njëri-tjetrit.

1 Selanikasve 1:3

FKSTREM

Besnikëri ekstreme

LAOS: EZEKIA




Shumë shpejt pasi u bë i krishterë në vitin 1997, Ezekia shkoi në atë që në krahinë njihej si «shenjtërore» (tempull, kishë) për t'u dishepullizuar në ungjillizim. Ai u kthye pastaj në shtëpinë e të atit dhe menjëherë u ndesh me 35 të afërm dhe fshatarë që kërkonin të dinin pse ishte bërë i krishterë. Ai u tha atyre: «Jezusi është e vetmja rrugë që të mund të shpëtohem nga mëkatet e mia dhe të kem jetë të përjetshme».

Turma u zemërua dhe Ezekia u përpoq të arsyetonte me ta. Më në fund e kapën prej flokësh dhe filluan ta godisnin me grushte në fytyrë derisa ra pa ndjenja.

Një mik i Ezekias ishte në gjendje ta merrte në shtëpinë e tij, ku ai qëndroi në shtrat për katër ditë për të marrë veten nga të rrahurat. Ezekia nuk ishte më kurrë në gjendje të kthehej në shtëpinë e të atit, por ai vazhdon të udhëtojë nga fshati në fshat në Laos duke çuar lajmin e mirë të shpëtimit.

Që në incidentin e tij të parë, Ezekia është rrahur në dhjetë raste të tjera, ndonjëherë duke preferuar vdekjen ndaj vuajtjeve të vazhdueshme. Ai dëshmon: «Ndërsa jam pjekur në ecjen time me Krishtin, kam më tepër besim për të duruar këto vështirësi. Sprovat që kam kaluar kanë shërbyer për të forcuar besimin tim dhe unë shoh besnikërinë e Zotit në çlirimin tim. Falënderoj Zotin që kam qenë në gjendje të sjell tridhjetë njerëz në njohurinë shpëtuese të Jezusit.

Besnikëria e Zotit ndaj fëmijëve të tij nuk është reciproke. Nëse do të ishte kështu, ne do të ishim braktisur kohë më parë. Por Zoti është i vetëdijshëm për dobësitë tona dhe gjithsesi, vendos të na dojë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm t'i lexojmë historitë e martirëve nën dritën e besnikërisë së Zotit ndaj fëmijëve të tij. Martirët do të ishin të parët për të na kujtuar se historitë nuk flasin për ta. Flasin për Zotin. Megjithëse ne lexojmë për shumë besimtarë që më me dëshirë duruan torturat, sesa të mohinin Krishtin, përfundimi i mahnitshëm nuk është besnikëria ekstreme e një personi, por besnikëria ekstreme e Zotit të laudisë. Besnikëria jote mund të lëkundet, por besnikëria e tij e patundur nuk mbaron kurrë. Kalo ca kohë për ta falënderuar Zotin për besnikërinë e tij sot.




Nëse jemi të pabesë, ai mbetet besnik, sepse ai nuk mund të mohojë vetveten.

2 Timoteut 2:13

FKSTREM

Ambient ekstrem

RUMANI: SABINA VURMBRAND



Mjekja e re çifute ishte shumë e trishtuar. Një natë, Sabina Vurmbbrand u përpoq t'i ofronte ngushëllim: «Zoti i premtoi Abrahamit që çifutët do të kishin një të ardhme të ndritur. Ata do të ishin si rëra në bregun e detit dhe yjet në qiell».

Mjekja ngriti kokën me lot në sy dhe tha: «Si rëra në breg të detit, ne jemi të shkelur nga këta roja komuniste. Mos më fol më për Zotin tënd».

Disa ditë më vonë, Sabina u sëmur rëndë. Ndërsa ishte e shtrirë në prag të vdekjes në spitalin e burgut, drejtori i burgut erdhi dhe tha: «Ne komunistët kemi ilaçe dhe spitale dhe jemi më të fortë se Zoti yt. Në këtë spital s'duhet ta përmendësh emrin e Zotit». Vetëm Sabina guxoi të fliste për ekzistencën e Zotit. Gratë e tjera ishin të entuziazmuara që dikush në fakt kishte sfiduar drejtorin.


Të nesërmen, ata e detyruan Sabinën të kthehej në punë. Zoti preku mrekullisht trupin e saj dhe ajo u shërua plotësisht. Lajmi u përhap në burg dhe nuk u shpëtoi veshëve të mjekes së re të trishtuar.

Vonë atë mbrëmje ajo iu afrua Sabinës dhe i tha: «Nëse Zoti mund të shërojë trupin tënd dhe mund të të japë ty një paqe të tillë në këtë gropë ferri, atëherë duhet ta besoj se është i vërtetë. Asnjë fuqi tjetër s'mund ta kryejë këtë. Si duhet të shpëtohem?»

Sa herë që ndihemi sikur jeta jonë është në një gropë, mund të jemi të sigurtë që njerëzit po vëzhgojnë për të parë se si do të dalim prej saj. Krishterimi duket sikur tërheq spektatorë të interesuar – veçanërisht kur jemi duke u munduar. Njerëzit vëzhgojnë besimin tonë nga afër për të përcaktuar se çfarë është Zoti. Ata shohin me interes të madh kur ne përjetojmë një krizë. Nëse jetojmë me besim gjatë kohës së sprovave, njerëzit s'mund ta refuzojnë provën që shohin në jetën tonë. Çfarë shohin njerëzit në mënyrën se si jeton ti? Çfarë u tregon të tjerëve për Zotin reagimi yt ndaj situatave të jetës? Nëse e ndiesh që jeta jote është në një gropë, mbaj mend, njerëzit po të vështrajnë për të parë se si do t'ia dalësh mbanë.

*Dhe prapëseprapë, në të gjitha këto,
jemi më tepër se ngadhënjyes, falë
Atij që na ka dashur.*

Romakëve 8:37



Pavarësisht nga kujtimet e dhimbshme, nuk kam kohë për hidhërim. Jeta ime është e mbushur me kaq shumë lumturi, kaq shumë njerëz të dashur dhe të kujdesshëm, që t'ia lejoj vetes të përpihem nga kanceri i urrejtjes. Unë gëzoj, këndoj, qesh dhe festoj sepse e di që Zoti im mbretëron suprem mbi të gjitha forcat e së keqes dhe të shkatërrimit që Satani ka thurur ndonjëherë. Dhe mbi të gjitha – Zoti im mbretëron suprem tek unë!

PASTOR NOBEL ALEKSANDER, I BURGOSUR NË KUBË PËR NJËZET E DY VJET – DO TË VDES I LIRË

FKSTREM

Kërkesë ekstreme

KINË: ZHANG RONGLIANG

Zhang Rongliang është drejtuesi i një prej grupeve më të mëdha të kishave-shtëpi në Kinë, e cila ka një numër prej dhjetë milionë besimtarësh kinezë që ndjekin shërbesat çdo javë. Në vitin 1998, Zhangu dhe drejtues të tjerë të kishave-shtëpi – që përfaqësojnë pesëmbëdhjetë besimtarë të fshehtë – firmosën një dokument të titulluar «Rrëfimi i besimit të Kishës-Shtëpi», që publikisht i bëri thirrje qeverisë komuniste të ndalonte së sulmuari kishat-shtëpi të peregjistruara.

Disa muaj pas bërjes publike të dokumentit, Zhangu dhe persona të tjerë që kishin firmosur, u arrestuan dhe u burgosën. Më vonë, Zhangu u lirua me kusht që «të sillet mirë» për shtatë vite të tjera. Sot Zhangu udhëton për t'u shërbyer tufave të tij të ndryshme. Meqenëse ai nuk po «sillet mirë» siç do të donte qeveria, Zhangu nuk fle asnjëherë në të njëjtin shtrat më tepër se disa netë me radhë.

Kur Pali shkroi te Romakëve 13, që ne duhet t'u bindemi qeverive tona, ai më tepër se kushdo, duhet ta ketë ditur rrezikun. Përsëri, megjithëse romakët e persekutonin, përmes një apelimi ndaj ligjit të tyre ai e çoi vetë ungjillin në Romë, megjithëse do të ishte udhëtimi i tij i fundit.

Si Pali, Zhangu ndërmoi një rrezik ekstrem kur bëri kërkesën e tij zyrtare. Megjithatë, pasojat e rrezikut të tij personal kanë bërë që shumë të njohin Krishtin.

Si Pali, drejtuesit e kishave në Kinë e dinë që Zoti i cakton qeveritë. Por ata e dinë gjithashtu se Zoti nuk do t'i kalojë pa u vënë re padrejtësitë e një autoriteti të lig. Përmes historisë e dimë që romakët i prenë kokën Palit. Në mënyrë të ngjashme, besimtarët në Kinë vuajnë padrejtësi të mëdha nën regjimin e qeverisë së tyre aktuale për hir të Krishtit. Nëse rrezikojnë jetët e tyre për të sjellë drejtësi në Kinë, është e nevojshme që pastorë të tillë të jenë të gatshëm të vdesin. Sa e fortë është dëshira jonë për të parë të vendoset drejtësia? Sa e vlerësojmë ne të drejtën për të predikuar lirshëm Fjalën e Zotit? Lutu për besimtarët në Kinë sot, të cilët na frymëzojnë për të kërkuar drejtësinë e Zotit për shtypësit e tyre. Kërkoji Zotit të tregojë mënyrat si mund të mbështesësh punën e tyre për përparimin e mbretërisë së Zotit.

Ai do që të mbretërojnë e drejta dhe drejtësia; mbarë bota jeton nga mirësia e tij.

Psalmi 33:5

Për herë të tretë Krishti e pyeti Pjetrin: «Simon, bir i Jonas, a më do ti mua?»

Pjetri ishte i lënduar. Tri herë ai e kishte mohuar Krishtin; tani tri herë Jezusi e pyeti për dashurinë e tij. Ai u përgjigj me ngadalë këtë herë, sikur të peshonte rëndësinë e secilës fjalë në zemrën e tij: «Zot, ti i njeh të gjitha gjërat. Ti e di që unë të dua».

«Ushqe delet e mia» – Jezusi e përsëriti për herë të tretë. Vetëm këtë herë, ai shtoi: «Kur ishe i ri, visheshe dhe shkoje ku të doje; por kur të plakesh, dikush tjetër do të të veshë e do të çojë atje ku ti nuk do të doje». Pastaj Jezusi tha: «Më ndiq» (Gjoni 21:15-19, e parafrazuar).

Neroni e persekutoi Pjetrin kur ky i fundit ishte shtatëdhjetë vjeç. Sipas legjendës, miqtë e Pjetrit dhe besimtarë të tjerë e nxitën atë të arratisesh nga Roma. Ai në fillim refuzoi, por u bind më pas të largohej. Ndërsa iu afrua portës së qytetit për t'u larguar, pa një vizion të Jezusit që ecte në qytet. Ai ra në gjunjë duke e adhuruar. «Zot ku po shkon?»

«Unë kam ardhur përsëri për t'u kryqëzuar. Më ndiq».

Pjetri u kthye dhe e ndoqi «atje ku ai s'donte të shkonte». Ai u kthye për ta përballuar Neronin. Kur autoritetet e arrestuan, ai kërkoi që të kryqëzohej përmbys, sepse mendonte se nuk ishte i denjë të kryqëzohej në të njëjtën mënyrë si Zoti.

Në këtë legjendë nuk tregohet që Jezusi u kryqëzua për herë të dytë. Ai vdiq dhe u ringjall një herë e përgjithmonë. Legjenda na kujton se Jezusi identifikohet me dhimbjen dhe vuajtjen tonë njësoj si t'i kalonte ai vetë. Në rastin e Pjetrit, Bibla thotë profecinë e hershme të Jezusit që i referohet kryqëzimit të Pjetrit. Kush tjetër përveç Jezusit mund të lidhej me përvojën torturuese të Pjetrit? Jezusi është ekspert i vuajtjes. Ai e di se çfarë është ajo dhe do të na shoqërojë. Nëse ka dhimbje në jetën tënde, Jezusi e kupton. Nëse je i lënduar, edhe Jezusi ka qenë. Lejoje atë ta marrë barrën dhe trishtimin tënd sot me anë të lutjes.

I tha këto fjalë për t'i lajmëruar se me ç'vedkeje do ta nderonte Perëndinë. Pastaj i tha: «Më ndiq mu!»

Gjoni 21:19

FKSTREM

Grua pastori ekstreme

RUMANI: SABINA VURMBRAND

Një kontrast i thellë ekziston midis fshatit të bukur rumun dhe vuajtjeve që të krishterët dhe çifutët përjetuan në duart e pushtuesve nazistë dhe komunistë. Për Sabina Vurmbbrandin, shqetësimet ishin trefish: Ajo ishte e krishterë, çifute dhe gjithashtu edhe gruaja e një pastori të njohur.

Një ditë mori vesh se mamaja, babai, tri motrat më të vogla dhe vëllai nëntëvjeçar ishin vrarë brutalisht në një kamp përqendrimi. Atë ditë besimi i saj u bë i gjallë dhe i vërtetë.

Plot me hirin e Zotit, Sabina tha: «Nuk do të kem një fytyrë të trishtuar. Unë i detyrohem Zotit të jem një besimtare plot gëzim; për kishën një shembull kuraje dhe për bashkëshortin tim një grua e qetë».

Sabina nuk lejoi kurrë që dhimbja e saj personale dhe agonia ta pengonin për të qenë një inkurajuese publike për ata rreth saj. Në mendjen e saj, ajo s'kishte zgjedhje. Vdekja dhe vuajtja, veçanërisht midis anëtarëve të kishës së fshehtë, ishin të përhapura. Shumë sy ishin mbi të si gruaja e pastorit. Nëse ajo do ta humbiste shpresën, çfarë shprese do të kishin ata?

Më vonë Sabina kaloi tre vjet në burg duke punuar si sklave në kampet e punës, ku gratë përballeshin me veprimet më poshtëruese dhe brutale nga të gjithë të burgosurit. Përsëri, edhe në burg, ajo njihej si mikja e të gjithave dhe kishte gjithnjë një fjalë të mirë.

Para se të largohej nga Rumania, Zoti i dha Sabinës shpërblimin e saj. Ajo dhe

bashkëshorti i saj, Riçard, sollën më vonë familjen e vrasësit te Krishti!

Pastorimi është një partneritet midis pastorëve dhe miqve të tyre. Dikush nuk është i plotë pa shërbimin dhe inkurajimin e tjetrit. Zoti nuk ka thirrur asnjë të krishterë të jetojë e të punojë në izolim – ai na thërret në komunitet. Ne kemi nevojë për të krishterë të tjerë që të na shoqërojnë në shërbesat tona, të na japin urtësi dhe inkurajim herë pas here. Ne nuk pritemi ta bëjmë këtë vetë – as nuk duhet të përpiqemi. Mendoni për sferën tënde të ndikimit. Kush është partneri yt në shërbesë? Kush po lutet për ty që të jesh një dëshmitar efikas në vendin e punës, shtëpi apo shkollë? Kërkoji Zotit të të drejtojë tek një mik i krishterë që do të të inkurajojë dhe do të të forcojë kur të kesh nevojë.

..dhe dërguam Timoteun, vëllanë tonë dhe bashkëpunëtorin e Perëndisë në përhapjen e Ungjillit të Krishtit, që t'ju forcojë dhe t'ju japë zemër në besim...

1 Selanikasve 3:2

Forcë ekstreme

INDONEZI: FRIC

Frici ndjeu çdo goditje shtypëse në kokë dhe u lut për forcë. Sulmuesit myslimanë e rrethuan dhe me radhë e rrihnin në fytyrë. Njëri prej sulmuesve myslimanë kapi një thikë të madhe duke menduar se kjo do ta hiqte qafe pastorin e krishterë. Herën e parë që tehu përshkoi Fricin, gjithçka që mund të bënte ishte të thërriste «Jezus!» Ai u përshkua shumë herë nga thika dhe çdo herë thërriste «Jezus!» Sulmuesit u acaruan me pastorin që nuk vdiste!

Myslmanët radikalë vazhduan duke bërë bashkë stolat dhe podiumin e kishës për t'u vënë zjarrin. Dy prej myslimanëve e kapën Fricin dhe e flakën mbi drurët e ndezur. Të kënaqur me sulmin e tyre, ata u larguan. Frici nuk kujton shumë pas kësaj, por ai di një gjë. Asnjë fije e flokut të tij nuk u dogj.

Shumë shpejt pas sulmit, Frici u çua në spitalin më të madh në atë krahinë të Indonezisë, por iu refuzua trajtimi kur mësuan se ishte i krishterë. Ai u çua në një spital tjetër, por mjeku që u kujdes tha se, nëse do ta kalonte atë natë, do të mbetej me një dëmtim të përhershëm të trurit.

Pas një kohe të gjatë në spital, Frici ishte duke predikuar përsëri në një kishë të re. Për habinë e tij, njëri prej myslimanëve që e sulmoi filloi ta kërkonte vetëm për t'i bërë një pyetje të vetme: «Kush është ky Jezus?»

Kujt nuk i pëlqen ta mendojnë si «ekspertin» e zonës? Kjo mund të ketë të bëjë me mekanikën, matematikën, veglat e punës, zdrukthtarinë, pikturën, mbledhjen e pullave të postës apo sportin – secili mund të mendohet si ekspert në të paktën një fushë. Ne duam të na shtrohen pyetje mbi një temë, të cilën e njohim shumë mirë. Por nëse dikush do të të pyeste: «Kush është ky Jezus?», a do të ishit po aq të përgatitur sa do të ishte një «ekspert?» Jo çdo i krishterë është ungjilltar, por çdo i krishterë mund të ungjillizojë duke ndarë planin e shpëtimit kur jepet mundësia. Nëse ti bëhet kjo pyetje nga një mik jobesimtar, si do t'i përgjigjeshëshe? Nëse nuk jeni i sigurt, bisedoni me dikë që e di.

Jini gjithnjë gati për t'iu përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju.

1 Pjetrit 3:15

Grup të rinjsh ekstrem

RUSI: PASTOR SEREBRENIKOV

Gazetat lokale e përshkruan skenën si «barbare». Nuk ishte një skenë vrasjeje apo një aksident me makinë; ishte një studim Bible.

Historia u shfaq në një gazetë komuniste ruse rreth viteve '60. Në një pjesë lexohej: «Djem të rinj e vajza të reja këndojnë himne shpirtërore. Ata marrin ritualin e pagëzimit dhe mbajnë mësimet të rrezikshme dhe të këqija të dashurisë ndaj armiqve», Historia vazhdon për të shfaqur realitetin tronditës që shumë të rinj në Organizatën Rinore Komuniste ishin të krishterë të fshehtë.

«Ne duhet t'i besojmë Shpëtimtarit tonë siç bënë të krishterët e parë, – i tha pastori Serebrenikov grupit të tij të të rinjve. – Për ne, ligji kryesor është Bibla. Ne nuk njohim asnjë tjetër, duhet të nxitojmë që t'i shpëtojmë njerëzit nga mëkati, veçanërisht të rinjtë»,

Pastori u hodh në burg kur komunistët zbuluan një letër të shkruar nga një person i kthyer në fe. Vajza adoleshente kishte shkruar: «Të dërgoj bekime nga Zoti ynë i dashur. Sa shumë më do ai mua!»

Editorialët e gazetave pyesnin veten se si studentët komunistë mund të vendosnin të ndiqnin Krishtin dhe akuzonin shkollën komuniste si të «pafuqishme» dhe «pa dritë», Ata thanë se krishterimi mund «t'ua rrëmbente dishepujt nën hundë, mësuesve të tyre indiferentë»,

Nuk ishte indiferenca e mësuesve. Ishte thirrja e dashurisë së Krishtit që paraqitej nga pastori Serebrenikov dhe anëtarët e grupit të tij të të rinjve – të krishterë, që lejuan dritën e tyre të shkëlqente në një tokë të errët.

*«K'të pak dritë që kam, dua ta ndriçoj...
» Kjo këngë e njohur për fëmijë ka një melodi të thjeshtë, jo me shumë fjalë për t'u mbajtur mend – ajo mund të qëndrojë në mendje, edhe ditë pasi është kënduar. Fëmijët e vegjël e kanë të lehtë për ta mësuar këngën, por është shumë e vështirë për t'u jetuar, veçanërisht ndërsa rritemi. Sa mundësi kemi ne në një ditë për të lejuar dritën tonë të ndriçojë dhe të nderojë Zotin? Një apo dy? Dhjetë? Njëzet? Numri i saktë s'ka rëndësi. Ajo që ka rëndësi është reagimi ynë ndaj ngjarjeve me të cilat përballemi çdo ditë. Kush e di? Drita jote mund të jetë ajo që u duhet të tjerëve për të gjetur rrugën për në shtëpi.*

Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet. Po ashtu nuk ndizet një qiri për ta vënë nën babunë, por për ta vënë mbi shandan, që t'u bëjë dritë të gjithë atyre që janë në shtëpi.

Mateu 5:14-15

Shitje ekstreme

RUMANI: SABINA VURMBRAND

Përsëritja të çmendte dhe nervat e Sabinës ishin tendosur gati sa të shpërthenin, por oficeri ishte i palëkundur. «Kemi metoda për të të bërë të flasësh, të cilat nuk do t'i pëlqesh. Mos u përpiq të bëhesh e mençur me ne. E harxhon kohën kot.»

Pyetjet e tyre kishin si qëllim ta bënin atë të zbulonte emrat e të krishterëve të tjerë – të atyre për të cilët ishte përkujdesur si një nënë në besim dhe i kishte inkurajuar të ishin të fortë përballë persekutimit. Tani ishte radha e saj për të qenë e fortë, por s'mendonte se do të duronte edhe një sesion tjetër të marrjes në pyetje.

Sesioni tjetër u luajt në një mënyrë më të butë, më me mjeshtëri. Hetuesi ishte vetëm dhe duke buzëqeshur. «Grua e dashur, ti je vetëm tridhjetë e gjashtë vjeçe, me gjithë jetën tënde para. Vetëm na jep emrat e tradhtarëve.» Sabina qëndroi në heshtje.

Ai vazhdoi: «Le të flasim praktikisht. Çdo njeri e ka një çmim, kështu pse nuk na thua tëndin? Vetëm na thuaj çfarë do. Liri për ty dhe bashkëshortin tënd? Një shtëpi të mirë dhe një kishë? Ne do të kujdesemi mirë për familjen tuaj»,

Sabina u përgjigj me bindje të fortë: «Faleminderit, por tashmë e kam shitur veten»,

«E ke shitur?» – ndërpreu hetuesi. «Për sa dhe kujt?»

«Birit të Perëndisë që u torturua dhe dha jetën e tij për mua. Nëpërmjet tij ne mund të arrijmë parajsën. A mund të paguani çmim më të lartë se ky?»

Ne presim që adoleshentët të kalojnë përmes kësaj. Themi që është rit i kalimit, por s'mendojmë asnjëherë që mund të vazhdojë të na kapë neve ndërsa rritemi. Presioni i bashkëmoshatarëve. A nuk është kjo një ndjenjë e njohur për të gjithë, ndjenja e «të qenit të blerë» nga dikush apo diçka, sa herë që tundohe mi të bëjmë kompromis me parimet tona? Pasi marrëveshja është bërë, ne ndihemi si lolo. Budallenj. Ndhemi të pavlerë, duke qenë se kemi tradhtuar vetë – vlerësimin tonë. Megjithatë, Krishti ka paguar çmimin përfundimtar me qëllim që të fitojë dashurinë tonë. Nëse secili e ka një çmim, ai e ka paguar për ne, një herë e përgjithmonë. Blerja me anë të gjakut, na bën shumë të çmuar në sytë e tij. Tashmë jemi të blerë dhe është paguar për ne, kështu që të mos e shesim veten. Kujtoje këtë sot.

Ju jeni blerë me një çmim, mos u bëni skllëvër të njerëzve.

1 Korintasve 7:23

**Një kishë që nuk kujton vëllezërit e saj të
persekutuar nuk është aspak kishë.**

**NJË PASTOR LUTERIAN, I CILI KA DURUAR TORTURA TË TMERRSHME
PËR TË MBROJTUR ANËTARËT E KISHËS SË FSHEHTË**



FKSTREM

Mjete ekstreme

SHTETET E BASHKUARA

Tymi i trenit të shkatërruar ishte i dendur, ndërsa të thirrurat e agonisë vinin nga deti i gjakut të pasagjerëve, trupa të vrarë midis makinave të shkatërruara. Midis të plagosurve dhe të vdekurve ecte një kirurg, i cili nuk ishte dëmtuar në përplasje. Megjithatë, bagazhet i kishin humbur në rrëmujë dhe ai thërriste: «Mjetet e mia! Mjetet e mia! Sikur të kisha mjetet e mia!»

Me instrumentat mjekësorë, burri mund të kishte shpëtuar shumë jetë. Me duart bosh, ai qëndronte i pashpresë, duke parë shumë veta të vdisnin.

Sot kisha e persekutuar është si ai kirurgu. Ata e kanë njohurinë dhe gatishmërinë për të shpëtuar shumë jetë të kapura në rrënojat e komunizmit apo të islamit të pa Krisht, por u mungojnë mjetet.

«Dëgjojini të thirrurat e vëllezërve dhe motrave në vendet e robëruara! – shkroi pastor Riçard Vurmbrandi kur erdhi në Shtetet e Bashkuara. – Ata nuk kërkojnë të shpëtojnë; nuk kërkojnë siguri apo një jetë të lehtë, por vetëm mjete për të kundërvepruar ndaj helmimit të rinisë së tyre – brezit pasardhës – me ateizmin. Ata kërkojnë Bibla. Si mund ta ndajnë Fjalën e Zotit, nëse nuk e kanë atë?»

Të krishterët në vendet e izoluara nuk mund t'i sigurojnë vetë këto mjete. Ata shpresojnë që të krishterët në vendet e lira t'i ndihmojnë. 'Na jepni mjetet që na nevojiten, – na tha një i krishterë – dhe ne do të paguajmë çmimin për t'i përdorur ato!»

Shkumës për një mësues, gjilpëra për një infermier, durim për një prind dhe një traktor për një fermer. Çdo person, pavarësisht nga thirrja, përdor mjete. Ato mund të jenë aq të komplikuar, sa një kompjuter, ose aq primitive, sa duart tona, por jeta jonë ndryshon në mënyrë drastike me këto mjete. Si të krishterë, ne i njohim mjetet tona shpirtërore sepse lexojmë për to në Fjalën e Zotit, Biblën. Po ata që s'lexojnë asnjëherë për mjetet e dhembshurisë, faljes, dashurisë, ndarjes dhe të gjitha dhuratat dhe talentet që ofron Zoti? Ti s'mund t'i mbash këto të vërteta për vete, duke i fshehur si një grumbullues koprac ari. Ji i gatshëm t'i ndash mjetet e tua lirshëm me të tjerët në nevojë.

Por, si do ta thërrasin Atë, në të cilin nuk besuan? E si do të besojnë në Atë, për të cilin nuk dëgjuan? Si do të dëgjojnë, nëse ndokush nuk ua predikon?

Romakëve 10:14

Çdo kërcitje e rrotave të trenit e tundte me dhimbje trupin e brishtë të vietnamezes së krishterë në sediljen e ashpër të drunjtë. Por ajo ishte në mision.

Ajo kishte nevojë për ushqim shpirtëror për të krishterët që drejtonte në Vietnamin e Veriut. Tri bashkësi njerëzish luteshin që drejtuesja e tyre do të ishte e suksesshme dhe do t'u sillte kopje të çmuara Bible.

Puna e saj në vend ishte e lodhshme. Ajo ishte e krishtera e vetme e pjekur në zonë dhe kishte mbjellë tri kisha nga hiçi, duke fituar gjithmonë një njeri me anë të dëshmisë së saj personale. Ajo nuk kishte makinë, madje as një biçikletë. Ecte ose lundronte me një varkë të vogël për në takimet e kishës.

Ishte përballur me kërcënimet dhe sulmet e policisë dhe me tronditjen e prindërve të saj budistë për shkak të besimit të saj. Tani udhëtonte një mijë e dyqind kilometra me tren për tri ditë me radhë, duke shpresuar të gjente një besimtar që mund ta ndihmonte. Më në fund arriti qytetin Ho Chi Minh.

Atje takoi vizitorë perëndimorë të krishterë, të cilët i dhanë Bibla për të krishterët në veri. Ata i dhanë edhe një biçikletë për ta ndihmuar teksa u shërbente tri bashkësive. Para se të largoheshin, ata u lutën së bashku, duke kërkuar bekimin e Zotit për udhëtimin dhe shërbesën e saj.

«Sa vjeç jeni?» – pyeti njëri prej tyre, sapo ajo po bëhej gati të largohej. Gruaja largoi tufën e flokëve të zinj nga fytyra dhe pëshpëriti: «Jam njëzet e dy»,

Fëmijët – gjeni kanë aftësi të veçanta përtej moshës së tyre. Ne mund të njohim dikë që ka mbaruar kolegjin në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, apo ka shkruar një simfoni para moshës dymbëdhjetë vjeç, apo që ka shkëlqyer në një sport në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Reagimi ynë është shpesh me xhelozji; sepse edhe ne do të donim të kishim bërë diçka të mrekullueshme në rini dhe të fitonim gjithashtu njohje për të. Gruaja e krishterë vietnameze bëri pikërisht këtë, por ajo ndoshta s'kishte ndonjë aftësi të veçantë më tepër se bashkëmoshatarët e saj. Megjithatë, kishte dëshirë për të ndjekur Krishtin dhe për t'ua sjellë atë njerëzve të vendit të saj. Krishti të thërret edhe ty të jesh këmbëngulës për të. Të ndash dashurinë e Zotit është mjaft e thjeshtë dhe nuk kërkon ndonjë aftësi të veçantë – vetëm disponueshmërinë tënde.

*Kujdesu për këto gjëra dhe kushtoj
atyre tërësisht, që përparimi yt të jetë
i dukshëm për të gjithë.*

1 Timoteut 4:15

Udhëzim ekstrem

FRANCË: FRANC RAVENAS DHE MARTIN GIABER

«Me të dëgjuar dënimin me vdekje, do ta marrësh atë si ftesë nga Mbreti i lavdisë, i cili të ka ftuar në festën e tij të dasmës»,

Udhëzimet ishin të vështira, por të qarta. Autorët francezë, Franc Ravenas dhe Martin Giaber, shkruan një manual udhëzimi për të krishterët që po përballeshin me kërcënimin me vdekje. «Zyra e tyre botuese» ishte qelia e tyre e burgut gjatë revolucionit francez. Ata e panë qelinë si «paradhomën për në parajsë»,

«Kur të kenë përfunduar së lexuari dënimin tuaj» – vazhdon manuali, – «ju do të thoni me shumë martirë që kanë shkuar para jush, «Faleminderit, Zot!» Këndoni këngë të gëzueshme. Kur t'ju lidhin duart, thoni fjalët e Shën Palit: «Unë jam gati, jo vetëm të lidhem, por gjithashtu edhe të vdes për emrin e Jezu Krishtit». Gjatë rrugës për t'ju pushkatuar, u flisni rojave nga Shkrimi për kënaqësinë e vuajtjes dhe vdekjes për Krishtin. Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit? (Romakëve 8:35)

Kur të takoni ekzekutuesin, mbani mend fjalët e martirit të madh Ignaci: «Kur do të vijë momenti i lumtur që do të vritem për Shpëtimtarin tim? Sa kohë duhet të pres? Kujtohuni gjithashtu të thoni një lutje për persekutuesit»,

Ravenës dhe Giaberit u prenë kokën. Fjalët e tyre janë shumë për t'u imagjinuar për shumicën e të krishterëve në vendet e lira, por në vendet e izoluara. ato ndiqen edhe sot.

Çdo ditë që jetojmë duhet të vijë me një paralajmërim: Kujdes! Në çdo moment, tragjedia është një mundësi e qartë. Nëse jemi duke ngarë ndonjë automjet, jemi duke kaluar rrugën apo thjesht po shkojmë në punën e përditshme, s'jemi të sigurt nga një aksident, një sëmundje apo një veprim i qëllimshëm dhune. Ndërsa s'mund të jetojmë të pambrojtur nga të këqijat e kësaj bote, mund të jetojmë me premtimin që Zoti na jep: «Asgjë, absolutisht asgjë s'mund të na ndajë nga dashuria që kemi në Jezusin.» Ndoshta, asnjëherë s'do të vdesësh për besimin tënd, por mund të përballesh me refuzimin dhe persekutime të tjera të dhimbshme. Dashuria e Zotit do të të udhëzojë dhe do të të ndihmojë të përballosh çdo gjë që sot të del përpara.

Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta, as engjëjt, as pushtetet, as fuqia dhe as gjërat e tashme, as gjërat e ardhme, as lartësitë, as thellësitë, as ndonjë tjetër krijesë, nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Romakëve 8:38-39

Mjete ekstreme

EKSTREM

IRAN



«Ne jemi argjila, ai është poçari»,

Një besimtar qëndronte në dritare duke ruajtur rrugët e mesnatës nga ndonjë lëvizje që mund të sinjalizonte policinë që u afrohej adhuresve. Të krishterët po takoheshin në fshehtësi në pjesën jugore të Iranit. Vizitori i huaj shtonte rrezikun, sepse policia iraniane do të tërbohej po të dinte që të krishterët kishin bashkësi me një të huaj.

Një besimtar ishte liruuar kohët e fundit nga arrestimi i policisë dhe vurratat në trupin e tij tregonin për trajtimin që kishte marrë. Megjithatë policia e ruante nga afër dhe e dinte për punën e tij të krishterë, ai vazhdoi të shërbente sa më shumë që të mundej kur nuk ishte nën arrest.

Fliste me zjarr dhe nxiste besimtarët e mbledhur për t'u bërë më tepër si Krishti, pavarësisht nga çmimi. Të gjithë ata e dinin që çmimi do të ishte i lartë, sepse të gjithë njihnin të krishterë, të cilët ishin arrestuar, rrahur apo vrrarë. Të tjerët thjesht ishin zhdukur.

Shërbesa e mrekullueshme ishte e gjatë dhe plot adhurim. Më pas, mysafiri i ftuar, i mahnitur pyeti folësin rreth përvojave të tij në burg dhe vuajtjeve që kishte duruar. «Si mundeni ju» – pyeti ai, – «të mbani një shpirt shprese dhe gëzimi në mes të këtyre telasheve?»

«Këto sprova janë thjesht “mjete” në duart e Zotit», – tha besimtari iranian.

«Kush jam unë të kritikoj mjetet që Zoti përdor për të më bërë më të shenjtë?»

Njerëzit magjepsen prej së ardhmes. Prej shekujsh ne kemi konsultuar astrologë e të tjerë që deklarojnë të njohin të ardhmen tonë. Kemi shkruar libra dhe kemi bërë filma të bazuar mbi konceptin e udhëtimit në kohë. Duam të dimë çfarë ndodhet para nesh në udhëtimin tonë përmes jetës. Megjithatë, ashtu si argjila s'mund ta pyesë poçarin se çfarë do të jetë, kështu edhe ne s'mund ta pyesim Krijuesin se çfarë do të jemi. Por mund të besojmë që Zoti do të krijojë diçka të bukur dhe të shenjtë me jetën tonë. Ne e dimë me anë të besimit që jemi produkte të duarve të Zotit. Si ke nevojë të besosh se Zoti, Poçari, po të kthen ty në një vepër arti?

Megjithatë, o Zot, ti je ati ynë; ne jemi argjila dhe ti je ai që na formon; ne të gjithë jemi vepra e duarve të tua.

Isaia 6:4

FKSTREM

Dashuri ekstreme për kryqin

ROME: ANDREU

«Nëse nuk e mohon këtë Jezus, do të vdesësh në kryq», – tha i inatosur guvernatori Agias. Ky i krishterë i kishte shkaktuar atij një turp personal në sytë e Romës, duke shpërndarë krishterimin në të gjithë provincën e guvernatorit grek, madje edhe gruas së tij.

«Të kisha frikë vdekjen në kryq, nuk do të kisha predikuar madhështinë dhe lavdinë e kryqit të Krishtit», – iu përgjigj Andreu.

«Dhe kështu do të ndodhë! Kryqëzoheni!»

Ndërsa Andreu i afrohej kryqit në formë X-i, ai me gëzim shpallte: «O kryq i dashur! Gëzohem të shoh që je ngritur këtu. Vij tek ti me ndërgjegje në paqe dhe me gëzim, duke dëshiruar që unë, dishepulli i tij, i cili u var në kryq, të mund të kryqëzohem. Sa më tepër i afrohem kryqit, aq më afër vij te Zoti»,

Andreu u var, i lidhur në kryq për tri ditë, duke predikuar dhe duke u bërë thirrje njerëzve përpara tij: «Qëndroni të palëkundur në Fjalën dhe doktrinën që keni marrë, duke udhëzuar njëri-tjetrin, që të mund të banoni me Zotin në përjetësi dhe të merrni frytet e premtimeve të tij»,

Andreu shpalli: «O Zot, Jezu Krisht! Mos lejo që shërbëtori yt i varur në një pemë për hir të emrit tënd të çlirohet për të jetuar përsëri midis njerëzve; merrmë në mbretërinë tënde», Pasi kishte përfunduar përgjërimin e tij, ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit.

Prej porcelani, argjendi të pastër, ari njëzet e katër karatësh, madje edhe prej platini. Kryqet i gjejmë sot në një sërë dizenjosh të ndryshme. Bizhuteri, zbukurime muri, madje edhe në dekoret e pasqyrave. I kudondodhuri kryq. Megjithatë, me gjithë popullaritetin e tij, sa të krishterë kanë ndalur për të konsideruar se çfarë do të thotë të shfaqësh kryqin? Për dikë, kryqi përfaqëson një instrument torturash – imagjinoni të kishit një trekëmbësh apo një karrige elektrike për zbukurim në shtëpinë tënde! Kryqi na kujton që Krishti vdiq me një vdekje të dhimbshme. Përveç kësaj, ai përfaqëson një urë që kalon përtej mëkatit, që dikur na ndante nga Perëndia dhe njerëzit e tij. Jezusi na solli përsëri te Perëndia me anë të kryqit. Pikërisht tani, konsideroje se çfarë kuptimi ka kryqi për ty.

Duke i drejtuar sytë te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit, i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtë të fronit të Perëndisë.

Hebrenjve 12:2

Shpëtim ekstrem

HOLANDË: DËRK UILLEMS

Në Holandën e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Dërk Uillems ishte quajtur si «anabaptist» (ishte kundër pagëzimit të foshnjave) gjatë qeverisjes së katolikëve spanjollë dhe u burgos. Tani ai po vraponte për jetën e tij.

Ishte arratisur nga dritarja e vogël duke zbritur me një litar të krijuar prej rreckash të vjetra. Ndërsa zbriste në pellgun e ngrirë në anë të murit të burgut, ai shkeli me kujdes mbi akull, duke pyetur veten nëse do të binte në të. Por muajt e urisë të duruara në burg tani ia vlenin. Ai mezi peshonte më shumë se dyzet e pesë kile.

Para se të arrinte në anën tjetër të pellgut, një e ulëritur theu heshtjen e natës. «Ndalo menjëherë!» – thirri roja duke dalë nga dritarja prej nga kishte dalë Dërkun disa momente më parë. Dërkun ishte shumë afër lirisë. Ai vazhdoi.

Roja thirri përsëri, kur ai vendosi këmbët mbi akull. Shumë shpejt ai filloi ta ndiqte Dërkun, por në hapin e tretë pati një të kërcitur. Një pllauritje u dëgjua ndërsa roja ra përmes akullit. Të ulëriturat e tij u kthyen në klithma prej të ftohtit dhe tmerrit. «Më ndihmo, të lutem! Më ndihmo!»

Dërkun ndaloi duke parë drejt lirisë. Pastaj u kthye shpejt dhe u drejtua për nga pellgu i burgut. Ai u shtri barkas dhe zgjati krahun për të shpëtuar rojën pothuajse të ngrirë. Në mirënjohje sarkastike, roja e kapi Dërkun dhe e detyroi të kthehej në qelinë e tij.

Pavarësisht nga heroizmi, Dërkun u dogj në turrën e druve për besimin e tij.

Të krishterët e përkushtuar nuk jetojnë sipas logjikës. Ata bëjnë gjëra të pabesueshme duke ditur plotësisht pasojat, bëjnë të pamundurën sikur të ishte një gjë e zakonshme. Besimtarët jetojnë sipas një thirrjeje më të lartë. Veprimet dhe reagimet e tyre janë aq të panatyrshme, sa shumë shpesh keqkuptohen. Për disa, shpëtimi ekstrem i Dërkut duket si një zgjedhje e panatyrshme, madje, ndoshta edhe pak si budallallëk. Megjithatë, Dërkun besonte se thjesht po ndiqte gjërat bazë të Biblës. Ai vendosi nevojat e të tjerëve para të tijave. Kur ne bëjmë sakrificë, jo gjithmonë do të kenë kuptim për botën, por e marrë nga një perspektivë qiellore, ne e dimë që po përparojmë. A jeton shumica prej nesh sipas logjikës? A je ti i përkushtuar të ndiqësh urdhërimet e Zotit me çdo kusht?

*Ki besim te Zoti me gjithë zemër
dhe mos u mbështet në gjykimin
tënd.*

Fjalët e urta 3:5

**Unë e urrej sistemin komunist, por i
dua njerëzit. E urrej mëkatin, por e dua
mëkatarin. I dua komunistët me gjithë
zembrën time. Komunistët mund t'i vrasin të
krishterët, por s'mund të vrasin dashurinë e
tyre, *madje edhe për ata që i vrasin.***

**Unë nuk kam as edhe më të voglin
hidhërim, apo mëri kundër komunistëve apo
torturuesve të mi.**

ISH I BURGOSUR PËR BESIMIN NËN KOMUNIZËM

«Pse rrezikon fëmijët e tu?» – pyeti njëri prej tre oficerëve egjiptianë.

Ahmedi ishte arrestuar shumë herë për ndarjen e besimit dhe për shpërndarje të literaturës së krishterë. Por ai e shihte çdo marrje në pyetje si mundësi për të dëshmuar për Krishtin.

«Siguria e fëmijëve të mi nuk vjen prej meje», – i tha me qetësi oficerit. – «Ajo vjen prej Perëndisë. Unë s'do të ndaloj së ndari për Jezusin, sepse ai është Rruga e së vërtetës. – tha Ahmedi. – Jezusi ka ndryshuar zemrën time».

Oficerët e pyetën atë për literaturën e krishterë që ishte shtypur në fshehtësi. Ata e pyetën edhe për të krishterë të veçantë dhe veprimtarinë e tyre. Në të dyja rastet, Ahmedi qëndroi në heshtje.

«Nuk u thashë asgjë, – tha ai më vonë. – Unë nuk do të bëhem tradhtar i Trupit të Krishtit». Kur ata i kërkuan të spiunonte të krishterë të tjerë dhe të raportonte në polici, ai u tha: «Nuk e kam për detyrë këtë».

Në një rast tjetër, Ahmedi u kap dhe u mor në pyetje nga policia në Turqi, sepse kishte çanta plot me literaturë të krishterë. «Nëse nuk u përgjigjesh pyetjeve tona dhe nuk na ndihmon, do të të burgosim, sepse i ke shkaktuar probleme qeverisë turke», – e siguroi policia.

«Jezusi nuk na thotë të shkaktojmë probleme për qeveritë», – u përgjigj Ahmedi. – «Ai do që ne të dëshmojmë për dashurinë dhe faljen e tij».

Ngatërrestarë. Ata janë fëmijë në një orë mësimi që s'mund të pushojnë së biseduari, janë prepotentët në një mensë shkollë që vjedhin paratë e drekës së të tjerëve. Ato janë thashethemet në zyra që flasin keq për të tjerët dhe i shpërndajnë si epidemi. Të krishterët nuk janë thirrur për të qenë ngatërrestarë. Në fakt Jezusi na thërret për të qenë paqebërës. Ky rregull nuk ka asnjë përjashtim, megjithatë ne duhet të bëhemi ngatërrestarë për Satanin dhe planet e tij. Ne s'mund të përçmohemi nga djalli si të padëmshëm për mbretërinë. Lutja është arma jonë më e fuqishme. Sa shpesh e ndërpresin lutjet e tua punën e Satanit? Ji i zënë sot duke u lutur në emër të Jezusit kundër planeve të kundërshtarit tënd.

Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër kurtheve të djallit.

Efesianëve 6:11

FKSTREM

Bindje ekstreme

KINË: NJË PASTOR DHE E ËMA

Pastori ishte marrë në pyetje dhe ishte rrahur shpesh, por sot roja e mori atë në një dhomë për të biseduar dhe i tha: «Jam kurioz për besimin tënd dhe kërkoj të më thuash Dhjetë Urdhërimet»,

I tronditur, pastori filloi të ndante Urdhërimet. Kur arriti të «Ndero babanë dhe nënën tënde», oficeri e ndërpreu. «Ndalo atje. Ju të krishterët besoni që Zoti zgjodhi që «Ndero babanë dhe nënën tënde» të jetë një urdhërim shumë i rëndësishëm. Të lutem, shiko në qoshe», Pastori u kthye për të parë një grua të prangosur dhe të dërrmuar nën një grumbull rreckash. Ajo ishte vetë nëna e tij.

Roja vazhdoi. «Shiko sa ka vuajtur mamaja jote. Nëse tregon sekretet e kishës së fshehtë, ti dhe nëna jote mund të liroheni. Nëse ajo vdes nga torturat tona, ti nuk do ta kesh mbajtur urdhërimin për të nderuar atë dhe gjaku i saj do të jetë mbi kokën tënde»,

Pastori u kthye nga e ëma, e cila po fillonte të përmendej. «E dashur nënë, çfarë duhet të bëj?»

Me dashuri ajo u përgjigj: «Që kur ke qenë i vogël të kam mësuar ta duash Krishtin dhe kishën e tij. Mos e tradhto Zotin! Unë jam gati të vdes për emrin e shenjtë»,

Pastori u kthye nga roja dhe tha me kurajë të ripërtërirë: «Ke të drejtë, kapiten. Së pari, një njeri duhet t'i bindet nënës së vet»,

«Pse ka kaq vuajtje në botë?» – pyesin shpesh skeptikët kur duan të zholerësojnë krishterimin. Ata s'mund të pajtohen me një Zot të dashur që lejon që të pafajshmit të vuajnë. Në fakt, ata mund të përpiqen t'i bindin të krishterët, të cilët përjetojnë vuajtje, që problemet e tyre provojnë në njëfarë mënyre që planet e Zotit kanë shkuar keq. A është vuajtja në të vërtetë pjesë e planit të Zotit? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, shikoni jetën e Jezusit në tokë. Vuajtja e tij në kryq ishte zemra e planit të Zotit – që rezultoi në shpëtimin tonë dhe lavdinë e tij. Kur ti vuan sipas planit të Zotit, ti po ec ku eci Jezusi: drejt kryqit – drejt varrit dhe përfundimisht – drejt qiellit. A do të besosh ti se Zoti e di se ç'bën edhe në dhimbjen tënde?

Por, gëzohuni, duke qenë pjesëtarë të mundimeve të Krishtit, që edhe në zbuluesën e lavdisë së tij, të mund të gëzoheni dhe të ngazëlloni.

1 Pjetrit 4:13

Shembuj ekstremë

SHTETET E BASHKUARA: MAMAJA E SOFISË

Në vitin 1996, vajza jonë, Sofia, pati një krizë të gjatë që i shkaktoi dëmtim të përhershëm në tru. Ajo vuajti muaj të tërë, duke qarë pa reshtur për dy ose tri ditë, çdo herë duke u përpëlitur nga dhimbjet. Ajo nuk na njihte dhe nuk na përgjigjej.

Një infermiere s'mund ta kuptonte pse nuk ishim të zemëruar me Zotin që lejoji që kjo të ndodhte. U përpoqa ta ndihmoja të kuptonte se ne jemi shërbëtorët e tij dhe s'mund ta mohojmë dhuratën e jashtëzakonshme që Zoti na ka dhënë në Birin e tij. Katër muaj pas krizës, Sofia vdiq.

Ditën që ajo vdiq, pashë një fotografi nga një artikull i Zërit të Martirëve të një motre sudaneze, së cilës i ishte prerë gjoksi pranë foshnjës së saj. Persekutuesit e torturuan duke bërë këtë gjë të tmerrshme, duke e detyruar të shihte foshnjën e saj të vdiste nga uria. Mijëra kilometra larg prej vendit nga ishte ajo, e njihja dhimbjen e saj dhe qava duke menduar se nuk do ta lejoja veten të zhytesha në vetë-keqardhje.

Ajo grua dhe gra të tjera si ajo nuk kanë përfitimin e kujdesit mjekësor, bashkësisë dhe dashurisë nga vëllezërit siç kishim ne. Por megjithatë, ata kanë duruar kaq shumë, kështu edhe unë me hirin e Zotit mund të duroj.

Unë kam nevojë për këto letra të gjalla të Zotit Jezu Krisht për të shprehur realitetin që Jezusi jeton dhe kjo botë nuk është shtëpia ime.

Ndërsa prania e Zotit është gjithmonë pranë përmes personit të Frymës së Shenjtë, shpesh kemi nevojë për këta inkurajues shpirtërorë të gjallë të na ndihmojnë në besimin tonë. Martirët dhe besimtarët e tjerë gjatë gjithë shekujve janë persona realë, shembuj realë të kurajës, të cilët na inkurajojnë të besojmë se ndoshta, vetëm ndoshta, mund të jemi në gjendje të përgjigjemi në njëjtën mënyrë. Mund të mos ndajmë të njëjtat kundërshtime, probleme, por mund të përshtasim shpirtin e tyre të guximit në jetën tonë të përditshme. Bëhu shembull. Mëso të tjerët të marrin fuqi prej atyre që kanë shkuar më parë, duke jetuar besimin e tyre si shembull për të gjithë.

Sepse ju e tregoni se jeni letra e shkruar prej Krishtit, të cilët ne i shërbyem, e shkruar jo me ngjyrë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë, jo në rrasa guri, por në rrasa mishi të zemrës.

2 Korintasve 3:3

Refuzim ekstrem

RUSI: SERGEI MEKEN

«Krishterimi nuk është një mësim që dikush mund ta marrë nga librat apo nga predikimet. – predikoi Sergei Meken, drejtuesi i kishës Maroseika në Moskë. – Jezusi tha: »Unë jam e vërteta». E vërteta është një lloj i veçantë jete që ju siguron duke ndjekur shembullin e Krishtit».

Ishte viti 1923 dhe qeveria e re komuniste e Ruisë kishte nxjerrë të ashtuquajturën «Kishë e Gjallë», e cila nuk ishte gjë tjetër veçse socializëm i maskuar si krishterim. Pastor Sergei refuzoi hapur të lexonte lutjet e përcaktuara apo të predikonte idenë e shpëlarë që aprovonin komunistët për Zotin. Ai vazhdoi t'ia predikonte të vërtetën tufës së tij, duke e ditur që mund të vuante për këtë.

Për pesë vjet Sergei u burgos dhe komunistët e mbyllën kishën e tij, por koha e tij në burg vetëm sa e përgatiti Sergein më shumë për shërbesën. Menjëherë pas lirim, ai filloi punën me kishën e fshehtë. Shërbeu me besnikëri çdo ditë derisa pastori i tij i mëparshëm, një njeri që i kishte kthyer shpinën Zotit, e tradhtoi. Qeveria e shpërbleu atë pastor me punë si pedagog.

Sergei kishte lexuar shpesh fjalët e Jezusit që «një bari i mirë jep jetën e tij për delet». Ai vendosi të mos i tradhtonte kurrë vëllezërit e tij. Për aktivitetet e vazhdueshme të krishtera, Sergei Meken u ekzekutua nga një skuadër pushkatimi në vitin 1941. Jeta e tij shkoi, por mesazhi i tij mbetet: «E vërteta nuk ndryshon sipas nevojave të dikujt».

Zoti nuk vjen brenda një kutie. Ai vjen me gjithë lavdinë dhe plotësinë e tij, ndryshe nuk do të ishte aspak Zot. Disa mund të jenë të shpejtë në të thënë se nuk janë kundër Zotit, për sa kohë që u predikohet zoti që u pëlqen atyre. Sikur të ishin në një bar, ata do të zgjidhnin atë që do t'u pëlqente rreth idesë së Zotit duke i lënë gjërat e tjera si mbeturina. Megjithatë, natyra dhe karakteri i Zotit nuk ndryshojnë sipas tekave të njerëzve. Ne mund të përpiqemi ta kthejmë Zotin në një formë tjetër, por patjetër që do të dështojmë. Refuzo këdo që hedh poshtë karakterin dhe natyrën e Zotit në çfarëdo pike. A mund ta njohësh herezinë kur e sheh?

Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirri në lavdinë e tij të përgjeshme në Krishtin Jezus, pasi të keni vuajtur për pak kohë, do t'ju bëjë të patundur, do t'ju forcojë dhe do t'ju vërë themel.

1 Pjetrit 5:10



Pastori, gruaja e tij dhe gjashtë fëmijët e tyre të vegjël sapo kishin lexuar Psalmin 23, ndërsa ishin duke ngrënë mëngjes. Papritur policia hyri me forcë në shtëpi për ta bastisur dhe për të arrestuar pastorin.

Policia e pyteti: «Nuk ke asgjë për të thënë? Nuk ke asgjë pishman apo keqardhje?» Pastori tha me kujdes: «Ju jeni përgjegjja për atë që u lutëm sot. Sapo lexuam Psalmin 23, që Zoti përgatit një tavolinë për ne në praninë e armiqve tanë. Ne kishim një tavolinë, por asnjë armik. Tani keni ardhur ju. Nëse dëshironi ndonjë gjë që ndodhet në tavolinë, do të doja ta ndaja me ju. Ju jeni dërguar nga Zoti».

«Si mund të thuash budallallëqe? Ne do të të çojmë në burg dhe ti do vdesësh atje, s'do t'i shohësh më asnjëherë fëmijët e tu», Përsëri shtruar pastori vazhdoi: «Për sot ne lexuam edhe: «Dhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë».

Oficeri bërtiti: «Të gjithë e kanë frikë vdekjen. E di, sepse e kam parë në fytyrat e tyre».

«Hija e një qeni s'mund të të kafshojë dhe hija e vdekjes s'mund të të vrasë. Ju mund të na vrisni apo të na fusni në burgje, por asgjë s'mund të na ndodhë. Ne jemi në Krishtin dhe nëse vdesim, ai do të na çojë në botën e tij».

Paqja. Po bëhet aq e vlefshme, sa një aksion i qëndrueshëm në ekonominë e shqetësimit dhe dhunës. Fatmirësisht, të gjithë besimtarët janë aksionistë të dhuratave të Zotit nëpërmjet Jezu Krishtit. Por shumë njerëzve u mungon kjo paqe. Disa marrin udhëzime dhe shqetësohen pafundësisht, duke u përpjekur të marrin paqe larg Zotit. Çdo lloj ndjenje të mirë që mund të gjejnë, është më e mira e përkohshme, sepse shpejt kthehet në shqetësim. Përkundrazi, paqja e Zotit na bën të mundur të kemi sukses të paqtë në vuajtjet tona. Asnjë sprovë s'mund ta lëkundë besimin tënd në të. Si pastori i butë në histori, megjithëse fatkeqësia mund të godasë pa paralajmërim, ti do të jesh i përgatitur me paqen e përsosur të Zotit.


Ti, o Zot, u jep paqen e plotë atyre që ta mbajnë besën dhe kanë besim tek ti.

Isaia 26:3

FKSTREM

Mendime ekstreme

RUSI: PRINCI VLADIMIR



«Lëviz, o princ», – qeshi roja duke mbërthyer krahun e të riut. «Le të shohim sa do ta pëlqesh strehimin e ri», Rojat e zhvendosën princin Vladimir nga shtëpia mbretërore e Gikës në qelinë e ashpër të burgut. Në një qoshe, ai mund të shihte një të burgosur të dobët, me pamje meiti t'u jepte rrobat dhe batanijet të burgosurve të tjerë. Nga prapa mund të dëgjonte ulërimat e të burgosurve që torturoheshin.

Ky vend ishte shumë larg prej jetës luksoze që kishte njohur në shtëpi. Por, për sëri princi Vladimir u mbijetoi kushteve çnjerëzore në burg duke u mbajtur fort në besimin në Krishtin, i cili e ngushëlloi dhe e drejtoi. Një shok qelie i Vladimirit një herë tha: «Asnjëherë s'kam dëgjuar lutje më të pastra dhe më tepër mendime me vlerë të përjetshme sesa në burgjet komuniste»,

Mendimet e përjetshme të Vladimirit nga kjo kohë u botuan në një libër të fuqishëm. Ai shkroi: «Lum ata që shpërndajnë gëzim që ngrihet prej vuajtjeve të tyre. Ai që mohon veten për të tjerët e vesh veten me Krishtin. Kërkoni dikë që nuk guxon t'ju afrohet. Jepini dikujt që nuk kërkon, duajeni atë që ju largon. Sjellshin vuajtjet e mia gëzim për të tjerët»,

Kush do të ëndërronte që «lutje të tilla të pastra dhe mendime me vlerë përjetësie» do të vinin nga një princ i rënë nga fronti, i cili u mbijetoi birucave të mizorisë komuniste?

Mendimet negative mund të na ndikojnë thellësisht. Nëse fokusojmë mendjet tona te vuajtjet, si rezultat mund të hidhërohemi dhe të mbajmë mëri. Nëse zgjedhim të mendojmë pozitivisht në mes të një krize, atëherë mund ta ngremë veten tonë mbi rrethanat. Jo vetëm që mund të shpëtojmë veten nga dekurajimi dhe dëshpërimi, por mund të ndihmojmë edhe të tjerët. Vladimiri përjetoj gëzim në vuajtjet e tij. A je pre e negativitetit kur kalon sprova? Mbaj mend, ti s'mund të kontrollosh çfarë ndodh në jetë, por mund të kontrollosh qëndrimin tënd. Refuzo të jesh negativë. Kërkoji Zotit të të japë një perspektivë pozitive mbi sprovat e tua dhe të të hapë sytë për të ndihmuar të tjerët.

Dhe paqja që jep Perëndia, që është më vlefshme se mund ta mendojmë, do t'i ruajë zemrat dhe mendimet tuaja në Krishtin Jezus.

Filipianëve 4:7

Pa prehje është zemra derisa prehet në ty.

SHËN AUGUSTINI



FKSTREM

Shenjtor ekstrem

ROME: SHËN NIKOLLA

«Mos e bëj këtë!» – thirri Nikolla ndërsa pa ekzekutuesin të ngrejë shpatën për të vrarë një të burgosur tjetër. – «Ai s'ka bërë asgjë për të merituar këtë». Burri ishte gati për t'ua ekzekutuar për besimin e tij në Jezu Krishtin. Nikolla rrëmbeu me guxim shpatën e ekzekutuesit para se ajo të përshkonte trupin e të burgosurit.

» Bëj si të duash, Nikolla... kam shumë të tjerë për të vrarë sot». Ekzekutuesi pështyu ndërsa largohej dhe vazhdoi me detyrën e tij diku tjetër.

Nikolla foli me guxim për Krishtin në një kohë të vështirë në histori. Në vitin 303, perandori Dioklecan filloi një nga persekutimet më brutale të të krishterëve. Kaq shumë të krishterë vriteshin, sa ekzekutuesit ishin të rraskapitur dhe punonin me turne.

Nikolla u damkos me hekur të nxehtë, u mbijetoi të rrahurave të tmerrshme të rojave. Duroi edhe tortura të tjera – vetëm sepse refuzoi të mohonte se Jezusi është Biri i Perëndisë. Si mund ta mohonte ai atë, i cili ishte aq real për të? Nikolla mbeti i palëkundur në mes të një padrejtësie të madhe.

Pasi u lirua nga burgu, ai kaloi pjesën tjetër të jetës së tij duke u kujdesur për jetimët dhe duke mbrojtur fëmijët e varfër. Ishte i përkushtuar në përparimin e ungjillit të Krishtit në mënyra krijuese. Një herë madje, ai hodhi para të mbështjella në një çorape krishtlindjeje përmes dritares së shtëpisë së dy vajzave shumë të varfra, që ato të mos shiteshin në një shtëpi prostitucioni.

Shumë vite pas vdekjes së tij, Nikolla me mirëdashje u quajt Shën Nikolla. Për shumë fëmijë, nata para Krishtlindjes është nata më magjike e vitit, ndërsa ata presin një vizitë nga Santa Klausi (Plaku i Vitit të Ri), një karikaturë e Shën Nikollës. Historia e vërtetë e jetës përtej Shën Nikollës është më heroike dhe e dashur se ç'mund të ëndërroj në shumica e fëmijëve. Mendoni për historinë e jetës suaj. A e njohin njerëzit të vërtetën për besimin në Jezu Krisht? Apo ju njohin ju thjesht si një person i dashur dhe me moral të pazakontë? Megjithëse Santa Klausi nuk është i vërtetë, Shën Nikolla ishte dhe gjithashtu, edhe ti duhet të jshi. Ti mund të mos ndihesh si shenjtor, por bota ka nevojë për shembuj të vërtetë të krishterësh të vendosur. Çfarë do të bësh sot për ta jetuar besimin tënd në një mënyrë të vërtetë?

*Duajeni Zotin, ju, besnikët e
tij, sepse ai e mbron atë që ia
mban besën.*

Psalmi 31:23

FKSTREM

Gatishmëri ekstreme

BETLEHEM: MARIA, NËNA E JEZUSIT

«Nuk e kisha imagjinuar të lindja foshnjën tonë të parë në këtë mënyrë», – tha gruaja e re midis dhimbjeve të lindjes. «A je i sigurt që kjo është mjaft e pastër?» – e pyeti ajo të fejuarin e saj, Jozefin.

«Nuk e di, e dashur, – tha ai i shqetësuar, – por kjo është ajo që kemi. Ne e dimë që Perëndia do ta mbrojë këtë foshnjë. Ai duhet të ketë një plan, meqë po e presim foshnjën këtu».

Ndërsa një kontraktim tjetër i dhimbshëm erdhi u afrua, i fejuari e këshilloi: «Përpiqu të marrësh frymë gjatë kohës», – dhe ia fshiu fytyrën me një leckë të lagur. «Mbahu fort... duhen dhe shumë pak minuta».

Ajo tha përmes dhëmbëve të shtrënguar: «Unë doja ta lindja fëmijën në shtëpinë time. Doja që mamaja ime të ishte atje për të më ndihmuar».

«Jam unë këtu për të të ndihmuar, – tha Jozefi, – kështu që duhet t'ia dalim mbanë vetë. Dhe ne të dy e dimë që edhe Perëndia është këtu». Pastaj bëri pak shaka: «Nëse na duhet më tepër ndihmë, kemi edhe lopët dhe bagëtinë ngjitur».

Kontraktimi kaloi dhe Maria i buzëqeshi të fejuarit të saj të ri. Në kontraktimin tjetër, Maria filloi të shtynte. Shumë shpejt djali i saj erdhi në botë. Ata e quajtën Jezus, ashtu si i kishte udhëzuar engjëlli.


Ne ndonjëherë i harrojmë vështirësitë që Jozefi dhe Maria kaluan për të sjellë në jetë mbretin e mbretërve: një stallë në vend të një

dhome lindjeje, mërgimi në Egjipt, varfëria dhe skandali. Por ata duruan gjithçka me dëshirë nga dashuria për Perëndinë.

Ndërsa lexojmë Biblën, mund të mendojmë se besimi në premtimet e Jezusit do të ishte më i lehtë, nëse ai do t' i paketonte ato me disa shenja përfundimtare, si një engjëll lajmëtar. Por, edhe Maria që mori një shenjë të tillë, kishte dyshimet e saj. Kur engjëlli Gabriel e lajmëroi se ajo do të lindte Birin e Perëndisë, dukej ndoshta si e paimagjinueshme. Ajo e pyeti Gabrielin: «Si do të jetë e mundur kjo... meqenëse unë jam e virgjër?» Pavarësisht nga shqetësimet e saj, Maria vendosi me gatishmëri t'i besonte premtimit të Zotit dhe t'i bindej atij. Gatishmëria e saj e thjeshtë solli planin e shpëtimit të Perëndisë për botën. A po të thërret Zoti në gatishmëri pavarësisht nga dyshimet e tua? Si Maria, gatishmëria jote për t'u bindur mund të ketë një ndikim të përjetshëm në mbretërinë e Perëndisë.

Ja shërbëtorja e Zotit; le të më ndodhë sipas fjalës sate.

Luka 1:38



Dimitru Baku ishte një i burgosur i krishterë gjatë viteve 1950 dhe 1960. Si shumë të tjerë, krimi i tij ishte thjesht të qenit i krishterë. Dimitru i përdori njëzet vjetët në burg për të krijuar poezi dashurie për Zotin. Poemat u shkruan me kujdes në copa të vogla sapuni apo në mure në kodin mors, që të tjerët të mund t'i mësonin dhe t'i kalonin nga qelia në qeli.

«Dhimbjet, të cilat dobësonin trupat tanë nuk ishin në gjendje të zotëronin zemrat tona.» – tha Baku pas lirimit të tij. – «Në vend të urrejtjes, ne kultivojmë dashuri, kup-tueshmëri dhe urtësi.»

Këtu është një prej poemave të tij, e krijuar në izolim në një qeli të pushtuar nga minjtë, çimkat dhe morrat:

Jezusi m'u shfaq në qelinë mbrëmjen e shkuar;

Ai ishte i gjatë, plot dritë, por pak i trishtuar

Drita e hënës, e çmuar për mua, u venit
Kur fytyra ime, e lumtur u mahnit

Ai erdhi e qëndroi pranë shtratit ku lëngoja

Në qetësi për vuajtjet e tij dëgjoja

Shenjat ishin atje të gjitha, në duart dhe këmbët e tij,

Dhe një plagë në anën e zembrës që rrihte përsëri

Ai buzëqeshi dhe shkoi. E unë rashë mbi gur

«I dashur Jezus, mos më lër vetëm» – fort duke thirrur

Duke shtrënguar hekurat u çava në duar:
Shenja të bekuara, dhuratë e bekuar.

Një qeli e zyrtë burgu dhe humbja e lirive bazë nuk janë zakonisht lloji i frymëzimit poetik. Dimitru ishte në gjendje t'i kthente vuajtjet e tij në një mundësi për të lavdëruar Zotin dhe të ndikonte jetën e njerëzve të tjerë për Krishtin. Vuajtjet e tij u zbehën kur ai konsideroi se çfarë kishte vuajtur Krishti për të. Nëse do të përjetonin atë që përjetoi Dimitru, shumë besimtarë do të ndiheshin të irrituar ose të fyer e jo të frymëzuar. Disa do të dyshonin që Zoti kujdesej për ta. Krijimi i vargjeve poetike të lavdërimit për Zotin do të ishte gjëja e fundit që do t'u kishte shkuar ndër mend atyre. Por Dimitru u fokusua te Krishti e jo te qelia dhe u mbush me lavdërim. Si reagon ti në kohë vuajtjesh? Kur thirrësh për të vuajtur, do të shohësh pengesa për lumturinë tënde apo mundësi për të lavdëruar dhe për t'i shërbyer Zotit?

Unë jam mësuar të gëzohem në gjendjen që jam.

Filipianëve 4:11

FKSTREM

Përkrashje ekstreme

RUMANI: ANUCA MOISE

Pasi komunistët sovjetikë morën në kontroll Rumaninë, ata i ndiqnin gjermanët si simpatizues të nazizmit. Anuca Moise vendosi të siguronte një vend për të fshehur pikërisht njerëzit që e kishin urreyer se ishte çifute dhe e krishterë. Kur ofroi ndihmë për të fshehur këta njerëz nga komunistët, ata s'mund ta besonin se oferta e saj ishte e vërtetë.

«A nuk të kujtohet se ishim pikërisht ne ata që të çuam në burg?», – pyeti njëri prej tyre.

«Sigurisht që më kujtohet, – tha Anuca, – por unë jam e krishterë dhe Zoti nuk më lejon të mbaj mëri. Ju kam falur dhe tani kam mundësinë për t'ju ndihmuar. Jezusi ju do, kështu që ju dua edhe unë »,

Dashuria e saj i habiti dhe shumë prej tyre u fituan për Krishtin me anë të shembullit të saj. Ajo, bashkë me Ricard dhe Sabina Vurmbrandin e të tjerë, rrisnin fëmijë, prindërit çifutë të të cilëve ishin shfarosur në kampet naziste të vdekjes.

Më vonë Anuca emigroi në Norvegji, ku ishte aktive në shërbesë ndaj besimtarëve çifutë. Në këtë shërbesë, ajo mblodhi 10 mijë dollarë për të paguar shumën për pastorin e saj të mëparshëm, Riçard Vurmbrandin, duke fituar lirinë e tij nga Rumania. Anuca u mor me organizimin e udhëtimit për t'i çuar Vurmbrandët dhe djalin e tyre, Mihai, në perëndim. Pa dashurinë e Anucës dhe

përkujdesjen e saj ndaj tij, një pastor me influencë dhe themeluesi i Zërit të Martirëve mund të kishte vdekur në një burg komunist.

Kur Zoti na thërret për ta ndjekur atë dhe ne i përgjigjemi, do të thotë ta ndjekim kudo dhe të bëjmë çfarëdo që ai na kërkon. Për shkak se Anuca e mori këtë thirrje seriozisht, ajo veproi me dashuri dhe falje ndaj armiqve të saj. Detyra e strehimit të shtypësve të saj të mëparshëm duhet të jetë dukur monumentale, por Anuca ishte në gjendje ta bënte këtë. Ajo zgjodhi faljen ndaj hidhërimit dhe hakmarrjes dhe ndoqi shembullin e dashurisë së Krishtit. Çfarë të ka thënë Zoti të bësh? Mos e humb mundësinë për të bërë punë me rëndësi të përjetshme.

T'i doni armiqtë tuaj; u bëni mirë atyre që ju urrejnë.

Luka 6:27

«Ndonjëherë kam mall për ato ditë persekutimi!»

Fjalët dolën nga një pastor iranian, i cili ishte larguar për në perëndim. Në Iran, arrestimet dhe sulmet e policisë ishin eksperiencia të zakonshme. Ai kishte humbur madje shtëpinë dhe punën për shkak të besimit të tij. Tani ishte i lirë për të jetuar dhe adhuroar ku të donte. Si të mund të kishte mall për ditët e persekutimit?

«Ndonjëherë kam mall për ato ditë, – tha ai – sepse isha i gjallë. E ndieja çdo ditë që Jezusi ishte me mua.»

Pastori kishte mbjellë një kishë afër vijës së frontit të luftës Iran – Irak. Fitonte para duke ngarë një taksi dhe e rriti kishën e tij duke ndarë Krishtin me pasagjerët e tij. Brenda dy vjetëve, kishte fituar njerëz prej nëntë gjuhëve të ndryshme. Shumë ushtarë adhuronin me ta çdo javë dhe ai kishte pagëzuar pesëmbëdhjetë myslimanë të kthyer në besim.

Pastori dhe e shoqja besonin në Perëndinë për gjithçka. Kur bombat e luftës ranë rreth tyre, ata u lutën për mbrojtjen e tij. Kur s'kishin para mjaftueshëm, ata luteshin për sigurimin e tyre. Dhe çdo ditë Zoti siguronte për ta.

Shërbesa e tyre u shpërblye. Dhjetë anëtarë të kishës së tij kanë shkuar për t'u bërë pastorë. Madje edhe tani, pastori mund të shohë frytet nga koha e shërbesës në vijën e frontit.

Nëse s'keni rënë ndonjëherë në dashuri, s'mund ta kuptoni ç'do të thotë të jesh zemërthyer. Nëse s'keni humbur ndonjëherë ndonjë person të dashur, s'mund t'i kuptoni në të vërtetë ata që mbajnë zi. Ju s'mund të kuptoni një mall për diçka që s'e keni përjetuar ndonjëherë. Ata që janë persekutuar për besimin e tyre përshkruajnë një mall të veçantë. Ata nuk kanë aq mall për persekutimin, sesa për ndjenjën e bashkësisë që u solli persekutimi, nuk kanë mall për torturat, sesa kanë mall për atë që torturat u mësuan. Rezultati përfundimtar s'mund të krahasohet me vuajtjen. Nëse do të përjetosh një ecje më të thellë me Jezusin, duhet të jesh gati të sakrifikon me bindje për të. Edhe kjo është një lloj vuajtjeje.

Sepse vështirësia jonë e lehtë dhe e përkohshme na sjell një lavdi të përjetshme, pa krahasim më të madh.

2 Korintasve 4:17

DEKLARATË EKSTREME

RUSI: PJETËR SIMENS

Pjetër Simens qëndronte i shtrirë në dyshmenë e zyrtë të një burgu rus, pasi ishte pa ndjenja për tri ditë. Ishte arrestuar për ndarjen e ungjillit me fëmijët. Të burgosurit e tjerë e kishin rrahur tmerrsisht si shpërblim për premtimin e liritimit me kusht nga rojat. Ndërsa ata e sulmonin, Pjetri qëndronte në heshtje.

Duke parë se ishte i vetëdijshëm, njëri prej të burgosurve e pyeti: «Pse nuk bërtisje kur të rrihnim?»

«Nuk e dija nëse po më rrihnit thjesht për qejfin tuaj, pa aprovimin e rojave», – u përgjigj Pjetri përmes buzëve të gjakosura. «Nëse do të ishte kështu dhe unë do të kisha bërtitur, ju do të ishit dënuar për sjellje jo të mirë në burg. Unë nuk doja që ju të vuanit, sepse Jezusi ju do, kështu që ju dua edhe unë.»

Deklarata fisnike e Pjetrit fitoi zemrat e kriminelëve të ngurtë në qelinë e tij. Ata dërguan fjalë përmes një burimi të fshehtë që askush s'duhej ta prekte atë, pavarësisht se ku do të transferohej apo se çfarë shpërblimesh do të ofronin rojat.

Ndërsa prisnin ekzekutimin e tyre, të burgosurit dëgjuan historinë e Pjetrit dhe dërguan fjalë duke kërkuar ndihmën e tij. Pjetri u përgjigj dhe me ndihmën e rojave jo striktë, ai u tregoi për historinë e dashurisë së Jezusit. Disa prej tyre mund të kenë pranuar Krishtin para ekzekutimit për shkak të shërbesës së Pjetrit. Shembulli i tij i gjallë i dashurisë së Krishtit solli një mundësi

të rëndësishme për të tjerët. Ata, të cilët ndryshe nuk do të kishin dëgjuar, morën mesazhin e ungjillit.

Fjala e folur mund të jetë e fuqishme. Një fjalë këshille në kohën e duhur, dashurie apo inkurajimi mund të shkojë kilometra larg kur dikush është në nevojë. Po kur dikush është shpirtërisht në nevojë? Fjalët e Pjetër Simensit ishin të motivuara nga dashuria e tij për Krishtin. Ajo dashuri e aftësoi atë t'u fliste me guxim për dashurinë e Krishtit armiqve të tij në kohën kur ata kishin më shumë nevojë për ta dëgjuar. Pjetri ishte i bindur ndaj drejtimit të Zotit dhe Zoti përdori fjalët e Pjetrit për të ndryshuar shumë prej destinacionit të përjetshëm të të burgosurve. A përdori Zoti fjalët e dikujt për të të drejtuar ty te Jezusi? Kur Zoti të thërret për t'i treguar dikujt tjetër për Jezusin, a do t'i bindesh atij në atë kohë? Konsidero ndryshimin e përjetshëm që mund të sjellë shembulli dhe fjalët e tua.

Një fjalë e thënë në kohën e duhur është si mollë të arta mbi një enë argjendi.

Fjalët e urta 25:11

**Persekutimi nuk na largon prej shtëpisë
sonë. Persekutimi na ndihmon për të na çuar
në rrugën drejt «shtëpisë» sonë të vërtetë.**

PASTOR J. KOLAU



FKSTREM

Zhgënjim ekstrem

EVROPA LINDORE: NJË UNGJILLTAR I FAMSHËM

«Adoleshenti nuk u kthye kurrë më».

Ungjilltari i famshëm foli pas hekurave të burgut. Një predikues i fuqishëm, i njohur në mbarë Evropën Lindore, po thoshte se si s'mund të gjente paqe. Ky njeri kishte drejtuar mijëra te Krishti, kështu të burgosurit e tjerë të krishterë nuk mund ta kuptonin ndjenjën e tij të dështimit.

«Kisha predikuar në një takim ungjillizimi», – shpjegoi ai. – «Kisha derdhur zemrën time dhe në fund dyqind veta erdhën përpara për të pranuar Krishtin. Isha i rrëqethur, por edhe i lodhur. Ndërsa po largohesha, një djalë i ri erdhi tek unë. «Pastor, kam nevojë të flas me ju», – tha ai. «I thashë se isha shumë i lodhur dhe, nëse mund të kthehej në mëngjes. Ai nuk u kthye kurrë. Komunistët më arrestuan atë mbrëmje. Më morën në pyetje ditë e natë pa pushim për pesë ditë. Iu përgjigja të gjitha pyetjeve të tyre. Iu përgjigja sepse kisha frikë nga torturat, të rrahurat që do të merrja, nëse nuk përgjigjesha. Nga frika e komunistëve mund të flisja pesë ditë e netë pa pushim, ndërsa, nga dashuria e Zotit s'mund t'i flisja për pesë minuta më shumë atij djali adoleshent, që po kërkonte rrugën e jetës. Si do të qëndroj para Zotit dhe të jap llogari se solla vetëm dyqind vetë te Krishti atë ditë, kur mund të kishin qenë dyqind e një?»

Ne mund të zgjedhim t'i anashkalojmë mundësitë që Zoti vendos para nesh për të ndarë Krishtin me të tjerët, duke menduar se mund ta ndajmë më vonë ose do të kemi një kohë më të mirë. Por asnjëherë s'mund të kemi një mundësi tjetër. Kur ne zgjedhim ta shpërfillim mundësinë hyjnore të dhënë, ashtu si ungjilltari, mund të zbulojmë se ky moment po ikte – si dhuratë njëherë-she në jetë. Është e trishtueshme që mund të jetë hera e vetme që një person të kërkojë të dëgjojë për dhuratën e Zotit të jetës së përjetshme nëpërmjet Birit të tij, Jezusit. Në qiell, Zoti mund të të pyesë pse nuk ndaje ungjillin me dikë kur kishe mundësi për ta bërë. Si do të përgjigjeshe?

Unë duhet të kryej veprat e Atij që më ka dërguar sa është ditë; vjen nata kur askush nuk mund të veprojë.

Gjoni 9:4

FKSTREM

Dhuratë ekstreme

KINË: NJË VAJZË E VOGEL

«Dua të flas me ty për një dhuratë të pazakontë», – i tha babai kinez vajzës së tij të bukur me flokë të zinj. Ajo buzëqeshi me padurim. I pëlqente shumë kur i ati i saj i urtë ndante mësim të veçanta rreth Zotit. Ai e donte Krishtin dhe të gjithë që e njihnin, prekeshin nga mirësia dhe dhembshuria e tij.

Ai hapi një Bibël të përdorur së tepërmi dhe filloi: «Kjo dhuratë gjendet te Filipianëve 1:29. Thuhet: 'Sepse juve ju është dhënë hiri për hir të Krishtit, jo vetëm që të besoni në të, por edhe të vuani për të'. Diçka që na jepet është 'dhuratë'. Dy dhuratat në varg janë besimi dhe vuajtja. Vuajtja që vjen si rezultat i besimit në Zotin është dhuratë e çmuar, vlera e së cilës do të zbulohet plotësisht në parajsë».

Vajza buzëqeshi. «Faleminderit, babi», – tha ajo ndërsa iu afrua për ta përqafuar. – «E kuptova.»

Vajza e vogël u rrit për të qenë gruaja e pastor Li Deksianit, i cili është arrestuar mbi dhjetë herë dhe pothuajse është rrahur për vdekje për besimin e tij. Ajo vazhdon punën me të, duke këmbëngulur sepse mësoi që në moshë të vogël që vuajtja e përsëritshme është një dhuratë. Pastor Liu dhe gruaja e tij kanë fituar njerëz të panumërt për Krishtin në Kinën komuniste dhe ata vazhdojnë të punojnë nën një kërcënim të vazhdueshëm arrestimi.

Dhurata e besimit dhe vuajtjes janë në një marrëveshje të pandashme. Jo vetëm që nuk është e mundur që të ndahen, por secila dhuratë forcon tjetrën. Nëse na është dhënë dhurata e besimit në Krishtin, ne do ta ndjekim Krishtin. Të ndjekësh Krishtin do të thotë të rrezikosh, të shkosh kundër rrymës së njohur, të keqkuptohesh dhe madje, të durosh dhimbje fizike dhe emocionale. Besimi të çon shpesh drejt vuajtjes. Ndërsa përjetojmë të njëjtat vuajtje që përjetoj Jezusi, ne do ta njohim atë në mënyrë më të pasur dhe më të thellë. Cikli fillon përsëri sepse vuajtja forcon besimin tonë. Mos prit të jesh në gjendje të filtrosh vuajtjen prej jetës sate pa pakësuar besimin te Krishti.

Çmori për gëzim të vërtetë, vëllezërit e mi, kur t'ju ndodhë të sprovoni çdo lloj vështirësie.

Jakobi 1:2

«Ata s'mund ta bëjnë këtë», – thirri Uilliami. – «S'e shikoni sa e gabuar është?»

«Shiko, pjesa më e madhe e njerëzve në këtë qyetet mendojnë se është gjëja e duhur për t'u bërë, – u përgjigj zyrtari i qeverisë i acaruar. – Është pjesë e fesë së tyre».

Uilliami pyeti: «Si mund të jetë gjëja e duhur për t'u bërë, të lidhësh një grua të gjallë me burrin e saj të vdekur dhe të digjen së bashku?»

Në këtë pikë, zyrtari ngriti duart lart. «Uilliam, – u përgjigj ai, – një njeri s'mund ta ndryshojë këtë. Thjesht hiq dorë dhe kthehu e kujdesu për tufën (bashkësinë) tënde».

Kur denominacioni i tij tha se «vetëm Zoti» do t'i kthente barbarët në vendet pagane, Uilliami i shpërfilli dhe u nis në udhëtimet më të suksesshme misionare në historinë e kishës. Përveç kësaj, ai mësoi disa gjuhë dhe botoi një libër, i cili u bë burim për lëvizjen moderne misionare. Ai përktheu gjithashtu Dhiatën e Re në tridhjetë e katër gjuhë dhe Dhiatën e Vjetër në tetë gjuhë.

Uilliam Keri luftoi për katër vjet kundër praktikës së djegies së grave të gjalla në Indi me bashkëshortët e tyre të vdekur. Në fakt, pavarësisht nga kundërshtimi i qeverisë, ai ia doli mbanë t'i ndalonte djegiet.

Keri e kaloi jetën e tij si një novator për Krishtin, duke përballuar vështirësi për të

gjellë ndryshim dhe njihej për inkurajimin e të tjerëve për të «Pritur gjëra të mëdha nga Zoti; përpikuni për gjëra të mëdha për Zotin» (bazuar tek Isaia 54:2-3).

Uilliam Keri bëri pikërisht këtë.

Pjesa më e madhe e njerëzve ndahen në kategoritë e mëposhtme kur vjen puna për të ndarë besimin e tyre: shko-shko, shko-ngadalë, mos-shko. Kur Jezusi thërret të krishterët për të shkuar në botë dhe të bëjnë dishepuj, disa përgjigjen me zjarr të madh. Si Uilliam Keri, ata shkojnë e shkojnë për ungjillin. Në vazhdim, të tjerët shkojnë me gjysmë zemre, duke u ngadalësuar prej moshës apo orareve të ngjeshura. Për fat të keq shumë besimtarë janë të krishterë mos-shko. Ata e dëgjojnë urdhrin, por mendojnë se do ta bëjë dikush tjetër këtë. Cila kategori përshkruan përgjigjen tënde ndaj thirrjes së Jezusit për ungjillizim? Kërkoji Zotit të të përtërijë një dëshirë për të ndarë besimin me të tjerët. Nëse po, prit gjëra të mëdha nga përgjigjja e tij, atëherë ji i përgatitur të bësh përpjekje për gjëra të mëdha në emrin e tij.

Jezusi u afrua e u tha: «Më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt...»

Mateu 28:18-19

FKSTREM

Martirë ekstremë të së shkuarës

ROME: KRISANTESI

«Bir, ti s'mund ta besosh që ky Jezus është i vërtetë.» – tha ati i Krisantesit.

«E di që është i vërtetë, baba», – iu përgjigj Krisantesi. – «Unë besoj se Jezusi erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët si unë e ti. Ai është drita e botës. Nuk ka shpresë në idhujt që ti adhuron.»

Si dënim, i ati e mbylli Krisantesin në një qilar të errët gjatë ditëve, por akoma mund ta dëgjonte birin e tij t'i këndonte lavde Zotit. Për ta kthyer Krisantesin nga besimi, i ati u përpoq ta rrethonte atë me kënaqësi të botës dhe me vajza, por Krisantesi qëndroi i fortë. Pastaj i ati solli Darinë, një grua idhujtare me një bukuri të pazakontë në shtëpi për ta bërë atë të harronte Krishtin. Në të vërtetë, Krisantesi e solli atë në shpëtim dhe ajo u pagëzua.

Më vonë Krisantesi dhe Daria u martuan dhe gëzuan një shërbesë të mrekullueshme duke sjellë të tjerët te Krishti. Kur rojat romake u përpoqën t'i lidhnin për shkak të dëshmisë, litarët u ranë prej duarve. Guvernatori urdhëroi ushtarët të lidhnin Krisantesin në një shtyllë dhe ta rrihnin me shkopin, por të rrahurat nuk lanë shenja në trupin e tij. Si pasojë, ushtarët dhe guvernatori i ranë te këmbët duke rrëfyer fuqinë e Zotit.

Në një tokë që adhuroheshin idhuj, Krisantesi qëndroi i palëkundur, sepse besonte në Zotin e gjallë e jo tek idhujt prej guri a druri. Për shkak të qëndrueshmërisë së tij, shumë prej paganëve erdhën në besim.

Ungjilli i Krishtit nuk është gjë e re. Ai ka ndryshuar jetë prej shekujsh dhe do të vazhdojë të ndryshojë derisa Krishti të kthehet. Historitë e së shkuarës janë historitë e së tashmes. Martiri i krishterë me rroba të bëra me dorë dhe me sandale ndan të njëjtën zemër me besimtarin modern, besimtarin e veshur me xhinse, i cili e dërgon dëshminë e tij me postë elektronike. Asnjë ndarje brezash nuk i ndan ata që kanë lënë një trashëgimi besimi dhe ata që mbajnë trashëgiminë e tyre sot. Ku e gjen veten në linjën e historisë? A je gati ta renditësh dëshminë tënde me shenjtorët e së shkuarës? Jeto plotësisht për Krishtin sot dhe lër një trashëgim për nesër. Ti mund të ndihmosh të transformosh një shtëpi, një vend pune, një komunitet ose madje, një vend të tërë për Krishtin.

Por ti, o Zot, mbretëron përgjithmonë dhe të gjithë brezat do të flasin për ty.

Psalmi 102:13

Dishepullizim ekstrem

JERUZALEM: JAKOBI, I BIRI I ZEBEDEUT

Historia na mëson që njeriu që duhej të vriste Jakobin refuzoi. Mbreti Herod ua preu të dyve kokën. Ndoshta ka ndodhur në këtë mënyrë:

Ekzekutimi duhej të ndodhte simbolikisht në të njëjtën të Premte të Pashkës, afërsisht katërmëdhjetë vjet pasi Jezusi ishte kryqëzuar. Jakobi, i biri i Zebedeut, u shoqërua në dhomën e ekzekutimit. Një numër ushtarësh ishin tashmë në dhomë. Drita nga llambat e vajit reflektonte njollat e gjakut në dysheme. Sa ndjekës të Krishtit kishin shkuar para tij pikërisht në këtë dhomë?

Jakobi vështroi në sytë e rojës së tij, por roja u largua me zemrën shumë të shqetësuar. Jakobi i kishte folur atij shumë herë për Jezusin përmes së çarës së vogël në derën e rëndë të burgut dhe zemra e rojës dukej se po hapej. Tani «miku» i tij ishte bërë xhelati i tij.

Jakobi u ul në gjunjë me gatishmëri. Kur shpata arriti në lartësinë e tij, ajo u drodh nga pasiguria dhe pastaj u flak në dysheme përkrah Jakobit, duke mos e dëmtuar aspak. «S'mundem!» – thirri xhelati. – «Unë nuk do ta vras! Gjithçka që thotë ai për Jezusin është e vërtetë dhe s'mund ta vras shërbëtorin e tij Jakob.»

Me një shenjë të Herodit, ushtarët erdhën përpara dhe e morën xhelatin, ia lidhën duart pas dhe e ulën me forcë në dysheme përkrah Jakobit.

Të ulur në gjunjë së bashku, ua prenë kokën.

Këshillimi është një çështje e mirënjohur, si në botën laike, ashtu edhe në mbretërinë shpirtërore. Duket se gjithnjë e më tepër njerëzit po vërejnë fuqinë unike të një marrëdhënieje personale midis dy personave. Njëri ka diçka për të mësuar: Tjetri ka diçka për t'i dhënë si mësim. Njëri ka diçka për të fituar: Tjetri ka diçka për të dhënë. Të ndjekësh shembullin e dikujt tjetër që po ndjek Krishtin është përkufizimi shpirtëror i këshillimit. Një i krishterë i tregon personit tjetër si të jetojë praktikisht besimin e tij apo të saj. Cilin mund të konsiderosh si këshillues në jetën tënde? Çfarë cilësish si të Krishtit ke parë në jetën e tij apo të saj që ti do t'i ndiqësh?

Unë do të tregoj besimin tim me veprat e mia.

Jakobi 2:18

FKSTREM

Përkufizim ekstrem i lutjes

KINË: NJË USHTAR NË GARDEN E KUQE

Kjo letër interesante është nxjerrë nga Kina komuniste:

«Unë jam një adoleshent në Gardën e Kuqe. Nuk besoja në ndonjë Zot, në ndonjë parajsë, në ndonjë ferr, apo në ndonjë shpëtimtar, nuk besoja në asgjë. Një ditë rastësisht kapa transmetimin tuaj në radio. Në fillim isha i tunduar ta fikja. Komunistët e mirë nuk besojnë në Zot. Por programi m'u duk interesant dhe e dëgjoja gjithmonë. Tani besoj te Krishti, por kam dy pyetje:

E para: A pranon Zoti dikë nga Kina komuniste? Në transmetimin tuaj ju flisni për kishën, por unë jam në Kinë, ku pothuajse nuk kemi asnjë kishë. A mund të pranojë Zoti dikë pa kishë?»

Ky ushtar i ri nuk e dinte sa kisha jozyrtare ekzistonin në Kinë ose që, të gjithë ata që e duan Krishtin janë kisha. Më pas ai kishte pyetjen e dytë: «Ju lutem, a do të më mësoni të lutem? Ju e filloni çdo program radioje me një lutje dhe e përfundoni me një të tillë. Unë do të doja të lutesha, por nuk e di se si».

Ushtari s'kishte qenë kurrë në një kishë, por thoshte se e imagjinonte se ç'do të thoshte lutja: «të flasësh gjithë ditën dhe pas çdo gjëje që thua, të mund të jesh në gjendje të thuash 'Amen.'»

Çfarë përkufizimi i bukur i lutjes!

Lutja nuk është e natyrshme. Në fakt, nuk i vjen gjithkujt natyrshëm, sepse është një eksperiencë e mbinatyrshme. Zoti na jep një dëshirë shpirtërore për të komunikuar me të. Ashtu si matematika apo gjuha, lutja është një aftësi e mësuar. Sa më shumë që praktikojmë lutjen, aq më e natyrshme bëhet. Besimtari i ri në këtë histori e përkufizoi lutjen si ndikuese në çdo aspekt të jetës, duke e bërë kështu jetën një lutje drejtuar Zotit. Si po rritesh ti në eksperiencën tënde me lutjen? A je duke mos e praktikuar? Duke filluar që sot, kërkoji Zotit të të japë një dëshirë mbinatyrrore për të folur me të dhe për ta bërë lutjen një pjesë të natyrshme të jetës së përditshme. Pastaj fillo të praktikohesh.. Qoftë jeta jote një lutje!

Prandaj, le të lutet çdo besimtar në kohë të përshtatshme.

Psalmi 32:6

Përpara burgut kisha dëgjuar për Zotin, por në burg e përjetova atë.

PASTOR SZE – DREJTUES I NJË KISHE-SHTËPI,
I CILI U BURGOS PËR BESIMIN E TIJ. AI I MBIJETOI URISË,
SËMUNDJES DHE NJË SHPËRTHIMI NË
MINERËN E QYMYRIT KU ISHTE I DETYRUAR TË PUNONTE.



FKSTREM

Çmenduri ekstreme

RUSI: ANA ÇERTNIKOVA

Këmishat e forcës ishin torturuese për Ana Çertnikovën. Ajo e urrente të kishte duart e mbuluara dhe të lidhura afër trupit. Për mbikëqyrësit, ajo nuk ishte më tepër se një kafshë, jo e denjë për t'u konsideruar.

Ana kaloi dhjetë vjet në një azil të çmendurish në Rusi. Ajo nuk ishte aspak e çmendur. Një gjykatës e kishte çuar atje, sepse ishte e krishterë. Refuzimi i saj për të mohuar Krishtin për gjykatësin ishte një çmenduri.

E rrethuar prej të sëmurëve mendorë, ndonjëherë ajo dyshonte për shëndetin e saj mendor. Në netët e gjata ajo i thërriste Zotit në mendjen e saj, edhe kur ata rreth saj thërrisnin me zemërim apo tmerr. Por përsëri ajo nuk u zemërua asnjëherë. Ajo refuzoi ta mohonte besimin në gjyq dhe po ashtu, edhe në azil. Për ata që ishin në gjendje ta kuptonin, Ana madje, u përpoq të ishte një dëshmi dhe një shembull i dashurisë së Krishtit.

«Ju përshëndes të gjithëve me dashuri në Zotin tonë Jezu Krisht.» – shkroi Ana nga brenda azilit. «I lutem Zotit që do të na bëjë të gjithëve të bukur dhe të përsosur në Krishtin dhe që ai do të marrë kontroll të gjitha çështjet tona. Unë besoj fort se Zoti, i cili krijoi zemrën e secilit dhe që shqyrton të gjitha çështjet e njerëzve të vdekshëm, do të gjykojë sfidën time me idhujtarinë e ateizmit dhe do të zbatojë gjykimin dhe drejtësinë e tij.»

Të krishterët e gjejnë veten shumë herë në situata të çmendura që provojnë durimin dhe testojnë karakterin e tyre. Një organizim i vëshirë i jetesës. Politika hutuese zyrtare. Një fëmijë rebel. A mund të mbetemi ne me besim te Zoti, pa marrë parasysh rrethanat? Mundemi, nëse njohim sekretin e kënaqësisë. Bibla na mëson që ndjenja jonë e brendshme e kënaqësisë duhet të mbizotërojë kur përballemi me rrethana të jashtme. Qëndrimi ynë varet nga Zoti, e jo nga situata jonë, përndryshe ne rrezikojmë të hutohemi po aq shumë, sa rrethanat tona. Merr mësim nga Ana. Në vend të kësaj, kërkoji Zotit të të mësojë sekretin e të qenit të kënaqur pavarësisht nga situatat e tua.

Unë jam mësuar të kënaqem në gjendjen që jam.

Filipianëve 4:11

Procesi i aplikimit ishte i gjatë dhe i vështirë. Kontrollat e së kaluarës ishin të zgjatura dhe aplikimi i dr. Karlos, pothuajse u anulua prej thashethemeve të lidhjeve të tij të «krishtera». Por dr. Karloja ia doli mbanë përmes proceseve të vështira dhe u bë mjek për Policinë Sekrete. Ai shmangu t'u thoshte atyre se ishte i krishterë.

Vetë familja e dr. Karlos e sulmoi, sepse ata mendonin se ai ishte bërë komunist. Një nga një, familja e tij, kisha dhe të gjithë ata, të cilëve u kishte qëndruar pranë, i kthyen shpinën. Asnjë prej tyre nuk e dinte misionin e tij për të gjetur pastorin.

Në rolin e tij si mjek i Policisë Sekrete, ai mund të hynte e të dilte prej burgut pa problem. Ai kishte hyrje në çdo qeli, kështu që më në fund e gjeti pastorin të burgosur.

Karloja u dërgoi fjalë të krishterëve të tjerë, të cilët pastaj çuan fjalë në botën e jashtme. Atyre u ishte thënë se ai ishte i vdekur, por ata tani kishin një provë që pastor Riçard Vurmbrandi ishte gjallë. Gjatë bisedave midis Krushovit dhe Aizenhauerit në vitin 1956, të krishterët anembanë botës kërkuan me ngulm lirin e Vurmbrandit. Në fakt ai u lirua për një shpërblim prej 10 000 dollarësh.

«Pa këtë mjek, – shkroi Vurmbrandi më vonë, – i cili u bashkua me Policinë Sekrete specifikisht për të më gjetur mua, s'do të isha liruar asnjëherë. Do të kisha mbetur në burg – ose në një varr burgu.»

Agjentët sekretë janë yjet e ekranit të madh. Misionet e tyre përfshijnë aventura të njëpasnjëshme në shërbim të urdhrave të selisë qendrore. Në të njëjtën mënyrë, besimtarët ekstremë në kombet e izoluar bëjnë jetë aventureske. Historitë e tyre sjellin ndryshim të përjetshëm për shumë vetë. Ata guxojnë të mos e reklamojnë misionin e tyre, por janë gjithnjë të përgatitur të shfrytëzojnë çdo mundësi për të ndarë lajmin e mirë të Krishtit. Pavarësisht nga pozita gjeografike apo situata e jetës, Zoti thërret secilin prej nesh për të qenë një agjent shpirtëror, duke raportuar në selinë qiellore. Ne jemi me mision për të ndarë dashurinë e Zotit çdo ditë. Zoti nuk na jep asnjë garanci sigurie me caktimin e kësaj detyre, por ai premtim shpërblim të përjetshëm.

Për të gjithë u bëra gjithçka, që të kushtojë sa të kushtojë, por ta shpëtoj ndonjërin.

1 Korintasve 9:22

FKSTREM

Martirizim ekstrem

ROME: POLIKARPI

Polikarpi kishte qenë një dishepull i apostullit Gjon, dhe tashmë ishte në vitet e fundit të jetës së tij. Ndërsa ishte duke udhëtuar, një fëmijë e njeh dhe njofton menjëherë ushtarët. Kur e gjejnë Polikarpin duke ngrënë, ai ofroi të ndante ushqimin e tij me ushtarët që do ta arrestonin.

Pasi hëngrën së bashku, Polikarpi u kërkoi nëse mund të kishte një orë kohë për t'u lutur. Ushtarët ranë dakord, por më vonë u erdhi keq për vendimin. Polikarpi ishte lutur me aq shumë zjarr, sa vetë ushtarët u bindën për mëkatet e tyre.

Në fakt Polikarpin e sollën para guvernatorit, i cili e dënoi atë me djegie në sheshin e tregut. Guvernatori i dha mundësinë të shpëtonte, nëse do të mohonte Jezusin. Polikarpi refuzoi duke thënë: «Për tetëdhjetë e gjashtë vjet i kam shërbyer atij. Atëherë si duhet të blasfemoj Mbretin tim që më ka shpëtuar?»

Ata e lidhën Polikarpin në një turrë drush dhe ndezën zjarrin rreth tij. Flakët u ngritën lart rreth besimtarit të guximshëm, por për mrekulli nuk iu dogj asnjë fije floku në trupin e tij. Guvernatori u tërbua. Ai urdhëroi një ushtar ta godiste të krishterin me shtizë në ijë. Ata mundën ta vrisnin Polikarpin, por nuk ishin në gjendje të vrisnin besimin dhe shpirtin e tij triumfues.

Lutja e fundit e Polikarpit ishte kjo: «Unë të lavdëroj sepse më bërë të denjë të pranohem midis numrit të martirëve në këtë ditë dhe këtë orë, që të kem pjesë në kupën e Krishtit për ringjalljen e shpirtit tim.»

Polikarpi i jep kuptim të ri shprehjes, «dalje aktive në pension». Një shenjtor i moshuar në fund të tetëdhjetave, Polikarpi jetoi mjaft për të mos e vrarë mendjen se si ndiheshin kundërshtarët e tij për besimin e tij në Krishtin. Nga ana tjetër e spektrit, të rinjtë më të zellshëm sulmojnë armikun pa ditur ç'të bëjnë tjetër. Pjesa më e madhe e besimtarëve qëndrojnë diku midis të dyve. Neve na mungon zelli i përkushtimit tonë rinor, por përsëri s'kemi jetuar mjaft gjatë sa të largojmë opinionet që të tjerët kanë për besimin tonë. Lavdi Zotit që na merr ashtu si jemi dhe jo ashtu si duhet të jemi. Ji i vendosur t'i japësh atij çdo grimcë përkushtimi që të mundesh sot dhe lejoje të të rritë në besim.

Ne e kemi për detyrë ta falënderojmë gjithnjë Perëndinë për ju, o vëllezër, sikurse është fort e drejtë, sepse besimi juaj po rritet shumë.

2 Selanikasve 1:3

Shërbëtor ekstrem

PAKISTAN: ZEBBA

«Përsëriti këto vargje!» – e urdhëruan Zebën.

«Unë nuk do t'i përsëris vargjet. Jam e krishterë, do të jem gjithnjë e krishterë.»

Meqenëse familja e saj ishte në varfëri, Zeba detyrohej të punonte si shërbëtoreshë për një familje të pasur myslimane. Ndërsa ajo punonte atje, kreu i shërbyesve u përpoq t'i mësonte rreth islamit dhe e detyronte të mësonte vargje nga Kurani. Në tri raste të ndryshme Zeba refuzoi duke thënë: «Jam e krishterë», por rrihej sa herë që refuzonte.

Më pas, punëdhënësit e Zebas e arrestuan, duke e akuzuar pa të drejtë për vjedhje të familjes. Pasi siguruan lirim të saj, nëna e Zebës vizitoi familjen myslimane për të marrë në mbrojtje të bijën. Ajo nuk u mirëprit.

Një nga anëtarët e familjes i ulëriti: «Je një e pafel! Edhe ti dhe vajza jote jeni të pafel dhe nuk meritoni të jetoni». Ata i hodhën gazolinë mamasë së Zebës dhe i vunë shkrepësen. Zeba nuk e pa më nënën e saj. Pavarësisht nga tragjedia, Zeba vazhdoi ecjen e saj me Krishtin dhe kohët e fundit u pagëzua.

Sot në Pakistan, është themeluar një shkollë për rrobaqepësi, kështu që vajza të reja të krishtera si Zeba nuk do t'u duhet më të kërkojnë punë si shërbëtoreshë për të ndihmuar familjet e tyre për t'u ushqyer. Pavarësisht nga dhimbja e saj, Zeba nuk mban zemërim

dhe ëndërron të ndajë besimin e saj me të tjerë në vendin e saj. Ajo dëshiron të bëhet mësuese Bible një ditë.

Mbretëria e Perëndisë është në anën e duhur kur është në të kundërtën. Hierarkia e rëndësisë është në të kundërtën, e krahasuar me atë se si bota i vendos njerëzit në shoqëri. Para të talentuarve, bukuroshëve dhe të pasurve në krye të listës, titujt qiellorë i mbajnë shërbëtorët e përlurur. Zeba nuk është asgjë në sytë e botës, por ajo po bën një punë të mrekullueshme për mbretërinë. Një shërbëtoreshë mund të mos jetë aq e vlefshme sa të tjerët, por një shërbëtoreshë është e çmueshme në shërbim të Zotit. Çfarë do të thotë të jetosh në kundërshtim me pjesën tjetër të botës? Nëse i dorëzohesh Zotit si shërbëtoreshë, së pari do të përjetosh ndjenjën. A je gati të përulesh në rolin e një shërbëtoreshë dhe të bësh çfarëdo që është e nevojshme për të shpërndarë Lajmin e Mirë?

Ai që prej jush do të bëhet i madh, le të bëhet shërbëtoreshë juaj.

Mateu 20:26

FKSTREM

Kthesë ekstreme

KINE: ÇANG SHEN

Para kthimit të tij në besim, Çang Sheni njihej si kumarxhi, si hajdut dhe si njeri që rendte pas fustaneve të grave. Kur humbi shikimin në kulm të jetës së tij, komshinjtë thanë se ishte gjykimi i zotave për të këqijat që kishte bërë.

Në vitin 1886, Çangu udhëtoi qindra kilometra për në një spital misionar, ku njerëzit fitonin shikimin. Shikimi i tij u kthye pjesërisht dhe aty, ai dëgjoi për Krishtin për herë të parë. «S'kemi pasur ndonjë pacient që ta ketë pranuar ungjillin me një gëzim të atillë!» – raportoi mjeku.

Kur Çangu kërkoi të pagëzohej, misionari Jakob Uebster u përgjigj: «Shko në shtëpi dhe thuaju komshinjtë që ke ndryshuar. Nëse je akoma duke ndjekur Krishtin, kur unë të të bëj një vizitë më vonë, atëherë do të të pagëzoj». Pesë muaj më vonë, Uebsteri shkoi dhe gjeti atje qindra besimtarë. Ai e pagëzoi ungjilltarin e ri me gëzim të madh.

Më vonë, një mjek i ngathët vendas ia hoqi Çangut edhe atë shikim të pjesshëm që kishte, por Çangu vazhdoi udhëtimet e tij në fshatra të ndryshëm. Megjithatë disa i pështynin dhe e refuzonin, ai vazhonte të fitonte qindra për Krishtin.

Kur filloi kryengritja Bokser*, të krishterët e çuan Çangun në një shpellë në male për ta shpëtuar. Kryengritësit mblodhën pesëdhjetë të krishterë për ekzekutim në një qytet aty afër, por premtuan t'i kursenin të gjithë ata, nëse Çangu dilte nga strehimi. Kur Çangu dëgjoi për këtë, tha: «Do të vdisja me kënaqësi për ta».

Çangut iu pre koka tri ditë më vonë dhe të krishterët e mbetur u kursyen.

Shkëmbimi i madh është mesazhi i ungjillit të mrekullueshëm. Jezusi ofron mundësinë për të shkëmbyer jetën tonë të vjetër për një fillim të ri. Shikoni se si e ndryshoi ai Çangun, nga një person që jetonte për vete, në një person të dhënë plotësisht për Krishtin. Pavarësisht dëmeve që kemi shkaktuar në jetën tonë të mëparshme, ne mund të kthehemi në një marrëdhënie të drejtë me Zotin. Ja, pse dëshmia jonë personale është kaq e fuqishme. Një jetë e ndryshuar paraqet të dhëna të fortë për faktin e shpëtimit. Ne nuk flasim më siç flisnim më parë, as nuk ecim siç kemi ecur. Kush ka nevojë të dëgjojë për ndryshimin që Krishti ka bërë në jetën tënde?

*Bokser – një anëtar i shoqërisë sekrete kineze që në vitin 1900 u përpoq me dhunë të largonte të huajt nga Kina dhe të detyronte vendasit e kthyer në besim të braktisnin krishterimin.

Dhe duhet të përtëriheni me shpirtin e mendjes suaj dhe të visheni me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësi e shenjtëri që vjen prej së vërtetës.

Efesianëve 4:22,24

As droga as lufta civile s'mund të ndalojë shpërndarjen e ungjillit në Kolumbi.

Juani dhe gruaja e tij, Maria, janë misionarë midis njerëzve vendas në veri të Kalit, Kolumbi. Kali kontrollohet nga Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë (FARK), një grup gueril i së majtës. Shumë pastorë dhe misionarë kolumbianë ndeshën kundërshtim nga FARK-u dhe braktisën zonën. Kur Juani takoi një grup prej pesëdhjetë guerilasish të FARK-ut tre vjet më parë, njëzet prej tyre pranuan Krishtin. Si thotë ai «Ne shkëmbyem pistoletat me letrat e apostujve».

Tani Ushtria e Çlirimit Kombëtar ka sulmuar kishat e krishtera në rajon. Kohët e fundit, më shumë se njëzet kisha u mbyllën dhe shumë pastorë ikën për të shpëtuar jetën e tyre. Guerilasit shpesh vijnë dhe kërkojnë të dhjetat dhe ofertat, ndryshe do të vrasin pastorin. Tani Juani është i vetmi pastor i mbetur në zonë dhe nuk merr asnjë ndihmë nga jashtë.

Por përsëri, Juani dhe gruaja e tij kanë marrë vendim për të qëndruar dhe për të vazhduar t'u shërbejnë njerëzve. Ata thonë: «Nëse do të vdesim sepse predikojmë Fjalën e Zotit, më mirë të vdesim se sa të lëmë kishën».

Juani nuk i dënon ata që janë larguar, as nuk flet për vështirësitë që kanë kaluar. Ai preferon të ndajë atë që Zoti ka bërë dhe barrën e tij për shërbesën. Mendja e tij është

e shqetësuar, jo prej rrezikut, por për të arritur njerëzit e Kolumbisë për Krishtin.

Jezusi përshkruan imazhin e një kafshe pune të rënduar nga ngarkesa. Kafsha nuk lufton kundër peshës së barrës, për atë nuk është aspak e rëndë. Preokupimi me ungjillin nuk është e njëjtë si preokupimi me shqetësimet e botës. Preokupimi me ungjillin do të thotë thjesht vetëdije për nevojat shpirtërore të të tjerëve. Juani ka një «barrë» (d.m.th. një preokupim), por kjo barrë është e lehtë. Duke ndjekur shembullin e Krishtit, ne duhet të jemi të rënduar për njerëzit e humbur. Ngarkesa është e lehtë sepse jemi duke e dhënë atë gjithmonë. Ne nuk duhet ta mbajmë lajmin e mirë për vete. A je refuzuar kur ke ndarë Krishtin? Ndoshta ke konsideruar t'i dorëzohesh kundërshtarit. Le të të motivojë barra e Jezusit për të humburit për t'u mbajtur edhe një ditë më shumë.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë.

Mateu 11:30

Nëse ne të krishterët nuk vazhdojmë të ndajmë ungjillin duke e shtyrë zarfin tutje, ai do të na mbyllet. Nëse e mbajmë «dëshminë për vete» nuk do të ketë dëshmitarë dhe krishterimi do të vdesë në Amerikë.

REI THORN – MISIONAR NË KISHËN E PERSEKUTUAR



Ungjilltar ekstrem

KINË: PASTOR LI DEKSIAN

«Unë do të predikoj derisa të vdes.»

Pastor Li Deksiანი kishte predikuar vetëm disa minuta kur oficerët e Zyrës së Sigurimit Publik hynë me forcë në shtëpi. Ata e tërhoqën zvarrë jashtë pastor Liun dhe e rrahën bashkë me të tjerët në bashkësinë kineze.

Në stacionin e policisë ungjilltari u rrah përsëri, derisa vulli gjak. Oficerët e goditën në fytyrë me Biblën e tij, duke e lënë të gjakosur dhe pothuajse pa ndjenja në dyshemënë prej betoni të qelisë.

Kur u lirua shtatë orë më vonë, ai vazhdoi shërbesën e tij. Herën tjetër që dha një mesazh në atë kishë, shtatë oficerë të ZSB-së hynë duke hedhur akuza kundër ungjilltarit. Kur panë vizitorë perëndimorë me të, u larguan dhe u kthyen pesëmbëdhjetë minuta më vonë me përforcime. Oficerët e tërhoqën zvarrë dhe filluan t'i godisnin kokën pas një muri guri.

«Pse duhet ta rrihni? – thirrën disa prej të huajve. – Po për 'lirinë e fesë' që ju shpallni në Kinë?»

ZSP-të i morën të huajt në stacionin e policisë, bashkë me gruan që kishte hapur shtëpinë për takimin, kjo e fundit e spiunuar prej djalit të vet.

Që nga ky sulm, takimet e mëdha në fshat kanë ndaluar, por kisha jo. Tani ata mblidhen

në më tepër se dyzet takime më të vogla dhe persona të rinj gjejnë çdo javë Krishtin.

Kur kundështarët përpiqen ta mbajnë kishën nën kontroll, ndodh njësoj si me mërkurin kur shpërndahet, në pjesë edhe më të vogla. Kishat në vendet e ndaluara mund të mos e përjetojnë ndonjëherë eksperiencën e kulturës perëndimore të kishave të stërmëdha me komplekse prej dyzet hektarësh; megjithatë pjesëmarrja në to vazhdon e rritet. Në fakt, një kishë në Kore ia kalon pjesëmarrjes se disa kishave perëndimore të marra së bashku. Por, ashtu si strategjia në Kinë, bashkësia koreane është e përbërë prej mijëra takimeve të vogla në shtëpi apo të quajtura ndryshe «qelizat». Ato që mund të nxjerrim ne si pengesa për ungjillizimin, janë thjesht mundësi të maskuara. Kur ju ndeshesh me kundërshtim, a dorëzohesh shumë lehtë apo këmbëngul që të gjesh një mënyrë që mesazhi i ungjillit të përparojë?

Por duhet të qëndroni të themeluar në besim, të qëndrueshëm dhe të palëkundshëm në shpresën që jep Ungjilli për të cilin dëgjuat.

1 Kolosianëve 1:23

FKSTREM

Forcë ekstreme

BANGLADESH: IDRIS MIAH

«Nëse Abuja donte të bëhej i krishterë, duhej ta bënte diku tjetër. Ne rrethuem shtëpinë e tij gati për ta djegur dhe për ta nxjerrë atë jashtë.»

U afruam aq sa mund ta dëgjonim të fliste. «A mund të kishte mbledhur të tjerë për ta ndihmuar?» – menduam me vete. Pastaj mund të dëgjonim që ai ishte duke u lutur për tërë fshatin dhe duke i kërkuar Jezusit të na falte për çfarë do të bënim! Kjo na zemëroi edhe më tepër, kështu njëzet e pesë prej nesh u turrën në drejtim të shtëpisë së tij për ta kapur, por u larguan të frikësuar.

«Kur erdha në shtëpi, s'mund të flija. Vazhdova të mendoja për lutjen e Abusë. Më në fund në tre të mëngjesit, u ktheva në shtëpinë e Abusë. I kërkova të më tregonte për Jezusin. Pas tri orësh bisede me Abunë, i kërkova Jezusit të më falte dhe ia dorëzova jetën atij. Nxitova për në shtëpi dhe ndava me gruan çfarë më kishte ndodhur dhe ajo bashkë me fëmijët u bënë të krishterë.»

Brenda disa ditësh, Idris Miah, besimtari nga Bangladeshi, që tregoi historinë e tij, u përball me një provë. Ai u pushua nga puna dhe fëmijët e tij u dëbuan nga shkolla, por ai thotë se vazhdon të ketë gëzim, sepse ka Jezusin në zemër.

Shpesh ne s'mund të zgjedhim kontekstin e jetës sonë, por mund të zgjedhim qëndrimin dhe reagimin tonë. Ne mund të bëjmë gjithnjë zgjedhje, pavarësisht nga rrethanat. Kështu, kur qëndrojmë në buzë të fatkeqësisë si Abuja, mund të zgjedhim një reagim plot lutje si të Krishtit ose t'i dorëzohemi panikut dhe shqetësimeve. Është e pamundur për të tjerët, pavarësisht nga përpjekjet më të mira për të na zemëruar apo të stresuar. Ne i bëjmë zgjedhjet vetë. Në të njëjtën mënyrë, mund të vendosim të imitojmë Krishtin në reagimin tonë ndaj kundërshtimeve. Kush e di se ç'do të dalë prej saj? Kërkoji Zotit të të ndihmojë sot të zgjidhni reagimin e duhur ndaj çdo situatë sprove.

Kur të të thërras në ndihmë, më dëgjo,
o Perëndi, që me jep të drejtë! Ti që më
shpëtove në vështirësi: ki mëshirë për
mua e ma dëgjo lutjen!

Psalmi 4:1

«Skllav» ekstrem

ISHUJT E VIRGJËR: LEONARD DOBER

Leonardi pyeste veten nëse Jezusi kishte menduar shumë për kryqin; pastaj iu kujtua se lutja e Jezusit në kopsht përfundoi: «Jo vullneti im, por yti, At». Detyra e Leonardit dukej e pamundur, por ai po ndiqte vullnetin e Zotit dhe jo të vetin.

Leonard Dober përcaktoi se thirrja e Zotit për të ishte të fitonte skllëverit në Ishujt e Virgjër për ungjillin. Ai planifikoi t'i fitonte këta burra e gra, duke e shitur veten si skllav dhe duke punuar bashkë me të tjerët çdo ditë ndërsa ndante dashurinë e Zotit me ta. Mendimi i të qenit skllav e frikësonte dhe e bënte të ndihej keq. Ndjente frikë për trajtimin që do t'i bëhej. «Por Krishti ishte gati të vdiste në kryq për mua, – mendoi ai. – Asnjë çmim nuk është shumë i lartë për t'i shërbyer atij».

Persekutesit më të ashpër të Doberit nuk ishin padronët e skllëverve, por të krishterët e tjerë. Ata dyshonin thirrjen e tij për t'u shërbyer skllëverve dhe e tallnin si të çmendur për planin e tij. Por Doberi nuk do të sprapesej. Ai arriti në Ishujt e Virgjër në fund të vitit 1730.

Kur u bë shërbëtor në shtëpinë e guvernatorit, ai kishte frikë se ky pozicion ishte shumë larg prej skllëverve për të cilët kishte ardhur për t'u shërbyer. Kështu që u largua nga shtëpia e guvernatorit në një kasolle kashte ku mund të punonte me skllëverit një nga një.

Brenda vetëm tre vjetësh, shërbesa e Doberit përfshiu më tepër se trembëdhjetë mijë besimtarë të rinj.

Të çmendurit pas Jezusit. Ja çfarë i quan bota ata, besimi i të cilëve duket pak radikal. E çuditshme, ekstreme. Doberi ishte një «i çmendur pas Jezusit» i shekullit të tetëmbëdhjetë – një njeri i lirë, i cili vendosi të jetonte si skllav me qëllim që t'i fitonte ata për Jezusin. Ai ishte gati të bënte ç'të ishte për të shtrydhur pikën e fundit të përkushtimit prej zemrës në shërbim të Krishtit. Për Doberin, kjo do të thoshte një plan specifik, i cili nuk kishte kuptim për asnjë, përveç atij. A të kanë zhvlerësuar për shkak të refuzimit tënd të çmendur për t'u bashkuar me rregullin e pjesës më të madhe? Nëse Zoti të ka thirrur për të bërë diçka radikale për të në familjen tënde, kishë apo komunitet, ti duhet t'i bindesh. Le të të quajnë të tjerët të çmendur, por Jezusi të të gjejë të përkushtuar.

*Dhe vërtet, nëse jemi «jashtë mendsh»
— jemi për Perëndinë, e nëse jemi «ndër
mend» — jemi për vete.*

2 Korintasve 5:13

Adhurim ekstrem

BABILONIA E LASHTË: DANIELI

Ai e dëgjoji dekretin nga dritarja: «Për tridhjetë ditët e ardhshme, kushdo që i lutet dikujt tjetër e jo mbretit, do t' u hidhet luanëve.»

Danieli hapi qepenat. Në pullazin përballë, dy prej këshilltarëve të mbretit që e urrenin, qëndronin duke e vëzhguar me vëmendje. Ai i përshëndeti me kokë me mirësjellje, ndërsa u ndesh me sytë e tyre dhe ia kthyen përshëndetjen me buzëqeshje tinëzare.

Danieli shkoi te çdo dritare e dhomës së tij dhe i hapi. Tek secila dukej se kishte vëzhgues. Pastaj shkoi në qendër të dhomës, ku të gjithë mund ta shihnin, u përgjunj dhe filloi të adhuronte Zotin.

Mbreti u trishtua kur rojat i sollën Danielin përpara. Mbreti ishte futur në kurth. Dekreti i tij s'mund të anulohet, megjithëse kishte kërkuar tërë ditën një mënyrë për ta çliruar Danielin, të cilin e konsideronte burrë të mirë.

«Merreni! – u tha rojave perandor Dari. Pastaj, ai vështrroi në sytë e Danielit dhe tha: – Zoti, të cilit ti i shërben vazhdimisht, të shpëtoftë!» (Danieli 6:16). Ushtarët e çuan Danielin në gropën e luanëve, në praninë e vetë mbretit. Danieli nuk tha asnjë fjalë, por u përul para mbretit dhe hyri në mes të luanëve. Dera ishte e mbyllur me një dryn të madh.

Danieli shkoi në qendër të gropës, u gjunjzua dhe filloi të adhuronte Zotin.

Adhurimi ekstrem nuk është një mënyrë lavdërimi, as një metodë specifike apo një traditë e veçantë. Nuk përcaktohet duke debatuar për muzikën e organos apo e kundërta, për lavdërimin bashkëkohor. Në fakt, nuk ka të bëjë aspak me mënyrën se si e lavdërojmë Zotin. Adhurimi ekstrem përcaktohet se kur dhe ku adhurojmë. Kur tërhiqemi drejt adhurimit në kohën tonë më stresuese, praktikojmë adhurim ekstrem. Si Danieli, ne nuk duhet të lejojmë që situatat tona të diktojnë se kur dhe ku duhet të adhurojmë Zotin. Ne duhet të jemi të përgatitur të jetojmë besimin tonë në çdo kohë, në çdo vend. A je gati t'i shërbesh Zotit në adhurim ekstrem sot?

Por mbreti i foli Danielit dhe i tha:
«Perëndia yt, të cilit ti i shërben
vazhdimisht, do të vijë vetë të të
shpëtojë».

Danieli 6:16

Refuzim ekstrem

KOREJA E VERIUT

«Ata më janë lutur me këmbëngulje, por nuk mund t'jua jepja» – tha ai. «E di që të krishterët duhet të ndajnë atë që kanë, por unë nuk mund ta dorëzoja». Me trishtim e shtrëngoi dorën, që dëgjuesi i tij të mund ta shihte pronën për të cilën ishte aq krenar.

«Në të vërtetë doja, por nuk munda. Ta dini se njerëzit në Korenë e veriut më kanë treguar se që prej 50 vjetësh i janë lutur Zotit për të marrë një Bibël, por unë nuk ua kam dhënë Biblën time, sepse edhe unë i jam lutur Zotit për 20 vjet. Ia kisha marrë atë një pastori nga Koreja e jugut».

Psherëtiu thellë teksa mendonte për besimtarët në nevojë të Koresë së veriut, që i luteshin me dëshpërim Zotit vetëm për një kopje të Biblës. Pas kësaj e shtrëngoi atë fort në kraharor. Kishte arritur të largohej nga qeveria komuniste plot me burgje dhe tani jetonte i lirë në Korenë e jugut.

Biblat në Korenë e veriut janë të rralla. Për shkak të kundërshtimit nga ana e komunistëve, besimtarët e vlerësojnë Biblën si më të shtrenjtë se arin. Dikë e rrahën për vdekje me thupër hekuri kur e kapën në kufi, duke sjellë Bibla në Korenë e veriut. Mjerisht, raste të tilla raportohen vazhdimisht.

«Nuk mund t'i harroj ata njerëz, – tha duke psherëtirë – Nuk mund ta harroj pamjen në fytyrat e tyre, kur u tregova Biblën time. Më vjen keq për ta!»

Ndërkohë, në disa vende, Biblat shërbejnë si mbajtëse gotash për pije alkoolike, ose si një mbulesë e vogël mbi tavolinë për të vënë telekomandën sipër. Kapakët e tyre të fortë shërbejnë si mbulesë për të shkruar një letër me adresën e hotelit, ose për të pritur hirin që bie nga cigarja. Diku tjetër zbukurojnë tavolinën, pranë pjatës me bonbone e karamele. Megjithëse Bibla mbetet libri më i shitur vit pas viti, me sa duket askush nuk e lexon me shumë interes. Ajo keqpërdoret dhe lihet pas dore jashtë vendeve ku vlera e saj do të njihej mirë. Sa më ndryshe do t'i trajtonim në Biblat tona sikur të na duhej t'i luteshim Zotit nja 20 vjet vetëm për të marrë një kopje. Çfarë mund të bësh ti që etja jote për Fjalën e çmuar të Perëndisë të rilindë?

Do të kënaqem në urdhërimet e tua, që
aq shumë i kam për zemër.

Psalmi 119:47

FKSTREM

Pamje ekstreme

RUSI: LIUBA GANEVSKAIA

Liuba Ganevskaia ishte rrahur vazhdimisht në burgun rus, por kur shihte torturuesin e saj tekta i mbante kamxhikun mbi shpinë, ajo buzëqeshte.

«Pse buzëqesh?» – pyeti ai i habitur.

«Unë nuk të shoh ashtu si do të të tregonte një pasqyrë në këtë moment, – tha ajo. – Unë të shoh ashtu si ke qenë, me siguri – një fëmijë i bukur, i pafajshëm. Ne jemi në të njëjtën moshë. Mund të kemi qenë shokë lojërash.»

Zoti i hapi sytë Liubas për të parë një njeri ndryshe. Ajo pa rraskapitjen e tij; ai ishte po aq i lodhur nga të rrahurat, sa ishte edhe ajo që po rrihej, ishte i acaruar që nuk po zbulonte nga ajo aktivitetet e besimtarëve të tjerë.

«Ai është pak a shumë si ti, – i tha Zoti në zemër Liubës. – Ju të dy jeni kapur në të njëjtën dramë të jetës. Ju dhe torturuesit tuaj kaloni përmes së njëjtës luginë lotësh.»

Duke e parë personin përmes syve të Zotit, qëndrimi i Liubës ndryshoi. Ajo vazhdoi t'i fliste: «Unë të shoh edhe ashtu siç shpresoj që të bëhesh. Ka jetuar njëherë një persekutues më i keq se ti – Sauli nga Tarsi – dhe ai u bë apostull dhe shenjtor.» Ajo e pyeti personin e qetësuar se çfarë barre e madhe rëndonte mbi të aq sa ta çonte në çmendurinë e të rrahurit të dikujt që s'i kishte bërë keq.

Përmes shqetësimit të saj mirëdashës, Liuba e drejtoi torturuesin e saj në mbretërinë e Krishtit.

Të parit tokësor shpesh pengohet nga një shumëllojshmëri sëmundjesh: astigmatizmi (defekt në sistemin optik që pengon dritën të fokusohet saktë dhe rezulton në një shikim të veshur, jo të qartë), miopia, glaukoma (shkatërrim i retinës dhe humbje graduale e shikimit). Ashtu si shikimi ynë përfiton nga lentet korrigjuese, sytë e zemrës sonë mund të përfitojnë nga ndërhyrjet shpirtërore. Nëse e lëmë në mundësitë, mjetet tona, ne do të shohim vetëm të keqen tek të tjerët dhe jo të mirën. Por Zoti garanton vizion shpirtëror për ata që duan ta shohin jetën nga perspektiva e qiellit. Ne mund të fillojmë ta shohim shefin (pronar, drejtues) apo dikë që na ofendon, si një individ të plagosur, i cili ka nevojë për dashuri. Ne mund të shohim pas një maske të një adoleshenti rebel, vajzën apo djalin, që po thërret për t'u pranuar. A i shiko të tjerët me sytë e qiellit? Çfarë ndryshimi do të sillte shikimi shpirtëror në jetën tënde?

*Unë, Zoti, ju kam thirrur sipas drejtësisë...
për t'u hapur sytë të verbëve.*

Isaia 42:6-7

Më mirë të varem sesa të tradhtoj Zotin tim.

SALEMA – NJË E KRISHTERE NËNTËMBËDHJETË VJEÇARE NË
PAKISTAN, E CILA ËSHTË PERSEKUTAR SHUMË PËR BESIMIN E SAJ



Valeriu Gafenku dhe familja e tij humbën babanë dhe kanë vuajtur shumë në duart e torturuesve komunistë. Por përsëri, ai s'kishte asgjë të keqe për të thënë për komunistët, të cilët kishin sjellë shumë dhimbje në familjen e tij. Si mund të duronte ai kaq shumë dhe të mos fliste kundër torturuesve të tij?

Ai u përgjigj: «Kur mbreti David ishte në një hall shumë të madh, Shimei i hodhi gurë, e mallkoi dhe e akuzoi për krime, të cilat s'i kishte kryer (2 Samuelit 16). Një nga ushtarët e Davidit ishte gati ta vriste Shimein, por Davidi e ndaloi. Ai e lejoi Shimein ta mallkonte, sepse ndoshta Zoti e kishte urdhëruar. Davidi e dinte që ishte i pafajshëm për ato që e akuzonte Shimei, por e dinte se ishte fajtor për mëkate të tjera për të cilat Shimei nuk dinte asgjë.

Komunistët na quajnë banditë dhe armiq të njerëzve, por ne nuk jemi të tillë. Megjithatë, të gjithë ne jemi fajtorë se nuk jemi shenjtorë shembullorë duke u bërë më tepër si Krishti. Reagimi ynë ndaj veprave të këqija të komunistëve nuk duhet të jetë urrejtja, por ripërtëritja e brendshme. Rrezet e shenjtërisë që do të burojnë prej nesh do të shkatërrojnë të keqen. Fjala greke për Zotin, *theos*, vjen prej një fjale që ka kuptimin *buron*.»

Dëshmia e Gafenkut në burg solli shumë veta te Krishti. Dhe deri në ditën që vdiq, ai refuzoi të thoshte një fjalë të keqe kundër atyre që i shkaktuan dhimbje.

A meriton një armik të nderohet? Ndoshta është e vështirë të mendosh në këtë linjë. Megjithatë mund të mësojmë nga kisha e persekutuar që Zoti mund të përdorë, madje edhe armiqtë tanë për të na sjellë afër tij. Në këtë kuptim, ne mund të nderojmë rolin që luajnë armiqtë tanë në jetën tonë. Nëse i shajmë ata, mund të jemi duke treguar përbuzje ndaj planit më të madh të Perëndisë. Nëse je i zënë duke sharë armiqtë e tu për mënyrën se si të trajtojnë, ndalo dhe mendo pse Zoti ka lejuar situatën në jetën tënde. A po e bën më të lehtë apo më të vështirë për Zotin të të mësojë diçka përmes saj? Nëse është kështu, ti sigurisht që do të përballesh përsëri me të, derisa të mësosh.

«Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni!
Mos dënoni e nuk do të dënoheni! Falni e
do të jeni të falur!»

Luka 6:37

Thashetheme ekstreme

KINË: BESIMTARE KINEZE

«Kemi dëgjuar thashetheme se njerëzit në perëndim thonë që të krishterët në Kinë nuk persekutohen» – fillon letra nga një grup besimtarësh kinezë.

«Më tepër se njëqind vëllezër u burgosën këtu dhe shumë të krishterë të rinj nën të tetëmbëdhjetave u vunë nën presion të madh nga policia. Disa u hodhën në gropa plehu; të tjerë u rrahën me shkopinj elektrikë; disa u rrahën aq shumë, sa s'mund të qëndronin në këmbë, por vetëm mund të zvarriteshin

Vetëm disa mund ta duronin këtë. Të tjerët ia zbuluan policisë emrat dhe adresat e bashkëpunëtorëve të tyre. Këta u dënuan, ndërsa ata që nuk thanë asgjë, në fakt u liruan për shkak të mungesës së provave.

Persekutimi është normal për ne. Në shumë raste, jemi liruar pas marrjes në pyetje. Pastaj kthehemi në krahinën tonë të mëparshme për të predikuar.

Disa adoleshentë duan t'ia dedikojnë veten e tyre Zotit për një shërbesë të krishterë me kohë të plotë. Të dëbuar prej shtëpive të tyre, ata janë gati të kalojnë tërë jetën e tyre në këtë model të rrezikshëm ecejakesh. Kjo na e shton më tepër ankthin, duke pasur frikë edhe ne vetë do të flakemi tej pas predikimit të ungjillit. Ne kemi paguar një çmim të madh për ungjillin – shumë gjak dhe djersë, shumë lot të derdhur, shumë jetë të sakrifikuara dhe shumë përballje me shiun dhe erën».

Thashethemet që persekutimi i të krishterëve në Kinë ka përfunduar, sigurisht që nuk janë të vërteta. Në fakt këto thashetheme mund të jenë mjete që armiku përdor për të shtypur lutjet dhe mbështetjen për të cilat këta besimtarë të persekutuar kanë nevojë. Shpesh ne ndiejmë se, nëse i themi vetes se diçka nuk është kështu, atëherë ndoshta ajo nuk është në të vërtetë. Nëse e fshehim veten ndaj rrëfimeve të persekutimeve dhe historive të mbijetesës, atëherë mund të fillojmë të besojmë se shtypja nuk ekziston. Ne s'mund ta fshehim apo ta mohojmë të vërtetën mjaft gjatë që ajo të ndryshojë. Motrat dhe vëllezërit tanë po persekutohen sot në vendet e izoluar. Kur e merr vesh këtë, cili është reagimi yt? A do të lutesh? Do të shërbesh? Do të japësh? Kalo pak kohë duke menduar dhe duke u lutur për reagimin tënd.

Kujtoni të burgosurit si të ishin lidhur bashkë me ta, dhe ata që keqtrajtohen, sepse edhe ju vetë jeni ende në trup.

Hebrenjve 13:3

Pyetje ekstreme

ROME: PTOLEMEU

«Jeni i krishterë?» Pyetja u drejtua tre herë. Tre herë përgjigjja ishte «Po». Tre të krishterë u martirizuan. Sundimtari romak, Urbiku, nuk i toleronte të krishterët në vitin 150 pas Kr.

Ptolemeu u akuzua se mësonte që shpëtimi vinte vetëm me anë të besimit të Jezusi. Ai i urrente mashtruesit dhe të pafetë e asaj kohe. Kështu që kur Urbiku e pyeste nëse ishte i krishterë, ai s'mund të gënjente. Duhet të mbronte përgjigjen e drejtë dhe të guximshme «Po». Për këtë u prangos dhe u rrah shumë herë.

Përsëri u soll para Urbikut dhe përsëri iu drejtua e njëjta pyetje: «Jeni i krishterë?»

Dhimbja dhe vuajtja s'mund ta ndryshonin realitetin. «Po» – iu përgjigj përsëri Ptolemeu.

Me të dëgjuar për arrestimin e Ptolemeut, një burrë në moshë të thyer iu afrua Urbikut dhe iu përgjërta për shpirtin e tij. «Pse do ta ekzekutoni një mësues kaq të mirë? Çfarë përfitimi keni ju apo perandoria? Ai nuk ka thyer asnjë ligj, vetëm ka rrëfyer se është i krishterë.»

I intriguar prej mbrojtjes së burrit, ai bëri një pyetje të vetme. «Edhe ti i krishterë je?» Burri i moshuar këmbënguli me kurajë: «Po, jam».

«Atëherë mund të bashkohesh me mësuesin tënd.»

Sikur të mos ishte mjaft, një njeri tjetër u paraqit me të njëjtën protestë. Përsëri iu drejtua pyetja: «Jeni i krishterë?»

Të tre fëmijët e Perëndisë u ekzekutuan, sepse u përgjigjën «Po».

Pyetja është mjaft e thjeshtë. «Je i krishterë?» është e drejtpërdrejtë, personale, është një çështje po/jo ndaj së vërtetës. Atëherë çfarë është e vështirë rreth përgjigjes? Problemi nuk është që të krishterët nuk dinë si të përgjigjen. Problemi i vërtetë është se të tjerët nuk na e drejtojnë mjaft shpesh këtë pyetje. Ne nuk jetojmë në një mënyrë të ndryshme që dikush të mendojë për të pyetur se çfarë është ndryshe në jetën tonë. Duhet ta pranojmë se shumë pak njerëz na drejtojnë pyetjen që iu drejtua Ptolemeut. Këtu qëndron problemi i vërtetë. Kur është hera e fundit që stili yt i jetesës ka zgjuar interesin e bashkëpunëtorit tënd, mikut apo të afërmit, aq sa ata të pyesin për besimin tënd? Ti e di përgjigjen – jeto tani në mënyrë që të tjerët të ta bëjnë këtë pyetje.

Ju jeni kripa e tokës; por në qoftë se kripa bëhet e amësht, me se mund ta rifitojë shijen? Nuk vlen për asgjë, veçse për t'u hedhur që ta shkelin njerëzit.

Mateu 5:13

FKSTREM

Buzëqeshje ekstreme

RUMANI: MILAN HAIMOVIÇI

Qelia e ftohtë dhe e errët e burgut ishte mbushur me të krishterë rumunë, të cilët ishin të vendosur të sillnin dritën e Jezusit në errësi. Njëri prej të burgosurve ishte një besimtar çifut i quajtur Milan Haimoviç.

Një ditë, Milani filloi një diskutim me një shok tjetër të qelisë, i cili ishte shkencëtar i madh, por një njeri i pafe. Milani nuk ishte në të njëjtin nivel intelektual dhe kulturor si profesori, por ai i tregoi për Jezusin. Profesori e përbuzi: «Ti je gënjeshtar. Jezusi jetoi dy mijë vjet më parë. Si mund të thuash se ecën dhe bisedon me të?»

Milani u përgjigj: «Është e vërtetë që ai vdiq dy mijë vjet më parë, por edhe u ringjall dhe jeton edhe tani».

Atëherë profesori e sfidoi Milanin: «Mirë, ti thua se ai bisedon me ty. Cila është shprehja në fytyrën e tij?»

Milani iu përgjigj: «Ai ndonjëherë më buzëqesh».

«Gënjeshtër», – qeshi profesori. – Më trego se si buzëqesh». Milani plot hir pranoi. Ai ishte katandisur kockë e lëkurësive me sytë e thelluara në dy gropa. Nuk kishte dhëmbë, por një buzëqeshje shumë e bukur u formua në buzët e tij. Fytyra e tij e papastër shkëlqeu me shumë paqe, kënaqësi dhe gëzim.

Profesori i pafe përkuli kokën dhe pranoi: «Zotëri, ju e keni parë Jezusin».

Një buzëqeshje është shprehje e natyrshme njerëzore e sigurisë, paqes dhe kënaqësisë. Një buzëqeshje gjatë dhimbjes, vuajtjes dhe madje, edhe agonisë mund të japë një dëshmi të mbinatyrshme për Zotin. Nëse Jezu Krishti, Biri i vetë Perëndisë, është duke jetuar me të vërtetë në zemrat tona, atëherë disa prej nesh duhet t'i informojmë fytyrat tona për lajmin e mirë! Ka raste që në kishë këndojmë këngë si në një vajtim funeralesh – mendimet tona janë shumë larg prej fjalëve. Çfarë tregon fytyra jote rreth marrëdhënies suaj me Jezusin? A je një dëshmi për të tjerët që të kalojnë pranë në rrugë? A dëshmon kënaqësinë e Krishtit në zemrën tënde? Apo vetullat e tua janë të ngrysura nga shqetësimi dhe buzët vazhdimisht të mberthyerat? Kërkoji ndihmë Zotit për të qenë të vetëdijshëm për lajmin tënd të heshtur dhe të të mbushë me gëzimin e tij.


Në shpresë jini të gëzuar, në vështirësi të durueshëm, në lutje të qëndrueshëm!

Romakëve 12:12

FKSTREM

Sfidë ekstreme

JUDEJA: J. OSVALD SMITH



Zoti Jezu Krisht përdori një strategji kur ushqe pesë mijë vetë që e kishin ndjekur në këmbë nga qytetet përreth. Ishte afër mbrëmjes dhe dishepujt erdhën tek ai, duke i kërkuar ta largonte turmën gjatë natës. Megjithatë, Jezusi kishte një plan tjetër. I uli njerëzit në rreshta të rregullt mbi bar. Pasi mori ushqimin dhe falënderoi, dishepujt filluan në njërin skaj të rreshtit të parë dhe shkuan përgjatë këtij rreshti duke u dhënë secilit nga një pjesë.

Një predikues dhe autor, J. Osvald Smith, bëri një pyetje të jashtëzakonshme në këtë pikë. «A u kthyen dishepujt për qark dhe filluan përsëri në rreshtin e parë, duke pyetur nëse donin ndonjë racion tjetër?»

Jo! Po të kishin vepruar kështu, ata në radhët e fundit do të ishin ngritur dhe do të kishin protestuar më fort. Ata do të mund të kishin thënë: «Ejani këtu. Na jepni një racion. Pse duhet të marrin një racion të dytë personat në fillim para se ne të marrim të parin».

Dhe do të kishin pasur të drejtë. Ne flasim për ardhjen e dytë të Krishtit. Shumë vetë nuk kanë dëgjuar akoma për ardhjen e parë. *Pse duhet dikush ta dëgjojë ungjillin dy herë, më parë se dikush tjetër ta dëgjojë për herë të parë?* Asnjë person në të gjithë grupin prej pesë mijë vetash nuk mori një racion të dytë, derisa të gjithë të kishin mbaruar të parin».

Shumë të krishterë kanë frikë të shkojnë në vendet e pashkelura më parë nga ndonjë misionar. Është më e lehtë të mbetesh në një territor të njohur. Por, Jezusi i urdhëroi besimtarët të shkonin në «mbarë botën» dhe të gjenin vende të reja ku emri i Krishtit nuk është shpallur asnjëherë. Interpretimi realist i Smithit i të ushqyerit të pesë mijë vetëve i sfidon metodat tona kur vjen puna për ungjillizimin. Pse shumica e burimeve të njerëzve dhe buxheteve financiare shkojnë për ata njerëz që e kanë dëgjuar ungjillin tashmë? Në fakt, shumë prej këtyre vendeve janë në rrezik të të qenit të mbipopulluara me kisha, ndërkohë që grupeve të tjera njerëzish u mungon një Bibël e vetme e përkthyer në gjuhën e tyre. A mund të ndihmojë mbështetja jote në vendosjen e ekuilibrit të peshores? A mund të sjellë jeta jote një ndryshim në përpjekjet ungjillizuese të së nesërme?

Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin, që kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.

Gjoni 3:16

FKSTREM

Peng ekstrem

ANGLI: BILLI DHE XHONI

Billi dhe Xhoni ishin pranë skelës në Anglinë jugore kur panë flamurin rumun të varej nga bashi i anijes. Ishte gjatë viteve të linjës së ashpër të qeverisjes komuniste.

Me pak fjalë, ata e dalluan fushën e misionit para tyre, hapën çantat me Bibla dhe shkuan në bord. Hynë në dhomën e rrëmujshme ku ishin mbledhur të tridhjetë e pesë burrat e anijes. Billi dhe Xhoni shpjeguan pse kishin ardhur dhe filluan të nxirrnin Bibla rumune. Turma u kushtoi menjëherë vëmendje të pandarë. Shumica prej tyre s'kishin dëgjuar më parë për Perëndinë dhe Birin e tij, Jezusin.

Kur Billi dhe Xhoni zbuluan se ata s'kishin mjaft Bibla rumune, dy detarë trupmëdhenj e kapën Billin prej krahësh dhe me butësi, por me vendosmëri, e ulën në karrige. Ata shpjeguan me mirësjellje me anglishte të çalë se Billi do të qëndronte atje, derisa Xhoni të vinte me Bibla për të gjithë.

Peng për Bibla – Të qeshte apo të qante? Xhoni s'e dinte, por ishte e vetmja mënyrë që rumunët mund të siguroheshin që ai do të kthehej. Në një vend komunist plot me premtime të pambajtura, ata s'i besonin askujt.

Xhoni nxitoi për në zyrë dhe e mbushi arkën plot me Bibla rumune. Brenda një ore u kthye në dhomën e rrëmujshme, ku ekuipazhi mori me mirënjohje Biblat dhe liroi «pengun».

Ndajeni fjalën. Kjo ishte ajo që tha Jezusi për mesazhin e ungjillit. Si të mundemi, kudo që të shkojmë, çfarëdo që të bëjmë, duhet të jemi me detyrën e shpërndarjes së fjalës për Krishtin. Përkushtimi ynë mund të na çojë në skelë të portit ose thjesht në një tavolinë me komshinjtë tanë jobesimtarë në derën tjetër. Sido që të jetë, duhet të jemi të përgatitur të ndajmë Fjalën e Zotit me ata që janë duke humbur shpirtërisht. A je i nxitur të ndash fjalën për Krishtin? A je i vetëdijshëm për kohën e kuqizuar që mund të kesh për të përmbushur misionin tënd? Mos humb asnjë moment tjetër, duke menduar se dikush tjetër do ta bëjë pjesën tënde. Çfarë mund të bësh sot për të shpërndarë Lajmin e Mirë?

Besimi, pra, vjen nga dëgjimi dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë.

Romakëve 10:17

**Ne lutemi për qeverinë e Sudanit,
por edhe e falënderojmë Perëndinë për të.
Falë politikave dhe luftës së saj kundër
të krishterëve – terrorit, kërcënimeve,
burgosjeve – shikoni se sa është rritur kisha.
Shikoni çfarë na ka lejuar Perëndia të bëjmë
në mes të kësaj! Shikoni se sa shumë po
kthehen te Krishti!**

NJË I KRISHTER SUDANEZ



FKSTREM

Shtyp ekstrem

KINË: KATI LI

Vizitorët në mënyrë të fshehtë dhe qetësisht arritën në shtëpinë e një gruaje të moshuar kineze. Ata u shoqëruan pas një perdeje dhe pastaj u zvarritën mbi njëqind metra përmes një kanali të gjatë e të errët që përfundoi në dy dhoma të vogla në formë shpelle.

Në njërën prej dhomave, një vajzë nëntëmbëdhjetë vjeçare e krishterë, e quajtur Kati Li vinte në punë një shtypshkronjë primitive. Herë pas here gjatë gjithë këtyre muajve Kati punonte në këtë shpellë, duke shtypur libra të krishterë të paligjshëm dhe materiale të tjera të krishtera. Nëse zbulohet, ajo s'mund të ishte në gjendje të zbulonte identitetin e saj në publik.

Por ndërsa shtypi sekret botonte më tepër libra dhe trakte, Zyra e Sigurisë Publike (ZSP) dyshoi dhe filloi të pyeste fshatarët. Ata që dinin për shtypin nuk donin të bashkëpunonin.

Më në fund, e zemëruar prej mungesës së bashkëpunimit, ZSP-ja filloi të përdorte dinamit dhe të shpërthente çdo shtëpi në fshat, derisa më në fund arritën në shtëpinë e gruas së moshuar. Shpella u zbulua dhe shtypshkronja u konfiskua. Megjithatë, punonjësit megjithatë, ishin larguar më parë të padëmtuar.

Kati Liu dhe punonjësit e tjerë qëndrojnë të fshehur edhe sot e kësaj dite. Nëse gjenden, do të burgosen menjëherë dhe ndoshta ekzekutohen. Ata s'do të jenë kurrë më në gjendje të shohin sërish miqtë dhe pjesëtarët e familjes. Por puna dhe dëshmia

e Katit jeton ndërmjet librave dhe trakteve që ajo prodhon.

Deri më sot, ata janë lexuar prej mijëra të krishterësh kinezë.

Ajo mund të ndërpritet, mund të ndryshojë, madje, edhe mund të pezullohet përkohësisht. Por mbretëria e Perëndisë është vazhdimisht duke ecur përpara. Ajo s'mund të ndalohet kurrë. Krishti e ka vendosur mbretërinë në lëvizje kur u dha Porosinë e Madhe dishepujve. Që nga ajo ditë, ata që i shtohen mbretërisë kanë vazhduar të rriten me forcë të plotë, pavarësisht nga kundërshtimet e armikut. Sigurisht, shumë janë përpjekur ta ndalojnë ungjillin, por kanë dështuar. A ke përjetuar ndonjë ndërprerje në shërbesën tënde? A ke qenë i shqetësuar që pjesa jote ka përfunduar për shkak të rrethanave të paparashikuara? Mbaj mend, Zoti nuk ka përfunduar akoma me ty. Ndikimi yt për ungjillin do të vazhdojë për aq kohë sa i qëndrosh besnik atij.

Duke qenë i bindur për këtë, se ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezu Krishtit.

Filipianëve 1:6

«Pasuri» ekstreme

AZIA JUGLINDORE: TË KRISHTERËT HMONG

«Ata i kaluan thikën mospërmes gojës një besimtari dhe i hodhën ujë të nxehtë në fyt një tjetri, i cili ishte kapur me Bibël. Një familje e tërë u mbyt.»

Besimtarët në fisin Hmong të Azisë juglindore ranë dakord për të dhënë dëshminë e tyre në një videokasetë. Ata donin të inkurajonin të krishterët në perëndim.

Një i krishter Hmong tha: «Autoritetet komuniste ndihen të kërcënuar, sepse shumë persona Hmong janë bërë të krishterë. Ata i rrahin të krishterët që t'i detyrojnë të kthehen në adhurimin e tyre të shpirttrave të këqij».

«Policia lokale na ndaloi të bëheshim të krishterë. Kërcënuan të na fusnin në burg, madje edhe të na vrisnin. – shtoi gruaja. – Por nëse do të na duhet të vdesim për hir të Krishtit, ne jemi gati».

Këta besimtarë janë gati ta vendosin veten në një rrezik më të madh për të lejuar që bota ta dijë se ata po qëndrojnë fort përballë persekutimit.

Fisi Hmong është më i madhi në Azinë juglindore dhe është duke përjetuar rritjen më të madhe të krishterimit. Është gjithashtu një nga grupet më të persekutuara të njerëzve.

Një grua tjetër tha: «Falënderoj Zotin që kemi mbetur të fortë. Unë besoj se persekutimi është vetëm një provë e besimit tonë në Krishtin. Ai sjell pasuritë e vërteta. Ai sjell argjendin dhe arin. Vetëm lutuni që ne të jemi besnikë deri në fund».

Çeliku forcohet përmes një procesi kalitës – nxehet në një temperaturë ekstreme, shtypet në një formë dhe ftohet. Pastaj procesi përsëritet sërish e sërish, duke nxehur dhe duke larguar papastërtitë dhe pastaj ftohet që metali të mund të lidhet. Një proces i tillë kalitjeje forcon besimin tonë. Kur nxehehi nga urrejtja e të tjerëve, kur shtypemi nga persekutimi dhe kur ftohemi nga siguria e butë e pranisë së Zotit, papastërtitë tona largohen dhe besimi ynë forcohet. A e ke njohur procesin e kalitjes në jetën tënde? Mos i rezisto asnjë pjese të saj. Mëso nga motrat dhe vëllezërit në fisin Hmong. Armiqtë e tua nuk e kuptojnë që ti do të jeshi më i fort, si rezultat i urrejtjes së tyre.

...që prova e besimit tënd, që është shumë më i çmuar nga ari që prishet, edhe pse provohet me zjarr, të dalë për lëndim, nder e lavdi në zbulesën e Jezu Krishtit.

1 Pjetrit 1:7

FKSTREM

Kontrabandist ekstrem

EVROPA LINDORE: MIHAI

Furgoni Volkswagen i Mihait iu afrua me ngadalë pikës së kontrollit të kufirit. Ai me ankth pëshpëriti një lutje të shkurtër: «I dashur Jezus, të lutem, mbroje Fjalën tënde, që të mos gjendet dhe të konfiskohet prej rojave të burgut».

Me rregullat të ashpra rojat e urdhëruan të dilte jashtë furgonit dhe filluan listën e tyre të pyetjeve: «Çfarë të sjell në vendin tonë? A do të vizitoni dikë këtu? Nëse po, kë? A keni ndonjë armë me vete?»

Mihai iu përgjigj me kujdes çdo pyetjeje, por zemra filloi t'i rrihte me intensitet të madh ndërsa me bisht të syrit, vuri re një prej rojave që po shikonte poshtë çdo sediljeje në furgon. Mihai po fillonte të lodhej nga qëndrimi për një kohë kaq të gjatë. Të kënaqur me përgjigjet e Mihait, rojat e lejuan më në fund të hynte në vendin e tyre, me mallrat e çmuara të fshehura prej syve të tyre.

Prej vitesh, ky korrier i ri kurajoz kishte futur literaturë ungjillore në vendet komuniste në Evropën Lindore, duke mos iu zbuluar asnjëherë kjo ngarkesë sekrete. Mihai ishte njeri i zakonshëm, vizioni i jashtëzakonshëm i të cilit ishte sfidë e vërtetë. Ai nuk kishte këmbë – ato i kishte të prera pothuajse deri nëafërsi të këllqeve – por ishte i vendosur të mos e lejonte handikapin (të metën) e tij t'ia pengonte rrugën.

Ashtu si apostulli Pal, Mihai e dinte se fuqia e Krishtit do të përsosej në dobësinë e tij fizike. Pasi u pajis me gjymtyrë metalike, ai e vendoste literaturën në boshllëkun e secilës këmbë dhe pastaj fillonte me padurim udhëtimet e tij.

Zoti është një punëdhënës me mundësi të barabarta kur bëhet fjalë për shërbesën e tij. Mihai i pa kufizimet e tij personale si një mundësi e mrekullueshme për t'iu bashkuar Zotit në një punë krijuese. Çdo përgjegjesi mund të jetë një mundësi për një shërbesë unike. Për shembull, ata që vijnë nga një tragjedi e një familjeje të divorcuar mund t'u shërbejnë të tjerëve në të njëjtën situatë, në një mënyrë që të tjerët s'munden. Çfarë ken konsideruar për një kohë të gjatë si mangësi, përsa i përket dobishmërisë sate në mbretërinë e Zotit? Mendo për to nga perspektiva e Zotit. Pastaj ofroja Zotit dhe konstato se si mund t'i përdorë për laudinë e tij dhe për të mirën tënde.

Por ne e mbajmë këtë thesar në enë argjile, që kjo fuqi e pakrahasueshme të shihet se vjen prej Perëndisë e jo prej nesh.

2 Korintasve 4:7

Thesar më ekstrem

TAXHIKISTAN: BASHKESIA E HIRIT SONMIN

Ishte e diel dhe Kisha e Hirit Sonmin në Dushanbe, Taxhikistan, ishte mbledhur për shërbesën e saj të përjavshme të adhurimit. Megjithëse vendi i tyre ishte i lirë prej regjimit shtypës komunist, myslimanët radikalë e sulmonin hapur kishën. Shtypja thjesht kishte ndryshuar duart nga një autoritet terrorist në një tjetër.

Pikërisht në kohën kur pastori i ftuar përmbodhi predikimin, një shpërthim i madh pas kishës tronditi ndërtesën. Një bombë. Në një moment, besimtarët kaluan nga adhurimi i Zotit, në vrapim të çmendur për të shpëtuar jetën e tyre. Ata u përpoqën të shpëtonin në korridor, por një bombë tjetër shpërtheu në rrugën e tyre të shpëtimit. Trupa dhe gjak u shpërndanë kudo në kishën që më parë quhej «shenjtërore».

Një grua e moshuar, e shtrirë në dysheme nuk ishte në gjendje të lëvizte. Bibla që ajo po studioje disa momente më parë në shërbesën e adhurimit, ra përkrah saj e njetosur me gjakun e saj. Ajo u hap në një faqe ku kishte rrethuar tre vargje diku para sulmit në kishë. «Por ne e mbanim këtë thesar në enë argjile, që kjo fuqi e pakrahasueshme të shihet se vjen prej Perëndisë e jo prej nesh. Po, nga çdo anë jemi të ndrydhur, por jo të ngushtuar; jemi të pështjelluar, por jo të dëshpëruar, të braktisur, por jo të lënë, të hedhur andej-kënde, por jo të rrëzuar» (2 Korintasve 4:7-9).

Myslmanët radikalë i konsideruan njerëzit e pafajshëm si të sakrifikueshëm për kauzën e tyre. Por vdekjet e besimtarëve shkëlqyen si xhevahir, si një dëshmi ndaj besnikërisë së Zotit. Armiku mund ta ketë shkatërruar trupin e gruas së moshuar – «enën e saj prej balte», – por thesari i saj i brendshëm u zbulua kur shpirti i saj u ngjiti në qiell disa ditë pas sulmit. Ne jemi më të vetëdijshëm se kurrë më parë se vdekja mund të vijë papritur nga duart e armiqve tanë, por s'duhet ta kemi frikë vdekjen. E shumta që mund të na bëjnë armiq të tanë është të vrasin trupat tanë vdekatarë. Trupat e tu fizikë nuk të përbëjnë «ty» në të vërtetë. Ngushëllohu sot duke ditur se thesari i shpirtit tënd nuk mund të preket.

...kurdo ne e mbajmë në trupin tonë vdekjen e Zotit Jezus, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në trupin tonë. Ne që jetojmë, jemi vazhdimisht të dorëzuar në vdekje për Jezusin, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në mishin tonë të vdekshëm.

2 Korintasve 4:10-11

FKSTREM

Fillime ekstreme

SHTETET E BASHKUARA: RIÇARD DHE SABINA VURMBRAND

Në një ditë të bukur vjeshte të vitit 1967, çifti u ul para makinës së tyre të vjetër të shkrimit në një tavolinë të vogël kuzhine në shtëpinë e tyre të re – Shtetet e Bashkuara. Nuk kishte kaluar shumë prej kohës kur pastor Riçard Vurmbbrandi kishte qenë i ulur në një qeli të errët burgu rumun për punën e tij në kishën e fshehtë. Gruaja e tij, Sabina, ishte dënuar me punë të detyrueshme në një kamp burgu.

Çifti tani po meditonte për mesazhin që Zoti u kishte dhënë. Ata donin të ndanin sprovat dhe triumfet që kanë të bëjnë me të krishterët e persekutuar në vendet komuniste në mbarë botën. Çifti ishte kërcënuar nga policia sekrete rumune të mos flisnin kundër komunizmit, por kërcënimi s'mund t'i ndalonte. Ata ishin të nxitur për të ngritur zërin e trupit të vuajtur të Krishtit – një zë që është anashkaluar dhe harruar nga shumë njerëz në botën e lirë.

Fjalët rrodhën lehtë nëpër faqe dhe shumë shpejt ata nxorën botimin e parë të buletinit të Zërit të Martirëve. E filluan me njëqind dollarë dhe disa qindra emra dhe adresa nga të krishterë, të cilët ishin të interesuar të ndihmonin.

Vizioni që kishte lindur në një qeli të vetmuar burgu ishte kthyer në një organizatë mbarëbotërore përkushtuar shërbimit të kishës së persekutuar.

Miliona buletine të mëvonshme të Zërit të Martirëve janë shpërndarë në mbarë botën në më tepër se dymbëdhjetë gjuhë.

Fillojnë diku. Ja ku fillojnë idetë e mira në shërbim të Zotit – diku. T'i shërbesh Krishtit nuk ka rëndësi se ku fillon, kur apo si – mjafton të filloni. Shumë njerëz i vonojnë ëndrrat e tyre, në vend që të fillojnë diku. Ne themi me vete se ndonjë ditë do t'i shërbejmë Krishtit: kur fëmijët të rriten dhe të largohen nga shtëpia; kur më në fund të mund të paguajmë faturat dhe të jemi në gjendje të japim të dhjetën. Sa herë që themi se do të fillojmë t'i shërbejmë Krishtit pasi të kemi përfunduar diçka tjetër, ne e kemi humbur rëndësinë e thirrjes sonë. Çfarë po të thërret Zoti për të bërë? Jo kur po të thërret për ta bërë këtë, çfarë do ai që të bëhet? Çfarë po bën tani për të filluar përmbushjen e thirrjes sate?

Ecni me urti ndaj të jashtëmëve duke shfrytëzuar kohën.

Kolosianëve 4:5

Megjithëse Timoteu ishte i ri, Pali e inkurajoi të ishte një shembull për të gjithë. Timoteu dha prova që mund t'i vinte në jetë këto udhëzime.

Timoteu ishte nga Lистра, një nga qytetet që Pali kishte vizituar gjatë udhëtimit të tij të parë misionar. I ati i Timoteut ishte grek, mamaja dhe gjyshja ishin çifute të krishtera, të cilat ndikuan jashtëzakonisht në jetën e Timoteut të ri. Në fakt, Bibla thekson se ato ishin shembujt e Timoteut në besim. Pali duhet të ketë vënë re potencialin e Timoteut për t'u bërë vetë një besimtar i fortë. Kur Pali erdhi në udhëtimin e tij të dytë me Silasin dhe Lukën, Timoteu u bashkua me ta dhe udhëtuan për në Maqedoni.

Pali e quante Timoteun bir në besim. Kur kisha në Efes kishte nevojë për pastor, Pali e la Timoteun atje për të mësuar dhe inkurajuar besimtarët në atë qytet. Timoteu ndante jetën dhe shërbesën e Palit. Ai mund të ketë qenë me Palin në ditën kur ia prenë kokën në Romë, meqenëse Pali i kishte kërkuar të vinte për një vizitë të fundit...

Pas vdekjes së Palit, Timoteu u kthye në Efes dhe drejtoi kishën atje. Vazhdoi të dënonte adhurimin e idhujve, të cilët i bënë të pasur shumë njerëz në Efes. Kur Domiciani ratifikoi persekutimin e dytë të madh romak të të krishterëve, idhujtarët morën zemër. Timoteu u qëllua me gurë për vdekje rreth 98 vjet pas Kr. – besnik deri në fund, siç e kishte mësuar Pali të ishte.

Askush inkurajohet ta jetojë vetëm jetën e krishterë. Në fakt, është e pamundur ta bësh këtë. Në të njëjtën mënyrë që Pali mbikëqyrte Timoteun, ne kemi nevojë që dikush të na tregojë mënyrën dhe të besojë në potencialin tonë për të sjellë një ndryshim për Krishtin. Ne rritemi duke parë të tjerët që drejtojnë me anë të një shembulli në kisha, komunitet, familje dhe në shkollat tona. Ndërsa fillojmë ta kuptojmë rolin tonë të ndikimit, kemi nevojë për fansa në anën tonë, që të na japin zemër për një përkushtim më të madh. Cili është shembulli yt në besim? Kush është përgjegjës për të të mësuar si të jetosh për Krishtin? Mund të jetë pjesëtar i afërt i familjes, një mik apo pastor. Falëndero Zotin për ndikimin e tyre në jetën tënde.

Por ti, qëndro në atë që mësove dhe u binde plotësisht, duke e ditur prej kujt i mësove.

2 Timoteut 3:14

**Më është dashur të besoj se Zoti,
në urtësinë e tij, lejon martirizimin në çdo
brez pjesërisht sepse, pa të,
realiteti i vdekjes së Krishtit për ne bëhet
gjithnjë e më i paqartë, i turbullt...
Ndërsa shohim «martirët», mjegulla që
ndonjëherë mbështjell Golgotën e shekullit
të parë shpërndalet dhe ne atëherë
shohim... Zotin të kryqëzuar.**

MARK GALI

FKSTREM

Fytyra ekstreme

RUMANI: NJE PASTOR I BURGOSUR

«Është mahnitëse se si mund ta shihni Jezusin në fytyrën e besimtarëve të tjerë. Fytyrat e tyre shkëlqejnë dhe është një arritje për lavdinë e Zotit që ndriçon në fytyrën e të krishterëve në burgjet komuniste. Ne nuk lahemshim – unë nuk isha larë për tre vjet – por lavdia e Zotit shkëlqente, madje edhe përtej kores së papastërtisë. Dhe ata kishin gjithnjë buzëqeshje triumfuese në fytyrat e tyre.» – shkruante një pastor i burgosur.

«E di që të krishterë të tjerë u liruan nga burgjet komuniste ashtu si edhe unë. Njësoj si ata, ndalohesha disa herë në rrugë nga kalimtarë që më pyesnin: «Zotëri, çfarë ka të veçantë tek ju? Dukeni shumë i lumtur. Cili është burimi i lumturisë suaj?» U thashë se vinte prej shumë viteve të kaluara në burgjet komuniste duke vuajtur për Shpëtimtarin tim.

Ata s'mund ta kuptonin këtë, sepse s'mund të mendonin përtej vështirësive të jetës së tyre. S'kishin mësuar të silleshin sipas Frymës dhe të përjetonin praninë e Zotit. Shumë prej tyre do të mendonin: «Veç ta dije se çfarë jete kam – një burrë që më rreh, një grua që ma ha shpirtin, fëmijë që ma thyejnë zemrën.» Ka shumë vështirësi materiale dhe stuhi në shpirtin tënd. E çfarë pastaj? Si mund të krahasohen ato me gëzimin e njohjes së Jezusit?»

Atë që Jezusi jep, askush s'mund ta marrë. Ai na jep gëzim në praninë e Frymës së Shenjtë brenda nesh. Dhe, megjithëse situatat mund të duken të errëta, gëzimi ynë akoma shkëlqen. Madje, edhe pislëku i tre vjetëve në një burg komunist s'mund ta fshehë gëzimin e krishterë. Nuk është e thënë të jemi të gëzuar në vështirësitë tona, të jemi të kënaqur për dhimbjen tonë, por të mbetemi të gëzuar për shkak të pranisë së Krishtit në të. A e ke humbur ndjenjën e gëzimit? Ti e kupton se askush s'mund të ta heqë atë. Nëse mungon në jetën tënde, është për shkak se ti e ke braktisur për hir të rrethanave e tua. Kërkoji Zotit sot të ripërtërijë gëzimin tënd në të.

Zemra juaj do të gëzohet dhe askush nuk do të ta heqë gëzimin tuaj.

Gjoni 16:22

Shërim ekstrem

PAKISTAN: ASIFI

Asifi e kishte këmbën të thyer që kur një makinë e goditi në një rrugë të Pakistanit. Në mes të dhimbjes, ai ndjeu një dorë mbi këmbë. Ngriti sytë dhe dëgjoji një grua, që lutej që Jezusi të mund ta shëronte. Asifi filloi të zemërohej, sepse ishte mysliman. Pastaj një energji e çuditshme filloi të përshkonte trupin e tij, këmba u drejtua dhe kocka u kthye në vendin e vet. Ai në fakt, u kthye në këmbë në shtëpi pas aksidentit.

I uritur për të njohur më tepër për këtë «Jezus», i cili e kishte shëruar, ai lexoi për Jezusin dhe mrekullitë e tjera në Biblën që ajo grua i dha. Asifi shkoi të pyeste te mullai (drejtues fetar) në xhaminë e tij. «Pse po flet për Jezusin?» – e përbuzi mullai. «E si të mos kem interes për të? – pyeti Asifi. – Ai më shëroi.»

Mullai dhe të tjerët në xhami e mbyllën Asifin në një dhomë dhe e detyruan të pinte helm, duke menduar se nëse vdiste para se të pranonte Krishtin, mund t'ia dilte akoma të shkonte në parajsë. Megjithatë Asifi u zgjua dhe i thirri Jezusit.

Papritur një dritë e shndritshme mbushi dhomën e pluhurosur. Asifi u betua: «Kjo jetë është për ty. Për aq kohë sa jam në tokë, do të punoj për ty».

Që në këtë kohë, familja e Asifit e ka mohuar dhe ai është rrahur vazhdimisht, sepse refuzon të ndalojë së treguari njerëzve për mikun e tij të ri, Jezu Krishtin.

Ndonjëherë duhet të përjetojmë fuqinë e Zotit, para se ta besojmë atë. Në fakt, shumë jobesimtarë do të preferonin të debatonin për besimin në largësi, sesa të merren me një takim shpirtëror personal. Askush s'mund të argumentojë mbi përvojën personale. Individit është eksperti i vetëm për këtë çështje. Të takosh Zotin do të thotë të përjetosh fuqinë e tij dhe të ndjesh praninë e tij. Bibla na siguron shumë shembuj të jobesimtarëve që janë ndeshur me fuqinë e Zotit. Disa reagues me adhurim. Të tjerët i rezistuan fuqisë së tij dhe vuajtën pasojat. Si në njërin rast edhe në tjetrin, një person nuk është kurrë i njëjtë pas një eksperience me Zotin. Është sikur Zoti t'i thoshte një zemre dyshuese: «Unë jam i vërtetë, merru me këtë». Si të është treguar Zoti se është i vërtetë? Me kë mund ta ndash eksperiencën tënde?

*Veshi im kishte dëgjuar të flitej për ty,
por tani syri im të sheh.*

Jobi 42:5

FKSTREM

Tullumbace ekstreme

KOREJA E VERIUT: ZËRI I MARTIRËVE

«Gjyshe, shiko çfarë gjeta!» Vajza e vogël koreane veriore ishte shumë e emocionuar. Ajo po mbante diçka që s'e kishte parë kurrë më parë. Gjyshja e vështroi me shikimin e venitur, por s'mund të shquante detajet. Kështu që ajo thirri nënën e vajzës. «Të lutem, eja e më thuaj çfarë ka gjetur ky fëmijë».

Vajza e gruas së moshuar hyri në dhomë dhe e mori sendin nga dora e rrudhosur e nënës së saj. E bija filloi të lexonte fjalët e shtypura në tullumbacen plastike të krijuar mirë. «Zoti Jezus ju do. Motrat dhe vëllezërit tuaj nuk ju kanë harruar. Sepse Perëndia e deshi aq botën sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin».

Gjyshja thirri «Është nga Shkrimi! Ata na kanë dërguar vargje nga Bibla nëpërmjet tullumbaceve! Vazhdo të lexosh».

Tullumbacja plastike përmbante fjalë inkurajimi për tre breza koreanësh veriorë. Ajo përmbante një mesazh nga të krishterët në perëndim dhe mbi gjashtëqind vargje biblike, që e çojnë lexuesin që nga krijimi, te kryqi, deri në ardhjen e dytë të Jezu Krishtit. Në dekadën e fundit, mbi njëqind mijë prej këtyre «tullumbaceve me shkrime» janë shpërndarë në Korenë e Veriut.

Shërbesa e Zërit të Martirëve gjeti një mënyrë unike për të arritur këta njerëz të shtypur me Fjalën e Zotit dhe ungjillin. Në psalmin 19:1 thuhet: «Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij».

Ashtu si tullumbacet në këtë histori, Zoti dëshiron të na japë shkrime inkurajuese në mendjen dhe zemrën tonë kur kemi më tepër nevojë. Megjithatë ai s'mund të sjellë ndërmend shkrime që nuk kanë qenë kurrëndonjëherë aty. Ironikisht, megjithëse jetojmë në një shoqëri të lirë, shpesh sillemi sikur të jemi në vendet e izoluara si Koreja e Veriut që nuk e lejon Fjalën e Zotit. Leximi ynë i Biblës është sporadik dhe i rrallë – sikur të mos kishim aspak një kopje të shkrimit. Ndoshta është koha të «lundrojmë» Fjalën e tij përmes kufijve të mendjes sonë të mbyllur. Shënon një kohë në orarin tënd për leximin çdo ditë të Biblës dhe kërkoji Atij të ripërtërijë një dëshirë për Fjalën e Tij.

I gjithë Shkrimi është frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.

2 Timoteut 3:16-17

E vërtetë ekstreme

PAKISTAN: NADIA NAIRA MASIH

Pesëmbëdhjetë vjeçarja Nadia Naira Masih është një e krishterë e përkushtuar. Kur jetonte në shtëpi e kishte zakon të lutej dhe të lexonte Biblën herët çdo mëngjes. Megjithëse prindërit e saj nuk e kanë parë atë që prej shkurtit të vitit 2001, mendojnë se ajo e vazhdon këtë zakon në shtëpinë e rrëmbyesit të saj.

Një mysliman i quajtur Maksud Ahmed e rrëmbeu Nadinë. E ëma e Maksudit, atëherë mike e familjes së Nadisë, ndihmoi në nxjerrjen e saj nga shtëpia, ku më pas, dy prej vëllezërve të Maksudit dhe një mik i tij, e futën me forcë në një makinë me të, dhe të gjithë ishin të armatosur. Ajo nuk është parë që prej asaj kohe.

Rrëmbimi i vajzave të reja është i rrallë në Pakistan, por është e zakonshme për policinë pakistaneze të kthejë sytë nga ana tjetër kur krimet kryhen kundër të krishterëve, veçanërisht kur ofrohet rryshfet. Kjo është me sa thuhet situata në rrëmbimin e Nadisë dhe policia lokale ka qenë e ngadaltë në ndjekjen e çështjes.

Shtëpisë së Nadisë iu dha një certifikatë, ku thuhej se vajza ishte martuar me Maksudin. Çertifikata shpjegonte se, me anë të virtytit të martesës Nadia ishte kthyer zyrtarisht nga e krishterë në besimin mysliman. Nadia është vetëm një adoleshente. Duke u përballur me zemërimin dhe humbjen, prindërit e Nadisë nuk thonë akoma asgjë kundër Maksudit. Përkundrazi, ata besojnë se Zoti është mjaft i fuqishëm për të bërë çfarë është e nevojshme për ta kthyer Nadinë.

Besimi është diçka që dikush s'mund ta kuptojë plotësisht derisa është e vetmja gjë që ka. Prindërit e Nadisë e dinë çfarë do të thotë të besosh. Ata nuk besojnë se patjetër Nadia do të kthehet një ditë. Përkundrazi, ata kanë besim të plotë se Zoti është në gjendje ta sjellë atë shëndoshë e mirë. Ndryshimi është shumë i madh. Nëse ata do të besonin në një rezultat të veçantë, besimi i tyre do të tronditej nëse nuk ndodhte. Por ata po vendosin të vënë besimin e tyre në fuqinë e pashtershme të Zotit dhe aftësinë e tij për ta realizuar. Nëse Zoti në urtësinë e tij vendos të mos lejojë kthimin e saj, ata do t'i besojnë edhe më tepër. A i beson Zotit deri tani duke u varur te rezultati, apo i beson atij pavarësisht nga rezultati?

Perëndia ynë, të cilit i shërbejmë, është në gjendje të na çlirojë... nga dora jote, o mbret. Por edhe sikur të mos e bënte, dije, o mbret, që ne nuk do t'u shërbejmë perëndive të tua dhe nuk do të adhurojmë truporen e artë që ti ke ngritur».

Danieli 3:17-18

FKSTREM

Siguri ekstreme

ROME: JUSTINI

«Nëse fshikullohesh apo të pritët koka si kriminel, a akomodo të vazhdosh akoma të besosh se do të shkosh në qiell?» – e pyeti Rustik, zyrtari i qytetit.

«Unë besoj se, nëse i duroj këto gjëra, do të kem çfarë më premtoi Jezusi, – tha Justini. – Sepse unë e di që dhurata e tij e jetës është për të gjithë ata që mbeten në të deri në fund të botës.»

«A mendoni se do të merrni ndonjë shpërbtim atje?»

«Nuk e mendoj; e di. Jam i sigurt për këtë.»

Rustiku u spraps me padurim. «Ju duhet të bini dakord t'u kushtoni një fli zotave, perëndive»

Justini qëndroi i palëkundur. «Asnjë person me gjykim të drejtë nuk hedh poshtë bashkësinë me Zotin duke shkuar pas të pafeve.»

Rustiku nuk duroi më. «Nëse nuk bindesh, do të ekzekutohesh pa mëshirë.»

«Unë e di se nëse vdes për dëshminë e tij, s'duhet të kem frikë. Unë e vlerësoj vdekjen për një arsye të tillë si shpëtimi dhe siguria jonë para Krishtit», – iu përgjigj Justini.

Të tjerët që ishin bashkë me Justinin thanë: «Bëni si të dëshironi, sepse ne jemi të krishterë dhe nuk u ofrojmë sakrificë idhujve.»

Rustiku shpalli dënimin për të krishterët, që refuzuan kërkesat e tij. «Këta njerëz, që kanë refuzuar t'u ofrojnë sakrifica zotave dhe nuk u binden urdhrave të perandorit, do të fshikullohen dhe do t'u pritët koka sipas ligjit.»

Kur Justini u tha ekzekutuesve të tij: «Ju mund të na vrisni, por në të vërtetë s'mund të na bëni ndonjë të keqe», a ishin fjalët e një të çmenduri? A ishte aqi hutuar sa të vinte në diskutim sigurinë e vdekjes së tij? Jo, ai ishte i sigurt vetëm për një gjë: dhuratën e jetës së përjetshme të Jezu Krishtit. Ndërsa shqyrtonte fundin e ekzistencës së tij tokësore, Justini pothuajse mund të shihte bukurinë e shtëpisë së tij qiellore. A je më i frikësuar për humbjen e jetës në tokë se sa jesh i sigurt për jetën e përjetshme në qiell? Vdekja nuk është kohë për dyshime. Zgjidhe çështjen ndërsa je ende shëndoshë e mirë. Merre dhuratën e jetës së përjetshme të Perëndisë nëpërmjet një marrëdhënieje shpëtuese me Jezu Krishtin.

Mos i druani ata që vrasin trupin e nuk mund ta vrasin shpirtin. Kini frikë më tepër nga ai, që mund të ta humbë në ferr shpirtin edhe trupin.

Mateu 10:28

Xhon Foks, një mësues i ri në Kolegjin Magdalen përgjerohej në lutje: «Ata e quajnë veten priftërinjtë e tu, por adhurojnë veten dhe fuqinë e tyre politike. Ndhimoi të kuptojnë se nuk ka nevojë për një ndërmjetës tjetër midis Perëndisë dhe njeriut, përveç Krishtit Jezu dhe Fjalës së tij.»

Dikush e dëgjoji Xhonin dhe e raportoi në administratën e kolegjit. Ata e akuzuan se kishte besime në kundërshtim me qeverinë dhe kundër kishës së shtetit. Kur ai refuzoi të mohonte bindjet e tij, këshilli e përjashtoi nga universiteti.

Për shkak të kësaj, Xhoni e kishte shumë të vështirë të gjente punë si mësues.

Një ditë, i rraskapitur dhe i uritur, u ul për t'u lutur në një kishë. Një njeri që Xhoni nuk e kishte takuar kurrë u shfaq papritur dhe i dha një shumë parash në duar. «Gëzohu – i tha ai. – Brenda pak ditëve do të të jepet një punë e re.» Disa ditë më vonë atë e morën si tutor.

Nën mbretërimin e Henrit VIII, të krisherit si Xhoni toleroheshin.

Kur mbretëresha katolike, Meri, erdhi në pushtet, ajo ekzekutoi çdokënd që sfidonte urdhëresat fetare të shtetit. Treqind njerëz vdiqën gjatë pesë viteve të mbretërimit të saj. Xhoni dhe gruaja e tij shtatzënë u arratisën nga Anglia për në Belgjikë dhe zor se shpëtonin, nëse kapeshin.

Në mbrojtje të atyre që vdiqën për besimin e tyre, Xhoni shkroi «*Libri i Martirëve nga Foksi*».

Është tjetër gjë të lexosh për persekutimin dhe krejtësisht një gjë tjetër ta përjetosh atë. Në të njëjtën mënyrë shumë njerëz lexojnë për jetën e të krishterëve të përkushtuar dhe e admirojnë kurajën e tyre prej së largu. Por, ata nuk kanë ndonjë eksperiencë personale besimi që të mund ta quajnë të tillë. Ndërsa mburren me kurajën e martirëve, s'mund të lidhen me burimin e tij: një marrëdhënie personale me Jezu Krishtin. Ata mund ta lexojnë mesazhin e ungjillit, por nuk përgjigjen me besim. Martirët jetuan dhe vdiqën duke thirrur të tjerë te Krishti, madje edhe shtypësit e tyre. A mund të jenë duke të thirrur edhe ty për një përkushtim të krishterë, ndoshta edhe tani që po lexon historitë e tyre? Mos lavdëro thjesht besimin e tyre kur je i ftuar ta përjetosh personalisht atë!

Sepse edhe ne e kemi marrë lajmin e mirë, sikurse edhe ata, por atyre nuk u vleu gjë fjala që dëgjuan, sepse nuk u bashkuan në besim me ata që e pranuan fjalën.

Hebrenjve 4:2

**Burgu nuk është pengesë për një jetë të
dobishme të krishterë**

PASTOR RIÇARD VURMBRAND



Në një mëngjes të ftohtë anglez në vitin 1428, disa njerëz shkelën paturpësisht përmes varrezave. Një prej tyre, i veshur mirë me rroba fetare, tha: «Ja ku është. Gërmoni. Le të mbarojmë punë me të».

Kur lopatat goditën më në fund diçka të fortë, burri me rroba të mira qëndronte pranë duke parë pa u ngutur dhe tha:

«Hapeni».

«Por, zotëri, ai ka pesëdhjetë vjet këtu!» – iu përgjigj njëri prej gërmuesve. «S'ka mbetur shumë!»

Udhëheqësi fetar u rrënoqeth dhe pastaj shfryu me nervozizëm. «Atëherë nxirreni siç është, do ta djegim të tërin».

Çfarë mund ta ketë zemëruar kaq shumë këtë njeri? Pse të nxjerrësh trupin e një njeriu pesëdhjetë vjet pas vdekjes e ta djegësh me ceremoni si një heretik? Rreth vitit 1376, Xhon Uiklifi kishte botuar doktrinën e «pushtetit ndërsa themelohet në hir». Mesazhi jashtëzakonisht i diskutueshëm deklaronte: «Vetëm ungjilli është i mjaftueshëm për të sunduar jetët e të krishterëve kudo».

Uiklifi kishte filluar gjithashtu të përkthente Biblën (Vulgatën) latine në anglisht dhe ta shpërndante atë fshehurazi me fletushka dhe libra. Ai e vazhdoi këtë punë deri ditën që vdiq, në vitin 1384, njëqind e tridhjetë e tre vjet para Reformacionit.

«Hidheni hirin në lumë! – urdhëroi burri ndërsa zjarri u shua. – Kjo duhet të jetë hera e fundit që dëgjojmë për Xhon Uikliffin dhe

mësimet e tij». Do të kalonin njëqind vite të tjera para se të bëhej e ligjshme leximi i Biblës në anglisht.

Zyrtarët fetarë u përpoqën deri në fund për të larguar njëherë e mirë gjënë e «fundit» të Xhon Uikliffit, por në vend të kësaj, duket se çdo grimcë hiri nga trupi i djegur i Xhon Uikliffit përcolli një etje të re për Fjalën e Perëndisë në mbarë Evropën. Përpjekjet e tyre, jo vetëm që nuk e arritën qëllimin, por ndihmuan në kauzën e Krishtit. Në të njëjtën mënyrë ne mund të shohim armikun tonë, Satanin, të bëjë të pamundurën për të hequr qafe krishterimin. Gjithsesi, përpjekjet e tij përfundojnë në dështim. Zoti e lejon persekutimin për të frymëzuar besimtarët dhe t'i çojë ata drejt një përkushtimi më të madh. A po e lejon persekutimin personal të zbatohet sipas planit të Zotit? Shumë shpejt mund të shohësh se kundërshtimi i persekutuesit tënd të bën më të fortë dhe mallkimet e tij sjellin bekimet e Zotit.

Madje, jo vetëm kaq! Ne mburremi edhe për vuajtjet, sepse e dimë mirë se vuajtja sjell qëndresën, qëndresa na bën besnikë të sprovuar e besnikëria e sprovuar sjell shpresën.

Romakëve 5:3-4

FKSTREM

Martirizim ekstrem – pjesa e parë

ROME: KARPUS

«Emri im i parë dhe i zgjedhur është Kristian. Në botë më quajnë Karp».

«Ju e njihni dekretin e perandorit – deklaroi prokonsulli. – Ju duhet të adhuroni perënditë e gjithëfuqishme të Romës. Kështu që ju këshilloj të dilni para dhe t'u kushtoni fli atyre.»

«Unë jam i krishterë. Nderoj Krishtin, Birin e Perëndisë, i cili erdhi shumë kohë më parë për të na shpëtuar dhe duke na çliruar nga të gjitha çmenduritë e djallit. Unë nuk do t'u kushtoj fli idhujve të tillë. Zakonisht ata përfaqësojnë fantazma, në të vërtetë djaj. Është e pamundur për mua t'u kushtoj atyre fli.»

«Ti duhet të ofrosh sakrificë; këtë e ka urdhëruar Cezari.»

«Të gjallët nuk u kushtojnë fli të vdekurve.»

«A besoni se perënditë janë të vdekur?»

«Ata s'ishin njerëz dhe as që jetuan që të mund të vdisnin. Ata që i adhurojnë, janë të mashtruar keqas.»

«Të kam lënë të flasësh gjepura dhe tani të kam lejuar të blasfemosh perënditë dhe madhërinë e tij, perandorin. Duhet t'i japësh fund tani, ose do të jetë shumë vonë. Do të kushtosh fli, përndryshe do të vdesësh!»

«Unë s'mund të kushtoj fli. Nuk u kam kushtuar kurrë fli idhujve dhe nuk do ta bëj as tani.»

Prokonsulli urdhëroi që të varej dhe ia rropën lëkurën me mjete torture ndërsa ai thërriste: «Jam i krishterë! Jam i krishterë! Jam i krishterë!»

Si prokonsulli në këtë histori, mesazhi i kryqit duket budallallëk për ata që nuk e kuptojnë, ndaj ndiejnë se duhet ta kundërshtojnë. Ndoshta kanë frikë se s'mund të kuptojnë. Ndoshta krenaria e tyre i mban larg pranimit me përlësi të ungjillit të Krishtit me anë të besimit. Për çfarëdo arsye, ata më mirë humbasin, se sa të besojnë në mesazhin e kryqit. Ne duhet të kuptojmë që ata që diskutojnë kundër krishterimit, shpesh veprojnë kështu se nuk janë në gjendje të pranojnë të vërtetën me besim. A po lutesh kundër atyre që janë kundër ungjillit? Ndërsa lutesh për ata që persekutojnë të tjerët, kërkoji Frymës së Shenjtë t'i ndihmojë të kuptojnë mesazhin e kryqit.

Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbasin, por për ne që shpëtohem është fuqia e Perëndisë.

1 Korintasve 1:18

FKSTREM

Martirizim ekstrem – pjesa e dytë

ROME: PAPILI

Prokonsulli e ktheu vëmendjen ndaj Papilit, jo shumë larg nga vendi ku Karpi u var i gjakosur. «A keni fëmijë?» – pyeti prokonsulli.

«Oh, po, me anë të Zotit kam shumë fëmijë.»

Një prej turmës rrethuese thirri: «Ai do të thotë se ka fëmijë me anë të besimit të tij të krishterë».

Duke dëgjuar këtë, prokonsulli u zemërua edhe më tepër. «Pse po më gënjen duke thënë se ke fëmijë?» – thirri ai.

«Po ju them të vërtetën. Në çdo lagje e qytet kam fëmijë në Zotin.»

Zemërimi i prokonsullit nuk u shua. «A do të kushtoni fli apo do të pësoni të njëjtin fat si Karpi! Çfarë do të thuash tani?»

Papili u përgjigj me vendosmëri, «Qysh i ri i kam shërbyer Zotit. Nuk u kam kushtuar kurrë fli idhujve. Jam i krishterë. Nuk ka asgjë më të madhe apo më të mrekullueshme se sa të jesh i krishterë.»

Prokonsulli urdhëroi të varej përkrah Karpit dhe ia rropën edhe atij lëkurën me mjete torture hekuri. Papili nuk nxori asnjë zë, por si një luftëtar i guximshëm e duroi trajtimin.

Kur prokonsulli pa qëndrueshmërinë e tyre të jashtëzakonshme, urdhëroi që Karpi dhe Papili të digjeshin të gjallë. Ata të dy u zbritën në amfiteatër, të kënaqur që së shpejti do të çliroheshin prej kësaj bote.

Papilin e gozhduan në shtyllën e turrës së druve. Kur flakët u ngjitën lart ai u lut qetësisht dhe dorëzoi shpirtin e tij.

Të krishterët shpesh shqetësohen se çfarë do të thonë kur të thirren për të mbrojtur besimin e tyre. Kur vjen mundësia, ne nxisim veten duke përsëritur në mendje pyetjet si në një provim të semestrit. «Po sikur të më pyesin të mbroj Trininë?» «Çfarë të them, nëse më pyesin për fatin e atyre që s'e kanë dëgjuar kurrë ungjillin?» «Dhe si ta mbroj unë lindjen nga një e virgjër?» Në të vërtetë, ne s'mund të gjejmë fjalë më të mira, më të vërteta se sa dëshmia jonë e besimit në Krishtin. «S'ka asgjë që mund të them, e cila është më e madhe dhe më e mrekullueshme se sa dëshmia që jam i krishterë!» E gjithë përsëritja nuk do të mund ta bindë një jobesimtar, më tepër se sa gatishmëria jote për të ndarë sinqerisht dashurinë tënde për Jezusin.

Edhe vetë, o vëllezër, kur erdha në mesin tënd, nuk erdha për t'ju kumtuar misterin e Perëndisë me fjalë të larta e me urti të stërholluar.

1 Korintasve 2:1

FKSTREM

Martirizim ekstrem – pjesa 3

ROME: AGATONIKA

Karpi u gozhdua në shtyllën e turrës së druve dhe ndërsa flakët e përfshinë, ai u lut me gëzim «Lavdi të qoftë ty, o Zot, Jezu Krisht, Biri i Perëndisë, që më quajte mua mëkatarin, të denjë për të vdekur si martir, ashtu si edhe ti!» Pastaj ai e dorëzoi shpirtin e tij në parajsë.

Ndërsa Karpi u lut, Agatonika pa lavdinë e Zotit të shfaqej para tij. Qiejtë u hapën për të zbuluar festën e dasmës së Qengjit të Perëndisë me tavolina madhështore të hapura para saj dhe vetë Jezusi që qëndronte në krye. Zemra e saj kërceu dhe ajo njohu një thirrje prej qiellit.

U ngrit në këmbë dhe thirri: «Ky vakt është përgatitur edhe për mua. Duhet ta marr ushqimin e lavdisë».

Një thirrje u dëgjua nga turma: «Ki mëshirë për fëmijën tënd, birin tënd!»

«Ai ka Zotin që të kujdeset për të – u përgjigj Agatonika, – sepse Zoti është siguruksi për të gjithë. Ndërsa unë do të shkoj të jem me të.»

Ajo u ngjiti në amfiteatër, hodhi rrobën e saj të jashtme dhe me gëzim u gozhdua në shtyllën e turrës së druve.

Ata që qëndronin afër shpërthyen në lot dhe thërrisnin, «Ky dënim është mizor dhe i padrejtë!»

Midis flakëve, ajo thërriste: «Zot, Zot, Zot, më ndihmo sepse po vij tek Ti!» Pastaj ia dorëzoi shpirtin dhe u bashkua me Zotin e saj. Ishte viti 165 pas Krishtit.

Reagim zinxhir. Është efekti i papritur që një jetë ka mbi një tjetër – diçka e pashpjegueshme dhe e paplanifikuar. Ajo filloi me Karpin, i cili i tregoi rrugën e guximit Papilit, ndërsa të dy u torturuan për besimin e tyre. Pastaj një vëzhguese, e frymëzuar nga rezultati i pabesueshëm i martirizimit të tyre, e hodhi veten drejt besimit duke qenë gati të vdiste në turrën e druve. Sot, ne shohim reagime zinxhir besimi në rizgjimet e kishave dhe në universitete. E shohim këtë në fshatra, qytete dhe në komunitete, në disa kontinente ku një jetë nxit një tjetër dhe përsëri një tjetër, në një përkushtim më të madh. Sa kohë ka kaluar që kur ke përjetuar një reagim zinxhir përkushtimi në kishën apo komunitetin tënd? Lutu që rizgjimi të fillojë me ty – hallka më e rëndësishme në zinxhir.

Na përtërij e do ta thërrasim emrin tënd.

Psalmi 80:18

E arratisur ekstreme

KINË: LO LIEU

Lo Lieu zbriti me kujdes rrugën e populluar në Kinë, duke parë pas vetes për t'u siguruar që nuk po ndiqej apo vihej re. Ajo kaloi një poster tjetër që tregonte fytyrën e saj dhe kishte shpërblimin prej pothuajse gjashtëqind dollarësh për arrestimin e saj.

Kur Lieu ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç, u largua nga shtëpia për të qenë shërbëtorja e Zotit. Ajo themeloi një organizatë bashkësish që ndihmonte për të regjistruar kishat shtëpi të paregjistruara – të paligjshme në sytë e qeverisë komuniste. Puna e saj e vuri në kontakt me të krishterë të huaj, të cilët sillnin Bibla fshehurazi në vend.

Kishte pothuajse dhjetë vjet në shërbesë kur policia e arrestoi. Ajo duroi marrje intensive në pyetje. Një herë u rrah aq keq, sa kaloi në koma për disa orë, por refuzoi t'u jepte informacione autoriteteve për besimtarët me të cilët punonte dhe për veprimtarinë e tyre.

Muaj më vonë, ajo u lirua pasi nuk i tregoi asgjë policisë për punën e saj, por ishte akoma nën mbikëqyrje. Disa vite më vonë, ajo dhe pesë të tjerë u arrestuan dhe gjithçka që i përkiste u konfiskua.


Këtë herë ajo u dënua me tre vjet në një kamp pune.

Lieu u lirua pasi kreu dënimin e saj, por ishte akoma nën shënjestrën e policisë. Pavarësisht nga kërcënimi i arrestimit, Lieu vazhdon të jetojë si e arratisur për Krishtin, duke kryer «krimin» e dashurisë për Jezusin dhe ndarjes së kësaj dashurie me të tjerë.

Mendoni për këtë: nëse do të kishte një urdhër arrestimi për të gjithë të krishterët e përkushtuar, cili do të të dorëzonte ju tek autoritetet? A do ta nxiste shitësin ushqimor të lagjes shpirti juaj i hirshëm dhe përshëndetjet tuaja vlerësuese çdo javë kur bëni pazar për të të dorëzuar? A do të dinin të të identifikonin prindërit e tjerë në radhën e makinave si një besimtar i mundshëm, duke pritur me mirësjellje dhe durim radhën tënde? A do të debatonin të tjerët në vendin tënd të punës, nëse të të dorëzonin apo jo, ndërsa do të kishin të dhëna konkrete të besimit tënd në Krishtin? A do të luftonte familja juaj me vendimin për t'i telefonuar policisë, apo do të bindnin veten se qëndrimi dhe veprimet e tua nuk shkojnë me përshkrimin e «të krishterit të përkushtuar?» Çfarë mendon? Çfarë duhet të bësh?

*Prandaj, secili prej nesh do t' i japë llogari
Perëndisë për vetveten.*

Romakëve 14:12



Safina është një vajzë e qetë e mrekullueshme. Duke u rritur në Pakistan, ajo mësoi se si grua, goftë dhe e krishterë, mundësitë e saj në jetë do të ishin të kufizuara dhe të pakta.

Kështu që, kur gjeti punën për të gatuar dhe pastruar në një familje të pasur myslimane, ajo u mbush me gëzim që do të mund të fitonte ca para dhe të ndihmonte familjen e saj të varfër.

Në fakt, bukuria e Safinës dhe sjellja e saj e butë tërhoqi të birin e punëdhënësit. Ai u propozoi prindërve të tij për ta marrë atë si bashkëshorten e tij, por Safina ishte e krishterë. Ata i bënë presion për ta kthyer në islam, por Safina refuzoi me guxim dhe këmbëngulje. Pas javësh presioni, ajo donte të largohej, por e dinte se familja kishte nevojë të madhe për para.

Më në fund, i riu ndaloi së përpjekuri për ta bindur Safinën të bëhej gruaja e tij dhe mori një vendim të ashpër. Me ligësi e tërhoqi zvarrë në një prej dhomave të gjumit dhe e mori me forcë.

Safina u thye. Ajo la punën, por para se të hidhte akuzën, kjo familje e sulmoi dhe i tha policisë se ajo po vidhte. Safina u arrestua menjëherë dhe vuajti abuzim të mëtejshëm në burg.

Ajo nuk pendohet se mbajti një qëndrim për Krishtin, por akoma lufton me turpin e asaj që i ndodhi. Ajo po mbahet me kurajë te premtimet e Perëndisë për shërim fizik dhe emocional në mes të përpjekjeve të saj për të falur atë që kreu krimin.

Ne mësojmë shumë për një fe nga shqyrtimi i rezultateve në jetën e ndjekësve të saj. Kjo është një histori për një familje që ndoqi zotin e gabuar në një rrugë të gabuar. Feja e kësaj familjeje i çoi ata drejt manipulimit, imoralitetit seksual, gënjeshtërs dhe padrejtësisë. Në kontrast, Zoti i Safinës, Zoti i dashurisë, e çoi atë drejt të qenit e zellshme, sakrifikuase dhe këmbëngulëse. Një ditë, Zoti do ta ndihmojë Safinën t'i falë ata që e kanë lënduar. Jini të kujdesshëm kur dëgjoni të tjerët të thonë se të gjitha fetë janë kryesisht të njëjta. Ne jemi thirrur për të qenë vëzhgues të frytit – duke shqyrtuar me kujdes frytin e jetës së njerëzve për të zbuluar motivet e tyre. Mos u mashtro nga ato që lexon për ndonjë fe, shiko nga afër rezultatet në jetën e ndjekësve të tij.

Ju do t'i njihni nga frytet e tyre. A vilet vallë rrush nga ferrat, ose fiq nga murrizat? Kështu, çdo dru i mirë jep fryte të mira; por druri i keq prodhon fryte të këqija.

Mateu 7:16-17

**Sa më fort që godet djalli, aq më shumë
do të gëzohemi me mposhtjen e tij.
Le të vijë!**

NJË I KRISHTERË NË SUDAN



«Shtëpi shpëtimi» ekstreme

BANGLADESH: ANDREU

Shërbesa e Andreut në Bangladesh rezultoi me 749 myslimanë të kthyer në besim dhe të pagëzuar. Përveç kësaj, shërbesa u përfshi në shpërndarjen e më tepër se 3 000 Biblave dhe Dhiatave të Reja dhe mbi 137 000 trakte ungjilli.

Por Andreu i dinte rreziqet e shumë prej myslimanëve të kthyer, ndaj themeloi një vend të shenjtë që shërben si shtëpi shpëtimi. Familje të krishtera apo individë nga i gjithë vendi vijnë në vendin e shenjtë, por jo për pushim apo për siguri. Aty, të krishterët e rinj mësohen në dishepullizim dhe ungjillizim nga mëngjesi deri në mbrëmje.

Pasi përfundojnë programin, ata dërgohen në një fshat tjetër ku nuk njiheshin më parë. Kjo bëhet fusha e tyre e re e misionit! Këta të krishterë vijnë në kompleks për t'i shpëtuar rrezikut, vetëm për t'u formuar për një situatë, madje edhe më të vështirë. Dhe ata e dinë që nuk janë vetëm; qindra prej vëllezërve dhe motrave të tyre kanë shkuar para tyre për ta çuar Jezusin në të gjithë Bangladeshin.

Puna e Andreut nuk është pa rrezik. Ai është arrestuar dhe mbajtur vazhdimisht nga policia dhe është rrahur nga myslimanët radikalë që ia kanë frikën ungjillizimeve të tij. Familja dhe shtëpia e tij janë kërcënuar vazhdimisht. Shërbesa e Andreut është të sigurojë shtëpi shpëtimi për myslimanët e kthyer, por zor se është shërbesa e tij e sigurt. Ajo është një rrezik i përditshëm për familjen e tij dhe për ata të përfshirë në shërbesën e tij; megjithatë studentët e tij marrin jetën e përrjetshme dhe diplomohen për t'u dhënë të tjerëve të njëjtën mundësi.

Imagjinoni një fermer që përpiqet të korrë vetëm. Nuk ka rëndësi sa shumë do të punonte fermieri, ai s'do të kishte mjaft kohë gjatë stinës për të përfunduar detyrën. Jezusi i krahasoi njerëzit e humbur me fushën me shpirtra gati për t'u korrur dhe kërkon tej mase punë për një person të vetëm. Kështu që ne thirrmi të përdorim një strategji të ngjashme me strategjinë e Andreas në shtëpitë e shpëtimit në Bangladesh. Ne duhet t'u tregojmë se si t'u flasim të tjerëve për Krishtin. Nuk është mjaft të fitosh të kthyer në krishterim. Ne duhet të fitojmë dishepuj, të cilët në kthim mësojnë të jenë dishepuj veprues. A je fermer që përpiqet vetëm, apo je duke u treguar të tjerëve se si të punosh fushën?

Atëherë ai u tha dishepujve të vet: «E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak. Lutjuni, pra, Zotit të të korrave, të dërgojë punëtorë në të korrat e tij».

Mateu 9:37-38

FKSTREM

Këmbëngulje ekstreme

AZERBAJXHAN: PASTOR ROMAN ABRAMOV

Pastor Roman Abramov dhe gruaja e tij punuan pa pushim për tre vjet për të mbjellë një kishë në Ismaili, Azerbajxhan. Por brenda vitit që u transferuan në fshat, zyrtarët i arrestuan në përpjekje për t'i larguar prej qytetit.

Në pjesën më të madhe të kohës në kishë vijnë deri në dhjetë anëtarë, megjithatë, ata vazhdojnë ta ndajnë ungjillin e Jezu Krishtit. Për shkak të presionit nga zyrtarët lokalë për qiradhënësit e mundshëm, Abramovët kishin vështirësi për të marrë një shtëpi me qira, kështu që mund të ndërtonin një të tillë në të cilën të mund të jetonin të dy dhe të zhvillonin takimet sipas ligjit.

Kur Abramovët filluan të kishin takime kishë në shtëpinë e tyre të re, pjesëmarrja e rregullt po rritej dalëngadalë. Dhjetorin e kaluar, mulletër (drejtues ietareë myslimanë) erdhën në shtëpinë e tyre dhe u thanë se nuk kishin të drejtë të kishin shërbesa të krishtera.

Pastor Abramovi mbrojti kishën e tij dhe i ftoi edhe ata në shërbesë. Njëri e pranoi ftesën dhe që atëherë është kthyer në besim. Një mulla tjetër akuzoi të krishterët se kishin shkelur me këmbë një kopje të Kuranit dhe i dërguan një peticion qeverisë rajonale për të mbyllur kishën. Autoritetet lokale filluan të vizitonin shtëpitë e anëtarëve të kishës, duke i sulmuar pa reshtur, duke i marrë në pyetje dhe duke i dënuar disa me dhjetë ditë në burg.

Pavarësisht dënimit dhe frikës së shumë famulltarëve, pastor Romani beson se rizgjimi do të vijë. Shtëpia e tij mbetet hapur për të gjithë ata që do të vinin të ndiqnin takimet e tyre.

Ka disa gjëra që do të donim të mos i kishim. Sprovat janë një prej tyre. Pse jeta duket shpesh si shesh problemesh? Megjithatë, Bibla na mëson se jeta nuk mendohet të jetë pa probleme. Si fëmijë, shpesh do të dorëzoheshim para detyrave të vështira Do të hiqim dorë para vështirësive. Megjithatë, ndërsa u rritëm, mësuam të këmbëngulim – të qëndrojmë atje dhe të kuptojmë. Në të njëjtën mënyrë, ndërsa rritemi në besimin tonë, mësojmë vlerën e këmbënguljes. A je akoma i papjekur, duke u dekurajuar lehtë dhe duke u tunduar për t'u dorëzuar? Thuaji Zotit që je gati «të rritesh».

Por qëndresa le të ushtrohet me përpikmëri, që të jeni të përkryer dhe të përsosur pa farë të mete.

Jakobi 1:4

FKSTREM

Rruajtje ekstreme

SHTETET E BASHKUARA: PARK GILLESPI

Njerëzit shpesh janë gati të japin shumë për të ndihmuar motrat dhe vëllezërit e persekutuar në mbarë botën. Mësuesi i shkencave dhe i studimeve sociale i klasës së shtatë, Park Gillespi, mund të jetë i pari që do të japë flokët e tij!

Pasi punëtorët e krishterë folën në klasën e tij për Sudanin, nxënësit e Parkut morën një vizion për të ndihmuar refugjatët që po persekutoheshin për besimin e tyre. Dhembshuria e zjarrtë e nxënësve habiti madje, edhe mësuesit e tyre.

Çfarë nisi si nxitje për nxënësit e klasës së shtatë për të mbledhur batanije për sudanezët që po vuanin, shumë shpejt u shpërnda në të gjithë shkollën dhe më gjerë, edhe në komunitet. Gillespi kontaktoi WB TV në Sharlot, në Karolinën e Veriut dhe u tregoi atyre se çfarë po bënin fëmijët për të lehtësuar vuajtjet në Sudan.

Batanijet kishin filluar tashmë të mbushnin klasat, por çështja e kostos së transportit me anije nuk ishte adresuar ende. Kur reporteri nga WB TV erdhi për historinë, Gillespi përmendi se do të rruante flokët, nëse ata do të ndihmonin për faturën. Shumë shpejt pas transmetimit të historisë, u dukën fondet e para.

Nga dashuria për njerëzit, të cilët s'i kishte takuar ndonjëherë, Gillespi rruajti kokën. I gjithë trupi shkollor u mblodh me këtë rast dhe reporteri nga WB TV filmoi ngjarjen. Amerikanët ndihen shpesh sikur mund të bëjnë shumë pak për të ndihmuar të krishterët e persekutuar në vendet e tjera, Park Gillespi provoi të kundërtën.

Park Gillespi dhe nxënësit e tij na mësojnë procesin se si dhembshuria të çon në krijueshmëri, në përkushtim dhe përfundimisht drejt çmimit. Park dhe nxënësit e tij ishin të kënaqur që do të paguanin çmimin – madje edhe deri në fijen e fundit të flokëve të kokës! Dhembshuria është një reagim i natyrshëm ndaj vuajtjes, por nuk është i mjaftueshëm. Ne duhet të aktivizojmë zjarrin tonë me zgjidhje krijuese ndaj problemeve. Pastaj duhet të përkushtohemi t'i vëmë në lëvizje zgjidhjet tona dhe të jemi gati të paguajmë çmimin. Ku je ti në këtë proces? A e ke vendosur në punë dhembshurinë tënde me disa mendime krijuese? A ke bërë një përkushtim për të ndihmuar për të sjellë ndryshim? A je gati ta paguash çmimin?

Duke parë turmat, kishte dhembshuri për ta...

Mateu 9:36

FKSTREM

Dënim edhe më ekstrem

PAKISTAN: AJUB MASIH

«Kjo qeli s'mund të më ndalojë të dua Zotin tim, Jezu Krisht» – shkroi Ajub Masih. Ai tani ka kaluar më tepër se pesë vjet në burg për shkak të akuzave të rreme.

Të krishterët në Pakistan akuzohen shpesh padrejtësisht për blasfemi kundër Muhamedit, themeluesit të islamit. Sipas rregullave myslimane, blasfemia është krim që çon në dënim me vdekje. Ajubi ishte duke folur rastësisht me një shok mysliman me të cilin kishte diskutuar dhe kishte bërë shaka për çështje polemike; biseda u kthye drejt librit *Vargje Satanike* – një libër polemik kundër islamit. Ata u dëgjuan dhe nën presionin e të tjerëve, «shoku» i Ajubit nxori një ankesë kundër tij.

Ajubi u arrestua dhe u dënua me vdekje, sepse blasfemoi Muhamedin. Pak më vonë, fshati i tij u bastis dhe të dymbëdhjetë familjet e krishtera u dëbuan prej shtëpive të tyre. Ajubi u deklarua i pafajshëm ndaj akuzave dhe apeloi për gjykimin e gjykatës. Ai ka pritur me lutje për pesë vjet në burg për një përgjigje nga gjykata.

Aktualisht është në burgun qendror Sahiual në Multon në Pakistan dhe e di se me lirim, jeta e tij do të ishte në rrezik dhe se do të rrezikonte të tjerët në familjen apo komunitetin e tij. Në fillim të vitit 1998 u bë një përpjekje për jetën e tij dhe një herë, një mulla islamik ofroi një shpërblim prej dhjetë mijë dollarësh për këdo që do ta vriste Ajubin.

Sot në vendet myslimane, të flasësh për tema fetare të konsideruara si kundërshtuese ndaj islamit, mund të thotë vdekje. Në mëyrë ironike, adhuruesit myslimanë përballen edhe vetë me dënimin me vdekje. Bibla na mëson se dënimi për mëkatin është vdekja shpirtërore. Larg Krishtit, të gjithë përballen me vdekjen e përjetshme. Megjithatë, Krishti ka paguar dënimin me vdekje për të gjithë ata që besojnë, madje edhe për myslimanët. Jezu Krishti mori vendin tonë në dorë të ekzekutuesit duke u kryqëzuar në kryq. Vdekja e tij na bën të mundur të kemi jetë të përjetshme me Zotin në parajsë. Falëndero Zotin sot që dënimi yt është ndryshuar dhe ti je falur. Dhe lutu për ata në vendet myslimane, të cilët mund t'i vrasin të krishterët në tokë, por pa Krishtin, përballen me vetë vdekjen e tyre të përjetshme.

Pra, paga e mëkatit është vdekja, ndërsa jeta e përjetshme është dhuratë e Perëndisë, në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Romakëve 6:23

«Këndo këtë këngë «një kredo myslimane» ose do të vdesësh» – thirri një ushtar sudanoverior. I krishteri i burgosur mund të shihte urrejtjen në sytë e tij dhe pyeti veten se sa jetë do të kishte marrë. Ushtari vendosi një thikë të madhe në fytin e të krishterit.

Logjika i thoshte «Këndo, Zoti e di që je i detyruar. Pse të heqësh dorë nga jeta jote se nuk thua disa fjalë në të cilat gjithsesi nuk beson?»

Nga ana tjetër, ai e dinte që Bibla mëson se fjalët e një personi kanë fuqi. Ai solli ndërmend që rrëfimi i dikujt për Krishtin është i fuqishëm. «A do të ishte i fuqishëm edhe një rrëfim blasfemues? – mendoi ai me vete. – Edhe nëse nuk e kishte me tërë mend?» Pyetja dukej si një betejë kundërshtuese në mendjen e tij. Logjika luftonte kundër dashurisë së tij për Krishtin.

Të krishterët në Sudan përballen shpesh me zgjedhje të tilla dhe kanë parë shumë prej miqve dhe anëtarëve të familjes të vrarë për besimin e tyre në Krishtin. Martirët vendosën të mos këndonin kredon myslimane, duke mos dashur t'i ndotnin shpirtrat e tyre me këngë blasfemie dhe të rrezikonin t'i thyenin zemrën Zotit.

Mbrojtja e tyre kundër argumenteve logjikë është se Krishti që jeton brenda tyre nuk mund të këndonte një këngë të tillë: Kështu që atyre u duhej të përballëshin me pasojat. I njëjti Jezus që jetonte në ta, që nuk do të këndonte, nuk do të kishte frikë as nga një kërcënim me vdekje. Këta besimtarë e konsideronin veten tashmë të vdekur në Krishtin – Krishti në ta, në të vërtetë nuk do të lëndohej.

Çdo ditë gjendemi në diskutimin midis logjikës dhe besimit. Logjika na thotë të vazhdojmë. Besimi na thotë të shkojmë kundër atij pak popullariteti. Kur dëgjojmë logjikën, ne mund të vendosim mënjatë bindjet tona personale me qëllim që t'i bindemi një personi tjetër. Sa shpesh këndojmë këngën e dikujt tjetër për të shmangur konfrontimin? Mund të jetë një punë që kërkon praktika mashtruese. Logjika na thotë ta mbajmë gojën mbyllur për të ruajtur punën. Nëse e ndien se e ke dëgjuar shumë gjatë zërin e arsyes, kërkoji Zotit të të ndihmojë të qëndrosh të akorduar me të. Kërkoji atij besimin për të cilin ke nevojë për të thënë me zgjuarsia gjënë e duhur në një moment të gabuar logjik.

U kryqëzova bashkë me Krishtin; dhe tani nuk jetoj më unë, por Krishti jeton në mua.

Galatasve 2:20

ME tepër kontrabandistë ekstremë

UKRAINË: TË KRISHTERË TË FSHEHTË

Roja e kufirit rus po bënte patrullimin e radhës. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, kufijtë patrulloheshin me zell për ndonjë aktivitet të dyshimtë. Dy kërcënime ishin kryesore: qytetarët sovjetikë që përpiqeshin të arratiseshin dhe kontrabandistë që përpiqeshin të sillnin artikuj ilegalë, si për shembull Biblia.

Ky rojë, në veçanti u caktua në kufi midis Republikës Socialiste Sovjetike Ukrainase dhe Rumanisë. Ai ecte qetësisht në të ftohtin paqësor duke lëvizur elektrikun e dorës nga një anë në tjetrën në borën e saporënë.

Papritur ëndërrimi iu prish ndërsa drita ndeshi me disa shenja në borë. Gjurmë! Drejttoheshin nga Rumania! Ai vuri bilbilin në buzë dhe dha një alarm të gjatë të vazhdueshëm gërvishtës.

Shumë shpejt roja të tjerë e rrethuan. «Këtej! Këtej! – u hodh e thirri ai duke treguar katër palë gjurmë. – S'mund të jenë larg! Ndoshta mund t'i kapim para se të arrijnë Rumaninë!» Grupi u nis sa më shpejt që mundej nëpër natë.

Me të dëgjuar zhurmën, katër të krishterët rumunë ngrinë në errësirë. Ata dëgjonin me vëmendje ndërsa rojat thërrisnin dhe të thirrurat u larguan ngadalë gjithnjë e më larg. Ata u kthyen dhe i buzëqeshën njëri-tjetrit. Me miratimin e drejtuesit të tyre, vazhduan udhëtimin duke ecur me kujdes së prapthi për në Ukrainë, me ngarkesën e tyre të çmuar të Biblave për vëllezërit dhe motrat në kishën e fshehtë.

Në Bibël thuhet se kundërshtari ynë shpirtëror përdor përpjekje të zgjuara për të shkatërruar krishterimin. Në kontrast, ne që mbajmë ungjillin e paqes dukemi si karrem i pafajshëm i ujkut. Jezusi na udhëzoi të njohim rreziqet e të qenit dele në mes të ujqërve dhe të planifikojmë si duhet. Duhet të përgatisim strategji të sakta dhe taktika të zgjuara për t'ia prishur planet kundërshtarit. Satani ka fuqi, por Zoti është i gjithëfuqishëm. Ai do të të ndihmojë për të pasur fitore mbi armiqtë e tu. Puna jote është të kërkosh urtësi dhe kurajë për të përmbushur planet fitimtare të Zotit. A po ndeshesh me një problem të veçantë? A je lutur dhe i ke kërkuar Zotit urtësi ndërsa planifikon lëvizjen tjetër? Besoji atij për të ditur si t'ia prishni planet armikut tënd – ai ka vite që e bën këtë.

Ja, unë po ju dërgoj porsidele midis ujqërve! Prandaj, jini dinakë si gjarpërinjtë dhe të bardhë si pëllumbat.

Mateu 10:16

**Meqenëse Krishti nuk është më në tokë,
ai do që trupi i tij, Kisha, të zbulojë vuajtjet
e tij në vuajtjet e saj. Meqenëse jemi
trupi i tij, vuajtjet tona janë vuajtjet e tij.**

XHON PAIPER – TË DËSHIROSH ZOTIN





Ndërsa Lihn Dao dhe e ëma iu afruan burgut, ajo e dinte se çfarë do të bënte, por duhet ta bënte të dukej e vrullshme, si veprimi i një vajze të pushtuar nga emocionet.

I ati i Lihnit është një pastor i fshehtë në Vietnam. Një vit më parë, kur ajo ishte dhjetë vjeç, katër policë shpërthyen me forcë shtëpinë e saj dhe e bastisën duke kërkuar Bibla, të cilat ajo i kishte fshehur në çantën e shkollës. I ati u arrestua dhe u dënua me riedukim me anë të punës së rëndë.

Ndërsa arritën në gardhin me lidhje zinxhir që i ndante nga i ati, Lihni pa mundësinë e saj. Ajo u fut me të shpejtë përmes një boshllëku në gardh dhe u drejtua për nga i ati dhe e përqafoi fort. Rojat e panë të habitur, por e lanë të qetë. Për më tepër, çfarë mund të bënte një vajzë e vogël?

Familja e Lihnit ishte në gjendje t'i dërgonte babait të tyre një stilolaps të vogël me të cilin ai shkruante shkrime dhe predikime në fletë cigareje. Këto «predikime cigaresh» kalonin nga qelia në qeli dhe sollën shumë të burgosur te Krishti.

Lihn Dao është tani një adoleshente e vrullshme, e cila nuk shqetësohet për rrezikun para bërjes së asaj që është e drejtë. Dëshira e saj është të ecë në gjurmët e të atit dhe të jetë një predikuese e ungjillit. Ajo i njeh nga afër rreziqet e ndarjes së besimit

të saj në Vietnamin komunist dhe mbetet «impulsive» për t'u bindur Krishtit më tepër se sa njerëzve.

Një nga arsytet që besimtarët nuk janë më aq impulsivë në dëshminë e tyre për Krishtin është se dëgjojnë shumë zëra në vend që të dëgjojnë vetëm një. Nuk mund të ketë bindje impulsive nga një vëmendje e ndarë. Ne dëgjojmë zërin e Zotit në zemrat tona që na thotë menjëherë se çfarë duhet të bëjmë në një situatë të veçantë. «Thuaje tani, ndaje besimin tënd». Por njëkohësisht dëgjojmë zërin tonë që na paraqet të gjitha llojet e justifikimeve. «Jo tani. Më vonë. Çfarë po bëni?» Zoti na ofron një zemër të pandarë që dëgjon vetëm zërin e saj. Kur rritemi në besim, mësojmë se bindja vjen më natyrshëm – në mënyrë impulsive, ashtu si refleksi. Cilin zë do të dëgjosh sot?

Ma mëso, o Zot, udhën tënde, që të eci sipas drejtësisë sate, mësoje zemrën time ta nderojë emrin tënd.

Psalmi 86:11

Fuqi ekstreme

BANGLADESH: ABDULLAI

Që kur Abdullahi pranoi Krishtin, familja e tij është përpjekur shumë që t'i ndryshojë mendim. Për më tepër, ati i tij ishte njeri i respektuar në fshatin e tyre dhe në të gjithë Bangladeshin, duke ngritur një xhami pikërisht përkrah pronës së tyre.

Kur bisedat nuk e bindën Abdullain për t'u kthyer tek islami, ata përdorën rrahjet. Kur rrahjet ishin të kota, ata thirrën të tjerë për ta rrahur më fort. Asgjë s'ia doli; Abdullahi u mbajt fort te besimi i tij në Krishtin. Më në fund, e dëshpëruar, e ëma e ndaloi së ushqyeri duke i vendosur vetëm hi në pjatë. Abdullahi u lut për fuqinë e Zotit dhe qëndroi i fortë.

Si mundësi të fundit, familja thirri mullain që të vinte dhe të mbante një ceremoni për të larguar prej djalit «djallin», që kishte marrë kontroll të jetës së tij. Mullai erdhi në shtëpinë e tyre dhe recitoi mbi djalin lutjet myslimane. Ai këndonte. Zgjaste duart mbi djalin, kërcente e thërriste. Shpirti brenda Abdullait qëndroi i fortë. Pas pesë orësh, mullai u dorëzua i rraskapitur.

«Shpirti i Abdullait është më i fortë se shpirti im», – i tha ai atit të djalit dhe u largua. Abdullahi s'mund të kthehej dhe s'mund të ndalej së ndari atë Shpirt të fuqishëm me të tjerët. Në pak muaj, ai kishte drejtuar njëzet e shtatë myslimanë drejt besimit në Krishtin, duke i ngjallur të gjithë me Shpirtin e Krishtit!

Në një përpjekje për t'u marrë me një krizë të mundshme energjie, inxhinierët modernë po përpiqen të projektojnë makina që funksionojnë plotësisht me fuqinë e baterisë. Pengesa është se makinat duhet të kenë hyrje në një burim energjie për të rikarikuar bateritë e tyre. Në këtë mënyrë, koncepti është akoma aq i ri, sa stacionet me karikues ndihmës energjie janë të pakta. Pa një burim energjie, makina është e padobishme. Në të njëjtën mënyrë, të krishterët që përpiqen të jenë dëshmitarë efektivë larg nga fuqia e Frymës së Shenjtë janë po aq të padobishëm. Bashkë me mësimin e fjalës së Zotit, ne duhet të mbështetemi te Fryma e Shenjtë për urtësi, mbrojtje dhe fuqi në dëshminë tonë. A po përpiqeni të bëni gjëra me fuqinë tënde për Jezusin në vend që të lejoni fuqinë e tij të rrjedhë përmes jush?

Por ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë të vijë mbi ju.

Veprat 1:8

FKSTREM

Dashuri ekstreme për Fjalën e Zotit

ANGLI: NJË SHËRBYESE E RE

Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, mbreti spanjoll, Filipi II, mori masa të rrepta për ata që do të përpiqeshin të interpretonin shkrimin. Kushdo që gjendej duke studiuar Biblën gjatë kësaj kohe, varej, digjej në stivën e druve, mbytej, copëtohej ose varrosej i gjallë.

Inkuizitorët u dërguan nga mbreti për të inspektuar shtëpinë e kryetarit të bashkisë së Brugit për të parë nëse zhvilloheshin studime Bible. Gjatë kërkimit ata gjetën një Bibël. Të gjithë të pranishmit mohuan të dinin ndonjë gjë për të. Një shërbëtoreshë e re hyri dhe kur e pyetën për Biblën, ajo deklaroi: «Unë po e lexoj!»

Kryetari kërkoi ta mbronte duke thënë: «Oh, jo, ajo nuk di të lexojë».

Por shërbëtoresha nuk donte të mbrohej nga një gënjeshtëri. «Është e vërtetë, ky libër është i imi. Unë po e lexoj dhe është më i shtrenjtë se çdo gjë tjetër për mua!»

Ajo u dënua me vdekje – me marrje fryme e mbyllur në murin e qytetit. Pikërisht para ekzekutimit të saj, ajo u pyet nga një zyrtar: «Kaq e re dhe e bukur dhe do të vdesësh?»

Ajo u përgjigj: «Shpëtimtari im vdiq për mua. Edhe unë do të vdes për të».

Kur më në fund mbeti një tullë e vetme për të përfunduar murin, asaj iu tha përsëri: «Pendohu! Thuaj vetëm një fjalë të vetme pendese!»

Në vend të saj ajo shprehu një dëshirë të vetme për të qenë me Jezusin dhe shtoi: «O, Zot, fali vrasësit e mi!»

Për disa, ai është thjesht një libër – libri më i shitur prej vitesh. Për të tjerë është vetëm një traditë familjare – e dhënë në martesë, datëlindje dhe funeralë. Por për të tjerë, është Fjala e Shenjtë dhe e frymëzuar e Zotit. Këta besimtarë kapen pas fjalëve si të ishin letra prej të dashurit/ës, duke u derdhur gjithnjë mbi ta. Çfarë shohin në të vërtetën e Fjalës së Zotit? Çfarë i bën të gatshëm për të rrezikuar vdekjen që ta lexojnë? Kërkoji Zotit përgjigje. Nëse e vërteta e saj mbetet mister për ju, kërkoji Zotit të të hapë sytë për ta parë fjalën e tij më qartë. Pa ndihmën e tij, fjalët do të mbeteshin thjesht shenja në një faqe, por Zoti ka për t'i bërë të gjalla.

M'i hap sytë të shikoj mrekullitë e ligjit tënd.

Psalmi 119:18

FKSTREM

Dëshmitar ekstrem

KOREJA E VERIUT: NJË NENË E PANJOHUR DHE I BIRI

«Çfarë ndodhi?» – pyeti nëna koreano-veriore ndërsa i biri hyri në derë me pamje të tronditur.

«Isha me një shokun tim sot dhe dy oficerë policie na ndaluan. Ata e rrahën atë dhe e akuzuan se ishte i krishterë. Ai nuk u përpoq të mbronte veten. Madje, edhe me armën drejt tij, fytyra i mbeti në paqe.

Më pa drejt e në sy pa thënë asnjë fjalë, por unë e dija çfarë ishte duke thënë. Ai donte që të besoja të njëjtën gjë si ai dhe pastaj tha vetëm «Zoti i bekoftë». U ekzekutua pikërisht para meje, sepse ishte i krishterë. Unë as nuk e di se çfarë është një i krishterë, s'marr vesh asgjë nga këto.»

Pasi i tregoi historinë e tij, e ëma ia vendosi kokën në duar dhe thjesht tha: «Të kuptoj». Atëherë filloi të ndante me të të vërtetën për Krishtin, Shpëtimtarin e saj. I mësoi të birin për lindjen e mrekullueshme të Jezusit dhe mundësinë për shpëtimin, sesi erdhi falë vdekjes së tij në kryq. Megjithëse i vinte shumë keq që asnjëherë s'kishte guxuar t'i tregonte djalit të saj sepse ishte e shqetësuar për sigurinë e tij, ishte falënderuese që Zoti po u jepte një mundësi të dytë.

«Ndërsa ata plumba goditën zemrën e shokut tënd, Zoti mbolli njëfarë shprese në zemrën tënde.»

Sot ky i ri është veprues në kalimin e Biblave në Korenë e Veriut dhe në mbjelljen e kishave-shtëpi.

E ëma e djalit i dha atij jetë fizike kur lindi në familjen e saj, por e kaloi mundësinë për ta ndihmuar të merrte jetë të përjetshme me anë të lindjes. Jeta fizike venitet, por dhurata e jetës së përjetshme të Zotit zgjat përgjithmonë. Kur ne ndajmë Fjalën e Zotit me ata që duam, Zoti u ofron atyre jetën e përjetshme. A ke humbur ndonjë mundësi për të ndarë planin e shpëtimit me të dashurit e tu? Kërkoji Zotit të të japë një mundësi të dytë, ashtu si i dha nënës së këtij djali të ri. Mos prit që të godasë tragjedia, para se ta marrësh këtë mundësi.

...sepse u rilindët jo me një farë që prishet, por që nuk ka vdekje kurrë: me fjalën e Perëndisë së gjallë e të përjetshme.

1 Pjetrit 1:23

FKSTREM

Himn ekstrem

KOREJA E VERIUT: ELIZABETA PRENTIS

«Ndihem bosh.» – qante Elizabeta Prentis. Humbja e dy fëmijëve dukej mbyhtëse. Megjithëse kishte përjetuar dhimbje të madhe në jetën e saj prej humbjes së të dy këmbëve, besimi i saj te Krishti e kishte mbajtur gjithnjë të buzëqeshur, me një mundësi unike për të inkurajuar të tjerët.

Këtë herë dhimbja ishte e madhe për t'u duruar. «Zot, të lutem, ngushëlloje shpirtin tim të thyer!»

Zoti iu përgjigj lutjes së saj. Një pasdite, e prekur prej keqardhjes më të madhe, ajo shkroi fjalët e këtij himni të njohur frymëzues:

Më tepër dashuri për ty,
o Krisht, më tepër dashuri për ty!
Dëgjoje lutjen që të drejtoj e përlulur në
gjunj.

Ky është përgjërimi im:
Më tepër dashuri, o Krisht, për ty...
Një herë dëshiroja gëzimet tokësore,
kërkoja paqe dhe prehje;
Tani vetëm ty të kërkoj,
më të mirën të marr prej teje...
Le të bëjë fatkeqësia punën e saj,
dërgo dhembje;
Të ëmbël janë lajmëtarët e tu,
i ëmbël refreni
Kur ata këndojnë me mua:
Më tepër dashuri, o Krisht, për ty...

Elizabeta nuk e mori vesh kurrë ngushëllimin dhe ndikimin që kënga e saj do të kishte mbi të krishterët e ditëve moderne.

Në Korenë e Veriut kur udhëheqësi komunist Kimi Ill Sung zbuloi tridhjetë të krishterë që jetonin në fshehtësi, i çoi ata në ekzekutim publik. Fjalët e fundit të kënduara nga të krishterët, ndërsa përballëshin me vdekjen ishin fjalët e këngës së saj, «Më tepër dashuri për Ty».

Jezusi nuk na e jep dhimbjen nga zori, ai e kupton se ndonjëherë duhet të qajmë, por na do shumë për të na braktisur në lotët tanë të hidhëruar. Ai e lejon pikëllimin të zgjasë aq sa të bëjë punën e tij në jetën tonë, duke na rritur në ngjashmëri me të. Pastaj, kur mendojmë se s'mund të durojmë më, shohim që jetët tona marrin një kthesë për më mirë. Do të vijë dita kur do të ndihemi më të fortë. Barra do të duket më e lehtë. Si të krishterët në Korenë e Veriut që presin persekutim, a do ta dimë ne më në fund ç'do të thotë të gëzojmë, edhe kur vuajmë? A e ke përjetuar veprën e plotë të pikëllimit? A ka sjellë ajo më tepër dashuri për Krishtin?

*Por në çdo gjë e dëftojmë veten
si shërbëtorë të Perëndisë... si të
brenosur, por gjithmonë
të gëzuar...*

2 Korintasve 6:4,10

Grumbullim ekstrem

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

Pastor Riçard Vurmbrandi hapi derën e rëndë të çeliktë dhe hyri në dhomën e madhe prej betoni. Ai vështrroi përqark te librat e grumbulluar në dysheme. Me buzëqeshje të madhe dhe me lot ndër sy, mori një dhe ia tregoi shokut të tij. Ishte një Bibël për fëmijë në gjuhën rumune.

Pasi e mblodhi veten tha: «Unë kam qenë këtu ku qëndron tani kjo magazinë. Isha pikërisht këtu, tridhjetë këmbë nën tokë për tre vjet në izolim. Asnjëherë s'e pashë hënën apo diellin. Rrihesha pothuajse përditë. Tani Biblat dhe librat e mi ruhen këtu. Zoti s'mund të kishte zgjedhur më mirë!»

Kur komunizmi ra në Rumani në vitin 1989, punonjësit me Zërin e Martirëve mundën të blinin shumë lirë një librari dhe një shtypshkronjë të madhe nga komunistët e dështuar. Ata shtypën mijëra Bibla dhe libra të Riçard Vurmbrandit dhe ndjenë nevojën për një vend të përkohshëm për t'i mbajtur. Kryetari i ri i Bashkisë së Bukureshtit ofroi një mundësi grumbullimi nën pallatin e Çausheskut – pikërisht në vendin ku Riçardi kishte kaluar vitet në burg duke u lutur për një shërbesë në vendlindjen e tij, Rumaninë!

Kur Riçardi ishte në burg, rojat i thoshin se asnjëherë s'do të lirohej apo të kryente ndonjë punë të dobishme për Zotin. Sot, vendi i tyre i torturave është bërë një vend shërbesë!

Vanilje, gjalpë, sheqer, miell dhe kakao kryesojnë listën e përbërësve për një kek të përsosur me çokolatë. Duke i përzier të gjithë përbërësit së bashku krijohet një ëmbëlsirë e mirë. Por, nëse marrim ndonjë prej këtyre përbërësve në veçanti – si vanilja – shija nuk është e ëmbël, madje e hidhur. Në të njëjtën mënyrë, Zoti është kuzhinieri ynë, duke përzierë të gjithë përbërësit në jetën tonë për të bërë një ëmbëlsirë për t'ia ofruar atij. Një përvojë individuale në veçanti mund të jetë e hidhur; por e përzierë me të tërën, jetët tona kthehen në një krijim hyjnor. A po përjeton një sprovë të hidhur tani? Prit dhe do të konstatosh se si Zoti do ta përdorë atë eksperiencë dhe do të sjellë gjëra të tjera në përzierje. Besoji atij, prit dhe shiko.

Dhe ne e dimë se të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.

Romakëve 8:28

Ju s'mund t'i ndihmoni të tjerët vetëm me sa keni vuajtur. Sa më i madh të jetë çmimi, aq më tepër ju mund të ndihmoni të tjerët. Sa më i vogël çmimi, aq më e paktë është ndihma juaj. Ndërsa kaloni përmes sprovave të zjarra, mundimeve, persekutimeve, konflikteve – ndërsa lejoni Frymën e Shenjtë të realizojë vdekjen e Jezusit në ju – jeta do të rrjedhë tek të tjerët, madje edhe jeta e Krishtit.

I KRISHTERI KINEZ UAÇMAN NI –
I BURGOSUR NË KINË PËR BESIMIN E TIJ

FKSTREM

Aleancë ekstreme

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

Dymbëdhjetë studentët qëndruan me pastorin e tyre përgjatë gardhit. Në anën tjetër kishte një hendek të madh, përtej të cilit ishte hyrja e një shpelle të krijuar nga njerëzit. Një luan i madh sillte andej-këtej para hyrjes së shpellës.

Pastori i tyre tha: «Etërit tuaj janë hedhur para bishave të tilla për besimin e tyre. Ta dini se, edhe ju do të duhet të vuani. Nuk do t'u hidheni luanëve, por do të duhet të vuani në duart e njerëzve që do të jenë më të këqij se këto kafshë. Vendosni këtu dhe tani, nëse dëshironi të zotoheni për besnikëri ndaj Krishtit».

Studentët panë njëri-tjetrin. Para tyre qëndronte pastori i tyre, Riçard Vurmbrand, një njeri, i cili kishte kaluar katërmbëdhjetë vjet në burg për punën e tij në kishën e fshehtë. Kjo ishte java e fundit e pastorit në Rumani, sepse ai dhe familja e tij ishin liruar me kusht nga vendlindja e tyre dhe do të largoheshin brenda disa ditësh.

Riçardi nuk e dinte nëse studentët e shkollës së të dielës do të vuanin nën dorën brutale të komunistëve ateistë, por ai donte të mbillte një besim që do t'u mbijetonte sprovave më të vështira, ndaj i kishte sjellë studentët në kopshtin zoologjik për të parë luanët.

Megjithëse të rinj, studentët e kuptuan plotësisht se çfarë donte të thoshte pastori i tyre. Me lot, ata iu përgjigjën me vendosmëri «Ne zotohemi për besnikëri ndaj Krishtit».

Mësimi i Riçardit drejtuar të rinjve u bë në kohën e duhur. Edhe pse mund të mos i kenë kuptuar ndërlikimet e martirizimit deri vonë dhe mund të mos u jetë dashur të përballen vetë me të, ai ilustrim i ndihmoi të merrnin një vendim të rëndësishëm. Ata siguruan besnikërinë ndaj Krishtit më parë. Marrja e vendimeve më parë është çelësi i suksesit gjatë kundërshtimit. Ne duhet ta kemi vendosur tashmë besnikërinë tonë, para se ajo të vihet në provë. Momenti i presionit më të madh nuk është koha për të peshuar mundësitë tona dhe për të vendosur bindjet tona. Është koha të vendosim bindjet tona të paracaktuara në praktikë. A i ke vendosur bindjet e tua para se të vijë tundimet, kështu që asnjë epror, bashkëshort/e, pjesëtar i familjes, qeveri apo autoritet tjetër të mund të ndryshojë mendjen tënde?

Perëndia na ka vënë në këtë themel të patundur: në Krishtin. Ai na ka veçuar për shërbimin e tij

2 Korintasve 1:21

FKSTREM

Dëshmi ekstreme

ARMENI: BARTOLOMEU

Mbreti Astigo, iu hakërrye. «Ti ke çoroditur vëllanë tim, gruan time dhe disa prej fëmijëve! Ti ke shqetësuar adhurimin e zotave tanë! Priftërinjtë e Ashtarotit kërkojnë gjakun tënd! Nëse nuk ndalon së predikuari këtë Jezus dhe nuk u kushton fli zotave tanë, do të vdesësh me vdekjen më të dhimbshme!»

Pasi apostujt u shpërndanë, Bartolomeu udhëtoi me ungjillin përmes Likaonisë, Sirisë, Azisë së sipërme dhe deri në Indi. Pastaj shkoi në kryeqytetin Albana të Armenisë, ku shumë veta pranuan Krishtin. Këtu, Bartolomeu u soll para mbretit për gjykim.

«Unë nuk i kam çoroditur ata, – u përgjigji Bartolomeu, – por i kam kthyer tek e vërteta. Unë nuk do t'u kushtoj ili zotave tuaj të rremë. Kam predikuar dhe kam adhuruar Zotin e vetëm të vërtetë dhe do të preferoja më mirë ta vulosja këtë dëshmi me gjakun tim, sesa të vuaja shkatërrimin më të vogël të besimit apo ndërgjegjes sime!»

Mbreti u zemërua. Me qëllim që ta bënte Bartolomeun të pushonte, ai urdhëroi të rrihej me shkopinjtë dhe të torturohej. Por akoma Bartolomeu nxiste të tjerët të mbaheshin tek e vërteta. Pastaj ai u var kokëposhtë në kryq dhe iu rrop lëkura i gjallë me thika, por ai vazhdoi t'u bënte thirrje të gjithëve të vinin tek i vetmi Zot i vërtetë dhe Biri i tij, Jezu Krishti. Më në fund, mbreti urdhëroi t'i pritej koka me sëpatë, për të pushuar thirrjet e tij, por njëkohësisht duke ruajtur dëshminë dhe duke vulosur besimin e tij në Jezu Krishtin.

Ndoshta disa i dëgjojnë historitë e martirëve e lexojnë për jetën e tyre me një ndjenjë mposhtjeje. Mbi të gjitha, njësoj si Bartolomeu, në fund ata vdiqën në duart e armiqve të tyre. Jezusi nuk e kurseu një përfundim të tillë. Ata që refuzojnë ringjalljen e tij mendojnë për të si një mësues i mrekullueshëm, shërbesa e të cilit u ndërpre në mënyrë tragjike prej vdekjes së tij të parakohshme. A është vdekja në të vërtetë një shenjë e fitores së Satanit? Jo, në rastin e Jezusit. Në fakt, vdekja e Jezusit ishte fitorja përfundimtare e Zotit mbi mëkatin. Në rastin e martirëve të krishterë, dëshmitë e siguruara nëpërmjet vdekjes së tyre të guximshme sollën shumë më tepër të tjerë në besim, sesa do të mundeshin ndonjëherë me jetën e tyre. Është e mundur të nderosh Zotin si me vdekjen ashtu edhe me jetën tënde.

Dhe ata e fituan atë me anë të gjakut të Qengjit, the me anë të fjalës së dëshmisë së tyre; dhe nuk e deshën jetën e tyre deri në vdekje

Zbulesa 12:11

DEKLARATA EKSTREME

ROME: APOSTULLI PAL

Pali u shkroi Timoteut: «Lufto luftën e mirë të besimit, fitoje jetën e përjetshme, në të cilën u thirre». (1 Timoteut 6:12) Ai ishte i njohur me luftën.

Ai përshkroi disa prej eksperiencave të tij në letrën drejtuar korintasve: «Në shumë vuajtje, në shtrëngime, në nevoja, në ngushtica në rrahje, në burgosje, në mundime, në të pafjetura, në agjërime, ...⁹ si gënjeshtarë, por të vërtetë, si të panjohur, por të njohur, si njerëz që vdesin, por, ja, jetojmë, si të ndërshtuar, por jo të vvarë; si të brengosur, por gjithmonë të gëzuar, si të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur; si njerëz që s'kanë kurrgjë e kanë gjithçka!» (2 Korintasve 6:4-5; 9-10).

Ndërsa ishte në burg i dënuar me vdekje, Pali u shkroi filipianëve: «Sepse për mua të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim. Por, nuk e di se jeta në mish të jetë për mua një punë e frytshme, as mund të them çfarë duhej të zgjedh, sepse unë jam i shtrënguar nga dy anë, sepse kam dëshirë të iki nga kjo çadër dhe të jem bashkë me Krishtin, gjëja më e mirë, por të qëndruarit në mish është më i nevojshëm për ju. Këtë e di me siguri, që do të rri dhe do të qëndroj me ju të gjithë përparimin tuaj dhe për gëzimin e besimit tuaj.» (Filipianëve 1:21-25).

Megjithatë, disa vite më vonë, ai i shkroi Timoteut: «Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin». (2 Timoteut 4:7). Në Romë, në moshën gjashtëdhjetë e katër vjeçare, Palit iu pre koka me urdhër të perandorit Neron dhe shkoi për të qenë me Jezusin.

Nëse do të na duhet ndonjëherë frymëzim për të vazhduar përballë vuajtjeve, nuk do të na duhet të shohim më tutje se jeta e Palit. Gara e qëndrueshmërisë së Palit filloi me shqetësimin e fillimit. Ai kaloi përmes një sërë përvojash rrëqethëse të shënuara në librin e Veprave të Apostujve. Por përsëri, i konsideronte të gjitha gjërat që kaloi si pleh, krahasuar me njohjen e Jezusit dhe bërjen e tij të njohur. A jeni në gjendje të thoni të njëjtën gjë si Pali kur vjen puna te vuajtja? A të pengon ndonjë gjë nga qëllimi i njohjës së Krishtit dhe bërjes së tij të njohur? Nëse ke frikë se je në hapin e fundit të shërbimit besnik, merr zemër nga fjalët inkurajuese dhe fillo përsëri.

Por unë nuk dua t'ia di fare për jetën time që nuk e çmoj aq, sa ta kryej me gëzim vrapimin tim dhe shërbesën që mora nga Zoti Jezus, të dëshmoj plotësisht ungjillin e hirit të Perëndisë.

Veprat e Apostujve 20:24

«Pagëzues» ekstrem

JUDE: GJON PAGËZORI

Gjon Pagëzori nuk pushoi asnjëherë së foluri për drejtësinë. Kur mbreti Herod Antipa la gruan e tij për të marrë gruan e vëllait të tij, Gjoni e qortoi. I tha Herodit se ai nuk po i bindej ligjit të Zotit duke vepruar kështu. Herodi filloi ta urrente Gjoni për qortimin e tij, por edhe kishte frikë për shkak se njerëzit e konsideronin atë profet. Herodi donte ta vriste Gjoni, por nuk guxonte të vinte dorë mbi të dhe të rrezikonte kryengritje të hapur. Edhe nën presionin e gruas së tij të re, Herodiadës, ai ngurroi ta vriste, megjithatë, e futi në burg.

Ndërsa ishte në burg, Gjoni dërgoi lajmëtarë te Jezusi për të vërtetuar që Jezusi ishte Mesia i pritur dhe për të cilin kishte profetizuar. Pasi mori vërtetimin prej Jezusit, që ai ishte në fakt Mesia i pritur, Gjoni u siguroi që misioni i jetës së tij ishte përmbushur. Mesia kishte ardhur. Gjoni e dinte se gjithçka që i ndodhi ishte thjesht pasoja. Çfarë kishte rëndësi ishte Jezusi.

Në ditëlindjen e Herodit, mbretëresha Herodiada dërgoi vajzën e saj për të vallëzuar para tij. Kur Herodi bëri një betim të rrëmbyer për t'i dhënë vajzës çfarë të donte, ajo me zgjuars i kërkoi kokën e Gjon Pagëzorit në një pjatë. Herodi, i vënë në siklet para mysafirëve të tij, nuk kishte kurajë ta refuzonte këtë kërkesë mizore, kështu që i preu kokën Gjoni.

Shumë admirojnë guximin dhe mburrin kurajën e tyre, por martirët nuk jetuan dhe vdiqën me qëllim që të admiroheshin. Ka mundësi t'i nderojmë aq shumë historitë e tyre, sa të humbasim qëllimin e jetës së tyre. Ata që u vranë për besimin e tyre vdiqën me qëllim që të nderonin Jezusin dhe jo ta zbehnin atë. Një reagim ndaj jetës së tyre duhet të jetë një nderim i thellë për Zotin, jo admirim për njerëzit. Ndjenja jote më e madhe e përkushtimit nuk është për atë se çfarë do të të sjellë ty nderim. Përkushtimi yt nuk është për atë se çfarë do ta shkruante emrin tënd në listën e të krishterëve të nderuar. Përkushtimi yt duhet t'i sjellë nder Jezusit dhe vetëm atij.

*Ai duhet të rritet dhe unë të
zvogëlohem.*

Gjoni 3:30

FKSTREM

Mbajtës ekstrem shënimesh

BURGU KOMUNIST: FLORIKA

Florika ishte skeptike dhe nuk kishte shpresë. Prej javësh, ato kishin parë gra të linin burgun. Askush nuk e dinte se ku do të çoheshin ndërsa thirrreshin emrat dhe gratë mblidheshin në oborrin e burgut. Ndoshta me të vërtetë liroheshin.

Dhe kështu, kur ajo dëgjoi emrin e saj, e dorëzoi veten për të pranuar vullnetin e Zotit, cilido të ishte ai.

Majori pas tavolinës tha: «Në këtë vend, duhet ta dini se jam më i fuqishëm se vetë Zoti. Të paktën deri në këtë pikë Zoti juaj nuk ka bërë ndonjë ndërhyrje për ju. Por, a e keni pranuar në të vërtetë këtë? Dua të them se ju duhet ta keni kuptuar tani që në një shoqëri komuniste, nuk ka nevojë për një zot dhe as ju nuk duhet të keni nevojë për një të tillë. Nëse liroheni ndonjëherë prej këtej, do të shihni vetë arritjet që kemi bërë në vitet e fundit dhe ky është vetëm fillimi!»

Florika pa dokumentet në tavolinën e tij dhe u përgjigj: «E shoh që jeni i fuqishëm dhe jam e sigurt që keni dokumente, të cilat s'i kam konsideruar kurrë se mund të vendosnin fatin tim, por edhe Zoti mban shënime. Asnjëri prej nesh nuk do të kishte jetë pa të. Kështu që, nëse ai më mban këtu apo më çliron, do të pranoj çfarë është më e mira për mua».

Tri ditë më vonë, Florika u lirua.

Kur fëmijët janë në shkollë e mësojnë shumë shpejt fuqinë e dërrasës së zezë. Në sytë e një fëmije, të kesh emrin të shkruar në dërrasë nga mësuesja, është një përgjegjësi e madhe për nxënësin rebel. Si fëmijë, ne kemi patur shumë dëshirë për ata që na shkaktonin probleme, ta kishin emrin të shkruar. Ishim të bindur që ndëshkimi do të ishte i shpejtë dhe i sigurt. A e kemi humbur ndopak atë besim fëmije? A jemi aq të lodhur nga shumëfjishimi i së keqes në botën e sotme, që nuk beson se Zoti është akoma duke «mbajtur emrat shënim?» Bibla na mëson se e gjithë bota do t'i japë llogari Zotit. Kështu që, merr zemër kur të shikosh që e keqja po kalon pa u ndëshkuar. Zoti do t'i sjellë para drejtësisë.

...me qëllim që çdo gojë të heshtë dhe gjithë bota t'i jetë nënshtruar gjykimit të Perëndisë.

Romakëve 3:19

Revolucionarë ekstremë

ROME

Të krishterët e hershëm ishin revolucionarë shpirtërorë. Në një shoqëri që adhuronte idhujt dhe ata që refuzonin i quante «ateistë», të krishterët ishin një forcë radikale që kërcënonte vazhdueshmërinë e Romës. Ata shkolin kundër rregullit të pjesës më të madhe dhe kështu që bëhej një kërcënim i dukshëm për autoritetin romak. Urreheshin aq shumë, sa vdekjet e tyre nuk ishin vetëm të panumërta, por kryheshin me një aftësi të tmerrshme.

Të krishterët ishin revolucionarë që shpallnin gjykimin e fundit dhe transformimin e botës nëpërmjet kthimit të Krishtit, kështu që shumë të mund të shpëtoheshin. Ata e ngritën Jezusin si autoritet më të lartë se perandorin romak. Ndaj perandorët romakë dërguan dekrete në të cilat deklarohesh se, dikush që shpallte që të ishte i krishterë të dënohej me vdekje pa ndonjë ndjekje të mëtejshme ligjore. Asnjë proces nuk sigurohej për këta «rebelë», të cilët guxonin të sfidonin rregullin e perandorit. Imperializmi romak nxori dhjetë periudha ekstreme persekutimi, çdonjëra më e keqe se ajo paraardhëse.

Revolucionarët u bënë të njohur me termin *martir* (d.m.th. *dëshmitar*). Kjo u përdor nga ata dëshmitarë, të cilët sollën dëshmitë e tyre para gjykatësve dhe perandorëve me këmbënguljen e ushtarëve të mirë-disiplinuar. Me kalimin e kohës termi *martir* përdorej vetëm për ata që vdisnin për dëshminë e tyre, kurse termi *rrëfyes* për ata që u torturuan, por nuk vdisnin. Ata thjesht nuk pranonin të ndryshonin mendje. Martirizim në kuptimin e parë do të thotë dëshmim i besimit tek Jezusi, pavarësisht nga rrethanat

e vështira. Çdo dëshmitar për Krishtin është një revolucionar i ditëve moderne.

Martirët në histori ishin njësoj si jemi ne sot, ushtarë në një luftë shpirtërore. Kjo betejë filloi kur Jezusi çrrënjosi fuqitë e së keqes kur vdiq në kryq. Me vdekjen e tij ai çarmatosi ferrin dhe djajtë e tij. Martirët po e vazhdojnë këtë betejë, por jo duke luftuar me armët fizike, por me ato shpirtërore. Rrëfimi i tyre është arma e tyre e zgjedhjes. Ata marshojnë në territorin e armikut si në vendet e izoluara dhe pa frikë shpallin fitoren e Krishtit mbi Satanin. Prona e tyre e çmuar nuk është jeta e tyre, por dëshmia e tyre. Ja, pse ata janë gati të japin jetën me qëllim që të ruajnë besimin e tyre. Kur do ta fillosh ti betejën? A je gati ta përdorësh armën e rrëfimit?

Lufto luftën e mirë të besimit, fitoje jetën e përjetshme, në të cilën u thirre dhe për të cilën dhe një dëshmi të bukur para shumë dëshmitarëve!

1 Timoteut 6:12

Porositja

I kërkova Zotit të ndihmonte të fqinjin tim
Dhe ta çonte ungjillin në vendet e thella
Të ngushëllonte të sëmurët, por ai më tha:
Nëse më do, bëhu duart e mia.

I kërkova Zotit të shkonte te njerëzit që po vdisnin
Dhe te jetimët në rrugët e pista
Të vizitonte të burgosurit, por ai më tha:
Nëse më do, bëhu këmbët e mia

I kërkova Zotit të shikonte të varfrit
Dhe të kujdesej për foshnjën që qan për ndihmë
Të shihte nevojat e çdo personi, por ai më tha:
Nëse më do, bëhu sytë e mi.

I thashë Zotit: Dua të të shërbej ty
Por nuk di ku ta hedh të parin hap.
Të duash, është përgjigjja, – më tha ai.
Nëse më do, bëhu zemra ime për ta.

Qëndrueshmëri ekstreme

PATMOS: APOSTULLI GJON

Çfarë bëni me dikë që po zjen në vaj, por nuk vdes.

Thuhet se perandori romak, Domician, urdhëroi që apostullin Gjon ta zienin për vdekje në vaj, por Gjoni vazhdoi të predikonte nga brenda poçes. Një herë tjetër, Gjoni e detyruan të pinte helm, por siç premtohet te Marku 16:18, ai nuk i bëri asgjë të keqe. Kështu që Gjoni, kreu i kishës në Efes në atë kohë, u internua në Patmos në vitin 97 pas Krishtit.

Gjoni u mbijetoi të gjitha këtyre, sepse Zoti nuk kishte mbaruar ende me të. Duhej të vinte edhe një «zbulesë».

Ndërsa ishte në një shpellë në ishullin e Patmosit, Gjoni pa një vizion. Vizioni u bë libri i Zbulesës – libri që do të ishte si forcë nxitëse për ungjillizim gjatë erës së Kishës. Ajo profetizonte ngjarjet që kanë të bëjnë me kthimin e Krishtit. Gjoni shkroi për ardhjen e dytë të Krishtit dhe mirëpriti ardhjen e tij. Madje edhe sot, shkrimet e tij frymëzojnë besimtarët për të pritur me padurim kthimin e lavdishëm të Krishtit.

Dy vjet pas internimit të Gjunit, perandori Domician vdiq dhe Gjoni u kthye në kishën e Efesit. Më i vogli i dishepujve jetoi për të qenë më i moshuari, duke vdekur në paqe në Efes në moshën tetëdhjetë vjeçare pas një gjysmë shekulli shërbimi të qëndrueshëm ndaj kishës së Jezusit.

Është e pamundur të dalësh në pension nga shërbimi i Zotit. Pyesni Gjunit. Në një kohë kur moshë mesatare e vdekjes ishte shumë më e vogël, Gjoni jetoi për t'u bërë tetëdhjetë vjeç, duke shërbyer me besnikëri gjatë gjithë kohës. Ndoshta ti je duke u përpjekur me dobishmërinë tënde në shërbim të Zotit. Ndoshta ndihesh shumë i/e moshuar dhe e gjeni veten duke menduar se Zoti do të mund të përdorte dikë më të ri në vendin tënd. Ose ndoshta je i ri dhe beqar e mendon se Zoti ka ndërmend më mirë një çift të martur. Në vend që t'i lësh justifikimet e tua, Zoti do të ndërtojë tek ti një qëndrueshmëri shpirtërore që nuk dekurajohet lehtë. Fillo t'i kërkosh Zotit sot të të zbulojë hapat e tjerë në shërbimin e tij.

Unë, Gjoni, vëllai juaj dhe bashkë me ju pjesëtar në vuajtje, në mbretëri dhe në qëndresë në Jezusin: isha për shkak të fjalës së Perëndisë dhe të dëshmisë së Jezusit në ishullin që quhet Patmos.

Zbulesa 1:9

FKSTREM

Mosbindje ekstreme

JERIHO: RAHABA

Kur Jozueu dërgoi dy spiunë për të parë tokën e Jerikosë, ata u fshehën në shtëpinë e Rahabës, prostitutës. Shtëpia e Rahabës ishte ndërtuar përgjatë mureve të Jerikosë, një mur i ndërtuar për të parandaluar kalimin ilegal të vizitorëve jo të mirëpritur. Kur mbreti dëgjoi se hetuesit izraelitë ishin në qytet, ai i dërgoi menjëherë fjalë Rahabës. E udhëzoi atë të kallëzonte spiunët që kishin hyrë në shtëpinë e saj.

Rahaba nuk iu bind urdhrat të mbretit të saj duke i fshehur spiunët, madje edhe duke gënjyer për të mbrojtur vendndodhjen e tyre. Më vonë atë mbrëmje, ajo i nxori fshehurazi ata prej qytetit duke i zbritur me një litar të gjatë përmes dritares së saj poshtë murit.

Rahaba nuk e njihte shumë Zotin e Izraelit, por ishte e përgatitur të ndihmonte njerëzit e tij. Ajo nuk iu bind autoriteteve të saj pagane duke e vënë jetën e saj në rrezik. Si pasojë, jeta iu kursye.

Një rast i ngjashëm gjendet te Veprat 9:25. Shumë shpejt pas kthimit të Palit në besim, ai kaloi disa ditë me dishepujt në Damask, duke predikuar dhe duke mësuar në sinagoga. Çifutët ishin aq të mahnitur nga ndryshimi i Palit, sa filluan ta konsideronin një kërcënim. Dishepujt e zbritën poshtë një muri për ta mbajtur larg portave të qytetit dhe për të kursyer jetën e tij prej çifutëve, të cilët po komplotonin për ta vranë.

Disa të krishterë besojnë se po të mos u bindesh autoriteteve qeveritare në vendet e izoluara e ke të garantuar persekutimin. A i meritojnë të rrahurat që po durojnë të krishterët kinezë, të cilët refuzojnë të

regjistrohen me kishën zyrtare? A meritojnë myslimanët, të cilët kthehen në krishterim, të qëllohen me gurë për vdekje në vendet islamike? Ndërsa pjesë të ndryshme mund të interpretohen ndryshe, të gjithë të krishterët bien dakord që ne s'mund ta lejojmë qeverinë të na detyrojë të mos u bindemi ligjeve të Zotit. Sigurisht, kjo nuk i lejon të krishterët të ushtrojnë hakmarrje personale kundër shtetit. Mosbindja është e lejuar vetëm kur jemi të detyruar të vendosim midis besnikërisë ndaj Krishtit dhe besnikërisë ndaj ligjeve qeveritare. Ku qëndron ti në këtë çështje? Studio Shkrimet dhe vendos vetë.

... sepse nuk ka pushtet veçse prej Perëndisë; dhe pushtetet që janë, janë caktuar nga Perëndia.

Romakëve 13:1

FKSTREM

Mashtrim ekstrem

KOREJA E VERIUT: NJË GRUA E MOSHUAR

Një ditë mësuesja na tha se do të luanim një lojë të veçantë. Ajo na pëshpëriti për një libër të veçantë që prindërit tanë mund ta kenë fshehur në shtëpinë tonë. Ne duhet të prisnim që prindërit të shkonin për të fjetur, të kërkonim librin dhe në mënyrë të fshehtë ta sillnim në shkollë të nesërmen për një surprizë të veçantë. Unë shkova në shtëpi dhe fillova menjëherë ta kërkoja.

«Të nesërmen isha një prej katërmbëdhjetë fëmijëve që kishin sjellë në klasë librin e zi, Biblën. Neve na dhanë shajë të kuq të ndezur midis duartrokitjeve të nxënësve të tjerë, ndërsa mësuesja na drejtonte në një paradë rreth klasës.

Atë pasdite për në shtëpi e bëra me vrap, sepse isha e emocionuar që t'i tregoja amasë se si e kisha fituar shallin e kuq. Ajo nuk ishte as në shtëpi dhe as në kasolle. Prita, por as ajo dhe as babai im nuk erdhën në shtëpi dhe fillova të frikësohesha. Isha e uritur dhe po errësohej. Fillova të ndihesha keq përbrenda dhe fjeta në karrige.

Të nesërmen, oficerët e policisë erdhën dhe më informuan se tani isha nën kujdesin e qeverisë. Nuk i pashë më kurrë prindërit e mi.

Një grua e moshuar nga Koreja e Veriut e tregoi këtë histori. Ajo nuk mori vesh kurrë më për prindërit dhe ende po lufton me veten për falje. Ajo është vetëm një prej të shumtëve që kanë kaluar sprova të tilla.

Në kundërshtim me karikaturën popullore, djalli nuk vishet me kostum të kuq i pajisur me sforc. Ne do ta njihim lehtë një ftesë të tillë të dukshme për t'u marrë me të ligun. Megjithatë, si fëmija në tregimin e përmendur më lart, ne shpesh e ndeshim atë në një dritë të ndryshme. Përfaqësuesit e armikut janë shpesh njerëz mbresëlënës në vende të larta. Konsidero ndikimin e një partneri biznesi me një të folur të shtruar. Ose imagjino pushtetin që një profesor universiteti ushtron në emër të akademisë. Ashtu siç e zbuloi edhe fëmija në këtë tregim, armiku nuk luan pastër. Ne duhet ta shmangim naivitetin dhe të ruhem kundër armiqve dhe përfaqësuesve të tij kudo që t' i ndeshim. A je një pre i lehtë për armikun apo ka për të të gjetur në gatishmëri?


Dhe nuk keni pse të çuditeni! Sepse edhe vetë djalli merr trajtën e engjëllit të dritës. S'keni, pra, pse të çuditeni në qoftë se edhe punëtorët e tij marrin dukjen e jashtme të punëtorëve të drejtësisë. Mbarimi i tyre do të jetë sipas veprave të tyre.

2 Korintasve 11:14-15

FKSTREM

I burgosur ekstrem

VIETNAM: TO DINH TRUNG



Dinh Trungu ka bërë me qindra kilometra me biçikletën e tij, duke udhëtuar në rrugë të papastra dhe të prishura për t'i shërbyer fisit K'Ho. Ky është njëri prej gjashtëdhjetë fiseve në Vietnam, Ku është e ndaluar hyrja për ungjillizim. Kur po hynte në fshat në 4 prill të vitit 1995, papritur policia e tërhoqi nga biçikleta dhe filloi ta rrihte. Ata e regjistruan në një në video dhe e tallën para fshatarëve.

Ai u çua në burg dhe u mbajt për gjashtë muaj para gjyqit. Kur këndoi këngën e fëmijëve me titull «Duaje Zotin natë e ditë» ai u dënua për të kaluar edhe më tepër kohë në burg.

Në fakt, për shkak të presionit të organizatave të krishtera të ndihmave, qeveria i ofroi Trungut lirim gjatë muaj më herët. Por, megjithëse kishte një grua besnike dhe dy fëmijë të vegjël që po e prisnin, ungjilltari nuk ishte gati për të ikur! Ai e pa këtë si një mundësi tjetër hyjnore për t'u predikuar të humburve. Çfarë mund t'i bënin atij? Ai tashmë ishte në burg!

Falë përpjekjeve të Trungut në burg afër Quang Ngai, shumë besuan në Krishtin. Kur dëgjoi për shumë të krishterë që luteshin dhe kërkonin ndihmën e tij, si mund ta humbiste këtë mundësi për të dhënë një shembull duke braktisur jetën e tij për mbretërinë e Perëndisë? Trungu refuzoi lirim e tij të hershëm dhe vendosi të qëndronte në burg dhe të vazhdonte punën e tij si ungjilltar.

Dikur Trungu ishte i burgosur i shtetit dhe i nënshtruar mizorisë dhe torturës. Megjithatë, kur vendosi të mbetej në burg për kohëzgjatjen e dënimit të tij, ai u bë i burgosur i Jezu Krishtit. Shteti u përpoq ta mposhte. Mësuesi i tij i ri e ripërtëriu atë. Shteti u përpoq të shuante mesazhin e tij. Jezusi e çoi mesazhin e tij në çdo qeli, duke e bërë Trungun dy herë më ungjilltar siç ishte para dënimit të tij. Trungu na kujton ç'do të thotë të gëzosh liri në Krishtin, edhe në mes të shqetësimeve dhe vuajtjeve të kësaj jete. Ndoshta ndihesh të jesh i burgosur i një situatë po kaq trishtuese. Lejo Jezusin të të çlirojë duke e lejuar atë të bëhet Zoti i jetës suaj.

Për këtë arsye unë, Pali, jam i burgosuri i Jezu Krishtit për ju johebrenjtët...

Efesianëve 3:1

FKSTREM

Pastor ekstrem

SUDAN: PASTOR LUKA

Pastor Luka u tha mirupafshim me vështirësi të pestë fëmijëve dhe gruas së tij para se të largohej nga kampi refugjat dhe të kthehej në shërbesën e tij në Sudanin e jugut. Vetëm pas tre muajsh do të mund ta shihte sërish familjen, sepse shërbesa e tij është në njërin prej krahinave më të ndikuara nga lufta civile dhe nga sulmet e qeverisë islamike.

Bashkësia e pastor Lukës nuk kishte ndërtesë kishe sepse shumë ndërtesa ishin shkatërruar në pothuajse dy dekada të luftës civile të Sudanit. Ata takohen çdo javë, në hijen e një peme të madhe në të cilën është i gdhendur një kryq. Anëtarët ulen në tokë ose qëndrojnë në këmbë gjatë shërbesave, ndërsa pastor Luka qëndron afër kryqit të gdhendur dhe predikon.

Nëse pastor Luka do të qëndronte me familjen e tij, do të kishte kohë çdo ditë me ta. Sigurisht, punëtorët e ndihmave do të vazhdonin të siguronin ushqim për sudanezët e shpërngulur, duke plotësuar nevojat e tyre fizike. Megjithatë, Zoti e thirri Lukën të plotësonte nevojat shpirtërore të njerëzve. Cili do të zinte vendin e tij nëse ai nuk do të shkonte?

Luka shërben në një rajon që më parë nuk ka pasur një kishë vepruese. Ai po i bindet urdhrit të Zotit për të qenë kripë dhe dritë në një krahinë të dërrmuar nga lufta. Është e vështirë – ndonjëherë pikëlluese – për pastor Lukën të lërë familjen e tij, por Zoti i ka shpërblyer sakrificat e tij me një «kishë-pemë» të gjallë dhe në rritje.

Puna e Zotit na ndan ndonjëherë nga ata që duam. Vetë Jezusi la të gjithë ata që kishte njohur në qytetin e tij dhe familjen kur ishte tridhjetë vjeç dhe filloi shërbesën e tij. Nëse ne ndjekim planin e Zotit për jetën tonë, ajo rrugë do të na çojë larg prej së njohurës dhe në drejtim të së panjohurës. Ndërsa udhëtimi ynë mund të na ndajë nga të dashurit, shtëpia, rehatia dhe siguria, s'jemi kurrë të ndarë nga dashuria e Krishtit. Dashuria e tij është shoqëruesi ynë i vazhdueshëm dhe kështu, në të vërtetë nuk jemi kurrë vetëm. A ndiheni të vetmuar prej shtëpisë, familjes, miqve? Nëse je i sigurt që po ndoqësh planin e Zotit për jetën tënde, atëherë duhet të vazhdosh me detyrën. Krishti do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm.

Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit?

Romakëve 8:35

FKSTREM

Predikues ekstrem TV

VIETNAM: VELLA K'BE

Kur fëmijët e vëlla K'Besë e panë për herë të parë t'atin në televizorin vietnamez, thirrën të gëzuar. Por emocioni i tyre u zhduk kur dëgjuan spikerin të thoshte se i ati ishte kriminel. U deklarua se ai ishte fajtor për shumë «krime» kundër qeverisë vietnameze.

«Krimet» e vëlla K'Besë ishin predikimi i ungjillit në takimet e «kishave-shtëpi» të peregjistruara. Qeveria e nxori fytyrën e tij në televizor për ta turpëruar dhe për t'i paralajmëruar të tjerët të kinin kujdes prej tij. Madje ata luanin duke dhënë në televizor dhe radio intervistat e tij me policinë, por kjo sa ndihmoi në shpërndarjen më tej të mesazhit të ungjillit. Kjo i dha atij një platformë për të fituar shumë të tjerë për Krishtin. Ata që e panë në televizor e pyetën për besimin e tij dhe ai ishte në gjendje t'u tregonte për Krishtin.

Ai shpjegoi: «Ata e nxorën fytyrën time në televizor, që shumë njerëz të mund të më njihnin. Komshinjtë e mi më thonë: «Pse e le familjen?» U them se Zoti do të kujdeset për këtë. Unë duhet të shkoj. E korra është gati dhe ka pak punëtorë».

Duke parë se turpi publik nuk po e lëkundte shërbesën e K'Besë, policia e ka kërcënuar se do ta arrestojë herën tjetër që do të kapet duke predikuar. «Gruaja ime gëzohet që emrat tanë janë të shkruar në Librin e Jetës dhe që fytyra ime është një dëshmi në televizor. Policia po ndihmon në shpërndarjen e ungjillit. Ata mund të mbyllin kishën, por jo dëshminë tonë.»

Besimtarët mund të gozhdohen në shtyllë, të prangosen në një qeli burgu apo të mbyllet në burgje. Besimtarët mund të vdesin madje, por ungjilli vazhdon të jetojë. K'Beja na kujton se ungjilli nuk ka të bëjë me një ndërtesë kisha, një takim apo ndonjë besimtar. Një ndërtesë kisha mund të mbyllet. Një takim mund të shpërndahet. Një besimtar mund të burgoset apo të vritet. A mos vallë e kuptoni krishterimin të lidhur me një pastor të caktuar, ndërtesë kisha apo veprimtari? A do të rritej besimi yt (si ndodh në vendet e izoluar), nëse të gjitha këto forma të jashtme do të hiqeshin? Fjala e Zotit do të mbetet përsëri, pavarësisht këtyre kuqizimeve. A do të gjesh akoma një mënyrë si K'Beja për të jetuar besimin tënd?

... sipas ungjillit tim, për të cilin unë po vuaj deri edhe në pranga porsiq keqbërës; por fjala e Perëndisë nuk lidhet në pranga.

2 Timoteut 2:8-9

**Mundësia për të qenë një shërbëtor i Zotit
ekziston gjatë gjithë kohërave dhe në
të gjitha vendet. Kundërshtimi nuk duhet të
sjellë ndryshim. Shpirtërisht kemi vetëm
një Udhëheqës. Ai drejton hapat tona.**

TOM UAIT, I CILI VUAJTI NË NJË BURG KOMUNIST KUBAN,
SEPSE KISHTE HEDHUR TRAKTE UNGJILLI PREJ NJË AVIONI TË VOGËL
MBI ISHULL



FKSTREM

Mjeke ekstreme

RUMANI: DR. MARGARETA PESKARU

Në Rumaninë komuniste, çdo i burgosur kishte një mjek, i cili do të ishte shpesh i pranishëm gjatë sesionit të marrjes në pyetje dhe do t' i drejtonte torturuesit në metodat më të mira, që nxisnin dhimbje pa shkaktuar vdekje. Por disa mjekë e morën seriozisht betimin e tyre duke përbuzur atë që po bënin komunistët.

Një mjeke e tillë ishte një grua e bukur e krishterë e quajtur Margareta Peskaru. I gjithë personeli mjekësor kontrollohej kur futej në burg, por dr. Peskaru, duke rrezikuar seriozisht veten, ishte në gjendje të sillte vazhdimisht ilaçe fshehurazi. Përpjekjet e saj vetëmohuese shpëtuan shumë jetë.

Një herë u caktua në një burg spitali që ishte menduar veçanërisht për pacientët e tuberkulozit. Gjatë kësaj kohe, komunistët caktonin burra si «riedukues» për të përdorur çfarëdo mjeti të nevojshëm që të bindnin një person të mohonte gjithçka që besonte dhe të betohej për besnikëri të plotë ndaj komunizmit.

Këta riedukues ishin të pamëshirshëm dhe shumë të krishterë vdisnin nën torturat e tyre. Kur dr. Peskaru dëgjoi lajmin se ata kishin ardhur në spitalin e burgut për të filluar punën e tyre shkatërruese mbi pacientët me tuberkuloz, ajo bëri të paimagjinueshmen. Shkoi te zyrtarët më të lartë të burgut dhe parashtrori rastin e të burgosurve të pashpresë. Askush nuk e di se si, por dr. Peskaru fitoi miratimin e zyrtarëve.

Për njëfarë kohe në komunizmin rumun, tortura e të pafajshmëve nga «riedukuesit» u ndalua, falë përpjekjeve të saj të guximshme.

Përpigu! Ky është ndryshimi midis të ecurit përpara dhe të qëndruarit palëvizur. Përpjekja është çfarë janë të përkushtuar të bëjnë të krishterët kur janë të fokusuar në ungjillin e Krishtit. Provuani. Të thuash që të paktën dikush u përpoq, është mënyra e vetme sesi besimtarët bien dakord të pranojnë dështimin. Është e vërtetë – ne nuk do ta dimë kurrë çfarë do të ndodhë, nëse nuk përpiqemi. Ndoshta i idetë krijuese që na vijnë për të çuar më tej mesazhin e ungjillit në punë, në shtëpi ose në komunitetin tonë, jemi të shpejtë që më parë t' i dëbojmë nga vetja. Mendojnë se ato s' do t' ia dalin mbarë kurrë. Ne bindim veten se kundërshtimi do të ishte shumë i fortë, por s' do ta dimë kurrë me siguri, nëse nuk përpiqemi. A je gati të përpiqesh t' i bindesh Krishtit me çfarëdo lloj çmimi duke filluar që sot?

Pastaj do të hyj te mbreti; megjithëse një gjë e tillë është kundër ligjit; dhe në qoftë se duhet të vdes, do të vdes.

Ester 4:16

Letër muri ekstreme

KORE: ROBERT J. TOMAS

Robert J. Tomas dhe gruaja e tij u larguan për të qenë misionarët e parë në Kore në korrik të vitit 1863. Gruaja e tij vdiq shumë shpejt pas mbërritjes së tyre. Në vitin 1866, pasi kishte ungjillizuar për disa muaj në Kore dhe pasi kishte mësuar gjuhën e tyre, Tomasi lundroi në anijen amerikane *General Sherman*, përgjatë lumit Taedong në vendndodhjen e kryeqytetit të sotëm të Koresë. Anija ngeci në një dunë rëre. Ushtarët koreanë në breg ishin dyshues dhe të frikësuar, ndaj ata hipën në anije duke vringëllyer thikat.

Kur Tomasi e pa se do të vritej, u nxori një Bibël koreane duke thënë «Jezus, Jezus», Koka iu pre.

Njëzet vjet pas vdekjes së Tomasit, dikush zbuloi një shtëpi pritjeje në këtë zonë me letër muri të çuditshme. Letra kishte shkronja koreane të shtypura. Pronari i shtëpisë shpjegoi se i kishte ngjitur fletët e këtij libri në mur për të ruajtur shkrimin. Pronari dhe shumë mysafirë të tjerë vinin dhe qëndronin për të «lexuar muret», Kjo ishte Bibla që Tomasi u kishte dhënë vrasësve të tij.

Megjithëse sot atë zonë e kontrollojnë komunistët, kisha jeton. Puna e Robert J. Tomas-it i quajtuar «misionari i përkohshëm» – vazhdon në Korenë e Veriut, ku tani Fjala e Zotit nuk është e ngjitur në muret e tyre, por është e fshehur në zemrat e tyre.

Imagjinon të mbillje një kopsht në pranverë dhe të largohesh, në verë. E gjithë koha dhe përpjekjet për të mbjellë, prashitur dhe ujitur farat e domateve, specave dhe bostanëve duket e humbur. E njëjta gjë mund të thuhet për dëshminë tonë për Krishtin. Por këtu, shtyllat janë më të larta se një shportë me domate. Pa përfitimin e të parit të fryteve të punës sonë, mund të jetë e dhimbshme të besosh se puna jonë e vështirë do të vlerësohet dhe respektohet. Mbaj mend, Zoti është ai që i bën gjërat të rriten. Ne duhet të besojmë se Zoti do të vazhdojë punën që kemi filluar – edhe kur na çon tutje. Çfarë kopshti ti duhet të lësh që dikush tjetër ta rritë?

Unë mbolla, Apoli ujiti, po Perëndia i bëri të rriten. Kështu, pra, as ai që mbjell, as ai që ujit, nuk është gjë, por Perëndia që rrit.

1 Korintasve 3:6-7

Qëndrueshmëri ekstreme

PERANDORIA ROMAKE: BLANDINA

Blandina ishte një shërbëtore, e mbushur aq shumë me fuqinë e Zotit, sa edhe ata që e torturuan me radhë natë e ditë, më në fund u dorëzuan. Në fakt, tortura dukej se e bënte besimin e Blandinës më të fortë. Ajo me guxim shpalli besimin e saj duke thënë: «Jam e krishterë; nuk do të kem turp»,

Blandina u persekutua gjatë sundimit të perandorit romak, Mark Aureli Antoni (161-170 ps. K). Gjatë kësaj kohe të krishterët mbanin shënime të përpikta të vuajtjeve të tyre. Ata shpresonin të inkurajonin besimtarë të tjerë, të cilët do të vijonin me histori të vërteta qëndrueshmërie.

Blandina u var në një shtyllë, por duroi, duke shërbyer si inkurajim për ata që ishin dëshmitarë të torturës së saj. Duke qenë se i mbijetoi këtij skenari, e vendosën në një arenë me luanë bashkë me një djalë pesëmbëdhjetë vjeçar të krishterë të quajtur Pontik, i cili u inkurajua prej shembullit të saj. Blandina nuk shfaqti dëshpërim përpara kafshëve, por po «gëzoi dhe ngazëlloi për ikjen e saj sikur të ishte ftuar në një darkë dasme»,

Blandinën e hodhën dy herë para luanëve të uritur, të cilët nuk e prekën. Kështu që ajo u kthye në burg e padëmtuar. Në fakt, ajo u «copëtua» prej luanëve, u fshikullua, u vendos në një rretë dhe u hodh tutje prej një demi të egër e më pas u vendos e zhveshur në një karrige metalike të nxehtë», Por ajo jetoi dhe inkurajoi të gjithë ata që ishin pranë saj për të qëndruar të palëkundur në besimin e tyre. Blandina u vra me shtatë, pasi torturuesit e saj nuk ishin në gjendje ta detyronin të mohonte besimin e saj.

Megjithëse jo të lidhura me dëshminë e krishterë, ka situata nga të cilat s'mund të shpëtojmë, të cilat janë të dhimbshme dhe sfiduese. Rritja e një fëmije të vështirë në shtëpi. Të punuarit përkrah një bashkëpunëtori të vështirë. Patja e vështirësive në jetë. Ka kohë kur mendojmë se s'mund ta përballojmë tensionin dhe tundohemi të dorëzohemi. Nuk ka rëndësi si janë rrethanat, Zoti na jep qëndrueshmëri dhe fuqi për të bërë çfarëdo për të cilën na ka thirrur. Zoti i kërkoi Blandinës të duronte torturat. Ai mund të na nxisë të kërkojmë ndihmë në përkujdesjen tonë prindërore, të përballemi me bashkëpunëtorin tonë ose të ndërmarim disa detyra në dukje, të pamundura. Duke qenë në emrin e Jezusit, ne mund të jemi dëshmitarë të tij. Pavarësisht prej skenarit tonë, Zoti është me ne, duke na dhënë durim dhe madje, edhe gëzim. Ku ke nevojë për durim ekstrem që vjen vetëm prej Zotit tonë të hirshëm?


...që, të forcuar me çdo fuqi si i përgjigjet pushtetit të Hyjnisë së tij, të jeni të fortë e të durueshëm në çdo provë, që me gëzim ta falënderoni Atin, i cili ju bëri të aftë të keni pjesë në trashëgimin e shenjtëve në dritë.

Kolosianëve 1:11-12

FKSTREM

Hajdut ekstrem – pjesa e parë

RUSI: NIKOLAI HAMARA



Nikolai Hamara u arrestua për vjedhje dhe u burgos për dhjetë vjet. Hamara vështronte të krishterët dhe pyeste veten se ç'lloj qeniesh ishin ata. Ata ishin njerëz, por shfaqnin gëzim pavarësisht vuajtjeve të tyre dhe këndonin edhe në kohë shumë të errëta. Kur kishin një fetë buke, e ndanin me dikë që nuk kishte. Fytyrat e tyre shkëlqenin ndërsa flisnin me dikë që Hamara s'mund ta shihte.

Një apo dy të krishterë u ulën me Hamarën dhe e pyetën për historinë e tij. Hamara u tha tregimin e tij të trishtuar dhe përfundoi duke thënë: «Jam një njeri i humbur».


Njëri prej të krishterëve, me një buzëqeshje e pyeti Hamarën: «Nëse dikush humbet një unazë ari, cila është vlera e saj kur humbet?»

«Çfarë pyetje e kotë! Unaza e arit mbetet unazë ari. Ti do ta humbësh dhe dikush tjetër do ta marrë.»

«Përgjigje shumë e mirë, – tha i krishteri. – Tani, më thuaj, cila është vlera e një njeriu të humbur? Njeriu i humbur, madje edhe një hajdut, një shkelës kurore apo një vrasës, ka vlerën e një njeriu. Ai ka aq vlerë, sa Biri i Perëndisë braktisi parajsën për të dhe vdiq në kryq për ta shpëtuar.»

I krishteri i tha hajdutit: «Ti mund të kesh humbur, por dashuria e Zotit për ty mund të të gjejë», Duke dëgjuar këtë, Hamara ia dha jetën Krishtit.

Si mund të matet vlera? Zakonisht nëpërmjet investimit të kohës, parave apo emocioneve të diku. Nga mënyra sesi e trajton një person një pronë, aktivitet, madje edhe një marrëdhënie, zbulon se sa shumë vlerësohet ajo prej atij personi. Konsidero për shembull, ndryshimin midis një veshjeje pune të vjetëruar dhe një kostumi të ri apo kontrastin midis një gote letre dhe një globi kristali. Dhe kur humbet diçka me vlerë, apo një person i dashur lëndohet, ah, sa lot që derdhen! Kështu, sa të vlerësuar janë njerëzit... je ti? Ashtu si të krishterët i thanë Hamarës, se ishte aq i vlefshëm, sa Jezusi la parajsën dhe vdiq në kryq për krijesat e tij të humbura dhe rebele. Zoti i do shumë. Ti je i dashur; je i vlefshëm. Gëzo dhe shpërnda jua këtë Lajm të Mirë të tjerëve pranë teje, që janë njësoj «të dashur».



Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.

Romakëve 5:8

FKSTREM

Hajdut ekstrem – pjesa e dytë

RUSI: NIKOLAI HAMARA

Nikolai Hamara kishte shkuar në burg si hajdut dhe doli i krishterë. Pas lirimit të tij, u bashkua me kishën e fshehtë në Rusi.

Disa kohë më vonë, pastori i kishës së Hamarës u arrestua. Autoritetet e torturuan duke shpresuar se do ta tradhtonte kishën, por ai nuk u tregoi asgjë. Pastaj ata arrestuan Nikolai Hamarën. E sollën para pastorit dhe i thanë: «Nëse nuk tregon sekretet, ne do ta torturojmë Hamarën para teje».

Pastori s'mund ta duronte që dikush të vuante për të, por Hamara i tha: «Qëndro besnik ndaj Krishtit dhe mos e tradhto. Unë jam i lumtur të vuaj për emrin e Krishtit». Pastaj ata i nxorën sytë.

Pastori s'mund ta duronte këtë dhe i thirri Hamarës: «Si mund ta shoh këtë? Do të mbetesh i verbër!»

Hamara u përgjigj: «Kur sytë të më hiqen, do të shoh më tepër bukuri. Do të shoh shpëtimtarin. Ti duhet t'i mbetesh besnik Krishtit deri në fund».

Kur marrësit në pyetje i thanë pastorit se do t'i prisnin gjuhën Hamaras, ky tha: «Lavdi Zotit, Jezu Krisht. Ja, i thashë fjalët më të mëdha që mund të thuhesh dhe nëse doni mund të ma prisni gjuhën». Hajduti i mëparshëm u vodhi oficerëve mundësinë për të vjedhur besimin e tij. Ai vdiq si martir.

Historia e Hamarës është një mësim në krahësimin midis mbretërisë së Zotit dhe mbretërisë së djallit. Bibla na mëson se si t'i njohim ata që vjedhin, vrasin dhe shkatërrojnë si pjesëtarë të mbretërisë së djallit. Në rastin e Hamarës, armiku i vodhi shikimin, i shkatërroi të folurën dhe më në fund e vrau. Në ndryshim nga kjo, mbretëria e Jezusit ka të bëjë me jetën – jetë deri në ekstrem. Si e tillë, Jezusi i dha Hamarës një jetë të re dhe e ktheu nga një hajdut të mëparshëm në një njeri të drejtë. Të dy mbretëritë janë në konflikt dhe jeta jonë është preja. Hamara «dezertoi» në anën tjetër, kur dy besimtarët i treguan se si t'i bashkohej mbretërisë së Perëndisë. Çfarë po bë ti për t'i sjellë të tjerët në mbretërinë e Zotit?

Vjedhësi nuk vjen veçse për të vjedhur, për të vrarë e për të shkatërruar; por unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.

Gjoni 10:10

FKSTREM

Përkthime ekstreme – pjesa e parë

ANGLI: NJË E VE E KRISHTERE

Gjashtë burra dhe një e ve u çuan para një gjyqi se kishin kryer një krim të rëndë kundër kishës katolike në Angli. Ata u kishin mësuar fëmijëve të tyre lutjen e Zotit dhe dhjetë urdhërimet në gjuhën angleze.

Latinishtja ishte e vetmja gjuhë e lejuar për mësim biblik në Angli, në vitin 1519. Megjithatë, njerëzit e zakonshëm flisnin anglisht. Besimtarët përkthenin në fshehtësi pjesë të Shkrimit në anglisht dhe e kalonin përkthimin me kujdes nga njëra shtëpi në tjetrën. Por tani ishin kapur dhe ishin lidhur në shtyllën e turrës së druve ku do të digjeshin publikisht.

Mëshira e gjyqtarëve kishte buzëqeshur vetëm për vejtashën nga të shtatë të burgosurit e tjerë dhe ajo u lejua të largohej. Askush nuk protestoi se ajo ishte e vetme dhe kishte fëmijë për t'u kujdesur në shtëpi.

Një rojë i quajtur Simon Morton ofroi bujarisht që ta shoqëronte gruan e falur në shtëpi. Ndërsa po ecte në krah të saj, ai dëgjoji një fëshfërimë poshtë mëngës së palltos së saj. Ai nxori prej andej përkthimin në anglisht, të njëjtin material që u ishte mësuar fëmijëve. Megjithëse sapo i kishte shpëtuar një dënimi me vdekje, ajo refuzoi më pas të hiqte dorë nga përkthimi, duke besuar se fëmijët e saj kishin akoma nevojë të njihnin të vërtetën e Fjalës së Zotit. Fati i saj ishte i vendosur tashmë.

S'kaloi shumë kohë dhe të gjashtë burrat bashkë me gruan e guximshme u vendosën në shtylla druri dhe u dogjën të gjallë.

Ne jetojmë në një epokë dixhitale të sistemeve të alarmeve të shtëpive që rivalizojnë kompleksitetin e shumicës prej bankave. Çfarë vlerësojmë është e qartë – shtëpitë dhe gjërat tona janë shumë të çmuara për t'i rrezikuar t'i humbasim. Por, për të krishterët që jetonin në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, Shkrimi ishte prona më e vyer. Ashtu si vejusha e palëkundur në këtë histori, ata i konsideronin thjesht disa pjesë të Biblës, të vlefshme për të dhënë jetën e tyre. Ndërsa kohët kanë ndryshuar, vlera e Fjalës së Zotit jo. Jeta jonë akoma duhet t'u tregojë të tjerëve se Fjala e Zotit është e çmuar – megjithëse nuk ka të ngjarë të odesim nëse veprojmë në këtë mënyrë. A e dinë të tjerët sa e vlerëson Shkrimin? A mund ta thonë ata vlerën që Fjala e Zotit ka në jetën tënde?

Ligji yt është më e çmuar se mijëra monedha ari dhe argjendi.

Psalmi 119:72

**Misionarët e krishterë duhet të raportohen
dhe të kërkohen pa lëshuar pe',
sepse janë si ujçerë tinëzarë që shërbejnë si
vegël e imperializmit.**

**NJË PARALAJMËRIM I HAPUR I NXJERRE NGA QEVERIA E
KORESË SË VERIUT POPULLIT TË SAJ.**



FKSTREM

Përkthime ekstreme – pjesa e parë

ANGLI: UILLIAM TINDEIL

«Por, zoti Tindeil, duhet ta pranoni, – u tall mësuesi i ditur i teologjisë, – ata njerëz ndjehen më mirë me ligjet e kishës që kuptojnë sesa me vetë ligjin e Zotit në Bibël!»

Uilliam Tindeili u zemërua me këtë gjë. «Unë i shidoj priftërinjë dhe ligjet e tyre! Nëse Zoti e sheh të përshtatshme të më lejohet të jetoj, atëherë s'do të jetë e largët dita kur çdo djalosh që plugon tokën do t'i njohë shkrimet më mirë se ata!» Vërejtja e tij shkaktoi një mospajtim midis Tindeilit dhe kishës kombëtare. Shumë shpejt ai u largua nga Anglia për në Europë, ku nxori versionin e tij të «jashtëligjshëm» të Dhiatës së Re në anglisht.

Për vite me radhë, Dhiata e Re e Tindeilit transportohej fshehurazi në dengjet e pambukut në bordin e anijeve gjermane dhe në çdo vend tjetër, ku mund të hynin fshehurazi në Angli. Megjithatë, Tindeili u tradhtua nga një «mik», Henri Filips dhe u gjykua për herë.

Ndërsa Uilliam Tindeili qëndroi në burg për më tepër se një vit duke pritur ekzekutimin, besohet se ai përfundoi aty përkthimin e Dhiatës së Vjetër në anglisht. Fjalët e tij të fundit para se të digej në turrën e druve në tetor të vitit 1536 ishin «Zot! Hap sytë e mbretit!»

Dhe Zoti e dëgjoji lutjen e tij. Vetëm një vit pas martirizimit të Tindeilit, monarkia lejoi që Bibla e parë në anglisht të botohej

ligjërisht. Versioni i autorizuar i King James u shfaq shtatëdhjetë e pesë vjet më vonë. Sot versioni i Biblës, King James, përkon afërsisht nëtëdhjetë për qind fjalë për fjalë me punën e Tindeilit.

Kundërshtimi nuk është i njëjtë me dëshitim. Ndonjëherë do të thotë vetëm të kundërtën. Pjesa më e madhe e kolegëve tanë me qëllim të mirë mund të kundërshtojnë ndonjëherë vizionin tonë për shërbesë. Ne mund të habitemi prej kritikës së tyre dhe fillojmë të vëmë në dyshim thirrjen tonë. Kur Zoti na jep një vizion për shërbesë, si i dha edhe Tindeilit, duhet të jemi besnikë ndaj detyrës, pavarësisht nga kundërshtimet. Kritika s'duhet ta shtypë entuziazmin tonë – ajo duhet të na bëjë më të përkushtuar për të përmirësuar vizionin tonë. A të ka dhënë Zoti një vizion për shërbesë? Si Tindeili, ti mund të mos i shohësh rezultatet e punës suaj për pak kohë, ose mund të mos i shohësh fare dhe mund të qortohesh ndërkohë. Por qëndroji besnik detyrës dhe Zoti do të kujdeset për kritikën.

*Sepse për shkakun tënd e mbarta
poshtërimin, turpi ma mbuloi
fjtyrën.*

Psalmi 69:7

FKSTREM

Fëmijë me kurajë ekstreme

KOREJA E VERIUT: ÇENG LI DHE HONG JUN

Komunistët u thonë fëmijëve në Korenë e Veriut se do të kenë fat të tmerrshëm nëse kapen ndonjëherë në Kinë, por fëmijët e dinë se, nëse janë mjaft me fat të arratisen, duhet të kërkojnë një ndërtesë me formën e një kryqi për të gjetur ndihmë. Dy fëmijët koreanë që arritën të shkonin në një kishë kineze, i treguan historitë e tyre pastorit.

«Emri im është Çeng Li. Unë dhe motra ime i pamë prindërit tanë të vdisnin urie. Mundëm të kalonim lumin Jalu, ndërsa ishte akoma i ngrirë. Kur ishte në anën tjetër motra ime e madhe tha: «Ti qëndro këtu, sa të shkoj e të shoh ca më tutje, por nuk u kthye kurrë». Çengu është vetëm gjashtë vjeç.

Hong Jun, një djalë njëmbëdhjetë vjeçar tha: «Dua të kthehem në Korenë e Veriut dhe t'u tregoj të tjerëve për Krishtin». Pastaj qau ndërsa këndonte:

Oh, Zot, na jep zërin e ungjillit,

Për vëllezërit tanë të dashur që Zoti i desh i aq shumë më parë.

Ku kanë shkuar të gjithë këta? Zoti po i kërkon.

Oh, Zot, na dërgo te vëllezërit tanë të dashur koreanë.

Oh, Zot, na dërgo te vëllezërit tanë të dashur koreanë.

Kudo që janë, le të lulëzojnë si lulet.

Disa muaj më vonë, Hong Jung u rrëmbye nga fshati dhe u kthye me forcë në Korenë e Veriut. Ndoshta ende sot ai është duke u dëshmuar rrëmbyesve të tij.

Guximi është një prej atyre gjërave që njerëzit nuk e dinë që e kanë derisa e kanë të nevojshme në një situatë. Në momentin kryesor kur duhet, ata, ose e kanë këtë guxim ose jo. E njëjta mund të thuhet për karakterin – situata të caktuara do të zbulojnë patjetër nëse e kemi ose jo. Si rezultat, karakteri dhe kuraja janë dy gjëra të vështira që të shtiresh. Fatmirësisht, Jezu Krishti na jep një guxim dhe një karakter të pakundërshtueshëm për kohën kur kemi më tepër nevojë. Ne mund të kemi njëfarë kuraje, por vetëm Jezusi mund të na bëjë të guximshëm, mund të kemi një reputacion të shkëlqyer, por vetëm Jezusi mund të na japë karakter për ato kohë kur askush nuk është duke na parë. Ku e sheh karakterin tënd dhe guximin të veprojnë në jetën tënde?

...kur panë çiltërsinë e Pjetrit e të Gjonit., u mrekulluan dhe i njihnin që kishin qenë me Jezusin.

Veprat e Apostujve 4:13

FKSTREM

Një dritë tjetër ekstreme

PAKISTAN: ZAHID

Zahidi ishte një hoxhë nga Pakistani, i cili u ngrinte prita të krishterëve dhe u digjte Biblat. Një herë mbajti një prej Biblave dhe filloi ta studionte për të vërtetuar se krishterimi ishte një gënjeshtër.

«E lexova Biblën, duke kërkuar kontradikta, të cilat të mund t'i përdorja kundër besimit të krishterë. – tha Zahidi. – Krejt papritur, një dritë e madhe u shfaq në dhomën time dhe dëgjova zërin të më thërriste në emër. Drita ndriçoi të gjithë dhomën.

-Zahid, pse më persekuton?» – pyeti zëri.

Isha i frikësuar. Nuk dija ç'të bëja. Pyeta: – Kush je ti?

- Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta.

Drita dhe zëri erdhën edhe pë tre netë të tjera. Natën e katërt, u ula në gjunj dhe pranova Jezusin si shpëtimtarin tim».

Duke qenë se u kthye i krishterë, Zahidi u arrestua dhe u burgos si tradhtar ndaj islamit. Ai u torturua në burg për dy vjet dhe në fakt u dënua me vdekje. Ndërsa laku iu vendos rreth qafës, Zahidi u tha ekzekutuesve të tyre se Jezusi ishte «Rruga e Vërteta dhe Jeta». Ai donte që fryma e tij e fundit të përdorej për të shpëtuar njerëzit e tij.

Pastaj, papritur rojat nxituan për tek ai duke i thënë se ekzekutimi ishte pezulluar dhe Zahidi ishte liruar. Askush nuk e di pse dënimi i Zahidit u kthye, por sot Zahidi vazhdon të udhëtojë në Pakistan si ungjilltar.

Njerëzit që kanë kaluar një përvojë afër vdekjes thonë zakonisht të njëjtën gjë. Ata dalin me përfundimin se Zoti duhet të ketë pasur një qëllim për kohëzgjatjen e jetës së tyre. Fatkeqësisht, intervistat e televizionit rrallë e theksojnë qëllimin e vërtetë! A e zbuluan ata qëllimin e Zotit për jetën e tyre, apo jo? Në fakt, Zoti ka të njëjtin qëllim me jetën tonë. Ai do që ne ta njohim atë dhe t'ua bëjmë të njohur të tjerëve. Disa si Zahidi mund të kalojnë përvojë unike për të ardhur në ato vende të veçanta ku shpallin Zotin. Megjithatë misioni ynë mbetet kryesisht i njëjti. A e ke ndjerë ndonjëherë se Zoti të ka vendosur në këtë tokë për një arsye të veçantë? Kjo është që ta njohim atë dhe t'ua bëjmë të njohur të tjerëve.

Unë jam udha, e vërteta e jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.

Gjoni 14:6

FUQI EKSTREME

ROME: VINSENTI

Litarët në kyçet e tij të duarve dhe të këmbëve u tërhoqën më tej derisa i krishteri romak, Vinsenti, ndjeu që krahët t'i dilnin prej supeve dhe gjymtyrët e poshtme t'i dilnin prej vendit.

Deciu, perandori romak, qëndronte pranë rrotës së torturës ku Vinsenti ishte lidhur.

«Do të vdesësh në dhimbje të tmerrshme», – i tha ai të krishterit të ri.

«Asnjë vdekje nuk është më e ndershme se sa ajo e një martiri. – i tha Vinsenti perandorit me bindje. – Unë shoh parajsën dhe kam neveri për idhujt tuaj.»

I tërbuar nga inati, perandori urdhëroi që i krishteri i gjymtuar të torturohej edhe më shumë, por ata s'mund t'ia hiqnin Vinsentit buzëqeshjen nga fytyra. Përmes dhimbjes ai i tha perandorit: «Ti shkatërron vetëm trupin, i cili gjithsesi do të prishet. Brenda meje jeton një tjetër Vinsent dhe mbi të cilin nuk ke pushtet. Ai Vinsent s'mund të vendoset në rrotën e torturës dhe s'mund të vritet».

Vinsenti e mirëpriti vdekjen me buzëqeshje.

Më në fund, ushtarët romakë e hoqën prej rrotës së torturës, por torturat e tij s'kishin marrë fund. Ata ia grisën rrobat prej trupit dhe e hodhën në dyshemenë e një qelie, e cila ishte e mbuluar me xhama të thyer. Duke mos qenë në gjendje të qëndronte në këmbë, Vinsenti u detyrua të qëndronte shtrirë mbi xhama. Por edhe atje, paqja e Zotit ishte me të. Rojat i raportuan më vonë perandorit se ai qëndroi mbi xhamat e thyer «si në një shtrat lulesh».

Në kulturën moderne, ideja e pushtetit është e lidhur me autoritetin dhe pozitën. Pushteti është i rezervuar për ata në pamje të parë të rëndësishëm, të kulturuar dhe të rafinuar. Megjithatë historia tregon se njerëzit thjesht me një pozitë pushteti nuk janë efektive pa patur një fuqi të brendshme për të zbatuar detyrat e tyre. Në kontrast me këtë, Zoti e nxit fuqinë tonë të brendshme falë pranisë së Frymës së Shenjtë. Vuajtja është shkolla e tij, ku ai na mëson ç'do të thotë të jesh i fortë. Ne jemi në gjendje të durojmë më tepër se ç'imagjinojmë. Jemi me kurajë përtej fuqive tona. Ju mund të ndiheni sikur vuajtjet ju kanë dobësuar. Kërkoji Zotit të të tregojë si të të bëjë më të fortë. Shtrëngo muskujt dhe do të konstatosh se je më të fortë se ç'mendon.

...duke u forcuar me çdo fuqi, pas pushtetit të lavdisë së tij, për çdo ngulm e durim, me gëzim...

Kolosianëve 1:11

USHTARË EKSTREMË

PERANDORIA ROMAKE: DYZET USHTARË BESNIKË

Perandori Kostandin e ligjëroi krishterimin në Perandorinë Romake në vitin 320 pas Krishtit. Megjithatë, Likiniu, i cili kontrollonte gjysmën lindore të perandorisë, e theu aleancën me perëndimin dhe vazhdoi ta shtypte krishterimin.

Kur Likiniu kërkoi që çdo ushtar në komandën e tij t'u kushtonte fli zotave romakë, dyzet burra të krishterë të «Legjionit të Gjëmimit» refuzuan. Gjenerali i tyre, Lisiasi, i fshikulloi me kamxhik, i copëtoi me grepa dhe i burgosi me pranga. Kur ata refuzuan sërish të përkuleshin duke ia drejtuar adhurimin e tyre Zotit, ai i urdhëroi t'u hiqeshin rrobat dhe të liheshin në mes të një liqeni të ngrirë derisa të dorëzoheshin.

Kushdo që do të hiqte dorë nga bindjet e veta, do të shpërbehej me një banjë e ngrohtë. Burrat u lutën së bashku që askush s'do të dorëzohej dhe do të qëndronin dyzet. Megjithatë, ndërsa u errësua, njëri s'mundi të duronte më të ftohtin dhe vrapoi drejt banjës së ngrohtë.

Njëri prej rojave, i cili i kishte mbikëqyrur të dyzet ushtarët t'i këndonin Krishtit, u zemërua që njëri prej tyre do t'u dorëzohej urdhrave të Lisias. Zemërimi i tij u kthye në bindje dhe bindja e tij në besim. Grisi rrobat dhe vrapoi drejt liqenit të akullt, duke përmbushur premtimin e tyre për të qenë «dyzet ushtarë të guximshëm për Krishtin!»

Të dyzet vdiqën së bashku atë ditë, përfshirë edhe atë që hoqi dorë nga besimi i tij për një banjë të ngrohtë.

Komuniteti i krishterë është i përbërë prej disa individëve të përkushtuar, të cilët veprojnë me një mendje. Nëse është një organizatë e krishterë, një shërbesë e krishterë, një kishë apo një familje, grupi i vëllazërisë dhe motërisë është një forcë që duhet marrë parasysh. Ne qëndrojmë më të fortë kur qëndrojmë së bashku. Në mbarë Shkrimin, Zoti na nxit të bashkohemi në një komunitet përkushtimi – një familje besimi. Më tepër se parimi i fuqisë në numër, një komunitet i krishterë inkurajon besimin e anëtarëve të tij. Si kjo histori, të fortit kompensojnë ata që janë të dobët. A e ke identifikuar komunitetin tënd të krishterë? A e ke gjetur kishën, familjen tënde apo qoftë një grup tjetër aleat dhe të dashur, pavarësisht nga çmimi?

Vuaj edhe ti bashkë me mua, si ushtar i mirë i Krishtit Jezus.

2 Timoteut 2:3

FKSTREM

Bukuri ekstreme

LENINGRAD: AIDA SKRIPNIKOVA

«Gjëja më e vështirë në burg, ishte të jetoje pa një Bibël.»

Aida Skripnikova ishte një grua e re dhe e bukur. Ishte vetëm në fillim të të njëzetave kur nisi të shpërndante poema në një qoshe në rrugët e Leningradit, duke deklaruar dashurinë e saj për Jezusin dhe gëzimin e njohjes së tij si Zot dhe Shpëtimtar.

Shumë shpejt ajo u arrestua, por vërtetoi të ishte e vendosur në bindjet e saj, megjithëse u dënua me një vit burg.

Në kohën kur Aida ishte njëzet e shtatë vjeç, u përball me herën e saj të katërt të burgosjes për vendosmërinë për të mbrojtur ungjillin. Ajo kishte mbetur e çiltër, duke thënë në një botim, «Ne s'mund të qëndrojmë në heshtje rreth asaj që përbën gjithë kuptimin e jetës sonë – Krishti».

Qëndrimi i saj i shtatë në burg ishte më i vështiri. Rojat provonin vazhdimisht të korruptonin besimin e saj me gjithçka, që nga abuzimi deri tek ofertat e çokollatave. Por gjëja më e vështirë për të ishte të jetonte pa Fjalën e Zotit. Kopja e saj e shkrimit iu konfiskua. Si dënim, ajo kaloi dhjetë ditë në izolim. Më vonë mori një Dhiatë të re dhe e ruante si diçka më të çmuar se jeta.

Kur më në fund u lirua, Aida zor se njihej – bukuria e saj dallëdisëse ishte venitur dhe dukej shumë më e vjetër. Por dashuria e Zotit ndriçonte përmes buzëqeshjes së saj, duke restauruar bukurinë e pakrahasueshme që buronte nga brenda.

Në shumë dyqane ushqimore, kremrat e bukurisë ia kalojnë në numër primeve të konservuara. Rreshti i kozmetikës është i mbushur me formula që premtojnë të ripërtërijnë dhe të rikthejnë tërheqjen tonë të jashtme. Po sikur ne të ishim të shqetësuar për karakterin tonë të brendshëm, aq sa për paraqitjen tonë të jashtme? Martirët na mësojnë të vlerësojmë ripërtëritjen e asaj që jemi në të vërtetë përbrenda, vetja jonë e brendshme. Ky është personi që asnjë lloj torture s'mund ta trondisë. Ky është ai që po shndërrohet në imazhin e Krishtit. Ti mund të dëshirosh t'u bësh përshtypje të tjerëve sipas standardeve të botës. Megjithatë, Zoti mendon se vetja jote e brendshme është shumë më tërheqëse. A je i fokusuar njësoj në karakterin tënd të brendshëm, ashtu si në pamjen e jashtme? Në çfarë mënyrash është duke u zbukuruar më tepër vetja jote e brendshme me kalimin e moshës?

Stolia juaj të mos jetë e jashtme; gërshetimi i flokëve, stolisja me ar ose veshja me rroba të bukura, por njeriu i fshehur i zemrës, me pastërtinë që nuk prishet të një shpirti të butë dhe të qetë, që ka vlerë të madhe para Perëndisë.

1Pjetrit 3:3-4

**Kërkova forcë –
dhe Zoti më dha vështirësi për të më bërë më
të fortë.**

**Kërkova urtësi –
dhe Zoti më dha probleme për të zgjidhur.**

**Kërkova begati –
dhe Zoti më dha mendje dhe forcë fizike për
të punuar.**

**Kërkova guxim –
dhe Zoti më dha rreziqe për të kapërcyer.**

**Kërkova dashuri –
dhe Zoti më dha mundësi për ta dhuruar.**

**Nuk mora asgjë që doja –
Mora gjithçka që kisha nevojë.**

Lutja ime u plotësua.

«Mësim» ekstrem – pjesa e parë

ANGLI: DR. ROLAND TEILOR

Njerëzit e Hadleit iu lutën dr. Teilorit të mos shkonte të takonte peshkopin e Uinçesterit, kryetar i dhomës së Lordëve. Ata e dinin se peshkopi ishte i zemëruar me mësimet e dr. Teilorit.

Për afërsisht njëzet vjet, Bibla në anglisht ishte shpërndarë ilegalisht në Angli. Dr. Teilori thjesht u kishte mësuar të gjithëve në kishën e tij të lexonin Biblën vetë dhe të ndiqnin mësimet e saj. Në kundërshtim, udhëheqësit nën qeverisjen brutale të mbretëreshës katolike, Meri I, kërkonin besnikëri të rreptë ndaj zakoneve të kishës katolike.

Pasi u fye dhe u akuzua nga peshkopi, Rolandi u përgjigj: «Unë jam i krishterë. Nuk kam blasfemuar kundër kishës. Në fakt sipas akuzës suaj, heretikët jeni ju. Krishti vdiq një herë për të gjithë mëkatet e njerëzimit. Është e mjaftueshme. Ju dhe traditat tuaja s'mund të ofroni asgjë më tepër».

Për dy vitet që pasuan, dr. Teilori u mbajt i burgosur. Kur mësoi se do të digjej në turrën e druve jashtë Hadleit, kërcëu nga gëzimi. Ai nuk ishte i shqetësuar për sigurinë e tij. Përkundrazi, gëzonte prej mendimit se do të udhëtonte përmes Hadleit, ku do të mund të shihte përsëri motrat dhe vëllezërit e tij në besim.

Dr. Roland Teilor u martirizua në dimër të vitit 1555.

Dashuria flitet në shumë gjuhë të ndryshme. Njerëzit kanë nevojë ta dëgjojnë dashurinë në gjuhën e tyre që të mund ta njohin. Disa bashkëshortë u shërbejnë grave mëngjesin në shtrat për të treguar dashurinë e tyre. Akoma të tjera kanë nevojë për një dhuratë të menduar, me qëllim që ta dëgjojnë qartë dhe fort «Të dua». Kompanitë e kartolinave përshëndetëse shpresojnë ta shprehim me fjalë. Megjithatë, Jezusi thotë se gjuha e tij e dashurisë është bindja. Ja si ia shprehim dashurinë atij. Kur i bindemi atij, ne tregojmë se e duam. Teilori u martirizua sepse u mësoi ndjekësve të tij të flisnin gjuhën e dashurisë së Jezusit. Ai u mësoi të lexonin Biblën dhe t'u bindeshin mësimet e saj. Tregoji Jezusit që e do dhe nderon sot kujtimin e dr. Teilorit.

Jezusi u përgjigj dhe i tha: «Nëse ndokush më do, do ta zbatojë fjalën time».

Gjoni 14:23

«Mësim ekstrem» – pjesa e dytë

ANGLI: DR. ROLAND TEILOR

Para se të digjej në turrën e druve për mësimin e Biblës, dr. Roland Teilor shkroi këto fjalë të bukura:

«I them gruas sime dhe fëmijëve të mi: Zoti më dha dhe Zoti po më merr prej jush dhe ju prej meje: Bekuar qoftë emri i Zotit! Ai ka qenë më besnik dhe më i mirë se çdo bashkëshort apo baba. Besoni në të me anë të meritës së Shpëtimtarit tonë të dashur: Besojini, duajeni, kini frikë dhe bindjuni atij. Lutjuni sepse ai ka premtuar t'ju ndihmojë. Mos më quani të vdekur, sepse do të jetoj në përjetësi dhe nuk do të vdes kurrë. Unë do të shkoj më parë dhe ju do të më ndiqni më pas në shtëpinë tonë të përjetshme.

Unë ju them juve, miqve të mi të dashur të Hadleit dhe të gjithë atyre që më kanë dëgjuar të predikoj, që po nisem prej këtej me ndërgjegje të qetë përsa u përket mësimëve të mia, për të cilat lutem të falënderoni Zotin me mua, sepse kam shpërndarë librin e Zotit, Biblën e bekuar. Kështu që, nëse unë apo ndonjë engjëll prej qiellit do t'ju predikojë ndonjë ungjill tjetër përveç atij që keni marrë, mallkimi i madh i Zotit qoftë mbi atë predikues!

Duke u nisur prej këtej me shpresë të sigurt, pa ndonjë dyshim për shpëtimin e përjetshëm, falënderoj Perëndinë, Atin tim qiellor, nëpërmjet Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tim të sigurt.»

Roland Teilor

Ruaji urdhërimet e mia dhe ke për të jetuar; ruaji mësimet e mia si bebja e syve të tu.

Fjalët e urta 7:2

A mund ta kujtoni mësuesin më të paharruar të fëmijërisë? Ndoshta për shkak të parfumit që përdorte. Ndoshta për shkak të mënyrë së veçantë si prekte pjesën qerose të kokës. Diçka e veçantë për personin të mbetet ndërmend. Megjithatë kur rritemi, i vlerësojmë mësuesit për arsye të ndryshme. Ne kujtojmë çfarë na kanë mësuar – mësimet që s'do t'i harrojmë kurrë. Do të kujtojmë gjithnjë atë që na mësoi i pari Fjalën e Zotit. Ne s'mund të harrojmë të vërtetat bazë që mësuesit na treguan për dashurinë e Zotit dhe shpëtimin e tij. Kur dikush tjetër vjen në emër të një zbuluese apo studimi akademik, të vërtetat e Zotit do të të mbrojnë dhe do të të ndihmojnë të njohësh mashtrimin. Ato janë më tepër se thjesht kujtime, janë pasuria jote më e vlefshme.

FKSTREM

Familje ekstreme

KAMBOXHA: HAIMI DHE FAMILJA E TIJ

Në xhunglën e Kamboxhas, Haimit dhe familjes së tij u kishin dhënë nga një lopatë dhe u kishin thënë të gërmonin vetë varret e tyre. Ata ishin pengje të kmerëve të kuq, të cilët i konsideronin të krishterët «armiç të revolucionit të lavdishëm».

Ushtarët lejuan Haimin dhe familjen e tij të gjunjëzoheshin, të bashkonin duart së bashku dhe të luteshin. Atëherë Haimi nxiti ushtarët të pendoheshin dhe të pranonin Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tyre. Ushtarët u habitën nga dhembshuria në zërin e tij pikërisht përballë vdekjes.

Ndërsa ai fliste, njëri prej bijve të tij u shkëput dhe u arratis në pyll. Ushtarët u nisën pas tij, por Haimi i ndaloi. Qetësia e tij i bindi komunistët të shihin çfarë do të bënte.

Ndërsa familja e tij ishte në gjunj me armët e ushtarëve mbi kokë, Haimi ndali në prag të pyllit. «Bir, a mundet që vjedhja e disa ditëve më tepër prej jetës si i arratisur të krahasohet me bashkimin me familjen tënde rreth një varri, por shumë shpejt të lirë në parajsë me Krishtin?» Pas një çasti, u dëgjua një fëshfëritje shkurresh ndërsa djali i Haimit doli i përplotur dhe u përgjunj me të atin e tij.

Haimi pa drejt ushtarëve, «Tani jemi gati të shkojmë».

Por asnjë prej ushtarëve s'mundi të tërhiqte këmbëzën. Vetëm pas pak erdhi një oficer, i cili nuk e kishte parë kthimin e djalit, dhe, pasi i quajti ushtarët frikacakë, i vrau të krishterët.

Disa familje njihen se janë jashtëzakonisht të lidhur, të tjerë krenohen se janë jashtëzakonisht të pasur, por familje të tjera theksojnë përpjekjet e tyre për të qenë të rëndësishëm. Ndërsa Zoti mund të përdorë edhe këto gjëra, koncepti i tij i ndikimit është shumë ndryshe. Çfarë e bën një familje të dobishme në mbretërinë e Zotit? Bindja ekstreme. Nuk është përmasa e minifurgonit të familjes që ka rëndësi; është përkushtimi i tyre ndaj Krishtit. Zoti e krijoi familjen si një vend ku prindërit udhëheqin me anë të shembullit, me qëllim që fëmijët të mësojnë si t'i binden Krishtit. Ndërsa skenari i Haimit ishte unik, ne mund të jemi po aq të bindur në situatat tona. Si do ta karakterizoje ti përkushtimin e familjes sate? Cila familje është shembull i një familjeje ekstreme?

Sepse kushdo që bën vullnetin e Perëndisë, ai është vëllai im, motra dhe nëna ime!

Marku 3:35

FKSTREM

Përdorim ekstrem i gënjeshtreve

RUSI: NJË STUDENT UNIVERSITETI

Një profesor që s'besonte në Zot i buzëqeshi fotografisë së Leninit të varur përkrah derës dhe shkoi drejt kanës me ujë që qëndronte në tavolinë. Ai nxori një paketë me një lloj pluhuri dhe ndërsa e hidhte me ngadalë në të, uji u bë i kuq.

«Kjo është e gjithë mrekullia, – filloi ai mësimin e tij. – Jezusi kishte fshehur në mëngën e tij një pluhur si ky dhe pastaj pretendoi të kishte shndërruar ujin në verë në mënyrë të mrekullueshme. Por unë mund ta bëj më mirë se Jezusi; unë mund ta shndëroj verën në ujë përsëri.»

Ai nxori një paketë tjetër me pluhur dhe e hodhi në lëngun e kuq. Ai u bë i qartë. Me një paketë tjetër u bë përsëri i kuq.

Njëri prej studentëve u ul në bangën e tij duke tundur kokën, i pantesuar.

Më në fund e sfidoi profesorin: «Ju na keni habitur, shoku profesor. Ne ju kërkojmë vetëm një gjë tjetër – pijeni verën tuaj!»

Profesori qeshi mbyturazi dhe tha: «Këtë s'mund ta bëj. Pluhuri është helm».

I krishteri iu përgjigj: «Ky është i gjithë ndryshimi midis jush dhe Jezusit. Ai, me verën e tij na ka dhënë gëzim, ndërsa ju na helmoni». Profesori doli me zemërim prej dhomës, e arrestoi studentin dhe e rrsi në burg, por lajmi i incidentit u përhap shumë larg dhe fuqizoi shumë vetë në besimin e tyre.

Premtimi i armikut për një shkëmbim të lehtë është gënjeshtër. Pjesa më e madhe e dyqaneve kanë një politikë kthimi miqësore ndaj përdoruesit, e cila lejon klientët të shkëmbejnë blerjet e tyre me qëllim që të kënaqen. Njerëzit qëndrojnë në radhë për të shkëmbyer një masë të vogël për një më të madhe, ose një ngjyrë për një tjetër me shpresë se ajo do t'i bëjë të duken më të dobët, më të bukur apo thjesht, më të lumtur. Në të njëjtën mënyrë shumë njerëz në jetë qëndrojnë në radhë, me të vërtetën e Zotit në dorë. Atyre u thuhet të shkëmbejnë të vërtetën e Zotit me çdo gjë dhe ajo do t'i bëjë klientë të kënaqur. Ne gjithnjë përfundojmë të zhgënjyer në fund. Zoti do që ti të shohësh përtej gënjeshtreve të armikut. Kapu fort pas së vërtetës së Zotit – me çdo kusht.


*Ata e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë
në gënjeshtër.*

Romakëve 1:25

FKSTREM

Përgjërëm ekstrem

INDONEZI: DELORES



Trupi i moshuar i Deloresit ishte i kapitur prej vrapit, ndaj ajo s'i mbajti dot lotët: «Zot, të lutem, ki mëshirë për ne, fëmijët e tu!» Deloresi po arratisej për të shpëtuar jetën bashkë me besimtarë të tjerë, ndërsa sulmuesit bombarduan me artilieri mbi fshatin e saj. Duke përdorur shkopin e saj të pagdhendur, ajo u ngjiti hap pas hapi në një shpat të thepisur mali derisa arriti në një vendndodhje të sigurt. Ajo u vendos në një kamp refugjatësh të improvizuar midis qindra të tjerëve, të cilët ishin shpërngulur prej dhunës.

Deloresi është vetëm një prej miliona të krishterëve që jetojnë në Indonezi – një komb i përbërë prej më tepër se trembëdhjetë mijë ishujsh. Indonezia është gjithashtu, shteti më i populluar në botë nga myslimanët, por myslimanët dhe të krishterët kanë ditur të jetonin së bashku në paqe prej brezash të tërë. Megjithatë, sot ata ndeshen me një armik të ri: grupet fanatike myslimane kanë nxitur shumë xhihade (luftëra të shenjta) në ishujt.

Ndaj sot nuk mund të flitet për paqe midis myslimanëve dhe të krishterëve.

Në një qytet, të krishterët u mblodhën në zyrën e guvernatorit në një demonstratë paqësore të çështjes së Krishtit dhe kënduan «Unë i dorëzoj të gjitha». Ata u lutën që qeveria të njihte se sa të krishterë ishin masakruar në duart e militantëve myslimanë. Por, ndërsa trupi i qetë i besimtarëve vazhdoi të këndonte, forcat myslimane sulmuan një fshat tjetër dhe e shkretuan atë. Shumë komunitete që më parë lulëzonin. tani janë kthyer në pirgje hiri dhe gurësh.

Deloresi është vetëm njëra prej një grupi të madh besimtarësh në Indonezi, të cilët i thërrasin Zotit për çlirim. Zbulesa flet për një numër të madh martirësh, të cilët kërkojnë gjykimin dhe drejtësinë e Zotit. Megjithatë, nuk duhet të jenë vetëm ata që thërrasin. Ne duhet t'i bashkojmë zërat bashkë me përgjërimet e tyre më të zjarra. Edhe pse mund të jemi shumë larg në shtëpitë tona të rehatshme, mbështetja jonë e sinqertë është vetëm një lutje larg. Kur ofrojmë lutjet tona për siguri dhe çlirim, bashkojmë zemrat tona me ata që janë duke vuajtur. A do të lutesh sot për Deloresin dhe besimtarë të tjerë në Indonezi? A do t'i kërkoesh Zotit t'i mbrojë ata në udhëtimin e tyre dhe të dëgjojë lutjet tona për çlirim?

Deri kur, o Zotërues i shenjtë e i drejtë, do të vonosh të bësh drejtësi e ta shpaguash gjakun tonë mbi banuesit e tokës?

Zbulesa 6:10

Lutje ekstreme

EKSTREM

ZVICËR: MIKAEL SATLER

Mikael Satleri nuk u habit nga dënimi i tij – t'i pritej gjuha dhe pastaj të digjej si heretik. Ishte shekulli i gjashtëmbëdhjetë dhe Mikaeli ishte anabaptist, një lëvizje besimtarësh, të cilët donin t'i ktheheshin formës së kishës në Dhiatën e Re. Megjithatë, institucionet sociale dhe fetare të Evropës i shihnin anabaptistët si kërcënim.

Një turmë kureshtarësh filluan të mbli-dheshin në sheshin e tregut. Njëri prej të pranishmëve ishte njëzet e pesë vjeçari Klaus fon Grafenek, i cili i qëndroi afër të dënuarit, duke parë ekzekutuesin të përgatitej për vdekjen e sigurt të Mikaelit.

Mikaeli filloi të lutej, pavarësisht të folurës së tij të paqartë: «I dashur Zot, hapi sytë këtij të riu...»

Klasi papritur u spraps i tronditur që ky kriminel po lutej për të!

Ndërsa xhelati e lidhi Mikaelin, i burgosuri u kthye nga turma dhe me të folur të paqartë tha: «U kthefshi në besim!» Pastaj ai mbylli sytë dhe u lut: «Zot i gjithëpushtetshëm, Zot i përjetshëm... unë... në këtë ditë do të dëshmoj të vërtetën dhe do ta vulos me gjakun tim».

Me të thënë këtë, xhelati e hodhi Mikaelin në zjarr. Kur litarët e duarve u dogjën, ai i ngriti lart dhe u lut: «At, unë e dorëzoj shpirtin tim në duart e tua».

Klasi u prek aq shumë nga lutja e të dënuarit për të, sa vdekjen e Satlerit e kujton me nderim. Ai përfundoi duke shkruar: «Zoti na dhëntë mundësinë që të dëshmojmë për të, po aq me guxim dhe durim».

...Lutja është arma sekrete e të krishterit. Ajo bën një deklaratë të heshtur ose një përçapje të hapur për besimin e dikujt në Krishtin. Kur Klaus i dëgjoi lutjen e të dënuarit, ndaloi të mendonte. Në të njëjtën mënyrë, kur të tjerët në restorant na shohin ta falënderojmë Zotin për ushqimin para se të hamë, ne gjithashtu, mund t'i bëjmë ata të ndalojnë e të konsiderojnë Zotin. Madje, edhe kur kapim mendimet e njerëzve për një moment të vetëm dhe i kthejmë mendjet e tyre drejt Krishtit, ne e kemi bërë detyrën tonë. Ashtu si Mikaeli e provoi me Klausin, lutja ndryshon jetë dhe frymëzon përkushtim. Megjithatë, Zoti s'mund të përdorë lutjet që s'ofron. Kalo pak kohë për të ofruar një lutje të heshtur për të mirën e dikujt që ke takuar sot. Asnjëherë s'e di ç'mund të ndodhë si rezultat i saj.

*duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj
lutjeje dhe përgjërimi në Frymë..*

Efesianëve 6:18

Fjala «misionar» nuk ndodhet në Bibël – fjala «dëshmitar» po.

XHIM ELIOT, MISIONAR NË EKUADOR, I CILI U MARTIRIZUA NDËRSA
PËRPIQEJ T'I SILLTE UNGJILLIN FISIT INDIAN AUKA – CITUAR NGA
ELIZABET ELIOTI NE *NJERËZIT E EGËR, TË AFËRMIT E MI.*



Dorëshkrim ekstrem

ITALI: EUSEBIU

«Persekutimi i madh» filloi në Romë në vitin 303 pas Krishtit nën Dioklecian. Kjo ishte një periudhë kohe kur Diokleciani nxori një dekret kundër krishterimit me përpjekjen për të shkatërruar besimin. Midis rregullave të detajuara ishin urdhrat e mëposhtëm:

Të krishterët, të cilët kishin pozita publike duhet të shkarkoheshin;

Të gjitha akuzat kundër të krishterëve duhet të mirëpriteshin dhe të pranoheshin;

Të krishterët duhet të torturoheshin për besimin e tyre;

Shkrimet duhet të konfiskoheshin dhe të digjeshin menjëherë;

Ndërtesat e kishave duhet të shkatërroheshin;

Të drejtat qytetare të një të krishterit duhet të mohoheshin me forcë dhe kryetarët, peshkopët e drejtuesit e kishave duhet të arrestoheshin me qëllim që t'u sakrifikonin zotave.

Gjatë kësaj kohe, një shkrimtar i ri i quajtur Eusebiusi, dokumentoi krimet e kryera kundër kishës së hershme. Një drejtues kishe dhe teolog i quajtur Pamfili e frymëzoi së tepërmi. Pamfili u arrestua dhe u torturua në vitin 308 pas Krishtit, por pasi kishte patur një ndikim të madh në jetën e Eusebiut.

Eusebiusi shkroi: «Ne i pamë me sytë tanë shtëpitë e lutjes të shembura në themele... Shkrimet e frymëzuara dhe të Shenjta të hedhura në zjarr... dhe pastorët e kishave, disa për turp duke u fshehur sa andej-këndej»,

Ekzekutimi i Pamfilit në vitin 309 pas Krishtit nuk e pengoi Eusebiun të shkruante dorëshkrimin *Historia e Kishës*.

Eusebiu u arrestua më vonë për kontributin e tij ndaj çështjes së krishterë. Megjithatë, jeta iu kursye. Zoti e mbrojti, që ai të mund të vazhdonte t'i shkruante mesazhin e tij kishës së ardhme. Shkrimet e tij u hapën sytë brezave të mëvonshëm për trazirat me të cilat u përball kisha e hershme. Regjistrimi i jetës së tij dhe vdekja e një trashëgimie drejtuesish të krishterë na kujton trashëgiminë e madhe të heronjve të krishterë. Nëse mund të mësojmë sot prej besimit të guximshëm dhe dashurisë së pavdekshme të etërve tanë, të cilët u përkushtuan, shkrimet nuk janë të pavlera. Çfarë po bën sot që të mund të frymëzojë brezin tjetër drejt një përkushtimi më të madh? Kërkoji Zotit të të ndihmojë të lësh trashëgiminë tënde.

*Për drejtësinë e tij do t'i tregohet popullit
që vjen »Kështu bëri Zoti!«.*

Psalmi 22:31

Një burrë dhe gruaja e tij arritën në vendin e pasur me naftë të Arabisë Saudite prej një vendi tjetër.

Ata jetuan dhe punuan në shtetin mysliman, të cilin e quanin shtëpinë e tyre të re. Në fakt, takoheshin dhe adhuronin me punëtorë të tjerë të huaj, të cilët ndanin besimin e tyre – krishterimin. Megjithatë, praktikimi i krishterimit në kryeqytetin shpirtëror të Muhamedit, jo vetëm që s'është i njohur, por është gjithashtu ilegal. Por edhe kështu, çifti pranoi rrezikun e burgimit, dëbimit dhe vdekjes së mundshme, me qëllim që të vazhdonin me besnikëri adhurimin e tyre.

Ata jetuan për shumë vite në paqe. Megjithatë, një ditë anëtarët e policisë sekrete të Arabisë Saudite bastisën shtëpinë e tyre. Ata u çuan në stacionin e policisë për t'u marrë në pyetje për orientimin e tyre fetar dhe kompjuteri, ku ata mbanin kontaktet informative me të krishterët e tjerë lokalë, iu konfiskua. Frika e tyre e vetme ishte që shumë shpejt, edhe të tjerët do të uanin të njëjtin fat.

Bashkëshorti mbeti në burg, por gruaja e tij u lirua për mungesë provash. Ajo u bëri disa apele qeverive të jashtme për të ndihmuar që ta nxirrnin të shoqin të pafajshëm dhe të lirohej nga burgu. U mbështet tek ata që kërkonin liri, por sërish, shtetet e tjera nuk kishin dëshirë të ndërhyjnë në situatën e saj. E lanë në baltë me dyshimin, nëse do ta shihte sërish bashkëshortin e saj. Rasti i tyre është njëri prej persekutimeve të fshehta kundër krishterimit në shtetin mysliman të Arabisë Saudite. Por përsëri, e vërteta do të njihet një ditë.

Sipas raporteve, Arabia Saudite është një vend me shkallën më të lartë të ekzekutimeve në botë. Në vitin 1999, Arabia Saudite shpenzoi më shumë se 1000 000 dollarë në firmat e marrëdhënieve publike për të siguruar fshehtësinë e abuzimeve të të drejtave të njeriut. Por përsëri, ato s'mund të mbeten sekret përgjithmonë. Ne duhet të lutemi që zërat e të krishterëve në burgjet e Arabisë Saudite të dëgjohen dhe të marrin përgjigje gjatë jetës sonë. Ne e dimë se kur të kthehet Krishti, asnjë firmë e marrëdhënieve publike s'do të jetë në gjendje t'i mbrojë ata prej gjyqimit. Por, po sot? Lutja është hapi i parë në drejtim të sjelljes së një ndryshimi. Nuk është sekret – kundërshtari është i fuqishëm. Megjithatë, Zoti është më i fuqishëm. Çfarë po bën ti për të mbledhur fuqinë e tij në emër të atyre që janë në burg?

Sepse nuk ka asgjë të fshehtë që nuk do të zbulohet, as sekret që të mos njihet dhe të dalë në dritë.

Luka 8:17

FKSTREM

Mosbindje ekstreme

PERANDORIA ROMAKE: LEGJIONI TEBAN

Në vitin 286 pas Krishtit perandori Maksim urdhëroi që 6.666 burra të legjionit Teban të marshonin për në Gaul dhe të ndihmonin kundër rebelëve të Burgundit. Çdo anëtar i këtij divizioni ishte i krishterë i përkushtuar.

Pasi bënë një udhëtim të vështirë përmes Alpeve, Maksimi kërkoi një sakrificë të përgjithshme para se të shkonin në betejë. Secili burrë në legjionin Teban refuzoi të çnderonte Zotin. Perandori u zemërua nga mosbindja e tyre, kështu që kërkoi t'i bindte duke vrarë me shpatë çdo person të dhjetë. Por legjionistët nuk ishin më pak të vendosur në qëndrimin e tyre. Perandori u përpoq të ndryshonte pozicionin e tyre duke i çuar përsëri ushtarët në radhë e duke vrarë çdo person të dhjetë. Këta burra vdiqën me dinjitet duke qëndruar si para një beteje, por kjo masakër e dytë nuk ishte më efektive se e para.

Sikur të mos kishte ndodhur gjë, ushtarët e mbetur ishin më të vendosur se kurrë të rezistonin pas masakrës së shokëve të tyre. Duke mos dashur të vdisnin dhe me drejtimin e oficerit të tyre, ata hartuan një kontratë nënshtrimi ndaj perandorit ku deklaruan se besimi dhe përkushtimi i tyre ndaj Zotit i bënte më besnikë ndaj perandorit. Ata kishin shpresuar se kjo do ta qetësonte perandorin, por ajo pati efekt të kundërt. I tërbuar nga inati, ai urdhëroi që pjesa tjetër e legjionit nga Teba, të vritej.

Mosbindja është fyerja më e lartë ushtarake. Por përsëri, legjioni Teban nuk kishte zgjedhje tjetër, sepse të mos i bindeshin Zotit do të kishte qenë një krim akoma dhe më i madh. Njerëzit qeverisin me autoritet, megjithatë vetëm Zoti ka autoritet. Bibla na jep shembuj se si njerëzit e Zotit vendosën të shkelin autoritetin njerëzor kur ai ishte në konflikt me urdhrin e Zotit. Ki parasyshti mamitë hebreje dhe gjithashtu prindërit e Moisiut, të cilët nuk iu bindën urdhrave të Faraonit. Mendo për Danielin dhe miqtë e tij, të cilët refuzuan t'u shërbenin perëndive të huaja. Shembujt e tyre dhe të këtyre ushtarëve të guximshëm na kujtojnë se kemi për detyrë të njohim autoritetin njerëzor. Por përsëri, ne duhet të respektojmë mbi të gjitha autoritetin e Zotit. Kur urdhrat njerëzorë janë në konflikt të drejtpërdrejtë me urdhërimet e Zotit, ti duhet të konsiderosh rrezikun e mosbindjes.

Por Pjetri dhe Gjoni, duke iu përgjigjur atyre, thanë: «Gjykoni ju, nëse është e drejtë para Perëndisë, të të bindemi më shumë juve sesa Perëndisë».

Veprat e Apostujve 4:19

Sebastiani ecte çdo ditë përmes korridoreve të pallatit. Ai kishte punuar shumë për të marrë këtë pozicion në rojat mbretërore, por kur arriti në Romë, e kufizoi veten prej stilit idhujtar të jetës së perandorisë romake. Ai donte vetëm t'i shërbente Krishtit me gjithë zemër.

Kur perandori Dioklecian dëgjoi për këtë kufizim, s'pati interes për shërbimin e tij. E ballafaqoi atë dhe zbuloi rreth besimit të tij. Për këtë, ai urdhëroi që Sebastiani të nxirrej jashtë qytetit dhe të qëllohej me shigjeta për vdekje. Ushtarët bënë punën e tyre dhe e lanë trupin të kalbej. Shumë shpejt një grup të krishterësh erdhën për t'i bërë një varrim të përshtatshëm.

Ndërsa e ngritën, njëri prej tyre thirri: «Ai po lëviz!».

«Shsht! – paralajmëroi dikush. – Le ta çojmë në një vend të sigurt».

Sebastiani u çua në njërin prej shtëpive të tyre ku u trajtua dhe u shërua nga dëmtimet. Sapo u bë mirë, doli përsëri para perandorit. Një herë ai e kishte shijuar shpresën e qiellit, kënaqësitë e kësaj bote ishin edhe më pak tërheqëse për të.

Sigurisht që perandori u trondit kur pa Sebastianin, në pamje të parë, të kthyer prej së vdekurish. Ai urdhëroi që Sebastiani të kapej, të rrihej për vdekje dhe trupi i tij të hidhej në kanalet e ujërave të zeza. Trupi i tij u mor përsëri nga të krishterët dhe u varros në katakombe.

Imoraliteti seksual, gjuha e pahijshme, vjedhja, gënjeshtria, mashtrimi. Shumë të krishterë e përcaktojnë veten ekskluzivisht nga ajo që nuk bëjnë. Sigurisht, ka një sërë veprimtarish që Zoti i ndalon njerëzit e tij t'i praktikojnë. Megjithatë, kufizimi nuk është i dobishëm në vetvete. Sebastiani nuk u martirizua thjesht për kufizimet e tij – përndryshe ai do të ishte vrarë thjesht sepse ishte njeri i mirë. Ai u martirizua për besimin e tij të sinqertë. Në të njëjtën mënyrë ne duhet të kufizohemi ose të sprapsem nga e keqja me qëllim që të përqafojmë plotësisht urdhërimet e Zotit. Bindu, adhuro, duani, shërbe. Përkufizojeni besimin tënd nga ato që bën, jo thjesht nga ato që s'bën. A njohësh ti, thjesht se je një person i mirë, një person i mirë pa një besim të shprehur?

Kam përmbajtur hapat e mia nga çdo shteg i keq, për të respektuar fjalën tënde.

Psalmi 119:101

FKSTREM

Liri ekstreme

MORAVIA: PAUL GLOK

Paul Gloku ishte në gjendje të vështirë. Ishte burgosur për besimet e tij anabaptiste dhe roja i kishte dhënë pak liri, sepse kishte premtuar të mos arratisesh. Ai lejohej të mblidhte dru, të riparonte këpucë, të bënte punë të rëndomta dhe të kryente ndonjë porosi, por duhej të largohej kur afroheshin të huaj, kështu që drejtuesit fetarë nuk do të merrnin vesh për lirinë e tij.

Pauli u habit nga liria e tij. Roja e tij, Klaus fon Grafenek, kishte dëshmuar martirizimin e një tjetër anabaptisti, Mikael Satler, në vitin 1527. Si një spektator i rastit, ai u mposht kur Satleri u lut për të, pikërisht para se të ekzekutohej. Kjo kishte ndodhur para njëzet e pesë vjetësh dhe ndoshta Klaus kishte një vend të butë në zemrën e tij ndaj anabaptistëve padrejtësisht të persekutuar.

Pauli s'kishte ç'të humbiste. Gruaja dhe fëmija e tij tashmë kishin vdekur; ai kishte vetëm bashkëvëllezërit e tij në Moravia, por nuk do t'i dorëzohej tundimit për t'u arratisur. Nëse do të largohej, Klaus, i cili kishte qenë aq i mirë me të, do të ishte në rrezik të tmerrshëm ligjor dhe të burgosurit e ardhshëm në atë zonë do të mbikëqyreshin rreptë. Pauli vendosi të ishte njeri i fjalës.

Zoti e nderoi më vonë vendimin e tij. Në vitin 1576, në kështjellën ku ai mbahej, ra zjarr. Ai dhe një i burgosur tjetër ndihmuan të shuanin flakët dhe kështu fituan lirinë para se drejtuesit fetarë, të cilët ishin kundërshtarët e tij të fortë, të mund ta anulonin.

Historitë e burgimeve të martirëve nuk janë tema për filmat hollivudianë, ku personazhe naivë gërmojnë tunele dhe bëjnë kalime sekrete për t'u arratisur. Komploti nuk varet se si do të shpëtojë i burgosuri nga rreziku. Në fakt, ashtu si Paul Gloku, martirët nuk u arratisën, madje edhe kur e patën mundësinë për të vepruar kështu. Historitë e tyre njehsojnë çdo situatë për lavdinë e Zotit, pavarësisht rrethanave. Ki parasysht si Pali dhe Sila drejtuan rojën e burgut dhe familjen e tij tek Krishti, sepse ata vendosën të mos arratiseshin nga burgu. A je i shqetësuar për të gjetur një rrugë për të dalë nga telashet e tua? Po sikur të jesh saktësisht atje ku Zoti do që të jesh? Ndoshta Zoti do që të durosh, në vend që të largohesh.

[Rojtari i burgut] pasi i çoi [Palin dhe Silën] në shtëpinë e vet, ua shtroi tryezën dhe u gëzua me gjithë familjen e tij që kishte besuar në Perëndinë.

Veprat e Apostujve 16:34

Fuqia e letrës nuk vinte prej vargut të vetëm të fjalëve: «Ndalo së predikuari myslimanëve», Metoda e dorëzimit pati ndikimin më të madh; ishte ngjitur në trupin e gjakosur të një studenti të një kolegji biblik i quajtur Sheraz. Letra dhe trupi i Sherazit u hodhën në portën kryesore të kishës së tij afër Lahores, Pakistan.

Sherazi nuk kishte ndjekur këshillën e letrës. Ai kishte predikuar kudo që shkonte për dashurinë e Shpëtimtarit, i cili kishte vdekur për mëkatet e tij. U kishte predikuar punëtorëve në fabrikën ku punonte, në shkollën e tij biblike dhe familjes së tij.

Një javë më vonë, Sherazi ishte duke punuar në fabrikë në ndihmë të familjes dhe tri motrave të tij, kur hyri në diskutim me disa myslimanë me të cilët punonte. Ata u zemëruan dhe punëtorët e tjerë dëshmuuan për një diskutim të nxehtë. Ishte hera e fundit që dikush e pa Sherazin të gjallë.

Sherazi e dinte rrezikun. Shumë të tjerë në Pakistan janë vrarë, sepse kanë treguar për besimin e tyre. Të tjerët janë akuzuar për blasfemi dhe i kanë mbyllur në burgje. Por mesazhi i ungjillit ishte tejmase i mirë dhe Sherazi s'mund ta mbante për vete.

Madje as anëtarët e kishës së tij nuk do të ndiqnin këshillën e letrës. Ata vazhduan t'u predikonin myslimanëve, duke u ofruar dashurinë e Jezusit të skllavëruarve nga zemërimi dhe frika e islamit. Ata e dinin rrezikun, por kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë, edhe t'i ndiqte shembulli i Sherazit.

Dëshmia e sinqertë është më efektive.. Ne nuk na duhet të mbajmë mend përmendësh rëndësinë teologjike të pendesës për t'u treguar të tjerëve se Jezusi sjell ndryshim në jetët tona. Gjithçka që kërkon Jezusi është të dëshmojmë çfarë kemi parë dhe dëgjuar me sytë dhe veshët tanë. Përvoja jonë personale është argumenti më i fuqishëm për besimin në Jezu Krisht. Askush s'mund ta kundërshtojë atë, sepse na ka ndodhur neve. A ngurron të ndash besimin tënd? A ke frikë se do të thuash gjënë e gabuar apo do të pengohesh nga pyetjet e dikujt? Thjesht thuaj çfarë di të jetë e vërtetë. Përvoja jote personale ju bën një dëshmitar ekspert në çështjen e krishterimit.

Sepse ne s'mund të mos flasim për ato që kemi parë dhe dëgjuar.

Veprat e Apostujve 4:20

**Jezusi tha se ne duhet të shkonim.
Ai nuk tha kurrë se do të ktheheshim.**

I PANJOHUR



FKSTREM

Shtypje ekstreme

ARABIA SAUDITE: TË KRISHTERË TË PERSEKUTUAR

«Ndodhet emri im në listë?» Pyetja ishte në mendjen e çdo të krishteri në Jedah, Arabia Saudite, pasi policia fetare bastisi shtëpinë e një të krishteri dhe konfiskoi një kompjuter personal me informacion për të krishterët në zonë. «A do të trokasim herën tjetër në derën time?»

Prabhu Isaku ishte i pari që priti një vizitë nga *mutaua* apo ndryshe policia fetare. Isaku ishte qytetar i Indisë, por në Arabinë Saudite është e paligjshme të shpallësh çdo besim, përveç islamit. Madje, edhe shfaqja e kryqit është krim. *Mutaua* ishte e shqetësuar se qytetarët e Arabisë Saudite po bashkëvepronin vazhdimisht me të krishterët. Ata refuzuan ta lejonin Isakun të hynte në konsullatën e shtetit të tij, pavarësisht nga kërkesat e ligjit ndërkombëtar. Policia mori në pyetje edhe gruan e tij dhe e paralajmëruan të mos kishte kontakt të jashtëm.

Një besimatar tjetër, Eskinder Menghis, u arrestua pasi emri i tij u gjend në kompjuterin e Isakut. Uilfredo Kaliuag ishte tjetri. Shumë shpejt pas arrestimit të tij, Kaliuagu u çua në spital, i raportuar për trajtim nga një «goditje vape», Megjithatë, vizitorët thanë se trupi i Kaliuagut ishte i mavijosur dhe i dërrmuar, *njësoj* sikur policia ta kishte keqtrajtuar.

Arabia Saudite është e mbyllur për ungjillin, por të krishterë të guximshëm që kanë zënë punë në shtetin mysliman kanë filluar të mbjellin fara besimi te miqtë dhe bashkëpunëtorët. Puna është e vështirë dhe rreziqet janë të mëdha, por lajmi i mirë është duke rritur mbretërinë.

Të krishterët në Arabinë Saudite kanë frikë se emrat e tyre mund të jenë në listën e masave të rrepta të policisë fetare. Por, para se kompjuterat e tyre të konfiskoheshin dhe emrat e tyre të renditeshin si shënjestër, emrat e tyre u shfaqën në një listë tjetër, më të rëndësishme. Bibla na mëson se ndodhet një «Libër i Jetës» në qiell që rendit emër pas emri besimtarët. Ata, emrat e të cilëve janë shkruar në Librin e Jetës, do të shpëtohen. Ata, emrat e të cilëve nuk gjenden, do të humbasin përjetësisht. Nëse ti e ke pranuar Jezun Krishtin si Shpëtimtar, le të të shënohet emri nga çdo formë kundërshtimi pa frikë. A je renditur ti me Krishtin një herë e përgjithmonë?

Unë nuk do ta fshij emrin e tij nga libri i jetës, por do ta rrëfej përpara Atit tim dhe para engjëjve të tij.

Zbulesa 3:5

FKSTREM

Dënim ekstrem

AFGANISTAN: PUNONJËSIT E NDIHMËS NGA JASHTË

Taliban. Emri i qeverisë radikale islamike të Afganistanit është tani i njohur në mbarë botën. Praktikimi i krishterimit ka qenë gjithmonë një krim në këtë komb të shtypur, të drejtuar nga Talibanët.

Ata nuk i donin fëmijët, vendosi qeveria afgane. Ata donin etërit e tyre. Fëmijët, të cilëve mendohej se u mësohej rreth krishterimit, arrestoheshin. Grupe të huaja, të cilët lejoheshin në këtë shtet për të shpërndarë ndihma humanitare, sollën edhe libra dhe materiale të krishtera. Në shumë shtete, ndihma humanitare është e vetmja derë e hapur ndaj ungjillit. Megjithatë, s'kaloi shumë dhe qeveria i konfiskoi materialet.

Qeveria vendosi që nuk duhet të fajësoheshin fëmijët se u ishin nënshtruar mësimëve, por prindërit e tyre që nuk i kishin drejtuar e nuk ishin kujdesur për fëmijët e tyre. «Arrestimet duhet të jenë mësim për prindërit që duhet të ruajnë fëmijët dhe të dinë se çfarë po bëhet me ta», – tha ministri në fuqi për promovimin e virtyteve dhe parandalimin e vesit.

Vërejtjet e zyrtarit erdhën pasi tetë punonjës të ndihmës nga jashtë ishin arrestuar në gusht të vitit 2001 bashkë me një numër afganësh, të cilët kishin punuar për organizata të krishtera. Në nëntor të vitit 2001, të huajt u gjykuan për predikimin e Jezu Krishtit myslimanëve, një akuzë që mund të sillte dënimin me vdekje. Punonjësit

afganë u përballën me mundësinë për t'u kthyer në islam. Ata do të gjykoheshin si femohues. Edhe ata mund të përballeshin me dënimin me vdekje.

Të paktën dy prej punëtorëve janë të krishterë amerikanë, historia e të cilëve është një dënim i padrejtë, me përmasat e një tragjedie. Megjithatë, çfarë duket si tragjedi mund të kthehet për qëllimet më të mëdha të Perëndisë. Shihni thjesht jetën e Jezusit. Në dukje, vdekja e Jezusit, dukej të ishte gjëja më e keqe që mund të ndodhte. Shërbesa e tij dukej se kishte marrë fund. Megjithatë, Perëndia e përdori dënimin e tij të padrejtë, që të na sillte shpëtimin. Në njëjtën mënyrë, fakti që këta punëtorë janë gati të përballen me dënimin me vdekje me qëllim që t'u sjellin të tjerëve Lajmin e Mirë, është dëgjuar në mbarë botën, duke sjellë shumë vetë në besimin te Krishti dhe duke frymëzuar besimtarë të tjerë. A je duke vuajtur nën rrethana të padrejta? Perëndia di t'i përdorë situata të tilla për të mirën tonë.

*..ndëshkimi, peng paqeje për ne,
peshoi mbi Të.*

Isaia 53:5

«Shpella» ekstreme

RUMANI: SHENIA KOMAROV

Qeni u turr duke tërhequr zinxhirin me dhëmbët e tij të ligj. «Kape!» – ulëriti padroni i tij, roja i burgut, kapiten Nudni.

«Zot, ki mëshirë!» – thirri Shenia Komarov, i burgosuri i krishterë. Ai e dinte që qentë e egër rojë kishin vrarë shumë të burgosur, ndaj u lut që Zoti ta shpëtonte.

Qeni i madh gjerman u turr në drejtim të tij, por papritur ndaloi. Ai u mbloodh nga frika, duke refuzuar ta kafshonte të krishterën. Nudni urdhëroi qenin të turrej dhe ta kafshonte, por ai nuk e sulmonte Komarovin.

Të burgosurve nuk u jepej pothuajse asgjë për të ngrënë dhe kur Komarovi, me përlësi kishte kërkuar pak më tepër ushqim, kërkesa e tij kishte nxitur zemërimin e Nudnit.

Ditë më vonë, Komarovi u lut: «Zot, më është sosur durimi për shkak të urisë, përbuzjes dhe fatkeqësisë. Të lutem, jepi fund gjithçkaje. Të mund të vdes dhe të gjej çlodhje, përndryshe bëj një mrekulli si bëre për Elian».

Menjëherë, Nudni u afrua me nxitim – por këtë herë pa qenin e tij. Komarovi mendoi se Zoti i ishte përgjigjur lutjes së tij dhe se shumë shpejt do të vdiste. Përkundrazi, udhëheqësi i rojave e çoi të krishterën në kuzhinë ku i dha supë dhe bukë për të ngrënë. I siguroi edhe ushqim për të burgosurit e tjerë të krishterë.

«Më fal që të dërgova qenin për të të sulmuar, – i tha Nudni të krishterit. – Ndihem në siklet tani».

Komarovi e fali rojën dhe falënderoi Zotin për mrekullinë e tij.

Shumë njerëz mund ta lidhin këtë me historinë e Danielit dhe të shpellës së luanëve. Rrethanat e tyre më të ashpra i ngjajnë fatit torturues që Danieli mendohej të vuante në duart e të ligut. Historia e Danielit ishte me fitore. Ai u ngrit mbi rrethanat e tij të tmerrshme, sepse i besoi Zotit për ta shpëtuar. Në të njëjtën mënyrë, ne mund të vendosemi në rrethana – disa, madje edhe jetë – kërcënuese – të cilat ndodhen jashtë kontrollit tonë. Zoti mund të na shpëtojë nga realiteti frikësues dhe të na japë paqen e tij. Ne duhet thjesht t'i besojmë atij për t'u marrë me «shpellën» tonë të problemeve. Me çfarë situatë frikësuese po përballësh? Kërkoji Zotit të të japë ndjenjën e pranisë së tij mbrojtëse. Besoji atij të të çlirojë të sigurt përmes provave të tua.

Perëndia im dërgoi engjëllin e vet e ua mbylli gojë të luanëve. Nuk më bënë asnjë të keqe, sepse u gjenda para Tij se jam i drejtë. Por as para teje, o mbret, nuk bëra asnjë faj.

Danieli 6:22

«Bashkëbisedime» ekstreme

INDONEZI: VAJZA E VOGËL E KRISHTERE

Uji i ftohtë spërkati turmën para xhamisë së fshatit indonezian. Luftëtarët e xhihadit, të pajisur me armë dhe të veshur me të bardha, rrethuan vendin. Larja rituale ishte një përgatitje e detyrueshme që grupi të kthehej në islamizëm. Turma e dinte që, ose do të ktheheshin ose do të qëlloheshin, më keq, do t'u hiqej koka në vend.

Vajza e vogël qante për besimin e saj, sepse imagjinonte që rituali i larjes do t'i kthente besimin. Ajo nuk e dinte që besimi i saj te Krishti ishte në shpirt, pavarësisht se çfarë i ndodhte trupit të saj. Ajo qante edhe nga frika, sepse e dinte që do të rrethpritej, bashkë me burrat, gratë dhe fëmijët e tjerë në grup. Rrethprerja e detyruar është akti i tyre final i marrjes së një feje të re. Ajo nuk e donte fenë e re dhe i thirri Zotit.

Indonezia ka qenë parajsë tolerance. Megjithëse është shtëpia e më tepër myslimanëve se në çdo vend tjetër në botë, ka pasur shumë pak probleme. Myslimanët, të krishterët dhe budistët jetonin krah për krah, duke punuar së bashku pa armiqësi.

Tashmë ka ndryshuar. Myslimanët radikalë e kanë tërhequr vendin drejt xhahadit apo ndryshe luftës së shenjtë dhe çdo i krishterë është një shënjestër. Shumë recitojnë kredon myslimane vetëm për të shpëtuar jetën; por në zemrat e tyre ata i thërrasin Zotit, duke ditur se vetëm ai mund të ofrojë shpëtim.

Njerëzit përpiqen të na ndryshojnë nga jashtë – brenda, por vetëm Zoti mund të na ndryshojë nga brenda – jashtë. Para se të vinim te Krishti, ne shpesh përpiqeshim t'u përshtateshim standardeve të botës për jetën tonë dhe të humbisnim veten tonë të vërtetë. Ne detyrohemi të bëhemi njerëz që s'duhet të ishim. Megjithatë, kur Zoti i ndryshon njerëzit nga brenda jashtë, ata ndryshojnë përgjithmonë. Ne s'mund të ndryshohemi, s'mund të kthehemi më në veten e vjetër. Ashtu si e zbuloi edhe vajza në këtë histori, të tjerët mund të ndikojnë dhe të ushtrojnë njëfarë kontrolli mbi ne, por s'mund të na ndryshojnë si Jezusi ka bërë tashmë me ne. A e ke përjetuar «ndryshimin» për të cilin mësohet në Bibël?

Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni... ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiellit.

Mateu 18:3

FKSTREM

Mirësjellje ekstreme

RUSI: PIOTRI

Rrugës për në Emaus, Shpëtimtari i ringjallur eci bashkë me dy dishepuj, duke folur me ta për ngjarjet e fundit në Jeruzalem. Megjithëse nuk e njohën, ai bisedoi me ta për planin e Perëndisë për Mesinë. Kur arritën në qytetin e tyre, Jezusi bëri sikur po vazhdonte udhën. Pse? A nuk donte ai të qëndronte dhe të vazhdonte bashkëbisedimin?

Për Piotrin, një besimtar rus, veprimet e Jezusit tregonin mirësjellje. Ai nuk donte të qëndronte nëse s'ishite vërtet e nevojshme. Piotri kishte parë komunistët të pushtonin vendin e tij. Policia shpërthente shtëpitë e njerëzve me kohë e pa kohë. Më në fund, një i krishterë i tregoi Piotrit për historinë e Shpëtimtarit, i cili trokiste lehtë në zemrën e tij, duke pritur të lejohej të hynte. Piotrit i bëri përshtypje ky Jezus i mirësjellshëm dhe me dëshirë e hapi derën. Jezusi u bë Shpëtimtari dhe Zoti i Piotrit.

Piotri e dinte kuptimin e kthimit, ai kishte ndryshuar. Zoti e dërgoi si punëtor në kishën e fshehtë. Këtu mësoi prej shembullit të të tjerëve. Të krishterët e rritur i treguan si të zhvillonte dëshminë dhe të ushtronte besimin e tij. Shumë shpejt, Piotri bëri udhëtime të panumërta duke sjellë fshehurazi literaturë të krishterë në Rusi. Ai u bë gjithnjë e më shumë i guximshëm. Ishte i nxitur për t'u bërë jo vetëm thjesht një dishepull, por dishepull veprues, duke sjellë të tjerë te Krishti.

Më në fund, u arrestua dhe u burgos. Askush nuk e di se çfarë ndodhi me të.

Pastori rumun, Riçard Vurmbrandi, një herë ka thënë: «Ne s'duhet të ndalojmë asnjëherë kur kemi fituar një njeri për Krishtin. Me këtë ne kemi bërë vetëm gjysmën e punës. Çdo njeri i fituar për Krishtin duhet të bëhet një fitues njerëzish». Rusët, jo vetëm që u kthyen në besim, por u bënë 'misionarë' në kishën e fshehtë. Ata ishin moskokëçarës dhe të guximshëm për Krishtin...» Si mundet një person si Piotri të rritet, nga të qenit i shpëtuar në të shpëtuar të tjerët? Njësoj, ashtu si dikush i tregoi Piotrit si të bëhej i krishterë, dikush tjetër i tregoi si të rritej në besimin e tij. Njerëzit duhet të mësohen si të jenë më tepër për Krishtin. A është besimi yt në rritje një shembull për të tjerët? Zoti të thërret për të qenë dishepull, ashtu edhe dishepull veprues.

Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

2 Pjetrit 3:18

FKSTREM

Kujtime ekstreme

KUBË: TOM UAIT

Para se avioni i tyre i vogël të përplasej në ishullin e izoluar të Kubës, Tomi dhe piloti i tij kishin kaluar muaj duke lëshuar trakte ungjilli, duke mos e ditur kurrë nëse kubanët ishin përgjigjur. Tani, i dënuar me njëzet e katër vjet në burgun e Kombinado Del Este, Tomi dëgjoji drejtpërdrejt rrëfimin e kushteve të kishës kubane. Ishte shumë e gjallë!

Ai e quajti nder të ishte në burg bashkë me shumë të krishterë që kishte takuar. Megjithatë, kapiten Santosi vendosi ta fuste atë në një qeli të ngrirë izolimi. Përpijekja ishte për të qëndruar pozitiv dhe për të ruajtur zemrën e tij të mos ftohej ashtu si qelia.

Gjumi ishte i pamundur sepse dyshemeja ishte shumë e ftohtë. E vetmja mënyrë për të pushuar ishte duke qëndruar një këmbë larg murit të betonit dhe të mbështeste ballin në të.

Ndërsa luftonte betejën mendore kundër dorëzimit, ai këndoi himne dhe këngë. I mbledhi të gjitha forcat dhe u fokusua në fuqinë e vëllezërve të tij në burg. Ata e kishin inkurajuar duke i thënë se luteshin për të. Madje iu bënë mbështetje shumë dëshmi frymëzuese që i mbante mend nga një libër që e ëma ia kishte dhënë kur kishte qenë ende shumë i ri.

Tomi ishte në gjendje të mbijetonte në atë kohë të vështirë për shkak të shoqërisë që fitoi nga kujtimi i atij libri. Titulli i librit? «Libri i Martirëve nga Foksi».

Kur dikush tjetër ka kaluar nëpër të njëjtat sprova përpara nesh, në njëfarë mënyre na bën ta marrim më lehtë. Quhet fuqia e historisë personale. Duke lexuar përvojën e dikujt tjetër na ndihmon ta vendosim situatën tonë në perspektivë. Herë-herë ne mund ta gjejmë veten në versionin tonë të izolimit të Tomit. Mund të jemi duke kaluar gjithçka krejt vetëm. Gjatë këtyre kohëve të vetmuara, shoqëruarit më të mirë mund të jenë historitë e besimtarëve të tjerë të guximshëm. Martirët dhe biografitë e të krishterëve të tjerë mund të na sigurojnë, të na inkurajojnë dhe të na sfidojnë si miq të një mishi e gjaku. A po kaloni vështirësi? Largoje vetminë tënde me historitë e motrave dhe vëllezërve të tua të krishterë. Merr fuqi sot dhe shpresë për nesër.

Ngushëlloni, pra, njëri-tjetrin me këto fjalë.

1 Selanikasve 4:18

Më tepër persekutim – më tepër rritje!

CITIMI I PREFERUAR I PASTOR SAMUEL LAMBIT – NJË PASTOR
I NJË KISHE-SHTËPI NË KINË, I CILI KALOI NJËZET E PESË VJET NË
BURG PËR BESIMIN E TIJ



FKSTREM

Një misionar tjetër ekstrem

INDI: EIMI KARMAJKËLL

Në 24 tetor të vitit 1931, Eimi Karmajkëll u lut: «Zot, të lutem, bëj me mua çfarë të duash. Bëj çdo gjë që do të më ndihmojë të të shërbej ty më mirë». Si misionare në Indi dhe nënë shpirtërore e shumë fëmijëve indianë, të cilët i kishte shpëtuar nga prostituimi në tempujt paganë, Eimi ishte mësuar duke u lutur dhe duke ia besuar Zotit pasojat.

Më vonë atë ditë, ajo ra, ndrydhi kyçin e këmbës dhe theu këmbën. Për shkak të komplikacioneve, Eimi mbeti e gjymtuar dhe i kaloi njëzet vjetët e ardhshme e izoluar në dhomën e saj.

Por ajo s'e kalonte kohën duke u qarë për kushtet në të cilat ndodhej. Ajo i përqendroi energjitë e saj drejt shkrimit dhe inkurajimit të shenjtorëve rreth botës. Dërgoi mijëra letra nga shtrati i saj, ishte autorja e trembëdhjetë librave, gjithashtu shkroi edhe poezi të bukura.

A nuk keni ju ndonjë plagë?

Asnjë plagë? Asnjë shenjë?

Por, ashtu si i Zoti edhe shërbëtori do të jetë,

dhe të shpuara janë këmbët që më ndjekin

Mua;

Por të tuajat janë të plota: a mund ta kenë ndjekur larg

Kush nuk ka asnjë plagë, apo shenjë?

Nga *Fllade Malore* nga Eimi Karmajkëll. 1999, Bashkësia Dohnavur. Botuar nga Fushata e Literaturës së Krishterë, Fort Uashington, PA. E përdorur me leje.

Emi u gjymtua, por plagët e saj e sollën më pranë Zotit. Ajo eci në bashkësi të ëmbël me një Shpëtimtar, të cilin e kishte kuptuar më mirë për shkak të shenjës së saj. Njerëzit që kanë kaluar një tragjedi të veçantë, lidhen me njëri-tjetrin dhe ndiejnë një lidhje të menjëhershme. Ata që vijnë nga familje të divorcuara lidhen me njëri-tjetrin në një mënyrë që të tjerët s'munden. E njëjta është e vërtetë edhe për Krishtin. Kur ne vuajmë, lidhemi me Jezusin në një nivel krejt ndryshe. Ne e ndiejmë që ai nesh lëndimet tona dhe në njëfarë mënyre kemi një kuptim më të qartë të lëndimeve të tij. Çfarë po i mësojnë plagët e tua për Jezusin? A po i lejon ato të të tërheqin në një marrëdhënie më intime me të?

Perëndia çliron të pikëlluarit me anë të pikëllimit të tyre dhe u hap veshët me anë të fatkeqësisë.

Jobi 36:15

FKSTREM

Kod ekstrem

RUMANI: PASTOR RIÇARD VURMBRAND

I vetëm në qelinë e tij të nëndheshme, pastori iu ankua Zotit: «Ti thua se jep diellin dhe shiun për të mirin dhe të keqin. Pra, cila është? A jam unë i miri, apo i keqi?»

Zoti i tha zemrës së tij: «Ti je diçka krejt tjetër – një fëmijë i Perëndisë. Një fëmijë i Perëndisë nuk pret diellin apo shiun. Ai duhet të jetë dhënës i diellit. Ti je drita në një botë të errët, peandaj jep dritë. Në vend që të ankohesh për ato që s'ke, pse nuk jep? Ka kaq shumë njerëz rreth teje në qelitë e tjera».

Pastor Vurmbrandi u lut: «E si t'ia çoj shpëtimin dikujt kur jam i vetëm në qeli?»

«Mendoje vetë.»

Riçard Vurmbrandit i erdhi një ide, i ra murit e sigurisht që dëgjoi të rëna në kthim. Pastaj vazhdoi t'u mësonte të burgosurve në anën tjetër kodin Mors. Në fakt ata ishin në gjendje të komunikonin me efikasitet dhe Riçardi filloi t'u predikonte ungjillin. Të tjerët me radhë bënë të njëjtën gjë me ata në qelitë ngjitur.

Qëndrimi i tij i ri e lejoi Zotin ta kthente një situatë, në pamje të parë të pashpresë, në një metodë efikase për shpërndarjen e ungjillit në të gjithë burgun.

Vite më vonë, Riçardi dëgjoi dikë të dëshmonte se në një burg rumun, një tjetër i burgosur ngjitur me qelinë e tij e kishte fituar atë për Krishtin duke i rënë murit.

Të përballesh me faktet mund të jetë punë e vështirë. Kur pastor Vurmbrandi vlerësoi situatën e tij, faktet nuk dukeshin të mira. Megjithatë, vuajtjet e tij e çuan drejt një zbulimi të ri. Ai e kuptoi se qëndrimi i një personi ishte më i rëndësishëm se faktet. I armatosur me një qëndrim të një shprese të përtërirë, ai filloi të riolerëonte faktet. Ai s'mund të fliste, por mund të përdorte kodin Mors. Ai madje, mundi të ndante edhe ungjillin – dashurinë e tij të vërtetë. Kur rrethanat na vijnë kundër, ne duhet t'u kushtojmë vëmendje qëndrimeve tona, duhet të jemi të përgatitur për vuajtje, siç ishte Krishti, por duhet ta vendosim që kjo s'do të na mposhtë. Do të mbijetojmë. A u kushton më tepër vëmendje fakteve, apo je person i besimit?

Sepse, duke qenë se Krishti ka vuajtur për ne në mish, armatosuni dhe ju me të njëjtin mendim...

1 Pjetrit 4:1

Punë ekstreme

VIETNAMEZI I VERIUT: VËLLA DA

Vëlla Daja ishte anëtar besnik i Partisë Komuniste në Vietnamin e Veriut kur dëgjoji për herë të parë programet e krishtera në radion e tij me valë të shkurtra. Në fillim, ai i refuzoi idetë si besëtytni të kota, por pas dy muajsh dëgjimi, s'mund t'i rezistonte më Krishtit. Ishte i ngazëllyer për dashurinë e tij për Zotin dhe kjo dukej se i mbushte zemrën. Shumë shpejt ai fitoi të afërmit e tij për Krishtin.

Por ngazëllimi i tij ishte jetëshkurtër. Më 29 dhjetor të 1998, policia vietnameze, e zemëruar prej veprimtarisë ungjillizuese të Dasë, bastisi shtëpinë e tij dhe nën tytën e armëve e nxorën jashtë. Gruaja dhe katër fëmijët vetëm mund të shihnin ndërsa e çonin në një kamp burgu.

Në kampin e punës së ndërtuar mizorisht, Daja detyrohej të punonte në fabrikën e tullave. Kjo do të thoshte që të mbante dy mijë tulla çdo ditë. Nëse Daja nuk plotësonte normën e tij, rrihej brutalisht. Pikërisht kur mendonte se s'mund të vazhdonte më punën, ai u lirua, në 15 tetor të vitit 2000.

Përsëri nën arrest shtëpie, Danë e urdhëruan të ndalonte së ndari besimin e tij duke e paralajmëruar: «Ti sapo je kthyer nga një kamp pune. A do të kthehesh përsëri? Mendo me kujdes».

Por Daja i ishte përkushtuar «punës së dashurisë» për Zotin, ndaj e vazhdoi punën e tij për ndarjen e Krishtit me njerëzit rreth tij. Asnjë punë fizike – madje edhe mbajtja e dy mijë tullave në ditë s'mund ta lëkundte atë.

Pak njerëz do ta pranonin se pëlqejnë të shkojnë në punë çdo ditë. Për disa, puna është një e keqe e domosdoshme. Megjithatë, ata që punojnë si dëshmitarë të Zotit kanë një mendim të ndryshëm. Puna e Zotit nuk është asnjëherë e mërziqshme. Por ne jemi gjithnjë në kohë, duke punuar vazhdimisht për të përparuar ungjillin kudo. Ai na jep energji për detyrën e çastit dhe qëndrueshmërinë kur vijnë kohët e vështira. Pse punojnë kaq shumë të krishterët? A ka të bëjë me pagesën, me bonuset, shpërblimet apo përfitime të tjera? Jo, dashuria na motivon të japim gjithë veten tonë në shërbim të Zotit. Nëse e do Krishtin, do të punosh me kënaqësi për të. Çfarë të ka thirrur ai për të bërë sot në shërbim të tij?

Duke kujtuar vazhdimisht veprën tuaj të besimit, mundimin e dashurisë suaj dhe qëndrueshmërinë e shpresës në Zotin tonë, Jezu Krishtin...

1 Selanikasve 1:3

FKSTREM

Kërkesë ekstreme

KOREJA E VERIUT: NJË MISIONAR VIZITOR

Kur djali në hotel më në fund e dalloj «biznesmenin» vizitor, vrapoi drejt tij dhe e kapi prej dore. Vizitori i habitur u përpoq të largohej, por shumë shpejt e kuptoi që djali në heshtje po bënte shenjën e kryqit me gisht në pëllëmbën e dorës. Burri, një misionar, i cili ishte lutur që të krijonte kontakt me kishën, pa drejt fytyrës së imët të djalit dhe e kuptoi menjëherë mesazhin, «Kisha është e gjallë në Kore!»

Të nesërmen, misionari u takua fshehurazi me djalin. Ai mësoi se i ati i tij ishte një i krishter, i cili ishte burgosur vite më parë. Familja e djalit kishte vuajtur shumë nën qeverinë mizore dhe atij i duhej të lypte për ushqim vetëm për të mbijetuar. Tani, për shkak të thatësisrës, njerëzit kudo po vdisnin nga të mosushqyerit.

Kur misionari pyeti se çfarë mund të bënte, ai mendoi se djali do të kërkonte ushqim për familjen e tij, por i kërkoi vetëm katër gjëra; të merrte të dhjetat e tij të kursyera prej shumë vitesh, ta pagëzonte, t'i jepte darkën e Zotit dhe një Bibël më të mirë.

Burri u prek kur e kuptoi urtësinë e djalit. Ndihma fizike do t'i shërbente atij vetëm për një a dy ditë dhe pastaj do të kthehej në të njëjtën gjendje të vështirë. Ndihma shpirtërore do ta përgatiste për përjetësinë.

Të duash dhe të kesh nevojë për diçka janë dy gjëra krejt të kundërta për pjesën më të madhe të njerëzve. Ajo që duan nuk është ajo për të cilën kanë nevojë. Por, ajo që u nevojitet më tepër, nuk është ajo që duan. Ja pse kaq shumë njerëz janë të shqetësuar. Djali në këtë histori na mëson se çfarë ndodh kur gjithçka që duam përshtatet me nevojat tona. Ai kishte të drejtë. Donte pikërisht atë për të cilën kishte më tepër nevojë: Jezu Krishtin. Kur gjithçka që ti dëshiron është gjithçka për të cilën ke nevojë, do të gjesh kënaqësi të madhe. Ju mund të thuash se do para, por shumë shpejt do të konstatosh se paratë plotësojnë vetëm disa nevoja. Mund të kesh nevojë për para, por shumë shpejt do të duash edhe gjëra të tjera. Vetëm Jezusi mund të plotësojë dëshirat dhe nevojat njëkohësisht.

Dhe Perëndia im do të plotësojë çdo nevojë tuajën me begatinë e vet, për mrekulli, nëpër Jezu Krishtin.

Filipianëve 4:19

Qëndrim ekstrem

NIGERIA: SARATU TURUNDU

«Unë nuk do të arratisem. Jam gati të mbaj një qëndrim».

Saratu Turundu ishte tridhjetë e pesë vjeç dhe e pamartuar. Ajo i donte fëmijët aq shumë dhe dëshironte me gjithë zemër një të vetin, por Zoti nuk i ishte përgjigjur lutjes së saj.

Saratuja vendosi t'ia përkushtonte veten Perëndisë dhe kishës. Ajo përqafoi familjen e saj të kishës me gjithë zemër dhe veçanërisht, pëlqente shumë të jepte mësim në shkollën e së dielës. Bashkëveprimi i saj me fëmijët dhe mundësia e saj për t'u treguar atyre rrugën drejt Krishtit e mbushte Saratunë me gëzim të papërshkrueshëm. Ajo e dinte se nuk do të ishte asnjëherë e lumtur pa Krishtin.

Por myslimanët fanatikë, të cilët dominonin qytetin e Kadunas, Nigeri, filluan të persekutonin të krishterët. Ajo kishte dëgjuar histori të të krishterëve që persekutoheshin në fshatra të tjerë, shtëpitë dhe pronat e tyre të digjeshin. Disa madje, ishin rrahur dhe u vrrarë.

Kështu, kur turma erdhi për të sulmuar të krishterët në Kaduna, Saratuja e kishte vendosur tashmë të qëndronte dhe të mbante qëndrim për Krishtin. Vëllezërit e Saratusë iu lutën të largohej nëpër pyje me ta, por edhe pse shihte turmën e zemëruar të digjte kishën e saj të dashur, ajo nuk u largua. U gjunjëzua dhe u lut në dyshtim të

apartamentit të saj, ndërsa myslimanët lagën ndërtesën me gazolinë dhe i vunë zjarrin.

Ajo mbahet mend nga familja si një person i mirë dhe i dhembshur, që i shfaqte dashuri kujdto. Ajo vdiq duke e dashur Shpëtimtarin e saj.

Përrallat për fuqi mbinjerëzore janë po aq frymëzuese, sa edhe të pabesueshme. Ne mahnitemi nga historitë e nënave që ngrenë makinat që po digjen, për të shpëtuar fëmijët e tyre në aksidente të tmerrshme. I shtyrë nga adrenalina, trupi njerëzor është i aftë për bëma mahnitëse. Në të njëjtën mënyrë si adrenalina ndikon muskujt njerëzorë, besimi ynë mund të mundësojë muskujt tanë shpirtërorë të kryejnë atë që ne s'e kemi menduar kurrë të mundur. Saratuja forcoi muskujt e saj shpirtërorë kur vendosi të mbante një qëndrim për Krishtin në komunitetin e saj. Ajo ka të ngjarë të mos e ketë kuptuar kurrë se kishte mundësi për ta bërë deri në atë moment, por Zoti e aftësoi për ta bërë këtë. A ke bërë diçka që ke menduar se s'mund ta bëje kurrë më parë? Falëndero Zotin sot për besnikërinë e tij për të të bërë të qëndrosh të fortë.

... Ai do të qëndrojë sepse Perëndia është i zoti ta bëjë të qëndrojë në këmbë.

Romakëve 14:4

FKSTREM

Hakmarrje ekstreme

SPANJE: BARTOLOME MARKEZ

«Ju lutem, merrni hak!»...

Lexuesit e letrës nga martiri spanjoll, Bartolome Markez, u tronditën kur panë një thirrje për hakmarrje në letrën e tij të fundit. Pastaj panë se thirrja nuk ishte për gjakderdhje njerëzore për të marrë hak për të, por që më tepër njerëz të vinin nën gjakun e Jezusit.

«Ju lutem të merrni hak të krishterë duke u përpjekur t'u bëni mirë atyre që më bëjnë të keqen», – sfidoi Markezi besimtarët e tjerë. «Shpresoj t'ju shoh atje ku do të jem së shpejti, në qiell.»

Komunistët spanjollë e vranë Markezin, bashkë me shumë pastorë të tjerë në vitin 1939. Letra e tij e fundit ishte një letër gëzimi drejtuar gruas së tij dhe motrave dhe vëllezërve të krishterë.

«Për disa orë, do të njoh gëzimin e pashprehshëm të të bekuarve. Sa e lehtë është vdekja e atyre të persekutuar për hir të Krishtit! Zoti më jep një nder të pamërituar: të vdes duke gëzuar hirin e tij.»

»Për aq kohë sa zemra ime rreh, – i shkroi ai nuses së tij, – do të rrahë me dashuri për ty. Kur u dënova për mbrojtjen e idealeve të larta të fesë, atdheut dhe familjes, dyert e qiellit u hapën për mua. Në kujtim të dashurisë sonë, madje edhe më intensive tani, të lutem të konsiderosh shpëtimin e shpirtin tënd si detyrë supreme. Kështu do të bashkohemi përjetësisht në qiell. Atje, askush s'ka për të na ndarë.»

Ata që vuajnë për Krishtin duhet të kenë aftësinë për të parë tablonë e plotë. Bibla është e mbushur me histori që na mësojnë rreth jetëve individuale. Por ato jetë përshkatan në një skemë më të madhe – betejës midis Zotit dhe djallit. Pamja e plotë na ndihmon të shohim se si Satani ndodhet pas shtypjes dhe vuajtjes; kështu që s'duhet të marrim hak te shtypësit tanë. Ata janë thjesht pengje në planin e Satanit. Martirët e krishterë si Markezi, na kujtojnë se nuk ka hakmarrje më të madhe për sulmet e Satanit mbi të krishterët se sa kur sulmuesit drejtohen për te Krishti. Lutu për drejtuesit e qeverive dhe regjimeve shtypëse. Mbështes ata misionarë dhe të tjerë që ndodhen në një pozitë për të ndarë ungjillin me ta.

Perëndia, burimi i paqes, do ta dërrmojë për së shpejti djallin nën këmbët tuaja.

Romakëve 16:20

**Kisha ka qenë dhe do të jetë gjithnjë e
persekutuar, të gjithë na vëzhgojnë. Nëse
vdesim në besim, shpresë dhe dashuri,
ajo mund të ndryshojë historinë e kombeve.
Nëse nuk qëndrojmë në dashuri dhe shpresë
për besimin tonë, kombet shpesh mund të
refuzojnë Krishtin.**

NGA NJË MISIONAR QË PUNON NË KINË DHE NË KORENË E VERIUT



FKSTREM

Ndërhyrje ekstreme

RUMANI: JOANA MINDRUC

Joana Mindruc habiti shumë vetë me veprimin e saj. Ajo shkoi me guxim tek oficeri i policisë dhe tha: «Gjashtë dishepuj të Krishtit prej njerëzve të zgjedhur të Zotit vuajnë këtu. Unë dua të vuaj me ta». Shumë shpejt ajo ishte duke kënduar me të akuzuarit, të cilët ishin arrestuar më herët atë ditë – një pastor çifut i krishterë, gruaja e tij dhe katër të krishterë të tjerë të burgosur.

Qeveria rumune, që kur lidhi aleancë me nazistët gjermanë, kishte persekutuar dhe vrarë çifutët në një shkallë alarmuese. Por ky çift çifut i krishterë në veçanti, njëhej dhe duhej në të gjithë Rumaninë – pastor Riçard Vurmbrandi dhe gruaja e tij, Sabina.

Ditën e gjyqit, disa drejtues të njohur fetarë erdhën në mbrojtjen e Vurmbrandëve, duke shpresuar se ndërhyrja e tyre do t'i çlironte. Por papritur, qielli u mbush me avionë luftarë sovjetikë dhe të gjithë, duke përfshirë çdo të burgosur, u shoqëruan me shpejtësi në vendstrehimet ndaj bombave.

Atje, pastor Vurmbrandi ishte në gjendje të lutej për grupin, duke përfshirë edhe gjykatësit. Lutja e tij ishte në të vërtetë një thirrje e fshehtë për besim dhe pendesë dhe kur rreziku kaloi dhe gjyqi filloi përsëri, ndodhi një mrekulli.

Zoti kishte lëvizur në zemrat e gjykatësve gjatë asaj krize dhe Vurmbrandët u liruan nga akuza! Një gjykatës shtoi: «Policia arrestoi gjashtë veta, para meje po qëndrojnë shtatë. Mesa duket do të ketë një ngatërrësë. Çështja zgjidhet!»

Ishte në fakt, i vetmi rast në atë kohë në të cilin çifutët e akuzuar shfajësoheshin nga akuza.

Është e pashpjegueshme, e pabesueshme! Sa herë që Zoti hyn në realitetin tonë, gjurmët e tij janë të pagabueshme. Ndonjëherë gjërat ndodhin në mënyrë të tillë sa madje, edhe ata që janë vëzhgues mosbesues e pranojnë që dikush, apo diçka kujdeset për ne. Ata mund t'i referohen atij si «Njeriu atje lart» që kujdeset për ne ose si «Engjëlli ynë mbrojtës», Megjithatë, si të krishterë ne e dimë se Ati ynë qiellor është i plotfuqishëm dhe mjaft përkujdesës për të bërë një mrekulli për ne kur kemi nevojë për një të tillë. A ke qenë i privilegjuar të jesh dëshmitar të ndërhyrjes së Zotit në jetën tënde dhe në jetën e një personi të dashur? Kalo pak kohë sot për të falënderuar Zotin që ndërhyr në jetën tënde.

*Ti më dhurove jetën edhe mëshirën,
kujdesi yt ma ruajti shpirtin.*

Jobi 10:12

MBROJTJE EKSTREME

UKRAINË: VERA JAKOVLEVA

Të krishterë të panumërt në qytetin e Ukrainës ishin dërguar në kampet e punës të Siberisë për shkak të besimit të tyre. Tani ishte radha e Vera Jakovlevës. Reputacioni i këtyre kampeve ishte shumë i njohur dhe ajo ishte e sigurt se nuk do të mbijetonte kurrë.

Kur një rojë e gjeti duke dëshmuar për Krishtin, dënimi i saj ishte të qëndronte zbathur për orë të tëra në akull. Kur nuk arrinte të përmbushte kuotën e saj të punës, rrihej dhe i mohohej supa e ujshme që e quanin vaktin e darkës.

Një mbrëmje, e dëshpëruar dhe duke qarë, Vera doli në kopshtin e burgut për të qenë vetëm. Në mjerimin e saj ajo nuk e kishte vënë re që kishte kaluar në zonën e ndaluar, ku të burgosurit qëlloheshin me t'u vënë re.

Papritur një zë i ashpër thirri: «Hej, a mos e ke nënën të krishterë?»

Vera e shtangur dhe e frikësuar, e cila kishte qenë duke menduar për nënën e saj në atë kohë, u përgjigj: «Pse më pyesni?»

Roja tha: «Sepse kam dhjetë minuta që të kam parë, por s'kam qenë në gjendje të të qëlloj. S'mund ta lëviz fare krahun edhe pse e kam të shëndetshëm e sot e kam lëvizur gjithë ditën. Kështu mendova se mund të kesh një nënë, e cila lutet për ty. Kthehu mbrapa, – do të shoh nga ana tjetër»,

Vera e pa rojën ditën tjetër. Ai i buzëqeshi dhe ngriti krahun duke thënë: «Tani mund ta lëviz përsëri»,

Neve na pëlqen të jemi të sigurtë, na pëlqen më tepër siguria sesa aventura. Preferojmë rehatinë ndaj sfidës. Kur vjen puna, ne duam të ruajmë jetën tonë sa më tepër që të jetë e mundur prej dyshimit dhe frikës, por e kemi harruar se Perëndia ofron mbrojtjen e tij në kohën kur jemi në vijën e frontit në shërbimin e tij. Mbrojtja e Zotit është më tepër si një mburojë në betejë, sesa një batanije sigurie për rehatinë tonë në shtëpi. Kur është hera e fundit që ke ecur aq shumë me besim, sa thjesht duhet të mbështeteshe në mbrojtjen e Zotit? A je aq i zënë duke ruajtur jetën tënde, sa ke harruar si t'i besosh Zotit? Pavarësisht nga rezultati, një dëshmitar nuk është thjesht një «rrezik», Është besim.

*Ai i ruan të gjithë ata që i trajtojnë të tjerët me drejtësi dhe që ia mbajnë besën atij.
(parafrazim)*

Fjalët e Urta 2:8

FKSTREM

Vendim ekstrem

RUMANI: RIÇARD DHE SABINA VURMBRAND

Nuk ishte vonë për t'u larguar nga vendi; mijëra vetë ishin në gjendje të paguanin për t'u larguar. Pastori dhe gruaja e tij u përlëshën me vendimin të shkonin apo të qëndronin. «Nëse hyjmë në burg, mund të jetë për vite të tëra. Po djali ynë?»

Por ata s'donin ta linin kishën e tyre, anëtarët u kthye tek ata për forcë dhe mbështetje dhe çifti u ndje fajtor që dëshiroi të largohej. Një mik u kujtoi fjalët e engjëll Lotit: «Largohu për të shpëtuar jetën tënde; mos shiko pas»,

Pastori pyeste veten: «Ishte mesazh nga Zoti? A duhet të largohemi për të shpëtuar jetën tonë?»

Gruaja e tij lexoi një varg tjetër. «Sepse ai që do të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim e për ungjillin, do të shpëtojë» (Marku 8:35).

Kështu debati vazhdoi derisa një natë, në një takim sekret kishë-shtëpi, ku ishin mbledhur pesëdhjetë besimtarë për një takim vigjilje që zgjati tërë natën, një grua e gjunjzuar me të tjerët thirri: «Dhe ti, ai që është duke menduar për t'u larguar – mbaj mend se Bariu i Mirë nuk e braktisi tufën e tij. Ai qëndroi deri në fund»,

Kjo grua e dashur nuk dinte asgjë për përlëshjen e pastorit dhe të gruas së tij, por për ata mesazhi ishte i qartë. Ata qëndruan dhe vendosën t'i shërbenin tufës së tyre dhe më vonë vuajtën me të në burg.

Si Vurmbrandët, ne duhet të lutemi për vendimet tona, të kërkojmë Biblën dhe të dëgjojmë këshillën e të tjerëve. Dhe si Vurmbrandët, ne duhet t'i bindemi përgjigjes së Zotit para se ta marrim atë. Ky është çelësi. Është si të fillojmë lutjet tona me një «Po» të vendosur, madje edhe para se të pyesim se çfarë duhet të bëjmë. Ne duhet të jemi gati ta lëmë veten tonë dhe të humbasim të gjithë ndjenjën e pronësisë. Vetëm atëherë zbulojmë jetën tonë të vërtetë dhe pranojmë vullnetin e plotë të Zotit për jetën tonë. A kapesht aq fort pas jetës sate, sa, nëse Zoti do të donte të të ndryshonte mendjen për një vendim të caktuar, gjithsesi nuk do ta lejoje ta bënte këtë?

Sepse ai që do të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim e për ungjillin, do të shpëtojë.

Marku 8:35

Festë ekstreme ditëlindjeje

RUSI

«Është ditëlindja ime sot, apo e jotja?» – pyeti e krishtera e re, duke shkelur syrin.

«E jotja», – tha i ati. «E imja ishte javën e kaluar». Për të krishterët në vendet komuniste, ditëlindjet ishin një arsye e rëndësishme për t'u mbledhur së bashku me besimtarë të tjerë. Disa familje mblidhen çdo javë për një festë ditëlindjeje që ishte në të vërtetë shërbesa e një kishe të fshehtë.

Të rinjtë përdorin këto «festa» për të përforcuar përkushtimin e tyre ndaj ungjillit. Në vitin 1966 në Rusi, tre djem të rinj dhe katër vajza u arrestuan sepse kënduan një himn në tren.

Në gjykatë, shtatë të rinjtë ranë në gjunjë. «Ne e dorëzojmë veten në duart e Zotit», – thanë ata para gjykatësit dhe dëshmitarëve të mbledhur. «Ne të falënderojmë Zot, që na ke lejuar të vuajmë për këtë besim»,

Pas rrëfimit të tyre, të krishterë të tjerë në dhomën e gjyqit filluan të këndonin pikërisht himnin për të cilin fëmijët ishin arrestuar. Ata thanë: «Le t'ia kushtojmë rininë tonë Krishtit»,

Komunistët s'mund ta ndalonin kishën të takohej dhe të rritej. Një gazetë ruse tregonte për një pastor, i cili ishte futur në burg tri herë. Sa herë që lirohej, ai shkonte menjëherë dhe organizonte shkollën e së dielës.

Këta besimtarë përdornin çfarëdo mjeti të mundshëm për të shprehur besnikërinë e tyre ndaj Zotit. Ata rrezikuan dhe vuajtën dënimin e vendit të tyre, në shërbim të kishës së Zotit.

Me qëllim që muskujt tanë të forcohen, ata duhet të lodhen e të tendosen përmes ushtrimeve dhe punës së vështirë. Në të njëjtën mënyrë, besimi është muskul që rritet vetëm kur është i mbledhur. Vuajtja mbledh muskulin e besimit tonë. Ne jemi të tendosur dhe të «thyer» para Zotit në kohë sprovash, por si rezultat bëhemi më të fortë. Kishat në vendet e kuqizuara shfaqin forcë të jashtëzakonshme për shkak të vuajtjeve të tyre. A mund të thuhet e njëjta gjë për besimin në vendin tonë? Ushtrimet të rraskapisin – ne s'duam t'i bëjmë. Në mënyrë të ngjashme, mendimi i vuajtjes mund të të shqetësojë. Megjithatë, ti s'mund të rritesh nëse nuk mbedh besimin tënd.

Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirrri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin Jezus, pasi të keni vuajtur për pak kohë, do t'ju bëjë të përsosur ai vetë, do t'ju bëjë të patundur, do t'ju forcojë dhe do t'ju vërë themel.

1 Pjetrit 5:10

Manifest ekstrem

RUI: NJË I BURGOSUR PA EMËR

Vejusha qëndroi pranë trupit të bashkëshortit të saj të martirizuar, duke mbajtur duart e dy prej katër fëmijëve të saj. Burri i saj kishte vdekur në burg dhe shenjat në trupin e tij e bënin të qartë që vdekja kishte ardhur ngadalë dhe me dhimbje.

Besimtarët e tjerë e dinin se ky do të ishte gjithashtu edhe fati i tyre, por qindra erdhën në funeralin e tij. Ai kishte vdekur për besimin e tij vetëm tre muaj pas kthimit në besim dhe tani ata mbanin zi për të.

Njerëzit u mblodhën rreth shtëpisë ku mbahej funerali dhe shumë u frymëzuan prej shembullit të tij. Tetëdhjetë persona pranuan Krishtin atë ditë, duke përfshirë të rinj që kishin qenë pjesë e Organizatës Rinore Komuniste.

Të krishterët ecën përgjatë gjithë qytetit drejt lumit ku pagëzonin besimtarët e rinj. Turma ishte rritur në mbi një mijë e pesëqind veta.

Shumë shpejt makinat e policisë arritën. Ata vendosën të arrestonin drejtuesit e shërbesës, sepse s'mund t'i arrestonin të gjithë. Të krishterët u ulën menjëherë në gjunj në lutje, duke i kërkuar Zotit t'i lejonte të përfundonin shërbesën. Pastaj qëndruan sup më sup, duke bllokuar policinë të vinte përpara, ndërsa shërbesa e pagëzimit vazhdonte. Turma u shpërnda, vetëm pasi të gjithë besimtarët e rinj u pagëzuan, duke lejuar policinë të vinte përpara.

Një mijë njerëz u frymëzuan prej shembullit sakrifikues të një besimtari të ri.

***Manifestim** – thjeshtësi, vizibilitet; demonstrim; shfaqje, dukje. Kuptimi i fjalës është i qartë, por a është manifestimi i besimit tonë po aq i dukshëm? Personi në histori imitoi Jezusin. Thjeshtë e qartë. Si rezultat i shembullit të tij të qartë, një numër i madh u nxit për ta ndjekur në manifestimin e besimit të tyre. Kështu, edhe jetët tona duhet të shfaqin qartë besimin tonë në Krishtin që të gjithë ta shohin. A do të dinë të tjerët se si të ndjekin Krishtin thjeshtë duke parë shembullin tënd? Ki kujdes që të mos ngatërrosh manifestimin e besimit tënd me retorika (fjalë boshe) ngatërruese, apo me marrëzi të tjera fetare. Thjeshtë, ji si Jezusi dhe të tjerët do të të ndjekin.*

Përngjajini Perëndisë porsì bij të dashur.

Efesianëve 5:1

FKSTREM

Vargje ekstreme

VENDET KOMUNISTE: KISHA E FSHEHTË

«Vargjet e Biblës mbeten të vërteta, madje edhe nëse djalli i citon ato»,

Në fillim ideja ishte që ta tallnin Biblën e krishterë, ta vinin në lojë, sa kushdo që di të respektojë vetveten nuk do ta besonte. Për të zbatuar planin, u botuan miliona libra, duke përfshirë *Biblën Komike* dhe *Bibla për besimtarë dhe jobesimtarë*.

Libri vinte në lojë Jezusin, vinte në dyshim mrekullitë e tij dhe tallej me aspekte të tjera të besimit të krishterë. Por kritikant ish in aq të tepruara, sa askush nuk i merrte seriozisht. Vargje të panumërta të Shkrimit u shuan në tekst si «provë» në mendjet e komunistëve të falsitetit të librit.

Anëtarët e kishës së fshehtë morën kopje të këtyre librave «komikë» sapo ato u botuan. Vargjet që citoheshin në libra ishin një bufë kënaqësish për ata që ishin shpirtërisht të uritur. Dhe e gjithë kjo ishte e ligjshme, e botuar prej qeverisë të tyre Perëndi-urries. Ashtu si laraskat ushqyen Elinë kur ai ishte i uritur, kështu Perëndia përdori shtëpitë botuese të qeverisë për të ushqyer fëmijët e tij të uritur në vendet komuniste.

Botuesit ishin të kënaqur të merrnin mijëra letra, të cilat kërkonin ribotimin e librit. Ata shumë shpejt nxitën shtypshkronjat të botonin më tepër kopje, nuk e dinin se këto letra vinin prej besimtarëve, të cilët dëshironin të shpërndanin librat e çmuar plot me fjalën e Zotit anëtarëve të tjerë të kishës së fshehtë.

A është e rëndësishme të dërgosh Bibla në vendet e izoluar? Lexoni historitë e martirëve dhe vendosni. Në një vend ku Biblat shiten në një shitje garazhi për hiç gjë, s'ka pikë vlere përvoja e atyre që kanë uri shpirtërore. Ndërsa ne mund t'i vendosim Biblat në tavolina të vogla për t'u dukur, besimtarë të tjerë kërkojnë me ngulm për një kopje të vetme për ta ndarë me një kishë të tërë. A është e drejtë për vendet e mbushura me kisha të kenë shumë Bibla në pothuajse çdo shtëpi, ndërsa në vendet e izoluar të mos ketë asnjë? Zot, rizgjo urinë tonë për Shkrimin dhe për t'ua çuar Fjalën atyre që janë tashmë duke vuajtur urie! Konsidero se si mund të ndihmohet për të mbështetur shpërndarjen e Biblave në vendet e izoluar sot.

Sa të ëmbla janë fjalët e tua në gojën time! Janë më të ëmbla se mjalti në gojën time.

Psalmi 109:103

**Miqësia me Jezusin është e shtrenjtë.
Vetëm besimi shpëton, por besimi shpëtues
nuk është kurrë vetëm.
Është gjithnjë i shoqëruar
nga sakrifica të mëdha për hir të Krishtit.**

PASTOR RIÇARD VURMBRAND



FKSTREM

Dëshmi ekstreme

SUDAN: KUA BASHIR

«Nëse vdes do të jem i lumtur, sepse do të lë një shembull për të krishterët e tjerë që të më ndjekin në zgjimin tim.»

Kua Bashir, një pastor sudanes i të rinjve ishte i zënë duke studiuar për mësimin tjetër të Biblës kur dëgjoi lajmin e tmerrshëm, por jo të papritur. Ishte viti 1987 dhe qeveria e forcave myslimane sudaneze sapo kishin zënë zonën e Nilit Blu në Sudan.

Forcat myslimane shumë shpejt arrestuan Bashirin, të vendosur për t'i kthyer të gjithë në islam. Bashiri u torturua dhe u rrah për shtatë ditë para se të lirohej, por refuzoi të ndryshonte fenë. Ata i thanë të mos organizonte më aktivitete për të rinj dhe të mos shkonte më në kishë, por Bashiri nuk u frikësua. Ai e dinte se forcat myslimane nuk ishin në gjendje të preknin shpirtin e tij.

Kur u arrestua për herë të dytë, Bashiri dëshmoi: «Unë do të vdes me kënaqësi pa frikë ashtu si Jezusi bëri në kryq», Ai vazhdoi t'u fliste atyre për Zotin dhe oficeri në ngarkim kërcënoi ta qëllonte, por ata vendosën t'i hidhnin Bashirit acid në duar si një kujtesë e vazhdueshme e refuzimit të tij për t'u kthyer në islam.

Por besimi i Bashirit ka mbetur i fortë dhe sot duart e tij të djegura e të papërdorshme janë bërë një dëshmi e gjallë për të rinjtë në kampin e refugjatëve në Bonga, ku ai punon përgjatë kufirit sudano-etioapas.

Mesazhin që martirët flasin nëpërmjet vdekjes së tyre dramatike duhet ta ndajmë me anë të jetës sonë të përditshme. Ne duhet të jemi një dëshmi e gjallë e hirit të Zotit, mund të mos u bashkohemi kurrë rangjeve të martirëve, të vdesim për besimin tonë në Krisht. Megjithatë, kemi mundësi të përditshme për të jetuar për të. Është thënë se: «Çfarë nuk na vret, na bën më të fortë». Ne u mbijetojmë vuajtjeve kështu që të mund të jetojmë për t'u treguar të tjerëve për hirin e Zotit. A është shenjuar jeta jote nga vuajtjet? Mos ki turp! Le të jenë shenjat dëshmia jote. Le t'ua tregojnë ato historinë tënde të gjithëve që shohin besimin tënd të palëkundur.

Por, nëse dikush vuan si i krishterë, le të mos ketë turp, por të lavdërojë Perëndinë për shkak të këtij emri.

1 Pjetër 4:16

FKSTREM

Misionarë të rinj ekstremë

RUMANI

Megjithëse pushtuesit sovjetikë po terrorizonin vendin e tyre, fëmijët rumunë ecnin të vendosur drejt ushtarëve rusë me buzëqeshje të ngrohta e të sigurta në fytyrë.

Ushtarët i përshëndetën me mirësjellje, duke i ledhatuar në kokë. Çdo ushtar po mendonte për fëmijët e vet, të cilët ishin të detyruar t'i linin në Rusi.

«Merrni disa ëmbëlsira», – tha njëri prej oficerëve duke u nxjerrë një grusht me çokollata të rinjve, të cilët i rrëmbyen me të shpejtë ëmbëlsirat që s'gjendeshin kollaj.

«Faleminderit, zotëri». – thanë djemtë. «Edhe ne kemi dhurata për ju». Ata gërmuan në xhepat e tyre duke nxjerrë trakte ungjilli dhe Dhiata të Reja në rusisht.

«Çfarë është kjo?», – pyeti ushtari.

«Është libri i Lajmit të Mirë», – thanë djemtë me gojën plot me çokollatë. Ushtarët vëzhguan traktet. Një oficer i njohu fletushkat të ishin fetare duke e ditur mirë rrezikun. Ai pa fëmijët me shqetësim të thellë në sy. Nëse të rriturit do të kishin shpërndarë materialin, atij do t'i duhej t'i arrestonte. *Por çfarë bëni mund të bënin këta fëmijë?* – mendoi ai.

Ajo që nuk dinte oficeri ishte se këta fëmijë kishin shpërndarë qindra trakte dhe Dhiata të Reja, duke ndihmuar shumë vetë në ushtrinë ruse të gjenin Zotin. Këta fëmijë ishin regjistruar në një «ushtri» tjetër me një «betejë» të përtjetshme.

Ndryshimi midis një pesimisti dhe një optimisti është midis «mund» dhe «nuk mund». Sigurisht, besimtarët si në vendet e izoluar fetare, ashtu edhe në vendet me liri fetare, ndeshen me dyer të mbyllura. Në disa vende, të pasurit e një Bible do të thotë dënim me burg. Në Amerikë «ndarja e kishës dhe shtetit» ka shkuar shpesh në ekstrem. Ndonjëherë fokusi ynë se çfarë mendohet se nuk duhet të bëjmë si të krishterë na bën të humbasim mundësi. Ne shohim dyer të mbyllura më tepër se ç'shohim ato të hapurat. Për shembull: ndërsa misionarët s'mund të hyjnë në vendet e izoluar si të tillë, punëtorë «profesionistë» rekrutohen! Ne gjithashtu mund të mbështesim punëtorët e krishterë të vendit, të cilët jetojnë atje. Dëra është e hapur. Kalo në të.

Lypni dhe do të të jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokisni dhe do të të çelet.

Mateu 7:7

FKSTREM

Fëmijë shkolle ekstremë

SUDAN

Të ulur mbi trungje nën hijen e një peme, 230 nxënësit e krishterë po fillonin mësimin e anglishtes kur dëgjuan zhurmat tmerruese mbi kokë. Një avion ulërinte përmes qiellit mbi kopshtin e shkollës. Për disa minuta, ushtria islamike kishte hedhur pesë bomba nga një bombardues i madh rus.

Të tmerruar dhe duke ulëritur, fëmijët filluan menjëherë të vraponin. Dy prej bombave ranë në një hendek të thatë rreth fshatit dhe një tjetër nuk shpërtheu.

Fatkeqësisht, dy bombat e tjera të mbushura me gozhdë ranë pikërisht midis studentëve të frikësuar. Shpërthimi ishte i tmerrshëm, dëmi i paimagjinueshëm.

Në 09:15 bombarduesi u largua dhe realiteti i tmerrshëm filloi të shfaqej. Nxënësit endeshin të trullorur rreth kopshtit të shkollës, duke qarë dhe të gjakosur. Dymbëdhjetë prej shokëve të tyre të klasës me moshë nga nëntë deri në gjashtëmbëdhjetë vjeç nuk i kishin mbijetuar shpërthimit. Edhe mësuesja e tyre e dashur, Roda Ismaili, qëndronte e vdekur midis gurëve.

Shtatë nxënës të tjerë e humbën betejën për mbijetesë në ditët pas sulmit dhe tre të tjerëve duhej t'u priteshin gjymtyrët.

Pikërisht të nesërmen, fëmijët erdhën në shkollë si zakonisht. Drejtoi i shkollës, i rraskapitur dhe i dëshpëruar u tha të shkonin në shtëpi. «S'mund t'ju them kur apo nëse do të fillojmë mësimin».

Një djalë dhjetëvjeçar iu afrua dhe tha: «Të lutem, na lejo të vazhdojmë. Ne duam të mësojmë dhe, nëse është vullneti i Zotit, atëherë s'do të vdesim».

Jetë në udhëkryq. Ne të gjithë kemi qenë atje, duke u lëkundur midis – të dorëzohemi apo të vazhdojmë. Si djali i shkollës, turmat që po ndiqnin Jezusin një ditë e kuptuan se rruga në të cilën ndodheshin ishte plot me rrezik. Si drejtori zemërlëshuar i shkollës, shumë veta në turmë u drejtuan për në shtëpi, duke mos qenë në gjendje të thoshin, nëse apo kur do të vazhdonin të ndiqnin Krishtin. Por Pjetri dhe dishepujt e tjerë qëndruan. Kërkesa solemne jehon përgjigjen e Pjetrit: «Le të vazhdojmë». Kur tundohej të dorëzohemi, le të vazhdojmë. Kur duket se të ndjekësh Krishtin është shumë e vështirë, le të vazhdojmë. A po përballesh me udhëkryqet e përkushtimit? Kërkoji Zotit forcë për të vazhduar në vend që të dorëzohesh.

Simon Pjetri u përgjigj: «Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme.

Gjoni 6:68

I mbijetuar ekstrem

KOREJA E VERIUT: NJË DËSHMITAR I VETËM

Ndërsa u përmend me ngadalë, sytë e tij iu përshtatën tymit. Ai thirri pastorin e tij, por askush nuk u përgjigj. I tmerruar filloi të dilte jashtë nga përgju i mishit dhe i gurëve.

Atë mëngjes kishte qenë në mes të një grupi prej 190 besimtarësh koreano-veriorë kur policia hyri brenda, i rrethoi dhe me ashpërsi i çoi në qendër të qytetit.

Udhëheqësi i vendit, Kim II Sung, qëndroi para tyre. Diktatori i pazemërt shkoi në qendër të sheshit dhe vizatoi një vijë në pluhur, duke i urdhëruar ata, që donin të mohonin Krishtin të kalonin vijën.

Asnjë nuk kaloi përpara. I tërbuar nga inati, Kim II Sung urdhëroi që grupi të hidhej në një tunel të minuar me kallëpë dinamiti.

Gjëja e fundit që mbante mend besimtari i mbijetuar ishte pastori i tij, duke ngushëlluar dhe inkurajuar grupin. Duke e kuptuar se ai ishte i vetmi i mbijetuar, thirri: «Pse, Zot? Pse nuk më le të vdes me të tjerët?»

Zoti menjëherë ia mbushi zemrën me paqe dhe ai e dinte se dikush duhej të mbetej dhe të ishte dëshmitar për besimin e tyre. Ky ishte i pari i shumë prej sulmeve brutale nga forma brutale e komunizmit dhe adhurimit të Kim II Sungut, i quajtur *Juche*. Lajmi i ngjarjes heroike u shpërnda shumë shpejt midis të krishterëve duke u treguar gojë më gojë edhe në ditët e sotme në Korenë e Veriut.

Si besimtarët në këtë histori, zjarrfikësit që i mbijetuan sulmit terrorist në Qendrën Tregtare Botërore nuk janë dëshmitarë të heshtur. Megjithëse s'mund ta shpjegojnë pse ata mbijetuan dhe shokët e tyre jo, ata janë patriotë të vërtetë, të cilët e dinë se dikush duhet të mbetet për të treguar historinë e atyre që vdiqën duke shpëtuar të tjerët që ata të mund të jetonin. Si i krishterë, ju keni një histori edhe më të madhe mbijetese për të treguar. Jezusi nuk i mbijetoi Kryqit. Ai e mposhti atë. Ai, jo vetëm që i mbijetoi provës, por triumfoi. U rikthye në trupin e tij të ringjallur për t'u dhënë lajmin dishepujve të tij, të cilët shumë shpejt do t'ia thoshin botës. Jezusi vdiq për të shpëtuar të tjerët, kështu që ata të mund të jetonin. Por ai është i gjallë tani, i kthyer prej së vdekurish, duke i ofruar shpëtim botës.

Kjo fjalë është e vërtetë dhe meriton të besohet prej të gjithëve – Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët.

1 Timoteut 1:15

Bijë ekstreme

TAXHIKISTAN: MUNIRA

«Munira, ke pesë minuta kohë para se të të vras. Kë do të zgjedhësh – familjen tënde, apo Jezusin?»

Prej muajsh, Munira ishte përpjekur ta ruante sekret besimin e saj; ajo e donte shumë familjen e saj dhe nuk donte t'i lëndonte, por kur i ati bëri përgatitjet që Munira të martohej, ajo u tregoi atyre për dashurinë e saj për Krishtin.

Munira ishte në fill të besimit të saj dhe iu përgjigj të atit: «Duhet të zgjedh Jezusin». Ai u zemërua aq shumë që vajza e tij e bukur do të kthehej kundër familjes duke mohuar rritjen e saj si myslimane në Taxhikistan, sa e rrahu për nja dy orë të tjera.

Por Zoti ndërhyri. Një shoqe e krishterë e çoi në vend të sigurt për një periudhë kohe. Munira tha: «Gjatë kohës sime larg, Zoti më zbuloi besnikërinë e tij dhe pas shumë lutjesh, e dija se ishte koha të ripajtohesh me familjen time të dashur».

Kur ajo u kthye në shtëpi, të gjithë ishin të gëzuar përveç babait të saj.

Fjalët e tij të para ishin: «Të urrej! Dil jashtë! Vajza ime vdiq tre muaj më parë!»

E shkatërruar, Munira qau në këmbët e të atit duke thënë: «Zoti im më tha të kthehesha tek ti. Unë nuk do të të lë kurrë, madje edhe nëse më rreh dhe më vret».

I ati u thye dhe e përqafoi Munirën, ai shumë shpejt iu dorëzua besimit të saj të ri dhe madje ra dakord ta lejonte të ndiqte një kolegji bibliik.

Disa lexues përfshihen aq shumë në histori, sa lexojnë përfundimin për të parë se çfarë do të ndodhë. Ata e lënë një kapitull, madje shkojnë në fund të librit se duan ta dinë nëse heroi fiton në fund, duan ta dinë nëse gjithçka funksionon siç është planifikuar. Fatkeqësisht, ju s'mund të lexoni përpara në historinë e jetës suaj. Si Munira, ju duhet të kaloni nga një kapitull, çdo ditë njëri pas tjetrit. Si rezultat, nuk ke për t'u zhgënjyer, njësoj si Munira. A je i paduruar për të parë se ku do të të çojë bindja jote? A do të zuloth se çfarë ka planifikuar Zoti më tej për ty? Më e mira që mund të bësh është të bindesh sot dhe t'ia lësh Zotit të nesërmen.

Prandaj, mos u brengosni për të nesërmen, sepse e nesërmja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i del mjaft pikëllimi i vet!

Mateu 6:34

«Ata kanë djegur zotërimet tona, por s'mund të djegin Jezusin prej zemrave tona»

Origeni nuk ishte tetëmbëdhjetë vjeçar tipik. Ai ishte një mësues në Egjiptin e shekullit të dytë. Ndërsa kisha e kohës së tij vuante persekutim të ashpër, Origeni nuk e kalonte kohën duke shkuar pas vajzave apo duke u përpjekur t'u bënte përshtypje bashkëmoshatarëve.

Në vend që të largohej prej tmerrit që kishte vrarë, madje edhe vetë babanë e tij, Origeni vendosi të bëhej shok me kishën e persekutuar. Ai kalonte kohën duke inkurajuar të krishterët që ishin sjellë para gjyqit. Kur ata çoheshin drejt vdekjes, ai çohesh për t'i puthur, madje vizitoi burgjet për të ngushëlluar besimtarët.

Por Origeni u gjend shumë shpejt në një rrezik të madh për shkak të dhembshurisë së tij ndaj të krishterëve të dënuar. Shumë shpejt ushtarët u vendosën rreth shtëpisë së tij për shkak të ndikimit të tij në kishë. Ai kishte shumë armiq dhe zemërimi ndaj tij ndizej gjithnjë e më shumë.

Në fakt u detyrua të linte qytetin. Lëvizi nga një shtëpi në tjetrën për shkak të shumë kërcënimeve për jetën e tij, por, i nxitur nga shembujt e besimit në Letrën drejtuar Hebrejve, ai vazhdoi të ishte mik për ata që persekutoheshin. Ai, madje punësoi disa njerëz për të shkruar me dorë kopje të tjera të Shkrimit.

Në fakt, qëndrimi i tij i mahnitshëm tërhoqi disa prej armiqve të tij drejt Krishtit.

Megjithatë, ai u burgos, u torturua dhe u vra për të njëjtin qëndrim.

Çfarë do të thotë të jesh shok me ata që persekutohen? Njerëzit nuk janë shokë se po kalojnë përmes vuajtjeve të njëjta. Ne mund të jemi në situata krejtësisht të ndryshme nga vëllezërit dhe motrat në vendet e izoluara, por akoma mund të jemi shokët e tyre. Distanca fizike nuk na bën shok shpirtëror, por përkushtimi personal po. Mbështetja e palëkundur, lutja dhe interesimi lidhin zemrat dhe jetën tonë së bashku. Si Origeni, a jemi gati ta rendisim veten me ata që janë duke vuajtur për ungjillin? S'duhet të na vijë turp për miqësitë tona dhe as të jemi të paditur për rreziqet që sjell. Kur dëgjojmë zërin e martirëve të na thërrasë në lutje, a do t'u kushtojmë vëmendje thirrjeve të tyre si shokë të vërtetë?

Unë, Gjoni, vëllai juaj dhe bashkë me ju pjesëtar në vuajtje, në mbretëri dhe në qëndresë në Jezusin.

Zbulesa 1:9

**Me të, Zotin tim të dashur, është mirë kudo.
Me të unë kam dritë në qelinë e errët.
I kërkova të jem atje ku duhem,
jo ku është më mirë për njeriun e jashtëm,
Por ku mund të jap fryte.
Kjo është thirrja ime.**

PASTOR RUS P. RUMATCHIK – NGA NJË LETËR E SHKRUAR KUR U
BURGOS PËR HERË TË PESTË



FKSTREM

Një tjetër mbrojtës ekstrem

GJERMANI: DITRIH BONHËFER

Kur katërbëdhjetë vjeçari, Ditrih Bonhëfer, deklaroi dëshirën e tij për të qenë pastor, familja e tij e pasur kritikoi kishën. Ditrih u tha atyre se do ta reformonte atë.

Në moshën njëzet e një vjeçare, fjalimi i tij *Bashkësia e Shenjtorëve*, u lavdërua si «mrekulli teologjike». Si pastor i vajosur/emëruar, profesor teologjie dhe autor, Bonhëferi e kaloi jetën e tij duke hetuar çështjet e kishës.

Kur Adolf Hitleri erdhi në fuqi në Gjermani në vitin 1933, kisha adoptoi një nga klauzolat e Hitlerit duke mohuar të drejtën e saj për të vajosur/emëruar pastore me prejardhje çifute. Vetëm Bonhëferi foli hapur kundër vendimit dhe u zotua që ai të shfuqizohej.

Me anë të leksioneve dhe artikujve të botuar, Bonhëferi kundërshtoi ligësinë naziste dhe qortoi kishën që nuk kishte «ngritur zërin në emër të viktimave dhe... të gjente mënyra për të shpejtuar në ndihmë të tyre».

Në prill të vitit 1943, Bonhëferi u arrestua në Berlin për «sabotim të forcave të armatosura». Por ndërsa ishte në burg, ai vazhdoi të shkruante. «Kisha qëndroi në heshtje kur duhej të kishte klithur».

Në vitin 1945, Bonhëferi u transferua në kampin e përqendrimit të Flossenbyrgut ku u var bashkë me gjashtë të tjerë në 9 prill. Mjeku i kampit, i cili e kishte parë të ulej në gjunjë e të lutej para se ta çonin në trekëmbësh tha se, «zor se kam parë një njeri të vdesë aq plotësisht i nënshtuar ndaj vullnetit të Zotit».

Thuhet se nëse nuk mban qëndrim për diçka, është e sigurt që do të rrëzohemi në çdo gjë. I tillë ishte rasti në Gjermaninë Naziste. Kisha në një vend të krishterë qëndroi në heshtje ndërsa dallgë ligësie përplaseshin në bregun e historisë, duke shurdhuar thirrjen e vetme të Bonhëferit. A mund të themi ne se jemi mbrojtës të së vërtetës nëse qëndrojmë në heshtje në këto lloj çështjesh? A sinjalizon heshtja jonë në këto çështje miratimin tonë ndaj mizorive në vendet e izoluar? Një mbrojtës për të vërtetën duhet të jetë i drejtpërdrejtë në besim. Si Bonhëferi, ne duhet të jemi gati të durojmë pasojat e qëndrimit tonë, përndryshe rrezikojmë të «rrëzohemi në çdo gjë» ndërsa jemi të zënë për të vendosur nëse të mbajmë një qëndrim për Krishtin.

Dhe të gjithë do të të urrejnë për shkak të emrit tim. Por as edhe një fije floku e kokës suaj nuk do të të humbasë. Me durimin tuaj ju do t'i fitoni shpirtat tuaj.

Luka 21:17-19

Armë ekstreme

RUMANI: SABINA VURMBRAND

Në 05:00 të mëngjesit, ata dëgjuan të rëna në derë dhe menjëherë e kuptuan se ishte një sulm i policisë. Bashkëshorti i Sabinës ishte tashmë në burg dhe ajo tani shqetësohej për fatin e djalit të saj të vogël nëse do merrej edhe ajo. Kështu që kur policia rumune shpërtheu herët atë mëngjes duke bërë turrë dhe duke frikësuar mysafirët në atë shtëpi, Sabina me qetësi u lut dhe ia përkushtoi veten dhe familjen e saj kujdesit të Zotit.

Ata pyetën: «Sabina Vurmbrand? Ne e dimë se po fsheh armë këtu, na trego ku janë!» Para se të mund të diskutonte, ata hapën dollapë e kuti dhe boshatisën sirtarë në dysheme, ndërsa vazhdonin të thërrisnin: «Kështu, nuk do të na tregosh se ku janë fshehur armët? Do ta bëjmë këtë vend copa-copa!»

Sabina duke u përpjekur të qëndronte e qetë, thjesht tha: «E vetmja armë që kemi në këtë shtëpi është këtu» Dhe ngriti Biblën prej këmbëve të tyre.

Oficeri iu përgjigj: «Nëse nuk më tregon të vërtetën, duhet të vish me ne për të bërë një deklaratë të plotë për ato armë».

Sabina e vendosi Biblën mbi tavolinë dhe u përgjigj: «Ju lutem, na lejoni disa minuta për t'u lutur dhe pastaj do të vij me ju».

Ndërsa Sabinën e morën, asaj i vinte keq për humbjen e «armës», Biblën, por fitoi fuqi duke e ditur se i kishte fshehur fjalët e saj në zemër, ku s'mund të konfiskoheshin.

Ndodhet vetëm një armë sulmi e renditur në përshkrimin e asaj që i referohemi zakonisht si armatura e Perëndisë. Tek Efesianët, Pali rendit masat mbrojtëse në besimin e krishterë, e përfaqësuar nga një helmë, një parzmore, një brez, një mburojë dhe këpucë mbrojtëse. Megjithatë, ai inkurajon vetëm një armë sulmi: Fjalën e Perëndisë. Ajo është arma e zgjedhjes. Ashtu si një ushtar i lashtësisë do të varej nga shpata e tij, kështu ne duhet të varemi nga tehu i mprehtë i Shkrimit për të siguruar një rrugë për sigurinë tonë. Është për të ardhur keq, se shumë të krishterë mbeten të pambrojtur në një betejë shpirtërore. Ata nuk e kanë mësuar përmendësh Biblën si Sabina; nuk janë në gjendje të varen nga fuqia e saj. Mos ji një rastësi tjetër shpirtërore. Merre shpatën tënde sot.

Merrni përkrenaren e shpëtimit dhe shpatën e Frymës së shenjtë, d.m.th. Fjalën e Perëndisë!

Efesianëve 6:17

FKSTREM

Falje ekstreme

RUMANI: DIANA DHE FLOAREA

Diana ishte vetëm nëntëmbëdhjetë kur i ati u dërgua në burg për besimin e tij. Asaj dhe motrës së saj, Floareas, iu la familja në ngarkim, por shumë shpejt humbën punën e tyre në fabrikë për shkak të burgosjes së babait të tyre.

Me një nënë të sëmurë dhe me katër vëllezër e motra më të vegjël në shtëpi, Diana dhe Floarea ishin të dëshpëruara. Ndaj, kur një djalë i ri i thirri dhe u tha se do mund të gjente një leje pune për Dianën, ato u gëzuan së tepërmi. Ajo e takoi atë për darkë, ku ai i dha shumë verë të pinte dhe pastaj e mashtroi. Më pas i dha ca para dhe kjo u bë zakon. Asgjë nuk u tha më për një leje pune dhe Diana pranoi paratë, sepse ishte e dëshpëruar.

Diana vazhdoi të prostituohej me qëllim që të mbështeste familjen, megjithëse ishte e mbushur me faj. Shumë shpejt motra e saj u përfshi dhe së bashku fshihnin turpin e tyre.

Sot, ndërsa shohin nënën e tyre në fytyrë, thonë: «Si mund të na falësh? Ne menduam se do të të vinte neveri».

Ajo u ofroi atyre fjalë dashurie dhe ngushëllimi: «Ju ndieni turp për çfarë keni bërë dhe kështu duhet, por kjo ndjenjë turpi dhe faji do t'ju çojë në një drejtësi vezulluese. Mbani mend, ushtarët nuk e shpuan zemrën e Jezusit më tepër se sa e »hapën« atë që mëkatarët të mund të hynin lehtë në zemrën e tij dhe të gjenin falje».

Të na vijë keq për mëkatet tona dhe të na vijë keq për veten, janë dy gjëra të ndryshme. Shumë njerëzve që kalojnë përmes dhimbjeve u vjen keq për veten. Ata janë të gjithë shumë gati për t'ua hedhur fajin të tjerëve për fatkeqësinë e tyre. Sa tunduese duhet të kishte qenë për vajzat në histori t'ia hidhnin fajin babait të tyre për gabimet e tyre. «Nëse ai s'do të kishte qenë i krishterë, atëherë s'do të ishte arrestuar dhe ne s'do të ndodheshim në këtë rrëmujë». Por përsëri, ato erdhën tek e ëma me turp të vërtetë dhe pendim për mosbindjen e tyre me vullnet të plotë dhe gjetën falje. Keqardhja e përshpirtshme të çon në pendim, i cili të çon në falje. A po të vjen keq për veten në vuajtjet e tua? Kujdes! Mund të të çojë shumë shpejt në mosbindje.

Sepse trishtimi sipas Perëndisë prodhon pendimin që sjell shpëtimin e nuk tërhiqet më pas; kurse trishtimi sipas kësaj bote, sjell vdekjen.

2 Korintasve 7:10

«Kriminel ekstrem»

ARABIA SAUDITE: PASTOR UALLI, NJË PUNONJËS FILIPIN

Ai ishte krimineli më i kërkuar në Arabinë Saudite. Pastor Ualli u mor nga shtëpia dhe u çua në një dhomë ku ishin tre burra dhe atje u godit me shuplaka, shkelma dhe grushte. Abuzimi më i dhimbshëm ishte fshikullimi i pjesëve të poshtme të këmbëve. Kur fshikullimi mbaronte, këmbët dhe duart kishin ngjyrën e një patëllxhani.

Në mes të asaj dhimbjeje, torturuesit e urdhëruan Uallin të ngrihej në këmbë. «S'mundem» – u tha atyre. I dhimfte çdo centimetër pjesë e këmbëve dhe s'kishte se si të mbante peshën e tij. «Ju lutem, më lejoni vetëm të ulem në gjunj». Torturuesit refuzuan.

Ndërsa të tre burrat e rihnin, pastor Ualli lutej për ta. Lutjet i kujtuan një varg. «Sepse ai do të urdhërojë engjëjt e tij... ata do të të mbajnë në duart e tyre, me qëllim që këmba jote të mos pengohet nga ndonjë gur.» (Psalmi 91:11-12). Pavarësisht nga këmbët, Ualli u ngrit drejt midis burrave. Ata u tronditën që ai mund të qëndronte pas një rrahjeje të tillë.

«Unë po qëndroja në duart e engjëllit të Zotit», – tha pastor Ualli më vonë.

«Ata s'mund t'i shihnin engjëjt, por unë e ndjeva që ishin atje për të më ndihmuar të qëndroja.»

Disa njerëz duket se i dërgojnë engjëjt e tyre mbrojtës në punë jashtë orarit. Si pastor Ualli, ata janë vazhdimisht gati për Krishtin me një dëshmi të përsëritshme dhe shpirt të guximshëm. Akoma ne mund të imagjinojmë se disa engjëj mbrojtës e kanë kohën në dorë, u caktohen të krishterëve, të cilët nuk bëjnë asgjë për të zgjeruar mbretërinë. Ndërsa situata e pastor Uallit është unike, lutja e tij nuk duhet të jetë. Ndonjëherë ne duhet të qëndrojmë në duart e engjëjve të Perëndisë me qëllim që t'i qëndrojmë besnikë Krishtit. A e shfaqim ne këtë lloj dëshire të zjarrtë në vendin tonë të punës? Në shtëpi? Në shkollë? Sa herë që e ke të vështirë të mbash një qëndrim për Krishtin sot, kërkoji Perëndisë të dërgojë engjëjt e tij për të të ndihmuar.

*Sepse ai do të urdhërojë engjëjt e tij...
ata do të të mbajnë në duart e tyre, me
qëllim që këmba jote të mos pengohet
nga ndonjë gur.*

Psalmi 91:12

Udhëheqje ekstreme

FILIPI: PALI DHE SILA

Ai më tha: «Eja në Maqedoni dhe na ndihmo», – tha Pali.

Sila iu përgjigj: «Ti beson se ishte një ëndërr nga Perëndia?»

«Po».

Sila buzëqeshi dhe iu përgjigj: «Atëherë do të shkojmë në Maqedoni menjëherë!»

Kur arritën në Filipi, një grua e rëndësishme tregtare u kthye në besim dhe një vajzë e re u çlirua nga një demon. Sigurisht, ata e kishin dëgjuar Zotin saktë dhe po ndiqnin drejtimin e tij.

«Ja ku janë!» – thirri drejtuesi i turmës rebele. Para se Pali dhe Sila ta kuptonin çfarë po ndodhte, u tërhoqën zvarrë para gjykatësve të qytetit dhe u akuzuan se po prishnin qetësinë me mesazhin e tyre të ungjillit.

Gjykatësi kryesor u grisi rrobat dhe urdhëroi që të rriheshin me shkopinj dhe të hidheshin në burg.

Ata natë, të gjakosur e të mavijosur me këmbët në pranga, Pali dhe Sila kishin plotësisht të drejtë të ndiheshin sikur Zoti i kishte drejtuar keqas. Por pyetja «Si mund ta lejonte Zoti të ndodhte?» – nuk u bë asnjëherë.

Përkundrazi, në mesnatë ata ishin akoma duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin sepse i besonin drejtimit të tij. Ata e dinin se ai nuk i kishte braktisur, siç do ta provonte shumë shpejt shpëtimi i tyre i mrekullueshëm.

Silasi dhe Pali vazhduan të ndiqnin udhëheqjen e Zotit në udhëtimet e tyre së bashku. Në fakt, Sila u bë drejtuesi i kishës në Korint. Të dy burrat ndoqën drejtimin e Zotit dhe u bënë martirë për besimin.

Ah, sikur vullneti i Zotit për jetën tonë të na vinte në një ëndërr! Vetëm sikur planet e tij të shtroheshin qartë para nesh si një tabelë lajmërimesh në rrugë. Më mirë akoma, të kishim një zë që të na thoshte saktësisht se çfarë duhet të bënim! Sado të këndshme mund të duken këto, metoda të tilla direkte do të shfuqizonin elementin e besimit. Zoti dëshiron që ne të mbështetemi në të si një hartë kur përcaktojmë drejtimin e jetës sonë. Pali dhe Sila nuk e dinin saktësisht se çfarë do t'u ndodhte atyre në Filipe. Ata dinin vetëm se Zoti u kishte thënë të shkonin. Ti mund të mos e dish se ku po të çon Zoti, por a je gati ta ndoqësh sido që të jetë? Ti nuk do të shkosh, nëse nuk i beson plotësisht atij.

*Më drejto me të vërtetën
tënde dhe më mëso,
sepse ti je Perëndia im,
Shpëtimtari im, në ty
shpresoj gjithmonë.*

Psalmi 25:5

«Kriminel ekstrem»

ARABIA SAUDITE: PASTOR UALLI

«Zot, çdo gjë mund të ndodhë sot këtu, – u lut pastor Ualli. – Por, të lutem, mos i lejo të më marrin jetën».

Ndërsa të rrahurat vazhdonin, pastor Ualli vazhdoi të lutej për torturuesit e tij arabë. Në mes të lutjeve të tij, iu kujtuan vargjet që thonë se trupat tanë janë tempull i Frymës së Shenjtë.

«Faleminderit që më ke lejuar të jem tempulli yt, – u lut Ualli. – Unë besoj se ti nuk do një tempull që është i rrënuar dhe i abuzuar nga armiku, Zot. Ti do një tempull që është i ngritur në lavdi dhe plot me shkëlqimin tënd. Unë po shpall ripërtëritje të plotë të trupit tim, Zot. Nuk ka rëndësi se çfarë bëjnë këta torturues, unë lutem që ti do të marrësh lavdi edhe më tepër kur unë të jem shëruar plotësisht. Njerëzit nuk do të shohin asnjë shenjë që këta torturues i bënë trupit tim.»

Pastor Ualli u qëllua me shkop në duar, në shpinë, në këmbë, aq sa duart iu dëmtuan plotësisht. Më në fund, e kthyen në qelinë e tij kur ishin tejmasë të lodhur për të vazhduar të torturonin këtë të krishterë.

Ualli u lut me orë të tëra dhe pastaj ra në një gjumë me ndërprerje, gjatë të cilit ndjeu praninë e Zotit dhe prekjen shëruese. Kur u zgjua, duart dhe këmbët i ishin shëruar. Ai nuk ndiente asnjë dhimbje nga të rrahurat. Ualli u mahnit, sepse Zoti e kishte shëruar.

A shkoi shumë larg pastor Ualli kur u lut me besim për shërimin e tij? A shfrytëzoi ai Shkrimin me kërkesën e tij të pafytyrë? Faktet duket se sugjerojnë se Ualli nuk bëri asnjë prej këtyre gjërave. Në fakt, pastor Ualli thjesht i besoi Zotit në fjalën e tij. Shumë të krishterë do të përfitonin duke bërë po ashtu, por ne s'mund të besojmë në fjalën e tij nëse nuk e njohim atë. Pastor Ualli ishte në gjendje të kujtonte vargjet inkurajuese në kohë nevojë, sepse ai ka kaluar kohë me Shkrimin e Shenjtë. Shumë të krishterë besnikë që janë rrahur nuk janë shëruar menjëherë, por Zoti i përdor dëshmitë tona nëse jemi apo jo të shëruar. A je në gjendje të kujtosh Fjalën e Zotit kur është e nevojshme? A di më tepër për Shkrimin sesa i njohësh vetë Shkrimet? Thuaji Zotit se je gati të besosh në fjalën e tij.

*Sepse ju jeni tempulli i
Perëndisë së gjallë.*

2 Korintasve 6:16

Unë meditoj mbi fjalët e Jezusit: «Që kushdo që beson në të do të... ketë jetë të përjetshme». (Gjoni 3:16)

Unë jam në mes të kriminelëve. Është një nënkuptim që njerëzit mund të bëhen si kafshë. Kafshët janë pa mëkat. Por njerëzit që më rrethojnë në burg arrijnë thellësitë e errësirës djallëzore të paarritshme për kafshët.

Do të ishte më e lehtë të jetoje në një stallë sesa midis këtyre kriminelëve. Çdo fjalë e tyre është e ndyrë, çdo gjest është i neveritshëm.

«Gryka e tyre është një varr i hapur... goja e tyre është plot mallkim dhe hidhërim».
(Romakëve 3:13-14)

Por kundër këtij ambienti ndriçon drita e jashtëzakonshme e dashurisë së Zotit. Sepse është e vërtetë se kushdo që beson – çdo njeri i tillë – mund të ketë jetë të përjetshme. Zoti më dërgoi në burg për t'u sjellë atyre Lajmin e Mirë.

NJË LETËR NGA NJË I BURGOSUR I KRISHTERË RUS

Pushime ekstreme

IRAN: NJE QYTET BREGDETAR

«Tani jemi me pushime, e dashur, – i tha pastori iranian gruas së tij. – Të lutem, mos bëj asgjë që do të detyrojë policinë të na marrë në pyetje. Le të mos e shkatërrojme këtë kohë së bashku.»

Gruaja e pastorit ishte dëshmitare shëtitëse për Jezu Krishtin. Ajo u kishte shpërndarë mijëra Bibla myslimanëve në Iran dhe mbi pesë mijë kopje të filmit *JEZUS*.

Në qytetin bregdetar kur ishin duke pushuar, shkuan në një dyqan. Ata u ndanë për të kërkuar gjëra të ndryshme që donin dhe kur pastori u kthye, e gjeti gruan e tij duke i treguar një grupi të madh njerëzish në dyqan për Jezu Krishtin.

Duke vështruar përreth për policinë sekrete, ai me nxitim e nxori gruan jashtë dyqanit për në makinë. «E dashur, jemi me *pushime*. Mendoja se s'do ta bënim këtë gjë këtu.»

Ajo e vështroi në sy. «Ka shumë njerëz në atë dyqan që nuk e njohin Jezusin», – tha ajo seriozisht. «Nëse ata vdesin dhe shkojnë në ferr, ti je përgjegjes.»

Pastori i zënë ngushtë e ktheu makinën dhe u kthye në dyqan. Me shpejtësi gruaja e tij u kthye brenda, duke dhënë kopje të Shkrimit dhe filmin *JEZUS*.

Një zonjë doli përpara. «Oh, faleminderit shumë!» – tha ajo e përbotur. «Kam pesë vjet që lutem për një Bibël dhe tani Zoti iu përgjigj lutjes sime.»

Pushimet krijojnë kujtime të bukura, shëtitje në plazh, pazar në qytet, lexime pranë zjarrit. Po aq sa kemi nevojë të shkëputemi nga rutina e përditshme, po aq edhe nuk duhet të shkëputemi nga dëshmia jonë. Në fakt, dëshmia jonë duhet të jetë po aq pjesë e personalitetit, sa s'mund t'i ndajmë të dyja. Apostulli Pal nuk shkoi asnjëherë diku si »turist«. Për njerëz si gruaja e pastorit në këtë histori, dëshmia nuk është diçka që mund ta ndezin e shuajnë si një çelës drite. Dëshmia e tyre e guximshme është thjesht se kush janë ata dhe vjen natyrshëm me kohë e pa kohë. Gjë e panatyrshme është besimi i veçuar – i cili është i rremë. Përkundrazi, le të rritet besimi yt lirshëm në përvojat e përditshme.

*Prediko fjalën; ngul këmbë me kohë
e pa kohë.*

2 Timoteut 4:2

FKSTREM

Përgjigje ekstreme

AFRIKA E VERIUT: NJË BESIMTAR I RI

«Pse i vazhdoni këto takime? – e pyeti policia të krishterën. – Mendoni se komshinjtë tuaj nuk do të na raportojnë?»

I riu ishte i krishterë i ri, por tashmë kishte drejtuar njëzet të tjerë te Krishti. Ata po luteshin që Zoti të siguronte një vend ku të adhuronin së bashku.

Për tri javë, të krishterët afrikano-veriorë takoheshin në një apartament – një mbledhje ilegale që mund të çonte në arrestimin e tyre. Adhurimi dhe këngët e tyre zgjonin komshinjtë, të cilët i raportonin në policinë sekrete.

Tre herë i krishterë i ri është thirrur për t'u marrë në pyetje.

«A flisni kundër islamit?» – pyeti oficeri gjatë marrjes së tretë në pyetje.

«Jo, – iu përgjigj i krishterë. – Ne s'kemi të bëjmë fare me islamin. Ne adhurojmë Jezusin.»

«A flisni kundër udhëheqësve tanë?»

«Jo, zotëri. Ne lutemi për udhëheqës të tanë, ashtu si na ka thënë Jezusi.»

«Pse nuk gjeni një vend tjetër për t'u takuar? Atëherë, komshinjtë tuaj nuk do t'ju raportojnë më.»

«Po si? Ne s'kemi lejen e duhur.»

Oficeri u zgjat drejt tavolinës së tij dhe nxori një formular. Ai shkroi për disa minuta dhe ia dorëzoi formularin të krishterit. U siguronte të krishterëve të drejtën për t'u takuar në një ndërtesë kisha që nuk përdorej më. Një ndërtesë e bukur dhe lejen e qeverisë për t'u takuar atje – ishte plotësimi i lutjeve të tyre.

Nuk ekziston një gjë e tillë si lutje e paplotësuar. Zoti plotëson gjithmonë secilën prej lutjeve tona. Por, ai mund të mos i plotësojë në mënyrën se si lutemi ne. Ndonjëherë përgjigjja është «Prit». Ne duhet të presim kohën e tij me qëllim që të ecim përpara. Ndonjëherë përgjigjja për ne është «Rritu». Kërkesa jonë është pikërisht në shenjë, por duhet akoma të rritemi me qëllim që të ecim përpara. Por, ndonjëherë ne zhgënjehemi kur dëgjojmë që përgjigjja e tij është «Jo». Kërkesa jonë nuk është në pajtim me vullnetin e tij, ose nuk është koha e duhur. Dhe ndonjëherë përgjigjja është: «Shko». Kërkesa jote ka qëlluar në shenjë. Ne jemi shpirtërisht të përgatitur dhe është koha e duhur. Cila është përgjigjja e Zotit për lutjen tënde tani?

Unë të drejtohem ty, o Perëndi, sepse ti m'i plotëson lutjet, zgjat veshët e tu ndaj meje, dëgjo fjalët e mia

Psalmi 17:6

FKSTREM

Ngurrim ekstrem

IRAN: PASTOR ROUBAK

Ishte pasmesnate dhe i burgosuri ishte i lodhur. Ishte në mes të njëzet e tetë ditëve të izolimit në burgun iranian, duke u lutur që Zoti do ta ndihmonte ta përballonte. Kur dëgjoi një të trokitur në derën e qelisë, ishte i lodhur dhe i acaruar.

«Pastor, – tha roja – Dua të flas me ty për Jezusin.»

«Largohu! – iu hakërrye pastori. Nuk dua të flas me ty.»

«Por, ju duhet të flisni me mua, – tha roja. Ju jeni pastor.»

Roja i ri iranian kishte shumë pyetje. Ai donte të dinte për ndryshimin midis islamit dhe krishterimit, midis kërkesave të rënda të Allahut dhe thirrjes së dashur të një Ati qiellor.

Për katër orë të dy burrat biseduan dhe pastori i shpjegoi besimin e krishterë, shpëtimin nga mëkatet falë vdekjes së Jezusit në kryq dhe se si mund të pranonte Krishtin në jetën e tij.

Në 04:30 të mëngjesit tjetër, dy burrat u lutën së bashku. Me lot që u rridhin në fytyrë, roja pranoi Krishtin. Me lot edhe në vetë sytë e tij, pastori e mirëpriti atë në mbretërinë e Zotit.

Ndërsa roja hyri në një jetë të re, pastori ndjeu ndryshimin në zemrën e tij. «Për herë të parë, – tha ai më vonë, – i gjithë hidhërimi kishte ikur.» Ai ndjeu vetëm dashuri për robëruesit e tij dhe për myslimanët në vendlindjen e tij. Shërbesa e tij u rrit shumë pas atij çasti.

Mobiliet që trashëgohen nga brezi në brez krijojnë në ndjenja atë që i mungon në bukuri. Një karrige e veçantë që u përkiste gjyshërve tuaj mban kujtime të veçanta, të cilat ju bëjnë të verbër ndaj njollave dhe shenjave të tjera të konsumimit. Një dollap rrobash dru kedri i konsumuar dhe i gërvishtur i mbajtur më parë nga një i afërm i veçantë është një thesar i veçantë me një vlerë të pallogaritshme. Në të njëjtën mënyrë Zoti mund të na japë dashuri të veçantë për të pakëndshmit. Ai mund të na ndihmojë të shohim vlerën në të pavlefshmit. Dashuria e Tij mund t'i lërë në hije gabimet e një personi tjetër – ashtu si bën ai me mëkatet tona. Provoje e shih. Kërkoji Zotit të të ndihmojë të duash të padashurin duke parë të tjerët përmes syve të tij.

...duke i mësuar me butësi kundërshtarët,
me shpresë se Perëndia ua jep atyre
të pendohen, që arrijnë të njohin të
vërtetën.

2 Timoteut 2:25

FKSTREM

Misionar ekstrem

IRIANJAIA: STANLI ALBERT DEIL

Të gjitha shigjetat goditën në trupin e tij dhe Stanli Albert Deil i hoqi një nga një dhe theu drurin e heshtës në gju. Gjaku rrodhi prej plagëve të tij të shumta në shtratin e lumit. Luftëtarët J alas ulërinin dhe kishin frikë se njeriu i bardhë, ose *duong* ishte i pavdekshëm.

Tashmë, J alasit në një fshat tjetër ishin përpjekur të vrisnin Deilin. Ata ishin të frikësuar nga mesazhi i tij, sepse ndjekësit e tij kishin djegur idhujt e tyre tradicionalë dhe vendet e adhurimit të shpirtave. Ata gjithashtu i kishin qëlluar Deilit, por *duong* ishte larguar dhe ishte shëruar plotësisht.

Deili kishte ardhur në malet e Irianjais (sot pjesë e Indonezisë) në vitin 1960 për t'u treguar njerëzve për dashurinë e Krishtit. Tani, duke u përballur me qindra luftëtarë ulëritës, ai hoqi shigjetat prej trupit sapo ato kishin shpuar lëkurën.

Këta J alas ishin paralajmëruar që shpirti brenda tij ishte shumë i fuqishëm. Më në fund, Deili dhe misionari tjetër ranë. Më tepër se gjashtëdhjetë shigjeta të thyera ishin grumbulluar në këmbët e Deilit. Luftëtarët copëtuan pjesët e trupit të tij nga frika se mos ringjallej.

J alasit menduan se ky do të ishte fundi i mesazhit të ungjillit në luginën e tyre, por nuk ishte kështu. Të krishterë të tjerë erdhën dhe shumë prej të njëjtëve luftëtarë që kishin hedhur shigjeta në trupin e Deilit, u bënë besimtarë. Duongu, i cili nuk vdiste, tani feston Jezusin bashkë me vrasësit e vet të kthyer në besim.

Megjithëse J alasit mendonin se trupi tokësor i Deilit ishte i pavdekshëm, ishte në fakt shpirti i tij që nuk do të vdiste. Misionarët, të cilët ndoqën gjurmët e Deilit, i ndihmuan J alasit të kuptonin përjetësinë. Ata u treguan J alasve për Zotin. Mendoni për një çast për ngjarjet, njerëzit dhe gjërat që ju kanë marrë pjesën më të madhe të kohës javën e shkuar. Sigurisht, ana praktike e jetës na thërret për t'u marrë me gjëra, të cilat zor se kanë të bëjnë me gjëra të përjetshme: pelena të pista, telefona që bien, pastrimi kimik dhe stërvitja e futbollit. Megjithatë, historia e Deilit na kujton t'u japim prioritet gjërave që kanë rëndësi në përjetësi. Cila pjesë e jetës sate të përditshme ka rëndësi të përjetshme? Nëse nuk siguron kohë për to, kush do ta sigurojë për ty?

Ai ka vënë madje përjetësinë në zemrat e tyre

Predikuesit 3:11

FKSTREM

Një poemë tjetër ekstreme

RUSI: ALEKSANDER ZATSEPA

Kur Aleksandër Zatsepa, një ushtar rus në ushtrinë komuniste, u vra në luftë, kjo poemë u gjet në veshjen e tij:

Më dëgjo, o Zot;
kurrë në jetën time s'të kam folur
Por e ndiej tani, të të dërgoj përshëndetjen
time.
Ti e di se që nga fëmijëria ata më kanë
thënë se ti nuk ekziston.
Unë, si budalla u besova.
Asnjëherë s'e kam vënë në dyshim krijimin
tënd
Por përsëri, sonte duke vështruar lart prej
gropës së artilierisë,
u mahnitua prej yjeve vezullues atje lart
dhe papritur e kuptova mizorinë e gë-
njeshtrës.
Pyes veten, a do të më zgjatësh dorën
tënde, o Zot?
Por do të tregoj dhe ti do të më kuptosh.
A nuk është e çuditshme që drita të vijë
mbi mua
dhe të të shoh në mes të kësaj nate ferri...?
Megjithëse nuk kam qenë mik me ty më
parë,
A do të më lejosh akoma të hyj tani, kur të
vij?
Pse, unë po thërras! O Perëndi, Zoti im, ti e
sheh çfarë më ndodh.
Sot sytë e mi u hapën.

Mirupafshim, Zoti im! Unë po shkoj dhe
nuk ka të ngjarë të kthehem.
E çuditshme, apo jo? Por vdekjen nuk e
kam më frikë.

*Martirët na mësojnë për besnikërinë e Zotit,
paqen e tij, dashurinë dhe mbrojtjen e tij.
Megjithatë, historitë e martirëve nuk kanë
të bëjnë vetëm me vetë martirët, por edhe
me armiqtë e tyre. Ata që janë kthyer nga
komunizmi në krishterim tregojnë një tjetër
anë të historisë. Ata zbulojnë durimin e
Zotit, hirin e tij, gatishmërinë e tij për të
falur, madje edhe mëkatarin më të keq, i
cili kërkon faljen e tij. Poema e Aleksandrit
i jep zë përgjërimit të çdo mëkatarit të
penduar, «sytë e të cilit janë hapur» ndaj
së vërtetës. Kjo histori na kujton se ne i
shërbejmë një Zoti të dashur, i cili dëshiron
shumë që ne të kuptojmë kush është Jezusi
dhe të vijmë tek ai për shpëtim. Ky është
mesazhi i mrekullueshëm i martirëve. A
është ky edhe yti?*


*Zoti është i durueshëm ndaj nesh sepse
nuk do që ndokush të humbasë, por që të
gjithë të vijmë në pendim.*

2 Pjetrit 3:9

FKSTREM

Rrezik ekstrem

AFGANISTAN: ERIK DHE EVA BARENDSEN



Njerëzit vinin prej shumë larg për të kërkuar ndihmë dhe mjekime nga Eva Barendsen dhe bashkëshorti i saj. Shtëpia e tyre modeste në Kabul, Afganistan, u bë një vend shprese për mijëra afganë – si myslimanë edhe të krishterë. Ata i thoshin gjithkujt që pyeste se kishin ardhur për t'i shërbyer Jezu Krishtit, megjithatë misioni i tyre i bëri shënjestër për kundërshtarët.

Eriku dhe Eva morën një leje të shkurtër në vitin 1980, por shumë shpejt u kthyen në vendin e shkatërruar nga lufta, i cili ishte bërë shtëpia e tyre. «Si mund të ktheheni? – pyetën disa. – A nuk shqetësoheni? A nuk do të jetë e rrezikshme?»

Eriku dhe Eva nuk e shihnin rrezikun; ata shihnin mundësinë, nuk shihnin vrasës të mundshëm, por potencial të krishterë. «Unë njoh vetëm një rrezik të madh, – tha Eva. – Rreziku i vetëm është të mos gjendemi në qendër të vullnetit të Zotit.»

Ata u kthyen në Afganistan, bashkë me fëmijët e tyre me moshë pesë dhe tre vjeç. Shumë shpejt pas kthimit të tyre, u sulmuan në shtëpi, e cila shërbente gjithashtu edhe si vend takimi për personat e kthyer në të krishterë. Ata u vranë me thikë, duke i lënë fëmijët jetimë. Por kishin paqe edhe në ato çaste të fundit.

Ditë para vrasjes, e ëma e Evës pati një vizion të Erikut dhe Evës në parajsë, me engjëj që i vendosnin kurora ari në kokë. Vizioni i dha asaj fuqi, madje edhe në pikëllimin e saj kur mori vesh më vonë për vrasjen e tyre.

Në një shtet mysliman, të qenit i krishterë aktiv është një nga gjërat më të rrezikshme të mundshme. Megjithatë, Eriku dhe Eva nuk e morën parasysh idenë e rrezikut. Ndërsa miqtë e tyre thoshin se s'mund t'ia dilnin të qëndronin në Kabul, Eriku dhe Eva e ndienin se s'mund të ishin në asnjë vend tjetër. Ata e shihnin atë si thirrjen e tyre, e kuptuan se ishte vullneti i Zotit. Është thënë se kur dalim jashtë gjithëpushtetshmërisë së Zotit, rrezikojmë të humbasim mbrojtjen e tij. Nëse rreziku i vetëm është të qenit jashtë qendrës së vullnetit të Zotit, është i vetmi që s'mund ta ndërmarrim. Sa shpesh e vendosni veten në më tepër rrezik duke e anashkaluar Zotin në emër të vetëruajtjes? Bindja ekstreme e vendos rrezikun në perspektivë.

Sepse ne jemi bërë pjesëtarë të Krishtit, në qoftë se do ta ruajmë të palëkundur deri në fund fillimin e besimit...

Hebrenjve 3:14

**Atje ku nuk ka kryq, nuk ka kurorë.
Ky mësim s'mund të mësohet nga librat
Dhe njerëzit nuk e shijojnë zakonisht
këtë ëmbëlsi. Kjo jetë e pasur nuk ekziston
në një mjedis të rehatshëm.
Nëse erëzat nuk rafinohen për t'u bërë vaj,
nuk mund të vijë aroma e parfumit;
dhe nëse rrushi nuk shtypet në vozë,
nuk bëhet vera.**

NGA NJË I KRISHTERË KINEZ

«Merruni mobiliet dhe kërkoni në shtëpi për Bibla!» – tha roja që urdhëronte. Zonjës Jing iu mbushën sytë me lot ndërsa shihte katër rojat komunistë t'i plaçkisnin shtëpinë.

«I gjeta!» – thirri roja. Por ndërsa roja nxori Biblën për t'ia dhënë oficerit, zonja Lu Jing ia rrëmbeu me guxim.

«Ky libër përmban gjithçka që kam nevojë të di për Zotin tim të dashur dhe Shpëtimtarin tim, Jezu Krishtin, dhe s'dua të ndahem prej tij.» – tha ajo me zjarr ndërsa e mbante Biblën fort pas kraharorit.

«Nxirreni jashtë,! – thirri komandanti. – Do ta shohim sa gjatë do të kapet pas librit të saj rreth Jezusit.»

Katër rojat komunistë e nxorën zonjën Jing në rrugë, e tallën, e pështynë, e rrahën derisa s'mund të qëndronte më. «A beson akoma në librin tënd të miteve?» – qeshën rojat.

Përmes gojës së enjtur dhe të gjakosur, duke mbajtur akoma Biblën e saj, Lu Jing dolën fjalët e deklaratës së saj të besimit.

Rojat morën një shufër hekuri dhe ia thyen kockat e duarve duke e gjymtuar që të mos mbante më gjë në duar. Bibla i ra në rrugë dhe iu konfiskua.

Pothuajse njëzet vjet më vonë, një mision i dërgoi zonjës Jing një Bibël. Sytë iu mbushën me lot. Ajo e kapi me duart e saj të deformuara dhe pëshpëriti: «Këtë herë nuk e lë të më ikë».

Shumë njerëz kapen plotësisht pas gjysmë të vërtetave. Nëse janë ateistë apo agnostikë, budistë apo hinduistë, i gjithë përkushtimi që zotërojnë s'mund t'i transformojë besimet e tyre të rreme në fakte. Sinqeriteti i tyre nuk është zëvendësi për mungesën e substancës. Në kontrast, të krishterët kanë një siguri të pandryshueshme që Fjala e Zotit mbështet besimin e tyre dhe ata e dinë se është e vërteta. Ne s'mund ta trajtojmë Biblën me pakujdesi, megjithëse të tjerët na kundërshtojnë me gjithë forcën e tyre. A je ti po aq këmbëngulës në mbajtjen e Fjalës së Zotit, si je edhe me gjërat e tjera të vlefshme në jetën tënde, siç janë paratë, apo reputacioni yt? Lëri gjërat e tjera të shkojnë, por kapu pas Fjalës së Zotit me çdo kusht.

Fjalët e Zotit
janë të pastra.

Psalmi 1:6

«Fantazmë» ekstreme

KINË: MIZHONG MIAO

Kushtet në kampin e punës kinez ishin mizore. Me racione shumë të vogla dhe me temperatura ngrirëse në dimër, shpërtheu një epidemi në kamp. Kur filloi dimri, kishte një mijë e treqind të burgosur. Kur erdhi pranvera, vetëm dyqind e pesëdhjetë kishin mbijetuar.

Mizhong Miao u dërgua në kamp, sepse predikonte ungjillin dhe refuzonte të mohonte besimin e tij. Dënimi i tij pesëvjeçar iu trefishua kur refuzoi të ndalonte së predikuari të burgosurve të tjerë.

Gjatë dimrit të ashpër, rojat mendonin se Mizhong Miao kishte vdekur. Jeta dukej se e kishte lënë trupin pothuajse të ngrirë, por shpirti i Miaos ishte gjallë dhe ishte duke u lutur. I lënë vetëm në morg, ai pa një vizitor – një engjëll të veshur në të bardha dhe me fytyrë rrëzëlyese. Engjëlli u afrua dhe fryu mbi Miaon. Ndërsa engjëlli fryu, ai ndjeu sëmundjen t'i largohej prej trupit dhe ngrohtësinë t'i vinte dhe u ul menjëherë në gjunjë e tha një lutje falënderimi.

Ai doli prej morgut për te mjeku i burgut. Mjeku e vështrroi me një shikim të tmerruar në fytyrë; ai mendoi se po shihte një fantazmë.

«Mos ki frikë! Jam Mizhong Miao. – tha i krishteri. – Zoti më riktheu shëndet, më dërgoi për t'ju treguar rrugën e tij.»

Duke u përkulur me nderim, mjeku tha: «Zoti yt është i vërtetë». Atë natë ai pranoi Krishtin si Shpëtimtar.

Të shohësh do të thotë të besosh. Ne mund të flasim për Perëndinë, mund të mësojmë për Jezusin, por duhet ta përjetojmë atë me besim, që të mund të rrëfejme bashkë me mjekun: «Zoti është i vërtetë». Mundësitë që një mjek të vinte te Krishti në kampin kinez të punës ishin shumë të pakta. Megjithatë, kur ai u ballafaqua me një mrekulli të gjallë, vendosi t'i besonte Zotit të Mizhong Miaos. Ndonjëherë ne mund të ndihemi sikur njerëzit tanë të dashur përballen me situata të ngjashme, duhet të lutemi që ata të përjetojnë Zotin. Ata mund ta ndeshin atë përmes krijimit, mund ta shohin të veprojë nëpërmjet një marrëdhënieje dashurie. Ndërsa mrekulli si të Mizhong Miaos janë të pakta, lutu për njerëzit e tu të dashur të kenë një takim jetëndryshues me Zotin e dashur e të gjallë.

Ata iu afruan Filipit ...dhe iu lutën:
»Zotëri, dëshirojmë ta shohim Jezusin«.

Gjoni 12:21

«Marrëveshje» ekstreme

EVROPA LINDORE: SHOKE BURGU

Predikuesi po theksonte pikën e parë kur rojat e burgut hynë me furi në dhomë duke e rrëmbyer dhe duke përplasur në dysHEME të gjithë të tjerët.

«Ti e di që të predikosh është e ndaluar, – ulëriti njëri prej tyre. – Tani do të përballesh me ndëshkimin.» Rojat e fuqishëm e tërhoqën zvarrë nga qelia, në fund të korridorit. Të burgosurit e tjerë e dinin që rojat komunistë në Evropën Lindore po e çonin mikun e tyre në «dhomën e rrahjes». Ata dëgjuan derën e asaj dhome të tmerrshme dhe pastaj të klithura të mbytyra ndërsa rojat rrihnin pa mëshirë shokun e tyre.

Kishte kaluar pothuajse një orë para se rojat të shpërthenin derën e qelisë dhe të shtynin brenda burrin, i cili kishte qenë duke predikuar. Të burgosurit e tjerë panë që rrobat e tij ishin të gjakosura dhe në fytyrë kishte shenjat e rrahjes. Ai vështroi përreth te shokët e tij të qelisë, pothuajse sikur po shihte pjesëmarrjen.

«Tani, vëllezërit e mi, – tha ai, – ku e lashë kur na ndërpre në mënyrë jo të sjellshme?» Dhe predikimi vazhdoi. Të krishterët në burg e dinin çmimin që duhet të paguanin për të predikuar dhe përsëri shumë prej tyre predikonin. Disa, pa formim teologjik apo përvoja në shërbesë predikonin rrjedhshëm e me zjarr në burg.

«Ishte si një marrëveshje, – shkroi një i burgosur më vonë. – Ne predikonim dhe ata na rrihnin. Ne ishim të lumtur të predikonim dhe ata ishin të lumtur të na rrihnin. Kështu të gjithë ishim të lumtur.»

Në një botë ku një kontratë nuk është më e detyrueshme, një familje është e shpërbëshme dhe divorcet ua kalojnë martesave, të krishterët duhet të rivendosin kuptimin e përkushtimit – me çdo kusht. Cila është vlera e një premtimi, nëse nuk do të thotë asgjë? Megjithatë, pasojat e përkushtimit tonë ndaj Krishtit nuk janë të lira. Mund të na kushtojë mundësinë për të qenë shumë të suksesshëm sipas standardeve të botës. Mund të na kushtojë miqtë dhe popullaritetin. Mund të na kushtojë familjen, sigurinë tonë dhe për disa, madje, edhe jetën tonë. Përkushtimi duhet të ketë një çmim. Të burgosurit e kuptuan atë mjaft mirë, por shpërblimi i Krishtit është gjithashtu pjesë e përfitimit. A je duke e respektuar marrëveshjen?

Ti ke duruar, ke qëndrueshmëri dhe për hir të emrit tim je munduar pa u lodhur.

Zbulesa 2:3

Thirrje ekstreme

RUMANI: KAPITENI REK

Për ditë të tëra, rojat komunistë e rrihnin pastorin e burgosur, e ndihmonin të merrte fuqi me ushqim të mirë dhe pastaj e rrihnin përsëri. Ai rrihej sistematikisht për vdekje, por jo një vdekje të shpejtë. Ata donin që ai të vuante.

Kapiteni Rec tha një ditë ndërsa rrahu pastorin: «Unë jam Zot. Unë kam pushtetin e jetës dhe vdekjes mbi ty. Ai që është në qiell s'mund të vendosë të të mbajë në jetë. Gjithçka varet nga unë. Nëse dua, ti jeton ose vdes. *Unë jam Zoti!*»

Pastori iu përgjigj me qetësi: «Ti nuk e di se çfarë gjëje të thellë ke thënë. Ti nuk je krijuar për të qenë torturues, njeri që vret. Ti u krijove për të qenë si Zoti, me jetën e tij në zemër. Shumë persekutues si puna jote e kanë kuptuar që është e turpshme për njeriun të kryejë krime, kështu bëri dhe apostulli Pal. Ata mund të bëjnë gjëra shumë më të mira. Besomë, kapiten Rec, thirrja jote është të jesh si Zoti, e jo të jesh Zoti. Ti mund të kesh karakterin e Zotit, e jo të një torturuesi».

Reku u shtir sikur nuk i dëgjoi fjalët e të krishterit dhe vazhdoi ta rrihte pastorin për besimin e tij. Megjithatë, ai s'mund të mos mendonte për thirrjen e tij. Në fakt, i përlurur në gjunjë, Rec i pranoi Krishtin në zemrën e tij.

Çdo vemje, është në të vërtetë një flutur, nëse zhvillohet si duhet. Nëse jo, ajo mund të vazhdojë të jetojë. Megjithatë, është diçka që nuk ishte për qëllim të ishte e tillë. Në të njëjtën mënyrë, thirrja jonë e vërtetë si njerëz është të hyjmë në një marrëdhënie personale me Jezun Krishtin dhe të zhvillojmë karakter të krishterë. Pa Krishtin, ne përsëri mund të jemi shumë të realizuar, me autoritet. Mund të bëjmë shumë gjëra të admirueshme, mund të jemi – një biznesmen i suksesshëm, një nënë e dashur, një baba i përkushtuar. Por nëse humbasim thirrjen tonë të vërtetë, nuk bëhemi asnjëherë personi që u krijuam të ishim në fillim. Një vemje është interesante, por një flutur ia kalon në bukuri dhe aftësi. A ke pasur një jetë me sukses në botë, por përsëri ke humbur thirrjen tënde të vërtetë?

*Tani atij që, sipas fuqisë që vepron në ne,
mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa
kërkojmë ose mendojmë...*

Efesianëve 3:20

FKSTREM

Kufizime ekstreme

BABILONI: SHADRAKU, MESHAKU DHE ABEDNEGO

«Ne nuk duhet ta mbrojmë veten para teje për këtë çështje. Nëse hidhemi në furrën e ndezur, Perëndia të cilit i shërbejmë është në gjendje të na shpëtojë prej saj dhe nga dora juaj, o mbret. Por edhe nëse nuk na shpëton, duam ta dish se nuk do t'u shërbejmë perëndive të tua apo të adhurojmë imazhin prej ari që ju keni krijuar.» (Bazuar te Danieli 3:16-18).

Zemërimi i mbretit u ndez ndaj tre të rinjve. Ata kishin refuzuar të përuleshin para idhullit që ai kishte krijuar për vendin e tij, një krim i dënueshëm me vdekje në zjarr. «Ndizni furrën, – urdhëroi ai. – E dua shtatë herë më të nxehtë se normalisht.» Shtatë burrat më të fortë të ushtrisë së tij erdhën dhe u lidhën duart. Furra bubullonte dhe muret e saj shndrisnin në të kuqe sikur të ishte gati për t'u shkrirë. »Hidhini brenda!» – urdhëroi mbreti.

Ndërkohë që bënë këtë, vetë ushtarët morën flakë senxehtësia ishte shumë e madhe. Të burgosurit humbën në çast midis flakëve që shkëlqenin aq shumë, sa s'mund të shihej drejt furrës.

Pastaj, ndërsa ishte duke parë, Nebukadnetsari u hodh përpjetë nga habia. Ai tha: «Shikoni! Unë shoh katër burra që po ecin në zjarr, të zgjidhur dhe të paprekur dhe i katërti i përngjan një Biri të Perëndisë» (Danieli 3:25)

Papritur Nebukadnetsari i njohu kufizimet e tij para të vetmit Perëndi të vërtetë.

Kur vjen puna te beteja midis së mirës dhe së keqes, ky nuk është luftim i drejtë. Armiku është i fuqishëm, por Perëndia është më i fuqishëm. Satani është i fortë, por Perëndia është edhe më i fuqishëm. Satani mund të dërgojë djajtë e tij në mbarë botën për të kryer të keqen. Në kontrast, Perëndia është i gjithëpranishëm – plotësisht i pranishëm në të gjitha vendet, gjatë gjithë kohës. Edhe pse është kështu, kufizimet e armikut nuk janë gjithnjë aq të dukshme kur jemi nën presion nga kundërshtari. Në këtë kohë, armiku duket i tmerrshëm, i frikshëm, përpjës. Ne harrojmë përkohësisht fuqinë e pakufishme të Perëndisë. A i ke sytë te termostati kur je në furrën e armikut, apo fokusohesh në praninë e Perëndisë dhe gjen fuqi për të duruar nxehtësinë?

Sepse nuk ka asnjë perëndi që mund të shpëtojë në këtë mënyrë.

Danieli 3:29

FKSTREM

Duartrokitje ekstreme

ANGLI: TOMAS HUKER

Tomas Huker, një zotëri i ri dhe i pashëm, nuk e mohonte marrëdhënien e tij personale me Krishtin. Për këtë u dënua të vdiste në turrën e druve.

Ditë para ekzekutimit të tij, miqtë e Tomasit erdhën në qelinë e burgut anglez. Njëri tha: «Kam dëgjuar që Zoti u jep hir të veçantë atyre që vdesin në zjarr, që i aftëson të durojnë flakët. Për hatrin tënd që të jem në gjendje të duroj këtë mizori ndaj teje, a mund të na japësh ndonjë shenjë për këtë? Pa e ditur, nuk besoj se do të duroj atë ditë».

Tomasi mendoi për një çast. «Nëse furia e dhimbjes mund të tolerohet, para se të vdes do të ngre duart në qiell si tregues.»


Në ditën e ekzekutimit, turma gumëzhinte prej premtimit të Tomasit. Ndërsa u lidh në turrën e druve, ai u foli me qetësi dhe me hir të madh burrave që vendosnin drurët. Pastaj mbylli sytë dhe zjarri u ndez.

Tomasi vazhdoi t'u predikonte atyre rreth tij, por shumë shpejt prej kërcëllitjes së flakëve, nuk mundi. Të gjithë ishin të sigurt se kishte vdekur. Papritur duart e tij u ngritën mbi kokë drejt Zotit të tij dhe me lavdërim dhe falënderim duartrokiti tri herë. Një thirrje u ngrit prej turmës dhe Tomasi u zhyt në flakë dhe dha shpirt.

«S'mund të duroj më! Sa shpesh e gjejmë veten duke shprehur irritim në sprovën më të vogël. Një fëmijë qaraman, një dorezë dere, një natë e vonë me një afat të fundit të një projekti. Megjithatë, historia e martirëve u zë vendin mendimeve tona të parëndësishme kur duam të dorëzohemi nën presion. Ne shpesh i ekzagjerojmë problemet tona dhe nënvlerësojmë aftësinë për t'i duruar. Në fakt, Zoti na premtonte se nuk do të lejojë asgjë në jetën tonë që do të jetë më tepër se ç'mund të mbajmë. Tomasi, me duart e ngritura në adhurim, duke sinjalizuar triumfin e tij mbi flakët, është fakt i mjaftueshëm. Kur ti mendon se s'mund ta durosh më një situatë, kujto Tomasin dhe besnikërinë e Zotit. Ai e di mjaft mirë se çfarë mund dhe s'mund të durosh.»

Ne nuk kemi për qëllim të fitojmë gjërat e dukshme, por ato që nuk shihen...

2 Korintasve 4:18



**O Zot, prano gjithë vuajtjet e mia,
lodhjen, përbuzjen ndaj meje, lotët e mi,
nostalgjinë, urinë time,
vuajtjet e mia nga të ftohtët,
Të gjithë hidhërimin tim të
grumbulluar në shpirt.**

**I dashur Zot,
ki mëshirë gjithashtu për
ata që na persekutojnë
dhe natorturojnë natë e ditë.**

**Jepu edhe atyre hirin hyjnor të njohin
ëmbëlsinë dhe lumturinë e dashurisë sate.**

**NGA NJË GRUA E KRISHTERE, E CILA PO SHËRBENTE NË KAMPIN E
PUNES TË SIBERISË, VORKUTA**

Reformator ekstrem

GJERMANI: MARTIN LUTER

Në 31 tetor të vitit 1517, Martin Luter gozhdoi nëntëdhjetë e pesë pohime biblike besimi në derën e kishës në Uitenberg, Gjermani, dhe e kaloi pjesën tjetër të ditëve vetëm një hap larg ekzekutimit. Pavarësisht nga ky rrezik, Luteri asnjëherë nuk u largua nga mundësia për të argumentuar vlefshmërinë e doktrinës biblike të shfajësimit me anë të fesë kundër doktrinës së shfajësimit me anë të veprave, që kishte zaptuar kishën në atë kohë.

Megjithëse ishte paralajmëruar vazhdimisht të mos merrte pjesë në mbledhjen në Worms, ai tha: «Përderisa më kanë thirrur, jam i vendosur të marr pjesë, në emër të Zotit tonë, Jezu Krisht; megjithëse e di se ka aq shumë djaj që më kundërshtojnë, sa ka edhe tjegulla që mbulojnë shtëpitë në Worms».

Kur iu tha të tërhiqte doktrinat e tij, Luteri u përgjigj: «Ndërgjegjja ime është aq e lidhur dhe e përfshirë nga Shkrimi dhe Fjala e Perëndisë, sa nuk mundem ose nuk do të tërheq asgjë; nuk e konsideroj të përshpirtshme ose të ligjshme të shkoj kundër ndërgjegjjes sime. Në këtë qëndroj: Nuk kam gjë tjetër për të thënë. Zoti më ndihmoftë!»

Ai shpëtoi prej atyre që e donin të vdekur dhe në ishehtësi përktheu Shkrimet në gjermanisht. Megjithëse ishte vazhdimisht në rrezik, jetoi deri në moshën gjashtëdhjetë e tre vjeç dhe vdiq prej shkaqeve natyrore.

Njerëzit janë të shpejtë për të kritikuar kishën për një gjë apo një tjetër. Si shkrimi i një kritike për një shfaqje të Brodveit, anëtarët e kishës janë shumë të gatshëm për të vlerësuar një shërbesë adhurimi sikur të ishte një shfaqje. Muzika është shumë e lartë, predikimi shumë i shkurtër, vendet nuk janë të rehatshme.

Megjithatë, Luteri nuk ishte kritik, megjithëse nuk e mbështeste kishën e asaj kohe. Ai e qortoi atë. Një qortim është ndryshe nga një kritikë, një qortim e thërret një kishë që është larguar nga Shkrimi përsëri të Fjala e Zotit. Në kontrast, një kritikë është thjesht një opinion apo një preferencë njerëzore. A po i shërben ti me kujdes trupit të Krishtit si Luteri apo thjesht po kritikon kishën e Zotit?

*Predikojte Fjalën, nxit me kohë e pa kohë,
këshillo, qorto, urdhëro me plot durim dhe
mësim!*

2 Timoteut 4:2

«Jeta e një njeriu është vdekje e vazhdueshme, nëse Krishti nuk jeton në të.» – Ignaci

Ignaci ishte dishepull i apostullit Gjon dhe kishte qortuar publikisht perandorin Trajan Antiok për adhurimin e idhujve. Megjithatë, Trajani u betua të hakmerrej me Ignacin për qortimin e tij të sikletshëm.

Ignaci u arrestua dhe e sollën në Romë. Ndërsa u çua në gropën e luanëve, ai i tha një besimtarit tjetër: «Zoti im i dashur, Jezus, është i shkruar aq thellë në zemrën time, sa ndihem i sigurt se edhe po të ma copëtonin, emri i Jezusit do të gjendej në çdo pjesë».

Kur një turmë e madhe njerëzish u mblodhën për të dëshmuar vdekjen e tij, Ignaci iu drejtua me guxim turmës brohoritëse: «Unë jam gruri i Zotit. Jam bluar prej dhëmbëve të bishës, që të mund të jem një bukë e pastër e Krishtit, i cili është për mua Buka e Jetës».

Sapo tha këto fjalë, luanët e uritur e përpinë. Ai e jetoi jetën sipas mbiemrit të tij, Theoforus – «mbajtës i Zotit». Deri në fund mbajti emrin e Zotit dhe shpëtimtarit të tij në buzë. Ai kishte thënë shpesh. «Krishti i kryqëzuar është e gjithë dashuria ime e vetme». Dhe deri në fund gjeti ngushëllim në këtë të vërtetë të thjeshtë: «Ndërsa bota i urren të krishterët, Zoti i do ata».

Tradita e martesës është që një grua të mbajë emrin e bashkëshortit si simbol i bashkimit të tyre. Ata nuk janë më dy njerëz, por një. Ndërsa një çift plaket së bashku, fillojnë të ndajnë më tepër sesa vetëm mbiemrin. Ata kanë të njëjtët miq dhe interesa, fillojnë e përfundojnë fjalitë e njëri-tjetrit dhe disa fillojnë madje edhe t'i ngjajnë njëri-tjetrit... i tillë është intimiteti i tyre jetëgjatë. Në të njëjtën mënyrë, ata që mbajnë emrin «të krishterë» ose «krishter të vegjël» zhvillojnë të njëjtin intimitet – një njëshmëri me Shpëtimtarin. A po e mban mirë emrin e Krishtit? Si Ignaci, a të frymëzon ndarja e emrit të Jezusit për të ndarë vuajtjet e tij, shërbesën dhe jetën e tij?

*Sepse u quajta me emrin tënd, o Zot,
Perëndia i Ushtrive.*

Jeremia 15:16

FKSTREM

Një tjetër pyetje ekstreme

SHTETET E BASHKUARA: SKENARISTËT PËR FËMIJË

«S'mund ta bëjmë këtë pyetje. Nuk e dimë përgjigjen!»

Skenaristët po punonin me një video për fëmijë të quajtur «*Prova e Besimit të Shtjefnit*», në të cilën një djalë i ri udhëton në kohë për të mësuar historinë e persekutimit. Ata po punonin me një skenë në të cilën të krishterët u hidheshin luanëve të uritur pasi akuzoheshin se i kishin vënë flakën Romës.

«Ne s'mund ta bëjmë Shtjefnin të pyesë: 'Nëse Zoti mbrojti Danielin në gropën e luanëve, pse nuk i mbrojti të krishterët në Kolose?' Pse do të mbronte Zoti njërin prej fëmijëve të tij dhe do të lejonte mijëra të tjerë të humbisnin?»

Skenaristi kryesor u mendua dhe u përgjigj: «Problemi nuk është përgjigjia, por pyetja. Ne s'duhet të pyesim «Pse?» Duhet të pyesim: «A jemi gati?» Danieli ishte gati të vdiste para luanëve të uritur. Besimtarët ishin gjithashtu gati të vdisnin në ditët e Neronit. Fakti se njëri shpëtoi dhe të tjerët jo, nuk ndryshon situatën e zemrave të tyre. Është bindja jonë që krijon dëshminë dhe jo veprimi i vuajtjes».

Kur Nebukadnetsari hodhi në furrë Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon, ata thanë: «Perëndia, të cilit i shërbejmë është në gjendje të na shpëtojë prej saj... Por nëse jo, ne duam ta dish, o mbret, se nuk do t'u shërbejmë perëndive tuaja» (Danieli 3:17-18).

Shumë njerëz sot pyesin pse. Ne kemi hyrë në një epokë të re të pyetjeve pa përgjigje që kanë të bëjnë me tragjedi të pashpjegueshme. Bota po thërret për përgjigje ndaj pyetjeve, por ne e dimë se asnjë përgjigje nuk do të jetë e mjaftueshme për të shëruar dhimbjen. Edhe nëse do të dinim arsyen e ndodhjes së tragjedisë në nivel specifik për çdo person, nuk do të vlente për të lehtësuar dhimbjen tonë. Përkundrazi, ne kemi nevojë për besimin e shokëve të Danielit, të cilët thanë se, edhe nëse Perëndia vendos të mos lëvizë në mënyrën për të cilën ne u lutëm që të vepronte, mund të qëndrojmë të sigurt se gjithçka bashkëvepron për të mirën tonë. Në vend që të pyesim pse, duke u përgjyruar për të kuptuar, ne duhet të lutemi për paqe që ta kalojmë atë.

Dhe paqja që jep Perëndia, që është më e vlefshme se mund ta mendojmë, do t'i ruajë zemrat dhe mendimet tuaja në Krishtin Jezus.

Filipianëve 4:7

FKSTREM

Trashëgimi ekstreme

SHTETET E BASHKUARA: ANI HUÇINSON

«Fëmijë, zbrisni poshtë!» – klithi Ana Huçinson ndërsa dëgjoji shigjetat të godisnin derën. Pastaj dëgjoji ulërimat sflitëse të indianëve, të cilët rrethuan shtëpinë e saj. Më tepër shigjeta dukeshin se vinin ngado dhe ajo mund të dëgjonte hapa afër dritares. «Do të të shoh sot, Zot!» – tha Ani.

Ana Huçinson ishte grua e guximshme. Kur ishte njëzet e tre vjeç u burgos tri herë sepse fliste hapur për besimin e saj puritan. Puritanët (ungjillorët brenda kishës anglikane) donin të dëgjonin predikimet për Biblën në shërbesat e tyre kishtarë, sepse pak të krishterë në Angli kishin Bibla në gjuhën angleze.

Ana dhe bashkëshorti i saj, Uilliam, kishin ardhur në Amerikë në vitin 1634 për të kërkuar liri fetare, por edhe në Amerikë u përballën me persekutim, sepse organizonin takime fetare në shtëpitë e tyre. Njerëzit që mbështesnin këtë shërbesë arrestoheshin dhe madje kishin humbur edhe të drejtën për të votuar.

Në moshën dyzet e gjashtë vjeçare dhe shtatzënë me fëmijën e saj të tetëmbëdhjetë, Ana u dënua dhe u burgos për katër muaj. Pasi u përjashtua nga kolonia, familja dhe miqtë e saj filluan një qytet të ri dhe një kishë-shtëpi në Rhode Island.

Me shpirtin e saj pionier, Ana Huçinson ndihmoi ta bënin idenë e lirisë së adhurimit, një ideal amerikan. Ajo dhe pesë fëmijë vdiqën në duart e sulmuesve indianë. Ajo takoi Shpëtimtarin e saj me kurajë dhe besim, ashtu si e kishte jetuar edhe jetën e saj.

Liria nuk është asnjëherë e lirë, ajo gjithmonë të kushton. Jezu Krishti ishte i pari që pagoi çmimin përfundimtar për lirinë fetare – duke na dhënë hyrje te Perëndia nëpërmjet vdekjes në kryq. Ai ishte i vetmi që mund të paguante çmimin për lirinë tonë prej mëkatit. Vdekja dhe ringjallja e tij vendosi liri të vërtetë dhe shumë besimtarë kanë sakrifikuar që atëherë për të mbështetur të drejtën e gjithkujt për të përjetuar liri në Krishtin. Besimtarë si Ana e kanë bërë ëndrrën e lirisë fetare një realitet në Amerikë. Trashëgimia jonë e sakrificës është e madhe. Çfarë çmimi je i gatshëm të paguash që brezi tjetër të përjetojë lirinë fetare që gëzon ti? Kërkoji Zotit të të tregojë si t'ia kalosh këtë brezit tjetër.

Breznia breznisë do t'ia tregojë veprat e tua dhe do ta shpallin pushtetin tënd.

Do ta shpallin madhështinë e shenjtërisë sate,

do t'ia tregojnë mrekullitë e tua.

Psalmi 145:4-5

FKSTREM

Kontrabandist ekstrem

KOREJA E VERIUT: KIKU

«Kërkoni kryqin!» – dëgjoji Kiku, i riu korean prej një fshatari

Fjala u përhap për ata që arratiseshin nga Koreja e Veriut në Kinë, në kërkim të një ndërtese me kryq. Ai më në fund gjeti një dhe bashkë ushqim e veshje, gjeti edhe një marrëdhënie të re me Jezu Krishtin.

Anëtarët e kishës e dishepullizuan Kikut për tre muaj, por ai e dinte se duhet të kthehej në Kore për t'u treguar të tjerëve për Jezusin.

Kikut dhe një besimtar tjetër iu dhanë pesë Bibla dhe ushqim për udhëtimin e tyre. Megjithatë, rojat e kufirit i kapën sapa kaluan lumin për t'u kthyer në Kore.

Rojat zbuluan Biblat që mbanin Kiku dhe shoku i tij dhe një nga ata e rrahu shokun e Kikut për vdekje me një shufër hekuri. Pastaj u kthye nga Kiku, por ai ia doli të arratisëj. Pas disa muajsh, filloi të ndante Krishtin me të tjerë dhe mbolli një kishë të fshehtë në Korenë e Veriut.

Shumë shpejt Kiku e kuptoi se kishte nevojë për më tepër Bibla, pasi numri i besimtarëve po rritej shpejt. Ai u kujtua se si shoku i tij kishte dhënë jetën duke u përpjekur të sillte Fjalën e Zotit në atdhe. Kur Kiku vendosi të kthehej në Kinë për më tepër Bibla, besimtarët ishin në ankth për sigurinë e tij.

Ai e mbajti mend këshillën që iu dha pak kohë më parë dhe thjesht u përgjigj: «Vetëm shiko kryqin».

Kryqi është krijues i polemikave. Shumë njerëz flasin për fenë, por kryqi i bën të mos ndihen rehat dhe madje i ofendon. Kikut iu tha të shihte te kryqi për siguri. Megjithatë, ai s'e kuptoi se armiqtë e tij po kërkonin të njëjtën shenjë dhe për arsye të mirë. Ata e dinin se të krishterët mblidheshin nën shenjën e kryqit. Meqenëse kundërshtonin krishterimin, kryqi u bë armiku i tyre. Armiku ynë shpirtëror e përbuz kryqin me neveri të zjarrtë, frikë dhe urrejtje. A po shikoni ju te kryqi me të njëjtin intensitet të shprehur në gëzim, shpresë dhe mirënjohje? Armiku juaj është i përqendruar te kryqi – si një armik që planifikon një sulm. A je ti po aq të përkushtuar për të mbrojtur, shërbyer dhe për të dashur kryqin?

Sepse, sikurse ju kam thënë shpesh herë e tani po jua them me lot për faqe, shumë jetojnë si armiq të kryqit të Krishtit.

Filipianëve 3:18

«Kur dëgjova avionët të fluturonin në Qendrën Tregtare Botërore në 11 Shtator, m'u rikthyen kujtime të dhimbshme», – tha Nus Reimas, sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Ungjillore të Indonezisë.

«Më tepër se një vit më parë, qindra myslimanë të armatosur mirë, të cilët thuhej se ishin të lidhur me Osama Bin Laden, sulmuan ishujt tanë të Malukut. Misioni i tyre ishte të hiqnin qafe të gjithë të krishterët.» Thuhet se, më tepër se gjashtë mijë njerëz u vranë dhe pesëqind mijë banorë të tjerë u dëbuan prej shtëpive të tyre për shkak të të shtënave të pandërprera dhe zjarrvënies. «Myslimanët vranë tridhjetë e tetë anëtarë të fisit tim», – tha Reimasi mendueshëm.


Në një intervistë në revistën «Krishterimi sot» të dhënë në 22 tetor të vitit 2001, Reimasi tregoi se sa e vështirë ishte për të të zbatonte 1 Selanikasve 5.18: «Falënderoni në çdo situatë, sepe ky është vullneti i Zotit për ju në Krishtin Jezus», Dhimbja ishte aq e madhe dhe shërimi dukej sikur nuk do të vinte asnjëherë. Megjithatë me anë të hirit të Perëndisë, Reimasi kishte vendosur të jetonte atë që mësonte Fjala e Zotit.

«Vetëm mund të ngrihesha dhe të përballesha me situatën. Askush nuk pret gjëra të tilla, por ato ndodhin.» Tani Reimasi organizon takime midis shumë drejtuesve të krishterë nga denominacione të ndryshme. Ashtu si njerëzit në Amerikë janë mbledhur së bashku nga të gjitha rrugët e jetës për mbështetje dhe lutje, shumë drejtues të krishterë bashkohen për t'u lutur dhe për bashkësim në Indonezi. Reimasi buzëqesh ndërsa mendon: «Kjo s'ka ndodhur kurrë më parë».

Ne s'e kemi përjetuar kurrë këtë gjë më parë. Një ndjenjë e shkatërruar e mirësjelljes njerëzore. Kullat Binjake të shkatërruara. Antraksi. Flamuri amerikan i hedhur mbi plagët e Pentagonit. Njerëzit tanë po luten. Kishat tona janë të mbushura. Letrat e divorcit po tërhiqen. Jo, nuk e kemi përjetuar kurrë këtë gjë më parë. Muret që ndanin racat dhe kulturat nga njëra-tjetra janë zhdukur. Princi i errësirës u përpoq të na ndante. Zoti i dashurisë po i tërheq njerëzit drejt vetes. Nuk e ke përjetuar kurrë këtë gjë më parë. Pas gjithçkaje që është thënë e bërë, ne dimë një gjë: nëse do të përjetojmë përsëri të njëjtën gjë, do ta kalojmë së bashku.

Ja, sa e mirë dhe kënaqshme është që vëllezërit të banojnë bashkë në unitet!

Psalmi 133:1



**Çmenduria, shqetësimi për familjen time,
tensioni i vazhdueshëm,
të gjitha më shkatërrojnë.
Por nëse ato më çmendin,
apo qëndroj në gjendje të mirë,
pranoj gjithçka që Zoti dërgon,
ashtu si një fëmijë
pranon çdo gjë nga dora e atit të tij.
Frika është e arsyeshme.
Në azil kam menduar shpesh që vullneti i
Zotit
e ruan të paprekur lirinë e njeriut.**

NGA VËLLAI SHIANOV,
I IZOLUAR NË NJË AZIL PSIKIATRIK PËR BESIMIN E TIJ

«Humbje ekstreme»

ÇEKOSLLOVAKI: VËLLA ZAVARSKI

Përfundimisht zhgënjimi ishte shumë i madh. «Të gjithë kohën e kaloj në punë skllëvërisht! – u ankua i burgosuri çek, vëlla Zavorski. – Dhjetë orë në ditë thur shporta, të cilat komunistët i shesin për goxha para. Pse studiova aq shumë për të qenë pastor? Ata të paudhët në shërbim të komunizmit kanë pozicione të larta në kishë tani. Ata predikojnë, këshillojnë, ushqejnë tufën ndërsa unë vuaj.»

«Pse ankolesh? – tha një i krishterë tjetër në burg. – Zoti nuk ka nevojë për predikimet apo teologjinë tënde. Kukullat e komunizmit e bëjnë këtë punë, por ata s'mund të ndajnë vuajtjet e Shpëtimtarit. Ky është premtimi kryesor që dikush duhet të japë kur shugurohet (zgjidhet pastor). A ke predikuar ndonjëherë për durimin e vuajtjeve për Krishtin? Falëndero Zotin që të ka dhënë mundësinë të përbushësh atë që është pjesa më e vlefshme e çdo predikimi.»

I ndryshuar, Zavorski nuk u ankua më për burgimin e tij apo për ditët e gjata të punës. Pasi u largua nga burgu, Zavorski nuk mund të vazhdonte punën e tij si pastor për shkak se burgimi e kishte lënë shumë të sëmurë. Por vizitorët pranë shtratit të tij nuk gjetën një njeri të rrahur e të rrënuar. Ata panë një njeri, fytyra e të cilit shkëlqente me dashuri për Shpëtimtarin. Ai rrëfeu se jeta nuk humbi, nuk iu vodh, por ai e dha atë me dëshirë për të ndihmuar Jezusin të mbante kryqin e tij.

Çfarë do t'i bënte njerëzit të humbisnin me dëshirë një marrëveshje biznesi, që të mund të jepnin me bujari? Çfarë do t'i bënte njerëzit të linin vendlindjen e tyre të krishterë për një shtet të huaj pagan? Çfarë do ta bënte dikë të vdiste para sesa t'i dorëzohej tundimit? Është një përkushtim ekstrem ndaj personit të Krishtit. Ata shohin një mundësi për fitim shpirtëror në çdo humbje personale. Ata janë gati të goditen personalisht në kuletën, oraret, planet, mirëqenien dhe përfitimet e tyre, me qëllim që të çojnë përpara mbretërinë e Zotit. Si e shpreh ti përkushtimin tënd ekstrem? A mendojnë të tjerët se je i çmendur për shkak të nivelit të përkushtimit tënd? «Të humbësh mendjen» për Jezusin do të thotë fitim i parajsës.

Dhe me të vërtetë i konsideroj të gjitha këto një humbje në krahasim me vlerën e lartë të njohjes së Jezu Krishtit, Zotit tim, për shkak të të cilit i humba të gjitha këto dhe i konsideroj si pleh, që unë të fitoj Krishtin...

Filipianëve 3:8

MEKSTREM

Më tepër revolucionarë ekstremë

PERU: MARIA ELENA MOJANO

Ajo që i zemëroi ata aq sa ta vrisnin, ishte se ky person i kthyer në besim, kishte qenë më parë një terrorist si ata.

Maria Elena Moiano kishte bërë titull me ta për revolucionin në Peru. Ajo kishte thirrur për të ushqyer fshatarët me fuqinë e armës, por më pas takoi Jezu Krishtin dhe gjeti një lloj tjetër revolucion – një revolucion dashurie në zemrën e saj.

Ajo u bë zëvendës kryebashkiakia e qytetit më të madh të barakave të Limës, organizoi punën për ndihma për të arritur më të varfrit e të varfërve, duke ushqyer të uriturit, duke u kujdesur për të sëmurët dhe për jetimët.

«Ata na quajnë ne të krishterëve «zjarrfikës të revolucionit, – tha ajo, – sepse thonë se ne shuajmë zjarrin që ndezin ata. Duan që popullsia të mos ketë absolutisht asgjë për të ngrënë, duke shpresuar se atëherë njerëzit do t'u drejtohen armëve, por ne s'duhet ta kemi frikë terrorin. Duhet ta kundërshtojmë padrejtësinë dhe egërsinë për të ndihmuar ata që janë në nevojë».

Maria e dinte se do të vuante, por dinte edhe se ne duhet të ndajmë vuajtjet e Krishtit para se të ndajmë lavdinë e tij. Terroristët maoistë sulmuan me një tërbim të dhunshëm, duke hedhur në erë ndërtesën ku ndodhej ushqimi për të varfrit. «Ndonjëherë kam frikë, – thosh Maria, – por këmbëngul se s'duhet të përdorim kurrë dhunën. Është

e vështirë ta mundësh terrorizmin, por jo e pamundur».

Të zemëruar me efektivitetin e punës së Marias dhe duke mos qenë në gjendje ta ndalonin atë, gueriliasit e vranë Marian në 1 shkurt të vitit 1992.

Në fakt farisenjtë nuk ishin ekspertë taktikë. Ashtu si terroristët në Lima, strategjia e tyre për të dekurajuar njerëzit për të ndjekur Krishtin solli rezultate të paparashikuara. Si farisenjtë, ashtu edhe terroristët punuan shumë për nënshtrimin e njerëzve. Farisenjtë u përpoqën të vrisnin shpirtrat e njerëzve, ndërsa terroristët u përpoqën të vrisnin trupat e tyre. Megjithatë, njerëzit në Jeruzalem dhe ata në Peru ndoqën mësimet revolucionare të Jezusit në të njëjtën mënyrë. Kundërshtari punon kundër Jezusit për të përparuar kauzën e tij, mund të punojë kundër jush dhe përpjekjeve të tua, por ai nuk do të të mposhtë kurrë kur ju punoni për mbretërinë. Në fakt, kundërshtari mund të punojë pa e ditur, në favorin tënd.

Atëherë farisenjtë thanë midis tyre: «A e shihni se s'po bëni asgjë; ja, bota shkon pas tij».

Gjoni 12:19

Provë ekstreme

RUSI: PASTOR «GEORG»

Duke shëtitur në dhomën e vogël të kishës, kapiteni rus bëri shenjë me kokë në drejtim të kryqit në mur. «Ti e di që ai është një gënjeshtër, – tha ai. – Është vetëm një copë gënjeshtre/hile që ju pastorët e përdorni për të mashtruar të varfrit dhe për ta bërë më të lehtë për të pasurit për të dhënë para. Hajde, pra, tani – jemi vetëm. Pranoje se nuk ke besuar në të vërtetë asnjëherë se Jezu Krishti ishte Biri i Perëndisë.»

Pastor «Georg» pa drejt kryqit dhe pastaj buzëqeshi. «Sigurisht që e besoj. Është e vërtetë.»

«Nuk dua të bësh lojëra me mua!» – thirri kapiteni. Ai nxori revolverin prej këllëfit në brez dhe e mbajti afër trupit të pastorit. «Nëse nuk e pranon se është një gënjeshtër, do të të qëlloj.»

«S'mund ta pranoh këtë, sepse do të ishte një gënjeshtër, – tha Georgu. – Zoti ynë është Biri i vërtetë i Perëndisë. Të më qëllosh mua nuk do ta ndryshojë këtë.»

Kapiteni ilaku revolverin në dysheme. Pastori u habit kur ushtari e kapi prej kra-hësh me lot në sy.

«Është e vërtetë! – thirri kapiteni. – Është e vërtetë! Edhe unë e besoj. Nuk isha i sigurt që njerëzit do të vdisnin për këtë besim derisa e zbulova vetë. Oh, faleminderit! Ju keni forcuar besimin tim. Tani edhe unë mund të vdes për Krishtin. Ju më treguat se si.»

Martirë gjenden në çdo fe. Ne themi se jemi gati të vdesim për besimin tonë. Ata thonë se janë gati të vdesin për të tyrin. Si e vërteton një martir i krishterë besimin e tij apo të saj më tepër se një mysliman ekstremist? Nuk mundet. Që myslimanët janë gati të vdesin për besimin e tyre nuk provon besueshmërinë e fesë së tyre më tepër se ç'provon gatishmëria jonë krishterimin. Vetëm Zoti provon se ai është Zoti i vërtetë. Ne dëshmojmë të vërtetën, por Zoti është e vërteta. Dëshmia e tij për Birin e tij ia tejkalon tonës. Të tjerë mund të të tregojnë se si të vdisni për Jezusin, por vetëm Zoti mund të japë siguri të plotë që ia vlen.

Në qoftë se pranojmë dëshminë e njerëzve, dëshmia e Perëndisë është më e madhe, sepse kjo është dëshmia e Perëndisë që dha për Birin e tij.

1 Gjonit 5:9

FKSTREM

Mirënjohje ekstreme

HOLANDË: HANSI

Hansi ishte dalluar në Antverp, një qytet në Holandë, si student serioz i Biblës. Ai, madje i kalonte të dielat duke udhëzuar besimtarët e rinj. Por Hansi dhe e ëma e tij konsideroheshin kërcënim. Ata ishin anabaptistë (ishin kundër pagëzimit të fëmijëve) dhe besimi i tyre i bënte të konsideroheshin heretikë në sytë e udhëheqësve fetarë.

Në vitin 1577, nëpunësi i gjyqit dhe zyrtarët e tij më në fund e arrestuan Hansin dhe disa të tjerë, por nëna e tij mundi të arratisëj. Udhëheqësit fetarë e torturuan Hansin, duke u përpjekur ta detyronin të mohonte besimin e tij anabaptist, por ai refuzoi t'u dorëzohej torturave të tyre mizore.

Gjatë burgosjes së tij në një birucë me lagështirë e të izoluar në kështjellën e Antverpit, ai i shkroi letra inkurajimi familjes dhe miqve të tij.

Hansi shkroi letrën e mëposhtme:

«Nënë e dashur, jam i gëzuar t'ju them se jam mirë sipas mishit, por sipas shpirtit, falënderoj Zotin që më jep fuqi me anë të Frymës së Shenjtë, në mënyrë që të mos më ndryshojë mendja. Vetëm prej tij presim fuqi për t'u qëndruar këtyre ujërve mizorë, në mënyrë që të mos kenë pushtet mbi shpirtat tanë.»

Hansi u soll shumë shpejt para gjyqit ku shpalli me guxim besimin e tij dhe u dënua me djegie në turrën e druve. Letra e tij dëshmoi mirënjohjen e patundur ndaj Krishtit për të mbrojtur dhe shpëtuar shpirtin e tij.

«Zoti është i madh. Zoti është i mirë. Le ta falënderojmë atë për... vuajtjet tona?»
Kjo nuk është lutja e bekimit të fëmijërisë që jemi mësuar të dëgjojmë. Vetë shprehja tingëllon keq në veshët tanë, por na kujton se sa keq tingëllon parimi në zemrat tona. Ne do të preferonim ta falënderonim për ushqimin, sesa për sprovat tona. Në të njëjtën mënyrë, Hansi shkroi mirënjohjen e tij për vuajtjet në një shënim të çuditshëm falënderimi. Megjithatë, është lutja e sinkertë e një martiri, vuajtjet e të cilit e bënë njeriun që donte të ishte. A je ti pikërisht ashtu si doje të ishe për Krishtin? A je gati ta falënderosh Zotin që lejon gjëra, madje edhe vuajtje të mëdha, për të të sjellë këtë fitore?

Por ta falënderojmë Perëndinë që na jep fitoren me anë të Zotit tonë, Jezu Krishtit.

1 Korintasve 15:57

Thirrje ekstreme

PAPUA, GUINEJA E RE: JAKOB ÇALMERS

«Pyes veten nëse ka ndonjë djalë këtu, i cili... do t'ju sjellë ungjillin kanibalëve?» – sfidoi një misionar në një letër kishën e re të Jakob Çalmersit. Jakobi vendosi të ishte ky djalë.

Në vitin 1866, Çalmersi dhe gruaja e tij e re lundruan për në Detet Jugore dhe iu mbytn anija në Rarotonga, ku dhe u vendosën. Njëmbëdhjetë vjet më vonë, ata u larguan për në Papua, Guineja e Re dhe u pritën ngrohtësisht në një fshat kanibal të quajtur Suau.

Çalmersi filloi të udhëtonte lart e poshtë bregut. Në një prej ndalesave të tij, vendasit e rrethuan dhe kërkuan sëpatat dhe thikat, përndryshe do të vrisnin atë dhe gruan e tij. Çalmersi nuk lëshoi pe dhe vendasit e respektuan këmbënguljen e tij. Ata, madje kërkuan ndjesë të nesërmen dhe shumë shpejt u bënë miq.

Në vitin 1879, grua e tij vdiq. Çalmersi ishte i dërrmuar dhe i tha një miku: «Le ta varros pikëllimin tim në punë për Krishtin».

Çalmersi u kthye në Angli dy herë për pushime, vetëm për t'ju bindur edhe më tepër për thirrjen e tij. «S'mund të rezistoj me kaq shumë njerëz të egër pa dije/njohuri të Zotit pranë.»

Në 7 prill të vitit 1901, Çalmers, Oliver Tompkins dhe një grup ndihmësish lundruan për në ishullin Goaribari. Mëngjesin tjetër ai dhe Tompkinsi dolën në breg dhe u shoqëruan në një ndërtesë të madhe. Kur hynë brenda, vendasit i vranë burrat dhe i gatuan në të njëjtën ditë.

Sa e trishtueshme! Është e kuptueshme, kur lexojmë histori të martirëve si Jakob Çalmers, reagimi ynë i natyrshëm mund të jetë keqardhje dhe pikëllim, madje edhe turp. Çfarë humbjeje! Por duhet t'ju shohim historitë e tyre më nga afër. Çalmersi dha jetën e tij tokësore me qëllim që të ndante jetë të përjetshme me shumë të tjerë. Ai nuk e konsideroi martirizimin e tij një gabim trashanik. Pse duhet të dekurajohemi? Kur vuajtet tona tokësore sjellin lavdinë dhe nderin e parajsës një hap më afër të humburve, asgjë nuk është e kotë. Vuajtja bëhet pjesë e pandashme e planit të Zotit... për ty dhe për të tjerë. A je gati të durosh dhimbje tokësore me qëllim që t'ju sollësh mundësinë e parajsës të tjerëve?

Prandaj po ju lutem të mos ju lëshojë zemra për shkak të vuajtjeve të mia që i pësoj për ju! Ato janë nder për ju!

Efesianëve 3:13

FKSTREM

Dorëzim ekstrem

ISHUJT E ERËZAVE TË INDONEZISE: SUTARSI SELONG

Burri rrëmbeu gruan indoneziane dhe i bërtiti në fytyrë: «Thuaj: 'Allahu Ekber' (Zoti është i madh)! Vetëm thuaje!» Por e reja, Sutarsi Selong, refuzoi të dorëzohej dhe të çnderonte Zotin e saj të vërtetë.

Ai ia vendosi me tërbim armën në gojë. Ajo shqeu sytë, por sërish refuzoi. Duke u përlëshur me armën e tij, burri tërhoqi këmbëzën. Plumbi kaloi përmes faqes së majtë të Sutarsit, e cila u lëkund dhe pastaj rifitoi ekuilibrin, por militanti i zemëruar nuk ishte i kënaqur dhe nxori bajonetën duke e prerë në fytyrë.

Sutarsi Selong është një prej shumë të krishterëve të sulmuar nga një grup fanatikësh myslimanë të quajtur *Laskar Xhihad*, ose luftëtarë të shenjtë. Selongu dhe besimtarë të tjerë e dinin që luftëtarët e shenjtë, të cilët visheshin me rroba të bardha dhe maskoheshin, do t'i sulmonin shumë shpejt. Ata u mbledhën së bashku në kishën Nita, e cila është e rrethuar me një mur tre metra të lartë dhe disa persona bënëin rojë me radhë.

Kur luftëtarët islamikë erdhën, të krishterët u përpoqën të dorëzoheshin paqësisht. Megjithatë, flamuri i tyre i bardhë iu pre me shpatë dhe brenda disa minutave shpërtheu dhuna. Kjo skenë është bërë gjithnjë e më e zakonshme në ishujt indonezianë, ndërsa fraksionet fanatike islamike nxisin dhunën, djegin kishat dhe vrasin besimtarët.

Falë Zotit, shumë të krishterë në Indonezi, si Sutarsi Selong, refuzojnë të dorëzohen. Ata u rezistojnë kërkesave të luftëtarëve të xhihadit për të përqafuar islamin dhe të mohojnë Krishtin.

A nuk do të dorëzoheshim ne vetëm pak? Vetëm një centimetër? Çfarë pune do të prishte? Armiqtë mund të na përbuzin, siç bënë myslimanët fanatikë me Sutarsin, por ajo refuzoi të dorëzohej deri në fund. Në të njëjtën mënyrë ne nuk kemi luksin e një përkushtimi me alternativë – të dorëzohesh aty-këtu sa herë që tundimi bëhet i padurueshëm. Ne s'mund të vendosim se kur është mirë t'i dorëzohesh armikut dhe kur nuk është, duhet të qëndrojmë të patundur. Të qenit të patundur nuk do të thotë se ka më pak të ngjarë t'i dorëzohesh armikut, s'do të thotë se ti përpiqesh më tepër. Zoti të jep një zemër të patundur që të mos dorëzohesh. Pikë. Kërkoji Zotit sot një zemër të patundur.

Zemra ime është gati, o Perëndi, gati është zemra ime!

Psalmi 57:7

**Unë nuk erdha këtu të qëndroj në
heshtje duarkryq.
Erdha të flas për Krishtin.**


GALINA VICINSKAJA, E BURGOSURA PËR KRISHTIN NJËZET E TRE VJEÇARE NË RUSI
NË FILLIM TË VITIT 1980. AJO U ARRESTUA, SEPSE U MËSONTE FEMIJËVE NË NJË
KAMP VEROR TË KRISHTERË



FKSTREM

Zemërbutësi ekstreme

NIGERIA E VERIUT



Në Nigerinë e Veriut, myslimanët kanë krijuar Ligjin Sharia – kodi më i rreptë ligjor islamik. Të krishterët dominojnë popullsinë e Nigerisë, kështu që udhëheqësit islamikë këmbëngulin që ligji është i vlefshëm vetëm për çështjet e brendshme të myslimanëve. Megjithatë të krishterët e dinë më mirë. Qindra prej kishave të tyre janë shkatërruar tashmë. Nëse rindërtohen, ato digjen përsëri. Shumë të krishterë janë martirizuar.

Në qytetin Kaduna, në veri të Nigerisë, një prej drejtuesve të kishave deklaroi se ekstremistët islamikë kanë vendosur një çmim të majmë për kokën e të gjithë udhëheqësve të krishterë, duke ofruar njëqind mijë naira (afërsisht një mijë dollarë) për vrasjen e secilit. Në të njëjtën mënyrë kishte një çmim për kokën e Krishtit dhe ai u tradhtua vepër për tridhjetë sikla argjendi.

Për shkak të kërcënimit të vazhdueshëm, disa besimtarë po mendojnë të kundërvihen, por një drejtues i krishterë kohët e fundit i sfidoi besimtarët në Kaduna: «Në mes të gjithë kësaj duhet të kujtojmë mësimet e Zotit për të kthyer të keqen në të mirë dhe duke vuajtur me durim përballë kësaj që po ndodh. Për shkak se Nigeria është shpallur demokraci, ka një përgjegjësi për të krishterët që të sigurohen që të trajtohen me drejtësi».

Krishti ka sfiduar në të njëjtën mënyrë pothuajse dy mijë vjet më parë: «Duajeni Zotin, Perëndinë tuaj!»... Ky është urdhërimi i parë dhe më i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: «Duaje të afërmin tënd, porsivetveten».

(Mateu 22:37-39).

Zbatimi i urdhërimit të Jezusit për të dashur të afërmit tanë si veten është mjaft i vështirë. Është madje e vështirë të zbatosh urdhërimin e Jezusit për të dashur të afërmit tanë kur ata na urrejnë. Ne të gjithë e njohim këtë ndjenjë. Ti mund të kesh një koleg, i cili është i vendosur të sabotojë punën tënde. Mund të kesh një mësues, i cili ju shkakton probleme pa ndonjë arsye të dukshme. Ose mund të «bekohesh» me një të ashtuquajtur mik, i cili çuditërisht duket i kënaqur kur gjërat shkojnë keq në jetën tënde. Jezusi e njeh ndjenjën e gëzimit të të tjerëve për shkak të vuajtjeve të tij. Si mund t'i duash ata që do të paguanin për të të parë të vuash? Të tjerë mezi presin të të shohin të turpëroresh. Megjithatë, bindja jote ndaj Zotit në këtë fushë është e vyer.

*Por unë po ju them juve që më dëgjoni:
«T'i doni armiqtë tuaj; u bëni të mirë
atyre që ju urrejnë. Bekoni ata që ju
mallkojnë dhe lutuni për ata që ju
keqtrajtojnë».*

Luka 6:27-28

Shërbëtorë ekstremë

ARABIA SAUDITE: ESKINDER MENGIS

Ishte mesnatë kur oficerët shpërthyen në shtëpinë e tyre dhe zgjuan papritmas Eskinder Mengis, gruan e tij dhe tre fëmijët. Ata dolën jashtë, kur gjetën agjentët e Ministrisë së brendshme të Arabisë të bastisnin shtëpinë e tyre.

«Çfarë po bëni? Nuk keni të drejtë të shkatërroni shtëpinë tonë në këtë mënyrë.»

«Dhe ju s'keni të drejtë të ushtroni fenë tuaj në tokën e Muhamedit! U paralajmërova para se të vije që ta lije pas fenë tënde.» Oficeri e shtyu jashtë dere Eskinderin, ndërsa të tjerët mblodhën Bibla, himne, albume fotografish, kaseta audio dhe çdo gjë tjetër që mund ta përdornin si provë.

Eskinderi u çua në rajonin e policisë për ta marrë në pyetje, duke lënë pas gruan e tij të frikësuar dhe fëmijët. Eskinderi dhe familja e tij janë etiopas të krishterë. Ata janë midis shumë të huajve që përbëjnë një të tretën e popullsisë së Arabisë Saudite, që punojnë në shtetin e pasur me naftë. Shumë prej këtyre të huajve janë të krishterë, të cilët hasin vështirësi të tmerrshme kur vjen puna për shprehjen e besimit të tyre.

Shumë të krishterë nuk synojnë të ushtrojnë besimin e tyre kur shkojnë të punojnë në një vend mysliman, por kur ndodhen në renë e errët të islamit, ata fillojnë të shohin drejt qiellit dhe të kërkojnë bashkësi me besimtarë të tjerë rreth tyre. Shumë prej tyre, madje fillojnë t'u dëshmojnë punëdhënësve të tyre myslimanë. Në Arabinë Saudite, kthimi i një myslimani në krishterim çon në dënim me vdekje për të dyja palët.

Atje ku asnjë misionar me karrierë s'mund të shkelë, hyjnë në skenë shërbëtorët e krishterë me kohë të plotë. Ata sjellin një dëshmi unike dhe të fuqishme në një prej vendeve më të kufizuara në botë. Ata janë të krishterë të përkushtuar, të maskuar si inxhinierë të zakonshëm në fushat e naftës të Arabisë Saudite. Misioni i tyre është i qartë, megjithëse metodat janë të fshehta. Dëshmia e tyre është e fortë, por e fshehtë. Detyra e tyre është të paraqesin ungjillin duke qenë shërbëtor: koleg vetëmohues dhe punëtor në punë dhe komshi vetëmohues në shtëpi. Detyra jonë është t'i mbështesim ata me anë të lutjes. Ne jemi të gjithë shërbëtorë, të cilët bëjmë pjesën tonë për të sjellë botën në besim në Krishtin. Ata si Eskanderi në Arabinë Saudite po bëjnë punën e tyre. A po e bën ti tëndën?

*Jemi vepër e tij, të krijuar në
Krishtin Jezus për vepra të mira,
që Perëndia i përgatiti qysh më
parë që të jetojmë në to.*

Efesianëve 2:10

«Vriteni atë! Rroftë Diokleciani!» Jehonin fjalët në veshët e Zojes, ndërsa qëndronte në mes të Koloseut para turmës së zemëruar.

Zoja mendoi pse ishte atje dhe buzëqeshi. Ajo e mban mend ditën kur vizitoi bashkëshortin e saj në burg ku ai punonte, ruante të krishterët e burgosur sepse refuzonin t'u kushtonin fli zotave. Zoja u rrit duke dëgjuar se të krishterët ishin të drejtuar gabim dhe ndiqnin një besëtytni vdekjeprurëse, se ata i vunë flakën Romës në kohën e sundimit të perandorit Neron dhe morën dënimin që meritonin – u gozhduan në kryqe dhe iu hodhën luanëve.

Por atë ditë në burg, Zoja ishte e pranishme kur një familje e krishterë po lutej së bashku: «I dashur Zot, ndihmo që vdekja jonë t'i japë lavdi emrit tënd. Ne i falim ata që na kanë burgosur». Zoja u largua nga burgu e habitur. Pse kishin kaq shumë paqe këta të krishterë duke e ditur se shumë shpejt do të përballëshin me luanët?

Zoja filloi të takohej fshehtas me këtë familje dhe t'i pyeste për besimin e tyre. Shumë shpejt ajo ia dha zemrën e saj Jezusit.

Fjala u hap shumë shpejt për besimin e sapogjetur të Zojes dhe rojat u çuan në shtëpinë e saj për t'i dhënë mundësinë të mohonte besimin dhe t'i kushtonte fli perëndisë Mars.

Ajo refuzoi. Rojat e prangosën dhe e hodhën pikërisht në burgun, që ruante bashkëshorti i saj.

Kur Zoja vazhdoi të mos e mohonte besimin e saj, u var, u dogj dhe u hodh në lumë.

Kush është dëshmitari ekstrem në këtë histori? A është familja, e cila u lut para se t'u hidhej luanëve? Apo është Zoja, e cila nuk mohonte besimin e saj të sapogjetur para rojave? Përgjigjja është po. Familja, gjatë rrugës për të dalë nga kjo botë, solli një person tjetër në qiell. Të dy u bënë dëshmitarë ekstremë për Krishtin, i cili la një shenjë të pashlyeshme në faqet e historisë. Zoja, përndryshe do të ishte harruar si një grua pagane e një roje pagan burgu. Historia nuk do t'i kishte kushtuar asnjë vëmendje familjes si një prej mijërave të vrarë. Por një person i zakonshëm me një besim të jashtëzakonshëm ia vlen të mbahet mend. A do të shkruhet jeta jote në histori si një dëshmitar ekstrem për Jezun Krishtin?

Atë që pamë dhe dëgjuam, ne po jua shpallim, që edhe ju të keni bashkësi me ne.

1 Gjonit 1:3

FKSTREM

I burgosur ekstrem

KINË: AL LING

«Po e thua gabim, – udhëzonte roja i acaruar besimtaren e moshuar kineze. – Duhet të thuash: «Burgu është i mirë», jo «Jezusi është i mirë».

Al Long buzëqeshi. «Por burgu nuk është i mirë. A duhet të gënjej?»

«Atëherë bëj pesëdhjetë ulje-ngritje! – urdhëroi roja i irrituar. – Ashtu si dje.»

Shtatëdhjetë vjeçarja Al Ling bëri ulje-ngritjet dhe u kthye në kamp. Bashkëshori i Lingut ishte arrestuar për shpërndarje të unguillit dhe kishte ndërruar jetë. Tani ajo ishte në burg, sepse u tregonte kinezëve për dashurinë e Krishtit.

«Ushqimi është i mirë, burgu është i mirë!» – detyroheshin të burgosurit të thërrisnin sipas udhëzimeve pas një dite të vështirë pune në fushë. «Jezusi është më i mirë!» Zëri i saj i fortë u dallua në turmë.

«Al Ling, a do më tepër ulje-ngritje sot?» – pyeti roja.

«Unë dua që ti të dish se sa shumë të do Jezusi», – buzëqeshi ajo duke i dhënë përgjigje. Ajo u emocionua nga mundësia për t'u treguar rojave komunistë dhe të burgosurve të tjerë se sa i mirë ishte Jezusi, madje, edhe nëse do të thoshte të bënte ulje-ngritje të përditshme. Para se të dilte nga burgu, rojat vendosën ta merrnin në pyetje për herë të fundit. «Ku punon bashkëshorti juaj?» – pyeti roja i ri.

«Oh, ai po bën ca punë nën tokë», – u përgjigj ajo. Rojat e interesuar nxorën një bllok shënimesh. Al Ling buzëqeshi: «Ai ka ndërruar jetë vite më parë».

Al Ling nuk ishte teologe, as oratore e praktikuar. Por me pajajësinë e saj, këmbënguljen dhe madje, edhe me përgjigjet e saj me humor, ajo ishte në gjendje të hutonte armiqtë komunistë. Ne mund të luajmë lojëra mendore, duke pyetur veten se çfarë do të thoshim apo bënim nëse do të ishim në të njëjtën situatë. A mund të mendonim ne vetë? Jezusi na kujton se s' duhet të shqetësohemi se çfarë do të themi kur na pyesin për të mbrojtur besimin tonë. Neve nuk na kërkohet të japim një fjalim të përgatitur, kërkohemi të mbështetemi tek ai për fjalë urtësie – në momentin në të cilin kemi më tepër nevojë. Kur vjen ky moment, Zoti do të të japë fjalët për të qenë një dëshmitar efikas për hir të tij.

Ta vini, pra, në zemrën tuaj që të mos mendoni më parë se si do të përgjigjeni më parë për t'u mbrojtur...

Luka 21:14

FKSTREM

Vuajtje ekstreme – pjesa një

SUDAN: KAMERINO

Gjyshja më në fund e la nipin e saj të uritur dhjetë vjeçar të shkante të kërkonte ushqim. Ajo i dinte rreziqet jashtë fshatit dhe këmbënguli që të kthehej në shtëpi para mbrëmjes.

Kamerino dhe shokët e tij kishin ecur për disa kilometra, duke mbledhur manaferra kur papritur dëgjuan ushtarët që u bërtisnin. Të frikësuar, djemtë vrapuan në një fushë me bar të gjatë dhe u ulën poshtë. Ushtarët i vunë flakën fushës dhe pritën që djemtë të dilnin.

Të krishterët në Sudan shpërngulen prej vendit të tyre për shkak të bindjes fetare. Shumë prej tyre u kanë shpëtuar sulmeve mizore islamike me pothuajse, asnjë shenjë në trup.

Të thirrurat mbërritën shumë shpejt te djemtë, ndaj s'kishin zgjedhje tjetër veçse të vraponin për të shpëtuar jetën e tyre. Vetëm tre djem arritën të dilnin prej fushave; Kamerino qëndroi.

Kur zjarri u fik, ushtarët, të cilët kishin kapur tre të tjerët, shkuan ku qëndronte Kamerino. Dhimbje përvëluese kishin bërë që trupi i tij të mblidhej kruspull në pozicionin fetal. Trupi i djegur i djalit mbeti pa lëvizur dhe u la si i vdekur – një viktimë tjetër e krishterë. Ose të paktën kështu menduan ushtarët.

Me anë të ndonjë mrekullie, Kamerino u zvarrit jashtë fushës dhe u zbulua nga disa

bashkëfshatarë, të cilët e çuan në shtëpinë e gjyshes. Pjesa më e madhe e trupit të tij ishte djegur shumë. Nuk kishte asgjë që mund të bënin për Kamerinon, veçse të luteshin për dhimbjet e tij.

Të krishterët në Sudan e vendosin lutjen në perspektivë. Vuajtjet e tyre dhe rreziqet e përditshme kanë pakësuar varësinë te vetja dhe kanë rritur varësinë te Zoti. Lutja është gjithçka mbetet për shumë familje të krishtera në Sudan. Është një perspektivë e frikshme – dhe një vend i mrekullueshëm për të qenë dëshmitar për Krishtin. Nuk ka të ngjarë të themi se Zoti është gjithçka për të cilin kemi nevojë, derisa nuk është Zoti gjithçka që kemi. Përndryshe ne jemi të shpejtë për t'u mbështetur në aftësitë tona. Lutja – ajo që mund të na ndihmojë më tepër – e përdorim më pak. Zoti po ju thërret në lutje ekstreme në këto kohë ekstreme. Sa shpesh mbështetesh ti në lutje sikur të mos kishte asgjë tjetër që mund të bëjë, përveçse të lutesh?

Ngulmoni në lutje.

Kolosianëve 4:2

FKSTREM

Vuajtje ekstreme

SUDAN: KAMERINO

Një skuadër misionarësh amerikanë ishte duke udhëtuar përmes Sudanit duke shpërndarë ushqime, batanije dhe Bibla dhe duke shfaqur videon e filmit Jezus. Çdo gjë ishte sipas planit derisa kamioni i tyre ngeci në një lumë dhe ata humbën një ditë pune.

Misionarët ia përkushtuan ngjarjen Zotit dhe i kërkuan atij t'u drejtonte rrugën. Duke ditur se do t'u duhej t'u binin shkurt udhëtimeve të tyre për të përfunduar në kohën e duhur, ata vizituan një fshat më afër. Shumë shpejt pasi mbërritën, një grup grash erdhën duke vrapuar te vizitorët e huaj. Me një anglishte të çalë ato thërrisnin: «Ejani shpejt... djali ynë... ju duhet ta ndihmoni... ejani shpejt!»

Skuadra e ndoqi gruan në një ndërtesë të vogël e të errët. Në dysheme ata gjetën një djalë të vogël që qëndronte pa lëvizur, i mbështjellë me një batanije të rreckosur. Kur u ngrit batanija, ata zbuluan të djegurat e rënda që mbulonin trupin e Kamerinos.

Me të shpejtë dhe me kujdes e transportuan në kamionin e tyre dhe e çuan në spital, i cili ndodhej shtatëdhjetë e pesë kilometra larg. Atje, djali mori menjëherë trajtimin për të cilin kishte shumë nevojë. Sot sytë e Kamerinos mbushen me lot kur kujton se si lutja dhe providenca e shpëtuan. Ai e njuh dashurinë e Jezusit dhe fuqinë e tij për të shëruar dhe për herë të parë pas shumë muajsh, ai buzëqesh.

Edhe misionarët falënderojnë Zotin që, pas kaq shumë vdekjesh dhe vuajtjesh që përballën në Sudan, ai u lejoi të shpëtonin jetën e një djali të guximshëm dhjetë vjeçar.

Kamerino i jep kuptim të ri shprehjes: «Vazhdon». Jeta e tij dukej e destinuar për vuajtje të pafund nën një batanije të rreckosur. Megjithatë, pjesa e dytë vërtetoi të ishte një fund i lumtur dhe një kujtesë e hirit të Zotit. Por historia e tij nuk mbaron as këtu. Pjesa e tretë është akoma për t'u shkruar. Një ditë Kamerino do të përjetojë shërimin përfundimtar – një shtëpi qiellore ku nuk ka vuajtje apo dhimbje. Toka do të përkeqësohet para se të përmirësohet, por Zoti do të ndërhyjë në situatat më të këqija të imagjinueshme dhe do të largojë të gjitha vuajtjet. Pastaj ne të gjithë do të drejtohemi për në shtëpi. Nëse po kalon dhimbje të papërftytrueshme pikërisht tani, mbaj mend se për ku je nisur përfundimisht.

Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan.

Zbulesa 21:4

**Feja nuk është asgjë tjetër,
veçse bërja e vullnetit të Zotit para
vullnetit tonë
Ferri dhe parajsja varen vetëm prej saj.**


SUZANA UESLI, E ËMA E XHON DHE ÇARLS UESLIT



FKSTREM

Pastor ekstrem – pjesa e dytë

KOREJA E VERIUT: PASTOR IMI




«Ju mund të shkatërroni trupin tim, por jo shpirtin, – iu përgjigj pastori i guximshëm korean ushtrisë pushtuese komuniste të Koresë së Veriut. – Unë s’do të vendos propagandë marksiste në predikimet e mia. E di që natën keni marrë edhe pastorë të tjerë prej shtëpive të tyre dhe i keni torturuar, sepse nuk u ishin bindur urdhrave tuaj, nuk dua t’ia di se çfarë bëni me trupin tim.»

Zemërimi i oficerit u shtua ndërsa pastor Imi fliste. Pastaj ai tha me neveri: «Nëse nuk do t’ia dish për veten, atëherë mendo për familjen tënde. Edhe ata do të vriten». Pastor Imi hezitoi. Ai priste ta vrisnin, por s’kishte menduar për familjen e tij. Ai e dinte çfarë zgjedhjeje duhet të bënte dhe iu përgjigj oficerit komunist me qetësi: «Më mirë të më vdesin gruaja dhe foshnjat prej armës suaj, duke e ditur se ata dhe unë qëndruam besnikë, sesa të tradhtoj Zotin tim dhe të shpëtoj ata».

«Largojeni tutje», – urdhëroi oficeri. Pastori Im u mbajt në një qeli burgu të errët për dy vjet ku nuk lejohej të rruhej apo të ndërronte rrobat. Ai qëndroi me kurajë duke lexuar një varg biblik që ishte i çmuar për të. Çdo ditë prej qelisë së tij të vogël të izoluar, të tjerët mund të dëgjonin pastor Imin të recitonte me një zë të qetë e të dashur Gjonin 13:7 ku Jezusi premtonte: «Ç’po bëj unë – iu përgjigj Jezusi – ti tani nuk e kupton, do ta kuptosh më vonë». (Gjoni 13:7)

«Më vonë». Në një shoqëri moderne të kafes së çastit, të parave në dorë dhe të komoditeteve, «më vonë» është një term pothuajse i dalë jashtë përdorimit. Ne duam çfarë kërkojmë në çast, jo më vonë. Titujt sportivë, lajmet, argëtimet dhe motin – madje media na jep të dhënat e fundit në çdo fushë të jetës. Por përsëri Zoti, i cili mbretëron dhe sundon i pakufizuar në kohë vepron akoma mbi parimin «më vonë». A jemi gati t’i besojmë atij tani dhe të ndryshojmë kuptimin tonë të ngjarjeve në një kohë më të vonë, madje të papërcaktuar? Nëse je duke kaluar një sprovë tani, besimi është pasuria jote më e çmuar, jo të kuptuarit. Kërkoji Zotit një mundësi më të madhe për të besuar që do t’ia tejkalojë dëshirës sate për të kuptuar.



«Ç’po bëj unë – iu përgjigj Jezusi – ti tani nuk e kupton, por do ta kuptosh më vonë».

Gjoni 13:7

FKSTREM

Pastor ekstrem – pjesa e dytë

KOREJA E VERIUT: PASTOR IMI

«Por nuk jam komunist. Duhet të më besoni», – iu përgjërua pastor Imi kur Kombet e Bashkura rifituan territorin e pushtuar në shtator të vitit 1950. Ushtarët komunistë të Koresë së Veriut e kishin mbajtur Imin të mbyllur në një qeli të izoluar burgu për dy vjet, sepse u predikonte të tjerëve Krishtin dhe sepse refuzonte të ndryshonte predikimet e tij në propagandë pro-marxiste.

Kur trupat e KB mbërritën, ai u ndje i sigurt se do të ishte përsëri njeri i lirë. Por ata e morën për komunist dhe e hodhën në një tjetër qeli me robërit e tjerë komunistë.

Duke qenë një njeri i dhembshur dhe duke e pranuar situatën e tij si vullnetin e Zotit, pastor Imi u dëshmoi të burgosurve komunistë. Shumë prej tyre u kthyen te Krishti. «Ne vazhdojmë të dëgjojmë për këtë predikues të kampeve të burgut», – i tha një misionar amerikan mikut të tij, i cili po vizitonte Korenë si famulltar.

«Meqenëse ai i njeq aq mirë të burgosurit, pyes veten nëse do të na ndihmonte të organizonim një shërbesë ungjillizimi?» – pyeti famulltari. Zoti iu përgjigj lutjeve të tyre.

Misionarët amerikanë ia dolën mbarë të merrnin leje për të folur me pastor Imin. «Predikuesi i burgut» ndihmoi me besnikëri dhe predikoi në kampet e burgut në të gjithë Korenë e Jugut. Mijëra komunistë pranuan Krishtin. Brenda një viti, dymbëdhjetë mijë të burgosur ngriheshin çdo mëngjes për takime lutjeje.

Pastor Imi nuk e pa kurrë më familjen e tij, por mijëra vetë u bënë vëllezër në Krishtin në kampet e burgut.

«Cili është kuptimi?» Kjo është pyetja në mendjen e gjithkujt kur shohim vuajtje dhe dhunë të padrejtë. Megjithatë, s'mund t'i dimë gjithmonë qëllimet e Perëndisë. Ne mund të dimë që ato janë të mrekullueshme dhe pa dyshim që janë për të mirën tonë. Jemi si pjesë të veçanta të lojës formuese të shpërndara në një tavolinë. Hedhim sytë sa në një anë në tjetrën dhe shohim që pjesët rreth e rrotull nesh nuk duket se përshtaten, ndihemi të nervozuar dhe të frikësuar. Por Perëndia është Zoti i formueses – i vetmi që sheh figurën e plotë. Ai mund t'i shohë të gjitha pjesët në jetën tënde menjëherë. Ai e di se si përshtaten ato së bashku për qëllimin e tij të mrekullueshëm. A do të shohësh me besim në sytë e Zotit, i kënaqur në çfarëdo vendi që ai të vendos?

Të mrekullueshme janë qëllimet e tua dhe të fuqishme janë veprat e tua.

Jeremia 32:19

Histori ekstreme Krishtlindjeje

RUMANI: ARISTARI

«A i keni marrë erë ndonjëherë kashtës së freskët?»

Aristari, djaloshi fermer, filloi historinë e tij. «Është sikur dikush të ketë marrë esencën e pranverës dhe ta ketë mbledhur para se të humbasë freskinë. Maria dhe Jozefi duhet t'i kenë marrë erë kur arritën në grazhd pas udhëtimit të tyre të gjatë.»

Të burgosurit e tjerë dëgjonin me vëmendje ndërsa Aristari fliste natyrshëm për lindjen. «Veshët e kuajve duhet të jenë kthyer në drejtim të së qarës së Shpëtimtarit sapo ai lindi. Ata janë dëgjues të mrekullueshëm, ashtu si duhet të jemi edhe ne kur flet Jezusi.»

Jashtë burgut rumun të Tirgul-Oknas, bora ishte dy metra e thellë në një të ftohtë të hidhur në prag Krishtlindjesh. Të burgosurit kishin pak rroba, pak ushqim dhe rrallë nga një batanije secili. Ata të gjithë i kishte marrë malli për familjet e tyre dhe u kthyen për të dëgjuar historinë e Aristarit për lindjen e Krishtit si për ngushëllim.

Ai vazhdoi: «Drita e yllit duhet të ketë genë më e ndritshme se hëna. Ai mund të ketë ndriçuar përmes hyrjes së stallës dhe bëri gjelin të këndonte për të lajmëruar lindjen e Krishtit», Të burgosurit dëgjonin dhe qanin. Pas historisë, dikush filloi të këndonte, duke e thyer ajrin e pastër dhe të thatë. Të gjithë ndaluan për të dëgjuar tingullin e bukur.

Madje edhe në burgun e ashpër, historia e dhuratës së Krishtit ngrohu zemrat e shumë vetëve. Për shkak se Krishti është themeli, askush s'mund ta mbysë shpirtin e Krishtlindjes.

Sigurisht, Krishtlindja është festë e përvitshme. Krishtlindja është më tepër se kaq; ajo ndodh në zemrat e të gjithë njerëzve që ndalojnë për të festuar magjinë e hyrjes së Krishtit në botë – pavarësisht nga stina. Shpirti i ngrohtësisë së Krishtlindjes ndriçon në rrethanat tona më të errëta dhe na kujton për shpresën në Krishtin. Pavarësisht, nëse shohim apo jo borë në tokë, drita me ngjyra dhe një pemë të zbukuruar, mund ta festojmë Krishtlindjen. Çfarëdo të jemi duke kaluar, Krishti lindi për të të ndihmuar ty në kohë nevojë. Mëshira e tij zgjat gjatë gjithë vitit. Kur ishte hera e fundit që e ke ndjerë shpresën e Krishtit të gjallë në shpirtin tënd? Kalo pak kohë sot për të festuar lindjen e Krishtit – në botën dhe në zemrën tënde.

*Sot, në qytet të Davidit ju lindi
Shpëtimtari – Mesia, Zot!*

Luka 2:11

FKSTREM

Vizion më ekstrem

EVROPA LINDORE: NJË I BURGOSUR I KRISHTERË

E burgosura u soll para zëvendëskomandantes, një grua me fytyrë të skuqur, e ashpër, e zemëruar e me shpatulla të gjera. «Kështu, ti u ke folur përsëri të burgosurave për Zotin. Jam këtu për të të thënë se duhet t'i japësh fund!» Fytyra e saj ilustronte tërbimin në burgjet komuniste në Evropën Lindore.

E burgosura qëndroi e qetë, por e vendosur. Ajo i tha komandantes se asgjë nuk do ta ndalonte të fliste për Shpëtimtarin e saj.

Komandantja ngriti grushtin për të goditur të burgosurën, por papritur ndaloi. «Pse po buzëqesh?» – pyeti ajo.

«Po buzëqesh për shkak të asaj që shoh në sytë tuaj»,

«Dhe çfarë sheh?»

«Veten time. Edhe unë kam qenë mjaft impulsive. Isha e zemëruar dhe godisja derisa mësova çfarë do të thotë në të vërtetë të duash. Që atëherë, duart e mia nuk mblidhen më grusht.»

Ajo vazhdoi: «Nëse sheh në sytë e mi, do të shohësh veten, ashtu si vetëm Zoti mund të të bëjë, njësoj siç bëri me mua», Natyrshëm e burgosura do të kishte mbrojtur të drejtat e saj, duke e kthyer fyerjen me fyerje. Megjithatë, për shkak të jetës së saj të re në Krishtin, ajo shfaqti vetëm mirësi dhe fitoi të drejtën për të vazhduar dëshminë e saj.

Komandantja i uli duart, ajo u duk plotësisht e habitur dhe tha qetësisht: «Largohu»,

E burgosura vazhdoi dëshminë e saj për Krishtin në të gjithë burgun, pa ndërhyrje të tjera nga zëvendëskomandantja.

Përpyekjet e komandantes për të nxehur/zemëruar të burgosurën ishin si të diskutoje me një person të vdekur. Ishe sikur ajo po përpiqej të provokonte një kuçomë. Më në fund, komandantja e pa të burgosurën ashtu si ishte: një krijesë të re në Krishtin. Personi i vjetër që do të kishte reaguuar ndaj urrejtjes me më tepër urrejtje, nuk ishte më. Në vend të saj, e burgosura lejoi që komandantja të shihte vetëm përgjigje dhe mirësi të krishterë. Në të njëjtën mënyrë, ne duhet të shohim veten në një dritë të re. Nuk jemi më të detyruar t'i përgjigjemi armikut me armiqësi si të botës. Ne kemi vdekur prej mënyrës së mëparshme të jetesës. Kur ngacmohesh, nxite, apo provokohesh prej armikut për të vepruar në mënyrë të pahijshme, merr mësim prej së burgosurës në këtë histori. Shtiru si i vdekur.

Dhe duhet të përtëriheni me shpirtin e mendjes suaj dhe të visheni me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësi e shenjtëri që vjen prej së vërtetës.

Efesianëve 4:22,24

Kalim ekstrem lumi

TAJLANDE: VELLAI HO

Vëlla Ho ishte sëmurë dhe me ethe kur ai dhe miku i tij hynë në ujërat e akullt të lumit Mekong. Ata kishin qenë studentë të Biblës në Laos para se ushtarët komunistë të merrnin në kontroll kolegjin e tyre.

Mezi shpëtuan jetën e tyre rrugës për në Tajlandë. S'mund t'u thoshin lamtumirë as familjeve të tyre, të cilët nuk ishin të krishterë, sepse mund t'i dorëzonin në polici. Kështu thanë një lutje në heshtje dhe hynë në lumin e ftohtë e me baltë me një ngarkesë të çmuar të lidhur në shpinë – Bibla të mbështjella me plastmas. Gjërat e tjera tokësore u lanë pas.

Ho mendoi me vete: «Zot, të paktën nëse vdesim, ata do ta marrin vesh që jemi të krishterë dhe do të lexojnë një prej këtyre Biblave».

Pothuajse në mes të lumit, miku i Hosë i rraskapitur e kaloi çantën plastike nën kraharor për të qëndruar mbi të. Zhurma e papritur e përplasjes tërhoqi vëmendjen e rojave në kullën e vrojtimit aty afër dhe ata drejtuan një prozhektor mbi lumë. Drita shkëlqeu mbi njërën prej qeseve plastike dhe rojës iu duk si peshk.

I lehtësuar, Ho dhe miku i tij vazhduan për në anën tajlandeze të lumit. Ata falënderuan Zotin që Biblat e tyre që përmbanin fjalë jete të përjetshme kishin shpëtuar edhe jetën e tyre atë natë. Pasi arritën shëndoshë e mirë, iu përkushtuan shërbimit në shumë kampe refugjatësh në Tajlandë.

Misionarët në këtë histori po mbështeteshin në diçka më tepër se te letrat dhe lëkura për t'i shpëtuar. Ata u mbështetën te Zoti. Por kalimi i lumit në mesnatë na jep një pamje të saktë të rolit që duhet të luajë Bibla në jetën tonë. Ne duhet të mbështetemi në Fjalën e Zotit sikur jeta jonë të varej vetëm nga ajo. Nuk ka të ngjarë ta gjejmë veten në një situatë, ku kjo e vërtetë të bëhet realitet në kuptimin e parë të fjalës, megjithatë ilustrimi është i vlefshëm. Ne duhet të varem nga premtimet e Shkrimit për të ruajtur jetën tonë. Kur jemi në telashe, s'mund të notojmë mjaft larg për të dalë prej tyre. Duhet të «pluskojmë» në Fjalën e Zotit, përndryshe do të mbytemi.

O Zot, shiko sa i dua rregullat e tua! Me mirësinë tënde, më lejo të vazhdoj të jetoj!

Psalmi 119:159

FKSTREM

Tundim ekstrem

RUMANI: SABINA VURMBRAND

Gjatë gjithë kohës së martesës së tyre, Sabina Vurmbbrand nuk është lëkundur asnjëherë në dashurinë e saj për bashkëshortin, por kishin kaluar shumë vite që kur kishte dëgjuar prej tij në burg. Madje kishte fjalë që ai kishte vdekur, por ajo e ndiente Zotin t'i thoshte të mbahej fort e të besonte. A do të ishin përsëri bashkë një ditë?

Sabina ishte akoma e re dhe me një djalë adoleshent për të rritur, ajo ndiente shpesh tundimin për dashuri dhe shoqëri. Prandaj, kur një i krishterë i pashëm, i quajtur Paul, filloi të vinte për të ndihmuar djalin me studimet, ishte e natyrshme që do të ndihej e tërhequr prej tij. Ndonjëherë ai i mbante dorën ndërsa shëtisnin së bashku, apo shikonte me mall në sytë e saj.

Më në fund Sabina mori vendimin më të vështirë. Ajo e dinte se, nëse donte të vazhonte të besonte se do të ribashkohej me bashkëshortin e saj, duhet të shmangte të gjitha tundimet dhe të fokusohej në premtimin e Zotit drejtuar saj. Ajo i kërkoi Paulit të mos vinte më. Ai e kuptoi dhe me mirësjellje pranoi.

Pak kohë më pas, Zoti e shpërbleu besnikërinë e saj. Një mëngjes, ndërsa ishte në kishë duke fërkuar dyshe-menë, mori një kartolinë. Ishte firmosur «Vasili Gjorgjesku», por shkrimi i të shoqit ishte i qartë.

Sytë iu mbushën me lot ndërsa lexoi: «Koha dhe largësia mund të shuajnë një dashuri të vogël, por bëjnë që një dashuri e madhe të forcohet më tepër».

Historitë e kishës së persekutuar janë rreth njerëzve realë me emocione të vërteta. Protagonistët në këto histori të shkurtra nuk janë ca kukulla letre të krijuara me përsosmëri. Zëri i Martirëve është një zë i pagabueshëm i realitetit dhe i së vërtetës. Sabina manovroi përmes tundimeve që erdhën si rezultat i persekutimit të bashkëshortit të saj, i cili po vihej në provë, por edhe besimi i saj po shqyrtohej. Persekutimi na prek në një shumëllojshmëri nivelesh, por, ashtu si edhe kemi parë, ata që për pak kohë janë mbledhur në mbërthimin e tij të ashpër, dalin më të fortë si rezultat i tij. Ashtu si Vurmbbrandët, kapaciteti yt për dashuri do të rritet me anë të persekutimit – vetëm, nëse e lejo atë të përmbushë qëllimin e tij të vërtetë.

*Arsyeton gjithçka, beson gjithçka,
shpreson gjithçka, duron gjithçka.
Dashuria nuk mbaron kurrë.*

1 Korintasve 13:7-8

**Nëse ke një vizion, asgjë nuk do të të
frikësojë.**

**Me vizionin e tij, Zoti ju jep fuqi.
Ju nuk duhet të keni frikë.**


PASTOR IRANIAN



FKSTREM

Një tjetër adoleshente ekstreme

PAKISTAN: TARA



Tara ishte në klasë të shtatë në Pakistan kur u regjistrua fshehurazi në një kurs biblik me korrespondencë për të mësuar më shumë rreth Zotit. Familja e saj strikte myslimane nuk do të mundej kurrë t'u përgjigjej pyetjeve të saj për Jezusin, ndaj ajo ishte e vendosur ta zbulonte vetë të vërtetën.

Por kur prindërit e saj e zbuluan në dhomë duke lexuar libra të krishterë, u zemëruan shumë. Në nëntor të vitit 1992 e rrahën aq shumë, sa ajo mbeti pa ndjenja në dhomë për një javë. Ajo beson se një engjëll më në fund e zgjoi dhe e ndihmoi të shkonte në spital.

Tara vazhdoi të rritej në besim dhe në vitin 1995 u pagëzua fshehurazi. Më pas prindërit e saj ranë dakord që ta martonin me një burrë mysliman. Kur Tara refuzoi të bindej, e rrahën përsëri. E detyruan gjithashtu të qëndronte disa ditë me radhë pa gjumë. Gjatë kësaj kohe, Tara pati tre vizione në të cilët dëgjoi një zë t'i thoshte: «Unë jam me ty, jam Ati yt».

Pas rrahjeve të tjera, ajo ra në koma. U zgjua pas tri ditësh dhe e gjeti veten në një pellg me gjak. Ajo dëgjoi përsëri të njëjtin zë inkurajues: «Unë jam Ati yt. Unë do të të mbroj».

Tara mundi të largohej dhe tani jeton në një shtëpi të sigurt në një shtet tjetër, ku i shërben Zotit me kohë të plotë me premtimin e mbrojtjes së tij.

A është krishterimi një propozim me humbje? Ata në vendet e izoluar e dinë ç'do të thotë të humbasësh për shkak të besimit në Krishtin, e dinë se si mund të humbasin familjet në shumë mënyra. Një familje myslimane mund t'i refuzojë plotësisht pjesëtarët e familjes të kthyer në besim duke i quajtur tradhtarë. Ata janë të përjashtuar. Një familje e krishterë nuk ia kalon më mirë, megjithëse në rrethana të tjera. Ekstremistët rrafshojnë familje të tëra të krishtera për shkak të besimit të tyre. Humbja është e tmerrshme. Megjithatë, ne kemi premtimin e Krishtit. Çfarëdo që të humbasim për hir të tij do të shumëfishohet qindra herë më tepër në jetën tonë të përjetshme në parajsë. Nuk është lojë fati. Është një rrezik i llogaritur i bazuar në të pagabueshmen Fjalë të Perëndisë. Është në dorën tënde të besosh ose jo.

Dhe kushdo që ka lënë për hir të emrit tim, shtëpi, vëllezër, motra, atë, nënë, grua, bij ose ara, do të marrë njëqindfish dhe do të trashëgojë jetë të përjetshme.

Mateu 19:29

FKSTREM

Rreth Zërit të Martirëve...

I shërben kishës së persekutuar që në vitin 1967.

Zëri i Martirëve është një organizatë ndërdenominacionale, e cila i është kushtuar dhënies së ndihmës kishës së persekutuar në mbarë botën. ZM u themelua nga pastor Riçard Vurmbrandi, i cili ishte i burgosur në Rumaninë komuniste për katërbëdhjetë vjet për besimin e tij në Jezu Krishtin. Gruaja e tij, Sabina, u burgos për tre vjet. Në vitin 1960 Riçardi, Sabina dhe djali i tyre, Mihai, u shpenguan prej Rumanisë dhe erdhën në Shtetet e Bashkuara. Me anë të udhëtimeve të tyre, Vurmbrandët treguan historitë e vuajtjeve me të cilat të krishterët përballen në vendet e ndaluara dhe themeluan një rrjet të përkushtuar zyrash për t'i dhënë ndihmë kishës së persekutuar. Sot Zëri i Martirëve vazhdon me këtë mision rreth botës me pesë qëllimet e tyre kryesore:

Të inkurajojë dhe të fuqizojë të krishterët për të përmbushur Porosinë e madhe në vendet e botës ku ata persekutohen për shkak të përfshirjes në propagandimin e ungjillit të Jezu Krishtit. Ne e kryejmë këtë duke siguruar Bibla, literaturë, transmetime radiofonike dhe forma të tjera ndihme.

T'u japë ndihma familjeve të martirëve të krishterë në këto vende të botës.

Të pajisë të krishterët lokalë për të fituar për Krishtin ata persekutues, të cilët kundërshtojnë ungjillin në ato vende ku besimtarët persekutohen vazhdimisht për dëshminë e tyre të krishterë.

Të ndër marrë projekte inkurajimi, duke i ndihmuar besimtarët të rindërtojnë jetën e tyre dhe dëshminë e krishterë në vendet që kanë vuajtur më parë shtypjen komuniste.

Të theksojë bashkësinë e të gjithë besimtarëve duke informuar botën për mizoritë e kryera kundër të krishterëve dhe duke kujtuar kurajën dhe besimin e tyre.

Zëri i Martirëve boton një letër informacioni mujor falas, duke dhënë informacionet e fundit mbi kishën e persekutuar dhe duke sugjeruar mënyra se si mund të ndihmoni.

Për t'u regjistruar, telefononi ose shkruani:

Zëri i Martirëve

P. O. Box 443

Bartlesville, OK 74005

(800) 747-0085

e-mail: thevoice@vom-usa.org

web site: www.persecution.com

Treguesi i Temave

-A-

Adhurimi – 46, 60, 127, 128, 150, 200
Afër përjetimit të vdekjes – 149, 269, 331
Akuza të rreme – 266
Autoritetet – 22, 69, 155, 254, 258, 283, 324

-B-

Besimi – 20, 44, 105, 112, 122, 133, 143, 222, 223, 226, 264, 299, 313, 334, 339
Besim ekstrem – 17, 32, 34, 36, 82, 99, 113, 298, 310, 311
Besimi (citime) 308
Besnikëria – 6, 94, 110, 150, 203, 206, 226, 227, 230, 241, 264, 363
Besnikëria e Zotit – 95, 135, 148, 152, 335, 347
Besueshmëria – 92, 221, 169, 221, 303, 358, 362
Biblat – 49, 162, 201, 209, 225, 241, 265, 267, 274, 275, 307, 317, 330, 362
Bindja – 1, 7, 22, 50, 146, 169, 177, 257, 274, 283, 287, 339, 351, 357, 358, 359
Bukuria – 272

-D-

Darka e Zotit – 92, 134
Dashuria – 71, 109, 140, 363
Dashuri për armiqtë – 18, 39, 69, 71, 73, 74, 89, 93, 101, 124, 125, 130, 131, 139, 140, 167, 168, 179, 192, 198, 204, 336, 351
Dashuri për Jezusin – 50, 156, 164, 175, 176, 203, 229, 235, 243, 292
Dënim me vdekje – 107, 235, 236, 247, 249
Dëshmi – 194, 227, 242, 284
Dëshmitarët – 4, 12, 57, 132, 157, 286, 353
Disponueshmëria – 33
Drita – 44, 159
Dyshimi – 54, 346

-DH-

Dhuratat – 184

-E-

Emri i Jezusit – 158
E mira prej së keqes – 5, 29, 44, 74, 79, 93, 100, 115, 131, 144, 145, 80, 210, 244, 245, 260, 261, 307, 324, 326, 34
Engjëjt – 141, 290, 319, 331, 365
E vërteta – 38, 41, 81, 148, 172, 206, 274, 275, 277, 354

EKSTREM

-F-

Falënderimi – 347
Falja – 10,11, 18, 39, 73, 89, 101, 106, 121
Familja – (shiko Krishti përpara familjes)
Fillimet e Zërit të Martirëve – 215
Filmi Jezus – 100
Frika – 25, 41, 115, 328
Fryma e Shenjtë – 240, 347
Fushë misioni – 43, 208, 209

-G-

Gatishmëri – 33, 339
Gëzim – 61,107, 132, 150, 157, 207, 218, 277
Guxim – 27, 31, 97, 115, 122, 260, 306, 323, 337, 338

-H-

Hakmarrja – 300
Hinduistët – 13, 87

-I-

Imitimi – 62, 67, 216
Inkurajimi – 48, 67, 157, 293, 314
Inkurajues – 65, 75

-K-

Këmbëngulja – 52, 56, 87, 147, 148, 185, 193, 195, 197, 211, 229, 265,
284, 332, 304, 305
Komunikimi – 37, 215, 118, 220, 224, 227, 281, 312, 315
Krishti para familjes – 2,13, 16, 31, 36, 99, 113, 114, 169, 170, 219, 240,
242, 257, 258, 275, 276, 363
Krishti në ne – 202, 205, 361
Krishtlindja – 360
Kryqi i Krishtit – 54, 114, 166, 217, 268, 341
Kthimi në besim – 56, 153, 269, 351

-L-

Largimi i hidhërimit – 109, 154, 168, 325
Lavdërimi – 78, 142, 145
Liri në burg – 256
Liri fetare – 340
Luftë shpirtërore – 64, 129, 231
Lutja – 1, 5, 26, 28, 35, 37, 47, 63, 91,188, 279, 302, 303, 324, 336, 355

EKSTREM

-M-

Marrja parasysh e çmimit – 21, 211, 232, 308, 337
Martirizimi (citime) – 84, 217
Mohimi – 46, 66, 72, 121, 205, 271
Mrekulli – 30, 40, 118, 153, 158, 186, 219, 290, 303, 321, 331, 356
Mundësi – 329
Mundësi të humbura – 22, 123, 125, 183, 201
Myslimanët – 1, 12, 16, 26, 30, 34, 40, 62, 103, 149, 158, 193, 214, 219, 221, 230, 235, 232, 233, 240, 269, 278, 282,
286, 289, 291, 299, 309, 349, 352, 355, 365

-N-

Nderimi i nënës – 170
Në fshehtësi – 191, 199, 352
Nxitje – 105, 349, 337

-P-

Pagëzimi – 111
Paqe – 85, 173, 174
Pendimi – 300, 318
Përgatitje – 3, 164, 214, 246
Përgjigje lutjeje – 40, 192, 198, 223, 273, 302, 312, 324, 353
Përgjegjësia – 16, 323
Përkushtimi – 1, 13, 14, 17, 104, 108, 174, 230, 316, 329, 345
Persekutimi – (citime) 91, 161, 180, 182, 205, 294, 301
Persekutimi në Amerikë – 86
Pjekuri shpirtërore – 32, 44
Poezi – 178, 327
Prania e Hyznisë – 15, 51, 95, 115, 178, 180, 189, 228, 269, 365
Pranimi – 1, 190, 224, 243, 250, 293, 296, 343, 344
Pranimi (përsa u përket citimeve) 315
Premtim aleance – 246
Prindër — të sulmuar prej prindërve – 12, 33, 88, 186, 365
Prioritetet – 137, 326, 330
Pronësia – 24, 102, 136
Protestë paqësore – 76
Provë besimi – 4, 72, 115, 165, 212, 346, 348
Punë për Zotin – 297, 333

-Q-

Qëllimi – 53, 60, 248, 249
Qëndrueshmëria – 59, 151, 262, 270, 271, 225, 299, 319, 344

-R-

Refugjatët – 278
Revolucionarët – 251
Rreziqet – 97, 138, 155, 232, 286, 288, 289, 352, 362

Rritja e kishës – 145, 210, 294
Rritje shpirtërore – 120, 152

-S-

Sakrificë – 13, 16, 60, 83, 135, 306
Strategji të pazakonshme – 37, 43, 78, 116, 138, 191, 199, 213, 220, 234, 237, 239, 305

-Sh-

Shembull – 79, 83, 95, 97, 98, 103, 146, 150, 171, 181, 204, 207, 216, 218, 242, 252, 262, 279, 306, 309
Shenjat – 8, 34, 65, 230, 295, 309
Shërbimi – 117, 193, 230, 259
Shërimi – 153, 321
Shpërblimi – 160, 165, 180, 184, 285

-T-

Tradhtia – 10, 50, 121, 172, 205, 235, 255, 271

-U-

Udhëheqja e Zotit – 19, 119, 259, 273, 320
Ungjillizimi – 43, 169, 194, 196, 208, 257, 323, 348, 352
Ungjillizim në burg – 1, 23, 60, 71, 96, 111, 117, 142, 181, 187, 202, 207, 208, 256, 263, 296, 297, 322, 332, 333, 354, 359
Ungjilltarë – 11, 57, 58, 65, 268, 310
Uniteti – 342
Ushtarë për Krishtin – 271

-V-

Vdekja – 45, 47, 55, 64, 156, 164, 173, 214, 222, 228, 270, 327
Verbëria – 52, 226
Viktima të pafajshme – 62, 99, 80, 291, 255, 311, 114, 169, 170, 219, 240, 242, 257, 258, 275, 276, 363
Vizioni – 215, 253, 300, 328, 364
Vuajtje – 61, 62, 70, 77, 126, 151, 152, 184, 204, 212, 217, 238, 243, 300, 302, 329, 347, 355

-Xh-

Xhihadi i Indonezisë – 278, 291, 349

-Z-

Zgjedhjet – 9, 46, 125, 136, 236, 204

Treguesi i Shkrimit (Biblës)

Zanafilla 22:12 (13)
Zanafilla 50:20 (131)

Ligji i Përtërirë 7:6 (102)

Jozueu 1:9 (113)
Jozueu 24:15 (9)

Gjyqtarët 5:3 (128)

Estera 4:16 (260)

Jobi 10:12 (302)
Jobi 36:15 (295)
Jobi 42:2 (30)
Jobi 42:5 (219)

Psalmi 4.1 (198)
Psalmi 12:6 (330)
Psalmi 17:6 (324)
Psalmi 22:31(281)
Psalmi 25:5 (320)
Psalmi 27:1 (25), (149)
Psalmi 31:23(176)
Psalmi 32:6 (188)
Psalmi 33:5 (155)
Psalmi 37:5-6 (108)
Psalmi 42:2 (127)
Psalmi 44:20-21 (143)
Psalmi 57:7 (349)
Psalmi 62:8 (92)
Psalmi 69:7 (267)
Psalmi 80:18 (228)
Psalmi 86:11 (239)
Psalmi 90:12 (137)
Psalmi 91:11-12 (319)
Psalmi 95:1 (78)
Psalmi 102:12 (186)
Psalmi 119:18 (241)
Psalmi 119:47 (201)
Psalmi 119:159(362)
Psalmi 119:72 (265)
Psalmi 119:101 (284)
Psalmi 119:103 (307)
Psalmi 133:1 (342)
Psalmi 145:4 (340)

Fjalët e urta 2:8 (303)
Fjalët e urta 3:5 (167)
Fjalët e urta 7:2 (275)
Fjalët e urta 19:21 (19)
Fjalët e urta 20:24 (83)
Fjalët e urta 25:11 (181)

Predikuesi 3:11 (326)

Isaia 26.3 (173)
Isaia 40.31 (59)
Isaia 42.4 (36)
Isaia 42.6-7 (202)
Isaia 53.5 (289)
Isaia 55.8 (100)
Isaia 64.8 (165)

Jeremia 15.16 (338)
Jeremia 20.9 (51)
Jeremia 32.19 (359)

Danieli 3.17-18 (221)
Danieli 6.16 (200)
Danieli 6.22 (290)

Joeli 2.13

Mateu 5.11 (64)
Mateu 5.13 (206)
Mateu 5.14 (44), (159)
Mateu 5.16 (4)
Mateu 5.43-44 (18)
Mateu 6.12 (10)
Mateu 6.34 (313)
Mateu 7.7 (310)
Mateu 7.16-17 (230)
Mateu 9.36 (234)
Mateu 10.28 (222)
Mateu 10.32 (41)
Mateu 10.36 (237)
Mateu 11.29 (69)
Mateu 11.30 (195)
Mateu 12.30 (46)
Mateu 13.23 (88)
Mateu 17.20 (94)
Mateu 18.3 (82), (291)
Mateu 19.29 (365)

EKSTREM

Mateu 20.26 (193)
Mateu 29.18-19 (185)

Marku 3.35 (276)
Marku 4.22 (85)
Marku 8.35 (304)
Marku 10.15 (75)

Luka 1.38 (276)
Luka 2.11 (360)
Luka 6.22 (142)
Luka 6.27 (179), (351)
Luka 6.28 (124)
Luka 6.35 (11), (139)
Luka 6.37 (204)
Luka 8.17 (282)
Luka 12.15 (24)
Luka 21.14-15 (354)
Luka 21.17-19 (316)
Luka 21.34 (136)
Luka 22.19 (134)

Gjoni 3.16 (99), (208)
Gjoni 3.30 (249)
Gjoni 4.35 (144)
Gjoni 6.68 (311)
Gjoni 7.17 (97)
Gjoni 8.32 (81)
Gjoni 9.4 (183)
Gjoni 10.10 (264)
Gjoni 12.19 (345)
Gjoni 12.21 (331)
Gjoni 12.32 (40)
Gjoni 13.7 (358)
Gjoni 14.23 (274)
Gjoni 15.13 (135)
Gjoni 16.22 (218)
Gjoni 21.19 (156)

Veprat 1:8 (38), (240)
Veprat 4.13 (268)
Veprat 4.19 (283)
Veprat 4.20 (286)
Veprat 4.29 (71)
Veprat 5.29 (22)
Veprat 9.11 (5)
Veprat 16.34 (285)
Veprat 20.24 (248)

Romakëve 1:11-12 (48)
Romakëve 1:16 (93)

Romakëve 1:25 (277)
Romakëve 2:4 (74)
Romakëve 3:19 (250)
Romakëve 5:3-5 (53), (225)
Romakëve 5:8 (263)
Romakëve 6:23 (235)
Romakëve 8:5 (87)
Romakëve 8:28 (244)
Romakëve 8:37 (153)
Romakëve 8:38-39 (164)
Romakëve 10:14 (162)
Romakëve 10:17 (209)
Romakëve 12:1 (16)
Romakëve 13:1 (254)
Romakëve 14:4 (299)
Romakëve 14:12 (229)
Romakëve 15:19 (31)
Romakëve 16:20 (300)

1Korintasve 1:18 (226)
1Korintasve 2:1 (227)
1Korintasve 3:6-7 (261)
1Korintasve 7:23 (160)
1Korintasve 9:22 (191)
1Korintasve 11:1 (79)
1Korintasve 13:7-8 (363)
1Korintasve 13:13 (89)
1Korintasve 15:42 (65)
1Korintasve 15:55 (45)
1Korintasve 15:57 (347)
2Korintasve 1:21 (246)
2Korintasve 3:3 (171)
2Korintasve 3:4 (86)
2Korintasve 4:7 (213)
2Korintasve 4:10-11 (214)
2Korintasve 4:17 (180)
2Korintasve 4:18 (335)
2Korintasve 5:13 (199)
2Korintasve 5:17 (58)
2Korintasve 6:16 (321)
2Korintasve 7:4 (150)
2Korintasve 7:9 (104)
2Korintasve 7:10 (318)
2Korintasve 11:14-15 (255)
2Korintasve 12:9 (54), (148)

Galatasve 2:20 (236)
Galatasve 6:14 (114)

Efesianëve 1:8 (236)
Efesianëve 2:10 (352)

EKSTREM

- Efesianëve 3:1 (256)
- Efesianëve 3:13 (348)
- Efesianëve 3:20 (333)
- Efesianëve 3:29 (334)
- Efesianëve 4:22-24 (194), (361)
- Efesianëve 4:32 (121)
- Efesianëve 5:1 (306)
- Efesianëve 6:7 (130)
- Efesianëve 6:11(169)
- Efesianëve 6:12 (129)
- Efesianëve 6:16 (122)
- Efesianëve 6:17 (317)
- Efesianëve 6:18 (279)
- Efesianëve 6:19-20 (1)

Sfidë ekstreme

Ajeni gati për një sfidë? Atëherë hapeni këtë libër dhe lexoni vetëm një prej 365 dëshmime të vërteta të burrave e grave, të cilët u dhanë plotësisht për Krishtin. Shihni nëse ka ngjashmëri me ndonjë libër tjetër përkushtimi, që ju ka rënë në duar më parë.

Ndjekësit seriozë të Jezusit paguajnë një çmim, ndërsa ndjekësit ekstremë shpesh paguajnë çmimin përfundimtar. Zëri i Martirëve, bashkautorë të librit më të shitur «*Të çmendur për Jezusin*», ju sjellin histori të përditshme përkushtimi plot guxim, dëshmi dhe dhembshuri – një çmim i kërkuar dhe i paguar.

Në një epokë ekstremesh, ju mund të gjeni besim, forcë, inkurajim dhe shpresë përmes historive të bashkëbesimtarëve nga e gjithë bota, nga shekujt e kaluar deri më sot. Këta burra dhe gra, të rinj e të moshuar, prekën kufijtë e skajshëm të përkushtimit njerëzor.

Çdo histori është e vërtetë, e paharrueshme, ekstreme dhe jetëndryshuese. Merreni këtë sfidë sot dhe shikojeni vetë. Tregime ditore përkushtimi të besimtarëve të hershëm dhe atyre të kohëve të sotme, të cilët sakrifikuan gjithçka për Krishtin.